

KDU 821.18(05)
811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

27
2020



KDU 821.18(05)
811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

27
2020

KDU 821.18(05)
811.18(05)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

STUDIES

A review for philological studies

27
2020

Editorial board

Zejnullah Rrahmani, editor-in-chief

Bardh Rugova, secretary

Victor Friedman, member

Kujtim Shala, member

Nysret Krasniqi, member



PRISHTINA
2021

KDU 821.18(05)
811.18(05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

STUDIME

Revistë për studime filologjike

27
2020

Këshilli redaktues

Zejnullah Rrahmani, kryeredaktor

Bardh Rugova, sekretar

Victor Friedman, anëtar

Kujtim Shala, anëtar

Nysret Krasniqi, anëtar



PRISHTINË
2021

Copyright © ASHAK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “*Studime*”
Rr. Agim Ramadani, nr. 305
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. + 381 38 249 303
E-mail: ashak@ashak.org
www.ashak.org

PËRMBAJTJA

KUJTIM RRAHMANI: KRESHNIKU DHE TRADITA HEROIKE	7
IMRI BADALLAJ: SISTEMI KONSONANTIK NË ITALO- ARBËRISHTEN E QEFTIT	35
KUJTIM M. SHALA: LULE FRANGU SIPAS ZEF PLLLUMIT	63
ALI ALIU: PORTRETE	93
DINO MUJADŽEVIĆ / CHRISTIAN VOSS: NDËRTIMI I IDENTITETIT SUB - JUGOSLLAV NË ENCIKLOPEDIJA JUGOSLLAVIJE (1955-1990)	99
NYSRET KRASNIQI: REFUZIMI ESTETIK NGA QELITË E BURGUT	117
MUHAMEDIN KULLASHI: PASIONI, SUBJEKTIVITETI DHE POLITIKA NË TRAGJEDITË E RACINE-IT	131
MUHAMET HAMITI: SHKRIMTARI PËRKTHYES / PËRKTHYESI SHKRIMTAR	167
LINDA MËNIKU: KONEKTORËT KUNDËRSHTORË NË VEPRËN E PJETËR BOGDANIT “CUNEUS PROPHETARUM”	185
MIMOZA HASANI PLLANA: KOLEKSION TEMASH NË POEZINË E NJË DEKADE TË VEÇANTË	199
LUMNIJE JUSUFI: TRANSFER KULTUROR DHE GJUHËSOR GJERMAN NË KOSOVË	211

ALBANË MEHMETAJ: POEZIA E DE RADËS DHE TEORIA ESTETIKE	229
MANJOLA LUBISHTANI: MARKERËT RENDITËS TË MBYLLJES NË GJUHËN SHQIPE	241
FLAMUR MALOKU: POEZIA E SABRI HAMITIT	253
EGZONA HYSENAJ, LINDITA TAHIRI: IDEOLOGJIA POSTMODERNE E LETËRSISË SË POPULLARIZUAR	265
VJOLLCA BELEGU-CAKA, NEBI CAKA: VEÇORITË E LEKSIKUT TË NJË KONFERENCE TË CIGRE-s.....	271
AGOSTINO GIORDANO: EMANUELE GIORDANO, prift e albanolog (Në 100-vjetorin e lindjes).....	293

RECENSIONE

MEHMET HALIMI, KUJTIM SHALA: LEKSIKON I TERMAVE TË SOCIOLINGUISTIKËS	313
REXHEP ISMAJLI: BRIAN D. JOSEPH, VËSHTRIME ALBANO-BALKANOLOGJIKE	316

Kujtim Rrahmani, Prishtinë

KRESHNIKU DHE TRADITA HEROIKE

Dera e kreshnikëve dhe tradita shqipe

Paleologjia poetike e botës shqiptare të grish si konceptim kohe hapësire, si kulturë kërkimi, abstraktimi e indiference. Nëse shtegu i aventurës zbuluese me fytyrim arkeologjie, e cila është “nji argtim aq i kândshëm, sa të kallxohet me gojë” (Gjeçovi 2019: 57), nuk është tipike për traditën poetike shqipe, kjo s’domethënë se ky shteg është i parrahur.

Heroi i botës kreshnike si *hero epik* (Campbell 1993; Bowra 1952) e ka brenda lëkurës së çetaniut arkeologun; ai kërkon, gjen e s’gjen, fiton e humb, gjen kur s’e pret dhe humb kur s’e pret. Dhe, meqë ky hero shtresohet semantikisht brenda këngës duke u bërë subjekt i një paleologjie poetike, e kërkon edhe audiencën e interpretuesin e tillë. Bota e tij ka njohur shtresa kuptimesh e interpretimesh me ngjyra guri, bronzi, metali, leshi e mëndafshi.

Statusi *naturalis* bëhet *modus vivendi* i kreshnikut si hero gjahtar. Ai jeton në gjendje natyrore, duke pranuar një minimum efektesh sociale e kulturore që rrjedhin nga poliset krajli. Karakteri i tij ruan pamje fantastike të njeriut që u përket dy botëve të shkrira në një: asaj natyrore pagane dhe asaj përrallore si një trup bjeshke e cila hera-herës nxjerr kryet dhe merr frymë edhe në fushë e det.

Kjo botë e kreshnikut i sugjeron mjaft edhe horizontit të receptimit. *Perspektiva natyrore* (Frye 1965) joshet nga bota e kreshnikëve dhe bëhet ngjitëse, por fiton peshë nëse rri përtej një kulture popullore natyrore të konceptit nacional-romantik, që e trajtonte natyren si organikë peme dhe e identifikonte atë me *popull e folklor*. Natyrorja e këtushme është thirrje e poetikës primitive humane që njeh edhe shtegun transcendental, meqë “është thjesht përtej fuqive tona hyrja në imagjinatën e paskajtë të njerëzve herakë” (Vico 1948: 106).

Efekti i mitit, si përbërës me peshë i botës së kreshnikut është goxha i shkrirë në kazanin e shikimit të gjerë panteist a animist, duke eklipsuar spektrin e gjerë mitologjik, hiç efekteve të nënkuptuara kozmogonike nga të cilat ka dalë skena natyrore e kreshnikëve. Për

lidhjen e kreshnikëve me mitin vlen ajo çfarë thoshte Jungu: mentaliteti primitiv nuk inventon *mite* sa provon a përjeton ato (1951: 101).

Kreshnikët kanë hyrë në poezinë e kulturën shqiptare herët e padiktueshëm, si duket, nga një derë e vogël, siç di të hyjë vetë fikcioni në jetë, për t'u shndërruar pastaj vetiu në derë të madhe e të fisme, përgjithnjë.

Si zhanër ata promovojnë vetë fikcionalen në botën shqiptare, duke e futur vetë këtë botë në vallen e të kuptuarit se, siç thuhet, fikSIONET nuk janë vetëm tekste fikSIONALE, por kanë një rol të madh edhe në aktivitete njohëse, në veprime e qëndime si dhe në themelimin e institucioneve, shoqërive e botëkuptimeve (Iser 1993: 35-36); pra, vinë si një perspektivë përjetimi e njohjeje që lidh botëkuptime të ndryshme jete nga dikur moti gjer më sot, si një perspektivë që fikSIONIT i jep imagjinatë jetësore dhe anasjelltas, duke njohur edhe zona të reales së prekshme njerëzore. Si i tillë, ky zhanër prek zonat liminale ku fikcioni vjen e shpindërrohet pavërejtshëm me imagjinaren jetësore antropologjike, si lidhje me botën.

Si një zhanër i tillë, cikli i kreshnikëve ka rrahur e shtruar shtegun poetik poetik, njohës e sekular në shqip, me ç'rast sekularja është bërë sinonim i aventurës poetike, e cila e sekularizon logosin mitik përbrenda natyrores me efekte përrallore. Afria me baladën është bërë e hetueshme për këtë cikël – veçan sa i përket konceptimit të kohëhapësirës – aq sa dallimet mbeten vetëm në situimin intrinsek të heronjve e subjekteve, në përfundimin tragjik të baladës dhe në artikulimin e sentimentit erotik mes heronjve brenda temës së saj. Ta zëmë, Gjergj Elez Alia, sa kreshnik, është hero balade, por ai, megjithatë, vdes me tragjiken e heroit të baladës. Po ashtu, kreshnikët dallojnë, sepse nuk e kanë të sakralizuar institucionin e besës në nivelin që e kanë baladat. Për një kreshnik, besa bëhet fjalë e dhënë, e sforcuar, që eklipsohet nga hija e nderit. Besa ka peshë për aq sa i shërben nderit, por nuk kthehet në subjekt më vete si ndodh te balada, ku qoftë besa, qoftë nderi, janë koncepte të afërta me kanunin. Është fort e vështirë të thuhet nëse fjala e dhënë i paraprin besës, si institucion, apo e kundërta, sepse hija e përrallës e lashtëson shumë kreshnikinë, sikurse që hija e besës e lashtëson baladën. Për të dy këto zhanre, pesha e gjakut do të jetë nën hije të besës e fjalës së dhënë si nder. Gjaku do të marrë peshë ikonike e qenësore kryesisht te kënga historike.

Meqë kënga kreshnike ka dalë nga areali i këndimit, duhet thënë se, sado që ruan në vete aventurën si tematikë e hapësirë epike e narrative, ajo e ka të kufizuar sfondin melodik e vokal përballë një

spektri epik historik e lirik, pra popullor, që zgjeron diapazonin e këngës në *parlando rubato*. Kështu fenomeni melizmatik hyn në konkurrencë me narrativin aventurier, i cili në vetvete është i farkuar si identifikim me muzikën, sado që e ruan në brendi edhe identitetin prej recitali. Lidhja e kreshnikut me këndim pak më popullor (Sokoli 1984; Daja 1989) ruhet pikërisht mbi tehun e saj baladesk.

Tradita romantike e zbulimit të thesareve nacionale nga e kaluara, vërtet krijoi mjegulla për gjendjen e këtyre cikleve gojore dhe atë çfarë u ndodh, kur bien në duart kombëtarizuese të autorëve e redaktorëve romantikë. Aventurat e shpikjes a përpunimit të cikleve e sagave gojore u bënë të njohura nga etno-invincioni i Macphersonit me *Këngët e Osianit* deri te Vuk Karaxhiqi, i cili i dha një dorë të mirë epikës gojore serbe të cilën e mblodhi dhe e botoi. Këta dinjitarë romantikë thoshin se çdo komb që i thotë vetes të jetë i tillë duhej të kishte epikën e vet ndaj “i hynë punës që të konstruktonin një epikë të tillë për arsye politike e kulturore” (Jansen, Maier 2004: 7), në ndihmë shtetformimit e kombformimit dhe për agjenda nacionale që çonin këtij shtegu. Në shekullin XIX, epet nacionale gojore, po bëheshin shtresime themeltare për kombin e shtetin. Mjaftonte të gërmoje diku në gjirin e popullit, në ndonjë fshat të harruar, dhe do të gjeje margaritarë që do ta përndrisnin rrugën e kombit.

Kur kujtohet Macphersoni, Lönnroti e Karaxhiqi dhe tradita e tyre, ku rri në këtë mes projeksioni romantik shqiptar për epikën heroike të kombit të lashtë shqiptar? Mbase, jo në masën e disa popujve të tjerë, por një pjesë e mirë e veprave të De Radës, Naim Frashërit e Gjergj Fishtës e kanë syrin kah shtegu i Osianit. Gjithnjë në këtë frymë, botimi i *Visareve të Kombit*, më 1937, veçan i blenit II, redaktuar nga Bernardin Palaj e Donat Kurti dhe blenit I, redaktuar nga Karl Gurakuqi e Filip Fishta, po e mbushte kuptim ëndrrën nacionale romantike.

Ndonëse këngët kreshnike ishin botuar pjesërisht edhe më parë, nga autorë shqiptarë – kryesisht me nxitjen e Gjeçovit – e të huaj, *Visaret e Kombit* do të marrin epitetin e botimit ceremonial të tyre. Por, sa rezistuan Palaj e Kurti, Gurakuqi e Fishta që të mos fusnin duart në ato këngë për qëllime fytyre nacionale?

Nga sa dihet, mund të thuhet se ata vërtet e lakmojnë, por nuk e ndjekin traditën shpikëse të Macphersonit dhe as ndërhyrjes ribërëse të Karaxhiqit. Dora e tyre ndihet, pa dyshim, sikur që deklarohet në hyrje, por mund të kuptohet, po ashtu, se ndërhyrjet janë në nivelin e redaktimeve me rastin e tekstualizimit e editimit dhe të shtimit të një copë kënge a fragmenti vargjesh nga një këngë te tjetra. Arnimi i ndonjë

varianti me ndonjë copë a varg nga varianti tjetër, mbetet sidokudo brenda rrezes editoriale të dorës së tyre. Çfarë është me fort rëndësi, kjo dorë nuk preku në punë rikrijimi të temës, karaktereve e situatave të këtyre këngëve, çka do ta cënonte vetë nervin imagjinar dhe karakterin e këtij cikli. Ata ndenjnë larg projektit për kthimin e këtyre këngëve në një subjekt-sagë të vetme heroike nacionale të *ndoi Troje të rrënueme*, si fantazonin ata. Fare vonë, Kolë Jakova, në veprën e tij *Kreshnikët: poemë epike sipas Eposit të Veriut* (1992), kishte sprovuar kthimin e kreshnikëve në një subjekt heroik, por ky ishte tashmë një projekt krejt fiksional, me firmë autoriale, përtej pretendimeve për të risjellë një subjekt origjinar të këtyre këngëve. Për kureshtje, po të krahasohen perlat *Fuqija e Mujit, Gjeto Basho Muji - martesa dhe Gjogu i Mujit hargelja*, të botuara nga Palaj e Kurti (1937) me variantet *Fuqia e Mujit, Martesa e Mujit* dhe zanat dhe *Hergjelja e Mujit*, të edituara nga Haxhihasani (1983), nuk vërehen te variantet e para asfarë dallimesh të ndjeshme të natyrës kompozicionale nga këto të tjerat. Prekja e Palajt e Kurtit duket se kryesisht mbetet në nivel latimi versifikativ të frazës. Këngët e përmbledhjes së fundit janë më të shkurtra, por fare të ngjashme si subjekt e strukturë kompozicionale, ndonëse u përkasin gjeografive të ndryshme nga janë vjelë.

Sigurisht që është e qartë se pas një ndërmarrjeje të *Visareve të Kombit*, vërtet projekttohej afirmimi e kulturës kombëtare dhe luftës për kombin dhe kënga kreshnike shihej si mishërim i këtij qëllimi dhe mjet perfekt drejt cakut ideologjik. Ja çfarë thoshin Palaj e Kurti në hyrjen e tyre:

Mbas një shqyrtimi të kujdesëshëm vëhet ré, se ndër kto këngë mshehet ndiesija për pamvarsi, pse gjithkund del në shesh lufta e fisevet shqiptare të blokut Mal i zî – Shqipni kundra Sllavit, qi tue kapërcyem Danubin, msyn qëndrën e ktyne fiseve: Jutbinën (1937: IX).

Pothuaj i tërë leximi dhe interpretimi i *Këngëve kreshnike* shqipe brenda milieut kulturor, po edhe politik shqiptar, për gati një shekull, ndoqi këto premisa që pothuajse fusin nën udhë leximin dhe interpretimin e botës së kreshnikëve. Kreshnikët u bënë shembull i luftës nacionale, i mbrojtjes së kufijve nacionalë në luftë me krajla. Muji e Halili u bënë heronj kombëtarë. U denigrua tradhtija e grave sllave të rrëmbyeme dhe depërtimi i sllavizimit në fise ilirjane nëpër miqsi të rrejshme: pobratina (XV).

Ky lloj interpretimi, u ripërshtat dhe farkua edhe nga një ton *i ri* ideologjik, me ç'rast u insistua që “konflikti etnik iliro-arbëror me krajlët shkje përbën bazën konkrete historiko-shoqërore nga ku ka lindur bërthama e epikës sonë kreshnike” (Uçi 1986: 29) – një markë receptimi kjo që u shndërrua në stereotip interpretimi të këngës kreshnike. Për më shumë, kjo lloj thjerrëze nacionalizuese e ideologjizuese krijoi shteg interpretimi që u ushqye edhe politikisht në disfavor të një leximi të butë e interpretimi mbi primesa poetike. Ajo e mbylli estetikën për hatër të ideologjisë.

Pas një përvoje të tillë, shikimi mbi kreshnikët ka hapur perspektiva. Ndonëse nuk janë kurrfarë heronjsh nacionalë politikë dhe nuk afirmojnë në veçanti interesa nacionale a etnike, ata përbëjnë gurthemel të poetikës nacionale shqipe, që rritet mbi shtegun e heroit gjuetar e aventurier, një dimension ky aq fundamental për poetikën shqipe. Ata i japin karakter letërsisë shqipe. Duke i dhënë karaktere arketipash herake, ata i dhurojnë karakter kësaj poetike.

Tashmë është botuar pjesa kryesore e korpusit të këngëve kreshnike. Vazhdojnë të botohen ende variante të qerthullit të Rugovës dhe pritet të publikohen këngët e mbledhura më 1937 nga A. Lord, diku nja njëqind sosh që ndodhen *Koleksionin e Parryt*, në Universitetin e Harvardit, çfarë përbën interes të veçantë, meqë janë këngë që mund të përmbajnë elemente me peshë nga substrati i hershëm i këtyre këngëve.

Me sa është e mundur të shihet nga këngët deri tash të botuara, Palaj dhe Kurti, me të drejtë afirmonin përparësinë estetike të këngëve kreshnike që këndohen në Curraj të Epërm, në Mertur e në Dukagjin. Ata theksojnë, po ashtu, efektin e melosit e të përcjelljes muzikore që “është faret e thjeshtë e melankolike [...] me një cezurë të gjatë, qí ka lidhni me rreshtin qi vjen” (Palaj, Kurti 1937: XIII). Pra, Palaj e Kurti, dhanë edhe idenë për cilësinë artistike të këngëve që lidhej me një qerthull të caktuar hapësinor.

E pasur me botën e saj arkaike, me primitivitetin e jetës dhe të heronjve, kënga kreshnike kishte humbur fuqinë e madhe të kontaktit me socialitetin dhe politikën e jetës shqiptare në kohët moderne ndaj, me kohë, u bë e padenjë për të reprezentuar ekzigjencat moderne të imagjinare nacionale. Epoka e Gjergj Kastriotit, si luftëtar që do të krijojë ikonë nacionale, krijoi heronjtë e vet, të cilët, siç mund të kuptohet nga Barleti e deri te *Dorëshkrimi i Kieutit e Rapsoditë e De Radës*, kishin vazhduar të këndoheshin për bëmat e tyre, për disa shekuj. Madje, si arketipa nacionalë, ata kishin gjeneruar edhe heronj të tjerë mbi fytyrat e tyre. Pikërisht këta heronj epikë historikë – krahas

një dore këngësh për Millosh Kopiliqin – kishin krijuar shtegun e një cikli epik historik me primesa të ciklit nacional, paksa të ngjashëm me ciklin serb për Kraveviq Markon dhe me epikat e tjera nacionale në regjion.

Duket se epika legjendare ishte ndierë e papeshë nën ndikimin e heronjve të rinj historikë të pas 1389-tës dhe ishte strehuar te ajo strata e humbur në thepa e maja që kishte ruajtur një sentiment përrallor e primitiv për jetën, por që e mbante në fije peri lidhjen me botën e rrafshit e të qytetit, të tregtisë e administratës, të pashës e kadisë. Derisa në këtë kohë, një substrat i vjetër i këtij cikli, te popujt e tjerë, si boshnjakët, ishte rinkarnuar në epikë historike dhe i kishte goditur Mujin e Halilin si heronj nacionalë, te shqiptarët ishte ruajtur nëpërmes një ngrirjeje të thellë mentale në bjeshkët e malet që morën rolin e konservativeve natyrore, kryesisht nga popullata e krishterë e Malësisë së Madhe e të Vogël dhe Dukagjinit. Pa i shpëtuar një dore të mirë mbishtrese islame, ky cikël, megjithatë, ia doli të mbijetonte, mbase edhe për arsye të vetë përmbajtjes dhe origjinare të tij përrallore, ku nuk kishte një konflikt të veçantë me osmanët; ose konflikti me osmanët mund të evokohej e asociohej vetëm nëpërmjet konfliktit me krajlat, si konflikt me tjetrin, sado që cikli nuk afishon asnjëherë kujtesë dhe mobilizim të gjerë kundër një armiku frontal.

Këtu mund të tirret supozimi se, në njëfarë mënyre, në relievet e ulëta e qytetare, gjatë shekujve XV-XVIII, cikli hyri në konkurrencë të hapur me këngët pretendente historike. Humanizmi evropian i kishte dhënë zjarr vernakularit etnik e imagjinare nacionale; ambienti shqiptar ndihej mirë që kishte heronjtë e kohës së artë, pak më parë, të cilët mund t'i këndonte e t'i adhuronte, ndaj Skënderbeu vazhdoi të këndohej e të himnizohej për nja dy shekuj. Por, kjo nuk zgjati shumë. Nga fundshekulli XVII, këta heronj epikë nuk gjejnë ambient kulturor e politik të përshtatshëm për t'u ruajtur dhe për t'u zhvilluar më tej si heronj nacionalë në territoret shqiptare, ku konvertimi fetar po merrte vrull masivisht. Në këtë rast, këtij cikli këngësh i mbeti të ruante kryet nën strehën arbëreshe, në Itali. Fatkeqësisht, kërkesa për strehim e konservoi atë në një masë dhe e riformësoi në arbërisht, por nuk i dha ndonjë formë artistike të një cikli shumë të arrirë artistik.

Një cikël i tillë rihyri nëpër disa dyer të kulturës shqiptare vetëm si letërsi e shkruar, me De Radën si shembullin më të mirë. Romantizmi i De Radës, i ndjekur nga Naimi dhe pastaj autorë të tjerë shqiptarë, ringjalli të kaluarën e artë heroike të Skënderbeut dhe krijoji aleancë të letërsisë së shkruar shqipe me kode heroike historike, në shtegun e një

mësuesi misionar. Vetë fillet e poetikës shqipe të shkruar po zinin rrënjë në këto kode historike që nëpërmjet emblemave heroike të Motit të Madh po krijonin shtrat psikologjik të kësaj letërsie.

Ishte kjo koha kur po diferencoheshin dy heronjtë bazikë të krijimtarisë shqipe: Skënderbeu luftëtar dhe Muji kreshnik, gjuetar e aventurier. Skënderbeu, i kultivuar jo dhe aq artistikisht, po krijonte ndikim të fuqishëm në bërthamën e letrave shqipe, përballë Mujit të gdhendur artistikisht, por të pafuqishëm për të imponuar statusin e tij poetik e fiksional prej çetniku.

Vetë fillet e letrave të shkruara shqipe po ngjizeshin në misionaren a heroiken historike dhe jo në aventurën e kreshnikut. Kjo e përshkoi tërë letërsinë shqipe, deri në ditë e sotme. Pavarësisht attributeve popullore që i jepen, cikli i kreshnikëve vegjetoj, për shekuj të tërë, si një stratë artistike, e cila preket fare pak me jetën tonë të përditshme e me synimet kombëtare. Ai është i një harku tepër të gjerë imagjinitiv për t'u reduktuar në përrallë që bëhet konsum popullor masiv dhe tepër përrallor për të qenë i pranueshëm e i përdorshëm për kërkesa utilitare të grupit a etnisë.

Prandaj, ai mbetet jopopullor, skajohej në një skutë si fikcion krahinash apo dhe tretej sadopak me ujë dhe provonte të kooperonte me zhanre më popullore të heronjve historikë, sikur që kishte bërë cikli boshnjak.

Toni i zbehtë popullor me prirje drejt politizimit e socializimit tematik, po e çonte këngën kreshnike kah për afrimi me kulturën popullore të rrafshit e qyteteve, ku jeta muzikore po ndërshkëmbehej me elemente muzikore që vinin nëpërmjet depërtimeve osmane. Kënga kreshnike po ndahej në dysh. Me njërin këmbë mbante shtegun e vjetër, që e çonte kah konservimi në kohën e vet të gurit, dhe me këmbën tjetër po adaptohej me përvetësimin e emrave osmanë të heronjve, me një regjistër bazik fjalori oriental dhe me ndonjë skenë me sulltan e heronj të njohur historikë. E kënduar a e recituar, e shoqëruar kryesisht me lahutë, kënga kreshnike e refuzonte shoqërimin me instrument tjetër përveç lahutës, deri në fillim të shekullit XX, kur nisi të shoqërohej me sharki e çifteli dhe të rriste tiparet popullore. Kjo e popullarizoi një çikë dhe zuri të dëgjohej edhe nëpër qytete.

Nuk është çudi që standardet e larta primitive, pra edhe imagjinare, e kanë gërryer dhe e gërryejnë statusin popullor të këngës legjendare, sepse ajo, në bërthamë, nuk është popullore.

Parimet e udhëheqjes së botës kreshnike janë abstrakte, nuk i takojnë ekskluzivisht një civilizimi e një kulture, janë joracionale dhe të pashtuara si doktrinë. Ato katrithen mbi shtylla tradicionale inercioni që kërkojnë njësim me natyrën, duke mos iu shtruar racios e procedurave të elaboruara politike. Parime të tilla zbulohen në natyrë dhe nga vetë intuïta e arsyeja bazike njerëzore, si mjete e marifete të zotëruara nga gjithë njerëzia, por që nuk kthehen në mjete instrumentale. Ndjekja e pavetëdijshme e një tradite përballë ndjekjes së rregullave e doktrinës, i bën ato entitete poetike të koloviten në shtratin mes ludikes e seriozes, si mes qiellit e tokës. Ato shpesh motivohen si ludike dhe bëhen serioze, përballë epikave të tjera që motivohen si serioze dhe, rrugës, bëhen edhe ludike. Saga kreshnike njih fenomenalien elementale të jetës mes dritës, ajrit, kroit, venës e ndjenjës së çetimit. Brenda këtij elementaliteti bëjnë hije e kuptim: drit' e diellit, të dashurit, orët, shpata, probatimi, kali, era, bjeshka, gjarpri, dhia, tjetri si rival me të cilin thyhen a luhen shpatat dhe si i panjohur që mund të bëhet mik. Kjo sagë njih imazhin filmik si motivim i cili hera-herës bëhet temë specifike, por që gjithnjë ruan lidhjen me imazhin herak. Imazhi i këngës kreshnike është bëmë e çetim, kotësi e aventurë gjahu dhe ruan tiparet e një imazhi që rri në lëvizje, duke u shoqëruar me imazhe të tjera. Imazhet bëhen imagjinatë dhe imagjinata kthen te imazhet më shumë se te bëmat e mëdha, të cilat, si aventura, nuk mund të mos kthehen prapë te imazhet. Është ky një rikonfirmim që seriozja kreshnike rri në gjirin e ludikes, lojës së gjahut e aventurës, orëve e dhive, dueleve e rrëmbimeve.

Imagjinaria ludike primare fut dhe zien fiksjonalen dhe realen e kreshnikëve në një vegsh. Kjo imagjinare të hedh në ujë dhe të mëson: të kotesh, të ndiesh, të përjetosh, të gëzosh, të pikëllohesh, të zemërohesh, të luftosh, të besosh, të lidhësh aleancë, të rrëmbesh, t'i hysh aventurës e gjahut. Si filozofi jetësore ajo predikon hedonizmin e stoicizmin. Venën dhe shpatën. E tërë estetika kreshnike rri mes hedonistes, sensuales e stoikes si trupëzime të heroikes dhe natyrores.

Teksa e njohin venën, kreshnikët përçojnë vlera kontemplative. Kur imagjinimi bëhet kontemplacion, atëherë fakti dhe jofakti humbin kufijtë, humb imazhi i historisë (Oakeshott 2020); kreshniku e njih zonën e këtij kontemplacioni dhe, nga tjetër, njih inercionin e traditës së tij, që e mban në vete. Zona kontemplative përçon ndjesi indiference e kotësie të kreshnikut në çaste, një lloj gjendjeje: as qejf as brengë as dhembje, as simpati as antipati për një temë morale. Nga ana tjetër, dëshira dhe dhembja bëhen pjesë e lojës kur kreshniku nis me çetue.

Vetë aedi ndien letargjinë e heronjve dhe identifikohet e kontemplan me të nëpërmjet imazheve. Kontemplacioni ruhet nga interferencat e kujtesës dhe shpëton prej imazheve që lidhen me fakte që ribëjnë histori.

E ndodhur në këtë pozitë, kontemplativja kreshnike s'ka si të mos dobësohet në pikat ku lidhet me imagjinaren historike dhe realiste. Madje, përballë kësaj imagjinareje, edhe përsëritja dhe formulaikja japin intonim kontemplativ të këngës, si zë e si tekst. Ishulli i krijuar imagjinuar krijon anaforat, asonancat dhe përsëritjen e shprehjeve të përcjella me efekte melopoetike, të cilat i bëjnë vazhdimisht jehonë temës dhe zgjojnë kontemplacion, sa të bëjnë të besosh se kreshnikët sekah kanë trashëguar një damar shamanistik të shikimit e rresës në botë.

Nëse imagjinimi poetik në esencë ka rrënjët në një botë kontemplative, bota e imagjinimit të kreshnikëve është më e ndërliqshme se kjo; ajo është imagjinatë poetike, e cila ka aleancë me imagjinaren kreshnike si civilizim i vjetër ku dallimi i fikionales dhe reales në kuptimin e sotëm është fare i megjulluar. Fiksionalja për kreshnikun merr primesa reale; biseda me orën është përjetim real; vërtetësia e bisedës me qeniet që të shfaqen disi dhe flet me to, është e padiskutueshme e reale në mënyrën e vet. Ora për Mujin nuk njeh kuptim mitologjie nga distanca jonë me mitologjiken, ndaj dhe mund ta bëjë qesharak interpretimin tonë mitologjik, të figurave mitologjike në një botë poetike. Nëse figurat e orëve dhe gjarpërinjve janë te kreshnikët për dy-tri mileniume, kush jemi figuruar më shumë, ne apo orët? Prandaj, kur i përkthejmë figurat mitologjike te kreshnikët dhe letërsia e tillë, duket se një multifigurë interpreton një figurë bazike. Nëse ata janë figurë më e lehtë metonimike e sinekdoke, ne bëhemi metaforë dhe, kur hymë në marrëdhënie interpretuese me njëri-tjetrin, duket sikur metonimia interpreton metaforën dhe anasjelltas. Por, duke qenë ne metaforë, mbetemi gjithnjë më të interpretueshëm nga kreshnikët, se ata nga ne. Letërsia e shtegut të gjahtarit e aventurës, e dorës së kreshnikëve, gjithnjë na interpreton më shumë se sa mund ta interpretojmë dhe me këtë na fut në rrethin e hirit fatal të varësisë nga poesi.

Në rastet kur efektet mitologjike bëhen krejtësisht përrallore, vija e hollë dalluese mes realitetit përrallor dhe botës së kreshnikëve vjen vetëm kur pason skena tjetër tokësore, e cila pos tjerash invokon edhe zhanrin. E tërë kjo ndodh ngase përrallorja e kreshnikëve nuk është aty për ta diskualifikuar dhe për ta dekonstruktuar botën e kreshnikëve sa

për ta kualifikuar dhe shfaqur sublimen e saj. Aty poetikja kthehet në sfond naiv të imagjinimit human, që njëkohësisht bashkëjeton me rrëfimin e prozaikes a së rëndomtës, të riformësuar brenda zhanrit. E ndodhur në këtë shtrat, mitologjikja bëhet mënyrë primordiale e të menduarit që nënkupton brenda edhe poetiken.

Heroizmi themelor i kreshnikut lidhet me gjahun, duelin e rrëmbimin. Gjahtari i suksesshëm, grabitja e mundja e kundërshtarit, e bëjnë hero një të ri në rrugën e kreshnikut.

Kreshniku është çetani, është gjahtar, është njeriu ludik, njeriu i aventurës, i lojës dhe i aksionit.

Gjahu dhe lufta me tjetrin janë motivimet bazike të kreshnikut. Prijësi i çetës, çetobashi, është kreu politik e shpirtëror i çetës, sikur Gjeto Basho Muji. Kur shihet holleholl' e tërë bota e kreshnikëve – kush janë, çfarë bëjnë dhe çfarë përbën kuptim për ta, – çetimi bëhet kryetema e këngës kreshnike. Gjithë temat e tjera janë të nënrenditura për nën hije të çetimit të tyre. Në të vërtetë, çetimi si dalje për gjah është kryetema initiale e tërë ciklit dhe e vetë karakterit kreshnik, por zakonisht kalon shpejt në temën tjetër të rastit dhe rrallë mbetet deri në fund si temë më vete e gjahtarit. Çetimi-gjah bëhet çetim-aventurë në kuptim të gjerë të fjalës.

Zakonisht çetimi bëhet në bjeshkë, por ndodh edhe në fusha; dalja me krye në det, në Kotorre, sado që për qëllime të caktuara, dëfton se kreshnikët, si çetani, kanë prekje me qytetërimet që vijnë nga fusha e bregdeti, nga polisi e limani. Mbase Kotorret romane mbeten burimi më i pasur që i ushqen ata me qytetërim. Ndaj çetimi andejpari ia vlen gjithsesi, veçan kur has syri ndonjë vashë të bukur e me hire. Kështu, shpesh, ajo që nis si gjueti drenushe sos si gjueti Tanushe.

Kënga *Zuku Bajraktár* (Palaj 1937) është rapsodi kreshnike tipike sa i përket artikulimit të temës së gjahut dhe aventurës së çetimit:

Kúr ish kênë Zuku bajráktar,
Djalë të mirë zoti e ki' falë,
Edhe si babën dote me e bâ.
Tha, ishte çue djali n'sabah,
Po e shilon atin, e po e shtërngon,
Po ma merr pushkën në dorë,
Po ma merr topuzin e shpatën,
E në shpinë gjogut m'i ká hypë,
Don me dalë në bjeshkë për me gjue;

Sá shum bjeshkën djali e ká shetitë,
 As s'ká gjetë gjê me gjue,
 As s'ká gjetë ndoi shkjá me e pré!
 Ká nisë Zuku bjeshkën ma ká nâmë,
 - Gjoe n'ket bjeshkë kurr mos e gjetët,
 As mos dalët kurr çetë n'ket bjeshkë.
 Ora e Zukut ngjat ká qillue,
 Ajo Zukun mirë ma ka prigjue.
 Ç'ká qitë Ora e ka thânë:
 - Mo', bre Zuko, bjeshkën për me e nâmë,
 Se me e vú turbín në sy,
 Ti po sheh-o gjoe me gjue,
 Ti po i sheh Shkjét tuj çetue.
 Ma ka vú turbín në sy,
 Ki' pa gjoe për me gjue,
 Ki' pa shkjet tuj çetue.

Zuku është gjuetar-çetani tipik, si baba i tij. Çetimi është vlerë trashëgimie për kreshnikun dhe motivohet e përmbushet mbi dy pika: gjahun dhe ndeshjen me tjetrin, shkjaun.

Me promovimin e temës së çetimit si modus i aventurës, këngët kreshnike i dhanë dimension të veçantë poetikës shqipe.

Paradoksalisht, cikli i kreshnikëve, pavarësisht peshës së tij poetike e kulturore, nuk ia doli të shndërrohet në shtrat me ndikim të gjerë të poetikës së shkruar shqipe. Për mjaft arsye kulturore e politike ajo mbeti në margjina poetike dhe u lexua e u trajtua si një alteritet i epikës historike. *Kângët kreshnike* mbijetuan vetë më shumë se sa u mbajtën gjallë nga ndonjë perspektivë a instancë institucionale.

Martesa e Halilit ka fituar tashmë peshë të veçantë kanonike brenda traditës poetike shqipe. Ajo është cilësuar perlë e epikës shqiptare, krahas disa këngëve të tjera si: *Gjogu i Mujit me hyll në ballë*, *Gjergj Elez Alija*, *Ajkuna kjan Omerin*, *Vajtimi i Ajkunës*, *Fuqia e Mujit*, *Martesa e Mujit*, këngë këto antologjike, të cilat, edhe vetëm kaq sa janë, sjellin shembullin e një cikli kreshnikësh që reprezentojnë kanonin poetik nacional.

Të menduarit dhe bëmat e këngës kreshnike thërrasin aventurën më shumë se çdo zhanër poetik e letrar. E ndodhur mes misionarit e gjuetarit, këndimi poetik shqip mund t'i kërkojë origjinat e veta në heronjtë dhe historirat e tyre, në rrethin e tyre natyror e miqësor, në marrëdhëniet mes tyre dhe me heronjtë, mbretërit e botët përreth.

Nëse aventura e zakonshme përshkruhet me aktet e nisjes, arritjes në cak dhe kthimit, aventura e kreshnikëve nënkupton nisje në luftë, mejdan, grabitje, mbrojtje pronash dhe kthim i sigurt në vend, Jutbinë, në kullat e babës. Si e tillë kënga kreshnike shpërfill misionet nacionale. Imagjinaria etnike bëhet vetëm pjesë e dinjitetit të fisnikëve/agallarëve, por pothuajse nuk luftohet për të në mënyrë të organizuar. Humanja kreshnike ndien frymën e grupit, dyerve a oxhaqeve si një trung çete që ruan lidhjen me njeriun e dashur, orën, gjarpërin, çetanikun, probatinin, por që merr frymë përtej përtej nacionales së kuptimeve moderne.

Mes Gilgameshit e Beovulfit

Heroi kreshnik, si mishërim i një substrati që vjen nga kultura gojore, nis tek lind e sos tek perëndon, prek jugun dhe arratiset në veri. Harta poetike e ciklit të kreshnikëve, si origjinë e si histori poetike, banon mes *Gilgameshit*, *Iliadës* e *Odisesë* së Homerit, *Digenis Acritasit* dhe epikës së asaj gjeopoetike nga një anë, dhe *Beovulfit*, *Kalevalës*, *El Sidit*, *Nibelungëve* e *Këngës së Rolandit*, nga ana tjetër. Shtrati natyror e poetik i Mujit vë gurthemel me *Epin e Gilgameshit* dhe kulmon me *Beovulfin*.

Rrjedhimisht, e tërë poetika e *Këngëve kreshnike*, këtij cikli të ngritur pezull në ajrinë epike të epokave, rri mes dy traditave të vjetra gojore: asaj lindore akadiane-babilonase të mijëvjeçarit II-III p.e.s. të shtresëzuar e kristalizuar në atë homerike të mijëvjeçarit I-II p.e.s. dhe asaj veriore të *Nibelungëve* e *Beovulfit*, të ngjizur nga fantastika e njeriut fisnor gjermanik dhe e ushqyer e konsoliduar si epose më vete në shekujt V-XII të e.s., pasuar pastaj nga tradita të tjera veriake e përendimore. Vetë kompresimet i epokave dhe shtresimet kulturore të *Beovulfit*, *Kalevalës*, e *Nibelungëve*, krijojnë paralelen e ngjashmërive aksidentale a joaksidentale të këtij eposi me ciklin e kreshnikëve, hiç më pak se me epikën që vjen nga Lindja.

I ndodhur edhe gjeografikisht diku mes dy këtyre botëve epike, cikli i kreshnikëve merr nga të dy anët: nga Lindja asonancën, nga Veriu aliteracionin, nga Lindja diellin dhe nga Veriu borën, nga traditat pagane natyrore diellin e shtizën, ndërsa nga zonat e civilizuara shpatën. Duke ndodhur – edhe si fikSION – në skajin verior të botës klasike, cikli ilir u ndodh jashtë rrezes së fortë helene, por brenda rrezeve të shumta veri-lindje-perëndim që u kryqëzuan në atë pikë.

Substrati epik i Evropës Juglindore, nga antikiteti e deri në shekullin XIX, ka krijuar faqe të vetat të ndryshme, por që zakonisht reduktohen në tri faqe që u atribuohen tri traditave epike: shqiptare, boshnjake e serbe. Tradita shqipe ka ruajtur në veçanti elementin e vjetër të këtij substrati, përderisa tradita boshnjake dhe ajo serbe atë substrat e kanë kthyer në epikë historike e religjioze.

Nëse poetika e këngës në shqip tërheq kah poetika mitologjike nordike dhe ajo e vjetër mesopotame e homerike, poetika boshnjake dhe ajo serbe tërheqin kah poetika romane e mishëruar me *Këngën e Rolanit* dhe *El Sidin*, me efekte të poezisë kufitare bizantine të *Digenis Akritasit*. Këta vektorë të dallueshëm të këtyre tri poetikave – sikur dhe ciklevë në gjuhë kroate, malazeze e maqedonase – megjithatë, nuk e eklipsojnë lidhjen e tyre me një areal të përbashkët epik ilirik i cili, me kohë, ka marrë forma të ndryshme epike, si zhanër e si tematikë. Një ton të lehtë romance e balade, kryesisht sa i përket temës, ka marrë epika kroate, boshnjake e malazeze e frymës bregdetare, prej së cilës përcillet diçka edhe te këngët shqipe, veçan te *Martesa e Halilit*. Një shembull të tillë japin këngët e dorëshkrimit të Andro Muratit, të vitit 1886 (1996).

Zakonisht, afria më e madhe shihet mes ciklit kreshnik në shqip dhe atij në boshnjakisht (Desnickaja 1975). Afria hetohet menjëherë, sapo nis krahasimi i këtyre ciklevë, sikur që hetohet edhe vija dalluese e thellë, si perceptim kohë-hapësire dhe si motivim heroik, si temë e si zhanër (Parry, Lord 1953; Đurić 1954; Karadžić 2000; Međedović 2010). Lambertzi përmend dhjetëra motive që ai i gjen të përbashkëta për këto tradita poetike (1958). Megjithatë, mbase më shumë se nga motivet, e përbashkëta e tyre shquhet për formula të ndryshme hyrëse e situacionale, të cilat, po ashtu, strukturalisht hapin shtigje të ndryshme.

Ta zëmë, formula *çka m'e pa çudën me sy* i përshkon vazhdueshëm këto epika dhe, përveç si formulë hyrëse, shpesh vjen si nisje e episodit vijues, si seri e kompozicionit unazor dhe te secila traditë inicon hyrje në skenë të caktuar. Prandaj, formulat i lidhin këto epika, por edhe i përveçojnë, sepse, shpesh, vetë sfondi gjuhësor dhe ai kulturor që rri mbrapa gjuhës së formulës e shtyn një poetikë shtegut të vet.

Epika serbe, sado që më pak se ajo boshnjake, ruan lidhje e ndikime të ndërsjella me atë shqiptare. Atje gjejmë vend edhe figura historike arbanase, si ajo e Millosh Kopiliqit, Lekë Kapedanit e Musa Kesexhisë, apo figura kreshnikësh si Muji e Halili. Pavarësisht që kjo epikë merr karakter të pastër historik e religjioz, aty mbeten, po ashtu,

gjurmët e zanave dhe të mitologjisë së hershme. Në këngën *Marko dhe zana* – jo dhe aq tipike për epikën serbe – Milloshi i dëfton probratimit të tij, Markos, se nuk guxon të këndojë nga zana, por ai e nxit prapë t’ia marrë këngës.

Nis Milloshi kangën me e knue,
 kangë të mirë ai qi ma paska knue
 për trimnitë tona të moçme,
 qi na mbajtën gjallë mbretninë
 n’atë të madhen Maqedoni [...]
 Kno Milloshi e zana po i mban zhagun;
 Kish Milloshi ‘i za t’bukur krajlie,
 Paj ma të bukur se vetë zani i zanës.
 Idhun zana u kthye n’bjeshkë t’Miroçës,
 Ma ka marrë ajo harkun me shigjetë,
 Po m’i marrka nja dy shigjeta t’bardha
 Ja lshoi njanën Milloshit n’fyt,
 Ja lshoi tjetrën n’zemër trimit.
 Po bërtet Milloshi: “Kuku nane!
 Kuku, Marko, pobratimi jem! [...]
 Po a të thashë u’ që s’ban me knue,
 S’ban me knue n’bjeshkë t’Miroçës!

(*Karadžić 2000: 38*)

Kënga paguhet me jetë. Këndimi i bukur shiton. Zana nuk duroi dot që dikush të kishte zë më të bukur se ajo dhe e shëmtoi Milloshin. Markoja që e kishte zënë gjumi nga zëri i bukur i Milloshit zgjohet dhe sheh mynxyrën. Menjëherë i vihet pas zanës që t’i hakmerret. Tashti, këtu, zana i lutet Kraleviq Markos që ta lërë të gjallë duke iu betuar *në zotin e në shën Jovanin*. Dhe, me barishte mjekuese nga bjeshka e Miroçës ajo ia kthen prapë frymën Milloshit.

E tërë kjo skenë është mjaft e afërt me skenat e hakmarrjes së Mujit ndaj zanave apo të forcimit të marrëdhënieve me to, në disa raste, në ciklin shqip. Mjaft të përmenden variantet Martesa e Mujit/Mujës, Gjyre Harambashi plagos të lumet e Mujit (Palaj, Kurti 1937; Çetta 2000). *Marko dhe zana* është ndër këngët e pakta në ciklin epik në serbisht që japin lidhje me botën herake të *Kângëve kreshnike*.

Gjithashtu, te epika boshnjake, mbetjet e substratit të vjetër me ngjarje gjahu e zanash janë evidente. Te *Zanat e malit shërojnë Mujin*,

këngë e botuar nga Hörmann (1889), e kënduar kryesisht në zonat e Malit të Zi e Hercegovinës – aty ku ndodh pikëtakimi i epikës boshnjake me atë shqiptare – zanat u dalin në ndihmë Mujit e Halilit:

Kur ma çuen zanat degën përpjetë
nën të Muji koka mbetë,
metë sytë çelë, za' s'muj po qet,
k'in nisë plagt e po m'i ftofen.
Po i vikasin ato zanës s'tretë:
“Gutu motër, hajde ma shpejt”;
Kur ka ardhë dhe zana e tretë,
po ma sheh Mujin me sy,
po i rreh gujt me duer përmi:
“Mjera motra, o Muji jem,
qysh po doket, keq koke plague”

(Maglajlić 1990: 84)

Ajo menjëherë u kërkon te motrave t'i sjellin mehlem lulësh dhe e ngre Mujin në këmbë. Aleanca e heroit me zanat konfirmohet edhe këtu si në këngën shqipe.

Përveç skenave të tilla dhe fekteve formulaike e strukturore, epika serbokroate, boshnjake-serbe, ndan shpesh me ciklin shqip linja portretesh e përshkrime karakteresh. Kënga e njohur *Dasma e Miliq Bajraktarit* jep një profil gracioz të Leposavës:

Bash si çudë çikën qi po e kallxojnë:
Trup e shtat si shtat çetinet
Flokët e saj gërshet brishimi,
Të dy sytë dy gurë xhevahiri

(Đurić 1954: 695)

Pikërisht si përshkrimi i bukurisë së Tanushës te *Martesa e Halilit*, përveç që *Dasma e Miliq Bajraktarit* është baladë e vulosur me tragjiken; romanca merr kthesë balade dhe përfundon si tragjedi duke farkuar sublimen estetike të tragjikes. Ky portret i hollë hiri femëror zë e erotizohet te kënga a famshme *Dasma e Mehë Smajlajës*. Ja me çfarë

ngjyrash jepet sensualiteti femëror i vashave që sfidojnë Mehën e Osmanin:

Përmbi kofshë fustanin lara-lara;
 N'perla t'bardha tanë qendisë,
 Përreth zemre rrypat qemerli,
 Mu rrâzë zemre rritë kunora,
 Dy kunora dukati t'bardhë,
 Ua mblon kryzit floku i krehun,
 Mi flokë t'gata ç'po u tunden shnollat;
 Mbulue duert plihurë bojëgjake,
 Mbulue gishtat larë-e-lule mali,
 Rrethëmreth gjerdanë prej ari,
 Katarosh rruaza e inxhi,
 Përmbi gjËjt e bardhë palue;
 GjËjt të bardhë, gjerdanë bojalli,
 Njani-tjetrit dritën po m'ja marrin
 Thue ia morën detit portokallin.

(Međedović 2010: 118)

Jo vetëm Tanusha e Halilit, po edhe vashat e tjera të kreshnikëve ruajnë disa vegëza perceptuese me këto portrete feminine sikur dhe me portretin e Fatës, të dashurës së Mehmetit. Edhe portretet e disa prej kreshnikëve dhe situatave tipike – si ajo e mbledhjes e kuvendimit në llanxhë – ruajnë lidhje të qëndrueshme mes këtyre epikave.

Kur formulat dhe portretet prekin edhe motive e tema, nga të cilat më së shpeshti atë të martesës, merr formë edhe një një lidhje tjetër mes këngës epike boshnjake dhe asaj legjendare shqipe – efekti i quajtur romancë. Romanca e epikës boshnjake ndërlihet me elemente orientale, *sentimentale*, ndërsa ajo në shqip me elemente *naive* baladeske e përrallore.

Sigurisht që lidhjet e ciklit të kreshnikëve me epikat tjera, me të cilat nuk ka pasur ecje të përbashkët e të ndërskëmbyeshme strukturale, janë të një natyre tjetër.

Epika e Gilgameshit sjell pamje antropeutike të njeriut mes bjeshkës, qytetit, stepave dhe civilizimit; nga marrëdhëniet përbrenda kësaj bote kanë njohur mjaft *Kângët kreshnike*. Dalja e Enkidujit nga egërsia i ngjason kreshnikut, kur bie si gjeraqina mbi Kotorre.

Enkidujin *tarak* e zbut dashuria e Shamhatit, për shtatë ditë e shtatë net në shtratin e tij, sikurse që kreshniku zbutet pasi rrëmben vashën së cilës i ka vënë syrin dhe e merr me vete në Jutbinë. Dhe aq shpejt kapet Enkiduji pas mbrojtjes së moralitetit të vashave, sa i del n’mejdani vetë mbretit zullumqar, Gilgameshit, sado që ky duel do përfundojë ndryshe nga ç’kishte nisur:

Me shoi-shojnë keqas kokan rrokë,
 si tereqt paj shpinën p’e lakojnë,
 derë e mure po m’i shkundullojnë.
 Po shkojnë araz Gilgamesh e Enkidu
 si tereqt ata shpinat tu i lakue
 derë e mure tuj i shkundullue.
 Gilgameshi dikur n’guj â ra,
 i tanë pezmi i ka kapërcye,
 thotë mejdani kjoftë i krye’.
 Enkidui a’herë m’ia thotë dy fjalë:
 “Masi nana, ajo hyjneshë Ninsuna,
 lopa e egër e gjithë bulykut,
 t’ka marue ty t’pakundshoq e trim mbi trima,
 – me kanë mbret i Enlilit ty t’u paska shkruel!”

(2000: 107)

Prandaj, atyre s’u mbetet tjetër dhe:

Njani-tjetrin ngryk’ e paskan marrë
 Shoqi-shoit dorën m’ia shterngojnë

(2000: 18)

Kjo lidhje miqësie në log të mejdanit, është tipike për këngën legjendare. Kreshnikët bëhen miq me krajla a me shoi-shojnë; Muji i bën pobratima mjaft nga kundërshtarët e tij, ku dueli nuk përfundon tragjikisht. Madje edhe me Kraleviq Markon a me krajla të tjerë vëllazërohet e vendosin *me sundue dynjanë*; nganjëherë edhe me ndërhyrje të zanave.

Te Gilgameshi e Enkiduji, miqësia bëhet aleancë ndaj kundërshtarëve të tjerë si Humbaba, një bajloz i llojit të vet. Vaji i Gilgameshit për Enkidujin ka nota të rënkimit të Mujit a gjëmës e vajit

të Ajkunës për Omerin. Enkiduji e njeh Gilgameshin si vëlla, si një lloj probatimi, edhe në çastet e vdekjes. Në botën e tyre fryjnë trembëdhjetë erëra, si frymëzime natyre e njeriu; të reduktuara në disa sosh ato fryjnë edhe te kreshnikët.

Kreshnikët kanë një përfrim të hollë me Gilgameshin, me vetë motivimin e Gilgameshit e Enkidujit për aventura; sikur dhe me etjen për njohje e vetënjohje të Gilgameshit, pas vdekjes së Enkidujit.

Nga ana tjetër, kuptimi i aventurës si ndërmarrje për *nder e qejf* merr përmasa mjaft të veçanta te *Odiseja* e *Iliada* e Homerit.

E tërë drama e madhe e *Iliadës*, nisët nga motive nderi e plaçke. Ja si ia ia zbraz pezmin Akili Agamemnonit para se të niseshin për në Trojë:

“O dhelparak me paturpësi mbuluar,
po kush nga akejt është gati që t’u bindet
urdhrave tua, e luan për ty nga vendi,
o rrëmben armët të luftojë me burra?
Këtu s’kam ardhur të luftoj pse urreva
trimat trojanë, pse faj ata s’më kishin,
as kuaj, as qe, ata kurrë s’na grabitën. [...]
Por t’erdhëm pas o faqezi pa cipë,
për t’mirën tënde, që në vend të çonim,
nderin a Atridit Menelà ndër teukër,
gjithnjë për ty o turiqen. [...]
E kur mes nesh ne bëjmë ndarjen e plaçkave,
ty të përket më e madhja e mua më e vogla.

(*Homeri 2015: 12-13*)

Pra, *Iliada* identifikon nderin e luftëtarit me aventurën e plaçkës. Helena e Trojës është vetëm plaçka e madhe, e hirtë, nga ato që luftëtarët ia rrëmbejnë njëri-tjetrit siç ia rrëmbeu Agamemnoni Akilit Brisejdën. Brenda kësaj ndërloje të madhe të nderit e aventurës do të zhvillohet edhe etika e estetika e së mirës dhe së ligës te helenët.

Jo shumë larg kësaj bote lëshon rrënjë edhe konceptualiti poetik natyror, etika dhe estetika kreshnike. Kreshnikët rrëmbejnë dhe ndajnë duele për hir të vashave; nderi bëhet aventura e rrëmbimit dhe e dueleve, duke përfruar këtu me helenët edhe konceptin e të mirës,

nderit, të keqes e të bukurës. Ky është pikëtakimi me më peshë i botës kreshnike me atë homerike.

Megjithëkëtë, kreshnikët, si heronj e karaktere, pavarësisht lidhjeve me poetikën helene, frekuencat e së cilës nuk mund të mos i ndienin, kanë tipare karakteri që tërheqin kah bota veriake.

Muji e Halili nuk dinë të mendojnë e flasin si heronjtë grekë, as me njerëzit e as me zotat. Ata as që njohin stratat e zotave e gjysmëzotave. Madje atyre u mungon jeta e përtejme, e artikuluar, si një imagjinare e civilizimeve greke, egjiptiane e mesopotame. Jeta e tyre pas vdekjes reduktohet në disa këngë, me ç'rast ndodh edhe ringjallja në emër të një hakmarrjeje. Këngët vetëm sa u bëjnë jehonë profileve të heronjve për të gjallë të tyre. Kjo perspektivë e reduktuar e imagjinare së pasvdekjes e thjeshton mjaft sfondin kreshnik.

Për ta kuptimet jetësore mbeten të orientuara enkas kah hapësira animiste kur vdekjet, ringjalljet e antropomorfizimet kanë efekte të larmishme, por nuk prekin dhe aq kalimin e njeriut në botën tjetër. Mendja e tyre njih imagjinatë guri e bronzi si epoka që mezi njohin kalimin të shkëlqimi i metaleve. Kreshniku pranon pengadale zbulimet elementare të objekteve të reja si shpata, takemet që i duhen njeriut e kalit, porse jo doktrinat religjioze. Edhe si gjeografi ai ndjehet i izoluar nga bota e zhurmshme e ideve dhe mallrave. Zakonisht, Kotorret e reja përbëjnë burimin prej nga areali kreshnik filtron efektet civilizuese apo prekjat me civilizimet tjera. Krajlia e Kotorreve janë prekjat me polisin, me jetën e organizuar si qytet, sikur dhe Krajlia e Talirit, ajo e Sejtit dhe ajo e Zadranit, të cilat sugjerojnë trashëgimi civile e etnike-politike romane.

Kreshnikët kanë pak hyjni, bij e bija hyjnish, të cilëve u përkulen dhe me të cilët zhvillojnë drama, duele e intriga. Iliriku nuk i kishte bërë të vetët hyjnitë e shumta greke, të stratave të ndryshme, duke mbetur kështu brenda një sfondi më pagan besimesh. Fisnikët kreshnikë nuk dinë të mendojnë holl', ata ndjejnë dhe kanë të folur e të menduar të reduktuar natyror, të motivuar nga marrëdhënia me natyrën para se me mentalitet polisi. Intrigat sociale janë të reduktuara sikur që edhe spektri i emocioneve lidhet kryesisht me ndjenjat bazike, me adhurim natyre e nderi, mirënjohje, dashje (më shumë se dashuri), ndjenjë hakmarrjeje, krenari, kotje, solidaritet, dhimbje. Ndjenjat e kreshnikëve nuk sprovohen nëpër kontekste të ngatërruara sociale që krijojnë anijet me robër e luftëtarë nëpër limane e qytete të mëdha. Duket se ata ribëjnë rrëfimet që vijnë nga limanet duke i filtruar, censuruar a refuzuar brenda bëtëkuptimit të tyre të të jetuarit në bjeshkë. Megjithatë, pikëprerjet janë

evidente. Këngët për Ali Bajraktarin dhe Zukun Bajraktar, ku nëna mashtron, besohet se kanë brenda elemente të tragjedisë së Orestit (Lambertz 1958: 107), edhe pse tragjedia te epika e kreshnikëve përbën herë pas here vetëm një sfond të pasmë, pa ndonjë fokus skenik si te bota e vjetër greke, duke u prekur vetëm me elemente balade. Temat dhe heronjtë e kthimit, pas aventurave, po ashtu, lënë shenjat e tyre.

Civilizimi poetik i Trojës do të krijojë frymë të pashmangshme poetike për gjithë traditat gojore e letërsitë që erdhën pas, aq sa dukej sikur Troja si histori e kthyer në poezi, ndodhi për hir të fisnikërimit poetik të jetës njerëzore në këtë botë. Veçse, është për t'u kuptuar që, dramet e historitë njerëzore që ndodhin pranë brigjeve të lumenjve e deteve, nga Nili e deri te deti Egje dhe Adriatiku, nuk mund të kishin jehonë në gjithë historitë shpirtërore të hinterlandit. Nuk mund të transferohet te kreshnikët pushteti i zotave dhe heronjve, gjuha, marrëdhëniet dhe stratat e tyre ashtu siç ishin te helenët.

Mungesa e arealit të hapur të zotave homerikë, si civilizim më vete, kompensohet nga psikologjia e bëmave heroike që vijnë nga sagat e veriut. Kështu, tradita akadiane e homerike që haset e përvjedhur nga limanet e Lindjes, si formulaikë e si kompozicion gojor, preket me migrimet e motiveve heroike veriore dhe me psikologjinë e dyluftimeve dhe botës që sjellin ato. Nga vegëzat e atmosferës gjahtarë të temave të botës së vjetër në *Epin e Gilgameshit* kur Enkiduji i egër zdirgjet nga stepa në Uruk dhe përballet me Gilgameshin, kreshnikët kalojnë te mikstura fantastike-historike e skenave të *Beovulfit*, duke derivuar kështu kohën poetike kreshnike si poetikë unike të këndimit të tyre.

Kjo flet se sa hintergrundi i Ilirikut njeh dhe prek jetën e ardhur nga Babilonia dhe shkretëtirat aziatike nëpërmjet detit, pastaj jetën dinamike të limaneve e qyteteve helene, po aq sa prekjet e heronjve nga viset e ftohta, duke u bërë kështu kryqëzim i poetikave të hershme kryesisht nga drejtimet Lindje e Veri, por pastaj të kryqëzuar me Veri-Jug-Lindje-Perëndim.

Lidhja me poetikën veriore e ciklit të kreshnikëve bëhet e veçantë kryesisht në pikëpamje të kohës poetike heroike si kohë tejhistorike. Siç thoshte Heaney, përkthyesi i shkëlqyeshëm i *Beovulfit* në anglishten e sotme, *Beovulfi* ndodh “në na ishte njëherë, me efekte të pjesshme historike” (1999: IX). Ai fillon:

Dhe k'shtu – Dan-muzdrakët e atij zamani
dhe krajlrat që atyne sundin s'ua danë;

trimni dhe shkëlqim kallxuen kta princa.
 Të gjithë e dimë sa larg u shkoi zani.
 Ish Shild Shifsoni aty çetobashi,
 ai që aq fiseve ua bani gjamën,
 taraku i mejhaneve, mnera e hasmit.

(1999: 3)

Rrëfimi në të kaluarën e pacaktuar, të rruður si *n'atë zaman a dikur (in days gone by)*, ngjan me formulën hyrëse *Kokan kanë Muja me Halililin*, që përsëritet shpesh, apo edhe me formula të ngjashme që afirmojnë të kaluarën, e cila pastaj kur ndodhet brenda kontekstit epik thërret të kaluarën e largët. Edhe trimnitë a bëmat heroike (*heroic campaigns*) që dalin këtu, kanë përafrim të lehtë me çetimin kreshnik sado që shquhen në rend të parë për një rreshtim luftarak kundër të tjerëve. Danët (danezët) e *Beovulfit* janë heronj të heshtës, muzdrakut e topuzit, mu si kreshnikët.

Situimi kohor dhe deri diku edhe hapësinor i *Beovulfit* rri në frekuenca të përafërta me botën poetike të kreshnikëve. Por, përveç sensit të kohës, *Beovulfi* dhe *Kângët kreshnike* ndajnë mjaft nga kultura e tyre pagane e mitologjike, krahas një etike fundamentale sekulare që njihet heroike të nderit e emrit të *Beovulfi* (Irwing 1997: 180), mu si të kreshnikët.

Mjafton të kujtohet skena e ndeshjes, e *Beovulfit* me dragoin – pa harruar edhe skenën me Grendellin – që ngjan me skenën e ndeshjes së Gjergj Elez Alisë me Bajlozin. Ndonëse Bajlozi mbetet vetëm figurë njerëzore, përmasat e kërkesat e tij të frikshme i japin atij imazhin mitologjik pothuaj të një kulçdre që ha desh e vasha, për çdo ditë nga një. Kjo e bën atë gati po aq sfidues e fantastik sa dragoi i *Beovulfit*. Pastaj, vetë skena e luftës, nderi në fushë të mejdanit, guximi i pamatë dhe zhvillimi i duelit, kanë mjaft ngjashmëri të dy heronjtë. Për më tepër, edhe vdekja e dy heronjve pas suksesit që kanë në fushëbetejë i bën ata tamam probatima në distancë traditash poetike. Virtyti i besnikërisë të *Beovulfi* është fare i afërt me atë të kreshnikëve, pa hijezuar efektin e besnikërisë si virtyt i lartë në gjithë epikat heroike, nga ato të hershme deri te ato mesjetare dhe romantike. Si atmosferë e marrëdhënies natyrë-njeri, mbarë cikli i kreshnikëve ka vija të afërta me botën e *Beovulfit*, me qeniet mitologjike dhe konfliktet e tyre me njeriun, por nuk është larg as me mjegullat legjendare të *Nibelungëve*. Vetë *Nibelungët* marrin emrat nga fjala *Nebel* – mjegull.

Si kompozim dhe kompilim unifikues nga mjaft këngë nëpër Finlandë, *Kalevala* (Lönnrot 2017) lë hapësirë të mendohet të ketë qenë strukturë e përafërt kompozicionale me *Kângët kreshnike*, por ajo bëhet një nga mbledhësi, Lönnroti, ndryshe nga *Kângët kreshnike* dhe cikli në boshnjakisht që botohen, por nuk lidhen në një subjekt nga një dorë editoriale apo autoriale.

Megjithatë, pas *Beovulfit*, kreshnikët ndihen afër me këngën e *Nibelungëve*. Kur fisniku Sigfrid shkon ta marrë Krimhildën, ai flet me zogj mu si Halili kur shkon ta marrë Tanushën. Floçkat (që këtu pothuaj identifikohen me nimfat, orët e zanat) po lahashin e freskoheshin ndër gurra, kur i dëgjon Hageni, u afrohet mengadalë, ua merr rrobat, po s'po i përket më tej:

Dhe zuni e foli Hadburga, floçka kështu pagëzue:
 “Hagen, kalor fisnik, kem’ dy fjalë me t’kallzue.
 Petkat tona t’trupit n’kjoftë me na i dorzue’,
 Qysh ju del rruga e Hunëve, kem me ju diftue.

(2015: 236)

Koha poetike, mitologjike, për një çast mund kohën historike të këngës. Sikur që orët, te *Martesa e Mujit*, janë në gjendje t’i bëjnë çfarëdo shërbimi Mujit, mjaft që ai t’ua lëshonte dhinë, meqë orët kishin gjithë forcën në brirët e tyre të artë, edhe floçkat i premtojnë Hagenit shërbim duke i dëftuar fatin, mjaft që ky t’ua kthente rrobat e grabitura. Hageni vërtet ua kthen rrobat atyre, sado që s’do t’i pëlqejë pastaj parashikimi i tyre. Ai po hynte në një rrugë tragjedi, sepse do të njihte hakmarrjen finale të Krimhildit për Sigfridin, të dashurin e saj, djaloshin që maskohej si Halili te te kreshnikët.

E tërë ngjarja e këngës së *Nibelungëve* zhvillohet aty nga fillimi i mesjetës, mes Gjermanisë Jugore, Francës Lindore, Holandës, viseve të Austrisë e Hungarisë duke ndjekur vijën e Danubit e duke u prekur me zonat e Ilirikut. Pavarësisht se korniza historike e *Nibelungëve* është e qartë, efektet mitologjike që rrjedhin së andejmi lidhen me arealin e Ilirikut dhe me substratin e kreshnikëve. Përmendja aq shpesh e mënyrës së veshjes *maxharrisht*, e maxharrëve dhe e krajlisë së Budimit te cikli i kreshnikëve, është një fije e hollë që çon drejt një tradite e civilizimi që asocion me traditën e *Nibelungëve*; mbase, drejt një tradite orale gjermanike që rri dallueshëm përballë asaj romane. Duket sikur

epika nordike nibelungase (që mund të kishte sjellë me vete elemente të mitologjisë nordike e sagave të *Beovulf*it e *Kalevalës*) dhe ajo e kreshnikëve, preken simbolikisht apo edhe më shumë, aty rreth Danubit, përkrye Ilirikut. Mjafton të kujtohet se në mesjetë, edhe para se te editohej e kodifikohej siç është sot (kah 1200-ta), cikli i *Nibelungëve* u bë shumë i njohur nëpër Evropë.

Po aq të njohura u bënë në fundmesjetë edhe *El Sidi*, edhe *Kënga e Rolanit* me temën e ndeshjes së religjioneve e kulturave, sado që nuk e prekën bërthamën e ciklit shqip të kreshnikëve. Por, sado që cikli i kreshnikëve jeton brenda strukturave mentale arkaike, të ndryshme nga bota e Rolanit, sa i përket kodit të nderit dhe ndërtimit të karaktereve, këto epika kanë dhënë e marrë nga njëra-tjetra.

Ja se si duket profili i Ganelon mashtruesit të *Kënga e Rolandit*, nëpërmjet vetë fjalëve të tij, pasi propozohet e sfidohet nga Rolani për t'i dërguar porosinë mbret Marsilit. Ai po i thotë mbret Sharlemanjës:

Imzot, tha Ganeloni, tanë këtë e kam prej Rolanit,
Për sa t'jetë jeta s'kam me ia harrue,
dhe as Oliviesë, që i rri krah atij;
Dhe dymdhet kreshnikëve që ia kanë hatrin aq fort
u lyp mejdan mu këtu, para syve tuej.

(1990: 49)

Ganeloni ndihet i poshtëruar nga Rolani, Olivieja dhe dymbëdhjetë fisnikët dhe nuk do t'ua falë poshtërimin. Ai do t'i tradhtojë ata para mbretit saracen Marsilit, mu si Dizdar Osman Aga, Arnaut Osmani, Zuko Bajraktari e ndonjë kreshnik tjetër që do mashtrrojë e tradhtojë Mujin a ndonjë nga kreshnikët e tjerë. Dezdard Osman Aga nxit vazhdimisht kreshnikët që Muji *po ua merr lavdin* e ata *po i bajnë trimnitë* dhe gjithnjë shfrytëzon rastin t'ia punojë ndonjë rreng.

Karakterit i rrëmbyer i heronjve kreshnikë ndërshkëmbejnë tone mashtrimi e thurje intrigash me heronjtë e *Këngës së Rolandit*. Përderisa maskimi maxharrisht përbën veçanti të kreshnikëve, si rrëfim e traditë më vete, skenat me mashtrime e tradhti lidhen me skena epike mesjetare çfarë janë tipike për *Këngën e Rolanit*.

Nga krahu tjetër, ndonëse *Digenis Akritisi* bizantin ruan disa lidhje tematike e strukturore me *El Sidin* dhe *Këngën e Rolandit* –

përveç tjerash edhe me kontekstin e qartë historik – me komunitete etnike e religjioze të formuara e në konflikt, me luftërat e kufirit e kryqëzatat, ka elemente të tjera të këtij ciki epik që e për afrojnë me arealin e botës së kreshnikëve. Ta zëmë, mu si çetanikët kreshnikë, edhe Digenisi, kur i mbushi të dymbëdhjetat – ngjashëm Omerit të Ri – iu lut Basilit, luftëtarit të kufirit, të cilin e njihte si baba, që ta lejonte të dalë për gjah:

E një ditë, ai babës po m'i thotë:
 "O imzot, e babë, m'i paska thanë:
 etja shpirtin, o babë, ma ka marrë,
 m'e provue veten në gjôjë;
 N'ëm paç djalë, o Basil, qysh ke thanë
 epëm izë me dalë për gjê të egër,
 e merr vesh ti shpejt merakun tem.

(1998: 71)

Në gjah ai vërtet dëshmon shkathtësi e fuqi epike, si Muji. Ai shpejt do të dëshmohet edhe në diçka tjetër; do rrëmbejë nusen kreshnikisht – me dashuri, si Halili – nga një *krajli* tjetër e largët. Edhe varza përshkruhet si Tanusha; me shikim gaztor e flokë kaçurrel, vetulla të zeza e fytyrë që i shkëlqente si rrezja e diellit. Efekte të romancës përshkrijnë fuqishëm lidhjen e Digenisit me vashën e tij, si të Halilit me Tamushën.

Me a pa dashje, cikli epik ilirik, me ciklin e kreshnikëve në bërthamë, bëhet njëfarë epiqendre e kryqëzimeve indoevropiane, nga përvojat asiro-babilonase te ato gjermanike. Ta zëmë, e gjejmë vajtimin si të *Gilgameshi* dhe *Iliada*, por e gjejmë artin e duelit dhe skenën e mejdanit më shumë si te *Beovulfi*, *Nibelungët* e *Kënga e Rolandit*. Në këtë plan cikli i kreshnikëve anon kah klima dhe fryma e sagave të vjetra gjermanike. Pra, ndonëse ky cikël njih frymën e poetikës heroike akadiane-babilonase që i priu asaj greke duke u zhvilluar në tema, syzhe e gjeopoetikë më vete, nuk e njih shumë urbanen antike helene. Vetë Troja, si qytet e si ndodhi, krijoi një civilizim poetik; epika shqipe e kreshnikëve nuk ka as Trojë, as ndodhi, as heronj që lidhen me ndonjë qytet. Paradigmat ilire, sado të moçme që mund të jenë, dallojnë me ato helene pikërisht për shkak të gjeografisë dhe historisë së diktuar nga kjo gjeografi. Nëse areali helen dha epikën e detit, areali ilirik dha epikën e malit, ku zërat poetikë gjermanikë si ata të *Beovulfit*, *Nibelungëve*, e

Kalevalës përplotësuan motivet e lashta indoevropiane që kishin zënë rrënjë aty.

Rrjedhimisht, te ato etni ku ndjenja religjioze bëhet e fortë dhe monolite, ajo bartet edhe në sfondin e bëmave të heronjve epikë. Brishtësia e doktrinës religjioze te ilirët dhe te arbit, i lë Mujin e Halilin në paqe me besimin natyror.

Së këndejmi, drejtimi e radha e përfrimit psikologjik e mental të sagave epike të njohura me ciklin e kreshnikëve rrjedh si vijon: një lidhje strukturale e kompozicionale me epikën boshnjake, me atë malazeze dhe më pak me atë serbe, lidhje efektsh mitologjike me *Beovulf*, *Nibelungët* dhe tërë Nordin epik gjermanik, lidhje me elemente morale e tematike me botën e *Gilgameshit* dhe atë *homerike*, por edhe me epikën bizantine dhe, në fund, lidhje me arealin epik të *Këngës së Rolandit* dhe epikës romane. Pra, lidhjet me veriun e jugun janë më të vërejtshme se sa me epikën perëndimore nacionale të kryqëzatave.

Brenda kësaj perspektive ka edhe mjegulla. Ndonëse loja e poezisë gojore nuk është e varur nga shkrimi, besohet se, te popujt gjermanikë dhe ata nordikë, përgjithësisht, sensibiliteti dhe gjuha poetike u gdhendën e u stabilizuan krahas përhapjes së krishterimit si kulturë e si shkrim dhe patën ndikim e vet edhe për karakterin e sagave gojore. Ky rrëfim duket se nuk ngjau kështu më në jug e në lindje. Mediterani, bota e kulturave të lashta mesopotame, egjiptase, greke e ilire, areali i Azisë së Vogël dhe Iliriku, njohën kulturën poetike gojore para doktrinave të mëdha religjioze.

Kjo prani e supozuar e kulturës poetike e heroike gojore para se asaj të shkrimit, duket se la pas një mister të tërë të origjinës së kësaj kulture të Ilirikut dhe të strukturës së saj etnike e politike. Meqë, ky cikël ka rrënjë më të hershme se gjuhët moderne të Siujdhesës Ilirike, gjuha (gjuhët?) origjinare e tij bart më vete një mister të tërë, sepse zë fill herët e dokumentohet vonë, nëse është ndonjë nga gjuhët e sotme të gjalla të regjionit. Edhe ashtu, evidentimi kronologjik i ciklit ka më pak peshë se bërthama e tij si botë imagjinare e sinkretikes, si mimezë e bashkëbisedimit të natyrës me njeriun, besimeve, sjelljeve e marrëdhënieve mes njerëzve e natyrës në këto këngë. Duhet pasur parasysh se areali ilir i botës të kreshnikëve ishte përfshirës sa u përket ndikimeve nga epikat e ndryshme veri-lindje, po aq sa bëhet difuziv në tradita të ndryshme etnike. Duke pasur parasysh paleologjinë e kësaj kulture, asnjë nga traditat gojore të Evropës Juglindore nuk mund të shpallin autorësi mbi këtë substrat të supozuar dhe të lëshojë licenca trashëgimie

etnike të këtij cikli. Ky substrat nuk i dhuron pronësi asnjë gjuhe a etnie edhe ngaqë gjuha ndërron gjithnjë më shpejt se mentaliteti dhe, në këtë rast, mentaliteti mund ta ketë konservuar substratin epik origjinar, mbase duke e kaluar nga gjuha në gjuhë. Nëpër kohë të ndryshme, mentaliteti ka pronësuar dhe punësuar gjuhët më shumë se gjuhët mentalitetin.

Për më shumë, megjulla primitive e marrëdhënieve njerëzore-natyrore në këtë cikël, ka peshë më të veçantë, sesa gjuha e tij si mentalitet nacional modern. Ndërsa, gjuha e kreshnikëve ka peshë si gjuhë e heronjve, si çfarëdo gjuhe bëmesh e heronjsh, e cila jep gjuhët e bashkësive që i këndojnë këto bëma, por duhet përkujtuar që shtresa kulturore e kreshnikëve ilirë nuk këndon luftëra kombesh e tema gjuhësh. Gjuha e brendshme e tyre është mbi regjistrin politik të bashkësisë së gjerë dhe, rrjedhimisht, vonë prodhon efekte të forta në gjuhët politike të kësaj bashkësie.

Trashëgimia kulturore e periudhave të ndryshme (Çabej 1939), qoftë ajo *illyre* e kohës parahelene, helene dhe pashelene apo e traditave të tjera, mbetet substrat me primesa të kulturës indoevropiane brenda *Kângëve kreshnike*.

Summary

The article *The Warrior and the Heroic Tradition* aims to bring a dialogue with the natural and naivety of the Albanian warrior songs-heroes as a rich source of poetry and reflection.

It opens up as with an interpretation of the hero in Albanian warrior songs and its poetic horizon in Albanian poetics. Then the attention is turned to the connection with *The Epic of Gilgamesh*, Homeric tradition, the Byzantine Digenis Acritis, and also to the connection of the Albanian warrior songs with the other cycles. A parallel is drawn with the Bosnian and Serbian ones, and also with the epic poetics of *Beowulf*, *The Song of Nibelungs* and *The Song of Roland*. Different layers of *warrior songs* are identified and investigated, encompassing the characteristics of what is called the *warrior naturalis*, such as adventure group hunting, and the honour. If the heroic warrior songs have crowned the Albanian poetic tradition with name and honour, the song *The Marriage of Halil* worthily represents the crown chair.

I seem to have adopted a kind of *natural perspective* (N. Frye) to interpreting the poetic world of the hero-warriors. However, I have tried to step out and beyond the common popular national-romanticism.

Burimet

- [1] *Beowulf*. 1999. (Transl. by Seamus Heaney). London: Faber and Faber.
- [2] Cordignano, Fulvio P. 1942. *La poesia epica di confine nell'Albania del Nord. II Parte*. Padova: Tipografia del Seminario di Padova.
- [3] *Das Nibelungenlied* 2015 (Aus dem Mittelhochdeutschen von Karl Simrock) Köln: Anaconda Verlag GmbH.
- [4] *Digenis Acritis. The Grottaferrata and Escorial versions*. 1998. (Ed. and transl. by Elizabeth Jeffreys). Cambridge: Cambridge University Press.
- [5] Đurić, Vojislav (Ed.) 1954. *Antologija narodnih junačkih pesama*. Beograd: Srpska književna zadruga.
- [6] *Epika legjendare. Cikli i krishnikëve I*. 1966. (Red. prej Qemal Haxhahasanit). Tiranë: Mihal Duri.
- [7] *Epika legjendare II*. 1983. (Përg. nga Qemal Haxhihasani). Tiranë: ASHASH, Instituti i Kulturës Popullore.
- [8] Hörmann, Kosta 1889. *Narodne pjesme Muhamedovaca u Bosni i Hercegovini*. Sarajevo: Zemaljska štamparija.
- [9] Homeri 2015. *Iliada* (Përkth. nga Gjon Shllaku). Tiranë: Onufri.
- [10] Karadžić, Vuk Stefanović 2000. *Srpske narodne pjesme*. Beograd: Internet Izdanje.
- [11] *Këngë kreshnike I*. 2020. (Përg. nga Anton Çetta). Prishtinë: IAP.
- [12] *La chanson de Roland* 1990 (Éd. e trad. de Ian Short) Paris: Le livre de poche.
- [13] Lönnrot 2017. *The Kalevala. The Epic Poem of Finland*. (Transl. into English by John Martin Crawford).
- [14] Ontario: Devoted Publishing.
- [15] Maglajlić, Munib (ed.) 1990. *Pjesme o Muji Hrnjici*. MIZ B. i H.: Sarajevo.
- [16] Međedović, Avdo 2010. *Ženidba Smailagić Meha*. Novi Pazar: El-Kelimeh.
- [17] Parry, Milman; Lord, Albert (Eds.) 1953. *Srpskohrvatske junačke pjesme/ Serbocroatian heroic songs I*. Harvard: Harvard University Press/ Srpska akad. nauka.
- [18] *Visaret e Kombit. Vëllimi II. Kângë kreshnikësh dhe legjenda*. 1937. (Mledhë e redaktuem nga At Bernandin Palaj e At Donat Kurti). Tiranë: Shtypshkronja *Nikaj*.

Referencat

- [1] Bowra, Cecil, M. 1952. *Heroic Poetry*. London: Macmillan & Co. LTD.
- [2] Campbell, Joseph 1993. *The Hero With a Thousand Faces*. London: FontanaPress.
- [3] Cordignano, Fulvio P. 1943. *La poesia epica di confine nell'Albania del Nord. I Parte*. Venezia: Tip. Libreria emiliana.
- [4] Çabej, Eqrem 1939. *Për gjenezën e literaturës shqipe*. Shkodër: Hylli i Dritës, XV.
- [5] Daja, Ferial 1989. *Muzika e eposit legjendar*. Tiranë: IKP.
- [6] Desnickaja, Agnija D. 1975. Mbi lidhjet boshnjake-shqiptare në poezinë epike. Në: *Gjurmime albanologjike. Folklor dhe Etnologji*. Nr. V. 1977: 41-62. Prishtinë.
- [7] Frye, Northrop 1965. *A natural perspective. The development of Shakespearean Comedy and Romance*. New York and London: Columbia University Press
- [8] Gjeçovi, Shtjefën 2019. *Trashigime thrako-ilirjane*. Shkodër: Botime Françeskane.
- [9] Iser, Wolfgang 1993. *Das Fiktive und das Imaginäre. Perspektiven literarischer Anthropologie*. Frankfurt am Main: Suhrkamp.
- [10] Jansen, Jan; Maier Hendrik M. J. (ed.) 2004. *Epic Adventures: Heroic Narrative in the Oral Performance Traditions of Four Continents*. Münster: Lit Verlag.
- [11] Jung, Carl Gustav, Kerényi, C. 1951. *Introduction to a Science of Mythology: The Myth of the Divine Child and the Mysteries of Elensis*. London: Routledge & Kegan Paul.
- [12] Lambertz, Maximilian. 1958. *Die Volksepik der Albaner*. Leipzig. Halle: Max Niemeyer.
- [13] Oakeshott, Michael 1991. *Racionalizmi në politikë* (Përkth. nga Arsim Canolli) Prishtinë: Cuneus.
- [14] Sokoli, Ramadani 1984. *Lahuta dhe këngët e kreshnikëve*. Në: *Nëntori* 1/1984. Tiranë.
- [15] Vico, Giambattista 1948. *The New Science*. Ithaka, New York: Cornell University Press.

Imri Badallaj, Prishtinë

SISTEMI KONSONANTIK NË ITALO-ARBËRISHTEN E QEFTIT

Shqipja standarde në sistemin e saj konsonantik numëron 29 fonema, por në sferën dialektore të saj ky numër nuk është konstant. Përkundrazi, ai ndryshon, sidomos në të folmet italo-arbëreshe, ku në ndonjërin mund të realizohen 29 fonema të tilla, në ndonjë tjetër 30, 31, 32 ose edhe 33 fonema konsonantike, siç po ndodh edhe me të folmen e Qeftit (*it. Chieuti-t*), sistemi konsonantik i së cilës ngërthen 33 fonema konsonantike, që këtu më poshtë po i shtrojmë brenda këtyre rreshtave.

Sistemi konsonantik brenda idiomave dialektore të shqipes, jo vetëm për nga inventari i fonemave ndryshon, ai edhe për nga mënyra artikuluese mund të jetë afër ose larg sistemit konsonantik të shqipes standarde.

Për këtë çështje gjuhësore po nisemi nga kundërvëniet e fonemave, të cilat krijojnë vlera funksionale në këtë arbërishte, që i kemi vështruar nga mënyra e formimit, duke pasur për bazë pengesën e rrymës së ajrit, inkuadrimin e tejzave të zërit, rezonatorin nazal dhe vendin e secilit konsonant, ku realizohet nyjëtimi. Çfarë, këtu më poshtë pos tabelës klasifikuese: në okluzive, në frikative në nazale, në laterale dhe në vibrante, të gjitha këto grupe konsonantike, kur i vështruar me vëmendje brenda korrelacionit (bashkëlidhjes) na doli qartë, se përfshirja e tyre është mjaft e madhe, duke mbetur jashtë këtij segmenti vetëm disa konsonantet e këtij areali dialektor.

Kundërvëniet, sidomos të kapura gjatë hulumtimit tonë brenda në kontekst gjatë rrjedhës së të folurit nga informatorët vendës dhe në moshë, të vështruara nga pozicionet e ndryshme brenda fjalës për të gjitha fonemat konsonantike, doli në dukje një rendiment funksional fort produktiv, që prodhonte vlera të reja semantike. Kjo e dhënë na shtojë kërshërinë, që të ngjitemi drejt stadi të kësaj së folmeje arbëreshe fort të moçme, për t'i parë veçoritë e secilës fonemë konsonantike, të ruajtura jashtëzakonisht mirë, duke i rezistuar dhëmbit të moteve më se gjashtë shekuj, kur folësit e kësaj idiome u larguan nga Dheu i të parëve. Prandaj, hulumtimi i kësaj të folme italo-arbëreshe, e cila e ka

ruajtur kaq gjatë stadin e moçëm të saj, gjithsesi për studiuesit e gjuhës shqipe paraqet një rëndësi të veçantë.

Në arbërishten e Qeftit realizohen këto fonema konsonantike:

p, b, t, d, q/c/, gj/y/, k, g, c/ts/, x/dz/, ç/tʃ/, xh/dʒ/, f, v, th/θ/, dh/ð/, s, z, sh/s/, hj/ç/, j, zh/z/, h, gh/ɣ/, m, n, nj/n/, η, ll/L/, l, lj/ʎ/, r, rr/R /.

Konsonantet	Okluzivet		Frikativet		Likuidet			Na-zalet
	Të shur.	Të zësh.	Të shur	Të zësh.	La-ter	Polvi b.	Mon vib.	
Velaret	<i>k</i>	<i>g</i>	<i>h</i>	<i>gh</i> /ɣ/	<i>Ll</i> /L/			<i>η</i>
Palatalet	<i>q</i>	<i>gj</i> /ʝ/	<i>hj</i> /ç/	<i>j</i>	<i>lj</i> /ʎ/			<i>nj</i> /ɲ/
Palatalealveo-Laret	<i>ç</i> /tʃ/	<i>x</i> /dʒ/	<i>sh</i> /ʃ/	<i>zh</i> /z/				
Alveodentalet	<i>c</i> /ts/	<i>x</i> /dʒ/	<i>s</i>	<i>z</i>	<i>l</i>	<i>rr</i> /R/	<i>r</i>	
Apikodentalet			<i>th</i> /θ/	<i>dh</i> /ð/				
Posdentalet	<i>t</i>	<i>d</i>						<i>n</i>
Labiodentalet			<i>f</i>	<i>v</i>				
Bilabialet	<i>p</i>	<i>b</i>						<i>m</i>

Konsonantet e arbërishtes së Qeftit

Fonemat okluzive

Si fonema okluzive realizohen: *p, b, t, d, q, gj, k, g* (okluzive të thjeshta) dhe *c, x, ç, xh* (okluzive afrikate).

Fonema p.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

p/b: *po:sht* (giù) – *bosht* (fuso), *pe:s* (cinque) – *be:s* (besa, la parola d'onore);

p/d: *pa:sh* (io vidi) – *dash* (caprone), *pi* (io bevo) – *di* (io so);

p/c: pa (egli vide) – ca (un po);
p/ç: pe:l (giumenta) – çel (io accendo), par (primo)– çar (rotto);
p/dh: pes (cinque)–dhes(io accendo), pi(io bevo) – dhi: (capra);
p/f: para (avanti, davanti) – fara (il seme);
p/g: pas (dopo) – gas (sorriso), pra (poi) – gra (donne);
p/gj: pak (poco) – gjak (sangue),
p/s: pu:l (gallina) – sul (sulla, pianta erbacea), pis (inferno)-si:s (mamella);
p/sh: pa:t (oca) – sha:t (zappa), pi (io bevo) – shi (pioggia);
p/t: pa:t (oca) – ta:t (padre), pi (bevo) – ti (tu), pija (io bevevo)-tija (sua, di lui);
p/th: pat (oca, voi vedeste) – that (duro), pes (cinque) – thes (sacco), pir (bevuto) – thir (scanna tu);
p/v: pinj (bere) – vinj (venire), *p/z:* pi (io bevo) – zi (nero);
p/ø: pa:t (voi vedeste) – at (padre) etj.

Fonema **p** nyjëtohet si okluzive e shurdhët bilabiale dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: pak (poco), pabëndat (benedetto), palje (dote), pafundi (senza fondo), (i,e,të) panjohur (ignoto), pi (bevo);

në pozicion mesor: papritur (inatteso), këpucar (calzolaio), kopa (pieno);

në pozicion fundor: jap (io dò), rrip(stringa), lip (chiedere) etj.

Fonema b.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicione:

b/d: bihet (si porta) – dihet (si sa), (i,e,të) bardhë (bianco) – dardhë (pera);

b/f: bleta (l'alveare) – fleta (la foglia), ba:r (erba) – fa:r (seme), burri (l'uomo) – furri (il forno);

b/l: bo:t (terra)–lot (lacrima),bajta(il fango)–lajta (io lavai);

b/m: bi:lj (figlia) – milj (mille);

b/p: bosht (fuso) – po:sht (giù);

b/rr: bush (bòsso) – rrush (uva);

b/x: bathur (calzato) – xathur (scalzo);

b/xh: baketa (la bacchetta) – xhaketa (la giacca);

b/v: *bera (io feci) – vera (il vino)* etj.

Fonema **b** nyjëtohet si okluzive mbylltore e zëshme, e cila realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *bu:rr (uomo), buzi (labbro), bu:k (pane)*

//Vloje *bukën e bardhë pë ditë të zeza – Conserva il pane bianco per giorni tristi* // etj.

në pozicion mesor: *zëmbra (cuore), albëresh (albanese), mbëcuor (istruito);*

në pozicion fundor: *dhëmb (dente), glëmb(spina) // I hiri një glëmb ta gishti – Gli entrò una spina nel dito // tremb (spaventare), shkëmb (roccia)* etj.

Fonema t.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

t/d: *tru: (cervello) – dru: (legno), ti (tu) – di (due);*

t/c: *dita (il giorno) – dica (alcuni);*

t/f: *tul (mollica) – ful (folla);*

t/nj: *zot (signore) – zonj(ë) (signora);*

t/rr: *ti (tu) – rri (stai), mot (tempo) – morr (pidocchio);*

t/s: *ti (tu) – si (occhio);*

t/th: *ta:t (padre) – (i) tha:t (secco)* etj.

Fonema **t** nyjëtohet si okluzive e shurdhër dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *tallur (piatto), ta:t (padre) takun (pasta fatta in casa), tucëllonj (bussare) // Kush ngë tundet me këmbët, ngë ha ma dhëmbë- Chi non si muove coi piedi, non mangia con i denti//;*

në pozicion mesor: *dëftuor (mostrato), petka (panni) //Kush vishet me petkat e tjervet shpejt xhishet – Chi si veste con i panni degli altri presto si sveste // stëluc (singhiozzo),butjun (bottiglione), (i,e,të) ngratë (avaro)* etj.

në pozicion fundor: *gisht (dito) // Ngë ka një gisht tru – Non ha un dito di cervello // Një udhë e gja:t – Una lunga strada // rrëçet (ricetta medica), bisht (coda) // Shoh me bisht të siut – Guardo con la coda dell'occhio // gisht (dito)* etj.

Fonema d.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në

opozicionet fonetike:

d/f: *de:r* (porta) – *fe:rr* (rovo);

d/t: *di* (*sapere*) – *ti* (*tu*), *dru:* (*legno*) – *tru:* (*cervello*), *dera* (*la porta*) – *tera* (*tori*);

d/dh: *dri:t* (*luce*) – *dhri:t* (*le viti*), *di:* (*sapere*) – *dhi:* (*capra*);

d/r: *di* (*io so*) – (*i*) *ri* (*nuovo*);

d/rr: *di:t* (*giorno*) – *rrit* (*alleva tu*) etj.

Fonema **d** nyjëtohet si okluzive postdentale e zëshme dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *dera* (*la porta*), *do:r* (*mano*) // *Ka duart të glata – Ha le mani lunghe /, dosa* (*la scrofa*) // **Dosa** bëri dhjetë çirza – *La strofa ha partorito dieci porcellini // dukem* (*apparire*), **dua** (*volere*) // *Dua ca bukë – Voglio un po' dipane*

// *Të duo mirë – Ti voglio bene // E duo shumë gruojën – Amo molto mia moglie //*

në pozicion mesor: *hunda* (*naso*) // *Mas ngul hundën ta shpia e tija – Non ficcare il naso in casa sua // ëndërr* (*sogno*), *ngudënë* (*incudine*), *ndihmë* (*aiuto*);

në pozicion fundor: *sod* (*oggi*) // *Më mirë veja sod ke pula nesër- Meglio l'uovo oggi che la gallina domani // ënd* (*piacere*), *fund* (*fondo*) // *Fund i bukjerit – Il fondo del bicchiere // katund* (*paese*) // *Vete ture lipur katund pë katund – Va elemosinando paese per paese // etj.*

Fonema q /c/.– Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

q/ç: *qa:r* (*pianto*) – *ça:r* (*spaccato*);

q/gj: *qen* (*cane*) – *gjen* (*trovi*);

q/k: *miq* (*amici*) – *mik* (*amiko*);

q/sh: *qelq* (*vetro*) – *shelq* (*salice*) etj.

Fonema **q** nyjëtohet si okluzive palatale e shurdhët dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *qepë* (*cipolla*) // *Bukë e qepë e do rri ta shpia jime – Pane e cipolla e voglio stare a casa mia // qengj* (*agnello*), *qiri* (*cero*) // *Je si qiri i shuor – Sei come cero spento // qjell* (*cielo*) // *Mas shpëti ta qjella se të vjen ta faqja – Non sputare in cielo perchè ti viene (torna) in faccia //*

në pozicion mesor: *pëlqenj* (piacere), *koqarele* (gemelli), *faqe* (faccia) // *Çë faqe ka ajo gruo – Che sfacciataggine ha quella donna* // *qiqër* (cece) // *Pjek qiqrat ta helli – Abbrustolisce i ceci allo spiedo* //;

në pozicion fundor: *furriq* (cova, tana), *keq* (male) // *Më bën keq – Mi fai male* // *Bëj të mirën e harro / bëj të keqën e pënxo – Fa il bene e dimentica / fa' il malee pensa (ricordalo)* //etj.

Fonema gj /J/. Mund të identifikohet me fonema të tjera në opozicionet:

gj/f: *gja:l* (bambino) – *fal* (scusare);

gj/k: *gjeq* (ascolta tu) – *keq* (cattivo); **gj/ç:** *gjel* (gallo) – *çel* (io accendo);

gj/q: *gjen* (trovato) – *qen* (cane);

gj/rr: *gjeq* (ascolta tu) – *rreq* (re);

gj/sh: *gjum* (sonno) – *shum* (molto);

gj/lj: *dogja* (bruciai) – *dolja* (uscii);

gj/ø : *gja:sht* (sei) – *asht* (osso) etj.

Fonema **gj** nyjëtohet si okluzive qiellzore e zëshme dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *gjumë* (sonno) // **Gjumë** i rëndë – *Sonno pesante* // *gjind* (gente), *gjilpëra* (l'ago), *gjethe* (foglia) //

Rrinë zogazit ndër gjethe e ngë këndojën – Stanno gli uccelli tra le foglie e non cantano // *gjegjur* (ascoltato) // *Është një njeri i gjegjur – E' una persona ascoltata* // *gjella* (vita) *gjëmb* (spina)

gjellë plot me hajdhi – Una vita piena di soddisfazioni // **gjizë** lopje (ricotta di vacca) etj.

në pozicion mesor: *magje* (madia) // *La brumët te magjja pë të folnej me ndrikullën – Lasciò la farina impastata nella madia per parlare con la comare* /, *mosgjë* (niente) // *Pa mosgjë ngë bëhet mosgjë – Senza niente non si fa niente* /, *ngjëmuor* (imbastito), // *Ngjiejta bukën te poçja – Intinsi il pane nella pignatta* // etj.

në pozicion fundor: *zogj* (uccello), *rregj* (re) etj.

Fonema k. - Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

k/g: *ku:r* (quando) – *gu:r* (sassò);

k/f: *kurr (mai) – furr (forno), klet (voi foste) – flet (tu parli);*

k/b: *gisht (dito) – bisht (coda);*

k/dh: *ki (questo) – dhi: (capra), keza (copricapo nuziale delle donne) – dheza – (io accesi);*

k/m: *ku:r (quando) – mur (muro), (të) korrat (la mietitura) – morrat (i pidocchi);*

k/n: *Le:k (Luca) – Le:n (Elena);*

k/p: *ka (ha) – pa (senza);*

k/sh: *koqe (chicco, acino) – shoqe (moglie);*

sk/h: *ka: (bue) – ha (mangio)*

k/th: *ka (egli ha) – the (tu dicesti) etj.*

Fonema **k** në arbërishten e Qeftit nyjëtohet si okluzive velare e shurdhët dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *kam (ho), keq (male) // Miku im isht keq – Il mio amico sta male) // kripë (sale), krimb (verme), ka:l (cavallo) // **K**ur kali ngë do pie, ka t'i fëshkoç – Quando il cavallo non vuole bere, devi fischiarlo// kaçunjelë (pollone del carciofo che si consuma cotto o crudo), kush (chi) // **K**ush u dogj me ujët të nxehtë, i trëmbet edhe ujët të ftohtë – Chi si scottò con acqua bollente, teme anche l'acqua fredda // etj.*

në pozicion mesor: *petku (la proprietà) // Gruoja e mirë bën petkun, e petku bën gruan të mirë – La donna buona fa la proprietà, /e la proprietà fa la donna buona // karkalec (grillo), ndukën (succhia) etj.*

në pozicion fundor: *pak (poco) // Sot shurbeva pak – Oggi lavorai poco // peshk (pesce), vivlik (biblico) etj.*

Fonema g.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

g/nj: *lag (io bagno) – lanj (io lavo);*

g/b: *gisht (dito) – bisht (coda), po:sht (giù) – bosht (fuso);*

g/k: *gu:r (sasso) – ku:r (quando);*

g/h: *ka: (bue) – ha (mangiare);*

g/x: *guri (la pietra) – xuri (egli apprese) etj.*

Fonema **g** nyjëtohet si okluzive velare e zëshme dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *gardh* (sieve) // *Edhe gardhet kanë sitë* – Anche le siepi hanno gli occhi // *gisht* (dito) // *I jep gishtin e të merr dorën* – Gli dai il dito e ti prende la mano // *gargarixë* (liquirizia), *guri* (ginocchio), *gruo* (donna) // *Gruoja e tjervet isht m'e mirë* – La donna altrui è migliore // *gërshërë* (forbice) // *Gërshërët ngë presnjën më* – Forbici non tagliano più // *gruri* (frumento) // *Ara lasht nxjerr grurë e kashtë*//*grika* (gola)*garxavile* (stato di euforia smoderata) // *Mos u vë në garxavile*- Non ti mettere in uno stato di euforia // etj

në pozicion mesor: *nglatur* (allungato), (i,e,të) *ngrënë* (mangiato) // *Kur delja bën be / bjer të ngrënit* – Quando la pecora fa be / perde il cibo // (i,e,të) *ngushtë* (stretto), *ngridhje* (levitazione);

në pozicion fundor: *zog* (uccello), *she:g* (melograno), *milima:ng* (ragnatela) *nëng* (non) // *Bukë meli nuk do / bukë të grinjë nëng kemi / ec e ha një cung qeni* – Pa di miglio non vuoi / pane di grano non abbiamo / va' a mangiare un pezzo di escremento di cane/¹.

Fonema c /ts/.– Identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

c/ç: *cung* (escremento) – *çung* (storpio);

c/h: *ca* (un po) – *ha* (io mangio);

c/l: *co:p* (pezzo) – *lo:p* (vacca), *ma:c* (mazzo) – *mal* (monte);

c/rr: *cita* (io saziai) – *rrita* (allevai);

c/t: *ec* (cammina) – *et* (sete);

c/s: *ca* (un po)- *sa* (quante);

c/sh: *curr* (caprone) – *shu:rr* (urina);

c/th: *puc* (pozzo) – *puth* (bacio) etj.

Fonema **c** nyjëtohet si okluzive afrikate alveoledentale e shurdhët dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *cëkonj* (pressare), *copë* (pezzo) // *Një copë dhe:* - *Un pezzo di terra / ca* (alcuni) // *Ca vijën e ca vejën* – Alcuni venivano e altri andavano/;

në pozicion mesor: *sbëcek* (taccagno, avaro), *skacamurjel* (folletto), *skacil* (cispa);

në pozicion fundor: *ec* (camminare), *ma:c* (mazzo), *lu:c* (lago) etj

¹ E. Giordano, FJALOR – Dizionario arbëresh –italiano / Vocabolario-italiano-arbëresh, Castrovillari (Cs), 2000, fq. 55

Fonema x /dz/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

x/d: *nxenj (riscaldo) – ndenj (stendo);*

x/b: *xathur (scalzo) – bathur (calzato) etj.*

Fonema **x** nyjëtohet si okluzive alveolodentale e zëshme dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *xathur (scalzo), xë (apprendere)*

// *Xura nuse ke do veç Rur, e mas t'errëfshe të vëç kurorë – Ho saputo, o sposa, che vuoi maritarti ad Ururi, e possa tu mai giungere alle nozze*
// *xëjtur (saputo), xurna (tuba) etj.*

në pozicion mesor: *Spexana (Spezzano), xanxàn (intermediario), vërxele (colpo infekto co un corpo contundente) mëxet (staio) // Ka koçën si një mëxet – Ha la testa come uno staio//*

në pozicion fundor: *vix (vizio) //Ujku kanjon leshin, po jo vixin (Il lupo cambia il pelo, ma non il vizio// etj.*

Fonema ç/ʧ/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

ç/m: *meç (stoppino) – mes (busto);*

ç/f: *ça:r (rotto) – fa:r (seme);*

ç/q: *çarë (spaccato)– qarë (pianto), çurr (moccio) – qurr (caprone);*

ç/r: *ça:r (rotto) – ra:r (caduto) etj.*

Fonema **ç** nyjëtohet si okluzive afrikate e shurdhër realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *çavllë (cornacchia), çambë (zampa), çëmnere (camino), çuf (fiocco) // Një çuf lulesh – Un mazzo di fiori // Një çuf lesh – Un ciuffo di capelli // etj.*

në pozicion mesor: *kuçatë (testata), kuçmënele (minestrine di poco valore), rëçëtonj (riposare);*

në pozicion fundor: *kiç (chiave) // Mbulli me kiç – Chiudi a chiave // ko:ç (testa) // Kush ngë ka ko:ç, ka këmbë- Chi non ha testa ha piedi // , skiç (escremento) etj.*

Fonema xh/dʒ/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

xh/b: *xhaketë (la giacca) – baketë (la bacchetta);*

xh/l: *maxhi*(il maggio)–*mali* (il monte), *xhesh* (io svesto) – *lesh* (lana) etj.

Fonema **xh** njihëtohet si okluzive afrikate palato-alveolare e zëshme dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës, por në pozicion fundor është më e rrallë:

në pozicion nistor: *xhaketë* (giacca), *xhavotë* (ciabatta), *xhunduor* (saldato), *xhepi* (tasca);

në pozicion mesor: *lexha* (legge), *rixhistronj* (registrare), *lixhuor* (lento), *vrëxhill*(stomaco dei pennuti) etj.

në pozicion fundor: *raxh* (raggio), *xhi:xh* (scintilla), *ranxh* (acido) // *Lardhi vjen mbë ranxh* – Il lardo sa di rancido// *krunxh* (storpio di braccia) etj.

Fonemat frikative

Si fonema frikative realizohen: **f, v, th, dh, s, z, sh, hj, j, zh, h, gh/ɣ/**.

Fonema f.- Mund të identifkohet me disa fonema të në opozicionet:

f/b: *fleta* (la foglia) – *bleta* (l'arnia), *fa:r* (seme) – *ba:r* (erba); *fala* (io salutai) – *lala* (il fratello maggiore, lo zio paterno e materno);

f/m: *faqe* (guancia) – *maqe* (macchia);

f/p: *fa:r* (seme) – *pa:r* (primo);

f/r: *fa:r* (seme) – *ra:r* (caduto);

f/rr: *fu:sh* (pianura) – *rrush* (uva)etj.

Fonema **f** njihëtohet si frikative labiodentale e shurdhët, e cila në këtë të folme realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *flas*(parlare), *fjala* (parola) // *Fjala jote ta veshi Krishtit* – *La tua parola all'orecchio di Cristo* // *fjalët janë si: thua një, dalën tri* – *Le parole sono comele ciliege: di ci una ed escono tre* // *Mos bëni fjalë* – *Non liticate*² *furri* (forno) // *Pjekur ta furri* – *Cotto al forno* // *fuzille* (fusilli), *fjalë* (parola) // *finjë* (liscivia) // *Lanj me finjën* – *Lavo con la liscivia* // *fufëll* (vuoto, secco) // *Ata arra janë fufëll* – *Quelle noci sono secche* // *fe:rr* (rovo) // *Mora mënzën e ferrit i vura zjarr* – *Presi la mora* (la sposa) e al rovo (alla sua parentela) *diedi fuoco*

² E. Giordano, *Po aty*, fq.113

(*riferito afamiglia di dubbia condotta/con la quale ci si imparenta ma non si vuole più avere a che fare*)³ *faqe*(faccia)//*Kush ka faqen martohet/ kush jo, mbjetet vetëm – Chi ha la faccia si marita; chi no, rimane sola //*

në pozicion mesor: *Qefti, bufun* (carbone del grano), *ngrëfonj* (rizzare), *rrëfenj* (raccontare), *rrëfim* (narrazione, racconto) // *Gjegjni të rrëfiemen çë ju thom – Ascoltate il racconto che vi dico //*;

në pozicion fundor: *plaf* (coperta) // *Sa ke plafin shtrij këmbën – Quanto hai (lunga) la coperta tanto stendi la gamba //* etj.

Fonema v.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

v/b: *vëra* (il buco) – *bëra* (io feci);

v/r: *ve:* (uovo) – *re:* (nuora)

v/p: *vinj* (vengo) – *pinj* (bevo) etj.

v/z: *vë* (mettere) – *zë* (prendere);

Fonema **v** nyjëtohet si frikative e zëshme labiodentale dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *valle* (ballo)*valj* (olio), *vavëcë* (sorbo), *vetëm* (solo);

në pozicion mesor: *peva* (vidi), *mallvazhi* (malvasia, varietà d'uv a bianca e di vino dolce e frizzante), *llavanare* (lavandaia) etj.

në pozicion fundor: *vuv* (muto) etj.

Fonema th /θ/- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

th/c: *puth* (bacio) – *puc* (pozzo);

th/dh: *thënë* (detto) – *dhënë* (that (secco) – *dhat* (deste);

th/h: *tha* ((egli disse) – *ha* (io mangio); **th/m:** *thes* (sacco) – *mes* (busto);

th/n: (i) *tha:t* (duro) – *na:t* (notte);

th/nj: *thom* (io dico) – (i) *njom* (molle);

th/r: *the:* (tu dicesti) – *re:* (tu cadesti);

th/rr: *thith* (io succhio) – *rrith* (corri tu);

³ M. Massaro, *Dizionario comparato delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti, Apricena, 2010, f. 52*

th/s: *thot (dice) – sot (oggi);*

th/z: *thot (egli dice) – zot (signore) etj.*

Fonema **th** nyjëtohet si fërkimore ndërdhëmbore (apikodentale) e shurdhët, e cila në këtë të folme realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *thi:k (coltello), thonj (unghie), thron (trono), thuoll (unghia) // Janë si mish e thuoll – Sono come carne e unghia // Gluha pret më ke një thikë – La lingua taglia più di un coltello // (i,e,të) thier (rotto, spezzato) // Nga zëmbra e thier – Dal cuore infranto // Të thom edhe këtë e vete – Ti dico anche questo e vado via // Shkoi një trim ka një udhë me një thuprëz ndë dorë - Passò un giovane per una strada / con un frustino in mano // etj.*

në pozicion mesor: *djathët (formaggio), ethe (febbre) // Kam ethe e madhe – Ho la febbre alta // uthëll (aceto) // Vera e mirë bëhet uthëll – Il vino buono diventa aceto // bithë (sedere) // Çë hëngre bithën e pulës - Hai mangiato il sedere della gallina (e sveli tutto) // xethe (foglia);*

në pozicion fundor: *thith (succhiare), fruth (morbillo) etj.*

Fonema dh /ð/. Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

dh/d: *dhritë (le viti) – dri:të (luce), dhi:(capra) – di: (so);*

dh/m: *dhe (terreno) – me (con);*

dh/th: *dhënë (dato) – thënë (detto);*

dh /g: *drudha (briciole) – druga (la spianatoia);*

dh/z: *dhi: (capra) – zi (nero) etj.*

Fonema **dh** në këtë të folme arbëreshe nyjëtohet si fonemë frikative apikodentale e zëshme dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *dhamat (covone) // Dia mbodhëm dhamatet – Ieri abbiamo raccolto i covoni // dhëndërr (fidanzato), dhemb (dolere) // Më dhemb koça – Mi duole la testa // dhëngall (molare), dhia (la capra) // Do barin pa ngarë e dhinë e ngopur – Vuole l' erba intatta e la capra sazia // etj.*

në pozicion mesor: *edhe (anche) udha (la strada) // Bëra udhën mbë këmbë – Percorsi la strada a piedi // adhjur (asino) // I lanj koçën adhjurit – Lavo la testa all' asino // idhëruor (amareggiato) etj.*

në pozicion fundor: *po:rdh (scorreggia) // Pordh si adhjur -*

Fa scorregge come asino // vidh (olmo), vjedh (rubare) etj.

Fonema s.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

s/l: sot (oggi) – lot (lacrima);

s/n: si:s (mammella) nis (avviare);

s/t: si: (occhio) – ti (tu);

s/th: sot (oggi) – thot (dice);

s/z: dorës (della mano) – dorëz (manciata) etj.

Fonema **s** nyjëtohet si frikative postdentale e shurdhët dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *sënduq (baule),sdëllambirën (lampeggia), sarakjuor (percosso), sa (quanto), spëllohem (pelarsi), si (occhio) // Ndërroitë sitë pë bishtin– Cambiò gli occhi per la coda // strafil (staffile), sgjeshënj(spogliare), sikur(come quando), sipër(sopra) etj.*

në pozicion mesor: *pësana(dopo,poi), mbësuar (insegnato) // Mbësuhu bith kur je vetëm, ke kur je bashkë me tjetrit bjer faqen – Impara, o sedere, quando sei solo, chë quando sei con gli altri ti svergogni // mustaqe (baffi) // Isht një burrë me mustaqet e dredhur-E' un uomo con i baffi attorcigliati // muskill (moscerino) etj.*

në pozicion fundor: *korrës (mietitore) // Le korrësit e vete pë çamarukelle – Lascia i mietitori e va per lumache // flas (parlare) // U flas gluhën arbëreshe – Parlo la lingua arbëreshe // pastis (abbeverare), sos (finire) // Sosa punën - terminai il lavoro // etj.*

Fonema z.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

z/q: doq (bruciò) – zoq (uccello); z/r: zërë (voce) - rërë (sabbia);

z/rr: buzi (il labbro) – burri (l'uomo);

z/s: dorëz (manciata)–dorës (della mano), zi:(nero)–si: (occhio)

z/th: zot (signore) – thot (dice),

z/v: zë (prendere) - vë (mettere) etj.

Fonema **z** nyjëtohet si frikative alveolodentale e shurdhët dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *zëmbër (cuore) // Faqja na i qeshën e zëmbra na i kla – Il viso ci sorride ed il cuore ci piange // zbatuor (sbattuto),*

zdënjuoja (mi indignai), zë (prendere) // A zuri pë një krah – Lo afferrò per un braccio // Zuri shiu–Cominciò a piovere // zog (uccello) // Isht i shkretë gja një zog pa fale – E' povero come un uccello senza nido // zot (signore) // Zoti mbullin një derë e hapën një purtun – Il Signore chiude una porta ed apre un portone // Të pafshe aq ditë të zeza – Possa tu avere tanti giorni tristi // zuri zjarr – prese fuoco // A zuri ta koça – Lo colpì in testa // etj.

në pozicion mesor: *organizmi (organismo), karuzuor (tosato), grazdhë (mangiatoia);*

në pozicion fundor: *grerëz (vespa), dorëz (impugnatura), pordhëz (lumaca di medie dimensioni e di colore verde che produce molta schiuma bianca), prallëz (favola), vashëz (ragazza) etj.*

Fonema sh /ʃ/. Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

sh/h: *shi:(pioggia) – hi: (cenere), qesh (io rido) – qeh (io porto);*

sh/l: *shuojta (io spensi) – luojta (io giocai), sha:l (sella) – la:l (zio, fratello maggiore);*

sh/n: *shat (zappa)– na:t-(notte), shesh (pianura) – nesh (di noi)*

sh/m: *shes (io vendo) – mes (busto), shi: (pioggia) – mi: (topo);*

sh/q: *shanj (disprezzare) – qanj (piangere);*

sh/r: *gu:sh (gozzo) – gur (pietra);*

sh/rr: *sho:sh (crivello) – (të) rrosh (possa tu vivere) etj.*

Fonema **sh** nyjëtohet si frikative palato-alveolare e shurdhët dhe realizohet në të gjitha pozicionet:

në pozicion nistor: *shiu (pioggia) // Kur maçja lan faqet vjen*

shiu – Quando il gatto lava la faccia viene la pioggia //

shkarpë (sterpo), shanj (disprezzare), shami (fazzoletto) etj.

në pozicion mesor: *//Gjaku i shprishur- Il sangue sparso // Vreshhta ishtë pavjelur –La vigna non è vendemmiata // etj.*

në pozicion fundor: *Kush ngë shurben ngë dërsin – Chi non lavora non suda // rrush (uva) // Rrush i vreshtës–L' uva della vigna etj.*

Fonema zh /ʒ/. Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

zh/h: *shjozhmi (crivelliamo) shohmi (vediamo);*

zh/z: *shozhnja (crivellavo) – soznja (finivo)* etj.

Fonema **zh** nyjëtohet si frikative alveolare e zëshme dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës, por me një shtrirje shumë më të reduktuar se fonemat e tjera:

në pozicion nistor: *zhakëz (lurida), zhdukem (sparire), zhgozhdjas (schiodare), zhgalia (burrone), zhbënj (disfo), zhurmë (chiasso), Zhur-i (cittadina della Kosova, gemellata con Casalvecchio di Puglia il 25.09.2008);*

në pozicion mesor: *rruzhe (turbine), bazhdunia (sporczia)* etj

Fonema hj/ç/.- Mund të identifikohet me disa të tjera në opozicionet:

hj/p: *djehj (diavoli) – dje(cùlla);*

hj/nj: *fihj (fili) – finj (liscivia);*

hj/r: *rahj(salita) – rar (caduto);*

hj/rr: *ehjur (affilato) – errur (oscuro);*

hj/k: *hje (ombra) – ke (tu hai);*

hj/sh: *gjesh (impasta tu) – gjehj (trova tu)* etj.

Fonema **hj** nyjëtohet si frikative-palatale e shurdhët dhe realizohet në të gjitha pozicionet, por më dendur e kemi hasur në pozicion nistor dhe fundor të fjalës:

në pozicion ni stor: *//Çë ka hje kjo kopilje kur çë ve një gunë a re – Come elegante questa ragazza quando indossa un abito nuovo // Hjedh një gur – Lancio un sasso // hje (ombra) // Ai lis na bën shumë hje – Quell' albero e ci fa molta ombra // Ajo ka hjatin e jëmës – Lei ha il sostegno della mamma // Ajo grua ka shumë hje – Quella donna ha molta grazia // Bashkë kimi hje – Insieme stiamo bene // Hjedhjën grurët ta lëmi – Spulano il grano sull'aia // etj.*

në pozicion mesor: *rehje (colli) // Ndër dy rehjez me borë- Su due colli nevosi // etj.*

në pozicion fundor: *djehj (diavoli), rahj (salita)* etj

Fonema j. - Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

j/z: *jot (tuo) – zot (signore);*

j/k: *jashtë (fuori) – kashtë (poglia), jam (sono) – kam (ho);*

j/sh: *qaj (piangere) – shaj (disprezzare)*

j/l: jot (tuo) – lot (lacrima);

j/x; jëtur (lasciato) – xëjtur (sapuno) etj.

Fonema **j** nyjëtohet si frikative-palatale dhe zë vend në grupin e sonanteve, e cila realizohet në të gjitha pozicionet:

në pozicion nistor: jam (sono), jap (dare), jashtë (fuori) /jashtë shpisë – fuori di casa/, jo (no) etj.

në pozicion mesor: ndjehem (sentirsi) //Ndjehem mirë–Mi sento bene// llambje (volta), pjesë (parte) //Një pjesë më nget edhe mua–Una parte spetta anche a me //pjekur (cotto), lladhjur (asino), llambion (lampeggiare) etj.

në pozicion fundor: juoj (vòstro), ej (si) etj.

Fonema h.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

h/g: huri (il palo) – guri (il sasso);

h/l: hip (io salgo) – lip (lutto);

h/k: ha (mangio) – ka (ha);

h/ll: koha (il tempo) – kolla (la tosse);

h/m: haç (sedano) – maç (gatto);

h/n: ha (io mangio) – na (noi);

h/nj: hera (l'ora) – njera (finoa);

h/q: (e) hëne (lunedì) – qëne (cagna);

h/ø: hera (l'ora) – era (il vento) etj.

Fonema **h** nyjëtohet si frikative-laringale e shurdhët dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: hollë (sottilmente), hiridhone (grazioso) // Tarandishe hiridhone kur do veç të bëç fale:n – Rondinella graziosa quando andrai a fare il nido // hurdhër (aglio) // Një shqjefë hurdhër – Uno spicchio d'aglio//, huoj (estraneo) // Ishi si i huoj – Era come un estraneo (in casa sua) /, hua (prestito) // Marr hua – Prendo in prestito // herë (volta) // Erruri hera – E'arrivato il momento // hajdhi (gioia) // Të paç me hajdhi – Ti vidi con gioia // Miell i bluor hollë – Farina macinata finemente // Jap hua – Dò in prestito // Me një fjalë të mirë hin kudo – Con una buona parola entri dovunque // Ngë dua të hinj me kët shubise – Non voglio avere a che fare con queste cose // Erruri hera – E arrivato il momento // Djali pa jëmë si nata pa hënëzë – Il bambino senza mamma (è) come la notte senza luna // Hap sitë – Aprire gli occhi // etj.

në pozicion mesor: *hahet* (si mangia) // *Hahet me bukë* – *Si mangia con pane* // *Këto këpurdhe ngë hahen* – *Questi funghi non si mangiano* (non sono commestibili) // *gjuha/gluha* (lingua) // *Dogji gjuhën* – *Si bruciò la lingua* // *lehem* (nascere) etj.

në pozicion fundor: *plëh* (polvere) // *Kush ka plëh shkrehën* – *Chi ha polvere spara* // *oh (oh)* // *Oh, mall i zëmbres sime* – *Sì, amore del mio cuore* // *shoh* (vedere) // *Shoh pak* – *Vedo poco* // etj.

Fonema **gh/ɣ/-** Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

gh/r: *baght* (la fronte) – *bart* (l'erba), *mogha* (la mela);

gh/rr: *magh* (mago) – *marr* (rendo);

gh/gj: *dogha* (uscio) – *dogja* (bricci);

gh/xh: *ghun* (il ginocchio) – *xhun* (giugno) etj.

Fonema **gh** nyjtohet si frikative sonore uvulave dhe te disa folës të kësaj idiome dialektore është e prirur të realizohet si fonema ll, duke u gjendur në të gjitha pozicionet:

në fillim të fjalës: *ghudhi* (mortaio), *ghadhjur* (asino) etj.

në mes të fjalës: *ughi* (olivo), *vgha/ugha* (fratello), *mogha* (lamela), *kogha* (la toske) etj.

në fund të fjalës: *uthugh* (aceto) etj.

Fonemat nazale

Në të folmen arbëreshe të Qeftit realizohen këto fonema hundore: **m, n, nj, ɲ**.

Fonema m.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

m/d: *mushku* (la spalla) – *dushku* (la bosaglia);

m/f: *mik* (amico) – *fik* (fico);

m/r: *mur* (muro) – *ku:r* (quando);

m/rr: *murrizi* (il rovo) – *kurrizi* (la schiena), *mëzë* (puledro) – *rrëzë* (falda);

m/k: *pa:m* (vedemmo) – *pak* (poco);

m/l: mik (amico) – (i) lik (cattivo), mal (monte) – la:l (zio, fratello maggiore);

m/n: kam (ho) – kan (hanno);

m/nj: më (a me) – një (uno);

m/k: muqe (erba secca) – kuqe (rossa);

m/p: matur (misurato) – pasur (avuto)

m/ø: marr (preso) a:rr (noce) etj.

Fonema **m** nyjëtohet si nazale sonante dybuzore dhe realizohet në të gjitha pozicionet e fjalës:

në pozicion nistor: mik (amico) // M'i miri mik të ngënjen – Il migliore amico ti inganna // mendëllë (mandorlo), mëma (mamma), mullënar (mugnaio), mërrur (manico) // M'u ça mërruri i shatit – Mi si ruppe il manico della zappa // mësalli (tovaglia), mëngë (manica), milingonë (formica) // Ecën si një milingonë – Cammina come una formica // mirë (bene) // Të uronj gjithë të mirat – Ti auguro ogni bene // mos (non) // Hir brënda, mos u lag pse bie shi – Entra dentro, non bagnarti perchè piove // Ngë do më - Non ne vuoi più // Vajta më këmbë – Andai a piedi // mashkull (maschio) // Gjithë lehen meshkulle, po pak bëhen burra – Tutti nascono maschi, ma pochi diventano uomini // Kush merr besën thërret t'in zotin për martiri – Chi giura chiama Dio a testimone // Mbësohu bithë kur je vetëm, ke kur je bashkë me tjetrit bjer faqen – Impara, o sedere, / quando sei solo ché / quando sei con gli altri ti svergogni // mëlshi (fegato) // Sonde do ha ca mëlshi ma pumëdorë – Stasera mangerò un po' di fegato col pomodoro // mëtonj (invitare), (i.e,të) mëtuor– invitato // etj.

në pozicion mesor: dhëmb (dente) // Krishti i jep bukën atija që ngë ka dhëmbë – Cristo dà il pane a chi non ha denti // zëmbër (cuore), Shëmëri (Madonna), shtrëmbur (storto);

në pozicion fundor: lum (fiume), jam (essere) // U jam kush jam e ti e dimi kush je – Io sono chi sono e tu lo sappiamo chi sei // kam (avere) // Kam kënduo-Ho cantato // shkrehem (spararsi) etj.

Fonema n.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

n/m: kan (hanno) – kam (ho), na:t (notte) – mat (io peso);

n/d: nesër (domani) - ders (dellaporta);

n/r: na (noi) – ra (cadde);

n/rr: *ana (il lato) – arra (la noce)*

n/t: *na:t (notte) – ta:t (padre) etj.*

Fonema **n** nyjëtohet si sonante hundore (nazale) postdentale dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *ndagjagjë (qualcosa), ndërmes (in mezzo) // Rri ndërmes shpisë si një nuse - Sta in mezzo alla casa come una sposa // nesërmbërëma (domani sera), nge (tempo) // Ngë kam nge – Non ho tempo // nuse (sposa) // Vajza i rriji ngrah jëmës – La bambina stava in braccio alla mamma // (i,e,të) ngratë (avaro) // I ngrati burr(ë) ngë njohu hare // etj.*

në pozicion mesor: (i) *pangrënë (digiuno), ngunajë (financo), shkanuor (panificato), sëmundje (malattia), qene (cagna), ngarnonjë (abituare);*

në pozicion fundor: *qen (cane) // Mas i qaseni qenit – Non avvicinatevi al cane // mullun (melone), shën (santo), lëmun (limone) etj.*

Fonema nj /ɲ/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

nj/d: *njihem (conoscersi) – dihem (aggiornare), njera (l'una) – dera (la porta);*

nj/l: *njetër (un altro) – letër (lettera), çanj (io rompo) – lanj (lavo);*

nj/rr: *njunj (babbeo) – rrunj (rogna);*

nj/ø: *shinj (io ventilo) – shi: (pioggia) etj.*

Kjo fonemë konsonantike nyjëtohet si palatale nazale sonante dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet:

në pozicion nistor: *njetër (un altro), njohur (conosciuto),*

njëmbëdhjetë (undici) etj.

në pozicion mesor: *puçënjel (voltafaccia), lonjë (giocano) // Fëmilët lonjën jashtë – I bambini giocano fuori // bënëjën (fanno) // Bënje si do – Fa come vuoi // etj.*

në pozicion fundor: *kushllonj (parlare), kunj (cuneo di ferro o di legno), kullonj (filtrare) // U kullonj ujët - Io filtro l'acqua // etj.*

Fonema ɲ.- Kjo fonemë konsonantike karakterizohet si velare nazale, e cila në këtë të folme arbëreshe është përftuar nga asimilimi i grupit konsonantik **ng:** *cuj < cung (tronco), mënjë < mëngë (manica), hëjra < hëngra (mangi)*

Fonemat laterale

Si konsonante anësore në këtë të folme realizohen tri fonema:

l, ll, lj.

Fonema l.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

l/ll: *hol (arnia) – holl (fino), kali (il cavallo) – kalli (spiga);*

l/dh: *li: (vaiolo) – dhi: (capra) etj.*

Fonema ***l*** nyjëtohet si palataloalveolare laterale sonante dhe si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet e fjalës:

në pozicion nistor: *lëkëngë (salsiccia) // Hami ca lëkëngë – Mangiamo un po di salsiccia // Të bëfshin copa-copa si mish lëkënge – Possano farti a pezzettini come carne di salsiccia // lëpërë (ago), lalë (zio, fratello maggiore), laluç (zio) etj.*

në pozicion mesor: *kular (collare), fletë (foglia) // Ranë fletet – Sono cadute le foglie // etj.*

në pozicion fundor: *mjel (mungere), dal (uscire), fitil (lucignolo) etj.*

Fonema ll /L/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

ll/l: *holl (fino) – hol (arnia), kalli (spiga) – kali (il cavallo);*

ll/rr: *molla (il melo / la mela) – morra (il pidocchio) etj.*

Fonema ***ll*** nyjëtohet si likuide velare laterale sonante dhe realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *llaca (dissenteria), llaç (laccio), llënxë (brandello) // Grisi këmishën e a bëri llënxa llënxa – Strappò la camicia e la fece a brandelli // Mbolla një llënxë dhe: – Ho seminato una striscia di terreno // llambje (volta, solaio) etj.*

në pozicion mesor: *molla (il melo), vullundatë (volontà, intenzione), mëllagë (malva);*

në pozicion fundor: *fell (bile), fufëll (vuoto, secco) // Ato arra janë fufëll – Quelle noci sono vuote // fuzill (ferretto quadrato utilizzato per la preparazione dei fusilli), kumbull (susino) etj.*

Fonema lj /l/.- Kjo fonemë nyjëtohet si palatale laterale e zëshme dhe realizohet në të tëra pozicionet fonetike të fjalës, sidomos tek brezi më

i vjetër, ndërsa brezi i mesëm dhe ai i ri këtë fonemë shpeshherë e zëvendësojnë me lateralen **l**. Pra, dëgjuam nga gojë të informatorëve fjalët : *ljulje* (fiore), por edhe *lule*, *kljiç* (chiave) // *Mbilli me kljiç* – *Chuse a chiave* // *kljostërë* (colostro), *ljehonë* (puerpera), *ljehmia* (latrato) // *Ljehmitë e qenvet* – *I latrati dei cani*// etj.

Fonemat vibrante

Si konsonante dridhëse në arbërishten e Qeftit realizohen fonema: **r, rr**.

Fonema r.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

r/rr: *mi:r* (bene) – *mirr* (prendi);

r/ll: *bartë* (l'e rba) – *balltë* (la fronte);

r/n: *na* (noi) – *ra*: (cadde) etj.

Fonema **r** nyjëtohet si dridhëse (vibrante) likuide alveolodentale sonante, e cila realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *rabushat* (alcolizzato), *rapiljë* (sabbia), *rëshorë* (vergogna) etj.

në pozicion mesor: *parathile* (finestra), *kurorë* (corona) // *Ajo ve kurorë sod* – *Ella si sposa oggi* // *pordhë* (scorreggia), *kurm* (corpo), *prëmë* (ieri sera) etj.

në pozicion fundor: *pishatur* (pitale), *pjellur* (partorito), *plor* (vomere) etj.

Fonema rr /R/.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

rr/l: *rripi* (la stringa) – *lipi* (ciocca di capelli disordinati);

rr/r: *mirr* (prendi) – *mi:r* (bene);

rr/d: *rri*: (stare) – *di*: (sapere);

rr/l: *limë* (lima) – *rimë* (stiamo) etj.

rr/r: *a:r* (oro) – *a:rr* (noce);

rr/h: *rreth* (cerchio) – *heth* (butto giù) etj.

Fonema **rr** nyjëtohet si dridhëse (vibrante) likuide alveolo-dentale sonante, e cila realizohet në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës:

në pozicion nistor: *rrashjuor* (speso copiosamente), *rrezë* (raggio), *rrjedhur* (corso) // *Të rrjedhurit e qerrëvet* – *La corsa dei carri* // *rrorsk*

(gelone), *rrufonj* (russare) *rrjedh* (scorre) // *Ujët rrjedh e gjaku shtrëngon* – *L'ac qua scorre e il sangue si coagula* etj.

në pozicion mesor: *arrë* (noce) *kurriz* (dorso), *schiena* // *Më dhemb kurrizi* – *Mi fa male la schiena* // *Arrat bjenjën kur piquen* – *Le noci cadono quando sono mature* // *ferrri* (il rovo) // *Mora mënzën e ferrit i vura zjarr* – *Presi la mora e al rovo detti fuoco* // *furriq* (cova, tana) *kurra* (mai), *kurra* (mai, giammai), *kurrgjë* (nulla) // *Ngë shtojën kurrgjë fjalëve time* – *Non aggiungono nulla alle mie parole*// *kurrkush* (nessuno), *kurrizor* (dorsale) etj.

në pozicion fundor: *furr* (forno) // *Pjekur ta furri* – *Cotto al forno* // *kurr* (mai), *bu:rr* (uomo), *varr* (tomba) etj.

Distribucioni i fonemave konsonantike

Grupet konsonantike, të cilat po i shtrojmë më poshtë, tregojnë qartë, se distribucioni fonematik është i duarduarshëm dhe paraqet një produktivitet të shqipes së vjetër më shumë se pesë shekuj më parë.

Përndarjen fonematike të së folmes arbëreshe të Kazallveqit po e pasqyrojmë, duke i shtruar shembujt e zgjedhur nga materiali i eksploruar nga gojët e informatorëve qeftiotë.

b+l: *blerë* (comprato), *bletë* (alveare), *bluanj* (io macino);

b+r: *brenda* (dentro), *brek* (pantalone), *breshkë* (tartaruga), *breshër* (grandine), *brazholle* (braciola), *brumi* (il lievito), *brinjë* (erta, costa di monte), *brumbullimë* (rombo, boato), *brisk* (rasoio), *brumrat* (pasta di casa grossolana), *broçë* (stampella), *breth* (giocare), *breg* (collina), *bres* (cintura d'argento), *bri* (corno), *brul* (gomito);

t+r: *trakanjonj* (tracannare), *trashë* (spesso), *trim* (giovane), *triesë* (tavola), *tru* (cervello), *truq* (potatura eccessiva), *trok* (trogolo), *tri* (tre), *trëndafil* (rosa), *trapjedh* (tripode), *train* (carretto); *trut* (cervello), *trkuza* (la corda), *tre* (tre), *trung* (potatura eccessiva), *trok* (trogolo), *truc* (mole), *trukullonj* (battere), (i,e,të) *trashë* (spesso, grosso, doppio), *traversë* (stanga di legno), (i,e,të) *trunguar* (troncato), *turjele* (succhielli);

p+l: *pleh* (polvere), *plak* (vecchio), *plesht* (pulce), (i,e,të) *plotë* (pieno), *plor* (vomere), *plënxë* (trippa), *pleqëri* (vecchiaia), (i,e,të) *plasur* (crepato);

p+r: *prapa* (dietro), *prallëz* (favola), *pres* (tagliare), *pruvëlluni* (il provolone), *prirem* (girarsi), *prevëllë* (sedile di legno a tre piedi,

sgabello), *prëmë* (ieri sera), *prift* (prete), *prill* (aprile);

k+l: *klishtë* (chiesa), *klënë* (stato), *klinde* (piega), *kloqi* (il baculo, il bastione), *klithën* (invocare), *kla* (piangere), *kliç* (chiave), *klumësht* (latte), *klostërë* (colostro);

k+r: *krimbi* (il verme), *krah* (braccio), *krehur*(pettinato), *kre* (rumore), *krështer* (cristiano), *krunde* (crusca), *krushku* (affine, parente), *kripë* (sale), (i,e,të) *krishterë* (cristiano), *krehër* (pettine), *krismë* (rumore);

g+l: *glisht* (dito), *glu* (ginocchio), *glëmb* (spina), *gluhë* (lingua), *glatë* (lungo);

g+r: *gruo* (donna), *grumbull* (mucchio), *grurë* (frumento), *grosh* (soldi), *groshë* (legume), *grisur* (logoro), *grëhje* (granchio), *grikë* (gola), *grep* (uncino), *grikgjer* (persona che parla molto);

gj+r: *gj(ë)ri* (parente);

f+l: *flë* (dormo), *fleta* (la foglia), *flas* (io parlo), *floku* (la ciocca), *flojerë* (flauto), *flutur* (farfalla);

f+j: *fjalë* (parola), *fjamuz* (baldanzoso), *fjeshtër* (figliastro); **m+b:** *mbadhuor* (confuso), *mbahur* (tenuto), *mbanuor impanato*), *mbanj* (mantenere), *mbëconj* (infilzare), *mbëkatë* (peccato), *mbë* (sopra), *mbesë* (nipote), *mbarë* (diritto), *mbiç* (impiccio), *mbullonj* (coprire), *mbulz* (bolsaggine degli animali), *mbushur* (riempito), *mba* (tieni tu), *mbathë* (calzare), *mbiazmat* (stupido), *mbëherë* (in tempo), *mbatanë* (la terra di là), *mbaronj* (finire);

m+j: *mjasditë* (mezzogiorno), *mjedhk* (medico), *mjedhikonj* (medicare), *mjedhiçinë* (medicina), *mjegullë* (nebbia), *mjel* (mungere), *mjekër* (barba), *mjell* (farina), *mjerë* (povero), *mjeshtër* (maestro), *mjalt* (il miele), *mjel* (mungere); *mjerësi* (miseria), *mjekërkuq* (dalla barba rossa o bionda); *mjekrrar* (barbiere); *mjalëm* (addolcito); *mjaft* (troppo); *mjalënj* (addolcire);

n+d: *ndagjagjë* (qualcosa), *ndanjëherë* (qualche volta), *ndajtur* (separato), *ndasuor* (ingolfato); *nder* (rispetto, onore), *ndejtur* (disteso), *ndë* (se, qualora), *ndërtënuor* (ritardato), *ndrëshërë* (avena, binda), *ndrikullë* (comare), *ndurtuor* (rimpinzato), *ndutu* (completamente, del tutto);

n+g: *ngarkuor* (caricato), *nganjë* (ognuno), *ngarë* (toccato), *nge* (tempo), *ngjatur* (allungato), *ngopët* (sazio), *ngratë* (avaro), *ngreñuor* (rizzato), *ngrohtë* (caldo), *ngruqërakuor* (accoppiato), *nguqem* (arrossire), *ngusht* (stretto), *ngrenë* (mangiato), *ngridhinj* (lievitare), *ngusht* (stretto);

n+gj: ngjalë (anguilla), ngjallinj (far risorgere), ngjëmuo (imbastito), ngjitur (attaccato), ngjim (imbastitura), ngjurrem (io divento rauco);

n+x: nxallatë (insalata), nxëvuor (unto, sporco), nxirt (innesto), nxjerr (levare), nxunonj (sognare), nxehtë (rovente), nxehem (riscaldarsi);

s+k: skamandil (fazzoletto), skacamurjel (folletto), skapetë (berretto di lana per la notte), skacil (cispa); skollë (scuola), skarnonj (disabituare), (i,e,të) skarnuor (disabituato), skretë (fessura), skapenë (pettine), skarpar (calzolaio), skaljernë (cardo selvatico mangereccio);

n+xh: nxhallambkë (imprevisto), nxhambkuor (inciampato), nxhenx (incenso), nxhin (asta di legno con due rebbi), (i,e,të) nxhënuor (indossato per la prima volta);

d+r: drizë (sterpo), drahë (fondo del mosto), drapër (falce), dredhur (vibrato), dreq (diritto), dridhem (tremare), dromsë (pasta sbriciolata fatta in casa e cotta in brodo), drudhëz (piccole briciole), drugë (matterello), drinj (buttare), droqe (cavatelli), dru (legna), drudhë (briciola);

v+r: vroka (la forchetta), vrakë (braca), vras (ammazzare), vrëxhill (stomaco dei pennuti), vriç (brecciame), vriskull (fiscolo), vrokëll (cavolfiore), vrërët (nuvoloso), vraketë (cerniera dei pantaloni);

th+r: throni (il treppiede), thrritinj (chiamo);

dh+r: dhria (la vite), dhrom (strada), dhropkë (marcio), dhrosia (cibo);

s+p: spalete (stipite), sparangerë (pianta dell'asparago), spartil (tamerice), spata (la scure), spëllëqun (disperato), spëllonj (pelare), spënduor (speso), spingullë (spilla), spix (ospizio);

s+t: staja (la stalla), stambatë (calcio, pedata), stanuor (stanato), stips (pestello), stupëll (tappo);

z+d: zduqi (il baule), zdënuor (indignato), zdrëlamuor (slabbrato), zdangë (stanga del carro);

s+k: skollë (scuola), skolë (cravatta), skallerë (varietà di cardo selvatico mangereccio), skanexh (mattatoio), skacil (cispa), skumbeçe (scapece), skunxhuor (guastato);

sh+p: shpia (la casa), shporta (il cestino), shprishur (sparso), shpresë (speranza), shpirt (anima);

sh+q: shqelp (calcio), shqep (io scucire) etj. **sh+t:** shtat (sette), shtie (io getto), shtip (io calpesto), shtoj (io aggiungo), shkëndilë (scintilla);

z+b: zbardhinj (imbianco), zbaljonj (sbagliare), zbetë (pallido),

zburthenj (io sbottono); zbrazët (vuoto), zbardhur (sbiancato), zbautirënj (spaventare);

z+g: (i,e,të) *grisur* (strappato), *zgrrip* (bordo), *zgulfat* (persona non di bell'aspetto), *zgleth* (io scelgo);

z+m: *zmanirem* (spazientarsi), *zmaxhënat-e* (mancino-a), (i,e,të) *zmunduor* (scolorito), *zmajun* (ometto), *zmushënë* (perquisizione), *zmëçonj* (sbirciare);

Në këtë idiomë arbëreshe grupet konsonantike realizohen në të gjitha pozicionet e fjalës, por në pozicion nistor dhe mesor janë më të shpeshta, sidomos *konsonant + konsonant*. Megjithatë, leksiku i arbërishtes së Qeftit realizon edhe *konsonant+konsonant+konsonant*, çfarë do të thotë, se edhe *trekonsonantshi* gjallon brenda këtij fjalësi, por denduria e tyre është më pak e shtrirë:

f+sh+t: *mundafsh* (filo di seta);

m+b+j: *mbjell* (seminare);

m+b+r: *mbrum* (impasto, pasta): *Mbrumi i ardhur – Impasto lievitato // Sod hami ca mbrum shpie – Oggi mangiamo un po" di pasta di casa //*;

n+d+r: *çëndruni* (grosso chiodo ripiegato ad angolo retto dal lato della testa, per legare una corda per stendere i panni lavati);

n+g+l: (i,e,të) *nglatur* (allungato);

n+g+r: *ngrohtë* (caldo): *Mbaje ngrohtë – Tienilo in caldo // hëngra* (mangiai);

s+k+j: (i,e,të) *laskjuor* (diradato, sfoltito);

s+t+r: *strepe* (spaccatura di terreno arido e asciutto);

sh+k+r: (i,e,të) *shkretë* (desolato, povero);

sh+p+l: (i,e,të) *shplarë* (risciacquato);

sh+p+r: *shpresë* (speranza), (i,e,të) *shprishur* (sparso) // *Gjaku i shprishur – Il sangue sparso* (espressione usata dagli Arbëreshë per indicare la diaspora albanese);

sh+t+r: (i,e,të) *shtridhënj* (strizzare), *shtrat* (letto);

z+g+r: (i,e,të) *zgrënuor* (affaticato);

z+m+ b: (i,e,të) *zmbuluor* (scoperto) etj.

Summary

THE CONSONANTAL SYSTEM OF THE
ARBËRESH VARIETY OF QEFTI (IT. CHIEUTI)

The consonantal system of the Arbëresh variety of Qefti consists of 33 consonantal phonemes, a salient divergence from the consonantal system of Standard Albanian, which contains 29 phonemes. These 33 consonantal phonemes during fluid speech, in relation to and in a variety of word-internal positions, play a rather productive functional role that yields innovative semantic characteristics.

This situation generates curiosity for further investigation regarding this variety, in particular given the aforementioned lines, when considering only the phonetic system, starting with the formation of the consonantal system and its usage, including its role in all the phonemic segments of this well-preserved variety in a multilingual linguascape in a foreign land for six consecutive centuries.

BIBLIOGRAFIA

- [1] **AA.VV.**, *Alfabetizzazione Arbëreshe*, 2 volumi, Edizione Il Capitello, Torino, 2000.
- [2] **Altimari**, Francesco, *Studi linguistici arbëreshë*, Quanderni di Zjarri, vol.12, San Demetrio Corone, 1988.
- [3] **Altimari**, Francesco, *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Prishtinë, 2002.
- [4] **Altimari**, Francesco, *Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë: Përfaqje diakronike, në Çështje të studimeve diakronike të shqipes (ASHAK)*, Prishtinë, 2010.
- [5] **Badallaj**, Imri, *E folmja e Hasit*, Prishtina, 2001.
- [6] **Badallaj**, Imri, *Çfarë alfabetesh përdorën autorët italo-arbëreshë para Kongresit të Manastirit*, në Letërsia dhe kultura arbëreshe - Jeronim de Rada në 200-vjetorin e lindjes, Elbasan, 2015
- [7] **Badallaj**, Imri, *Sistemi vokalik i të folmes së Kazallveqit*, Jeta Arbëreshe, nr. 80, Eianina (Italia), 2016.
- [8] **Badallaj**, Imri, *Distribucioni i fonemave konsonantike në arbërishten e Kazallveqit*, Jeta Arbëreshe, nr. 81, Eianina (Itali), 2016.
- [9] **Badallaj**, Imri, *Disa dukuri fonetike në arbërishten e Kazallveqit*, Jeta Arbëreshe, nr. 83, Eianina (Italia), 2017.
- [10] **Badallaj**, Imri, *Vrojtime gjuhësore*, Prishtinë, 2017.
- [11] **Badallaj**, Imri, Martin Camaj në këndvështrimin e studimeve italo-arbëreshe, në Studime albanistike në Itali, ASHAK, Prishtinë, 2019.
- [12] **Camaj**, Martin, *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Firenze, 1971.

- [13] **Camaj**, Martin, *Die albanische Mundart von Falcunara Albanese in der Provinzia Cosenza*, München, 1977.
- [14] **Camaj**, Martin, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in Provincia di Potenza*, , 1993.
- [15] **Camarda**, Demetrio, *Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864.
- [16] **Camarda**, Demetrio, *Appendice al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866.
- [17] **Cimochowski**, Waclaw, *Le dialecte di Dushmani*, Poznań, 1951.
- [18] **Cipo**, Kostaq, *Fonetika*, Tiranë, 2003.
- [19] **Çabej**, Eqrem, *Italo-Albanische Studien*, Universität Wien, (Disertacion doktorate), 1933.
- [20] **De Rosa**, Luis, *Elementi di grammatica albanese - arbëreshe del Molise, Rur*, 2005.
- [21] **Dodi**, Anastas, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- [22] **Eric**, Hamp, *La parlata di Vaccarizzo Albanese: premesse fonetiche, në I dialetti italo-albanesi*, Roma, 1994.
- [23] **Figlia**, Niccolò, *Codice Chieutino* – a cura di M.Mandalà, Comune di Mezzojuso, 1995.
- [24] **Fiorilli**, Giuseppe, *Dizionario Arbresh di Ururi*, (Ch), 2002.
- [25] **Fortino**, I. Costante, *Frangjisk Andon Santori, Romanci i tretë: Brisandì, Lletixja e Ulladheni, transkriptimi i tekstit origjinal të pabotuar dhe ndryshimet e redaktimit të parë, me një hyrje dhe një Fjalorth nga I. K. Fortino*, *Stab.Tipografico Biondi*, Cosenza, 1977, pp.225.
- [26] **Fortino** I. Costante, *Giulio Varibobba, La Vita di Maria*, Edizioni Brenner, Cosenza 1984, pp.347.
- [27] **Fortino**, Costante, *Giuseppe Angelo Nociti, Rëment'Arbresha-Albanesi*, a cura di Italo Costante Fortino, Edizioni Brenner, Cosenza, 1992, pp.229.
- [28] **Fortino**, I. Costante, *Osservazioni sull'infinito in albanese. Contributo delle parlate e della letteratura arbëreshe në Problemi di morfologia della lingua albanese. Atti di IV Convegno Internazionale di Studi sulla Lingua Albanese, Fisciano, 1-2 dicembre 1992, a cura di Addolorata Landi Patricia del Puente*, Salerno 1993.
- [29] **Fortino**, I. Costante, *Le Kalimere di Francesco Antonio Santori, - prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza*. - Edizioni Brenner, Cosenza 2004, pp. 363.
- [30] **Giordano**, Agostino, *Shënime mbi të folmet arbëreshe të Ejaninës dhe të Frasnitës*, në *Jeta Arbëreshe*, nr.82, Eianina (Itali), 2016.
- [31] **Giordano**, Emanuele, *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë*, Edizioni Paoline, Bari 1963.
- [32] **Giordano**, Emanuele, *Fjalor*, II edizione, ed. Il Coscile, Castrovillari 2000.
- [33] **Giordano**, Emanuele, *Gramatikë Arbëreshe*, Manduria (Ta), 2005.
- [34] **Hamp**, Eric, *La parlata di Vaccarizzo Albanese, premesse fonetiche, I dialetti italo-albanesi*, Roma, 1944.
- [35] **Ismajli**, Rexhep, *Ndërlidhni kundërvëniesh në sistemin bashkëtingëllor të shqipes*, Përparimi, 1973, 1.

- [36] **Ismajli**, Rexhep, *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes*, Gjurmime albanologjike, SF, VII, 1977, 1978, Prishtinë.
- [37] **Ismajli**, Rexhep, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706) – Hulumtime grafiko-fonologjike*, Prishtinë, 1985.
- [38] **Ismajli**, Rexhep, *Gramatikë e parë e gjuhës shqipe (1710) – Studim, transkriptim dhe fotokopje*, Prishtinë, 1982.
- [39] **Ismajli**, Rexhep, *Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet*, ASHAK, Prishtinë, 2019.
- [40] **Lambertz** Maximilian, *Italo-albanische Dialektstudien, Die albanischen Mundarten in der italienischen Provinzen Compobasso und Foggia (Molise)*, in Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung, (1923-1925).
- [41] **Guzzetta**, Antonino, *La parlata di Piana degli Albanesi, Parte I – Fonologia*, Palermo, 1978.
- [42] **La Piana**, Marco, *Studilinguistici albanesi – Varia, Palermo, 1949*.
- [43] **Leka**, Ferdinand- **Simoni**, Zef, *Fjalor shqip-italisht, Fjalori italisht-shqip*, Tiranë, 1996.
- [44] **Leotti**, Angelo, *Dizionario Albanese-Italiano*, Istituto per l'Europa Orientale, Roma, 1938.
- [45] **Marchiano**, Michele, *Canti popolari Albanesi della Capitanata e del Molise*, Casa Editrice "Apulia", Martina Franca (Ta), 1912.
- [46] **Massaro**, Mario, *Dizionario comparato delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti*, Apricena, 2010
- [47] **Massaro**, Mario - **Badallaj**, Imri, *Chieuti e la sua parlata arbëreshe*, Apricena, 2012.
- [48] **Osmani**, Tomor, *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 2008.
- [49] **Savoia**, L. Mario, *I dialetti albanesi dell'Italia meridionale*, në *Lingua albanese dell'Italia meridionale, Atti del I Convegno di Studi sulla Lingua Albanese*, Fischiano, 5-7 dicembre 1989, Salerno 1991, ff. 53-66.
- [50] **Solano**, Francesco, *La parlata albanese di Firmo*, Quaderni di Zjarri, 1983.
- [51] **Solano**, Francesco, *Le parlate albanese di San Basile e Plataci*, Quaderni di Zjarri, 4, San Demetrio Corone, 1979.
- [52] **Shkurtaçaj**, Gjovalin, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006.
- [53] **Tagliavini**, C., *L'albanese di Dalmazia*, Firenze, 1937.
- [54] **Tagliavini**, C., *Le parlate albanesi di tipo Ghego orientale (Dardania e Maqedonia nordoccidentale)*, Roma, 1942.
- [55] **Topalli**, Kolec, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995. Tiranë, 1996.
- [56] **Topalli**, Kolec, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.
- [57] **Topalli**, Kolec, *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002
- [58] **Topalli**, Kolec, *Fërkimoret e afrikate gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.
- [59] **Topalli**, Kolec, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004
- [60] **Topalli**, Kolec, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
- [61] **Topalli**, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2012.
- [62] **Troubetzkoy**, N. S., *Grundzüge der Phonologie*, Praha, 1939.
- [63] **William**, Ch., *Introduzione alla fonetica pratica*, Roma, 1972.

Kujtim M. Shala, Prishtinë

LULE FRANGU SIPAS ZEF PLLUMIT

I

LETRA E VITIT 1964

Më 20 nëntor 1964, Zef Pllumi i shkruante, nga Shoshi, një *letër* studiuesit Kolë Luka, në të cilën jepte mendimin e tij për studimin në dorëshkrim të Lukës mbi baladën e *Lule Frangut*. Krahas studimit, Pllumi e analizonte vetë e nga fillimi baladën *Lule Frangu* nga perspektiva e kritikës folkloristike dhe të asaj historike, si dhe shënjonte interpretimin e tij mbi këtë baladë. Kështu, *letra* e Pllumit merr të gjitha shenjat e një studimi folkloristik-historik dhe e provon Pllumin si një trashëgimtar të shkollës së etërve që mblodhën dhe që studiuuan Visaret e kombit.

Letra e Pllumit ka 24 faqe, në dorëshkrim, dhe ka ngelur e panjohur për publikun. Nga shënimet, vërejmë se letrën në dorëshkrim para nesh e kishte lexuar edhe Át Aleks Baqli. *Letra* ndodhet në koleksionet e Bibliotekës “Át Gjergj Fishta” të Kuvendit të Shën Françeskut të Gjuhadolit, Shkodër. Është ruajtur në gjendjen që e ka lënë vetë autori dhe, me ndonjë përjashtim, lexohet me lehtësi.

Letra është shkruar në kohën kur Pllumi ishte famullitar i Shoshit, në një epokë kur feja në Shqipëri, nën diktatin e komunistëve, mezi po mbahej, para se të ndalohej plotësisht dhe objektet e shenjta të fesë të rrënoheshin sistematikisht, duke nisur nga viti 1967.

Letra është strukturuar si varg vërejtjesh për studimin që analizon Pllumi, si interpretim i Pllumit për çështje të folklorit e të natyrës historike, të lidhura me folklorin, analizë e varianteve të baladës *Lule Frangu*, kërkim i variantit origjinar të baladës dhe interpretim i përqendruar i saj.

Meqë, „pikat”¹ në të cilat Pllumi nuk është dakord me studimin, trupi i letrës, si dhe shpjegimi i tij lidhen me baladën *Lule Frangu*, është

¹ Zef Pllumi, *Balada e Lule Frangut* (dorëshkrim), 20. XI. 964, Shosh, f. 1.

e udhës që këtu ta marrim të plotë tekstin e baladës, variantin e Palajt, nga vetë Pllumi të cilësuar si “ma i bukuri pa dyshim”.²

Varianti i Palajt, varianti i kënduar nga Marash Nika i Pecaj të Shalës, është varianti që interpreton Pllumi në rrafsh analize tekstore.

Leximi i këtij varianti e hap më tej letrën e Pllumit dhe studimin për *Lule Frangun*, bashkë me pikëpamjet për këngët e kreshnikëve legjendarë. *Balada e Lule Frangut* e Pllumit bëhet një lloj udhëzuesi për t’i lexuar këngët e kreshnikëve legjendarë në tërësi, në radhë të parë me metodën që propozon Pllumi e që ka parasysh shtresëzimet tekstore të këngëve, të lidhura me situatat sociale e historike të ambienteve në të cilët janë kënduar e janë trashëguar ato këngë.

II

LULE FRANGU (Varianti i Palajt)

Lule Frangu

*Lum per tý, o i Lumi Zot,
 Qi s'jem' kënë e Zoti na ká dhânë!
 Kúr ka kénun nji Turk e nji Kaùrr,
 Dikur motit trimat kishin kënë
 Ago Aga Turkut i kí'n thânë,
 Lule Frangu Kaurrit i kí'n thânë;
 Mbrëndë në Shkodër trimat ishin xânë:
 - Ditë e bukur, Ago, ka qillue;
 - A i lodrojm na gjogat e mejdanit?-
 <<Po i ladrojm na gjogat e mejdanit;
 Por un e kam njat vrâçin te mirin,
 Kurrkund shoqin nuk e ká
 Dielli tokës ka'i bjen, qaj rrushullaku!>>
 Paska folun Lula, aj Gog-Llatini:
 - Un e kam njatë gjogun e bardhë,
 Kurrkund shoqin, Ago, nuk i a dij
 As ne Turk, brê trima, as n'Kaùrr,
 Veç n'e pastë aj Gjeto Basho Muji:
 Per nji ditë ktû e n'Vlonë aj m'çon e m'bjen.-
 Sa e rândë fjala Turkut i ka rá:*

² Po aty, ff. 3-4.

<<A e di si bâjm, morè Lule Frangu,
 Se fjala fjalen kurr s'e ka mujtë,
 Por shtaga shtagen e shpata shpaten:
 Si n'mujsh ti Vlonen per nji ditë me e kapë
 Shkue e t'ardhun e n'Shkodër prap me kthye,
 Due me t'falun vashen me gjith djalë,
 Due me t'dhânun vraçin me gjithë shalë,
 Due me t' dhânun mâllin e sarajet
 Tý edhë dugâjët me gjith dojlana t'kojshin!>>
 Dielli n'bâll, tha, Lulit, m'i ká kcyë,
 Edhë n'gjuj trimi kënka çue;
 - Bjere besen, Ago Turku - i ka thá thânë;
 Se per ketë besë, qi jam tue t'a dhânë,
 Per nji ditë un shkue e t'ardhë
 Po s'e kapa un Shkodren e Vlonen,
 Po tý t'kjoftë, brë, vasha me gjith djalë
 Edhë sarajet me gjith dojlana;
 E metehet kû i kam e livadhet,
 T'a kam dhânë gjogatin me gjithë shalë,
 Edhë mue per rrogatâr ti m'paç marrë,
 Si kecan kû t'duesh me m'perdorue,
 Margaç drûsh ti perditë me m'ngarkue!-
 „Hajde mirë, na fjalët kshtû i paçim lânë!”
 Drodh e i tha aj Turku Ago Aga:
 „Por Liatinit besë un nuk i xâ;
 Se ju Gogët nuk dini se shka â besa;
 Veç po thrrasim qetash dy distarë,
 Qi askurnjani fjalve mos me u luejtë,
 N'gurit t'gjallë aj fjalët ka me na i dhênë
 Edhë pëgjjet qetash na po i shndrojm!”
 Gjithsi folne trimat, edhë bâne.
 Fill n'saraj aj Lula kur ka shkue,
 Idhët si helmi trimi, qi po rrin,
 As s'po falet me kurrkënd as s'po pvetet;
 Porsi gjarpni aj tue fishkullue,
 Por me shtagë aj votrën tuj e rrahë;
 Tym per krejet Lula qi po qet.
 Paska qitun vasha e e ka pevetë:
 - Zot, shka ké, more fat, qi rrin idhnueshem?
 E asnji fjalë ti djalit s'po m'i a thue,
 Veç po kqyrë ato ûnat e zjarmit?

Me shka shof un, tý dishka t'ká gjetë,
 Ndo t'ká gjetë, ndo dashka per me t'gjetë,
 Pse un kaq t'idhun tý kurr nuk t'kam pa.
 A t'ká dalë kreshnik tý ne mejdan?
 A t'ká dekun kund ndo 'i mik i mirë?'
 Paska qitun Lula e i ká thânë:
 - Mik i mirë, besa, mue nuk m' ká dekë,
 As m'ka dalë mue baloz në mejdan;
 Fjala fjalës por me Agon sot jam xânë,
 E kam bâ një gabim të rândë;
 Drue se as vorri mbrëndë nuk ka me m'lânë;
 Të kam dhanë, mori vashë, tý me gjith djalë,
 E Kam dhâne gjogatin me gjith shalë,
 E kam dhânun mallin e sarajet
 Edhë dugajët me gjith dojlana,
 Edhë vedin pêng sot e kam lânë,
 Ani Turkut rrogtár un me i u bâ,
 Vlonen e Shkodren po nuk i kapa
 Dritë e n'dritë, per një ditë t'shkue e t'ardhë!
 M'ká pasë thânun Gjeto Basho Muji:
 - N'bejleg fjalësh kúr t'bâjsh me rá nder burra,
 Ruejma kryet; gjuhë-oo! vedit me i thânë! -
 Sot mue fjala pêng po m'a ha kryet.
 Njimënd gjogun Muji m'a ka falë,
 Por ky flatra s'ka qi me flurue! -
 Sá bi sojit vashen m'a kish' pasë.
 - O hejr kjoftë, morë fati i êm i miri,
 Se per ket punë ti s'asht me u ngushtue!.. -
 Prap ká qitun Lula e po i kallxon:
 - Si n'mos mujsha un, t'shkue e t'ardhë,
 Shkodren e Vlonen per një ditë me e kapë,
 Qeto t'tâna prá Turku m'i ka marrë! -
 Paska qitun Vasha e i ka thânë:
 - Ti n'e paç baftin si e ké pasë,
 E n'e paç qat gjogatin të mirin,
 Ti per Turk aspak kryet mos e çáj;
 Nesor mbrama atij gjân i a ké marrë,
 Edhë dugajët me gjith dojlana,
 Gruen e tij per dadë mue m'a ké pru! -
 Sa mirë Lules i paska rá.

I a kthen buken Vasha per me ngrânë,

Ujë me pi me tasin e bilurit,
 Vênë me pi me tasat e florinit.
 Kur ká râ Lula me fjetë,
 Shka ká pritë Vasha me bâm?
 Mirë gjogatin po don me tagjisë;
 N'vënd të elbit grûnë po i nep me ngrânë,
 N'vënd të ujit vênë po i nep me pi.
 T'madhen çudë Vasha qi po bân:
 As s'po han gjogati as s'po pin,
 Veç idhnueshem gjogu qi po m'rrin,
 Me kambë t'para tue çukurmue,
 Aj me sý por tue lotue
 Edhë dhimbshem Ajken po m'a kqyrë,
 Kryet per gjoks tuj i a ferkue,
 Me qerpikë aj tue ligjrue.
 Qaty vasha sá fort âsht ngûshtue;
 Por me pûnë kishte qillue
 Ajo mesa e Gjeto Bashe Mujit.
 Kur ka bâ hana me rá,
 N'prerof t'kullës vasha paska dalë
 Edhë Zânen po m'a ndjellë:
 - Pa ndigjo, ti, moj Zâna e malit
 E ju sa jeni Shtojzorrjeshta,
 Ktyne mâjeve kû po rrini,
 N'paçi sý ju per me pá,
 N'paçi veshë ju per me ndie,
 Kurr mâ ngusht vedin s'e dij.
 Neser mbrâma robinë kanë me m'marrë
 Me shi podet e podrumevet,
 Me dhambë pishen Turkut me i a mbajtë;
 Neper burgje si robinë aj me m'shkrrye
 Anì mesen e Gjeto Bashe Mujit...?
 Anì motren e Zukut bajraktar...?
 Po kû mâ zi se kshtû, morì ti, Zanë?!
 As nuk kam se kujë t'i kjahem:
 A t'i kjahem nânës, qi m'ka dhânë,
 A t'i kjahem Zotit, qi m'ka falë?! -
 I a kanë mrrijtë tri Zâna t'idhuna
 Si shpë malit per qiell tue flurue:
 - Po ç'a kshtû, brë Ajkë, tý Zoti t'vraftë? -
 Zâna e madhe ka qitë e po i bertet:

- Tý me Zukun Shkjét të kanë rrethue,
 Po ti m'ké lá gunat e pergjakuna.
 Anì me gjak t'Mujit e t'Halilit,
 Por qeshtû na kurr tý s't'kemi páam! -
 Ka nisë Vasha me u ankue,
 Gjithsi pûnen Zânavet u a kallxon:
 Mbet e i tha ajo Zâna mâ e madhe,
 N'zbunim doren mbi krah tuj i a v'ndue:
 - Paj per hater t'ând veç, mori Ajkë,
 Se jé mesa e kuja jé,
 E njetij Mujit, të v'shtirit e trimit,
 Jé ti motra e atij Zukut, të mirit,
 Se na Gogve kurr s'u kem' ndimue;
 Voter t'dijtun kta nuk kanë;
 Qeraxhi kualsh kta Zoti i ka falë;
 As s'dijn besë, as s'kanë trevezë;
 Kta mirë n'bâr shoqi-shoqit i thonë,
 Me karvane kah po ênden
 Me goditë drume e podrume,
 Me goditë shpija e saraje...
 Burrë Llatî t'kam thâne, çik-oo, mos merr,
 Se kta luftavet nuk luftojn;
 Kta bejlegjevet u pritojn;
 Kurrkund burrave s'u aviten;
 Kta nder trima gjithmonë koriten;
 N'ta mâ i miri, çoban me shtjerra.
 Por jé mesa e Gjeto Basho Mujit
 E na tý sot do t'ndimojm.
 I a kam dhânë një ditë besen e Zotit,
 Fé e martesë kur t'bâjë Zuku me t'i qitë,
 Sá t'a kesh manatin gjallë,
 Tý si motres n' ditë t' ngushtë na me t'u gjetë! -
 - Amanet, mori Zana e malit, -
 Ka qitë vasha edhë i ka thânë:
 - Se un per t'tâna qeto fjalë nuk jam.
 Na fejhena, kû t'na fejojn;
 Na martohena, kû t'na martojn:
 Tatë e vllá p'r atâ Zoti i ka dhânë;
 E un mâ ngúsht vedin si sot kurr s'e dij:
 Me m'ngafisë mâ mirë, se me u koritë!
 Shtâng me m' ba, mori Zâna, u kjosha true!

Po a me koritë Gjeto Basho Mujin-a?
 Po a me koritë Zukun vllán t'ëm të mirin-a?
 Kurgjâ e keqe, mori Zâna, nuk u gjên,
 Edhë 'i qyqe prëndverës pse t'i shtoni,
 Qi t'këndojë kjo degë e n'degë:
 Qyqe u bâna, por s't'korita, morë vllá! -
 Dhimbët te Zoti Zânës i paska rá:
 - Nesor mbrâma, pá marrë dielli,
 Shndosh e mirë un te shpija t'a kam pru!
 Prîna te burgu! - Zâna i ká thânë.
 Kur kanë rá nder ato burgjet e errta,
 Drita e hânës aty kish pasë rá;
 Jânë zditë burgjet si me rá dielli;
 E kanë gjetë gjogatin tue lotue,
 E kanë gjetë gjogatin tue lotue,
 E kanë gjetë gjogatin tue çukurmue;
 Krejt tagjin me lot e kishte lagë,
 Vênë e ujë per tokë m'i kishte derdhë;
 Shpejt e shpejt qerpikët aj po m'i rrahë,
 Me rênd Zânat gjogu po m'i kqyrë,
 Per trup t'tyne âmbel tu' u ferkue.
 Sá fort Zânave i u ka dhimbët;
 Te tri Zanat i u kanë afrue:
 - Po pse kshtû, gjogu, ti me bâ? -
 Me dorë kreshten po i a lmojn,
 Me bár malit po e ferkojn,
 Po i a lmojn kopitat e kâmbvet,
 E i a lmojn ato peshqit e shpinës,
 Edhë gashtat e gliqet e gjûjvet.
 Ato lmo, e gjogu tue hingllue,
 Toje toje shtati i u ká bâ.
 Mbet e i tha aty Zâna mâ e madhja;
 - Kah të shkojsh, more gjog, e kah të vijsh,
 Gjithkund paran rrugës un kam me t'pri,
 Un per qiellë e ti për tokë,
 Shndosh te shpija Lulen kem' me e prû! -
 Edhe tjetër Zânat nuk janë pá.

Ka nisë drita bjeshkve me ague.
 Qatë-herë Vasha Lulen e ká çue;
 Veshë e mbathë âsht trimi e perdorue;
 Edhë n' armë aj tu' u shtrengue,
 - Me një ânderr, po i thotë, qi kam pá,
 Shêj i mirë, thâm, per mue ka me kënë:
 N' burg gjogatin Zânat tue m'a lmue,
 Me fjalë t'âmbra tuj e zbunue,
 Me bâr t'bjeshkvet tuj e ferkue;
 Si zog malit, i thojshin, kem' me t'bâ,
 Shkue e t'ardhun, kah t'u biejsht ti fushavet,
 Kurrkush dý herë me sý tÿ nuk t'ká pá! -
 Aspak Vasha nuk po flet.
 Âsht nisë trimi per me shkue,
 Hopa djalin e ka marrë,
 - Lamtumirë - edhë i ká thanë:
 - Udhë e mbarë! - Vasha i ká pergjegjë.
 Vrap të madh gjogatit i ka dhânë;
 Tym e mjegull gjogun e ka bâm.
 Kur po e ndalë gjogun te lumi,
 Me një pup lumin m'a kcen;
 Kur po e ndalë gjogun te kroni,
 Aspak ujë gjogu s'po pin.
 - Zot, o i Lumi, - pveten gjindja,
 Kush u rá qytetevet,
 Kush u rá katundevet,
 - A thue kje baloz prej detit,
 - A por kje ky aj drangoni i bjeshkve,
 - N'shpinë kulshedres tuj u lkë,
 - Ky qi Zânen per brî gjithkund e paská
 - E dý herë me sý kurrkush s'e paká? -
 Aspak Zânen Lula nuk po e shef.
 Kur ká mrrÿjtë te ato fushat e Vlonës,
 Edhë Vlonës per kundruell i ka dalë,
 Ma' ká pvetë një çoban me dele:
 - Mirë n'bâr, morë çoban! - m'i ka thânë.
 <<Mirë se vjen, Lule Frangu>> i ká pergjegjë.
 - Vetë nuk jam aj Lule Frang Kaÿrri;
 A s'm'a shef mitanin maxharrisht?
 Shalë e frë a s'i njef ti maxharrisht? -
 Paska qitë çobani e i ká thânë:

- Tjetër gûna e tjetër Lule Frangu!
 Pse kollaj tÿ âsht per me t'njoftë:
 Kurrkund shoqin ti per dokë nuk e ké;
 As balozi gjogun t'and s'e ká;
 Ti edhë kraholin gogisht m'a paské:
 Paj ndo dielli tokës sot s'i ká rá,
 Ndo je vetë ti Lule Frang Kaùrri! -
 Aty t' madhe Lula paska qeshë.
 - A ká ditë mâ, morè çobani me dele? -
 <<Si, a ká ditë? - çobani i a ka dredhë;
 Kqyre diellin, tre pash pa prëndue,
 As mjesdita thâm edhë s'a' bâ!>>
 Sá mire Lules fjala m'i ká rá:
 Doren e shtite n' at xhepin e jeleku,
 Plot me rrushpe çobanit i a ká dhânë;
 Per mjesditë aj n'Vlonë tek paska hîm;
 Shpejt e shpejt parin aj m'a ká thirrë;
 Gjithsi pûnen u a kallxon,
 Edhù vulat u a kerkon:
 Shtatë copë mhyre Lules i paskan dhânë;
 Edhë permbrapa Lula atë-herë âsht dredhë.

* * *

Ça kish' bam aj Turku, Ago Aga:
 S'e pret diellin me prëndue;
 Por ká dalë aj n'bedën t'kalás.
 Edhë sÿnin fushave po í a lshon:
 As kurrgjá me sÿ s'po shef.
 Sá me gaz pûnen e ka marrë:
 - Tybe n'Zotin, dielli pa prëndue
 Tri dit rresht, aj Shkodren nuk e kapë! -
 Fill te Vasha kênka nisë me shkue
 E te dera ngûtshem i ka thânë:
 - Çilma burgun, atin per me e shtî,
 Se un tÿ sande bullë kam ardhë me t'bâ
 O, mori e mesa e Gjeto Basho Mujit!
 Per djalë t'êm tÿ Zuku t'kishte dhânë,
 Kjo nderë sande cok nuk pat me t'gjetë! -
 Sa burrisht kjo Vasha po i pergjegjë:
 <<Kurrkujë Ago, „ké dekë” s'âsht me i thânë>>

Pa i ndie gjâmen, se po e mblojn me dhé.
 Se njajo ushtimë, qi po ndihet per tokë
 E kto mâje qi po kersasin,
 Per mbas gjasve Lula ka me kënë,
 E aj kaurreshë t'y vashen t'a ka bam.>>
 Mujshem Turku aty mbet e i tha:
 - Po ky s'âsht, morè, Gjeto Basho Muji,
 Gjithkund gati Zânat qi po i rrijn,
 Se me tajët e Lumnís aj ka qillue;
 Po ktij i thonë, moj bí, Lule Gog Llatini! -
 Edhè shkallve po don me i u ngjitë.
 Kur qe Zâna po pingron prej shkâmbit:
 - Po kû ve, morè Turku i Perëndis,
 Se qatij qi po ka pûnë me né,
 N'êmen t'Zotit gjithshka mujë me i kënë! -
 Fill mbas Zânet ati tue hingllue:
 Maje atit Lula tue këndue.
 Kqyr shka priti Turku atë-herë me bâm;
 N'mjedis t'oborrit gjûjve i paska râm,
 Edhè Lulen n' dy gjûj po m'a pret.
 Idhshem Lula qaty i paska thânë:
 - Tybe n'Zotin, sot nuk jam tue t'falë!
 A í din fjalët, brè Turk, na sí í kemi pasë?
 Kúr t'prëndojë aj hylli i çobanit,
 N'agshol t'dritës të dy na me u fillue;
 E un gjith ditën sot t'kam lypë,
 Tash per tokë e tash per qiellë,
 Shkue e t'ardhë, por kurrkund nuk t'kam ndeshë.
 Tybe n'Zotin, me Turk s'e flliga,
 Por tanë copash qetâsh due me t'bâ,
 Edhè qejvet Turkun me i a qitë! -
 Vring, prej millit shpaten m'a ka xierrë.
 Ndermjjet Vasha sa shpejt u ka hî:
 - Per jetë t'ânde, Zot-oo, ndale doren!
 Mbrenda deret aj tash na ka hî,
 Edhè gjûjvet u ka rá!
 Per qên hekurash mâ mirë âsht me e bâm,
 Se 'i fjalë t'keqe djalit me i a lanë!
 Bâni e ndieu aj Gjeto Bashe Muji,
 Se mbrenda oborrit Agon e kem' pré,
 Kur dy gjûjvet u ká rá,

Me gjith djalë sarajat na i ká djegë;
 Vritet Turku, por kanuja s'vritet! -
 Sá mire vedin Lula e ka ndalë:
 - I kjoftë falë, tha, Gjeto Basho Mujit!
 Qeraxhi mbas kualsh un kam me t'ba. -
 Po i rrin gati ajo Zana e malit:
 <<Gruen fisnike lum njaj, qi po e ká,
 Se ajo fjalën t'a ka lânë ndo djalin!>>³

III TIPOLOGJIA E VARIANTET

Që në hyrje të *Balada e Lule Frangut*, duke marrë për bazë strukturën dhe ritmin e vargut, Pllumi shënjon e saktëson se *Lule Frangu* është këngë lahute ose *sharkie* e çiftelie, saktësim që do të kapërcejë keqkuptimin që këtë këngë e skajon si *tërthorçe* apo *majekrahu*. Pllumi e gjen vargun e *Lule Frangu* më të shtrirë sesa atë të këngëve tërthorçe ose majekrahu, vargu i të cilave është i shkurtër dhe kap më së shumti gjashtë rrokje. Në tipologjinë e tillë, Pllumi e gjen si këngë lahute variantin e Palajt, ndërsa lahute apo dhe çiftelie atë të Haxhihasanit, varinate të cilave u referohet studimi i Lukës.

Vetë Pllumi nënvizon e shpjegon:

Në hymjen fq. 4 thohet: “Në qandër të katër varjanteve të para shqiptare, që janë kangë tërthorçe ase majekrahçe”, për sa diç un, këto nuk janë kangë tërthorçe e majekrahçe, por janë kangë lahutet, ose sharkut e edhe çiftelijet: varjanti i Palajt është lahutet, ndërsa i Haxhihasanit në daç lahutet në daç çiftelijet: kët e nxjerr prej ritmit e metrit. Kangët tërthorçe ose majekrahit janë shumë të shkurta: gjatë me shkue deri në 6 vargje. P.sh. kemi kangen historike “Shtatë Shaljanët kan rá në Shtoj”, që këndohet me çifteli, por kemi të njajtin argument që këndohet tërthorçe ose majekrahi dhe është: “Shala lidhi besen - Se n'Saraj do t'desin - Pi-pá!” dhe s'ka vargje tjera. Prandej mendoj ato fjalë në tekst të studimit tand “kangë tërthorçe ase majekrahçe” të ndërrohen me kangë lahutet ose sharkut.⁴

³ A. Bernardin Palaj OFM, *Lule Frangu*, në *Hylli i Dritës*, nr. 4-5 (Prill-Máj), Shkodër, 1943, ff. 179-188.

⁴ Zef Pllumi, *Balada e Lule Frangut*, ff.1-2.

Kështu, struktura dhe ritmi i vargut e shënjojnë edhe gjininë e variantit të caktuar të baladës, meqë variantet e ngjashme tematikisht, kanë strukturë e ritëm të ndryshëm. Kjo tipologji ka për bazë *rrafshin formal* (Zherar Zhenet) të tekstit, ndërsa ky është një nga rrafshet e përhershme letrare që e përcaktojnë gjininë e veprës letrare.

Vërtet, duhet të bëjmë dhe një saktësim tjetër, meqë Pllumi ndjek e numëron rrokje vargjesh, ndërsa duhet të kemi parasysh se variantet e kunduara të këngëve të kreshnikëve legjendarë nuk janë në varg silabik, por në varg izometrik. Ky saktësim lë të kuptohet se origjinarisht këngët kreshnike janë kënduar me lahutë, ndërsa variantet e kënduara me sharki ose me çifteli janë më të reja apo shumë më të reja. Në këtë kuptim, varianti i Palajt i *Lule Frangut* duket të jetë më afër variantit origjinar, meqë është këngë lahute, me varg e ritëm të përcaktuar nga *morat* e nga *këmbët*, ndërsa ky sistem vargëzimi është edhe shenjë vjetërsie e shenjë identitare e këngëve.

Kemi mendimin se tipologjizimi që i bën Pllumi *Lule Frangut* është i provuar jo vetëm nga vargu i kësaj vepre, por edhe nga vargu i këngëve të kreshnikëve legjendarë në përgjithësi. Vërtet, tipologjia e tillë është e dosmosdoshme për analizën e epikës legjendare shqiptare e duket që edhe të varianteve kalorsiake, një tipologji që provon identitetin e vjetër (paraturk) të këtyre këngëve, meqë vargu i vjetër i tyre është është ruajtur edhe kur u janë shtuar shtresëzime të reja varianteve origjinare të tyre.

* * *

Çështja e varianteve është thelbësore për tekstet orale, në mënyrë të veçantë për këngët e kreshnikëve legjendarë dhe për baladat, meqë variantet, përmjet konstantave, na çojnë drejt ribërjes së variantit origjinar, ndërsa varianti origjinar është edhe një çështje identitare. Te rasti i baladës *Lule Frangu* Pllumi ka parasysh variantet shqiptare të saj, të gjitha të Veriut dhe të arbëreshe, të cilat i ka studiuar Luka në dorëshkrimin që i kishte dërguar Pllumit. Siç nënvizon Pllumi, Luka mendon që variantet arbëreshe janë më të shkurtra e më të reduktuara, meqë, për gjatë shekujve kanë humbur pjesë të tekstit, ndërsa Pllumi e kundërshton këtë pikëpamje, meqë ka mendimin se pikërisht këto variante nuk kanë humbur asgjë, krahasuar me varianteve shqiptare që kanë shtuar përbërës e janë zgjeruar shekujve. Kështu, Pllumi shënjon se variantet arbëreshe janë më afër variantit origjinar. Po ashtu, ai nënvizon mungesën e varianteve jugore të baladës, që si rregull janë shumë më të shkurtër sesa ata të Veriut, ekzistenca e të cilëve do të

ndihmonte për heqjen e shtresave personale e politike, të provuara nga Pllumi në variantet shqiptar, në radhë të parë në variantin e Palajt.

Pikëpamja e Pllumit për variantet arbëreshe si të plota është interesante dhe rri përballë traditës që kërkonte copat e humbura të rapsodive arbëreshe. Pllumi pretendon se ambienti arbëresh nuk ka imponuar shtesat politike të varianteve shqiptare, të bëra për t'iu pështatur pushtuesit.

IV FRANGU E TURKU

Lule Frangu e Ago Aga Turku janë kundërshtarët e emërtuar nw atë mënyrë që të shënjojnë përkatësi e identitet. Frangu e Turku janë më shumë se emërtime personazhesh, meqë shënjojnë dallime religjioze e etnike: Frangu, i krishteri, dhe Turku, myslimani. Kështu, duke ndjekur interpretimin e Pllumit, Frangu është heroi i vjetër e i përthershëm i baladës, ndërsa Turku është shtuar pas pushtimit osman të tokave tona. Vërtet, duke evidentuar shenjat e moralitetit të sjelljes e të përballjes ndërmjet Frangut e Turkut, del se përballja nuk është e natyrës religjioze, por morale, ndërsa moraliteti është shenjë identifikimi e familjes që njeh nderin si kod të jetës, shenjë identifikimi e fisit dhe e vendit (ambientit), pastaj bëhet përkatësi klase, e kjo çon te përkatësia politike, prandaj edhe te përkatësia etnike.

Por, pse Frangu?

Pse kjo baladë ka këtë hero, kur veprat orale legjendare shqipe kanë heronj e personazhe të tjera, Mujin, Halilin, Zukun, Ajkunën, Tanushën, Gjergj Elez Alinë?

Pse kjo baladë nuk lidhet me ciklin e këngëve të kreshnikëve legjendarë?

Pse ngjarja e saj ka topos-e arbërore/shqiptare, Shkodër e Vlorë?

Pse të këndohet në trevat shqiptare e arbëreshë?

Këto janë çështjet që duhet t'i rimarrim bashkë me Pllumin, në diskurin e tij që, duke kërkuar origjinaren e të trashëguarën, kërkon identitaren e baladës.

Protagonistit ju ruejt emni dhe origjina posë në varjantin e Krajes, që edhe ai, tue ja veshë Mujit një fat të tillë, tregon për lashtësin legjendare të baladës. Lule Frangu është protagonist i njaj kange sonë gjatë gjith okupacionit turk: kjo është çudija ma e madhe. Për të mos i ra ndesh okupatorit 500 vjeçar na si popull kemi ndrrue dhe konceptet fetare e shoqnore, e bashkë me to kemi ndrrue ose kemi veshë ala turka

edhe herojt e kangve tona legjendare. Edhe n'ato vise ku nuk u muer feja e okupatorit u ndrruen herojt për të mos u ra në sy të keq; kështu kemi tanë çiklin e Mujit e të Halilit a por edhe protagonistët tjerë të Baladave tona që paraqiten turq: turq-shqiptarë merret vesh. Ne kemi varjant tonin Lule Frangun [...] kurr nuk paraqitet si sllav o shkjá. Në varjantet e Palaj e [...], si nga teksti ashtu konteksti ruhet kjarhtë origjina e protagonistit si i huej e jo shqiptar, por llatí, ndërsa të Haxhihasani e te Ivanaj na del Lule Frangu kaurr shqiptar, që merr hisen në Pazar të Shkodrës. Këtu ndër kto dy varjante është pshtjellue me dashje o pa dashje, gjatë kohëve nocjoni frang: frang në perandorin turke për një kohë të gjatë është kenë sinonim i katolik, mbasi me firman të Sulltanit Perandorija frange mprote të drejtat e tyne deri në mbarim të shek XIX, edhe kështu me anë të baladës sonë tentohet me u spjegue gjendja atëherë aktuale e qytetit të Shkodrës:

Për gjithë dugajat edhe sot i kan
me t'kshtenë turqit n'pazar.

Pra, merita kryesore e varjanteve tona asht se kan ruejtë protagonistin me emen e origjinë dhe antagonistin turk Osman. Por tipi kalorsjak i gunës e i shpatës u zevendsue gjatë shekujsh me tipa kalorsjakë feudalë e me feudalë orjentalë; që pllakosen me shekuj truëllin tonë. Shenjat e kjarta të ktij feudalizmi janë: djali, që i shtohet vashës; djali simbol i trashëgimis së një vendi; mandej vijn me rend kulla e saraje, metehe e livadhe, dugajë e mullij, bile deri gjemí në det e dojlanat e permenduna të Shkodrës. Pra balada vjen tue ndjekë proçeset e ktij populli, prej kalorsís së thjeshtë, në kalorsí feudale, në feudalizëm turk orjental, në feudo-qytetar, e deri në imprezarë-tregtarë të shekujve të fundit. Natyrisht gjatë këtyre proçeseve antagonistit turk (mbasi ky antagonist këtu ndër ne ishte zot shpije) vjen e i hiqet edhe marrja peng e vashës, mbasi fanatizmi familjar-shoqnor nuk do t'a lejote kurr një gjá të tillë e kështu ai - si kumbarët modern - ven peng tanë pasunín, por jo gruen. - Pra mbas mendimit tem të gjitha enumeracionet e varjanteve të truëllit tonë janë të shtueme gjatë shekujsh. Vjen prej vedit se tue i shtue këto enumeracione kushtit fillestar, është e logjikshme të mendojmë për të shtueme edhe ato të konkluzionit të baladës. Kët tezë ma e perforcon si varjanti i Palajt, si ai i Krajës që e mbyllin kangen pa konkluzion të logjikshëm, pse sidomos i pari, nuk kishin si t'a këndoijn një gjá të tillë gjatë okupacionit turk se frang-kaurri ja fitoi nusen turkut, prandej tëkurren. E kjo pikërisht është edhe arsyeja kryesore që varjantet tjera kan hjekë që në

fillim të baladës nga pengu i kushtit vashën e antagonistit turk e vû një tok enumeracionesh në vend të sajë e mandej si rrjedhim konkluzionin politik të tyne: që edhe sot i kan dugajët bashkë të kshtenët e turqit në Pazar; pse na e dijm historikisht se nuk âsht kenë Lush Frangu i pari i tanë kaurrave (të kshtenve) të Shkodrës, por edèt kan dashtë të përlijjen në rasë se i bjen keq okupatorit turk.⁵

V

AJKA

Ajka, siç Pllumi argumenton, është personazhi i shpikur i baladës *Lule Frangu*, një *ndërrhyrje personale* e këngëtarit, me qëllim që të krijojë lidhjen (artificiale) me këngët e ciklit të Mujit e të Halitit. Ajka shënjohe si mbesa e Gjeto Basho Mujit e motra e Zukut Bajraktar, por në ciklin e njohur nuk ka një personazh të tillë, prandaj lidhja e baladës *Lule Frangu* me ciklin e kreshnikëve legjendarë është *krijuar* a posteriori.

Këtë Pllumi e provon me analizën e tekstit në rrafshin historik e krahasues dhe e forcon me të dhënën se Át Bernardin Palaj e njihte dhe e kishte mbledhur e fiksuar këtë baladë, por nuk e përfshiu në ciklin e Mujit e të Halilit të *Visaret e Kombit* (1937). Pllumi mendon se lidhjen me ciklin e kreshnikëve legjendarë do ta ketë shpikur rapsodi Marash Nika i Pecaj të Shalës, variantin e të cilit e kishte marrë Palaj, me qëllim që baladës t'i japë ndërliqësinë e një kënge kreshnike legjendare, gjë që përkethehet edhe në përkatësi identitare të baladës.

Ndërrhyrjet e tilla, në trajtë shpikjeje e shtimi të përbërësve tekstorë, janë tipike për tekstet orale, meqë ato mbahen mend e trashëgohen, ndërsa, duke u trashëguar në trajtë orale, edhe ndryshohen. Pllumi mendon se *Lule Frangu*, ashtu si edhe këngët e ciklit të Mujit e të Halilit, është ndryshuar në vartësi të kohëve e të situatave sociale/politike. Këngët legjendare u krijuan kur afër trojeve tona të vjetra ishin afuar sllavët, kur trojet që i ruajnë nuk ishin pushtuar, ndërsa kur pushtimi ndodhi, këngëtarët situatat e këngëve ua përshtaten situatave të epokës së tyre. E gjithë kjo shpjegohet si një metodë për të mbrojtur thelbin e këngës, për edhe vetë këngëtarin që nuk duhej të cënonte në asnjë mënyrë pushtetin e pushtuesit. Këtë metodë e provojnë qoftë edhe vetë emrat e kreshnikëve legjendarë dhe të personazheve të tjera të ciklit të tillë, si: Gjeto Basho Muji, Halili, Zuku Bajraktar, Ajkuna, Krajli, Gjergj Elez Alija etj. Ashtu siç janë shtresëzuar tekstet

⁵ Po aty, ff. 12-14.

e këngëve, ashtu janë shtresëzuar apo janë ndryshuar emrat e personazheve të këngëve.

Ajka, mbesa e Mujit, është gruaja e Lule Frangut. Këtu Pllumi vëren *ndërrhyrjen personale* të këngëtarit dhe sugjeron ta konsiderojmë si një *lidhje artificiale*, madje pretendon se edhe Palaj do ta ketë vërejtur se lidhja ishte artificiale dhe se për këtë shkak baladën nuk e konsideronte pjesë të cikilit të Mujit e të Halilit, edhe pse vetë Palaj donte të gjente *Iliadën* e harruar orale të shqiptarëve dhe ta ribënte duke lidhur rapsoditë që i kërkonte paprerë.

Vetë Pllumi nënvizon se Ajka është veshur me vetitë morale të një ambienti kanunor, gjë që e dëshmon *veprimi* i saj, kur e kupton *kushtin* e të shoqit me turkun Ago Aga dhe njeh trishtimin e tij, sepse i mungon shpresa se do ta përmbushë atë që ka thënë, si dhe fakti se kur Lule Frangu do ta vrasë turkun brenda oborrit të vet, Ajka ia kujton se Kanuni nuk e lejon, meqë armiku në derën e tyre është një mik, ndërsa këtë normë, siç Pllumi thotë, Kanuni nuk e njihte para shekullit XIX, d.m.th. para atij shekulli Kanuni nuk e konsideronte armikun mik në asnjë rrethanë. Kjo është shtesë personale e Marash Nikës, burrë kanuni e urtie, siç Pllumi e di dhe siç dëshmon për ne. Po ashtu, varianti tjetër i mbledhur në Shalë, vëren Pllumi, nuk i përmban shtresat e variantit të kënduar nga Marash Nika.

Ajka e variantit të Palajt është gruaja që pranon fatin e saj, burrin si fat të mirë dhe bën çdo gjë që burri i saj të ruajë burrninë e tipit kanunor. Ajo duket si një malësore e rrëfimeve ambientale, e diskursit kanunor, veti me të cilat e vesh këngëtari. Kjo zbulon teknikën e këndimit të këngëve të tilla si teknikë krijimi, meqë këngëtari *shton personalisht*, d.m.th. krijon sipas mendësisë, moralitetit e sipas situatave të epokës së tij.

Po kur shtesat janë artificiale, si kjo e rastit të Ajkës së shpallur motër e Gjeto Basho Mujit?

Në rastet e tilla teksti duhet të interpretohet përtej shtesave të tilla që të tentohet varianti origjinar i tekstit. Kjo është një punë shumë e vështirë, meqë kemi të bëjme me tekste orale të ruajtura pa u fiksuar/shkruar ndër shekuj, prandaj të ndryshuara ndër shekuj.

Pllumi dëshmon e interpreton:

Ky Marash Nika është kenë një ndër burrat e kanunit ma të permendun në Dukagjin: alá sot përmendet emni i tij për të mirë “si Marash Nika i Pecaj” në parí të Shalës, me urtí, me dije kanunit e jetet e tjera virtute që i kerkote vendi e koha për me kenë i dalluem. Tue pasë para syshë këto, shofim se në varjantin e kënduem prej tij, ai ka shti dhe

vulosë noten personale të veten. E dijm se Palaj ishte i interesuem kryekreje për kangët e kreshnikve legjendarë të çiklit të Mujit e të Halilit, pse mendote dhe u perpiqte t'a qesë popullin tonë me një "Iljadë" Shqiptare, dhe keto kangë ja u kerkote me ngulm rapsodve të atëhershem. Marash Nika, që i ka dhanë edhe tjera t'atij çikli, shifet se pro fas et nefas mundohet me e lidhë me anë të parantezës edhe Lule Frangun me Gjeto Basho Mujin, por Palajt nuk ja mbushte dot mendjen, dhe megjithë bukurin që ka kanga, nuk e shtjen ndër Kangët e Kreshnikve të Vizareve të Kombit, megjithse e kishte mbledhë shumë e shumë vjet perpara, pse e shifte të kuartë se lidhja ishte artifiçjale. Prandej Ajkën, Gjeto Basho-Mujin, Zukun në Baladën e Lule Frangut mund t'i konsiderojmë si shtesë personale të një edi kalibrit të madh si Marash Nika i Pecaj. - Nji dyshim të vogël rreth ksajë pike m'a ngjallë një rapsod i Toplanës, të cillit kur ja këndova pak kangen me tha se kishte ndie se ka pasë Lule Frangu motren e Mujit a një sebeb por kangen nuk e dihte: por ky dyshim erdh tue m'u largue mbasi ky rapsodi asht kenë mik i ngushtë i Palaj e prendej mund t'i ket ra rasa me ndie ndoshta shí Marash Niken tue ja këndue Bernardin Palajt. Varjanti tjetër i mbledhun në Shalë nuk i permban keto personazhe të çiklit të Mujit.⁶

VI

KËNGA KALORSIAKE

Ideja e një varianti origjinar është thelbësore, meqë na çon te statusi identitar i *Lule Frangut*. Pllumi mendon se, kur largohen *shtesat* sociale e historike, d.m.th. politike, e *shtesat personale* të këngëtarëve, *Lule Frangu* del një baladë kalorsiake. Varianti origjinar, kalorsiak, është paraturk, gjykon Pllumi. Ndërsa, shtesat politike janë bërë gjatë sundimit turk, përgjatë shekujsh, derisa kënga ka arritur te ne me shtesa të shekujve politikë, me shtesa personale dhe me shtesa artificiale të këngëtarëve.

Lule Frangu një baladë kalorsiake, është propozimi thelbësor i Pllumit në aventurën e tij të kërkimit të variantit origjinar, pa shtesat e varianteve shqiptare e pa mungesat e presupozuara të varianteve arbëreshe, të cilat ai e pranon se ekzistojnë. Vërtet, Pllumi kështu skajon gjini, baladë kalorsiake, dhe kohë, meqë gjinitë janë kategori historike.

⁶ Po aty, ff. 4-6.

Në këtë pikë, kërkimi historik i Pllumit e gjen edhe një mbështetje thelbësore. Balada kalorsiake, si përcaktim gjinor, është edhe përcaktim tematik, ndërsa kalorsiakja, si kategori tematike, është edhe një kategori morale: përballjet bëhen për nderin personal të kalorësit, për nderin e urdhrit kalorsiak, apo për nderin e damës. Balada *Lule Frangu* origjinarisht lidhej me nderin personal të Frangut, pastaj, përgjatë shekujsh, u kthye në përballje nderi e Frangut me Turkun.

Tue perjashtue këto shtesa, kerkojm shtjellimin-tip. - Dy kalorsë, njani turk e tjetri frang, lidhen në kusht se kush e ka kalin ma të mirë edhe venë peng vashat e veta. Vrapimi bahet mrenda një dite në një fushë të gjanë. Vasha e protagonistit trishtohet dhe tue i pergatitë grazhdin kalit i ban premtimet ma të mdhát. Vrapimi perfundon me fitimin e Frangut që merr pengun. - Ky duket të jet kenë argumenti i vertetë i baladës në Kohen paraturke. Les chavalier de cape et d'épée posë damave të veta e kalin me shalë s'kishin çka të vejshin tjetër peng: prandej këtu kemi të bajmë me një baladë thjeshtë kalorsjake.⁷

Kalorsiakja e variantit origjinar të *Lule Frangut*, në rrafshet e moralitetit e të sjelljes së personazheve, siç e reflekton edhe diskursi, duket edhe në variantin e Palajt, por ky variant e kryqëzon, madje e mbulon kalorsiaken me moralitetin kanunor shqiptar. Kalorsiakja është variacion i sjelljes fisnike; sjellja kanunore përcaktohet nga moraliteti, prandaj fisnike është, kështu që kemi të bëjmë me dy variante të fisnikërisë. Ndërsa, kjo kategori, e thurur si tematikë, e bën baladën *Lule Frangu* një *vepër reprezentative* (Zhenet), *këngë të veprimeve*, gjini që në oralitetin tonë më së thelli përfaqësohet nga Kângët kreshnike, në të cilat veprimet i takojnë heroikes fantastike (legjendare), e cila ka ruajtur natyrën e saj, meqë këto këngë, deri në shekullin XX, janë ruajtur e trashëguar vetëm në versionin oral, pa u fiksuar si tekst i shkruar. Heroikja fantastike e Kângëve kreshnike apo veprimet fantastike të baladës *Lule Frangu* janë shenja vjetërsie, prandaj edhe shenja identitare. Edhe Pllumi, përmjet kritikës historike dhe shënjjimit të variantit origjinar paraturk, vetëdije identitare manifeston.

⁷ Po aty, ff.12-13.

VII SHËNIM

Kritika e Pllumit, e dhënë në trajtë sugjerimi për Kolë Lukën, është e natyrës folkloristike e historike, ndërsa këto, së bashku, na çojnë në rrafshin e gjerë të etnografisë, të një kritike etnografike. Pllumi e lexon studimin e Lukës bashkë me tekstin e baladës *Lule Frangu*, ndërsa kritika e tij determinohet nga pikëpamjet e Lukës,⁸ e përqendruar dhe e artikuluar fort në pikat e kritikës folkloristike e të sprovimit historik.

Studimi i Lukës është sistematik dhe problemin e shtron me durim e nga disa anë, si analizë e si krahasim, në shembullin e një kërkimi etnografik formal, i cili ndjek funksionet e tekstit, më parë se interpretimin. Në këtë nyjë duket të jenë ndarë më së thelli studimi i Lukës e Pllumi, i cili, si një nxënës i klasikës shqiptare, rrafshin formal të baladës e redukton te metri e te ritmi i vargut.

Sprovë për një shqyrtim etnografik-folklorik të baladës së Lule Frangut e Kolë Lukës është botuar 10 vjet pas letrës së Pllumit, ndërsa duket të jetë një variant i pwrpunaur i studimit që Luka i kishte dhënë Pllumit më 1964. Vërejmë se teksti i botuar i Lukës nuk e shtron fare çështjen e tipologjisë së baladës, të cilën Pllumi e shtronte si kritikë të parë në letrën e tij, ndërsa nuk vërejmë që Luka të ketë hequr dorë nga idetë dhe pikëpamjet themelore të tij lidhur me variantet,⁹ shtesat e reduktimet e tyre, madje as lidhur me origjinën tematike të baladës së *Lule Frangut*.

Studimi i Lukës është i vyer lidhur me baladën, por edhe për nga metoda; i çliruar nga ideologjia e studimit socrealist të folklorit, i shkruar, siç Pllumi thotë me "*preftsín e nji doctor subtilis*",¹⁰ i lakuar nëpër shtjellimin-tip që ndjek skena, topikë e vargje stereotipe të *motërzimeve* e *gjinikimeve*; shpjegimin e emrit, të origjinës e të funksionit të protagonistit Lule Frangu; kontrastet në botëkuptime brenda baladës; motërzimin e Krajës, si të ndryshëm nga *motërzimet* e *gjinikimet* e tjera; topografia dhe klasifikimi; si dhe balada në diakroni dhe kërkimi i një prototipi të saj, si kulm e si qëllim final i studimit.

⁸ Shih Kolë Luka, *Sprovë për një shqyrtim etnografik-folklorik të baladës së Lule Frangut*, në *Etnografia shqiptare V*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, 1974, ff. 79-129.

Teksti i studimit shtrihet nga faqja 179 deri te faqja 115, ndërsa nga faqja 115 deri në faqen 129 ka një rezymë në gjuhën frënge.

⁹ Luka flet për *motërzime* (variante) shqiptare e *gjinikime* (afiliacione) arbëreshe.

¹⁰ Zef Pllumi, *Balada e Lule Frangut*, f. 1.

Leximi i *Balda e Lule Frangut* të Pllumit krahas studimit të Lukës bën që Letra të duket edhe si një studim alternativ i baladës *Lule Frangu*, studim i lidhur në disa nyja thelbësore të tekstit të baladës, variantit të Palajt,¹¹ më të gjatit, prandaj më të pasurit, si dhe më të bukurit në rrafshin letrar.

Prishtinë, 2020

BIBLIOGRAFIA

1.

- Zef Pllumi: *Balada e Lule Frangut* (dorëshkrim), Shosh, 20. XI. 964

2.

- Kolë Luka, *Sprovë për një shqyrtim etnografik-folklorik të baladës së Lule Frangut*, në *Etnografia shqiptare V*, Tiranë, 1974, ff. 79-129

3.

- Át Bernardin Palaj OFM: *Lule Frangu*, në *Hylli i Dritës*, nr. 4-5 (Prill-Máj), Shkodër, 1943, ff. 179-188

- Át Bernardin Palaj OFM, At Donat Kurti OFM, *Kângë kreshnikësh dhe legenda*, *Visaret e Kombit*, Vëllimi II, Prishtinë, 1996

- Át Shtjefën Gjeçovi OFM: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 2010

4.

- *Çështje të romanit*, Prishtinë, 1980

- Zherar Zhenet: *Figura*, Prishtinë, 1985

- Gjergj Zheji: *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Prishtinë, 1990

¹¹ Luka, në vazhdimësi, e quan motërzimi i *Hyllit të Dritës*, duke shmatur nënvizimin e emrit të Palajt.

ADDENDUM

Zef Pllumi

Balada e lule frangut¹

*I dashtuni Kolë,
pata marrë një studim tandin prej 70 fq. mbi Baladën e Lule
Frangut e m'a njite gripin edhe mue.*

*Studimi ásht i çmueshem dhe mund t'a krahasoj me një projektor,
që, me një shllungë rrezesh të fuqishme, perpiqet të hetojë në errsinen e
shekujve origjinen e kangeve tona legjendare; ai ásht i punuem imtë,
me preftsín e një doctor subtilis, megjithkëta un këtu po shprehi
mendimet e vrejjet e mija, si për ndonji [...] ² që ka mujtë të depertojë,
si edhe ma tepër ndër disa pika të randsishme të kritikës folkloristike e
historike.*

*Tue ndjekë studimin faqe për faqe, pa u ndalë ndër lavdatet e
meritueme, po rreshtoj vetem pikat ku nuk jam dakord.*

*Në hymjen fq. 4 thohet: “Në qandër të katër varjanteve të para
shqiptare, që janë kangë terthorçe ase majekrahçe”, për sa dij un, këto
nuk janë kangë terthorçe e majekrahçe, por janë kangë lahutet, ose
sharkut e edhe çiftelijet: varjanti i Palajt ásht lahutet, ndersa i
Haxhihasanit në daç lahutet në daç çiftelijet: kët e nxjerr prej ritmit e
metrit. Kangët terthorçe ose majekrahit janë shum të shkurta: gjatë me
shkue deri në 6 vargje. P.sh. kemi kangen historike “Shtatë Shaljanët
kan rá në Shtoj”, që kendohet me çifteli, por kemi të njajtin argument
që kendohet therthorçe ose majekrahi dhe ásht: “Shala lidhi besen - Se
n'Saraj do t'desin - Pi-pá!” dhe s'ka vargje tjera. Prandej mendoj ato
fjalë në tekst të studimit tand “kangë terthorçe ase majekrahçe” të
ndrrohen me kangë lahutet ose sharkut.*

* * *

¹ Këtu po japim letrën e Pllumit, të traskriptuar dhe të përgatitur për botim. Të tillë, për herë të parë, e kemi botuar te revista *Hylli i Dritës*, nr. 2, korrik-dhjetor, Shkodër, 2020, ff. 232-240.

² Me [...] kemi shënjuar vendet në të cilat dorëshkrimi është i palexueshëm, si dhe ndonjë mungesë të supozuar të tekstit.

Në shtjellimin, sidomos nder fq. 7-8 e edhe ma vonë gjatë studimit tand, paraqitet mendimi sikur varjantet arbreshe kan humbë landë rrugës, ndersa varjantet tona janë ma të ruejtuna, pse kan topikë e enumeracione - un mendoj se ma të ruejtuna janë varjantet arbreshe: elementet kryesorë nuk u mungojn, po themi, në kurrnjisend, vetem se ato pasë para sysh se origjina e arbreshve, në pjesën ma të madhe është prej jugu të Shqypnis: toske: Folklori toskë përgjithsisht na jep kangë të shkurta dhe koncize, perkundra folklori i verit na jep kangë të gjata: edhe veriu ndryshon mes vedit: folklori i Malsís së Madhe është ma i shkurtë se i Dukagjinit i cilli preferon ma tepër prolisitet.

Por para se të vazhdoj pikpamjet e mija mi shtjellimin, po báj analizen teme të varjanteve tona shqiptare.

I. Varjanti i Palajt:

Si letersi, gershetim e paraqitje ma i bukuri pa dyshim. E këndoi Marash Nika i Pecaj të Shalës. Ky Marash Nika është kenë një ndër burrat e kanunit ma të permendun në Dukagjin: alá sot përmendet emni i tij për të mirë “si Marash Nika i Pecaj” në pari të Shalës, me urtí, me dije kanunit e jetet e tjera virtute që i kerkote vendi e koha për me kenë i dalluem. Tue pasë para syshë këto, shofim se në varjantin e kënduem prej tij, ai ka shti dhe vulosë noten personale të veten. E dijm se Palaj ishte i interesuem kryekreje për kangët e kreshnikve legjendarë të çiklit të Mujit e të Halilit, pse mendote dhe u perpiqte t’a qesë popullin tonë me një “Iljadë” Shqiptare, dhe keto kangë ja u kerkote me ngulm rapsodve të atëhershëm. Marash Nika, që i ka dhanë edhe tjera t’atij çikli, shifet se pro fas et nefas mundohet me e lidhë me anë të parantezës edhe Lule Frangun me Gjeto Basho Mujin, por Palajt nuk ja mbushte dot mendjen, dhe megjithë bukurin që ka kanga, nuk e shtjen ndër Kangët e Kreshnikve të Vizareve të Kombit, megjithse e kishte mbledhë shum e shum vjet perpara, pse e shifte të kjartë se lidhja ishte artifiçjale. Prandej Ajkën, Gjeto Basho-Mujin, Zukun në Baladën e Lule Frangut mund t’i konsiderojmë si shtesë personale të një edi kalibrit të madh si Marash Nika i Pecaj. - Një dyshim të vogel rreth ksajë pike m’a ngjallë një rapsod i Toplanës, të cillit kur ja këndova pak kangen me tha se kishte ndie se ka pasë Lule Frangu motren e Mujit a një sebeb por kangen nuk e dihte: por ky dyshim erdh tue m’u largue mbasi ky rapsodi asht kenë mik i ngushtë i Palaj e prendej mund t’i ket ra rasa me ndie ndoshta shí Marash Niken tue ja këndue Bernardin Palajt. Varjanti

tjeter i mbledhun në Shalë nuk i permban keto personazhe të çiklit të Mujit.

Posë këtyne kemi sentencat e Kanunit, të cillat Marash Nika, për t'u tregue Burrë Kanunit si ishte, i shtjen pa spontanitet në Baladën tonë, si nuk është zakon ndër kangët tjera të Kreshnikve, as historike as ndër balada p.sh.

- n. 23 se fjala fjalen kurr s'e ka mujtë
- 24 por shtaga shtagen e shpata shpaten
- 80 Më ka pasë thanë Gj. B. Muja,
- 82 Ruejma kryet gjuhë-oo!, vedit me i thënë!-
- 258 - Tjeter guna e Lule Frangu (filani)
- 295 Kurrkujë Ago, ké dekë" s'është me i thënë
- 296 Pa i ndie gjâmen, se po e mblojn me dhé.
- 338 Vritet turku por kanuja s'rritete

e krejt konkluzjoni që njerr mbrapa është fjalë urtijet

Gruen fisnike etj.

* * *

Tashti tue pa kuartë qellimet personale të edit fillojm analizen e kangës tue bâ perjashtimin nga elementë të shtuem, posë atyne vargjeve që i permendem nji herë e s'po i persrisim:

- n. 18 - Veç n'e pastë ai Gjeto B. Muji

ket varg edi e shtjen për të mujtë me e lidhë Baladën me çiklin e Mujit, por nuk ja ka gjetë rasen ende.

Turku Ago Aga ven i pari peng vashen me gjithë djalë: e Lule Frangu burrë llatí duhet me e pranue kushtin e e ven edhe ai vashen e vet. Edhe kështu vazhdon zhvillimi i ngjarjes me Vashen anonyme, si ndër varjantet tjera, deri te skena e grazhdit. Aty edi gjenë rasen e favorshme për t'a shti baladën në çiklin e Mujit dhe vashen deri atëherë anonyme e quen Ajkë vetem mbas gadi 120 vargjesh, mandej vazhdon

për ma se 100 vargje tjera tue huazue nga skena të njiillojta të kangve tjera të Keshnikve legjendarë, e nganjherë tue harrue se Muji paraqitet pergjithsisht ndër rapsodi tona porsit turk-shqiptar, pra si Ago Aga, antagonisti i Lule Frangut të Baladës sonë kundra të cillit Muja kurr nuk do t'i kishte ndihmue nji të huaje, çfardo lidhjesh krushqnie që të kishte pasë, pse nuk do t'a lejote ndjesija fisnore (o lidhje e gjakut si t'i thomi) aqë mbujtun e e zhvillueme e e naltueme ndër kangët e kreshnike legjendare, pse ishte koncept i tanë popujve e kohve deri tash vonë e s'di bile a ka ndrrue ende. Nji meritë por ka Marash Nika i Pecaj se gjatë gjithë këtij digresjoni nuk harron kurr se Lule Frangu asht burrë llatí, gogë o maxhar, por jo shkja (n. 243: Ty me Zuken shkjet të kan rrethue - i thotë Ajkës Zana).

Mandej - si gjykoj un - këtu e këndej, për ndërhyrje të edit personalisht, që të plotsojë dishirin e mbledhsit Palaj, në rasë se Palaj vetë nuk e ka prekë, por duket se jo se do t'i kishin ra në sy këto inkoherenca të permbrendshme të kangës, Balada merr skena e vargje nga "Martesa e Halilit" etj. dhe devijon gjatë e gjatë rrugën e thjeshtë të veten deri në konkluzionin e pa konkluzion.

Edhe skenën e mikut të prëm mbrenda derës s'oborrit Marash Nika e ka konceptue simbas ndryshimeve ma të vonshme të Kanunit. Dihet sigurisht se Kanuni deri në shek. XIX nuk e njehte për mik atë që të vjen në shpi si armik; për kët bajn dishmi konceptet e Kanunit mbi Krahina tjera jashtë Dukagjinit, e mund të konsultojsh edhe nji artikull të Palaj në Hylli Dritës Vj. 1943 Nr. 9-12 fq. 352, megjithse ndoshta auktori mundohet të provojë nji tezë tjetër.

Nji tjetër kontradiktë e mbrendshme e ktij varjanti, që mund të ja atribuojmë edit Marash Nikës, është ndër vargjet 291-293. Po si në fillim Ago Aga ven peng vashen e vet me djalë, e këtu i lakmon Ajkës për ré? Vasha është nuse e re, pse grueja kur t'i bahet djali për martesë thirret baxhi e jo vashë.

Tue perjashtue këto elementë të krijueme aty për aty prej edit, balada na jet e thjeshtë, si është rrejtë e zhvillue gjatë shekujsh në truall të Dukagjinit, dhe atëherë del se ka afinitet ma teper se çdo varjant tjetër me varjantet abreshe, pse kemi kushtin të vumë prej dyve, megjithse në ket turku nuk merr pjesë në vrapim si do të shofim ma vonë.

II. Q. Haxhihasani:

po e marr këtë varjant për tana tjerat mbasi është ma i bukri e ma i randsishmi posë atij të Palajt. Në këtë edi i Gajushit mund të ketë ndërhy te mielli i Selanikut pse i ka pelqye. Në rasë se ke shoqni e të folun me Q. Haxhihasanin, të lutem thirre në vedi e pvote me ma të madhen konfidencë a thue me të vërtetë e ka ndigjue njetë shprehjen “mir bārë”? Jam shum kurjoz me e dijtë, mbasi un vetë jam prej Malsís Madhe dhe nuk më ka ra me e ndië në popull: sot perdoret “Kulloso e mirë”. Megjithse këtu ban me dyshue a thue mbledhsi vetë ka nderhy me ndonji rresht që bjen tekstualisht si te Palaj, tue kenë këto varjante të krahinave të ndryshme.

Sidoqikjoftë ky varjant shifet se ka gjatsín e metrit o ritmit të baladave tona si Ago Ymeri etj. Muhabeti i Mejhaneve që fillon si në ket si n'at të Ivanajt, mendoj se është kallzue nga jeta e perditshme e vendeve ku është kendue: janë kenë të famshme mejhanet e Koplikut e të Kastratit, ku ka vlue kapadailleku, megjithse nuk perjashtohet që edhe në Kohen e herojve të baladës sonë duhet t'i kenë pasë mejhanet e veta.

* * *

Tue perjashtue këto shtesa, kerkojm shtjellimin-tip. - Dy kalorsë, njani turk e tjetri frang, lidhen në kusht se kush e ka kalin ma të mirë edhe venë peng vashat e veta. Vrapimi bahet mrenda një dite në një fushë të gjanë. Vasha e protagonistit trishtohet dhe tue i pergatitë grazhdin kalit i ban premtimet ma të mdhát. Vrapimi perfundon me fitimin e Frangut që merr pengun. - Ky duket të jet kenë argumenti i vertetë i baladës në Kohen paraturke. Les chavalier de cape et d'épée posë damave të veta e kalin me shalë s'kishin çka të vejshin tjetër peng: prandej këtu kemi të bajmë me një baladë thjeshtë kalorsjake.

Tash, tue u nisë te ajo statuja e mermerit të bardhë që paraqet në fillim të studimit, po analizoj mbas gjykimit tem proçeset që kan bâ stinët e shekujt mbí të:

Në varjantet arbëreshe:

Është harrue emni i herojit, mbasi nuk duhet të jet kenë kurr arbresh, por tue kenë se të shkretët arbresh në truell të huej kan pasë shum telashe prej frangve prandej urrejtja që kan pasë për ta s'i ka lanë t'a lajn protagonist fam-mirë të një kange së vet.

Ka humbë edhe nocjoni gjeografik: lugadhrit të madh prej 900 radesh, mbasi është rrujtë në truall të huej.

Kan humbë edhe dishmitarët e gjykatsit e kësaj mendje.

Unë për vedi nuk mendoj se varjantet arbreshe kan humbë rrugës tjetër gja. Himnizimi që përshkon një pjesë të varjanteve të tyne, është kenë i natyrshëm i kohës kalorsjake. Kështu varjantet e tyne mbesin tip në shtjellimin e vet.

Varjantet shqiptar:

Mjerisht janë të gjitha të veriut të Shqipnís; sikur të kishem edhe ndonji prej anës së jugut do të na ndriçote shumë më tepër.

Tash të shofim si u rrujten e u zhvilluen këto këtu ndër ne:

Protagonistit ju rrujt emni dhe origjina posë në varjantin e Krajes, që edhe ai, tue ja veshë Mujit një fat të tillë, tregon për lashtësin legjendare të baladës. Lule Frangu është protagonist i njëj kange sonë gjatë gjith okupacionit turk: kjo është çudija ma e madhe. Për të mos i ra ndesh okupatorit 500 vjeçar na si popull kemi ndrrue dhe konceptet fetare e shoqnore, e bashkë me to kemi ndrrue ose kemi veshë ala turka edhe herojt e kangve tona legjendare. Edhe n'ato vise ku nuk u muer feja e okupatorit u ndrruen herojt për të mos u ra në sy të keq; kështu kemi tanë çiklin e Mujit e të Halilit a por edhe protagonistët tjerë të Baladave tona që paraqiten turq: turq-shqiptarë merret vesh. Ne kemi varjant tonin Lule Frangun [...] kurr nuk paraqitet si sllav o shkjá. Në varjantet e Palaj e [...], si nga teksti ashtu konteksti ruhet kjarhtë origjina e protagonistit si i huej e jo shqiptar, por llatí, ndërsa të Haxhihasani e te Ivanaj na del Lule Frangu kaurr shqiptar, që merr hisen në Pazar të Shkodrës. Këtu ndër kto dy varjante është pshtjellue me dashje o pa dashje, gjatë kohëve nocjoni frang: frang në perandorin turke për një kohë të gjatë është kenë sinonim i katolik, mbasi me firman të Sulltanit Perandorija frange mprote të drejtat e tyne deri në mbarim të shek XIX, edhe kështu me anë të baladës sonë tentohet me u spjegue gjendja atëherë aktuale e qytetit të Shkodrës:

*Për gjith dugajat edhe sot i kan
me t'kshtenë turqit n'pazar.*

Pra, merita kryesore e varjanteve tona asht se kan rrujtë protagonistin me emen e origjinë dhe antagonistin turk Osman. Por tipi kalorsjak i gunës e i shpatës u zevendsue gjatë shekujsh me tipa kalorsjakë feudalë e me feudalë orjentalë; që pllakosen me shekuj

truellin tonë. Shenjat e kjarra të ktij feudalizmi janë: djali, që i shtohet vashës; djali simbol i trashëgimis së një vendi; mandej vijn me rend kulla e saraje, metehë e livadhe, dugajë e mullij, bile deri gjemí në det e dojlanat e permenduna të Shkodrës. Pra balada vjen tue ndjekë proceset e ktij populli, prej kalorsís së thjeshtë, në kalorsí feudale, në feudalizëm turk orjental, në feudo-qytetar, e deri në imprezarë-tregtarë të shekujve të fundit. Natyrisht gjatë këtyre proceseve antagonistit turk (mbasi ky antagonist këtu ndër ne ishte zot shpije) vjen e i hiqet edhe marrja peng e vashës, mbasi fanatizmi familjar-shoqnor nuk do t'a lejote kurr një gjá të tillë e kështu ai - si kumbarët modern - ven peng tanë pasunín, por jo gruen. - Pra mbas mendimit tem të gjitha enumeracionet e varjanteve të truellit tonë janë të shtueme gjatë shekujsh. Vjen prej vedit se tue i shtue këto enumeracione kushtit fillestar, ásh e logjikshme të mendojmë për të shtueme edhe ato të konkluzionit të baladës. Kët tezë ma e perforcon si varjanti i Palajt, si ai i Krajës që e mbyllin kangen pa konkluzion të logjikshëm, pse sidomos i pari, nuk kishin si t'a këndoyn një gjá të tillë gjatë okupacionit turk se frang-kaurri ja fitoi nusen turkut, prandej tëkurren. E kjo pikërisht ásh edhe arsyeja kryesore që varjantet tjera kan hjekë që në fillim të baladës nga pengu i kushtit vashën e antagonistit turk e vû një tok enumeracionesh në vend të sajë e mandej si rrjedhim konkluzionin politik të tyne: që edhe sot i kan dugajët bashkë të kshtenët e turqit në Pazar; pse na e dijm historikisht se nuk ásh kenë Lush Frangu i pari i tanë kaurrave (të kshtenve) të Shkodrës, por edët kan dashtë të përlligjen në rasë se i bjen keq okupatorit turk.

Skena e grazhdit ásh - si kushti - element i ruejtun mirë ndër tana varjantet, megjithse ndonji inovacion që mund të jet ba ma vonë, por fort ma e bukur e poetike paraqitet në varjantet arbreshë, ku e bukura deri kolonat e veta ja premtan kalit për fré, mjaft që ta pështojë pa u bâ robinë e turkut; edh ásh ma afër sensit kavaleresk, pse ndersa ndër varjantet tona Vasha i premtan vetem gjá për bark, atje e bukura i premtan takame të bukura, të cillat aq fort kishin randsí në kohën kalorsjake e për ma tepër - simbas psikologjis shtasore - kalit po i pelqyekan për së fortit, njilloj si njerit rrobet e mira.

Digresioni i Baladës ndër të gjitha varjantet o te Kulla në Shkodër ose e Bukura në Jerivol, lanë me kuptue identitetin e baladës, por me dy zhvillime të ndryshme që ja imponuen shekujt: njanji - ma gjenuin - ruen lirizmin e damës kalorsjake dhe tjetri zhvillon dramen e sajë të imponueme edhe nga pabesít e degjenerimi moral i feudalizmit orjental me të cillin u veshen e u frymzuen varjantet tona.

Takimi i çobanve dhe marrja e vulave që nuk janë rrujt ndër arbreshë, un i konsideroj si mbeturina që të kujtojnë dishmitarët e patrinët e këtij dueli original ose kushti, sikurse e lypshin rregullat kalorsjale.

* * *

Të gjitha keto zhveshje duhet të ja bajmë baladës sonë, jo për të dalë përdhuni te hipoteza që ti parashtron në fq. 72 të studimit tand, por pse na e imponojnë varjantet paraturke të arbreshëve si dhe kritika historike e ajo folkloristike.

I vetmi koc, për t'u brejtë i vështirë, në skeletin e kësaj balade na jet teatri i veprimt Shkodër-Vlonë. Nuk kemi si t'a mohojmë historinë e sundimit të frankve me veshjen Anzhuine në Vlonë, as influencën e tyre në Shkodër në kohën e sundimit të Nemanjave, mbasi nana e Uroshit kishte për nderë të mbiquhej "Regina Helena Franciae"; nga kjo rrjedh që një baladë shqiptare të pranojë si protagonist një frang, por me anë tjetër prezencë e turkut në truëllin tonë, n'at kohë, si e paraqet balada, është antihistorike: turku n'at kohë ishte larg nesh, përtej Bizancit. Kalorsit e kryqtarët freng kishin punë me të atje e njëti, kalojshin nëpër ket truëll për t'u ndeshë me të, por këtu nuk u perpoqen. Nga vjen pra turku këtu "në Shkodër mbrendë" si thotë balada? Duhet të jet e vertetë çka thue në studimin tand fq. 51 se "ka edhe mjaft raste tjera kur jokulatorët [...] e kangve të gjesteve thonë se kanë marrë kangët në viset e Ballkanit" por m'anë tjetër pranoj me rezervë frazën e fq. 52 "Hyn prandej n'at Cycle de la gageure, që nuk është çudi që vetë frangët t'a kenë huazue në viset e Ballkanit" aq me tepër frazën tjetër fq. 53-54 "po thomi se Balada është një krijim i truëllit tonë, ka pa dritën e sajë në truëllin tonë, me sa duket në truëll qytetar". Por a mund të jet edhe ndryshe? A përjashtohet mundësia se Balada jonë është relike e ndonji kange së humbun të frangve t'asajë kohe, që për nocionet e pakta gjeografike që kishin e venë turkun në Shkodër, a por në ndonji qytet tjetër që na ndër varjantet e Baladës sonë e kemi shndrrue me Shkodër? Si ndryshe mund të spjegohet fati i mirë i një protagonistit të huej, i një heroji të huej - Lul - Florian - Frang, në një baladë që të jet krijim i yni? Æsht e logjikshme që sikur n'originë t'ishte kenë baladë e jona, edhe protagonistit duhet t'ishte i yni. Un e dij se kjo është sinteza e tanë hipotezës që ti i pari sinjalizon në fq. 72; me shigjeten që u ven shek. XI-XII don të bajsh [...] tjerët që t'a thonë, por un mendoj se është ma mirë që t'a thuesh ti i pari e atëherë tjerët të hedhin valle.

* * *

Kaq e jo ma shum kishem për të thënë rreth Lulit.

Tue kqyrë një notë të studimit mbi pushken habertare, u binda se si Lambertzi kishte pasë folë aq pak. Çka ishte pushka habertare. Ne e dijm se ishte sheji i alarmit. Por tue kenë se tana krismet e pushkve nuk ishin alarmit pse njerzit qitshin në punë të vet kurdo që t'u ndollte rasa, të vjetrit kishin në perdorim një rod pushke, e cilla kishte krismen shumë më të madhe se pushkët e zakonshme që perdoreshin për qitje, në mënyrë që ushtima e sajë të ndihej larg fort e t'u kuptote se është për alarm. Ishte një rod topi i cilli përbahej nga një gyp i gjatë 2-3 police me një trashsi metalike 4-5 mm, me një gjatësi gypit afër 60 cm o aty pari; mbrenë u shtite baroti mandej u mbushte me shtupa të ndryshme, të cillat u rrahshin mbrenda gypit me një qyski si ato të shtesave të [...]; në njanen anë kishte një birë nëpër të cillen ndezej baroti e kshtu nepte një ushtimë sa topi i ramazanit që edhe ai është kenë pushkë habertare; për qitje nuk mund u perdorshin. Një ksi topi deri në vj. 1926 ishte kenë edhe te Kisha e Shoshit qi në çdo rasë me i dhanë haber fisit për ndonji kushtrim e në shendelek u shprazte me [...] vetëm një herë në vjetë natën e Kshnellave në mjesnatë. Kur kan râ lumjanët e Ahmet Begut në Dukagjin duket se e kan marrë me vedi me e përdorë për top ramazanit.

* * *

Po kthej edhe një herë te Luli - dhe çka më duket argumenti i ksajë balade nuk ka të bajë as me ata bajloz të detit që kerkojshin me shti në sundim ndoj vend në ket tokë, as me ato chenaliers që kerkojshin me shti [...] këtu, mbasi as nuk kan punë këtu as partitudo, as sapientia, as prudentia, as verecundia askurnji virtyt veç fatit - fort kollaj që heret n' origjinë të jet kenë vetem një kangë [...] o aty pari për t'u këndue ndë dasma o ksi sojit: por s'ka randsí kjo.

Tash nuk po të shkruiej ma gjatë se me gjasë do të jesh merzitë me shkrimin e bukur temin, por tanë fajin e ke ti vetë që me shtine edhe mue në ket pyllë. Në rasë se boton gjâ të lutem shumë më kujto me ndonji kopje për të cillen t'a dijshim për nderë, njashtu si t'a dij edhe për manuskript po i tham (megjithse asht shkruie në makinë) të shkrimit tand, të cillin po e ndali ketu, deri të më bajsh za me t'a dergue; un net e gjata të dimnit i kaloj vetem me lexim, që nuk asht shok aq i mirë sa shoku, mbasi muhabetin duhet me ja ndigjue, por s'të len me folë.

* * *

Pamvarsisht nga mendimet e mija që të shpreha në ket letër, uroj që të marr prej teje sa ma parë një gjâ të botueme e të fala me mallë.

Shosh, 20 - XI - 964.

Ali Aliu, Prishtinë

PORTRETE

Libri “Si e kam njohur”, i Mustafa Nanos një zhanër miks që të ndërmend portretet e Plutarkut e biografitë e romanizuara të Cvajgut

Kam përcjellë, mbase shumicën e monologjeve provokuese të të martave dhe premtëve televizive të Muçit, që, në përditshmërinë kulturore dhe politike shqiptare, shfaqin një tjetër figurë, një tjetër faqe të Nanos. Paraqitjet e tij në debatet mediatike, përballë kolegëve dhe të figurave politike a profileve nga fusha të ndryshme, janë më pasionante në mbrojtjen e parimeve, bindjet e veta. I ashpër, sidomos ndaj tifozërimeve, barrikadimeve, fanatizmave... ‘Provokacia’ e tij përshfaq një Muç tolerant, që mirëpret çdo mendim, besim, bindje ndryshe, pa atë pasionin që ka përballë bashkëdebatuesëve në emisione të kolegëve të tij... Sa herë kam kohë, ia dëgjoj monologjet dhe, jo se pajtohem gjithnjë e pa asnjë vërejtje, por kurrë nuk më pengojnë, falë argumentimit dhe çiltërsisë maksimale.... Thjesht, si në një ambient dhe mjedis të qytetëruar, normal.

Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana përditë e më shumë po merr fizionominë e një metropoli evropian, dhe, si i tillë, përgatitet të pranojë, të mirëpresë dukuri, sjellje, shfaqje, pikanteri dhe personazhe sidomos që janë në natyrën, në frymën e qendrave të mëdha. Mëtimi i tij urban, i Tiranës, sikur ka nevojë për veçanti me prirje të pangjashme më parë, të cilat i absorbon natyrshëm. Edhe për një zë publik, për një krijues e publicist që, në atmosferën e një debati, t’i thotë kryeministrit apo presidentit pse nuk jep dorëheqje, një shoëman-i, një këngëtareje etj... pse ka prioritet të parë, jo përsosmërinë e profesionit por atë të laku-riqësimit të trupit, zë që shpërthen ulëritje kundër mendjeve që kontaminojnë atmosferën, nga të gjitha perspektivat dhe statuset publike dhe, gjithnjë duke hulumtuar forma dhe alternativa të reja komunikimi, sa sokratiane dhe monologëve të dialogizuar, platoniane, sa të eseistit dhe romancierit, sa të provokuesit dhe polemistit dhe replikuesit, sa me portretet “Si e kam njohur” në frymën e Plutarkut antik, disa nga të cilët janë zhbiruar maestralisht...Pse? Nevojë për të tërhequr vëmendjen e

ambientit, të kohës së vet me patjetër, apo trysni e brendshme për të artikulluar një trazim revolte, një klithje që kërkon hapësirë, apo një kërshtëri zhbiruese që mëton përtej limiteve, që nuk mundet të mos jetë i pranishëm? Nuk e përballon dot anonimitetin? Nuk mund të mos u bëjë jehonë kërcënimeve që i parandjen, kurdisjen e minave për të nesërmen e sotme shqiptare? Mos vdes për të qenë në top listën e ngjarjeve?

Mund të nisemi nga cilido kënd dhe ta gjejmë pjesërisht paretin e Muçit, por të gjitha ngasjet e zëna në gojë, mund të përfshihen nga më shumë perspektiva... Në frymën e rrjedhës së lumit heraklitian, që zëvendëson veten e ndryshuar pa këputje, përfton në përditshmërinë kulturore, mediatike edhe autori, aktori, personazhi Mustafa Nano është në një kërkim të pareshtur, duke përfutur sa në një hapësirë mediatike, skenike, letrare, sa në përballje me besimtarë, sa me debate filozofike, metafizike, identitare, politike, etike dhe estetike.

Trokitja e tij e pareshtur në dyert e pahapura për njeriun, njerëzimin në fshehtësitë e universit metafizik dhe uniersit njeri, vjen, si të thuash nga të gjitha anët. Kategori të pa rrokura nga mendja dhe imagjinata e njeriut, e sidomos, fshehtësitë e parrokshme deri në ndriçim që do ta kënaqte njeriun me veten...ashtu siç ka qënë tundim dhe vuajtje e mendjeve më të ndritura të njerëzimit: *"...njeriu, ashtu siç ka murin e padepërtueshëm përballë universit dhe Zotit, e ka edhe përballë mëtimin për njohjen e vetes..."*, thotë Montenji, i cili ka qënë i bindur se njeriu i ka të kufizuar dhe të limituar sensorët, që do të ndriçonin terrin e mistereve. Sipas tij, sikur ai, njeriu, në vend të pesë shqisave, të kishte tetë ose dhjetë, mbase do të kishte zgjidhur më shumë enigma, si Zoti, hapësira, koha, e sidomos enigmën njeri... As shkenca, as gjenitë e artit letrar (Homer, Dante, Shekspir), nuk kanë qënë imun nga tundim-vuajtja e limiteve dhe pafuqisë së njeriut për të depërtuar shikimin përtej... Kjo e tundon pambarimisht Mustafa Nanon, në të gjitha shkrimet e tij, imagjinative dhe publicistike, në esetë, përsiatjet dhe monologjet skenike, televizive, i tillë në debatet e shpeshta të tribunave mediatike, i tillë në replikimet dhe polemikat, siç e përmenda më lart... Jo rastësisht atij i bëri aq përshtypje një tundim çasti I Papës aktual të Vatikanit nëse ka apo s'ka jetë të përtejme, të cilën ia pat' besuar një miku të tij të shquar gjithashtu, nga takimi sy më sy... Mos vallë i përvidhet ndonjë rebelim-tundimi të brendshëm edhe Muç atëistit të thekur? Ani se ai, gjatë debateve, sidomos përballë të ftuarve në studion e vet, që në fillim, ua tërheq vëmendjen për ateizmin e vet kur ofron për temë diskutimi besimin në Zot... Fundja edhe Ajshtajni, gjatë një

pyetjeje të gazetarit, se mos vallë është mistik, ai i përgjigjet: natyrisht, meqë nuk mund të di se çfarë ka në hapësirë, jam mistik...

Këto dhe caqe të tjera të pamundshme synon kërshtëria, përherë e trazuar e Muçit, jo vetëm në rrëfimin romanor. Në librin e tij *“Si e kam njohur”*, ku shquhet diskursi eseistik, ai përqendron vëmendjen tek tundimet tokësore të njeriut, siç është edhe ai përballë pushtetit. Në botën shqiptare sot, por jo vetëm në atë shqiptare, tundimi i parë i politikë bërjes, i politikanëve dhe pushtetarëve është ai për pushtet që sjellin mirëqenie, begati pa fund... Rrallë dhe tek-tuk në horizont duket edhe ndonjë idealist, si puna e Albin Kurtit, përfshirë në portretet e këtij libri të veçantë, do të thosha. Dhe Muçi, edhe pse, në realitetin e sotëm shqiptar, para të gjithëve do t’ia jepte votën atij, e pranon botërisht se më shumë ka frikë nga lloji i tillë i politikanëve, i idealistëve, sesa nga pushteti i të korruptuarve: *“Politikanët që sillen sikur të kenë dalë nga shpura e Jezu Krishtit, janë më të frikshëm sesa politikanët e korruptuar. Këta fillojnë dhe i mbushin mendjen vetes se askush si ata nuk e meriton të qëndrojë në pushtet. Kështu u lind natyrshëm dëshira për më shumë pushtet, për të gjithë pushtetet. Dhe, ‘të gjithë pushtetet’, i duan për të mirën e të tjerëve, jo për të mirën e vetes...”*

Në këtë mënyrë, faqet e librit *“Si e kam njohur”*, vlojnë nga sfida reale dhe të supozuara, të imagjinuara, nga shikime e parashikime miqësore dhe “miqësore”, të çliruar e “çliruar” nga idealistë dhe “idealiste” të arealit tonë që e bëjnë librin t’i qepesh pa iu ndarë.

Gjysmë i hapur është tek disa portrete... Elegant kur thotë se i kanë thënë, njohësit e Hashim Thaçit për zgjuarsinë e veçantë të tij, ai, pas njohjes “nuk e gjen atë”, edhe pse nuk dyshon në të vërtetën e atyre që ia kanë thënë... Është e veçanta e Muçit: nuk është thujse asgjë atipike për të, përkatësisht, çdo gjë e mundshme. Fundja nuk e ka në veçanti me askënd, e ka me ne, me të gjithë, duke e përfshirë edhe veten, me një spontanitet të natyrshëm, të besueshëm... Edhe kur thotë bie fjala “epo, le të zhbëhet ajo Akademi që nuk e ka filanin...”.

Për të qenë më konkret lidhur me librin *“Si e kam njohur”*, le të shohim ç’kam shënuar në margjinat e tij:

Fjala është për një zhanër miks, publicistiko-letrar, të pa ushtruar në këtë formë tek ne... Diçka që të ndërmend portretet antike të Plutarkut, por edhe biografite e romanizuara të Cvajgut. Muçi kureshtar i paparë, i ndjek, nga afër e nga distanca figurat publike, të pranishme në përditshmërinë tonë aktuale, që, nga perspektiva, sfera, fusha, opinione, vizione të ndryshme, ndikojnë në rrjedhat e përgjithshme... Autori, që mëton të përfshijë në total figurën, personazhin, niset nga e

njohura, e shpaluara botërisht e tij, të përgjojë në arkivat e thella të të panjohurave, përmes së vetëdijshmes në të pavetëdijshmen sipas shkollës Frojdiste... Libri në tërësi, zien nga shkëndijime të tilla që mund të jenë vatra shpalimesh psiqike më pretenduese. Portretet në fjalë vijnë rezultat, besoj, i kërshërisë për të njohur sa më shumë rrethin, ambientin, kohën që nuk rroket dot, kohën që rrëshqet vetëtimthi e ti nuk e ndal dot çastin e sapo rrëshqitur nga vetja, si uji i lumit antik. Etja e Muçit për njohje, për zhbirime enigmash e tabush manifestohet qartë edhe përmes performancave që ndryshojnë, thuajse, nga dita në ditë, metamorfozimesh në rresht, në radhëpritje, prandaj, ashtu siç e ka thënë vetë me një rast, - për Maks Velon, se Tirana, edhe po të mos e kish do ta krijonte, thënie që i shkon më në harmoni personazhit Muçi, raportit të tij me qytetin dhe i Tiranës me të.

Ai e zë edhe veten, jo rrallë, kur i përfton fluturimthi çasti që s'arrin as ta heshtë as ta objektivizojë, ta sqarojë... Në rrethana të caktuara, si për shembull nemitet kur duhet të ngushëllojë dikë për një humbje të madhe, ose pse i ka zët heronjtë se janë mendjembyllur... (mund të jetë tundim hapësira e mjegullt për memecërinë e heroizmit tonë).

“Si e kam njohur” ka dendësi pluskimesh të tilla, prandaj bëhet tekst atraktiv në kuptimin e estetikës së fjalës. Mbase, edhe pse është zënë dhe është gatuar gjatë shkarkim-çastit megapretendues...

Në një rast tjetër (Pëllumb Xhufi), autori thotë... *“Ja, një njeri i lirë në këtë vend, që do të thotë një njeri i ndershëm, që, tek ne, nuk mund të jesh pa qënë i lirë...”*. Brenda këtyre limiteve, Muçi, si tek portretet, si tek personazhet romanorë, si në performancat skenike, si tek monologët, është në kërkim të bashkëbiseduesve, njësoj në kërkim të vetes... ose biseda me Orneta Vorpsin, kur Muçi, duke rrahur ta gjejë bashkëbiseduesen, e “gjen” vetveten dhe pa lejen e tij i arratiset vetja tek shprehet: *“Çfarë zhgënjimi kur dëgjova se ajo qenkësh e martuar...kisha kapur veten në befasi...”*

Po ashtu, e veçantë është parathënia e Sokol Ballës, sidomos një detaj i sjellë gjithashtu nga orët e para të Partisë Demokratike. Ndër të tjera, Balla bën fjalë, përkatësisht sjell një fragment nga atmosfera e një mbledhjeje të organit më të lartë të partisë, Këshillit Kombëtar, në gjysmën e parë të viteve '90, anëtarë të të cilit paskëshin qenë edhe Nano edhe Balla. (Bëhet fjalë për kohën pas shkarkimit të Eduard Selamit kryetar...). Duke pritur bashkë para hyrjes në Pallatin e Kongreseve, afrohet për të hyrë brenda edhe Selami, meqë, sipas statusit të partisë, të gjithë ish-kryetarët marrin pjesë automatikisht në

forum. Dhe, siç tregon Balla, ndodh incidenti: polici para hyrjes, jo vetëm që nuk e lejon, por me insistimin e Selamit që ta kontrollonin listën, në vend të përgjigjes, polici i thotë: *“Do hiqesh, apo do një shkelm bythës”*... Me këtë ngarkesë acarimi, Balla, duke e tërhequr Muçin që po përsëriste *‘Ç’po bëhet kështu’*, mbase i gatshëm për ndërhyrje, futen në sallë... Para se të niste mbledhja, një anëtare e këshillit, Merita Zaloshnja, paskësh kërkuar fjalën duke kërkuar, po ashtu, që ta lejojnë të hyjë brenda Eduard Selami... *“ Dhe pas pak udhëheqësi (Berisha), foli: Dëgjo ti, putanë, spiune e gazetës ‘Koha Jonë’... ”*. Dhe komandot e tërheqin zvarrë ta nxjerrin jashtë, ndërsa “të qarat e Meritës nëpër korridore dëgjoheshin akoma në sale”, thotë Balla... Dhe unë, në margjinat e faqes numër gjashtë të librit në fjalë, paskam shkruar: Sikur bashkë me Meritën, këtë kuvend barbar ta kishin braktisur edhe Nano e Balla, edhe të tjerë... me siguri sot do të ishim më të mirë!

Po le të ndalem te një emër tjetër i përfshirë në këtë libër të Mustafa Nanos. Si shumica e teksteve, portreteve të librit, ai për Gramoz Pashkon është brilant, madje më nxiti një çast malli dhe keqardhje bashkë. Sidomos detaji kur Skraparin e Muçit, kryetar i degës së PD në ditët e para të saj, e paskësh vizituar Pashko dhe Ruli në shoqërim edhe të një gazetari të huaj, i cili, pas takimit në sallë me anëtarët e PD-ës, e pyet Muçin: “Pse Ruli u duartrokit më shumë? Përgjigjja e nikoqirit: për arsye se ai është përgatitur për këtë takim, ndërsa Pashko mbështetet në dhuntinë e vet... Gazetari i huaj, sipas parashikimeve të mia, paskësh qenë Misho Glen që asokohe qëndronte shpesh në Prishtinë dhe unë e njihja.

Besoj atyre ditëve e javëve të vjeshtës 1990, Rugova dhe unë, në udhë drejt Parisit për një takim me Kadarenë, në aeroportin e Zagrebit, takuam Misho Glenin që kthehej nga Tirana. Aq sa prisnim fluturimin, u interesuam për PD-ën që dinim shumë pak... Në pyetjen time se kë shihte në krye të asaj partie, ai, pa u menduar gjatë, më tha, Gramoz Pashko do ishte zgjedhja më e mire...

Muçi thotë, në shkrimin tek ky portret, *“ashtu si gazetari, asokohe, mendoja se Pashko e Ruli do duhej ta udhëhiqnin PD-ën shqiptare dhe e kisha gabim... Pse gabim? Besoj se Shqipëria do kishte ecur ndryshe, më mbarë, që është për një tjetër debat, nga perspektiva - sikur... Por, për bindjen time, sikur pjesa, bërthama intelektuale e kryesisë, Pashko, Preçi, Ruli, Ceka, Meksi, Selami u zgjuan me vonesë, pasi kaloi treni... Në vend që të siguronin vota të mjaftueshme të delegatëve në konferencën zgjedhore të kryesisë dhe kryetarit, siç kishte*

vepruar krahu tjetër, ata shkuan me vetëbesimin, si puna e Pashkos në Skrapar... Punët, detyrat e përditshme, prapa skenave, njësoi si sëra e Troçkit..., që ia lanë Stalinit “punët teknike...me terenin...”, atij që e kishte nuhatur me kohë fuqinë, pushtetin e numrave, votave...”

E, në këtë, logjikë depërtuese të autorit, në librin “*Si e kam njohur*” gjenden plot tundime eksploruese zonash të pashkelura të Botës - Njeri. Portretet ese të këtij libri që sjellë persona e personazhe të njohura publikisht janë edhe më pranë natyrës krijuese si eseist, nga ku autori paraqet një diskurs narrativ tërheqës, dhe, së bashku, me rreth dyzetë emrat e përfshirë në të, për shijen time, e bën tekst mbërthyes. Mustafa Nano rend drejt depërtimit të botës së personazheve, njësoj edhe atë të njerëzve përreth, duke gjetur tek ata çaste, gjendje, tundime të çastit etj. Dikush e bën këtë në heshtje, i qetë e në vetmi, pa porosi e testament, dikush me potere, i parehatshëm, duke u sprovuar në më shumë shtigje dhe nga më shumë perspektiva, me veprime që i sjellin tjetër ngjyrim ambientit, duke e përplotësuar spektrin e rrethit. Zë i tillë shfaqet ai i Muçit në skenën e përditshmërisë mediatike dhe kulturore në hapësirën shqiptare, mbase edhe ajo tani, sikur mëton t’i begatojë ngjyrat e Tiranës ngjashëm me metropolet evropiane...

Autori duket mendjehapur, si ndaj botës, ashtu edhe ndaj portreteve. I tillë në paanësi, me përjashtime të rralla, kur fare lehtë fshik dikë edhe nga perspektiva personale. Ajo që e veçon moralin arbitues, është prirja e tij për ta përfshirë veten si dëgjues me vëmendje të theksuar, është prirja për ta përfshirë veten edhe si sfidues, gatishmëria për ta kaluar e skanuar veten para një sprove, para sprovave të panumërta të radhës. Për të gërvishtur edhe sferave të panjohura të vetes, duke u gjendur edhe gafil, i befasuar në disa çaste kur i rebelohet diçka e paparaparë, e pakërkuar, nga qilaret e veta të panjohura... Dhe tërë kjo është në harmoni, në përputhje me Muçin e komunikimeve publike pasionante ndër vite, dhe që, besoj, do të vazhdojë të jetë rishtazi dhe përherë i ndryshëm, edhe më i ndryshëm.

Dino Mujadžević / Christian Voss

NDËRTIMI I IDENTITETIT SUB - JUGOSLLAV NË
ENCIKLOPEDIJA JUGOSLLAVIJE
(1955-1990)

Shembulli i çështjes shqiptare

I. Ndërtimi identitar dhe Enciklopedia e Jugosllavisë¹:

1. Vërejtje hyrëse

Në Jugosllavinë socialiste (1945 – 1990), prodhimi i enciklopedive të interesit të përgjithshëm, sidomos enciklopedia nacionale (*Enciklopedia Jugosllavije*, EJ), janë parë si projekte të një rëndësie kulmore kulturore. Kjo ndërmarrje ambicioze qe komplikuar nga natyra multietnike, multikulturore dhe multigjuhësore e federatës jugosllave dhe nga sundimi autoritar, me tensione që vlonin nën sipërfaqe. Detyra i qe besuar Institutit Leksikografik Jugosllav (ILJ) në Zagreb – një ndër institucionet e rralla federative që kishin adresë gjetiu e jo në Beograd. ILJ-ja qe formuar më 1950 si Instituti Leksikografik i Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, me shkrimtarin kroat Miroslav Krleža (1893-1981) në krye. Në vitet 1962 – 1984 njihej si ILJ, ndërsa më pas si ILJ “Miroslav Krleža”.

Krlezha, shkrimtar analitik dhe erudit, me statusin e intelektualit më të shquar të epokës socialiste dhe i mbrojtur nga vetë Josip Broz Tito, ia doli të krijonte një zë të pavarur, duke toleruar edhe bashkëpunëtorë që nuk kishin sfond majtist dhe duke afirmuar njëkohësisht aspekte përparimtare dhe internacionaliste të trashëgimisë historike dhe kulturore sllavo-jugore në shërbim të ideologjisë shtetërore socialiste jugosllave dhe të elitës komuniste të vendit.¹ Krleža dhe bashkëpunëtorët e tij u angazhuan në një seri të tërë projektesh të enciklopedive shumëvëllimëshe, të leksikonëve njëvëllimësh, të fjalorëve,

të atlaseve dhe të hartave që shënonin vendndodhjen e popujve në përputhje me atë që ata e shihnin si domosdo të sistemit të ri.

Projekti më i rëndësishëm i ILJ-së, pa dyshim, ishin dy vëllimet e EJ-së, ku Krleža ishte kryeredaktor. Përmes këtij projekti synohej krijimi i një kornize të përbashkët interpretative përbrenda kulturës “së lartë”. Duke krijuar një kanon të njësuar të dijës, EJ-ja formëonte ndjesinë e komunitetit jugosllav, por, njëherazi, e vinte në pah natyrën kompozite të saj. Organizimi i prodhimit të EJ-së pasqyronte strukturën federative të Jugosllavisë: pos redaksisë qendrore në Zagreb, kishte redaksi për secilën republikë (më pas edhe për secilën krahinë autonome), si dhe redaksi të veçanta për Lidhjen Komuniste dhe çështjet ushtarake. Shikuar në përgjithësi, EJ-ja favorizonte informacionet historike dhe kulturore. Veç kësaj, gjithë të arriturat “qytetëruese” të jugosllavëve – nga pylltaria e industria e deri te letërsia gojore e arkitektura – janë paraqitur historikisht.

Botimi i parë i EJ-së është publikuar vetëm në versionin në gjuhën serbo-kroate (8 vëllime, 1955-71, 5455 faqe, 30.000 kopje për secilin vëllim). Botimi i dytë ka nisur më 1980 dhe është ndërprerë, pa përfunduar më 1991. Ndryshe nga botimi i parë, pritej të kishte edhe versione në gjuhë tjera. Secili version do të kishte nga dhjetë vëllime (plus vëllimi *addendum*), me 22.000 njësi enciklopedike, por, në fund, pati shkallë të ndryshme të realizimit: dy versione në kroato-serbishten/serbo-kroatishten, pra njëri në alfabetin latin (6 vëllime, 1980 – 1990, me 4548 faqe) dhe tjetri në cirilikë 92 vëllime, 1983 – 1985), në sllovenishten (4 vëllime, 1983 – 1989), në maqedonishten (2 vëllime, 1983 – 1985), në shqipen (2 vëllime, 1984 – 1987) dhe në hungarishten (2 vëllime, 1985 – 1988). Secili vëllim qe shtypur në 55.000 kopje. Presionet e krijuara nga shpërfaqja e nacionalizmit serb në vitet ’80-të – me ç’rast intelektualë në zë akuzonin publikisht botimin e dytë për trajtime, sipas tyre, jo të drejta të serbëve dhe të Serbisë – bënë që në fund të ndërpritej para kohe versioni në cirilikë i EJ-së dhe, pas ardhjes së Slobodan Milosheviqit në pushtet më 1987, u ndalën edhe versionet në shqipen dhe në hungarishten. Më 1991, të gjitha projektet jugosllave të ILJ-së, me theks të veçantë EJ-në, u ndërprejnë krejtësisht. ILJ-ja ndërroi emër dhe u shndërrua në Institutin Kroat të Leksikografisë dhe, më pas, në Institutin Leksikografik “Miroslav Krleža”. Gjatë viteve ’90-të, nja 40.000 kopje që kishin mbetur pa u shitur të vëllimeve të EJ-së u recikluan për prodhim të letrës nga menaxhmenti i ri i institutit, kështu që nuk pati më hair prej tyre¹.

2. Vepër e arrirë

Roli i akademisë dhe i kulturës në shërbim të ndërtimit të kombit dhe të identitetit etnik në Jugosllavinë Socialiste është trajtuar nga disa autorë të ndryshëm, rëndom në kuadër të analizave më të gjera të ndërtimit të kombit ose të prodhimeve kulturore/akademike jugosllave gjatë socializmit, por roli i enciklopedive ka pasur vetëm vëmendje të kufizuar në këtë sferë. Banac vë në pah transformimet e historiografisë jugosllave gjatë periudhës socialiste dhe raportet e saj me ndryshimet në diskutet dominuese mbi kombin: nga një jugosllavizëm unitarist dhe federalist deri te nocioni decentralist i jugosllavizmit si një amalgamë kulturore e grupeve të ndryshme, por të afërta etnike, identiteti i të cilave qe vënë në plan të parë¹. Grandits ka analizuar mëtimet e udhëheqjes komuniste jugosllave për të krijuar një “jugosllavizëm nacional” në vitet ’50-të dhe për të nxitur punën për “aspektet kulturore të këtij koncepti”. Ai shqyrton disa projekte federative rreth historisë që kanë nisur gjatë kësaj periudhe, përfshirë EJ-në, për të shënuar se shumica e historianëve ishin vënë në mbështetje të konceptit të ri integruar të jugosllavizmit, ndonëse në fillim të viteve ’60-të udhëheqësia jugosllave hoqi dorë nga ideja e kombit jugosllav.¹ Brunnbauer i ka analizuar kontributet historiografike mbi kombndërtimin në jugosllavinë socialiste. Ai vë në dukje kufizimet e historiografisë që i kanë afirmuar perspektivën dhe identitetin jugosllav, si dukuri afatshkurtra që sa vinin e margjinalizoheshin. Pjesa më e madhe e historianëve pas viteve ’60-të iu rrekën sferave dhe interesave të kulturave të tyre etnokombëtare.¹ Wachteli i ka shoshitur në një anë proceset kulturore, me theks mbi letërsinë, përmes të cilave qe zhvilluar ideja e kombit jugosllav dhe, në anën tjetër, arsyet se kjo ide përfundimisht nuk arriti t’i lidhte sllavët e jugut në një shtet-komb të qëndrueshëm, përfshirë analizat e zhvillimeve gjatë Jugosllavisë socialiste. Sipas tij, politika kulturore jugosllave gjatë socializmit ka osciluar ndërmjet dy projekteve madhore: atij sintetik dhe atij multi-kulturor.¹ Me gjithë përpjekjet, investimet dhe ndikimin e konsiderueshëm që prodhimi i *lexica*-ve të ILJ-së – sidomos të EJ-së – po sillte në jetën kulturore në Jugosllavi, ka relativisht pak punime mbi leksikografinë enciklopedike në Jugosllavinë socialiste, si gjatë, ashtu edhe pas viteve ’90-të. Një shembull i rrallë i kërkimeve mbi përmbajtjen e EJ-së është ai i Gostl-it, i cili, ndërsa procesi qe ende në fazat e saj të para, ka hulumtuar aspektet sociolinguistike të botimit të dytë shumëgjuhësh, të EJ-së, sidomos duke trajtuar masat që qenë marrë për

të vënë barazi gjuhësore (dhe të shkrimeve), barazi të përfshirjes së personave dhe të nacionaliteteve. Studimet e rralla për EJ-në janë fokusuar kryesisht në rolin dhe vizionin e Miroslav Krležës. Visković thekson se Krleža në zanafillë të projektit që zotuar të mos zhytej as në etnonacionalizëm e as në “iluzionet romantike” unitariste jugosllave të “historiografisë borgjeze”. Në vend të kësaj, Krleža kishte dashur të vinte në pah në EJ të arriturat kulturore ndërkombëtarisht relevante të historisë jugosllave, duke zbatuar “ekspertizë të saktë të realitetit historik”. Ky autor thotë se shumëkush jashtë Kroacisë – sidomos në mesin e intelektualëve serbë – e shihte punën e Krležës në EJ si përpjekje në favor të supremacisë kulturore kroate brenda Jugosllavisë, por njëherësh edhe i druheshin hapësirës që ky projekt u kishte dhënë identiteteve dhe kulturave që dikur shiheshin si integrale ose të subordinuara ndaj Serbisë.¹ Roksandić i ka analizuar fjalimet programore të Krležës në dy sesionet plenare të këshillit të redaksisë së EJ-së, më 1952. Sipas këtij autori, Krleža kishte kërkuar një trajtim ndryshe nga ai sovjetik, i cili mëtonte të minimizonte historinë në veprat enciklopedike, si diçka anakronike. Krleža, së këndejmi, donte ta vinte dijen historike në vend qendror në kuadër të EJ-së dhe e shihte si pjesën më të ndjeshme të korpusit të dijes që enciklopedia pritej ta mbulonte.¹

Botimi i dytë i EJ-së në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë që përballur me politizim në rritje të projektit. Qe shndërruar në një fushëbetejë kulturore të llojit të vet dhe u nënshtrohej edhe proceseve të stërkomplicuara e të decentralizuara të prodhimit, edhe mungesës së financave, kështu që ishte e përshtatshme për të qenë cak i zhvillimeve lokale politike. Në këtë kontekst, Dautović analizon qëndrimet e Krležës për shqiptarët dhe ka nxjerrë në pah artikujt mbi “shqiptarët” dhe “marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave” në botimin e dytë të EJ-së, si një përpjekje për ta promovuar statusin e Kosovës në republikë.¹

3. Konsiderata konceptuale

Ky artikull mëton të ilustrojë një aspekt madhor të historisë së prodhimit, të përmbajtjes, të sfondit dhe të ndikimit të EJ-së: transmetimin e njohurive enciklopedike në funksion të ndërtimit identitar në nivelin sub-jugosllav. Në pjesën e parë të këtij artikulli, do të kundrohet prodhimi identitar – edhe si kombndërtues përbrenda republikave dhe krahinave autonome si kuazi aktorë dhe si ndërtime të identitetit etnik të kombeve dhe të pakicave – përmes autoritetit të enciklopedisë si

instrument të transmetimit të njohurive, mbështetur nga shteti. Ndërkaq, në pjesën e dytë të këtij artikulli do të diskutohet kjo dukuri, në të dy botimet e EJ-së, në rastin e prodhimit të identitetit etnik të shqiptarëve, pakicës më të madhe etnike në Jugosllavi.

Tipari i ndërtimit të identitetit në enciklopeditë bashkëkohore lidhet me nocionin e enciklopedive si mjete të kontrollit të dijes, pra të kontrollit të qasjes dhe të posedimit. Në librin e tij mbi historinë e dijes në periudhën mes shekujve XVIII dhe XXI, Peter Burke, vë në spikamë rolin e akterëve të përfshirë në transmetimin e dijes si “knowledge gatekeepers” dhe “epistemic brokers” që shoshitin njohuritë para se ato t’u transmetohen përdoruesve. Ky autor shfrytëzon historinë e enciklopedive, si *Encyclopédie* e Diderot-së dhe e d’Alembert-it, për ta mbështetur tezën e tij. Në përgjithësi, “knowledge gatekeepers” e kanë vënë në punë pushtetin e tyre shpeshherë që nga shekulli XVIII. Kanë luajtur rol ndërmjetësuesi të botës akademike (dhe të njohurive të prodhuara në elitën politike) dhe të publikut, duke konstruktuar rrugës edhe identitetet kombëtare.¹ Siç tregojnë studimet e rastit të të ashtuquajturave enciklopedi kombëtare (ndryshe nga ato ‘universale’ apo tematike), kanonet e njohurive të ndërmjetësuaras përmes enciklopedive të këtij zhanri leksikografik kanë luajtur një rol crucial për kombndërtimin dhe për identitetin etnik në shekullin XX në rastet, kur elitat politike po krijonin ndjesinë e përkatësisë kolektive në shtetet e sapoformuara (Australia në vitet ’20-të) apo në ato *in statu nascendi* (Izraeli në 1920 – 1930-tat).¹ Mendojmë se Jugosllavia socialiste (1945-90) ka qenë në situatë të ngjashme. I duhej jo vetëm të ndërtonte, por edhe të përkufizonte përbashkimet e interesave, të synimeve dhe të preferencave të popullatës së saj. Prandaj, projektit kombëtar të enciklopedisë jugosllave i qe dhënë nga elita jugosllave një rol formativ përkatës që, në përputhje me detyrat e tjera ideologjike, përfshinte kombndërtimin dhe ndërtimin e identiteteve etnike. Ç’është e vërteta, parathënia e botimit të dytë të EJ-së që më 1980 thoshte, se detyra e enciklopedisë ishte edhe “informuese, edhe formuese, mbështetur në idenë e një anëtari të shoqërisë socialiste vetëqeverisëse”.

Vendi që përballur me sfida të vështira të komb-ndërtimit që në masë të madhe e kishte komplikuar sistematizimin enciklopedik të njohurive kombëtare. Kjo që pasqyruar edhe në problemet terminologjike. Nga njëra anë, Jugosllavia socialiste ishte shtet federativ shumëtnik dhe shumëgjuhësh që qe zotuar të mbronte vetëqeverisjen e njësisive të veta përbërëse. Popujt dhe republikat konstitutive (më pas kombësitë dhe krahinat autonome) nxiteshin të ndërtonin dhe të

forconin përkatësinë kolektive në nivele të tyre, të paktën në njëfarë shkalle. Të folurit politik jugosllav që nga vitet '50-të popujt në republika i quante 'kombe'.¹ Në anën tjetër, mbajtja e kohezionit jugosllav lypte latimin e identitetit kolektiv jugosllav që asnjëherë zyrtarisht nuk qe shprehur si komb më vete. Etiketa komb jugosllav qe refuzuar në mënyrë të prerë në programin e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë më 1958, në një periudhë që shihej si kulmi i përpjekjeve për themelimin e një identiteti të përbashkët jugosllav. Në vend të kësaj, propozohej "vetëdija/patriotizmi socialist jugosllav".¹ Në këtë mënyrë, elita komuniste jugosllave qe zënë në një situatë paradoksale, duke mbajtur njëherazi disa shtresa potencialisht kundërthënëse mes vete të ndërtimit të identitetit. Pos (ri)prodhimit të identitetit të përbashkët jugosllav, mbështeste edhe komb-ndërtimin në nivel të njëjësive kuazishtetërore subjugosllave (republika dhe krahinat autonome) dhe ndërtimin e identiteteve etnokombëtarë transkufitarë të popujve konstitutivë dhe të kombësive, siç ishte rasti me shqiptarët. Veç kësaj, përbërja shumetnike e Jugosllavisë nënkuptonte se vetë republikat dhe krahinat autonome u ekspozoheshin kundërthëniesve ndërmjet komb - ndërtimeve të tyre dhe ndërtimit të identiteteve etnike (shembuj të dukshëm janë: tre popuj në Bosnjë e Hercegovinë, serbët në Kroaci, shqiptarët në Maqedoni). Gjendja u komplikua edhe më, kur eshaloni i lartë politik rrugës e ndërroi strukturën e praktikave dominante të "çështjes kombëtare". Fillimisht, fokusi qe në krijimin e një "patriotizmi socialist jugosllav" proto-kombëtar, në vitet '50-të. Kur kjo strategji u hodh poshtë në vitet '60-të, theksi u vu në komb-ndërtimin në nivel subjugosllav. Njëkohësisht, kishte edhe opozitë të këtij diskursi hegjemonist përbrenda elitës së Partisë, duke shtuar hutinë për strategjitë komb-ndërtuese.¹ Prandaj, EJ-ja ishte jetike për mëtimet e Jugosllavisë në vënien e detyrave për krijimin e një deponie autoritative të përbashkët të dijes që do të shërbente në favor të synimeve të saj komplekse, shumështrësore dhe fluktuative komb-ndërtuese. Që të dy botimet e EJ-së qenë krijuar që, në përputhje e prioritetet mbizotëruese komb-ndërtuese të kohës, të shtronin udhë për mëkimin e përkatësisë kolektive jugosllave dhe afirmimin e krijimit identitar të popujve konstitutivë dhe të republikave si dhe, më pas, të kombësive dhe të krahinave autonome.

4. Agjenda anticeutraliste e EJ-së

EJ-ja ka qenë platforma kryesore intelektuale për të siguruar infrastrukturën e dijes për diskurset anticeutraliste jugosllave dhe, së këndejmi, lidhej me agjendat kombformuese dhe ato të ndërtimit të identitetit. Këto qëndrime fillimisht qenë të lidhura me elitat komuniste kroate dhe sllovene, por që në vitet e vonshme '60-të gjetën mbështetje edhe në Bosnjë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në krahinat autonome, pjesë të Jugosllavisë këto që, po ashtu, përfitonin nga vllugu i decentralizimit. Sipas vizionit të Krležës dhe të bashkëpunëtorëve të tij, kanoni anticeutralist jugosllav i dijes ishte mbjellë për të vënë në dukje informacionet historike dhe kulturore që vinin theks mbi atë që mendohej si e arritur qytetëruese e sllavëve të jugut dhe e pakicave të tyre, rreth të cilëve mund të formësohej identiteti policentrik jugosllav dhe identitetet subjugosllave. Qëndrimet anticeutraliste në EJ mund të shpjegohen ashtu që fillimisht kanë mbështetur nocionin federalist të organizimit dhe të kulturës/kulturave shtetërore të Jugosllavisë, duke u bërë më pas gjithnjë e më në favor të modelit decentralist/konfederativ.¹

Që në vitet -50-të, botimi i parë i EJ-së i qe rrekur mesazhit për një nocion koheziv, por prerazi federalist të jugosllavizmit. Duke vlerësuar ndërlidhjet mes popujve jugosllavë, politika redaksionale në mënyrë subtile u rezistoi dhe u bëri ballë tendencave të fuqishme centraliste që në atë kohë mëtonin t'i zbehnin dallimet kulturore mes popujve jugosllave, duke shtruar udhë kështu për një identitet të vetëm eventual jugosllav. Struktura redaksionale e EJ-së, e themeluar rreth vitit 1950, ka qenë federative dhe ka mbetur e tillë deri më 1990.

Në përgjithësi, duket se redaktorët e botimit të parë të EJ-së e kanë shfrytëzuar ambivalencën e sipërpërmendur të diskurseve zyrtare për "çështjen kombëtare" për të shtyrë para interpretimin federativ të identitetit/identiteteve jugosllav/e brenda sistemit shtetëror relativisht shumë të centralizuar dhe ideologjikisht rigjid të Jugosllavisë në vitet '50-të dhe në pjesën e parë të viteve '60-të. Veç kësaj, mendojmë se botimi i parë i EJ-së – të paktën deri në fund të viteve '60-të – ka qenë më shumë i përqendruar për të nxjerrë në dukje përkatësinë kolektive në nivel të popujve jugosllavë se si atë të kombeve përbrenda republikave. Statusi i republikave në atë periudhë nuk u linte aq hapësirë manovruese e as pushtet që të shndërroheshin në qendra kombformuese. Kjo qasje, njëherësh, përfshinte edhe vendime kundërthënëse në atë kohë. Më 1951, udhëheqësia e ILJ-së vendosi të përfshinte muslimanët e Bosnjës - një grup me status të kontestuar atëbotë - në

botimin e parë të EJ-së dhe në projektet e tjera leksikografike si grup etnik më vete, i ndryshëm nga serbët dhe nga kroatët, që tashmë shiheshin si popuj konstitutivë jugosllavë.¹ Me këtë muslimanët morën praninë kulturore që para se të njiheshin zyrtarisht si popull konstitutiv.

Kur transformimet rrënjësore të strukturave të pushtetit në vitet -60-të mundësuan fitoren e decentralistëve në qarqe të E. Kardelit dhe të V. Bakariçit, EJ-ja u shndërrua në autoritetin kryesor të dijës për rimodelimin decentralist të vendit nën tutelën e reformave qeverisëse. Këtu do të tregojmë se redaksia e EJ-së në mënyrë të natyrshme e adoptoi orientimin e ri, të mbështetur në çytjet e mëhershme, ekzistuese anticeentraliste. Vëllimet e fundit të botimit të parë të EJ-së dhe, sidomos, tërë botimi i dytë i EJ-së, u bënë jetikë për të sjellë argumentet dhe legjitimitimin për decentralizimin e gjerë në Jugosllavi që e qonte më afër modelit konfederativ. Parathënia e vitit 1980 e Krležhës, e botimit të dytë të EJ-së, theksonte se ky botim kishte edhe përmbajtje që, për shkak “të rrethanave” nuk ka qenë i pranishëm në botimin e parë: vetëqeverisja (preteksti ideologjik i decentralizimit dhe *Ersatz-ideologie* për “patriotizmin socialist jugosllav i viteve ’50-të) dhe marrëdhëniet e reja ndër republikane dhe ndëretnike të sanksionuara me kushtetutë. Nocioni Jugosllavi në EJ që nga mesi I viteve ’60-të mbeti vital, ndonëse me rëndësi të zbehur, për një tërësi të përbashkët territoriale për republikat, të afërta, por krejt vetëqeverisëse, dhe për krahinat autonome. Në anën tjetër, kombndërtimi i entiteteve komponente jugosllave si kuazi shtete – në mënyrë kundërtënëse edhe me përfshirje të krahinave autonome – u bë thelbësor për projektin e EJ-së. Ky qëndrim krijoi precedent për ndërtimin e popujve dhe të kombësive. Për shembull, kjo është e qartë në mënyrën se si Bosnjë e Hercegovina është përfaqësuar në botimin e dytë të EJ-së – si njësi historike e kulturore më vete e jo si konglomerat kulturash e historish të tre popujve brenda saj.

Në këto rrethana, transmetimi i njohurive në botimin e dytë të EJ-së doli të jetë i decentralizuar dhe kompleks, pak a shumë si shteti jugosllav pas ‘74-ës: enciklopedia u botua pas 1980-ës, paralelisht, në versione në gjashtë gjuhë të ndryshme që kishin artikuj identikë, por me radhë tjetër, shkaku i renditjeve të ndryshme alfabetike. Poende, edhe versionet në kroatishten (me shkrim latin), edhe në serbishten (me cirilikë) kishin artikuj në katër variante të serbokroatishtes-/kroatoserbishtes (boshnjakisht, kroatisht, malazezisht, serbisht), varësisht se nga cila republikë po vinte artikulli. Ndryshe nga botimi i parë, afër gjysma e vëllimit që rezervuar për artikuj të vëllimshëm, gati të

nivelit të monografisë, për secilën republikë, krahinë autonome, komb e kombësi. Redaksia qendrore ua la në dorë një pjesë të përmbajtjes redaksive të republikave dhe të krahinave autonome.

5. EJ-ja dhe periferia jugosllave

EJ-ja ka luajtur rol të rëndësishëm prej pionieri për komb-ndërtim dhe për ndërtim të identitetit etnik në republikat e periferisë jugosllave (Bosnjë e Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedoni) dhe në dy krahinat autonome gjatë periudhës socialiste. I pranishëm edhe më parë, sidomos për sa i përket Maqedonisë, ky orientim u forcua në fund të të '60-tave. Prandaj, politikat e tilla redaksionale të EJ-së kishin hasur terren të përshtatshëm në këto pjesë të Jugosllavisë dhe mbështeteshin me entuziazëm nga elitat decentraliste, politike dhe kulturore, të tyre. Një bashkëpunëtor i lartë nga Vojvodina pohon se botimi i dytë i EJ-së madje edhe e ka zmadhuar rëndësinë e disa ngjarjeve a të personaliteteve nga periferia, në mënyrë që t'i paraqesë si të barabartë me sllovenët, kroatët a serbët.¹

EJ-ja, sidomos botimi i dytë i saj, u bë shtyllë për mbrojtjen, afirmimin dhe orientimin në histori e kulturë të shtetësive fillimisht të kontestuara dhe/ose të marginalizuara dhe të identiteteve etno-kombëtare në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni, Vojvodinë dhe Kosovë. Kjo dilte edhe më në pah për shkak të shkallës më të ulët të zhvillimit të infrastrukturës së tyre kulturore dhe mungesës së legjitimitetit dhe të njohjes jo vetëm nga publiku jugosllav, me Beogradin në radhë të parë, por edhe në rrafshin ndërkombëtar. Po e zëmë, Pech thotë se për maqedonasit qysh botimi i parë i EJ-së që “pikë referimi”, meqë përmes saj po konsolidohej pozita e tyre si grup etnik dhe po ndërgjegjësohej publiku për nacionalitetin e tyre (“nën prominencën e dhënë nga *Enciklopedia e Jugosllavisë* ata u hodhën në një nivel tjetër të njohjes”).¹ Po ende, redaksitë republikane/krahinore të botimit të dytë të EJ-së në Mal të Zi dhe Vojvodinë u bënë, në vitet '80-të, bërthama të projekteve leksikografike, më pas të ndërprera, që qenë krijuar për të përkrahur kulturalisht këto entitete subjugosllave.

Qarqet intelektuale dhe politike nacionaliste serbe e kanë kundruar mbështetjen e EJ-së për “rimëkëmbje kulturore” të sllavëve jugorë joserbë dhe të Vojvodinës si një kanosje për perceptimet e ingranuara tradicionale të zgjerimit territorial të kulturës serbe dhe të identitetit etnik, të integritetit territorial të Serbisë dhe të pozitës së saj

si qendër e Jugosllavisë. Në këtë plan, janë dhënë disa disa shembuj, tashmë të njohur nga burime dytësore. Artikulli makropedik i EJ-së për Bosnjën, që njëherazi e shënonte Bosnjën si një njësi të pavarur kulturore me veçori shteti dhe me status të muslimanëve si popull konstitutiv, qe botuar më 1984 me rastin e Lojërave Olimpikë Dimërore si libër më vete në variantin boshnjak të BSKM-së dhe në anglishten. Ky libër, gjasme i konsideruar si jo më pak se deklaratë e identitetit të pavarur kulturor të Bosnjës së viteve të fundit të socializmit, qe vënë në shënjestër të sulmeve nga intelektualë serbë që pohonin se me të po shlyhej historia serbe e Bosnjës. Udhëheqësia komuniste e Bosnjës publikisht e mbronte këtë libër dhe organizoi një konferencë akademike për të siguruar mbështetje.¹ Në Mal të Zi, dalja në dritë e artikullit të EJ-së, më 1984, *Crnogorsko-primorska mitropolija* nxiti një seri sulmesh polemike në mediat e shkruara serbe dhe malaziase kundër nocionit të pavarësisë kulturore dhe fetare të Malit të Zi përgjatë historisë. Ky artikull i EJ-së merret se ka hapur për publikun çështjen e historisë së autonomisë së kishës malaziase dhe, madje, edhe nisjen e lëvizjes për ta krijuar Kishën Ortodokse Malaziase si entitet të pavarur nga kisha serbe.¹ Zhvillimet lidhur me përfaqësimin e shqiptarëve në botimin e dytë të EJ-së e që diskutohen në pjesën e dytë të këtij artikulli, ndjekin të njëjtën gjedhe.

II. Përfaqësimet e shqiptarisë në enciklopeditë e viteve 1955, 1980 dhe 1983/1984

1. Ekipi i autorëve dhe çështjet përmbajtësore në artikujt mbi Shqipërinë

Do të donim të tregonim potencialin e konfliktit në bazë të dy artikujve “Shqiptarët” dhe “Marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi”. Do të shohim se kombet dhe kombësitë më Jugollavinë e fillimit të të ’80-tave nuk qenë në gjendje të kishin një vizion të përbashkët për historinë e tyre.

Kemi krahasuar artikujt në tri versione të serbokroatishtes: botimin e parë të 1955-ës (këtu si “Arbanasi”/“Arbanasko-Južno-slovenski odnosi”) me latinicë; botimin e dytë me latinicë dhe versionin e ri të këtij artikulli, nga viti 1983 me shkrim cirilik (dhe më 1984 si shtesë e vëllimit të tretë të botimit me alfabet latin).

Përbërja e ekipit të autorëve nga vitet '50-të dhe '80-të është shumë interesante, se pasqyron horizontin e shkollimit dhe të botëndijimeve të dy brezave: autorët e 1955-ës janë ekspertë të gjuhësisë, sidomos të gjuhëve indo-gjermane me sfond të klasës së mesme dhe të Evropës Perëndimore – për shkak të lidhjeve të tij me Titon, Krleža mund ta merrte lirinë që të përfshinte edhe Arbneshin Kruno Krstić¹ (1905-1987) dhe indo-germanistin Petar Skok¹ (1881-1956). Krahas profesorëve Đorđe S. Radojčić nga Novi Sadi dhe Vojislav Vučković nga Beogradi, i pesti autor qe Henrik Barići (1888-1957), gjuhëtar kroat dhe albanolog, mes të tjerash themelues i Institutit Ballkanik në Sarajevë.

Autorët e artikujve të viteve '80-të i përkasin brezit të parë të shqiptarëve të Jugosllavisë me Esad Mekulin, kryeredaktor dhe, njëherësh, përbëjnë brezin themelues të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe të Universitetit të Prishtinës (UP). Esad Mekuli (1916 – 1993) ka qenë poeti më i mirënjohur shqiptar në Kosovë dhe kritik letrar dhe bashkë me Ramiz Sadikun është parë si ikonë e integritit të shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavinë socialiste: Ramiz Sadiku (1915 – 1943) është pushkatuar tok me shokun e tij serb Boro Vukmirovićin, më 1943, nga forcat okupatore italiane dhe të dy janë bërë *lieu de mémoire* më i rëndësishëm në Kosovë me përmendoren Boro e Ramizi (më 1963 në Landovicë, afër Prizrenit). Ai dhe Mekuli kanë biografi të ngjashme: të dy kanë qenë ndër shqiptarët e paktë që kanë shkuar në Beograd në vitet '30-të për studime dhe të dy janë përfshirë gjithë entuziazëm në lëvizjen komuniste (Mekuli edhe në Luftën Qytetare në Spanjë). Duke angazhuar Ali Hadrin¹ dhe Idriz Ajetin¹, Mekuli, si kreu i redaksisë kosovare, u kujdes të kishte në ekip dy studiues të shquar dhe anëtarë të Akademisë.

Në kontekstin e kësaj antologjie është me rëndësi debati mbi çështjen shqiptare dhe shtrirjen e saj përtej komunitetit studimor pas publikimit më 1980. Në kohën kur kemi vdekjen e Titos më 1980, demonstratat në Kosovë në mars të 1981-ës, tërheqjen e Krlezhës nga redaktimi aktiv dhe momentin e publikimit, protesta të ashpra shpërthejnë në Serbi kundër artikujve dhe përgjithësisht kundër enciklopedisë. Kombndërtimi subjugosllav në enciklopedi, me të edhe shënimi i historisë shqiptare me prestigj dhe dinjitet, merret si shkaktar i thirrjeve për republikë në demonstratat e vitit 1981. Si rezultat i kësaj, redaktorët e redaksisë qendrore të EJ-së bënë një zgjidhje solomonike. Dy artikujt u ndanë – i pari mbeti në redaksinë e Prishtinës, i nënshkruar

nga redaksia (jo me inicialet e autorit) dhe nga Idriz Ajeti, ndërsa artikulli tjetër iu dha autorëve serbë që “i qetësuan” pikat nevralgjike.

Ç’paska kaq shpërthyesë në përshkrimin e historisë shqiptare? Cilat qenkan çështjet konkrete?¹ Para se të ilustrujmë tri versionet ekzistuese të artikujve mbi shqiptarët, le ta formulojmë tezën tonë këtu: përfaqësimi i shqiptarisë kosovare është përfundimisht i vendosur brenda kontekstit bashkëkohor, pra atë të kushtetutës jugosllave të ’74-ës dhe, së këndejmi, me status autonom të Kosovës në kuadër të Republikës së Serbisë dhe si kombësi (*narodnost*, jo *narod*, komb, si njësi vetëqeverisëse si sllovenët, malaziasit e maqedonasit).

Si rrjedhojë, këndvështrimi serb mëton t’i përfaqësojë kulturën dhe historinë shqiptare të paktën në nivel nacionaliteti dhe të mohojëtribute të tilla si kulturë ose gjuhë kombëtare.

Ajo që Cvetković-Sander e quan “lufta për të qenë zot shtëpie” (cf fusnota 27) është argument për autoktoninë relative në Kosovë, nga e cila ndahen të drejtat historike territoriale: ka të bëjë me teorinë ilire, mbështetja e së cilës nënkupton se shqiptarët kanë qenë të pranishëm në Ballkanin Jugor shumë shekuj para sllavëve. Në këtë hulli, një tjetër pikë nevralgjike shtohet: marrëdhënia me Shqipërinë që pas mbylljes me Jugosllavinë më 1948 dhe me Bashkimin Sovjetik në vitet ’60-të, mëtonte të legjitimonte organizimin e brendshëm përmes konstrukteve histoike, siç ishin trashëgimia ilirë-shqiptarë ose miti i Skënderbeut. Do të bëhej e qartë se ky postulat i të rrëfyerit të historisë së Kosovës dhe të asaj shqiptare brenda kufijve të Jugosllavisë, nuk do të lejohej.

2. Versioni i vitit 1955

Siç thamë më parë – si rezultat i politikës arsimore të Serbisë në periudhën mes dy luftërave – asnjë folës nativ i shqipes nuk qe në dispozicion si autor: prandaj Krleža u rrek t’i kërkonte Skokun, Krstićin dhe Barićin si ekspertë të jashtëzakonshëm. Artikujt kanë gjithsej 16 faqe dhe përfshijnë këta sythë dhe autorë:

ARBANAS: Historia (Krstić), Gjuha e folklori (Krstić), MARRËDHËNIET ARBANAS-JUGOSLLAVI: Marrëdhëniet politike ndërmjet arbanasëve dhe sllavëve të jugut (Radojčić, Vučković¹), marrëdhëniet kulturore dhe letrare të sllavëve të jugut dhe të arbanasëve (Skok dhe Krstić), Marrëdhëniet linguistike ndërmjet sllavëve të jugut dhe arbanasëve (Skok), Shkrimi boshnjak cirilik

(bosančica) mes arbanasëve (Barić), *Shkenca jugosllave mbi arbanasët (Barić)*.

Pikat potencialist problematike mbi çështjet shqiptare – përfundimisht identike me artikullin e skandalizuar të vitit 1980 – janë shmangur këtu përmes teknikës prevalente, me të cilën tashmë redaktorët e enciklopedisë franceze, Diderot dhe d’Alembert, ia dolën ta kalonin me zgjuarsi censurën absolutiste të kohës. Mendimtarët e Iluminizmit frëng ia kishin dalë t’i publikonin kritikën e tyre ndaj religjionit¹ duke përdorur sistem jo të drejtpërdrejtë të referencës: Artikulli i vitit 1955 emërtohet “Arbanasi”, pra një enklavë e mërgatës shqipfolëse afër Zarës që e diskuton shqiptarinë në nivel kombi, madje edhe në nivel etnie, po si dukuri lokale historike (arbanasi/arbneshët mund të krahasohen me arvanitët rreth Athinës dhe kanë qenë bartës të nacionalizmit kroat (grek të arvanitët) që në shekullin XIX). Gjatë leximit, semantika ambivalente e “Arbanasi” del në pah dhe bëhet sinonim për “Albanci”, ndërsa artikulli për marrëdhëniet më pas merr këndvështrim të padeklaruar dhe të pacensuruar të mbarë Ballkanit.

Shikuar hollë, kristalizohet qëndrimi anticentralist i botuesve, ndërsa ata flasin për teorinë ilire apo trakase të origjinës së shqiptarëve (dy fjalitë e para të artikullit): *“Pasardhës të ilirëve dhe të trakasve të lashtë (...) Gjuha e tyre (...) është ilirishtja ose trakishtja me elemente të ilirishtes (...) Arbanasët janë vendosur në këtë territor para ardhjes së sllavëve ose tok me ta”*.

Më 1955, përcaktimi i ilirishtes a i trakishtes si origjinë e shqiptarëve nuk është në konflikt me teorinë e autoktonisë të fiksuar në antikitet siç qe ndërtuar në Shqipërinë e Enver Hoxhës që nga të ’60-tat, por është pjesë e gjuhësisë, në vazhden e debateve indogermanike të kohës përreth Norbert Joklit, Gustav Weigandit, Franz Miklosichit, et al.

Rajonalizimi i shqiptarisë si Arbanas mundëson një kompromis ndërmjet njohjes së etnogjenezës së tyre potencialisht të rrënjësuar në antikitet dhe reduktimit lokal historik, me ç’rast më pas shmangej çështja shpërthyesë – kontinuiteti i vendbanimeve dhe demografia në Kosovë (shprehur në fillim të shekullit XX: “Pakica arbanase në Serbi dhe në Mal të Zi, 158). Njëherësh, ky citim shërben si shembull se nuk ka dallim mes etnonimit Albanski dhe enklavës pakicë Arabnaški (arbnishtja). Politikat serbomëdha (pas Garašaninit) janë përmendur në mënyrë eksplicite në artikull, sikundër edhe krimet serbe në Luftën Ballkanike (1912/13) në konfliktin për kufijtë lindorë të Shqipërisë, sidomos në zonën e Dibrës (*“Pas përparimit (të ushtrisë serbe), ata*

vepruan në disa raste me brutalitet ekstrem ndaj popullatës vendase (...) Në Serbi, politika e pushtimeve në dëm të shqiptarëve është dënuar nga Partia Socialdemokrate". (158).

3. Botimi i versionit të dytë, 1980

Pas krahasimit të përciptë të të dy botimeve, mund të themi se botimi i dytë i EJ-së përkon me konceptin mbizotërues të "ribotimit të përmirësuar": Thelbi, sidomos i artikujve të shkurtër, mbetet i njëjtë, ndërsa tekstet e reja shfaqen si azhurnime tematike: redaksia rreket të hartojë artikuj pasqyrues (me rëndësi politike p.sh. marrëdhëniet afrikano-jugosllave, ose arabo-jugosllave) që hedhin dritë mbi politikën e jashtme jugosllave dhe të Lëvizjes së të Painkuadruarve. Mirëpo, tendenca për t'i shqyrtuar kombet e vogla dhe kombësitë duket sheshazi (sidomos në formën e artikujve të shkurtër biografikë për boshnjakë, maqedonas, malazias, por edhe hungarezë e shqiptarë).

Rajoni i Kosovës ka pasur liri të dukshme dhe rivalutizim pas rënies së Rankovićit më 1966, mes tjerash për themelimin e Universitetit dygjuhësh të Prishtinës më 1970, të Akademisë, në rrafshin simbolik të ndërtimit të "Boro e Ramizit" (Pallati i Rinisë dhe i Sporteve) më 1977, ndërtimit të Bibliotekës Kombëtare më 1982, kupolat e së cilës me grila çeliku ishin shprehje arkitekture për të simbolizuar shtypjen e shqiptarëve. Dy publikime janë pragmatike për këtë zeitgeist: Nga njëra anë antologjia serbo-shqiptare "Kosova – dikur dhe sot"¹, 1973, dhe në anën tjetër antologjia me rast përvjetori "Rilindja. 1945-1985. Tekste për monografi" nga Ali Sutaj për shtëpinë botuese në gjuhën shqipe dhe gazetën me të njëjtin emër "Rilindja" (si edhe rilindja kombëtare e shekullit XIX).

Ndërkaq, ndihmë aktive për arsimin në gjuhën shqipe në shkallën e dytë dhe të tretë¹, po ashtu, arrihet përmes ndikimit të drejtpërdrejtë nga Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë përmes personelit dhe literaturës, ashtu që komunizmi kombëtar i Enver Hoxhës që dënonte Jugosllavinë dhe mbarë Paktin e Varshavës si "revizionistë", po përhapej veçmas ndër adoleshentë: Kjo ambivalencë formulohej si "Titoizmi vs. Enverizmit" (dy liderët komunistë që kanë sunduar për rreth 40 vjet dhe i kanë dhënë formë socializmit në shtetet e tyre) në një tezë doktore të mbrojtur në Ghent në janar 2020 nga Atdhe Hetemi. Mu kjo do ta nxisë kritikizmin serb ndaj botimit të dytë – konkretisht: marrëdhënia e padefinuar me Shqipërinë¹.

Artikujt e 1980-ës vazhdimisht dhe dukshëm komentojnë mbi çështjen ilire, ndonëse përmendet edhe teoria trakase. Që në fjalinë e parë thuhet: “*Shqiptarët kanë origjinë nga ilirët*” (72) dhe më pas: “*Shkenca ka vërtetuar se shqiptarët jetojnë mu te ato vise të Ballkanit Jugor ku kanë jetuar ilirët*”. (73). Çështja e kontinuitetit territorial sot shihet si më komplekse¹, ndonëse do të thoshin se diskutimi është bërë me standarde shkencore të larta (toponimi, onomastikë, kufij dialektorë etj.). Haptazi diskutohen pengesat në kohën e Jugosllavisë së parë: “*Mbretëria e Jugosllavisë ka qenë vërtet shtypëse e pakicave kombëtare. Pakica shqiptare (...) i qe nënshtruar një terrori të vazhdueshëm (arrestime, maltretime, vrasje) dhe shkombësimi*” (77). Në përputhje me këndvështrimin korrekt klasor, Serbia monarkiste mund të kritikohet: “*Forcat progresive të popullit serb, sidomos Partia Socialdemokrate, e dënonin terrorin e borgjezisë serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovës gjatë Luftës Ballkanike*”. (87)

Veçmas në sferën e kritikës brute të artikujve mbi shqiptarët nga Beogradi, duhet theksuar fakti se të dy artikujt në masë të madhe shprehin anën integruese jugosllave, qoftë si viktimat të përbashkëta të osmanëve (çështje konkrete janë p.sh. Beteja e Kosovës 1389, emigrimet e shekullit XVII), zhvillimi i Lëvizjes Punëtore, i Partisë Komuniste, barazia për shqiptarët e Kosovës në Jugosllavinë e Titos. Kjo shihet nga titujt e sythëve.¹

4. Skandalizimi për artikujt në mediet serbe 1981

Diskutimi mbi debatin është përmbledhur në një publikim të shefit të departamentit të Politikës, Sava Dautović’ më 2000¹, që ka nxjerrë në publik diskutimin akademik dhe e ka lidhur drejtpërdrejt si shkaktar të demonstratave të pranverës së ’81-tës. Debati tregonte diskursin serb të viktimizimit përgjatë të ’80-tave që qe shndërruar në ‘mainstream’. Diskursi i paraqiste artikujt për shqiptarët si mendjengushtësi e një konspiracioni antiserb dhe “ustashoid”. Problemi kryesor i tyre me të dy artikujt nga Politika 1981¹ ishte “glorifikimi jokritik”, “përfaqësimi megaloman gjithëshqiptar” dhe “koncepti integruer” (Dautović 2000: 10, 11, 17).

Nga njëra anë këto argumentime janë nacionaliste serbo-centrike që u mohojnë shqiptarëve momentet prestigjioze të historisë së tyre (duke nisur nga autoktonia më e lashtë e tyre në raport me sllavët jugorë në Ballkan). Njëherësh, artikujt e Politikës, argumentojnë nga

këndvështrimi lojal jugosllav, socialist dhe ankohen se artikujt mbi Shqipërinë në EJ flasin shumë pak për shqiptarët si shtetas dhe përfitues të shtetit Jugosllav. Të dy fillet lidhen në vërejtjen qortuese se tekstet në fjalë zënë rrënjë në borgjenizë e traditës para Titos dhe, prandja, nuk janë të arsyetueshme.

Meqë më 1981, as Titoja, as dora mbrojtëse e Krležës nuk ishin më aty, redaksia qendrore e EJ-së, nën zëvendëskryeredaktorin Ivo Cecić iu referua parimit fillestar të përfaqësimit të kombësive (narodnost) dhe të shteteve të tyre amë, pra që të përfaqësoheshin në mënyrë enciklopedike, por edhe mbështetëse ndaj Jugosllavisë socialiste. Në pjesën e dytë të librit (të quajtur “Diskriminimi I enciklopedistëve serbë”), Dautović (2000: 81) e ngrit tonin e tij, ndërsa në një artikull të tijin në NIN të 20 gushtit 1989 e kthen pyetjen e tij: “A është kjo vepër e studiuesve ustashë?” dhe e diskrediton ILJ-në në Zagreb si fashiste, pa krijuar skenarin paranoid nga fakti se zëri mbi Aloizije Stepincin mungon në botimin e parë të EJ-së¹. Në të njëjtën kohë, romani “Flamujt” i Krležës shfrytëzohet për të demaskuar pasazhet kritike të tij për “çlirimin” serb në Kosovë gjatë Luftës Ballkanike si tërësisht antiserb dhe antijugosllav.¹

5. Artikulli “i përmirësuar” për botimin në cirilikë, 1983

Siç thamë dhe më parë, artikulli për marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare iu dha një grupi autorësh serbë¹, kurse artikulli “Shqipja” i mbeti redaksisë në Prishtinë, nënshkruar nga Idriz Ajeti. Derisa teksti i Ajetit, qartazi është zbehur (“*Shqiptarët janë njëri ndër popujt më të vjetër në Ballkan*”, insert 1) dhe ka formulime eufemiste sidomos lidhur me Luftërat Ballkanike, artikulli për marrëdhëniet shqiptaro-jugoslave, i shkruar nga Živko Avramovski (studiues në Departamentin e Beogradit për Historinë Moderne) për periudhën deri më 1941 dhe nga Stanislav Stojanović për periudhën pas 1941-ës janë dukshëm më ndryshe. Artikulli i vë theks historisë së ngatërruar të sllavëve të jugut dhe të shqiptarëve që në nëntitull¹, duke shprehur marrëdhënie pozitive (Beteja e Kosovës 1389, ekzodi 1689, Kryengritja e Ilindenit 1903): Kemi zgjedhur disa fjalë kyçe me konotacion jashtëzakonisht pozitiv nga titujt e sythëve që shprehin hibriditet dhe konvencë: *isti* (“të njëjtë”), *rodbinske veze* (“lidhje farefisnore”), *izmešani* (“të përzier”), *zblížavanje* (“përaftrim”), *pomažu* (“ndihmojnë”), *podržava*

(“mbështet”), *uz pomoć* (“me ndihmën”), *pakt* (“pakt”), *priznala* (“ka pranuar”), *priznanja* (“mirënjohje”), *pomaže* (“ndihmon”).

Teksti i ri i vitit 1983 është njëherësh plot me kundërvënie të padiferencuara – të dukshme edhe te fjalët kyçe – që kundërvënë solidaritetin e thellë brendaballkanik me të ligën, Fuqitë e Mëdha Evropiane. Si element i ri – siç kërkohej në debatin te Politika – shtohet rishkrimi i Shqipërisë së Enver Hoxhës, Pos fjalimeve antijugosllave të Hoxhës më 1960 dhe 1975, sidomos fjalimi i tij i nëntorit 1981 në Kongresin VIII të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kërkesa për statusin e republikës për Kosovën është kritikuar si ndërhyrje e vrazhdë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Përfundimi i artikullit “të përmirësuar” së këndejmi na sjell te çështja hapëse e skandalit me artikullin për shqipen: Kush duhet fajësuar për demonstratat e studentëve në Prishtinë më 1981?¹ Fakti se Stojanovići, autori i pjesës pas 1941-ës, ishte nënkryetar i Komisionit për Histori të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, caktuar nga Presidiumi i Zyrës Qendrore të LKJ-së tregon se ‘epërsia morale’ për enciklopedinë kishte kaluar nga shkencëtarët e shquar te objeksionistët politikë – një shembull ky mjaft skandaloz i censurës ideologjike dhe nacionaliste. E ardhmja e këtij artikuli mbi shqipen ka përfunduar në deklarinimin e EJ-së për bankrotim, konkretisht një version i historisë jugosllave i shtyrë nga skandalet mediatike. Kjo e monopolizon aspektin e konviviencës dhe të solidaritetit të historisë shqiptaro-sllavojugore në mënyrë të njëanshme dhe artificiale, duke u bëtë “kulturë rrenash” – dhe me këtë rast nuk po aludojmë në romanin e Dubravka Ugrešićit, por edhe në aspektet kulturore-shkencore të shteteve të dështuara që Zorić i përshkruan si “rena të pasuksesshme kulturore”.¹

Ironia tragjike e EJ-së qëndron në faktin se pas 1991-ës, 40.000 kopje janë shkatërruar – projekti vizionar i historisë së nxënies së dijes i Krležës për krijimin e një identiteti të ardhshëm jugosllav që refuzuar në vitet ’90-të nga Kroacia, sikur në të ’80-tat nga Serbia.

Summary

The *Encyclopedia of Yugoslavia* (EJ) was the flagship project of the socialist Yugoslav nation-building in the fields of culture and academic knowledge. It was produced by Miroslav Krleža's Yugoslav Lexicographic Institute of Zagreb. The first edition of the EJ was published in one Serbo-Croatian version (1955-71), but the unfinished second edition of the EJ (1980-90) appeared in Slovenian, Serbo-Croatian in Latin and in Cyrillic script,

Macedonian, Hungarian and Albanian versions (chief editor of the Kosovar redaction was Esad Mekuli).

The EJ transformed itself from the staunchly federalist Yugoslav cultural platform in the 1950s that subverted Yugoslav unitarism to one that strongly affirmed nation-building(s) of republics and autonomous provinces reflecting the decentralist remodeling of Yugoslavia from the late 1960s onwards.

Using the example of the two articles on “Albanians” and “Albanian-Yugoslav relations” in the EJ in three versions from 1955, 1980 and 1983, we will present the political struggles in the Yugoslav ruling elite and academia. By producing a public scandal in the prominent newspaper “Politika” on the two articles and constructing a direct causal relation with the (student) riots in Prishtina 1981, Serbian elites succeeded to sanction the articles written by Ali Hadri and Idriz Ajeti and to reimpose a hegemonistic version of Albanian and Kosovar history (denying Illyrian descent as well as *dignitas* of Albanian language) in a text version rewritten by political functionaries. This way, Serbian elites corrupted and perverted the idea of a Yugoslav encyclopedic knowledge production.

Nysret Krasniqi, Prishtinë

REFUZIMI ESTETIK NGA QELITË E BURGUT

Planifikimi kulturor socrealist e kishte zëvendësuar autorin me shkrimtarin.

Funksioni diskursiv i shkrimtarit i mbrojtur nga ideologjia, e kishte mbytur autorin, qoftë duke ia marrë jetën me dhunë, qoftë duke ia marrë jetën me burg.

Përderisa shkrimtari shkruante, nëpër variante, utopinë e përparimit, me plot pushime krijuese, autori dergjej nëpër qeli burgu. Shkrimtari planifikonte “estetikën e re”, që në fakt ishte pseudo-estetikë, ndërsa autori në burg, lidhej me estetikën klasike si ikje nga koha reale.

Filozofia e teoria letrare nuk e njeh vetëm *autorin e krijimit*, por edhe *autorin e rikrijimit*. Autorë të rikrijimit janë përkthyesit-autorë, ngase *përkthimi është rishkrim i tekstit*.

Shkrimtarët përkthenin ideologjinë në letërsi, autorët e përkthimit, rikrijuesit, dialogonin me klasikën.

Përkthimi nga autorët në burgje, përmbante dy kërkesa themelore: e para, përkthyesit me kulturë të gjerë, iknin nga tortura shpirtërore, ngase tortura e trupit ishte gjithnjë e pranishme, dhe, e dyta, shfrytëzonin përkthimin e veprave të mëdha të letërsisë botërore për ta kompensuar jetën e tyre të humbur. Bestialitetin e burgut e kundërshtonin me botën fikzionale që e gjenin në libër.

Ndërkaq, shkrimtari i lirë, pajtohej me censurën dhe recensurën e tekstit të tij, por autorësinë e validonte supra-autorësia e pseudo-estetikës së planifikimit kulturor. Pra, shkrimtarët “përkthenin” ideologjinë në letërsinë e aplikuar, e cila, në të shumtën, ishte tekst propagandues.

Autorët e përkthimit në burgje zgjidhnin distopinë, shkrimtarët e lirë utopinë.

Guljelm Deda zgjodhi *Orlandin e çmendun* të Lodovico Ariostos ku ka latinitet e *humanizëm*, Gjon Shllaku i lidhur me idenë se *e reja pa të vjetrën është marrëzi* (Staintsbury), rishkroi *Iliadën* e Homerit, Nazim Saiti me vetëdijen se *të menduarit utopik e shkatërron esencën njerëzore* përktheu *Shënime nga bodrumi* të Dosktojevskit.

Të refuzosh utopinë e realizmit socialist, si planifikim kulturor, do të thotë që nga kushtet ekstreme të burgimit ta projektosh lirinë e individit dhe të shumësisë së zërave të librit në një të ardhme të lirë, qoftë edhe më *vdekjen e autorit-përkthyes* apo pa praninë fizike të tij. Kjo është një *ideo-identifikim* i plotë me literaturën.

Qelitë e burgjeve, për autorët, në disa ndërmjetëza, ktheheshin në burgje të hapura apo në fenomenin që e nxjerr si titull Zef Pllumi: *lirinë mbas burgimit* apo *lirinë ndërmjet dy burgimeve!* Qelia zëvendësohej me burgun e madh, ku mbretëronte ajo që psikologët e quajnë *pasiguria kolektive*.

Në këtë gjendje, në këtë sistem represiv e survejues, intelektualë të ndryshëm kanë nisur përkthimet e tyre në qelitë e burgjeve të mbyllura për t'i përfunduar në burgun e hapur, shpeshherë duke i lutur njerëzit e pushtetit, të emëruar në institucionet e kulturës, që të botohen veprat e përkthyer nga ta, kryesisht veprat e klasikës së letërsisë evropiane.

Në këtë plejadë të përkthyesve duhet të përmendim sidomos Mitrush Kutelin dhe Pashko Gjeçin.

Kuteli përkthente autorët e Rusisë së vjetër, Turgenjevin e Gogolin me intencën se në veprat e tyre diferenciohej *liria nga tirania*. Pashko Gjeçi, vijoi fenomenologjikisht aty ku e la Gjon Shllaku dhe përktheu *Odisenë* e Homerit, por edhe *Komedinë hyjnore* të Dante Aligerit, si intencë motivuese për dy llojet e ferrit.

Nga këta pak shembuj që morëm del pyetja: Pse ky strehim në klasikën letrare?

Nga mendimet e shumta për klasiken veçojmë venerimet e T. S. Eliot, Gadamerit dhe të Harold Blloomit, të cilët, në konceptet e tyre për literaturën, gjithnjë patën vetëdijen për fuqinë e ndikimit të autorëve të vdekur në autorët e gjallë.

Kur T. S. Eliot ndërlihet në diskutim për veprat e autorëve si Homeri, Virgjili, Dante, etj., thekson se ata janë *autorë të pjekur*, ndërsa kur Gadamer hyn në botën e *intertekstualitetit* apo të *influcencës* thekson se klasikët gjithnjë e *ilumonojnë idenë e traditës*. Një hap më tej shkon historiani dhe kritiku anglez, Harold Bloom, i cili thotë se autorët e mëdhënj klasikë janë të pashmangshëm, ngase *na kanë zbuluar të gjithëve*.

Përkthyesit autorë, patën këtë vetëdije, për ta iluminuar dhe për ta krijuar bazën e komunikimit ndërkulturor e humanist. Ky iluminim domosdo ka të bëjë me krijimin e memories letrare, ikjen nga ishullimi, izolimi, ngase *memorja është dija nga e kaluara, e jo dija për të kaluarën* (Margalit).

Dija nga e kaluara kur ndërlihet me fenomenin e letërsisë, bëhet edhe më e pranishme, gjithsesi edhe me utilitare, sepse *në letërsi, e kaluara është e tashme apo mund të bëhet e tillë* (Curtuis).

Në këtë udhë, qoftë edhe nga qelitë e burgjeve të mbyllura apo në burgjet e hapura, përkthimi i këtyre veprave, nga këta autorë, u bë me vetëdijen për ta mohuar pseudo-estetikën e shkrimtarit dhe për ta thyer mitin e planifikimit të *njeriut të ri*.

Po sot? Sot jemi rreth 30 vjet mbas rënies së komunizmit. Jam i vetëdijshëm se kjo thënie është *klishe*. Francis Fokujama, në vitet '90 kishte thënë se *rënia e komunizmit shënon fundin e historisë së ideologjive*.

Nga ajo kohë deri më sot, në letërsinë shqipe u shkruan shumë vepra të zhanreve të ndryshme, të cilat temë themelore patën *refleksionin dhe narrativen* e dhunës së pushtetit totalitar ndaj individit. Letërsi e traumës, e pasojës, e reminishencës, e shtresave neurotike etj.. Mirëpo, qoftë duke e trajtuar këtë temë, si mohim, në ajrin tonë e në leximet tona kemi *psiken e diktaturës*. Psikeja e diktaturës në liri, si shkrim distopik?

Distopia letrare ndërlihet me kohën kur është në ardhje apo kur sundon një sistem ideologjik-utopik. Të shkruarit për tiraninë mbas shkuarjes së saj është biografemë, historizëm fiksional e rijetimit mimetik i saj.

Pa asnjë tendencë që kritika letrare të marrë funksionin e detyrimeve për letërsinë, bëjmë një pyetje: A ka motiv që literatura jonë ta rijetojë kaq gjatë pasojën e diktaturës dhe ta transponojë në letërsi mimetike ndikimin e saj?

Autorët përkthyes, të cilët i përmendëm më lart, në kohë tiranie patën vetëdijen estetike, si ikje nga dehumanizimi, si injorim, si refuzim estetik.

Paradoks i llojit të veçantë del fenomeni kur lamenti anti-ideologjik, i cili po vazhdon, rrezikon të kthehet në një anë tjetër të medaljes, e cila, sado e vlershme në mohim e në evidencë, zgjat mbizotërimin e psikes traumatike duke e jetësuar shekullin e komunizmit shqiptar!

I njejtë filozof, Francis Fukujama, si *mea culpa* për venerimin e tij në vitet '90 për fundin e historisë, rrjedhmisht ideologjisë, tash së voni paralajmëroi mundësinë e *rikthimit të socializmit*.

Gjithsesi, ideologjitë, në jetë e rrjedhmisht në tekste letrare, vetëm transformojnë, por si admirues i autorit e jo i shkrimtarit, qoftë edhe i autorit përkthyes, mendoj se koncepti estetik si dhe identitarja si estetikë në tekstin letrar do ta bënin jetën tonë kulturore më të bukur dhe letërsinë më utilitare, nëse në letërsi ka dominancë utiliteti.

Roland Barti, proklamuesi i *vdekjes së autorit* megjithatë theksoi se autorët krijojnë e bëhen autoritete, ndërsa shkrimtarët shkruajnë e bëhën funksione.

Shqipëria, e integruar në sferën sovjetike, për 45 vjet rresht kishte adoptuar skemën e *realizmit socialist* në kulturë, duke forcuar artin e partisë, kishte shpallur slloganin e famshëm *ndërtojmë socializmin duke e mbajtur në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën*, por si pasojë e politikave jashtëzakonisht restriktive, nga viti 1945-1992, kishte mbetur vendi më i izoluar në botë. Gjendja e Shqipërisë komuniste, sa i përket vetë-izolimit, e zhvendosur metaforikisht në ditët e sotme, mund të krahasohet vetëm me Korenë e Veriut.

Në kuadër të kësaj periudhe jodemokratike, mbi parimin e rivlerësimit të historisë dhe të përshtatjes së saj me historinë e partisë, u errësua tradita kulturore paraprake, qoftë ajo romantike apo nismëtare moderne, gjithashtu u pa si e vjetër letërsia me bazë në kodet religjioze

dhe njëkohësisht u instruktua shkrimtari, i cili duhej të shkruante për formimin e *njeriut të ri*. Shkrimtari i *funksionit diskursiv* (Fuko) në të mirë të sistemit, binte ndesh me autorët e formuar, të cilët sistemi i ri i kishte zënë në befasi dhe në zenitet e tyre krijuese.

Si në çdo kulturë të vogël, ideologjitë e mëdha, bëjnë dëme më të fuqishme, madje si të tilla shndërrohen në një lloj karikature të ideve nismëtare, sepse, siç dihet, Ballkani nuk ka qenë prodhues direkt i ideologjive (Mazower). Mirëpo, autorët me vetëdije estetike letrare nuk i pranojnë ideologjitë, për më tepër i *refuzojnë estetikisht* (Rugova). Refuzimi estetik i dominancës së veprave soc-realiste në Shqipëri u pagua me vrasje e burgime të shumta të inteligjencës nacionale. Autorët shqiptarë, të shkolluar dhe të formuar në qendrat themelore të Ballkanit dhe të Evropës, nuk mund të mohonin veprën e tyre paraprake dhe etablimin e tyre në shoqërinë shqiptare si kulturë e hapur dhe refuzonin izolimin e ideve, rrjedhimisht mohonin shmangien nga universaliteti dhe komunikimi evrop-centrik i letërsisë së tyre.

Ndërkaq, Enver Hoxha, diktator komunist, i cili sundonte me *grusht të hekurt* nuk mund të pranonte diversitetin e mendimit dhe se nëpërmjet *aparaturës së tij shtetërore* (Althusser) vrau dhe njëkohësisht i mbushi burgjet me intelektualë shqiptarë. Sipas të dhënave jo të plota të Shoqatës së të Burgosurve Politikë, ky regjim izolacionist, *kishte burgosur 34,135, njerëz dhe i kishte dërguar rreth 59,009 të tjerë nëpër kampe të punës së detyruar. Mbas proceseve të montuara gjyqësore, 5,487 njerëz janë dënuar me vdekje* (Abrahams), dhe, duhet të theksohet, shumica e tyre ishin njerëz të penës dhe të mendimit elitist.

Pra, ata që u shpëtuan gjyqeve të montuara, të cilat çonin në pushkatime, u shndërruan në rob pune, rrjedhimisht autorëve në vend të penës iu dha kasma, ndërsa këta, në kushte të mjerueshme, duke shfrytëzuar zbrazëtitë e sistemeve të rrepta të burgimit, përkthyen vepra letrare.

Këto fenomene nuk janë shënuar në tekstet shkollore, sepse historia si disiplinë humane ishte kthyer në mjet për manipulimin e shoqërisë, madje shpeshherë ishte bërë mbuluese e krimeve.

Përkthimi i veprave letrare në burgjet e diktaturës, shikuar si fenomen, përmbante dy kërkesa themelore: e para, përkthyesit me kulturë të gjerë perëndimore iknin nga tortura shpirtërore, dhe, e dyta,

shfrytëzonin përkthimin e veprave të mëdha të letërsisë për ta kompensuar jetën e tyre të humbur. Kriza dhe mizoria e presionit fizik e psikik kundërshtojë me *estetikën* dhe *botën fikzionale* të librave. Përkthimi, gjithsesi si proces intelektual aposteriori leximit, domosdo i nënshtrohet një zgjedhjeje të veprave të veçanta, universale, të cilat zvogëlonin kohën reale, madje kohën dhe vuajtjet e përkthyesit, në të mirë të kohës universale, të cilën në esencë e posedonin ato, rrjedhimisht bëheshin motiv i mbijetesës dhe i vlerës për të jetuar.

Çdo zgjedhje veprash, në kohë burgu, përmban një intencë personale, qoftë kur lidhet me formimin intelektual të përkthyesit, qoftë me konotacionin e synimit të lirisë së munguar. Në procesin e rishkrimit të tekstit nëpërmjet përkthimit, autori përkthyes si intencë të tij megjithatë kishte një formë refuzimi, së paku *refuzimin estetik*. Pra, rishkrimi i një një veprave nëpërmjet përkthimit gjithsesi se nënkupton raportin e domosdoshëm etik të *dialogimit* dhe të *heteroglosisë* së propozuar nga Mihail Bahtini, që do të thotë një intencë e autorit-përkthyes për të jetuar me imazhin e lirisë kulturore.

Të mendosh polisemantikën kulturore në kohë të burgut dhe të utopisë së realizmit socialist, do të thotë që nga kushtet ekstreme të burgimit të jetosh në filozofinë e distopisë dhe ta projektosh lirinë e individit, të shumësisë së zërave të librit në një të ardhme të lirë, qoftë edhe më *vdekjen e autorit*.

Këto dy arsye themelore, ikja nga bestialiteti nëpërmjet librit dhe refuzimi i utopisë nëpërmjet distopisë letrare, por edhe nëpërmjet univerzalitetit letrar si kundërshtim i izolimit të mendimit totalitar mund të konsiderohen si shtyllat themelore të kulturës polivalente të përkthyesve dijetarë të shpërndarë nëpër burgjet më famëkeqe të diktaturës komuniste.

Guljelm Deda (1915-1994), i shkolluar dhe i diplomuar me ekselencë për Letërsi-Filozofi në Universitetin e Padovës në Itali, kthehet në Shqipëri me idenë për të shërbyer mësues në qytetin e tij, Shkodër. Mirëpo, vetë shkollimi i tij në Itali për korrektorët ideologjikë të sistemit të ri nënkuptonte dyshim, rrjedhimisht akuzë e fabrikime të ndryshme, të cilat çuan në burgim të tij (në vitin 1940) për ta detyruar të kalojë jetën në burgjet e ndryshme totalitare. Me gjithë dhunën sistematike ndaj tij, sa që disa herë Deda ishte sjellë buzë vdekjes, ai

kishte arritur që të përkthejë 40 mijë vargje të epikës romantike të Ludovico Ariostos *Orlando Furioso* (1516), veprimtari intelektuale kjo që mbeti testament i vetëm i tij. Sa për vlerën e kësaj vepre, më këtë rast, mjaftohemi të themi se ishte ndër veprat e para të renesancës italiane, e cila reflektoi besimin në njeriun, pastaj pati ndikim edhe te vepra *Don Kishoti i Mançës* e Miguel de Servantesit, e cila siç thotë Borhes, *ende e bën të lumtur njerëzimin*, ndërsa Ariosto si autor, ishte i pari që farkoi ermin *humanizëm*, si koncentrim filozofik në shpirtin njerëzor. Kjo filozofemë e shtyri edhe përkthyesin Guljelm Deda ta sjellë në shqip, qoftë edhe si thirrje latente për më shumë humanizëm në kulturën vendëse, si refuzim ndaj mendimit uniform, i cili në vijimësi po proklorohej nga zyrtat ideologjike. E përkthyer me mjeshtëri të rrallë, nga origjinali, pa asnjë mjet ndihmës, qoftë fjalor apo konsultim mes miqsh, vepra *Orlando Furioso*, e cila në shqip del me titullin *Orlandi i çmendur*, tashmë është përkthimi i vetëm dhe i plotë i këtij autori në gjuhën shqipe.

Sot, kur e kemi në duar përkthimin e Dedës, vërejmë disa shtylla të fuqishme të ndërmarrjes së tij: njohjen e thellësishtme të latinitetit, renesancës dhe të metrikës së vargut italian; aftësinë e përshtatjes së *oktavës* së Ariostos me vargëzimin specifik të dialektit *gegë* të shqipes dhe dëshirën e tij jetësore për dialogimin e dy kulturave evropiane: italiane dhe shqipe. Pra, dashuri, dije dhe intencë distopike në kohë utopie e mizorie.

Gjon Shllaku (1923-2003) konsiderohet helenisti më i madh shqiptar. Mirëpo, jeta e tij lidhet vetëm më burgimet e njëpasnjëshme. I rritur jetim, kreu shkollimin e lartë në Kolegjin Françeskan në Shkodër për të vijuar për 10 vjet Seminarin Papnor ku studioi teologji dhe filozofi si dhe gjuhët klasike: helenishten dhe latinishten.

Afiniteti i tij kulturor u shqua qysh kur ishte student, kur kishte përkthyer pjesë nga *De rerum natura* të Lukreciut dhe nga *Eneida* e Virgjilit, përkthime të cilat ishin vlerësuar shumë nga profesorët e tij jezuitë. Mirëpo, në vitin 1946, si 23 vjeçar, u dënua me 101 vjet burg vetëm pse kishte qenë anëtar i një grupimi demokratik kulturor. Me ndërprerje të kohëpaskohëshme përjetoi qelitë e burgjeve famëkeqe të Burrelit dhe të punës së detyruar në tharjen e kënetave në krahinën e Myzeqesë.

Mbas një pune disavjeçare, në vitin 1965, arrin ta përfundojë përkthimin e *Iliadës* së Homerit, e cila deri në këtë kohë nuk kishte komunikuar me lexuesin shqiptar. Janë disa arsye pse veçojmë përkthimin e kësaj vepre klasike. E para, vetëdija se veprat e Greqisë së

Lashtë janë baza kulturore e civilizimit evropian, e dyta, roli i kësaj vepre në kulturën shqiptare bëhet edhe më i vlershëm kur ndërlidhet me basenin mitologjik e rapsodik, e treta, njohja me një model tematik të kodeve të nderit, luftës, të kurajos, veti këto kanonike shqiptare. Përveç kësaj, zgjedhja për ta përkthyer *Iliadën* e Homerit është një ikje nga letërsia bashkëkohore, nga planifikimi kulturor monist, e realizuar mbi idenë e Falsafit se *të njohësh antikën është një përparim*. Pra, Shllaku kishte intencën e dijetarit, rrjedhimisht të përkthyesit, se, temat dhe kategoritë universale njerëzore nuk janë të reja, rrjedhimisht është utopike të mendohet se mund të bëhet një shkëputje arbitrare e së resë nga e vjetra.

Me gjithë daljen në shqip edhe të disa botimeve të ndryshme të kësaj vepre, përkthimi i *Iliadës* së Homerit nga Gjon Shllaku në kulturën shqiptare mbetet rishkrimi më i përafërt, më i arrirë dhe më autentik i kësaj vepre, qoftë edhe për faktin se tashmë është bërë e rrallë njohja e gjuhëve klasike nga përkthyes e studiues të brezit më të ri.

Nazim Saiti (1942-2001) është intelektual i Shkodrës, i cili në valën e utopisë së përparimit u shkollua në Bashkimin Sovjetik. Mirëpo, i zhveshur nga iluzionet e mëparshme, madje rinore, të proklamimit të përparimit socialist, pasi që kishte parë objektivisht komunizmin në gjenezën e tij, kthehet në Shqipëri. Me akuzat e fabrikua për agjitacion dhe propagandë, maksimumë kjo e gjyqësisë totalitare, dënohet rëndë dhe dërgohet për ta vuajtur dënimin në burgjet famëkeqe të Burrelit, Spaçit dhe Qafë Barit. Shkollimin të cilin e kishte fituar në Bashkimin Sovjetik, pra njohjen e idiomatikës së gjuhës ruse, nuk e ndërlidhte me sistemin politik të kohës. Vetëdija e tij intelektuale se kultura ruse posedonte autorët universalë e shtyri që në qelitë e burgut të Burrelit ta përktheje veprën *Shënime nga bodrumi* të Fjodor Dostojevskit, por edhe shtatë vepra të tjera të këtij autori, të cilat ende kanë mbetur në dorëshkrim dhe ruhen në posedim nga familja e tij. Nga dëshmitë biografike të Sait Saitit, djalit të autorit të përkthimit, thuhet se Nazim Saiti këto vepra i ka përkthyer në kushte ekstreme të mungesës së dritës, nëpër birucat e lagështa të burgjeve të Burrelit dhe të Spaçit.

Zgjedhja për përkthim e romanit *Shënime nga bodrumi* të Dostojevskit është tërësisht intencionale, mbi dimensione të theksuara alegorike, sidomos kur kemi të bëjmë me analogjinë e bodrumit të autorit me bodrumet dhe qelitë e burgosjes së përkthyesit. Përveç kësaj, dihet se ky roman temë themelore ka raportin e individit me sistemin, madje me ideologjitë dhe si i tillë mbi aspekte të thella psikologjike

trajton fatumin ekzistencial të njeriut, kur ky i fundit domosdo i nënshtrohet aparaturës së madhe të pushtetit. Sa i përket intencës themelore të prozës së Dostojevskit, te vepra *Shënime nga bodrumi*, ajo është refuzimi i të menduarit utopik kur dihet se një mendim i tillë, në esencë, e shkatërron vetë qenien njerëzore.

Sipas kësaj del se përkthyesi Nazim Saiti vetëdijshëm shndërrohet në alter-ego të njeriut të bodrumit të Dostojevskit, por tashmë i zhvendosur në kohë dhe në hapësirë. Gjithashtu, përkthyesi Saiti ka vetëdijen se kjo vepër letrare ka influencuar filozofin Fridrih Niçe në konceptet e tij për ekzistencializmin si dhe autorin Franc Kafka në novelën e tij *Metamorfoza*, si thirrje latente për fuqinë e individit në raport me sistemet si dhe me problemet që ngjallë në vazhdimësi filozofia e ekzistencializmit. Në këtë mënyrë, projektohet një thirrje e brendshme e përkthyesit për më shumë liri jetësore e kulturore, për një sistem të menduar politik ku synohet harmonia e parimeve individuale dhe sociale në vizionin e jetës pa uniformitet.

Shikuar nga prizmi i sotëm, burgjet e diktaturave, të mbushura me intelektualë e disidentë politikë e kulturorë, në të cilat kanë harxhuar jetët e tyre të dënuarit mbi bazë të gjyqeve të konstruktura, mund të konsiderohen vetëm variant më i egër i burgut të madh të krejt shoqërisë.

Një shoqëri e tillë, e udhëhequr dhe e kontrolluar nga aparatura e diktatorit (çdo diktatori) vegjeton e mbytur në survejim të përhershëm, fobi e frikë, në mbytje të egos dhe të karaktereve normale krijuese, fenomene këto që arrijnë deri në shkallën e krijimit të permanencës së rrezikut, luftës e urisë, pra të jetësimit të permanencës së *psikologjisë së frikës* në të gjitha segmentet e jetës, që do të thotë një jetese të një *pasigurie të përgjithshme* (Kurt Rizler).

Duhet të theksojmë, sa për argument, se, nëse Shqipëria totalitare kishte ndërtuar burgje të mbyllura dhe të hapura për intelektualët e njerëzit e kulturës pro-perëndimore, gjithashtu kishte rrethuar kufijtë e shtetit me tela gjemborë luftarakë, kishte ndërtuar mijëra bunkerë mbi tokë e nën tokë dhe kishte mbajtur pezull në vazhdimësi popullsinë e vendit me thirrje të befasishme mobilizuese kundër armiqtë të jashtëm, në të shumtën, të imagjinuar! Një donkishotizëm i tillë mund të realizohej vetëm kur gradualisht ishin mbytur e mbyllur të gjitha

komunikimet kulturore, shkencore e politike me botën, pra kur aparati represiv kishte arritur majat e izolacionizmit.

Në këtë gjendje, në këtë sistem represiv e survejues, intelektualë të ndryshëm kanë nisur përkthimet e tyre në qelitë e burgjeve të mbyllura për t'i përfunduar në burgun e hapur shoqëror, shpeshherë duke i lutur njerëzit e pushtetit të emëruar në institucionet e kulturës që të botohen veprat e përkthyer nga ta, kryesisht veprat e klasikës së letërsisë evropiane.

Në këtë plejadë të përkthyesve duhet të përmendim sidomos Mitrush Kutelin dhe Pashko Gjeçin, të cilët përjetuan dy llojet e burgimeve.

Dhimitër Pasko (1907-1967) i njohur me emrin letrar Mitrush Kuteli, njihet si njeri nga themeluesit e prozës moderne shqipe. U shkollua për linguistikë në Greqi, pastaj për ekonomi në Rumani, ku edhe arriti të bëhej Drejtor i Bankës Rumune (1942). U kthye në Shqipëri ku ushtroi funksione të larta në institucionet ekonomike të vendit. Mbi akuzën armik i popullit u dënua më 1947, por u lirua me falje më 1949 pasi kishte përjetuar dhunën fizike gjatë tharjes së kënetës së Maliqit *ku disa herë kishte tentuar të vetëvritej* (Plasari).

Mbas lirimit, e vetmja punë shkencore që i lejohej, pasi që e kishte damkën e njeriut të dyshimtë për sistemin, ishte përkthimi; iu ndërpre puna krijuese, e cila ishte nisur në vitin 1927. Me që, kishte damkë, *përkthimet e tij të shumta dilnin pa emrin e tij* (Kolevica). Sidoqoftë, Dhimitër Pasko ka nisur veprimtarinë e tij me përkthimin e poezive të poetit rumun *të igiturit* Mihail Eminescu. Ka vijuar me klasikët rusë si Ivan Turgenjev *Kujtimet e një gjahtari* (1963) dhe Nikolai Gogol *Tregimet e Petersburgut e Shpirtra të vdekura* (1969), të autorëve të letërsisë së “Rusisë së vjetër”, ngase nuk parapëlqente botëkuptimet e letërsisë së re, edhe pse detyrohej të shkruante parathënie për veprën e Nikolai Ostrovskit *Si u kalit çeliku* (1973). Pra, në burgun e madh të diktaturës Mitrush Kuteli përkthente autorët që diferenconin ndjeshëm lirinë nga tirania. Në përkthimet e tij shihet një formë e mirë e *intertekstualitetit kulturor* ngase preokupimet, figurat, narracionet dhe deskripsionet që i gjente në veprat e letërsisë klasike ruse motivoheshin me dihotomitë e vendit të tij, sidomos sa i përket raportit të ndërlikuar të individit me pushtetin, qoftë ai kulturor apoopersiv. Vetë zgjedhja e

autorëve dhe veprave të caktuara në laramaninë e tyre, pra rumuni Eminescu, Turgenjevi e Gogoli nga rusët, madje edhe disa përkthime të shkrimtarit nacional ukrainas Taras Shevçenko e të modernistit pers Sadek Hadajatit, nënkuptone botëkuptimin poli-estetik, poli-identitar dhe poli-semantik të Dhimitër Paskos, si vetëdije për kulturalitetin që ofron letërsia si dashuri për të veçantën, e cila arrin të universalizohet (Plasari). Kjo bindje për shumësinë e kulturave, rrjedhimisht të estetikave letrare që burojnë nga to, në mënyrë latente sikur e refuzonte uniformën e imponuar të realizmit socialist dhe krijonte një distopi të padeklaruar ndaj utopisë së përparimit mbi ideologjinë totalitare.

Pashko Gjeçi (1918-2010) i nisi mësimet në shkollën jezuite të Shkodrës, për t'i vazhduar në shkollën shtetërore, ku si gjimnazist përkthente poezi të Dantes, Petrarckës e Leopoldit. Me akordimin e një burse të vogël, iu mundësua vijimi i shkollimit në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Romë (1938) ku kryen studimet me sukses të lartë dhe i ofrohet puna e asistentit mësimor. Mirëpo, i nxitur nga dëshira për të kontribuar në atdhe, kthehet në Shqipëri për t'u bërë pedagog i letërsisë dhe i latinishtes në Shkollën e Mesme Femnore në Shkodër. Me ardhjen e pushtetit socialist, Pashko Gjeçi, mbi akuza të montuara për pjesëmarrje në grup kundër pushtetit, dënohet dhe mban burgim të rëndë pesëvjeçar në Durrës dhe në kënetën e Maliqit. Mbas burgimit, i mohohet e drejta e punës shkencore dhe detyrohet në bëjë punë të rënda krahu. Sidoqoftë, veprimtaria e përkthimit kishte nisur të bëhej pjesë e pandarë e shpëtimit të tij nga dehumanizimi qysh kur ishte në burg, por edhe mbas daljes në burgun e madh. Kjo jetë e rëndë e motivoi të nis përkthimin e *Komedisë hyjnore* të Dante Aligerit, e cila si zgjedhje e tij motivohej mbi dy shtylla themelore: e para, Gjeçi ishte njohës i jashtëzakonshëm i kulturës së latinitetit dhe i letërsisë italiane, e dyta, ky përkthyes nëpërmjet leximit e rishkrimit të kësaj vepre sikur dëshironte që ferrin real të totalitarizmit ta shihte si figurë në një vepër klasike-universale. Lexuesit e *Komedisë hyjnore* të Dante Aligerit gjithnjë kanë shprehur habinë për vetë titullin e saj të shkruar nga gjeniu italian. Mirëpo, alegoria e saj, sado e zhvendosur shekuj me vonë si intencë e purifikimit, thajse i ngjante shumë komedisë së kontrollit të vazhdueshëm dhe të shndërrimit të njeriut në shifër të sistemit, e cila e ktheu qenien individuale njerëzore në statistikë pune dhe dhune. Madje, ka autorë shqiptarë, të cilët duke përjetuar dhunën e sistemit totalitar me ironi patën deklaruar se Dante Aligeri nuk ka shkruar për ferrin italian të kohës së tij, por për *ferrin shqiptar* (Pllumi) të izolacionizmit komunist, duke e dëshmuar në një kohë dhe hapësirë tjetër

intencionalitetin dhe universalitetin e veprës së mesjetës latine në mesjetën e krijuar nga regjimi i ri. Në *psikenë* e përkthyesit, gjithashtu janë bashkuar burgu i vuajtur dhe burgu i madh, pastaj vuajtja e përhershme në jetën e përditshme, por nuk ka munguar për asnjë çast vizioni se bota ka përjetuar ferret e tilla, të cilat janë tejkaluara dhe se përkthimin e tij e ka parë si mjet e model kulturor.

Në vijim, i vetëdijshëm për fuqinë e veprave klasike, Pashko Gjeçi vazhdon punën e tij kulturore të përkthimit aty ku e kishte lënë Gjon Shllaku, i cili, siç u pa më lart, në qelitë e burgut kishte përkthyer *Iliadën* e Homerit. Ndërsa, Pashko Gjeçi, më 1963, nis përkthimin e *Odisesë* së Homerit duke i hyrë një pune kolosale të rikrijimit të saj duke shfrytëzuar greqishtën e vjetër në krahasim më variantët e kësaj vepre në gjuhën frënge dhe italiane. Kjo vepër e përkthyer nga Pashko Gjeçi plotësoi vakumin e njohjes me traditën homerike. Ky përkthyes kishte vetëdijën e plotë se asnjë letërsi kombëtare nuk mund të vihet në krahasim leximi e studimi pa e pasur në gjuhën e vet korpusin homerik. Madje, në letërsitë shqipe bëhet e domosdoshme njohja dhe leximi sistematik i veprës homerike edhe për faktin e ekzistimit të bazenit të fuqishëm mitologjik, rapsodik, pra rapsodik si kulturë orale mbi të cilën janë krijuar shumë vepra të autorëve nacionalë, të cilët qoftë në forma të intertekstualitetit, qoftë të raportit të nevojshëm me traditën hyjné në botën e krahasimit me klasikën e lashtë greke.

Në këtë tekst, kemi observuar fenomenin e përkthimit nëpër qelitë e burgjeve të komunizmit në Shqipërinë totalitare. Përkthimi i veprave të klasikës perëndimore është përcjellë me shembuj të trajktoreve të ndryshme të fatit të përkthyesve, qoftë të përkthyer në qelitë e burgjeve famkeqe, qoftë të përkthyer në burgun e madh të diktaturës. E përbashkëta e tyre, si ide, kulturë e vision ishte refuzimi latent dhe i hapur i uniformitetit letrar, kulturor e ideologjik si imponim nga aparatura shtetërore, e cila kishte për synim planifikimin kulturor nëpërmjet metodës së realizmit socialist. Vetëdija e se veprimtaria e përkthimit është dashuri, njohje letrare dhe kulturore si dhe nevojë utilitare, sidomos për kulturat e vogla që janë në udhën e zhvillimit të tyre për t'u krahasuar me vlerat kulturore e demokratike evropiane, i ka përcjellë dashuruesit e kulturës edhe në situatat më ekstreme të llogoreve të diktaturës. Përkthimi i veprave të letërsisë së huaj ka shërbyer si ikje nga bestialiteti, si kërkesë shpirtërore për estetikën

letrare dhe si vizion e dialog për një të ardhme kulturore në këtë pjesë të Evropës. Përkthimi në burgje është parë si testament kulturor për pasardhësit, si krijim i një baze themelore ku letërsia nacionale krahasohet, dialogon e maturohet me letërsitë e përbotshme. Testamenti i tillë shndërrohet në thirrje permanente për vijimin e përkthimit si rikrijim e dialog kulturash, si njëra ndër veprimtaritë më përkushtuese për demokratizimin e kulturës dhe të humaniteteve në përgjithësi. Nëse librat flasin me njëra-tjetrën, domosdo do të flasin edhe filozofitë e ndryshme gjuhësore, letërsitë autentike nacionale, popujt e ndryshëm, gjithnjë në të mirë të universalitetit estetik letrar dhe të kategorive humane universale.

Si dalje, por edhe si thirrje për të menduar, bëjmë një pyetje: Nëse në letërsi ka utilitet, sidomos në letërsinë që e merr në dorë autori-përkthyes dhe e bën të njohur për kulturën e vet, shikuar mbi parimet e historisë letrare shqipe, cili tip i intelektualit i la trashëgim më të çmuar letërsisë dhe kulturës shqipe, shkrimtari i funksionit të realizmit socialist apo përkthyesi autor i qelive të burgut? Estetika letrare, historia letrare, komunikimi dhe ndërkomunikimi universal i letërsisë padyshim se e favorizojnë të dytin.

Shënim:

Për hartimin e këtij teksti, përveç librave teorikë e studimorë të huaj, të cilët janë dhënë në formën e citateve të brendshme në tekst, janë shfrytëzuar edhe këto burime referencash:

- [1] Aligeri, D., 1966. *Komedia hyjnore* (Pashko Gjeçi). Tiranë: Naim Frashëri
- [2] Ariosto, L., 2013. *Orlando i çmendun* (dy vëlime), (Guljelm Deda). Tiranë: ISKK
- [3] Dostojevski, M. F., 2018. *Shënime nga bodrumi*. (Nazim Saiti). Tiranë: Çabej
- [4] *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*. 2016. Tiranë: ISKK
- [5] Gogol, N., 1969. *Shpirtra të vdekura*. (Mitrush Kuteli). Tiranë: Naim Frashëri
- [6] Gogol, N., 1969. *Tregimet e Petersburgut*. (Mitrush Kuteli). Tiranë: Naim Frashëri
- [7] Homeri, 1965, *Iliada*. (Gjon Shllaku). Tiranë: Naim Frashëri

- [8] Homeri, 1976. *Odiseja*. (Pashko Gjeçi). Tiranë: Naim Frashëri
- [9] Kolevica, P., 1997. *Me Mitrushin*. Tiranë: Toena
- [10] Kraja, F., 2003. *Gjon Shllaku - Helenisti i madh*. Në *Flaka*, nr. 7381 (23 mars 2003). Tiranë
- [11] Nikolla, F., 2018. *Sait Saiti në një rrëfim për të atin: Si e mbaj mend dhe pse e përktheu Dostojevskin*. Në *Gazeta Shqiptare* (02.06.2018).
- [12] Ostrovskij, N., 1973. *Si u kalit çeliku*, (Parathënie nga Mitrush Kuteli). Tiranë: Naim Frashëri
- [13] Pervizi, Lek., 2018. *Guljem Deda: Si i shpëtoi vdekjes në kënetën e Maliqit dhe presioneve të Sigurimit të Shtetit*. Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, 11.10.2018.
- [14] Plasari, A., 1995. *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*. Tiranë: Apollonia
- [15] Pllumi, Z., 2005. *Rrno vetem për me tregue*. Tiranë: 55
- [16] Turgenjev, I., 1963. *Kujtimet e një gjahtari*. (Mitrush Kuteli). Tiranë: Naim Frashëri

Muhamedin Kullashi, Prishtinë

PASIONI, SUBJEKTIVITETI DHE POLITIKA NË TRAGJEDITË E RACINE-IT

Abstrakt

Në pjesën e parë të këtij artikulli, për shtjellimin e raporteve midis pasionit, subjektivitetit dhe politikës në disa tragjedi të Racine-it, kemi marrë në shqyrtim disa interpretime pertinente (Rohou, Sellier, Starobinski) për këto tema. Kësodore kemi problematizuar interpretimin e Jean Rohou, i cili e përkufizon tragjiken rasiniane si një version i veçantë i antropologjisë së shën Augustinit, edhe në mbështetje të analizës së Ph. Sellier. Jemi orvatur të vemë në dukje se në disa tragjedi të Racine-it aksionet e personazhve vështirë se mund të shpjegohen me natyrën e tyre përkatëse të mirë apo të keqe, e as me mëkatin burimor. Racine-i shpalos dhe ndriçon në tragjeditë e veta karakteret e personazheve nëpërmjet implikimit të tyre në situata të ndërlikuara politike dhe brenda rivaliteteve të pasioneve të tyre.

Në analizën e tragjedisë Aleksandri ne kemi vënë në suprinë në veçanti mënyrën se si princesha e Indisë Cléophile, në të cilën ishte dashuruar pushtuesi i madh, e bën çështje vrapimin e pandërprerë të tij që të pushtojë toka të reja dhe popuj të tjerë nga horizonti i pasionit të dashurisë.

Fjalët çelës: Pasioni i dashurisë, augustinizmi, tragjika rasiniane, subjektiviteti, pushteti politik, shikimi i shikimit, ambicia e pushtimeve

Koha në të cilën shkruan dramaturgu i madh francez Jean Racine (Zhan Rasin, 1639-1699) është e shënuar me tronditje të thella politike e sociale, por edhe teologjike. Është kjo kohë në të cilën vazhdojnë të veprojnë ndryshimet që i shkaktoi Rilindja Evropiane (XV-XVI) e njëherazi paraqiten fenomenet e para kulturore që paralajmërojnë epokën e Iluminizmit në Francë. Jean Racine-i u bë i njohur në radhë të parë me tragjeditë, që i shkroi në atë kohë.

Në pjesën e parë të këtij artikulli, për shtjellimin e raporteve midis pasionit, subjektivitetit dhe politikës në disa tragjedi të Racine-it, do t'i marrim në shqyrtim disa interpretime, që na duken pertinente për këto tema. Ndërkaq në pjesën e dytë do ta bëjmë një analizë të shkurtë të këtyre temave në tragjedinë e tij *Aleksandri i Madh* (1674).

Njohësi i mirë i dramaturgisë së Racine-it, kritiku letrar Jean Rohou (Zhan Rou), në parathënien e veprës complete, një studimin me titullin « Tragjikja rasiniane »(f.I-XXII) mëton të shpjegojë përse Racine kishte shkruar tragjedi. Arsyen e parë ai e gjen te pikëshikimi, karakteristikë për shekullin XVII, sipas të cilit tragjedia merrej si « zhanri nga më bujarët »¹ dhe ngase ofronte mundësi të afirmimit për letrarët e rinj. Poezia dhe psikologjia e Racine-it do të lidhen me një vizion tragjik të botës edhe në saje të ndikimit të qendrës teologjike e filozofike Port-Royal (me filozofët e mëdhenj, Blaise Pascale (Blez Paskal), La Rochefoucauld (Roshfuko)etj.), ku ai mori formimin e parë nga letërsia, filozofia dhe teologjia.²

Virtyti në sprovë të situatave tragjike

Problematika themeluese e tragjedive të Racineit, për Rohou, është « gjendja tragjike » dhe « perspektiva organizuese madhore, që është vizioni tragjik. » Rohou thekson se Racine nuk e ka sqaruar asnjëherë këtë vizion, por e ka « shprehur në mënyrë metaforike, brenda fiksioneve dramatike ». Këtë vizion autori kërkon ta zbulojë në « kushtëzimin historik që e ka ndikuar Racine-in, brenda strukturës domethënëse të veprës dhe konceptcionit mbi njeriun, që e cilësonte atë epokë. » Në studimin e tij Rohou mëton të vejë në dukje se në ç' mënyrë poezia tragjike, në përgjithësi dhe ajo e Racine-it në veçanti e *sublimon* fatkeqësinë, pasionet e dhembjes dhe vuajtjet, sikurse edhe forcën rrëmbyese të dashurisë.³

Rohou thekson se shekullin XVII e cilëson një « reaksion politik e ideologjik që lidhet me synimet për *ndryshimin* e qëndrimeve, që nënkuptonin nënshtrimin ndaj rendit të natyrës, zotit dhe traditës kah qëndrimet që shquhen me emancipimin e individit dhe zhvillimin e aftësive të tij që i bëjnë të mundur ndërmarrje të aksioneve të lira [...]»⁴

Autori do të vejë në pah këtu se është fjala për kohën kur problematizohet nga shkrimtarët dhe filozofët statusi i religjionit dhe i institucioneve religjioze, botëkuptimet mbi zotin, botën e këtejme dhe

¹ Racine, *Théâtre complet*, Librairie Générale Française, Paris, 1998. Jean Rohou e përgatiti këtë botim dhe shkrou parathënien me titull « Tragjikja raciniane » ,f. I-XXII.

² Po aty, f.IV.

³ Po aty, f.V.

⁴ Po aty, f.VII.

atë mbinatyrore, e supozuar si e përbërë. Në Port Royal, si qendër teologjike dhe filozofike ballafaqohen dhe gërshetohen *augustinizmi* dhe *kartezianizmi*, përkatësisht interpretimet e ndryshme të tyre. Në rrafshin politik ndërkaq janë me peshë konfrontimet politike e ushtarake midis përfaqësuesve të rrymës së quajtur *La Ligue* dhe atyre me emrin kryengritës *La Fronde*. Ndërkaq elementi i tretë, që do të ndikoj në evoluimin e tragjedisë jo vetëm të Racine-it por edhe te ato të paraardhësit të tij të madh Pierre Corneille (Kornej) është ai i psikologjisë morale.⁵

Rohou vrojton në këtë studim, se tragjedia para Racine-it, në 30-vitet e para të shekullit XVII, cilësohet me theksimin e heroizmit dhe të temave politike. Tiparet karakteristike të kësaj politike shquanin projektet e mëdha politike që pavarësohen nga teologjia dhe morali, në këtë epokë të Richelieu-s, si mendimtar politik, teolog e Kryeministër i Luigjit XIII, dhe Descartes-it (Dekarti), i cili themelon mendimin modern filozofik me « *cogito, ergo sum* » (mendoj, pra, jam), duke afirmuar karakterin themeltar të *subjektivitetit* të njeriut. Rohou zhvillon tezën këtu, se tema e politikës, së paku disa aspekte të saj kryesore, janë pak të pranishme në tragjeditë e Racine-it.⁶ Ai më tutje vë në dukje se tragjeditë e Racine-it janë të ndikuara nga një periudhë e reaksionit teologjik e politik (i cili fillon nga viti 1640) ku bëhen çështje vlerat dhe pikëpamjet që shquanin kontekstin e monarkisë absolute : aftësitë e njeriut dhe aksionin e tij në botën e këtejme. Ndryshimet shfaqen me kthimin e shikimit kah zoti si vlera më e lartë ; lufta civile midis taborit të *La Fronde* dhe atij të *La Ligue*, me pasojat shkatërruese,

⁵ Michel Foucault në veprën e vet *Hermeneutika e subjektivitetit* (Paris, Seuil-Galliamrd, 2001) zhvillon analiza të thella mbi subjektin dhe subjektivitetin në filozofinë evropiane, duke filluar nga ajo klasike greke. Ai vë në pah aty se subjekti percepton e njeh veçantinë e subjektivitetit të vet, përfytyrimet dhe mendimet e veta, mënyrën si i përjeton ngjarjet e ndryshme, ndjenjat e veta, dashurinë dhe urrejtjen, fjala vjen. Ai vë në pah frytshmërinë e qasjes e cila *niset* nga një « analitikë e refleksivitetit, nga forma të refleksivitetit, të cilat e bëjnë të mundur ndërtimin e subjektivitetit si të tillë. » (f.444) Në hulumtimet e veta mbi raportet midis temës së *njohjes së vetes* (gr.*gnôthi seauton*) dhe *bregës për veten* (gr.*epimelei heautou*) në historinë e filozofisë, Foucault analizon qasje e interpretime të ndryshme të « mbikëqyrjes së përfytyrimeve ashtu si na paraqiten, të kuptuarit se prej çka ato përbëhen, me çka janë në raport. » Për të është me rëndësi të kuptohet dhe të ndriçohet « nëse gjykimet që i formojmë mbi ato përfytyrime, e rrjedhimisht edhe lëvizjet, pasionet, emocionet, afektet që ato nxisin, janë apo nuk janë të vërteta ». (f.444) Pra, qëllimi është që të ndriçohet *vërtetësia* e atyre përfytyrimeve që kemi e ato kanë të bëjnë me « format e mëdha » të meditimit.

⁶ *Théâtre complèt*, f.VII.

hap kushtet për kultivimin e pesimizmit, i cili do të artikulohet në veçanti brenda « jansenizmit » si rrymë teologjike rigoroze, e themeluar nga ipeshkvi Cornelius Jansen, në shekullin XVII. Rohou thekson se brenda këtij konteksti të ri politik e teologjik, tema e heroizmit zbehet, ndërkaq marrin hov kritikën e tiranisë, por edhe të « makiavelizmit » në format e ndryshme politike.⁷

Rohou megjithatë nuk mohon se në tragjeditë e Racine-it politika vazhdon të mbetet si temë : në disa prej tyre, si *Tebaida*, *Britanicus*, *Bajazet*, *Athalie* etj, vihen në skenë jeta politike në oborrin mbretëror, tema e luftës dhe paqes, tema e rezistencës patriotike dhe tradhtia. Ndonëse njëherazi orvatet të mbështesë pikëshikimin e vet se « politika këtu nuk është dimension i thelbësor i gjendjes (*condition*) njerëzore » por « vetëm një suazë për probleme të një rendi tjetër », për përplasjet e *pasioneve*, kurse pushteti aty nuk është asnjëherë « shkak i parë e as objekti kryesor »⁸. Në tragjedinë *Aleksandri i madh* Racine kësisoj, sipas autorit, zhvillon motivimet afektive në dëm të rezistencës kombëtare karshi pushtuesve.

Me një pikëshikim historik, Rohou ndriçon këtu disa momente të rëndësishme, që cilësojnë *kalimin* nga një kohë *politike*, e cila ekzaltonte aksionin e njeriut në këtë botë, në një kohë më shumë *morale*, e cila vlerëson « një rend të bazuar mbi vlera transcendentë (hyjnore) dhe dënon *dëshirën* si diçka subversive dhe problematike për moralin ». Në këto rrethana të reja *vlera* nuk është më një qëllim i realizueshëm, por një « transcendentë e paarritshme » ; njeriu paraqitet si qenie e kapluar nga *mëkati*, kurse jeta në këtë botë del e sunduar nga « tundimi për të keqen », sidomos në hapësirën e oborrit mbretëror, të cilën moralistët si Bourdalou (Burdalu) e shikonin si « qendër e botës së prishur ». Letërsia e viteve 1660-1680 (te La Rochefoucaud, Molière, La Fontaine etj.), në interpretimin e Rohou-s, ndonëse e shkruar për ta madhëruar kohën e vet, del megjithatë si pesimiste dhe tragjike, e ngarkuar në veçanti me temën e *mëkatit burimor*.⁹

Kjo letërsi vë në pah, sipas autorit, më shumë të metat e *natyrës* njerëzore, të *pasioneve* dhe të sjelljeve të tij, duke i lënë anash temat politike. Ai pranon megjithatë se te Molière në komeditë *Le Tartuffe*, *Le Misanthrope*, *Don Juan* zhvillohet një kritikë socio-politike.¹⁰ Do të shtonim, megjithatë, se kjo kritikë e Moliër-it shkon më larg, ngase

⁷ Po aty, f.VIII.

⁸ Po aty

⁹ Po aty, f.IX.

¹⁰ Po aty, f.12.

problematizon pikërisht botëkuptimin teologjik mbi njeriun. Kësisoj, zhveshja e hipokrizisë së Tartuffe-it godet, në të vërtetë, vet figurën dhe doktrinën e Krishtit. Kësodore, kur Tartuffe-i gradualisht e shpie larg manipulimin me mikëpritësinë e tij Orgon, duke përfituar nga të gjitha të mirat e familjes së këtij, përfshirë edhe ngashnjimin e gruas së tij, shpërfaqet aludimi i qartë të fjalët e Krishtit : lëni familjen e juaj, gruan e juaj dhe ejani pas meje, në botën e përtejme. Moliëri zhvillon bindjen e vet, me mjeshtrinë e vet artistike, se bota tokësore është botë e mirëfilltë, e vetmja e vërtetë, kurse ajo mbinatyrorja një fikcion dhe mashtrim i mashtruesve.

Tragjedia rasiniane, e cila vë në pah se njeriu është i dënuar të jetë fatkeq me lakminë e pafuqishme dhe shkatërruese të pasioneve të tij, ndanë kësisoj, sipas Rohou-s, pikëpamjet e kohës së tij, për të cilën thelbësorja i takon rendit moral, madje transcendent e jo politik. Autori megjithatë më larg pranon se tema e dashurisë dhe pasionit janë temat kryesore të tragjedive të Racine-it ; ai pajtohet po kështu se Racine-i do të largohet nga doktrinën teologjike e morale të qendrës Port Royal.

Rohou më tej shqyrton *strukturën dhe domethënien* e tragjikes rasiniane. Qasja karakteristike e Rohou-s shpërfaqet këtu edhe në përpjekjet e tij që të ndriçojë domethënien e veprës dramaturgjike të Racine-it duke shtjelluar « raportet midis shënjesve (*signifiants*), që e përbëjnë » tragjedinë e personazheve vepruese (*actants*), duke pasur parasysh anë të ndryshme të veprimeve të tyre.¹¹ Në veçanti ai dikton raportet *trekëndëshe* midis personazheve : në tragjedinë *Britanicus*, Neroni si subjekt, Junie dhe *Britanicus* si « objekt solidar » ose partner, dhe kundërshtari (Agripina dhe Burrhus).¹² Ky raport trekëndësh, në studimet e Rohou-s shpreh edhe « trekëndëshin antinomik të strukturës së personalitetit tonë » ashtu si e shohin moralistët e asaj kohe. Rohou në analizat e tragjedive të Racine-it orvatet të nxjerrë në shesh këtë strukturë të trekëndëshit brenda së cilës shpalosen *relacionet tragjike* midis personazheve kryesore.¹³

Në këto analiza Rohou merr në shqyrtim në veçanti temën e dashurisë si pasion, e jo thjesht si një ndjenjë që një personazh ushqen ndaj tjetrit, por me « domethënien simbolike dhe forcën tragjike » që ka ky pasion. Rohou ka parasysh këtu edhe *prizmat psikologjike* që kanë qenë karakteristike për mesin e shekullit XVII. Ai ka parasysh në

¹¹ Po aty, f.XIII.

¹² Po aty, f.XIV.

¹³ Po aty, f.

veçanti analizat psikologjike të La Rochefoucaud-së e La Bryère (Bryjer), për të cilët dashuria është para së gjithash « dashuri e vetes » (*amour propre*).¹⁴ Rohou mëton të vë në pah se sidomos në disa nga tragjeditë e Racine-it dashuria del si « ambicie për të pushtuar, si vullnet për fuqi ». Ai citon këtu maksimat 262 e 68. e La Rochefoucauld-së : « Nuk ka fare pasion ku dashuria e vetvetes sundon në mënyrë aq të fuqishme sa në dashuri », e bërë « pasion për të sunduar mbi tjetrin ». Mirëpo, pohimet e tilla dalin si problematike sidomos kur mëtojnë të shprehin thelbin e pasioneve të personazheve. Fjala vjen, a mundet pasioni i dashurisë së Fedrës të shpjegohet si shprehje e vullnetit të saj për mbisundim ndaj Hypolitit ? Së paku disa pasazhe në tragjedinë *Fedra* nxjerrin në shesh sa kompleksitetin e këtij pasioni të fuqishëm, aq edhe fuqinë tij që ta rrëmbejë e ta sundojë vetë personazhin kryesor.

Rohou largohet nga pikëpamja e moralistëve të mëdhenj francez duke shpjeguar se kur Pirrua-n, Neroni-n, Roxan-nën apo Fedre-ën i kaplon pasioni i dashurisë, dhe kur e takojnë *tjetrin* si qenie të kundërta me ta, me « pastërtinë e pafajsisë së tyre që nxitë dëshirën e tyre, ata ndiejnë thellësisht nevojë që të jenë të pranuar nga një qenie e tillë ideale, e në këtë mënyrë të shpëtojnë nga kufizimet e tyre, nga korruptimi i tyre. » Kësodore, dashuria këtu nuk reduktohet në vullnet për ta sunduar tjetrin pikërisht pse mëton të nxisë *pranimin* (*reconnaissance*, që nënkupton njohjen dhe pranimin) nga qenia e dashur. Rohou megjithatë e kërkon shpjegimin e këtyre raporteve midis personazheve të përfshira nga ky pasion brenda antropologjisë së krishterë si « bazë e konceptionit mbi njeriun në shekullin XVII. »¹⁵

Rohou e analizon tragjiken rasiniane më shumë si version i veçantë « i antropologjisë augustiniane ». Dashuria, brenda këtij horizonti del si si « dëshirë fajtoare e vë para shikimit të një gjykatësi dhe e etshme që të pranohet nga një qenie ideale e cila e dëbon (refuzon) e ndaj së cilës ai hakmerret duke e masakruar atë ». Rohou përkujton megjithatë se Racine e kishte mohuar, në një periudhë të jetës së tij « edukimin e tij të shenjt », duke iu dhënë « pasioneve [...] të ephshit », por nuk kishte arritur të çlirohet nga brejtja e ndërgjegjes. Rohou mendon se Racine ishte i ndikuar, jo aq nga temat e jansenizmit (si tema e hirit-faljes së mëkateve, i arbitrit të lirë ose vullnetit të lirë) sa nga psikologjia morale që kultivohej në qendrën e Port-Royal.¹⁶

¹⁴ Po aty, f.XVII.

¹⁵ Po aty, f.XVIII.

¹⁶ Po aty, f.XXI.

Për ta theksuar një tipar karakteristik të kësaj psikologjie Rohou përkujton disa formulime të filozofit Blaise Pascal, të frymëzuara nga antropologjia augustiniane, në versionin antihumanist të krishterimit. Ajo antropologji nënkupton mosbesimin ndaj njeriut, duke e parë si spontanisht i prirë nga e keqja dhe pak i aftë që të bëjë të mirën në saje të cilësive të tij, i cili mbisundon në gjysmën e dytë të shekullit XVII (XXI). Një shembull tjetër që ilustron frymën e kësaj antropologjie Rohou e merr nga vepra e shkrimtarit dhe ipeshkvit Bossuet (1627-1704) me titull *Traktati mbi vullnetin e lirë*.¹⁷ ku thuhet : « Zoti e ka krijuar njeriun me dy dashuri, njërin për Zotin, tjetrin për veten e tij ; mëkati burimor i Adamit dhe Evës, i cili është bartur mbi tërë gjininë njerëzore, e ka larguar njeriun nga zoti ; ai e ka dashur veten me një « dashuri egoiste e tiranike, e cila s'është veçse « epsh...i cili u bë natyrë e jona e dytë », epsh ky i pangopshëm. » Kësodore, mëkati burimor i gjithë njerëzimit shpjegohet me *dashurinë për vete* të njeriut, dashuri kjo « tiranike e egoiste », « epsh i pangopshëm », e cila *bëhet përcaktuese* si « natyrë e dytë » për njeriun. Të përkujtojmë se kjo pikëpamje mbi njeriun u kritikua rrënjësisht nga kultura e *humanizmit dhe rilindjes*, që u zhvillua në shekujt XV, XVI, në veçanti në veprat e një plejade të krijuesve të mëdhenj në fushën e filozofisë, letërsisë dhe arteve (Dante, Pico de la Mirandola, Erazmi i Roterdamit etj.) Këto kritika, natyrisht nuk e penguan praninë dhe riparazitjen e koncepcioneve *janseniste* (sipas ipeshkvit Cornelius Jansen, sh.XVII).

Rohou në interpretimin e tij mbi tragjiken rasiniane dëshironte të vejë në dukje se edukimi dhe formimi i Racine-it, ndonëse ishte shkëputur nga Port Royal, megjithatë do të vazhdojë të ushtrojë ndikim në qasjet e tij kulturore.¹⁸ Disa kritikë të tjerë, në shekullin e XX, do të synojnë të ndriçojnë në disa tragjedi të Racine-it më shumë anët me të cilat ai i ikën këtij ndikimi.

Horizonti jojansenist i Racine-it

Tani do ta bëjmë një vështrim të shkurt të interpretimit të Philippe Sellier (Sellie), njohës shumë i mirë i Racine-it, i cili ofron një shpjegim tjetër të tragjedive të Racine-it. A janë disa nga personazhet e Racine-it (si Neroni, fjala vjen) *modele* që shprehin natyrën thelbësisht të prishur të njeriut, siç e paraqet augustinizmi me mëkatin burimor dhe siç e

¹⁷ Po aty, f.XXI.

¹⁸ Po aty, f.XXII.

radikalizon këtë jansenizmi, apo ato « modele » janë mjaft të rralla në tragjeditë e tij, siç mendon Sellier, në tekstin « *Jansenizmi i tragjedive të Racine-it : realitet apo iluzion ?* »¹⁹

Autori përkujton së pari se teoria, me versionet e saj të shumta e të ndryshme, sipas së cilës tragjeditë e Racinetit janë të mbrujtura me jansenisëm dhe pikëpamjet e tij teologjike e morale, si interpretim radikal i augustinizmit, ka një traditë prej tre shekujsh. Sellier thekson se njeri nga *aspektet kyçe* të debateve mbi tragjeditë e Racine-it, gjatë tre shekujve (XVIII-XX) ka të bëjë me ndikimin e, jansenizmit në vizionin tragjik të Racine-it.

Ai citon Voltaire-in i cili ironizonte dhe i kundërvihej interpretimeve sipas të cilave tragjeditë e Racine-it qenkan nën ndikim të *jansenizmit*.²⁰ Ai shpalosë po kështu studimet e Maurice Delcroix (Moris Delkrua) të cilat në mënyrë të thukët kanë problematizuar dhe vërë në pah kufizimet e interpretimeve që i shpjegojnë tragjeditë e Racine-it dhe personazhet e tyre si figura të ndikuara thelbësisht me *jansenizëm* (Goldmann, Vossler, Bénichou etj.). Kjo pikëpamje teologjike e kupton « natyrën » e njeriut dhe njerëzimit si thellësisht e goditur dhe e prishur nga mëkati burimor i Adamit. Sellier zhvillon një hulumtim i cili në saje të analizave të thella të tragjedive të Racine-it nxjerr në shesh se ato s'kanë të bëjnë me bindjet dhe horizontin e të menduarit të *jansenizmit*.

Jansenius-i, zaten, i kundronte njerëzit si « skllëvër të mëkatis », si « qenie të dënuara nga zoti që të jenë të humbur », ngase të kapluar nga « pasionet e ndryshme mëkatore », nga « fodullëku, dhe epshi e kënaqësitë », nga « verbëria e çmenduria », njerëzimi si një « masë që kridhet në baltë », masë e të mallkuarve. Nga kjo masë zoti, sipas këtij vizioni mbi njeriun e botën, do të falë vetëm disa « të zgjedhur ».²¹ Sellier cekë se ndryshe nga filozofi Pascal dhe shkrimtari i teksteve mbi moralin La Rochefoucauld, që kanë qenë thellë të ndikuar nga augustinizmi, « universi i tragjedive të Racineit » i është shmangur këtij ndikimi. Ai përkujton se një pjesë e mirë e personazheve të Racine-it paraqiten si « të pafajshëm e të virtytshëm ». Kësisoj, cekë ai, në parathënien e tragjedisë *Britanicus*, Racine shkruante se Neronin e ka konsideruar përherë si një monstrum, i cili nuk e « duronte Oktavinë, princeshë kjo me një mirësi e virtyt shembullor ». Autori, në saje të

¹⁹ Në revistën *Cahires de l'Association internationale des études françaises*, Paris, 1979, nr.31, f.135-48.

²⁰ Po aty, f.135.

²¹ Po aty, f.137.

analizës së leksikut në tragjeditë e Racine-it konstaton se në to mbisundojnë fjalët, që emërtojnë *pafajsinë* dhe *virtytin* e personazheve. Ai madje shfaq mendimin se në disa nga këto tragjedi « virtyti është i natyrshëm ». Kësodore Racine-i e paraqet Britanicus-in shprehimisht si « një princ i cili kishte një zemër të madhe, shumë dashuri dhe shumë sinqeritet, cilësi këto të rëndomta për një të ri. »²² Sellier i nënvizon fjalët e fundit të cilat shprehin kredon e Racine-it se njeriu *për kah natyra* nuk është i keq dhe vicioz. Ky është aspekt i rëndësishëm i vizionit të Racine-it që del *krejt i kundërt* me botëkuptimin augustinian e aq më tepër me atë të *jansenizmit* rigoroz.

Autorët që kanë mbrojtur pikëpamjen se tragjeditë e Racine-it janë të ndikuara nga *jansenizmi*, më së shpeshti kanë marr si shembull Fedrën, dashurinë e saj të thellë për Ipolitin, djalin e burrit të saj Tezeut, i cili ishte në fakt njeri i Ipolitit. Mirëpo, në tekstin e tragjedisë *Fedra* Sellier vë në pah se Fedra është e torturuar nga « zotat-torturues », e ky vizon është rrënjësisht i kundërt me atë të Shën Augustinit.²³ Më pastaj ai përmend se në tragjedinë *Tebaida* Racine flet për « drejtësinë e pakufishme të Qiellit », përkatësisht të zotit, pikëpamje kjo shumë e ndryshme nga jansenizmi që e paraqet zotin kryesisht si *ndëshkues* i ashpër. Në këtë tragjedi, Antigona madje, kritikon « egërsinë e zotave » që kanë dënuar pamëshirshëm familjen e saj.²⁴ Interpretimet që shpjegojnë dashurinë e Fedrës për Ipolitin si shprehje e natyrës së prishur, që nga lindja dhe e trashëguar nga mëkati burimor i Adamit, lëne anash lirizmin poetik që ndriçon thellësinë, kompleksitetin dhe fuqinë e pasionit të saj. Një studiues tjetër i veprës së Racine-it P. Ricard i cili mendon po kështu se as augustinizmi e as jansenizmi nuk kanë ndikim të madh në botën e tragjedive rasiniane, thekson se disa kritikë e kanë ngatërruar simpatinë dhe miqësinë personale që kishte Racine me disa personalitete të Port Royal, përfshirë figurën kryesore Antoine Arnaud, prijësin e jansenizmit në Francë, me pikëpamjet e tyre teologjike.²⁵

²² Po aty, f. 140.

²³ Po aty, f.145.

²⁴ Po aty

²⁵ Po aty, f.147.

Subjektiviteti i shikimit dhe lindja e pasionit

Jean (Zhan) Starobinski (1920-2019), teoricien i shquar i letërsisë dhe psikiatër zviceran, në librin *Syri i gjallë*,²⁶ studimin me titull *Racine-i dhe poetika e shikimit* (f.71-89) e hap me një krahasim me paraardhësin e Racine-it Pierre Corneille. Heroi i Corneille-it « ka për dëshmitar gjithësinë » dhe « dëshiron të shikohet nga të gjithë popujt dhe të gjithë shekujt, si shembull i mrekullueshëm, si burim i kthjelltësisë»; këtë kthjelltësi nuk e mjegullon as « subjektiviteti i të tjerëve ». Ndërkaq te Racine-i shikimi është po ashtu i rëndësishëm, por vlera dhe domethënia e tij janë krejtësisht të tjera.²⁷

Derisa te Corneille-i shikimi i heroit, i cili kishte kapërcyer përçarjen tragjike, ka një shikim të magjepsur, te Racine-i ndërkaq « shikimi nuk pushon të shfaq pakënaqësinë dhe resantimanin. » Me impulsionin e tij të pasionuar, hero i rasinian « nuk mundet as ta aprovojë vetveten, e as të jetë i pranuar nga rivalët e tij. »²⁸ Konstatimeve të studiuesve të tjerë të tragjedive të Racine-it se në teatrin klasik francez, e sidomos te Racine-i, ka qenë e njohur prirja që « gjestet të zhiduken në dobi të ligjërimit», Starobinski shton dhe saktëson se kjo bëhet « në dobi të shikimit ». Te Racine-i « shikimet e këmbyerë kanë vlerën e shtrëngimit dhe të lëndimit » ngase « ato shkojnë më thellë se gjestet. »²⁹

Autori vë në pah se një shtrëngesë estetike bëhet kështu « një mjet i shprehjes tragjike », kurse ligjërimi bëhet « ligjëratë poetike », duke e ngritur mimikën dhe gjestikulimet në nivelin e shikimit. Racine-i kështu arrin të sublinojë « ligjërimin e syve në fuqi domethënëse të trupit ». ³⁰ Më tutje, Starobinski vë në shesh se në tragjeditë e Racine-it, pikërisht pse bëhet « spiritualizimi i gjesteve fizike duke u bërë shikim », ndodh që shikimi « të materializohet » përkatësisht të ngarkohet me « vlera trupore », me të gjitha domethëniet që nxisin pasionet. Ai saktëson se shikimi mund të bartë një egërsi e cila « godet shpirtat nëpërmjet reflektimeve të tyre në sy të dashurisë apo të urrejtjes ». ³¹

²⁶ Jean Starobinski, *L'œil vivant*, Gallimard, Paris, 1961.

²⁷ Po aty, f.71-72.

²⁸ Po aty, f.73.

²⁹ Po aty, f.74.

³⁰ Po aty, f.74.

³¹ Po aty, f.75.

Një shembull karakteristik të asaj « rëndese shqisore të shikimit » rasinian autori e gjen edhe në këtë varg të tragjedisë *Fedra* :

« Të ngarkuar me një zjarr të fshehtë, sytë e juaj bëhen më të rënduar ». Kritiku nënvizon se « të shohësh » do të thotë sa « të dish », « të njohësh », duke implikuar kësodore një « vizion intelektual mbi të vërtetat njerëzore e hyjnore. » Por « të shohësh » (*voir*) shpreh ndonjëherë te Racine-i edhe « një elan afektiv të pakontrolluar, akt epshori i cili kënaqet me dashuri nga prania e qenies së dëshiruar. »³²

Ndryshe nga autorët që shpjegojnë « magjinë » e tekstit rasinian me « muzikën verbale », Starobinski do ta vë theksin te akti i të shikuarit. Veçorinë e këtij akti të të shikuarit, autori e vrojton te fakti se ai nuk është i kthyer kah objektet, trajtat apo ngjyrat e tyre, ngase ai kërkon *shikimin* e të tjerëve.³³

Shikimi në tragjeditë e Racine-it, sipas autorit synon të kapë sa esencën e qenieve aq edhe atë të botës, ndonëse janë të pranishme edhe disa forma të stilizuara (kuajt, pyjet, brigjet, velat), ose disa çiftet elementare (dita-nata, hija-drita), kurse realiteti kozmik humanizohet me simbolin e shtuar etik ; kësisoj nata ngërthen në vete tmerrin, kurse dita përmban dëlirësinë.³⁴

Në tragjeditë e Racine-it autori nxjerr në shesh edhe temën e « shikimit të shikuar », ngase këmbimi i shikimeve midis dy personazheve zhvillohet shpesh me praninë e personazhit të tretë. Kësisoj në tragjedinë *Bajazet*, e cila ka të bëjë me ngjarje që i përkasin perandorisë otomane, shpërfaqet tema e shikimit të shikuar. Këtu sulltania Roksana në haremin e Konstantinopojës, ia hedh vjedhurazi një shikim (i ndaluar me rregullat e haremit) Bajazetit (Pajazitit), vëllait të sulltanit, Muratit, i cili kalon atypari. :

« Acomat : ...sulltania e humbi veten, Nuk kishte më dëshirë tjetër veçse ta shohë atë sërish.

Osmin : Por a kishin ata mundësinë të mashtrojnë aq shumë shikime xhelozie

Të cilat duket se venë mure të pakapërcyeshme midis tyre. »³⁵

Autori vë në pah se këmbimi i parë i shikimeve të disa personazheve në disa tragjedi (*Andromaque*, *Bérénice*) bëhet një *ngjarje burimore* nga e cila nis aksioni, i cili luhet në skenë. Ky është

³² Po aty, f.

³³ Po aty, f.76-77.

³⁴ Po aty, f.78.

³⁵ Po aty, f.79.

edhe çasti kur « fataliteti lind ». E kësisoj lind edhe ndjenja e dashurisë, e cila do të marr karakterin e një fataliteti. Kjo ndodhë, fjala vjen, brenda situatës ku Pyrrus në qytetin e Trojës së pushtuar, i hedh një shikim të zjarrtë Andromakës së burgosur, gruas së Hektorit, në « dritën e flakës e cila ndez pallatet » të cilat i kallin pushtuesit : mu aty bëhet këmbimi i shikimeve, aty ku « atdheu harrohet e tradhtohet. »³⁶

Fatkeqësia e Fedrës fillon ditën kur ajo këmben shikimet e para me Ipolitin, duke shkelur sa ndalesën e incestit, aq edhe atë të tradhtisë bashkëshortore :

«Athina ma tregoi armikun tim të mrekullueshëm :

E pash, u skuqa, u zbeha duke e parë ;

Një turbullim u ngrit në shpirtin tim të humbur... ».³⁷

Sytë e mi nuk shihnin më, unë nuk arrija të flisja... »

«Shikimi i Fedrës errësohet, cekë kritiku, nata e kaplon atë». Kësisoj «nata lind në brendinë e personazhit tragjik. » Derisa në disa tragjedi (*Britanicus, Bérenice* etj) pishtarët ndriçojnë natën kur ndodh këmbimi i shikimeve, te *Fedra*, ky imazh përbrendësohet dhe përmbysset ; ajo thotë: « Duke vdekur doja të kujdesesha për nderin tim, Dhe t'ia fsheh ditës një zjarr aq të zi.»

Fedra, kësodore, flet për përndezen e errët të saj, ndonëse me emrin që ka ajo simbolizon diellin dhe shkëlqimin. E megjithatë, siç cek kritiku « nata ka kapluar shikimin e saj ».³⁸

Starobinski vë në pah pastaj se Racine-i e ka përvetësuar « metaforën e brendisë së trupit » : « të ngihesh me një pamje aq të dashur ». Mirëpo, te Racine-i shikimi asnjëherë nuk arrin të ngihet nga pamja e dashur, ai përsëritet, në situata të ndryshme, shpesh të tendosura.³⁹

« Atë që dëshira donte me aq shumë pasion të arrijë – thellësinë e shikimit të të tjerëve - i ikën çfarëdo kapje (*prise*) : dëshira hidhet mbi prenë e vet, nuk gjen aty veç dhimbjen e vet, të cilën e acaron sa më shumë, që ngulë këmbë ; ajo atëherë bëhet tërbim shkatërrues. » Këtu është i rëndësishëm ky moment që e vë në pah analiza : « Atë që dëshira zbulon, është më shumë thellësia e saj që i ikën, mungesa e çfarëdo

³⁶ Po aty, f.80-81.

³⁷ Po aty, f.81.

³⁸ Po aty, f.81.

³⁹ Po aty, f.82.

pikëmbështetje të brendshme, humbja. Sikurse që heroi i shikon të tjerët pa i arritur, ai po ashtu e shikon vetveten pa e arritur. »⁴⁰

Oresti në tragjedinë *Andromak*, kur e risheh Ermionën tmerrohet nga « ato shikime të tmerrshme » : vizioni i fundit është vizion i shikimeve dhe përfundon një histori tragjike, e cila kishte filluar me takimin e shikimeve të njëjta. »⁴¹ Më tutje autori shton : « Para se kjo pyetje të jetë kthyer kundër vetvetes, shikimi rasinian është një pyetje e shqetësuar e zhytur në shpirtin e të tjerëve. Karakteri i përbashkët i dashurisë dhe urrejtjes të Racine qëndron aty se që të dyja shprehen me formën pyetësore. »⁴²

Starobinski, në vijim të shqyrtimit të vet vë në pah se *shikimi si pyetje*, shikimi që pyet, është i « bartur nga një qëllim i dyfishtë : ai dëshiron të kapë të vërtetën, e njëherazi ai mëton të posedojë me dashuri. Këto dy qëllime shndërrohen në një veprim : të bëjnë keq. Nxitja e lotëve në sytë e qenies së dëshiruar është njëherazi një njohje dhe një posedim. »⁴³

Në shikimin e viktimës, të Racine, kritiku dikton « një provokim kah ligësia : një sfidë të hapur për egërsi. Kësisoj, në dialogun midis Axianes dhe Taxil-it ai dikton aty një « gëzim të fshehtë për ta bërë persekutuesin gjithnjë e më fajtor, për ta acaruar vuajtjen e tij dhe për ta mbështetur për muri. »⁴⁴

Ai e analizon skenën në *Britanicus* në të cilën Neroni e organizon takimin midis Junies-ë dhe *Britanicus-it*, ndërsa vet fshihet prapa një perde për ta ndjekur bisedën midis tyre :

« Zonjë, kur ta shihni atë, ta dini se unë ju shoh ». « Të vëzhguara fshehurazi nga Neroni, sytë e Junisë nuk do të mund t'i thonë më asgjë *Britanicus-it*. Në saje të shikimit të tij, Neroni e dënon në vdekje këmbimin e shikimeve nga i cili jetonte dashuria e Junisë me *Britanicus-in*. »⁴⁵

Duke përfunduar këtë analizë Starobinski thekson se « kjo poetikë e shikimit– e dobësisë dhe gabimit të shikimit- me siguri është ngjizur nga takimi i tragjedisë greke dhe mendimit jansenist. » Ai saktëson se ajo poetikë gjithsesi ka lindur nga imagjinata e Racine-it,

⁴⁰ Po aty

⁴¹ Po aty, f.83.

⁴² Po aty, f.83.

⁴³ Po aty, f.83-84.

⁴⁴ Po aty, fg.84.

⁴⁵ Po aty, f.85.

poetika e shikimit gjen te Port-Royal dhe te Euripidi një ideologji e cila i përgjigjet. Tragjikja e krishterë e gabimit dhe mëkatit bashkëlidhet aty me tragjiken antike të gabimit ; dhe zoti persekutues i teatrit të Euripidit gërshetohet aty me zotin, shikimin e të cilit njeriu nuk mund ta takojë pa u bërë mëkatar. » Më tutje ai shton se « njohja tragjike është një kënaqësi e çuditshme që del nga mësimi se njeriu është i dobët dhe fajtor. »⁴⁶

Në këtë analizë Starobinski nxjerr në shesh me mjeshtri lidhjen midis poetikës së shikimit dhe gërshetimit dhe dy formave të fatalitetit : atij që u sajua brenda tragjedisë antike greke dhe atij që u ngjizë brenda teologjisë së krishterë.

Foucault mbi shikimin, teatrin dhe politikën

Filozofi japonez Mariaki Watanabe, specialist i teatrit francez, në një bisedë me Foucault-in (Fukon), të mbajtur në vitin 1978 në Tokio, e ngre çështjen e përsëritjes dhe riparimit të shpeshtë të temës së *shikimit* dhe të teatrit në tekstet e Foucault-së.⁴⁷ Foucault pajtohet se këto tema janë të rëndësishme për mendimin e tij dhe shpreh keqardhje pse filozofia, pas dënimit të teatrit nga Platoni, nuk u interesua fort për teatrin. Në përpjekjet e tij për të rivendosur lidhjet midis filozofisë dhe teatrit, ai u frymëzua nga Nietzsche. Për filozofinë, ndërkaq, siç cek Foucault, përherë ka qenë e rëndësishme çështja e *domethënies së shikimit mbi gjërat*, ajo që shikohet është e vërtetë apo iluzore, a jemi në një botë reale apo në një botë iluzore, të rreme. Këto dallime janë të rëndësishme për filozofinë por jo edhe për teatrin : “Nuk ka kuptim të shtrohet çështja se a është teatri i vërtetë, a është real, apo është iluzor, apo është i rremë ; vet shtruarja e kësaj çështje e bën të zhduket teatri. Të pranosh mosdallimin midis të vërtetës dhe të pavërtetës, midis reales dhe iluzores është kushti i funksionimit të teatrit.”⁴⁸ Foucault thekson këtu se njëri nga synimet e shkrimit të tij ishte që “të përshkruajë mënyrën se si njerëzit e Perëndimit i kanë parë gjërat pa e shtruar asnjëherë çështjen nëse kjo ishte e vërtetë apo e pavërtetë, të përpiqem të përshkruajë mënyrën se si ata vet kanë ngre, në saje të lojës së shikimit, spektaklin e botës. » Foucault i paraqet përpjekjet e veta në

⁴⁶ Po aty, f.89.

⁴⁷ Biseda është botuar në vëllimin e dytë të përmbledhjes së teksteve *Dits et écrits*, (Gallimard, Paris, 2001), me titullin *Skena e filozofisë*, f. 571-595.

⁴⁸ Po aty

hulumtimet që ka bërë mbi historinë politike e kulturore evropiane si orvatje për të vënë në pah « si është vënë në skenë sëmundja, se si është vënë në skenë çmenduria, si është vënë në skenë krimi, fjala vjen, do të thotë si e kanë parë, si e kanë pranuar, çfarë vlere i kanë dhënë çmendurisë, krimin, sëmundjes, çfarë roli i dhanë të luajë[...] ». Këto përpjekje kanë synuar të ndriçojnë se në ç'mënyrë është bërë *konstituimi i skenës dhe teatrit*. »⁴⁹

Watanabe, ndërkaq, e shikon *shkrimin* e Foucault-e-së të organizuar në mënyrë shumë *dramaturgjike*, ngase siç shkruan vet Foucault është e nevojshme “të dallohen ngjarjet, të dallohen rrjetet dhe nivelet të cilave ato i takojnë, dhe të ripërtërihen fijet që i lidhin dhe i bëjnë të prodhohen njëri nga tjetri”. Watanabe e çmon epërsinë që Foucault i jep një historiciteti të përcaktuar nga luftërat e konfliktet, nga raportet e forcave, relacionet e pushtetit e jo nga “një model i madh i gjuhës dhe shenjave”. **Ngjashmërinë e shkrimit të Foucault-ës me shkrimin e Racine-it në tragjeditë e tij, Watanabe e shikon në faktin se edhe “strategjia e pasionit rasinian është krejt luftarake”.** Ngjashmërinë e shikimit të Foucault-ës me gjenin e madh të dramaturgjisë klasike franceze, Watanabe e shef në faktin se ai gjithashtu ia del “**të bëjë të shpërthejnë këto përplasje të mëdha historike** të cilat, deri më tani, mbeteshin të pa vërejtura apo të panjohura.” (nënvizimi është i yni).

Foucault përkujton se tema e ngjarjeve historike, e lënë anash nga filozofia tradicionale, është futur brenda mendimit filozofik nga Nietzsche i cili “ e përkufizoi filozofinë si aktivitet që shërben të njohë atë që ndodhi dhe atë që po ndodh tani. Me fjalë të tjera, ne jemi të kapluar nga procese, lëvizje e forca; këto procese dhe forca, ne nuk i njohim dhe roli i filozofit është që të jetë diagnostik i këtyre forcave, të diagnostikojë aktualitetin”. Më pastaj, Foucault shfrytëzon rastin të saktësojë dallimin midis filozofisë bashkëkohore dhe asaj tradicionale edhe përmes dallimit të pyetjeve që ato shtrojnë. Derisa për filozofinë bashkëkohore, si filozofi e të tashmes dhe ngjarjes, janë thelbësore pyetjet “kush jemi ne? Dhe çka po ndodh?”, filozofia tradicionale pyeste “ç’është shpirti? ç’është përjetësia?”. Këtu ai e sheh edhe ngjashmërinë me teatrin, i cili synon të kapë një ngjarje dhe ta vejë në skenë.⁵⁰

⁴⁹ Po aty, f. 572.

⁴⁹ Po aty, f. 573. Po aty, f. 573.

⁵⁰ Po aty, f. 574.

Në pika shumë të rëndësishme të veprave të veta, Foucault ngre skena brenda të cilave luhet një ngjarje e rëndësishme për problemin, të cilin ai e shqyrton. Kështu, njëra nga veprat më të rëndësishme të tij, *Të mbikëqyrësh dhe të ndëshkosh* hapet me një skenë teatrale të torturës dhe ekzekutimit të personit që tentoi ta vriste mbretin Luigji XIII, me 1757, para portës kryesore të Kishës së Parisit. Këtë skenë të ndëshkimit, Foucault e rindërton në saje të dokumenteve të arkivit. Roli i saj është që të nxjerrë në shesh disa tipare karakteristike të funksionimit të pushtetit të sovranitetit mbretëror. Edhe skena në librin *Pushteti psikiatrik*, lidhur me mbizotërimin e mbretit anglez Georges i III, në spitalin psikiatrik, nga një infermier, ka për qëllim të shpjegoj kalimin prej procedurave të pushtetit të sovranitetit kah metodat e pushtetit disiplinor, që nisin të zhvillohen që nga shekulli XVIII. Veç tjerash, veprat e Foucaultsë i kundrojnë ngjarjet që zhvillohen brenda skenave të mbyllura, në çmendina, burgje, spitale, uzina, kazerma, e sidomos dispozitivat e pushtetit dhe relacionet e pushtetit dhe dijes brenda tyre.

Të cekim, në këtë kontekst, se Foucault ka zhvilluar kërkime për praktikën teatrale në politikë dhe teatralizimin e aksioneve të shtetit dhe sovranit. Ai e bën dallimin midis ceremonive tradicionale mbretërore si shenjtërimi, kurorëzimi apo funerali i sovranit, që shënojnë lidhjen e pushtetit mbretëror me pushtetin fetar e teologjinë, dhe me “këtë lloj të teatrit modern në të cilin mbretëria ka dashur të shfaqet dhe të mishërohet, e prej të cilave praktika e grusht shtetit, e bërë nga vetë sovrani, është njëra nga shfaqjet më të rëndësishme”.⁵¹

Në disa shkrime të veta Foucault ka shtjelluar domethënien e karakterit politik të teatrit klasik, duke marrë si shembuj kryesisht veprat e Racine-it. Ai pohon se veprat e Racine-it si *Andromaque*, *Atalie* e madje edhe *Bérénice* shpalosin, në mënyrë dramatike, disa grusht shtete: “Sikurse që në politikë arsyeja e shtetit shfaqet përmes një teatraliteti, teatri, në anën tjetër, organizohet rreth paraqitjes së kësaj arsyeje të shtetit në trajtën e saj dramatike, intensive dhe të dhunshme të grusht shtetit”. Oborri mbretëror të Luigjit të XIV Foucault e kundron si pikëlidhje midis një vendi ku teatralizohet arsyeja e shtetit në trajtë të “intrigave, ndëshkimeve, zgjedhjeve, përrjashtimeve, egzileve, dhe pastaj oborri po ashtu si vend ku pikërisht teatri do ta paraqesë vet shtetin”.⁵² Luigji i XIV, në fakt, i porosiste autorët sa të

⁵¹ Po aty

⁵² Po aty

tragjedive, Racine-in dhe Corneille-in, aq edhe ata të komedive si Molierin, që të bënin shfaqje për të dhe mbi të. Këto pjesë shfaqeshin në oborrin e tij dhe ofronin jo një « pasqyrim » të thjesht të ngjarjeve e konflikteve aty, por një **transponim artistik** të tyre.

II

Pasioni dhe politika në tragjedinë Aleksandri i madh

Personazhet e kësaj tragjedie :

Aleksandri i madh,

Porusi dhe Taxili, mbretër të Indisë

Axiane, mbretëreshë e një pjese tjetër të Indisë

Cléophile, princeshë, motra e Taxil-it

Ephestion, këshilltar Aleksandrit

Skena e parë e aktit të parë zhvillohet buzë lumit Hydaspes, aty ku është vendosur kampi ushtarak i Taxil-it, një mbret i Indisë, në pritje të sulmit nga trupat ushtarake të Aleksandrit.

Motra e mbretit Taxile (Taksil), princesha Cléophile (Kleofil), synon ta bind vëllain e vet të heqë dorë nga rezistenca kundrejt ushtrisë së madhe e të fuqishme të Aleksandrit :

« Si ? doni të luftoni kundër një mbreti, fuqia e të cilit,
 Duket se e detyron qiellin që ta mbështes atë,
 E nën të cilin e tërë Azia pa si binin mbretëritë e saj,
 Qiell ky që e mban fatin të nënshtruar nën ligjet e tij ?
 Vëllai im, hapni sytë për ta kuptuar Aleksandrin :
 Shikoni se si në të gjitha anët fronet bëhen hi,
 Popujt skllavërohen dhe mbretërit bien në pranga,
 Evitoni të këqijat që i kanë rënduar ata. »⁵³

⁵³ *Théâtre complet*, f.85.

Taxil-i, në fillim, refuzon t'i dorëzohet stuhisë pushtuese të Aleksandrit :

« Ai qe i goditur nga një frikë e ulët,
Ta shtrijë qafën nën zgjedhën, e cila na kërcënon,
E të dëgjojë pastaj t'u thuhet popujve të Indisë

Se unë i kam farkuar vet prangat e tyre dhe të miat ? » Ai shton se nuk mund ta braktisë mbretin Porus dhe princërit që tubohen për të rezistuar.⁵⁴

Taxil-i shprehë bindjen se asnjëri prej tyre nuk do të pranojë që pa luftuar të bëhet skllav, e mu për këtë arsye ai s'ka si të kërkojë mbështetjen e Aleksandrit.

Cléophile megjithatë nuk heqë dorë nga përpjekjet që ta bind të vëllain, pasi që dashuria e saj me Aleksandrin e madh e mahnit me shpresat jetësore që ia ka nxitur. Ajo ia përkujton vëllait se Aleksandri i madh ia ofron vetëm atij « miqësinë », e këtë ai nuk mund ta refuzojë, aq më tepër pse kësaj do t'i shpëtonte një luftë të pashpresë : « Kur rrëfeja ndizet dhe nisë të fluturojë , Ai përpiket fshehurazi të të mbrojë prej saj dhe të të bëjë mik».⁵⁵

Mirëpo, Taxil-i nuk mund të pajtohet me këtë ofertë, të cilën e konsideron të turpshme edhe për vetë faktin se ai është i vetmi mbret indus, të cilit ai i propozon paqe e miqësi, ngase supozon se ai mund të ketë më pak vullnet që të rezistojë, duke marrë parasysh lidhjen e së motrës me pushtuesin e madh.

Cléophile në vazhdim orvatet të zhvillojë argumente më të holla. Ajo cekë se Taxil-i nuk do të duhej ta akuzojë Aleksandrin se ai do ta bëjë skllav, ngase nga të gjithë armiqtë e tij ai e shikon atë si « më të guximshmin ». Duke ia hequr armët Taxil-it, Aleksandri nuk dëshiron ta njollosë emrin e tij, ngase miqësia e tij nuk pranon *qyqarë* dhe « ndonëse dëshiron ta shoh tërë botën të nënshtruar » ai nuk ka miq që janë skllavë. Ajo ia sqaron vëllait se mesazhet sekrete, që Aleksandri ia kishte dërguar, shprehin një dashuri të thellë për të (Cléophilen). Njëherazi ajo ia kujton Taxil-it se ai më parë e kishte inkurajuar të motrën jo vetëm të mos e refuzojë dashurinë e Aleksandrit, por madje edhe ta duaj atë. Cléophila kësaj e ballafaqon vëllain e vet me *dëshirën* që ai kishte shfaqur më herët, dëshirë kjo që ndriçon një anë

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Po aty

tjetër të subjektivitetit të tij, gatishmërinë e tij që të ketë një lidhje të favorshme me pushtuesin e madh.

Mirëpo Taxil-i po kështu sqaron më hollësisht qëndrimin e vet të ri karshi pushtuesit. Ai nuk i bën vërejtje të motrës pse « fituesi i Euftratit », i cili mposhti Dariusin e Persisë, e çarmatosi edhe atë, por se ndjen *tani* një përgjegjësi ndaj shtetit në krye të cilit është dhe se e sheh fatin e tij të jetë i lidhur me fatin e këtij shtetit. Kësisoj ai vë në dukje lëvizjen dhe *ndryshimësinë* e *subjektivitetit* të tij karshi zhvillimeve politike e ushtarake që ndodhin në një situatë dramatike.

Taxil i në vijim të bisedës, saktëson se e kupton shqetësimin që ky qëndrim i tij i shkaktonte Cléophiles. Mirëpo, ai shton njëherazi se tani e ka edhe një arsye tjetër, e cila nuk është as politike dhe as vetëm morale, por një arsye që lidhet me pasionin e tij të dashurisë ndaj mbretëreshës Axiane. Cléophila, e cila është e interesuar, për ta realizuar dashurinë e vet me Aleksandrin, ta bindë Taxil-in që të bëjë paqe me pushtuesin e madh. Taxil-i, ndërkaq e di se Axiana është e vendosur të luftojë, me trupat e veta, kundër Aleksandrit. Ai shton se ajo është mbretëreshë, të cilën e duan të gjithë shtetasit e saj, e çmojnë guximin e saj dhe aftësitë me të cilat ajo tashmë i ka organizuar ata që të luftojnë për liri. Meqë ajo nuk do të pranojë kurrsesi nënshtrimin dhe prangat, ai e ka vështirë t'i kundërvihet vendosmërisë së saj.⁵⁶

Mirëpo, Cléophila tani nxjerr në shesh një situatë tjetër, disa aspekte që Taxil-i nuk i ka parasysh këtu. Ajo thekson se duke e mbështetur me armë rezistencën e Axiane-s, Taxil-i do të hyjë në shërbim të *qëllimit* të Porusit, i cili e do Axianën. Përballë këtyre të dhënave, Taxi-i nisë të luhetet, ndonëse nuk është i sigurtë se Porusi e dashuron Axianën. Cleophile shfaq bindjen se Axiana e parapëlqen Porusin : « A nuk e shihni se me çfarë afshi ajo lavdëron vlerat e tij ? »⁵⁷ E vetëdijshme se këto pohime tanimë e kanë lëkundur Taxil-in, ajo shton një *mundësi tjetër* të rrjedhës së ardhshme të ngjarjeve. Duke e sforcuar realitetin e fuqisë ushtarake të trupave të mbretit Porus, ajo sugjeron mundësinë që ai të dalë fitimtar në ballafaqimin me Aleksandrin. Ajo shkon edhe më larg me këto supozime, duke pohuar se « liria e Indisë është në duart e tij », se pa të « muret tona do bëheshin hi, se vetëm ai mund të ndalë përparimin e Aleksandrit ». Ajo krijon kësodore një skenar të ri të ngjarjeve vijuese. Nga ky skenar ajo nxjerr përfundimin, të cilin e paraqet si të pashmangshëm : Axiane në këto rrethana do ta dojë edhe më shumë

⁵⁶ Po aty, f.87.

⁵⁷ Po aty, f.121.

Porusin. Së këndejmi, nëse Taxili hidhet në luftë kundër trupave të Aleksandrit, ai me këtë veprim vetëm sa do ta përforconte lidhjen e dashurisë së kundërshtarëve të tij, pasionin e tyre. Përballë kësaj situatë të mundshme, të cilën Cléophile e skicoi me mjeshtri, Taxil-i shqetësohet dhe pranon se edhe më parë i kishte ndodhur të kaplohej nga dyshime të ngjashme por se përherë ishte orvatur t'i mënjanojë ato. Ai i kërkon motrës që ta ndihmoj ta kultivojë shpresën ose edhe iluzionin se Axiana megjithatë e do vëllain e saj.

Konstelacionet e aleancave politike dhe loja e pasioneve

Cléophile i përgjigjet se ai mund të vazhdojë ta ushqejë një shpresë të tillë, por ajo është e kotë, aq më tepër se nëse ai i bashkohet Porusit dhe Axianës në luftë kundër Aleksandrit, megjithatë gjasat do të jenë të vogla që ai opsion ushtarak të ketë sukses. Në këto çaste ajo ia vijëzon vëllait një opsion tjetër: nëse ai pranon miqësinë e Aleksandrit, ai me siguri do ta mposhtë ushtrinë e Porusit, aq më tepër pse del i dobësuar pa përkrahjen e Taxil-it. Dhe meqë Aleksandri dëshiron që Taxil-i ta mbajë kurorën mbretërore, do të rritej mundësia që Axiana t'i kthejë sytë e saj kah Taxil-i, që ta harrojë rivalin e tij. Në anën tjetër, ajo ia bën të qartë se nëse ai i bashkohet ushtrisë së Porusit ai do ta humbte jo vetëm lirinë por edhe Axianën. Kësodore, shohim se si pasioni i Cléophiles për Aleksandrin dhe perspektiva e një jete të lumtur me të e ushqen invencionin e saj për të ndërtuar me mjeshtri *opsione taktike* si në një tabelë shahu ku shpalosen figura të ndryshme të rrjedhës së ngjarjeve që pritet të fillojnë. Ajo ndikon, me logjikën e saj inteligjente, mbi lëvizjet dhe ndryshimet e gjendjeve shpirtërore të Taxil-it. Këto veçori të lëvizjeve të gjendjeve shpirtërore, zaten, janë më shumë karakteristike e një *subjektiviteti modern* se sa të atij antik, brenda të cilit paraqiten ngjarjet. Racine-i, ndonëse këto ngjarje i ka marrë nga e kaluara e largët, megjithatë ai i formëson e përpunon ato brenda një atmosfere të *subjektivitetit* të personazheve që shquajnë një epokë tjetër, dukshëm të ndryshme.

Alternativat, qartësisht të vijëzuara nga Cléophile e lëkundin dukshëm mbretin Taxil, megjithatë ende nuk e shtyjnë të marrë një qëndrim të ri politik e ushtarak. Meqë ajo e kupton se frika kryesore e Taxilit ka të bëjë me mundësinë që Axiane t'i dorëzohet Porusit, ajo e ashpëron alternativën dhe kërkon prej tij një vendim më të shpejtë: Taxili duhet të zgjedhë, sipas saj, midis situatës që të jetë « skllav i

Porusit apo mik i Aleksandrit », duke i lënë anash paqartësitë, luhatjet dhe nuancat e qëndrimeve dhe ndjenjave të tij.

Vlen të cekim këtu se çështja e *zgjedhjes* së aleatëve për luftën, e cila përgatitej dhe matja e interesave, varësisht nga zgjedhja që bëjnë aktorët politik, është çështje e mirëfilltë politike, Zgjedhja e caktuar prodhon efekte të caktuara për njërën apo tjetrën palë. Konstelacionet e aleancave në këtë dramë bëhen e zhbëhen dhe ndikohen fort nga pasionet ; në një rast, nëse Taxil-i bën aleancë me mbretin Porus dhe me mbretëreshën Axian kundër Aleksandrit kjo mund të sjell një rezultat të caktuar ; mirëpo, ky konstelacion del se ka pak gjasë të realizojë pasionin e vet ndaj Axianës. Kjo është arsyeja përse opsionin e bindjes së vet politike dhe etike, se duhet të rezistojë me mbretërit tjerë të Indisë kundër pushtuesit të huaj, ai do ta modifikojë, duke kërkuar një opsion në të cilën pasioni i tij i dashurisë do të mund të përmbushet, e njëherësh të mos e humb fytyrën e nderin. Kjo do të mund të realizohej sikur të arrinte ta bindë Axianën që të mos lidhet me Porusin e njëherësh të mos i bashkojë forcat e veta ushtarake me të kundër Aleksandrit. Taxil-i tani anon kah opsioni sipas të cilit ai duhet ta bind Axianën që ajo t'i bashkohet atij, duke bërë një marrëveshje që mund ta shpëtojë nderin e tyre si mbretër ; pikërisht për këtë arsye Cléophila është thëllësisht e interesuar që t'ia qelë rrugën dashurisë së vet ndaj Aleksandrit.⁵⁸

Në skenën e dytë, në pallatin mbretëror, zhvillohet dialogu midis Taxil-it dhe Porusit. Ky ia përshkruan disponimin e shefave të ushtrive të tyre dhe ushtarëve të cilësuar me vendosmëri e guxim për t'u përplasur me ushtrinë e Aleksandrit. Mu për këtë arsye ai shfaq mendimin se nuk kanë pse të bisedojnë me të dërguarin e Aleksandrit, Efestionin. Taxil-i ndërkaq mendon se megjithatë do ishte mirë të bisedojnë me të, pasi që « ne nuk e dimë se çfarë kërkon Aleksandri. Ai ndoshta dëshiron të na propozojë paqen. »⁵⁹

Porusi, i befasuar dhe i indinjuar i përgjigjet si do të mund ta « pranonin nga dora e tij paqen, pas gjithë atyre luftërave të tmerrshme që ishin sulme kundër « qetësisë fatlume që mbretëronte në tokat dhe shtetet tona, të cilët nuk e kishin provokuar me asgjë ». Ai shton se e kemi parë Aleksandrin « të plaçkitë provinca të tëra, ta fryjë rrjedhën e lumenjve tonë me gjakun e shtetasve tanë, dhe mu në çastin kur qielli

⁵⁸ Po aty, f.88.

⁵⁹ Po aty, f.89.

përgatitet të na e dorëzojë, a do të duhej tani të shpresojmë që një tiran të na falë ? »⁶⁰

Taxil-i i përgjigjet se nuk mund të thotë se « qielli po e braktisë atë » pasi që shumë shtete « i janë nënshtruar ligjeve të tij » dhe se nuk mund të quhet « armik të cilin e përçmojnë mbretërit ». Porusi i përgjigjet se nuk e përçmon dhe se e çmon guximin e tij dhe se « mund ta ngremë në qiell Aleksandrin; Por nëse mundem, zotëri, do ta zbritja nga ajo lartësi,

Dhe do shkoja ta sulmojë deri te altarët.

Që ia ngritin duke u dridhur vdekatarët tjerë. » Ai shton se « sikur zemra e tij të kishte përjetuar ndonjë tmerrim në Azi, Dariusi duke vdekur a do ta pranonte atë si mbret të vetin ? »⁶¹

Taxil-i i përgjigjet se « sikur Dariusi të kishte ditur ta kuptojë situatën, ai do të sundonte aty ku sundon një mbret tjetër. » Megjithatë mendjemadhësia e tij që ia shkaktoi vdekjen, e kishte një bazë që përçmimeve tuaja i mungon : asokohe vlera e Aleksandrit mezi kishte filluar të shfaqej ; « Ajo rrufe ende ishte e mbyllur brenda resë », mirëpo ishte « rrufeja, duke rënë ajo që ia hapi sytë. »

Dallimi i pozicioneve kësisoj shkon duke u thelluar ; këmbehen argumente që mprehin këto dallime. Porusi cek se « paqja mashtruese » të cilën e ofron Aleksandri ka hedhur në pranga qindra popuj të ndryshëm » dhe se « miqësia e tij shoqërohet me një skllavërim të gjatë. »⁶² Prandaj, ai mendon se alternativa që shtrohet përballë tij mund të definohet « ose skllav i tij ose armik i tij. » Kësisoj ai i bën me dije Taxil-it se nuk ka pozicion të ndërmjetëm, marrëveshje të pranueshme me Aleksandrin.⁶³

Taxil-i vazhdon ta mbrojë pozicionin e tij të matur, i cili sipas tij nuk implikon as « qyqarllëkun e as trimërinë e pamatur », ngase me disa « homazhe të kota mund të kënaqet kërkesa e Aleksandrit, aq më tepër se ai është « një furtunë që kalon dhe violenca e të cilit ushtrohet mbi gjithçka që i kundërvihet ; ai dëshiron që me rrjedhën e rrëmbyeshme, të sajuar nga mbetjet e njëqind popujve të ndryshëm ta mbushë tërë gjithësinë » ; sugjeron t'ia dorëzojnë disa të drejta, të cilat do t'i rimarrin porsa të kalojë stuhia e tij. »⁶⁴ Taxil-i definton kësisoj një

⁶⁰ Po aty, f.90.

⁶¹ Po aty

⁶² Po aty, f.90.

⁶³ Po aty, f.91.

⁶⁴ Po aty

qëndrim të mundshëm, që synon të evitohet dështimin e paevitueshëm dhe shkatërrimet e panevojshme të vendit të tyre. Ky pozicion mëton të paraqitet si realist e pragmatik, që ka parasysh fundja shpëtimin e jetëve të shtetasve të vet dhe qyteteve të tyre. Natyrisht, një motivim i fuqishëm për ta sajuar këtë qëndrim buron nga shpresa se kësisoj mund ta fitojë edhe në saje të mbështetjes së Aleksandrit, zemrën dhe dashurinë e Axianës.

Mirëpo, për Porusin është i papranueshëm e i papërfytyrueshëm nënshtrimit ndaj Aleksandrit. Taxil-i në njërën anë pranon se qëndrimi i Porusit është i denjë, por në anën tjetër shton se pas shqyrtimit të disa opsioneve ka vendosur, megjithatë, « ta shpëtoj perandorinë e vet ». ⁶⁵ Në vijim të këtij dialogu të tendosur, Taxil-i i bën vërejtje rivalit të tij se dashurinë ndaj Axianës e ka si motiv që t'i kundërvihet Aleksandrit, e jo aq atdhedashurinë. Ai shton se duke e ndjekur këtë pasion në fakt ai « e ekspozon popullin e vet dhe personin e vet » ndaj një rreziku të madh. Ai saktëson madje se Porusi në fakt udhëhiqet në këtë situatë më shumë me urrejtjen e vet se sa me dashurinë e vet. Por meqë edhe ai vet (Taxili) ka parasysh pasionin e dashurisë ndaj Axianës si motiv për qëndrimin që merr në këtë situatë, ai mëton ta bëjë një dallim midis natyrës së ndjenjës së tij dhe ndjenjës së Porusit, e cila e shtyn t'i kundërvihet Aleksandrit : « Jo, jo, mos i bëni lajka vetes, pranoni se sot Ju po veproni sipas urrejtjes që ushqeni e jo sipas dashurisë ». ⁶⁶

Porusi pranon se karshi pushtimeve dhe rrëfimeve të përhapura për guximin dhe fuqinë e Aleksandrit kishte ndier, një « krenari bujare », një « xheloz » e pastaj një « armiqtësi të fshehur » dhe dëshirë që t'i kundërvihet atij sa më parë. ⁶⁷

Në skenën e tretë Porusi bisedon me Axianën, kurse Taxil-i largohet pa e përshëndetur. Axiana e pyet Porusin përse Taxil-i i ikën pranisë së saj. Porusi i thot se ai dëshiron kësisoj ta fsheh turpin e vet para syve tuaj. Ai shton se meqë ai nuk guxon tani t'i kundërvihet rreziqeve, nuk ka guxim të ndeshet me shikimin e juaj. Porusi kësisoj dëshiron ta fundos rivalin e vet para syve të Axianës, të mos i lë asnjë shpresë në zemrën e saj. Ai shton se Taxil-i, bashkë me motrën e vet, kanë zgjedhur rrugën e nënshtrimit të skllavërisë, ⁶⁸

⁶⁵ Po aty, f.92.

⁶⁶ Po aty, f.93.

⁶⁷ Po aty

⁶⁸ Po aty, f.94.

Axiana megjithatë shfaq mendimin se është mirë që ajo, pasi që Taxil-i e adhuron, të provojë të bisedojë dhe ta bind që t'i bashkohet atyre në rezistencë, « të mos e mënjanojmë me një përbuzje të ashpër, por ta shtyjmë që ta marr një vendim të cilin ende nuk e ka marr ». Axiana, kësisoj, dëshiron të vejë në pah se qëndrimet dhe ndjenjat e Taxil-it duhet parë në mënyrë më të nuancuar. Mirëpo, ky qëndrim i pengon Porusit dhe ai tani e bën më të ashpër gjykimin e tij negativ ndaj Taxil-it, në mënyrë që të mos mbetet asnjë hezitim në zemrën dhe mendjen e Axianës ndaj tij. Porusi, madje, shpreh një shqetësim ndaj prirjes së Axianës që ta afrojë Taxil-in, ndoshta jo vetëm për kauzën e tyre politike. Ai mëton ta shtyjë Axianën të lirohet nga hezitimet e saj :

« Po si ? ju ende dyshoni ? dhe shpirti i juaj mbështetet te besimi i një dashnori tradhtar që shkel betimin, i cili do që t'ju dorëzojë në duart e tiranit të vet sot,

Dhe i cili beson, duke ju dorëzuar, t'ju fitojë nga duart e tij.

Mirë pra ! ndihmojeni që t'ju tradhtojë vet juve.

Ai mund t'ju shkëpusë nga dashuria e ime e thellë,

Por ai nuk mundet të ma marrë, me përpjekjet e tij xheloze,

Lavdinë për të luftuar dhe për të vdekur për ju. »⁶⁹

Porusi kësisoj e zhvillon deri në skajshmëri *dallimin* midis qëndrimeve dhe ndjenjave të veta dhe atyre të rivalit të vet. Në veçanti, në këto dy vargje të fundit, mund të diktojmë se në ç'mënyrë Racine-i arrin të përmbledhë në mënyrë të dendur qëndrimet e Porusit karshi sprovës që krijon Aleksandri me kërcënimet për pushtimin e vendeve të tyre dhe nënshtrimin e shtetasve të tyre ; por njëherazi edhe ndriçimin e forcës së ndjenjave që ai ushqen për Axianën. Gatishmëria për të luftuar dhe për të vdekur për të, shpreh në mënyrë të fuqishme që të dy atitudat e tij në ato momente dramatike. Edhe në këtë tragjedi sikurse edhe në disa të tjera, shfaqet kjo prirje e Racine-it për të *dendësuar* në pak vargje mprehtësinë dhe thellësinë e mendimit bashkë me imagjinaren artistike. Ky dendësim ndriçon në mënyrë më të thukët lëvizjet e ndryshimet brenda *subjektivitetit* dhe projekteve politike e ushtarake të personazheve.

Në vijim të dialogut, Axiane dëshiron t'ia largojë pak nga pak Porusit dyshimet dhe supozimet që ai i shtroi mbi zgjedhjen e raporteve të tyre të dashurisë, në njërën anë dhe të opsioneve politike e ushtarake

⁶⁹ Po aty, f.94.

në anën tjetër, ndonëse këto dalin ngushtë të gërshetuara. Ajo bën përpjekje që të mos lë vend për dyshime te Porusi se do të mund « t'ia dhuronte zemrën » përderisa ai synon « ta bëj pre të » Alexandrit. Mirëpo, Porus-i i ngarkuar me shqetësimet dhe pasigurinë që ia shkaktojnë ndjenjat e Aksianës ndaj tij, e ka hallin edhe me ndjenjat që nuk shfaqen por veprojnë brenda subjektivitetit të Axianës. Ajo thekson pastaj se Taxili ka « një shpirt të pasigurt, dhe se dashuria te ai shfaqet atëherë kur frika e cytë. » Kësisoj ajo dëshiron ta paraqes Taxilin para Porusit si një kalkulues që nuk ka ndjenja të forta. Mirëpo, kjo nuk mjafton që Porusi t'i mënjanoj dyshimet që ka ; prandaj ai i bën një pyetje Axianës që është më shumë vërejtje e cila manifeston dyshimin në vërtetësinë e pohimeve të saj : përse ajo atëherë mban lidhje me Taxil-in dhe me motrën e tij Cléophile, e cila është dashnore e Aleksandrit ?

Përballë qëndrimeve të Porusit, Axiana tani e shpalosë një qëndrim që duket pak më kompleks. Së pari ajo shpjegon se duke mbajtur lidhje me Taxil-in dhe Cleophilen, ajo don « t'i bëj ata për vete » për hir të Porusit. Ajo mendon se aleanca me Taxilin është e dobishme për qëllimin e Porusit që t'i rezistoj Aleksandrit. Mu për këtë ajo ia bën me dije Porusit se ai me qëndrimin e tij të rreptë, duke përjashtuar bashkëpunimin me Taxilin, rrezikon ta humbasë luftën e në atë rast rrjedhoja do ishte « të më dorëzoni, pa mbështetje e pa përkrahje, në duart e Taxilit, si aleat i Aleksandrit. » Kësodore, ajo don ta shtyjë Porusin që të përpiqet të gjejë një *rrugëdalje* më të përshtatshme sa për Porusinë po aq edhe për dashurinë e tyre. E kjo rrugëdalje mund të çilet nëse edhe ai përpiqet ta bindë Taxil-in që t'u bashkohet atyre. Kësisoj, lidhjet e dashurisë dalin të kushtëzuara nga kjo analitikë e opsioneve e mundësive politike që dalin përballë sfidave që ngrit stuhia pushtuese e Aleksandrit. Axiane ia bën me dije se pa aleatë ai nuk mund të ketë gjasë të fitoj luftën, e kjo do ta çonte edhe te humbja e lidhjes me Axianen.

Subjektiviteti i ndryshueshëm i personazheve karshi ngjarjeve

Porusi më në fund bindet që ta takojë të dërguarin e Aleksandrit dhe t'i dëgjojë propozimet e tij, ndonëse cek, se lufta do të jetë e pashmangshme.⁷⁰

⁷⁰ Po aty, f.95.

Në skenën e parë të aktit të dytë zhvillohet biseda e Epehstion-it (Efestioni) me Cléophilën. Ai e njofton Cléophilën, se krahas bisedave për çështje të raporteve me shtetet dhe mbretërit e Indisë, ai është dërguar nga Aleksandri i madh në një « mision sekret » shumë të rëndësishëm ku do të jetë « dëshmitar besnik i zjarrit të bukur » të zotërisë të vet. « Më lejoni t'ua shpjegojë syve që e kanë bërë të lindë ai zjarr. » Ai shpjegon se kjo është edhe arsyeja kryesore përse Aleksandri ka marrë vendimin që t'i kursej mbretërit e Indisë nga lufta dhe shkatërrimet dhe t'u ofrojë paqen. Për hir të dashurisë që ushqen ndaj Cleophile-s, saktëson ai, Aleksandri i bën këto oferta bujare.⁷¹

Cleophila në fillim shpreh habinë dhe dyshimin që një princ aq i madh, në kulmin e lavdit dhe fitoreve të tij të ketë mbajtur në kujtesë sharmin e saj, nga takimi i parë. Epehstioni mëton ta sigurojë se zotëria i tij, i kapluar nga dashuria për të, ka nxituar t'i thejë rezistencat e krahinave që e ndanin nga mbretëria e Taxilit, në oborrin e të cilit jeton Cleophila. Epehstioni ia beson asaj pasigurinë dhe dyshimet, që ka Aleksandri nëse Cleophile do t'ia hap zemrën. Ai e njofton njëherazi se meqë Aleksandri është « i mundur nga fuqia e sharmit të saj », ai ka vendosur t'i ndërpresë të gjitha operacionet ushtarake (« tmerrin e armëve të tij ») duke u ofruar paqe mbretërve të Indisë. Ai e porositë Cleophilën se kjo dhuratë e paqes është meritë e ndjenjës së dashurisë që ka për të.⁷²

Cleophila e mirëpret këtë dhuratë të dyfishtë, e megjithatë shpreh brengosjen se Porusi dhe Axiane po orvaten ta nxisin vëllain e saj Taxil-in në rezistencë. Ajo e siguron Epehstionin se Taxil-i do ta respektojë dëshirën e saj për paqe e miqësi. Epehstioni, i kënaqur me këtë përgjigje, thekson se princesha nuk duhet të brengoset për kërcënimet e Porusit, duke e këshilluar ta lë Porusin « të shkojë atje ku fatkeqësia e tij e thërret ».⁷³

Në skenën II zhvillohet dialogu midis dy mbretërve të Indisë, Porusit dhe Taxil-it me Epehstionin, të dërguarin e Aleksandrit. Që në fillim Epehstioni ua paraqet situatën në të cilën gjenden mbretërit e Indisë dhe ofertën të cilën ai ua bën :

« Para se lufta e cila rrezikon kokat e juaja
T'i bëjë shtetet e juaja toka tona të pushtuara,
Aleksandri dëshiron t'i ndalë operacionet e veta,
Dhe t'ju ofrojë paqen për herën e fundit. »

⁷¹ Po aty, f.98.

⁷² Po aty, f.98

⁷³ Po aty, f.99.

Ai i këshillon ta pranojnë ofertën e tij, pasi që nuk dëshiron « t'i mbulojë fushat e juaja me të vrrarë dhe me gjakun e juaj ». Prandaj, ai u sugjeron t'i bëjnë një homazh Aleksandrit në shenjë të respektit të vendimit të tij që të heqë dorë nga dhuna, dhe ta pranojnë mbështetjen e krahu të tij : « t'i nderoni shtetet e juaja me një mbrojtës aq të madh...ju e dini qëllimin e tij ; prandaj zgjidhni sot a dëshironit t'i humbni të gjithat apo t'i keni të gjithat prej tij. »⁷⁴

Taxil-i e merr fjalën i pari dhe e bën të qartë qëndrimin e vet ndaj ofertës së Aleksandrit : « mos besoni se ndonjë krenari barbare na shtyn të bëhemi mosmirënjohës ndaj një virtyti aq të rrallë ». Mirëpo, në vazhdim ai e ndjen të nevojshme ta nuancojë qëndrimin e vet duke theksuar « se popujt e Indisë janë të guximshëm dhe nuk pranojnë lehtëzi të bëhen skllav ». Ai shton se madje, edhe popujt që Aleksandri i ka nënshtruar « i mbajnë sytë vazhdimisht të hapur » duke pritur rastin të çlirohen, prandaj mendon se do ishte mirë sikur pushtuesi i madh të kërkonte t'i bëjë miq.⁷⁵

Ndërkaq fjala e Porusit karshi Ephestionit është megjithatë më pak ambivalente : në njërin anë ai shfaq shpresën se të gjithë mbretërit e Indisë do t'i kundërvihen pushtimit, por njëherësh shpreh keqardhjen që njeri prej tyre « duke i bërë lajka dorës, e cila na kërcënon, kërkon një vend të padenjë midis aleatëve të tij. » Mu për këtë arsye ai e ndjen veten edhe më shumë të obliguar që ndryshe nga Taxili « që po tradhton, » t'i bëjë ballë pushtimit me armë në dorë. Në vazhdim ai shpalos edhe kritika të thukëta ndaj operacioneve pushtuese të tokave të huaja të Aleksandrit të madh :

« Çka ka ardhur të kërkojë mbreti, i cili ju ka dërguar ?

Cila është ajo ndihmë e madhe që krahu i tij do të na ofrojë ?

Me çfarë fytyre ai merr guximin të marr në mbrojtjen e vet

Popujt që nuk kanë asnjë armik tjetër veç vet atij ?[...]A do të duhej që aq shumë shtete , shkretëtira, lumenj,

Të bëhen midis neve dhe tij bariera të pafuqishme ?

Dhe a nuk do të mund të jetonim në këtë skaj të botës

Pa e njohur emrin e tij dhe peshën e prangave të tij ?

Çfarë vlere të çuditshme ka ai, kur nuk kërkon asgjë tjetër veçse të bëjë dëm,

⁷⁴ Po aty, f.100.

⁷⁵ Po aty, f.101-102.

Të kallë gjithçka porsa fillon të zbardh agimi ;
 Që si rregull dhe arsye s'ka tjetër veç mendjemadhësinë ;
 Mbret i cili do që universi të mos jetë tjetër veç një burg,
 Dhe si zotri absolut i të gjithë neve sa jemi,
 Ai do që të gjithë njerëzit të bëhen skllëvër të tij! »⁷⁶

Porusi nxjerr në shesh këtu, veç tjerash, pretendimin demagogjik të Aleksandrit që t'i marrë në mbrojtje popujt të cilët i sulmon dhe i nënshtron ; thuajse këta nuk do të mund të jetonin « pa e njohur emrin e tij dhe peshën e prangave të tij ». Ndryshe nga ata që e shohin « madhëstsinë » e Aleksandrit në pushtimet e tij të pafundme, ai e paraqet aspiratën e tij si vullnet që « universi të mos jetë tjetër veçse një burg. »

Këto përshkrime e vlerësime të synimeve të Aleksandrit, që i drejtohen këshilltarit të tij, me imazhe e shprehje të fuqishme, nuk janë thjesht lamentime e kritika, ngase shoqërohen me vendosmërinë e Porusit që t'i kundërvihet pushtuesit të madh.

Ephestioni, në përgjigjen e tij, çmon guximin e Porusit por thekson në veçanti kotësinë e kësaj gatishmërie që t'i rezistojë Aleksandrit, e njëherazi shfaq një ndjenjë mëshire për të, duke dashur t'i sugjerojë se çka e pret në këtë ballafaqim.⁷⁷

Porusi, i bën me dije se rezultati i mundshëm nuk e impresionon ngase synon « lavdinë si e vetmja e mirë. »

Pas një bisede të shkurtë me Taxilin, në të cilën nuk arrin ta bind që t'i bashkohet rezistencës kundër Aleksandrit, Axiane e njofton Porusin se tanimë nuk ka dyshim se ai na ka tradhtuar duke ia sakrifikuar motrës së vet nderin dhe vendin e vet. Ajo shton po kështu se Taxil-i shpreson se Porusi do të mbaroj në luftë kundër Aleksandrit. Axiane, megjithatë ia tërheq vërejtjen Porusit, se do ta ketë shumë vështirë me trupat ushtarake që i ka, të luftojë kundër ushtrisë shumë të fuqishme të Aleksandrit.

Porusi i përgjigjet se shtytja e fortë që e nxitë të luftojë kundër Aleksandrit është dashuria që ka për Axianën, se ai dëshiron ta pushtojë dashurinë e saj, duke luftuar dhe pavarësisht se do të vdesë apo të jetojë,

⁷⁶ Po aty, f.102-103.

⁷⁷ Po aty, f.103.

me rëndësi për të është të di se ajo e do. Axiana i thot se zemra e saj nuk ka si t'i rezistojë Porusit.⁷⁸

Kësodore, Racine me lirikën e vet shpalosë lidhjen midis *pasionit* të fuqishëm të dashurisë së Porusit për Axianën me qëmtimet politike dhe bindjen e tij morale se duhet t'i kundërvihet operacionit pushtues ndaj Aleksandrit ndaj vendit të tij. Pasioni i dashurisë gërshetohet këtu me vullnetin që të luftojë deri në fund për lirinë e vendit dhe popullit të vet, duke e vërë jetën e vet në rrezik. Në skenën e parë të Aktit III, Axiana i ankohet Cléophiles pse Taxil-i e ka mbyllur në pallatin e tij, duke e penguar të udhëheqë ushtrinë e saj në fushëbetejë, ku Porusi tanimë zhvillonte luftimet. Këtë situatë ajo e përshkruan kështu: « Ky adhures i përvuajtur tani del si zotëria im !

Dhe dashuria e tij, e lodhur nga ftohtësia e saj,

E burgos personin tim pas nuk mundi ta zotëroj zemrën time ! »⁷⁹

Cleophila përpiket ta shpjegoj ndryshe këtë situatë. Ajo cekë se Taxili, i kapluar nga dashuria ndaj saj, e strehoi në këtë pallat pse ishte i brengosur për sigurinë e saj në këto rrethana të ngarkuara me konflikte të rënda, ku ballafaqohen dy armata të fuqishme.

Mirëpo, Axiana përgjigjet me rrëmbim se siguria në të cilën e kanë mbyllur është një fyerje për të, derisa luftëtarët e saj dhe ata të Porusit vdesin duke luftuar

Në Skenën II, kësaj bisede i bashkohet Taxil- i. Ai e njofton Axianën për rrjedhën e luftimeve dhe disfatën e ushtrisë së saj dhe të ushtrisë së Porusit përballë armatës së Aleksandrit. E informon edhe për vdekjen e Porusit. Ai shton se më kotë është orvatur ta bind Porusin që të evitojë këtë luftë dhe të pranojë ofertën e Aleksandrit për paqe.

Axiana e mllëfosur dhe e dëshpëruar me qëndrimin servil të Taksil-it ndaj Aleksandrit e largon me përbuzje : « Ik, ti i shërben shumë mirë zotërisë tënd për të cilin motra jote të lidhi.

Përfundoje planin tënd dhe bën prej meje atë që urrejtja jote të urdhëron,... ».⁸⁰

Në përgjigjen e vet Taxili sugjeron se ajo nuk rrezikon as kërcënime e as pranga nga Aleksandri dhe se ai do të tregohet bujar ndaj saj. Derisa Porusi e lidhë vendimin e tij për ta luftuar Aleksandrin me dëshirën që ta pushtoj dashurinë e Axianës, Taxili ndërkaq me

⁷⁸ Po aty, f.108.

⁷⁹ Po aty, f.108.

⁸⁰ Po aty, f.111.

qëndrimin e vet që të bëjë paqë me Aleksandrin shpreson që t'ia shpëtoj jetën Axianës, ndonëse kjo i ishte bashkuar ushtrisë së Porusit për ta luftuar Aleksandrin.

Axiana e irrituar me këto fjalë të Taxil-it, pyet : « si mund të bëhet skeptri im në duart e mia dhuratë e një armiku ?

Dhe çfarë kuptim ka që të më vendosë në fronin tim i njëjti tiran që më largoi nga ai ? »⁸¹

Taxil-i ia kujton se gruaja dhe nëna e Dariusit, mbretit të Persisë, pas disfatës së tij, e respektojnë Aleksandrin për bujarinë e tij.

Mirëpo Axiane i bën me dije se ajo nuk do të pranojë një rol të tillë, ; se nuk do ta shoqërojë pushtuesin e saj, në vende të ndryshme të botës : « T'i bëjë lavdërimi gjithkrah, butësisë së prangave të tij ? »

Ajo pastaj shpreh dëshirën që Taxil-i për tradhtinë e tij të ndëshkohet, e jo të shpërblehet, siç ka ndodhur edhe më parë, nga pushtuesi, të cilit i ka shërbyer.⁸²

Bërja çështje e madhësisë së Aleksandrit

Skena VI, është skenë dialogut midis Aleksandrit dhe Cleophiles. Skenë ku, « perandori i gjithësisë » siç e quanin asokohe, « i afrohet, i ndrojtur, sharmit hyjnor » të Cleophiles ; kësaj ia përkujton se frytet e fitores së tij ia jep vëllait të saj, Taxilit që ta pushtoj zemrën e Axianës, por tani shpreson se ajo do ta mbaj premtimin që ia kishte bërë më parë, për t'ia ofruar atij zemrën e saj.

Cleophila pranon se është magjepsur me « shkëlqimin e virtyteve të tij, me fuqinë e tij pushtuese, së cilës iu nënshtruan shumë popuj ». Mirëpo, krahas ndjenjave që ushqen për Aleksandrin ajo ka frikë se, pasi t'ia jap zemrën-dashurinë e saj, ai shumë shpejt do të mund ta braktisë, i kapluar me synime për pushtime të tjera.

Aleksandri në përgjigjen e tij, i bën me dije Cleophiles se ajo nuk i njehë « dëshirat violente të dashurisë së tij ndaj saj ». Se më parë, gjatë pushtimit të Persisë, përballë femrave të bukura të atij vendi që i dolën para syve të tij, zemra e tij qëndroi me një « përbuzje krenare ndaj sharmit » të femrave të bukura të atij vendi.⁸³ Ndërkaq, sytë e Cleophiles ai i përshkruan si « tiranë të dashur që kanë prodhuar mbi zemrën tij

⁸¹ Po aty, f.112.

⁸² Po aty, f.112.

⁸³ Po aty, f.116.

rrjedhoja krejt tjera. » Ai i sugjeron të mos dyshoj më në fuqinë pushtuese të syve të saj, sy që janë « si nyje të bukura në të cilat ju më mbani »⁸⁴.

Në vazhdim ai ia shpalosë Cléophiles disa premtime :

« Do të shihni, me dëshmi krejt të reja do t'ju tregoj,
Se sa mundet të arrijë dashuria në zemrën e Aleksandrit.

Tani kur krahu im, do të drejtohet prej jush,

Duhet ta mbështesë emrin tim dhe tuajin njëherazi,

Do të shkoj t'i bëjë të famshëm me shkëlqimin e luftës,

Popuj të panjohur për pjesën tjetër të botës,

Dhe do të ngre për juve altar në vende

Ku duart e tyre të egra refuzojnë t'u ngrenë zotave. »

Mirëpo, ky vizion për « shkëlqimin e luftës » dhe për « ngritjen e altarëve », qofshin edhe për nder të saj, jo vetëm që nuk del mbresëlënëse e ngashnjyese për Cleophilen, por madje i nxitë dyshime e frikë të reja :

« Po, ju do ta tërhiqni pas vetes fitoren e zaptuar ;

Por dyshoj zotëri se dashuria do t'ju përcjellë në atë rrugëtim.

Aq shumë shtete, aq shumë dete, të cilat do të na ndajnë,

Do të më fshijnë nga kujtesa e juaj. »

Ajo e vë në dyshim premtimin se Aleksandri do të ushqejë dashuri për Cleophilen në udhëtimin e tij të stuhishëm, nëpër shumë shtete e dete ; meqë këto do të krijojnë doemos një *largësi*, jo vetëm gjeografike, midis tyre. Ajo mendon se jo vetëm largësia, por vet kaplimi i thellë i Aleksandri brenda një cikli të pandërprerë të pushtimeve të tokave të reja, do të bëjë që në shpirtin e tij nuk do të ketë më vend për ndjenjat e tij ndaj Cléophiles. Duke shtuar se shumësia e shteteve dhe deteve të pushtuara do të arrijnë ta fshijnë edhe nga kujtesa e tij imazhin e saj.

Cléophila më tutje vijëzon përfytyrime mbi hapësirat brenda, të cilave do të lëviz Aleksandri, që do ta shtyjnë ta harrojë Cléophilen :

« Kur Oqeani i turbulluar duke ju bartur mbi valën e vet,

Do t'ju shoh se si do t'i jepni fund pushtimit të botës,

Kur do të shihni se si mbretërit të bien para jush në gjunjë,

⁸⁴ Po aty, f.116-117.

Dhe se si bota, duke u dridhur do ta mbyll gojën para jush,... »⁸⁵

Ky vizion e bën çështje vet *kuptimin* e *stihisë* së sulmeve të Aleksandrit, kuptimin e dëshirave që të pushtojë përherë toka të reja dhe popuj të tjerë. Pyetja implicite në këto vargje pyet se si ndodhi fundja, me përfundimin e pushtimit të botës : mbretërit e atyre vendeve të pushtuara do të bien në gjunjë para Aleksandrit. Kurorëzimi i operacioneve pushtuese të tij sikur përhitet para syve të të gjithëve : Aleksandrit, popujve të nënshtruar dhe Cleofiles që soditë nga larg se si « bota, duke u dridhur do ta mbyll gojën » para pushtuesit të madh. Ajo dyshon nëse në mendjen dhe imagjinaren e Aleksandrit do të mbetet ndonjë termi nga çastet e lumtura të dashurisë së tyre ose nga vuajtjet e saj nën presionin e largësisë së madhe midis tyre.

Aleksandri, duke dashur ta lëkundë supozimin se a mund ta harrojë Cléophilën, e njofton se ai dëshiron ta bëjë atë mbretëreshë të gjithë Azisë. Edhe kjo përgjigje e Aleksandrit tregon dallimin e të kuptuarit të lumturisë midis tyre. Etja e pashuar për pushtime gjithherë të reja sikur fshin gjurmët e shpresave të Cléophila për një hapësirë për dashuri të mirëfilltë.⁸⁶

Edhe në skenën e parë të aktit V, Cléophila sërish shprehë bindjen se vrapimi i Aleksandrit nga një luftë te tjetra, nga një pushtim te tjetri, nuk ka fort kuptim, se ajo nuk e ka të qartë se çfarë konfirmimi të vetes ai kërkon brenda ndërmarrjeve të tij pushtuese :

« E çfarë kërkon Zotëri, nga lufta në luftë, vetëm qenie të nënshtruara edhe përtej Tokës ?

A po kërkon dëshmitarë për pushtimet e juaja të shkëlqyeshme,
Vende të panjohura edhe për vet banorët e tyre. »⁸⁷

Kotësinë e aspiratës së Aleksandrit për pushtime të pandërprera ajo e vë në pah me një paradoks edhe me formulimin se kërkon « dëshmitarë » madje edhe në « vende të panjohura edhe për vet banorët e tyre » ; pra, aty ku nuk mund të gjejë më dëshmitarë.

Ajo e formulon edhe një pyetje tjetër të rëndësishme, të cilën e zhvillon me përsiatje të tjera : « Çka po shpresoni të luftoni në ato vende me klimë aq të ashpra ?

Ato do t'ju kundërvënë vetmi të paskajshme,
Shkretëtira të cilat qielli refuzon t'i ndriçojë,

⁸⁵ Po aty, f.117.

⁸⁶ Po aty, f.117.

⁸⁷ Po aty, f.131.

Aty ku natyra duket se shuhet. »

Cléophile madje e ballafaqon Alexandrin me përfytyrimin se në ato humbëtira edhe varri i tij mund të sharrojë dhe të gllabërohet nga harresa.

Në skenat e fundit të kësaj tragjedie, në ndërkohë arrijnë lajme se gjatë luftimeve Porusi e ka mposhtur Taxil-in dhe ushtrinë tij dhe se e ka vrarë në një dyluftim.

Në skenën VII Aleksandri e urdhëron Efestionin ta gjejë Porusin, « atë luftëtarin trim » dhe t'ia falin e jetën atij dhe e ushtarëve të tij. Aleksandri shfaq respekt për guximin dhe dinjitetin që ka dëshmuar Porusi duke luftuar kundër tij.

Në fund, ai vendos ta autorizojë Porusin që të qeverisë mbi mbretërinë e vet, sikurse edhe Cléophilen mbi mbretërinë e vëllait të saj. Porusi shfaq respekt për virtytin që dëshmon Aleksandri kësisoj ndaj tyre.

Të përkujtojmë se projekti i Aleksandrit ishte që ta mbështesë lidhjen e Taxil-it me Axianën, në mënyrë që të kënaqë dëshirën e Cleophiles, motrës së Taxil-it. Projekti i tij politiko-ushtarak në Indi ishte kësodore i gërshetuar me pasionin e tij për Cleophilen. Mirëpo, pas *ndryshimeve* që ndodhën në fushëbetejë, në veçanti raporti i forcave midis Taxil-it dhe Porusit, si rezultat i të cilit ishte edhe vrasja e Taxil-it nga Porusi, Aleksandri ndryshon edhe qëndrimet e veta ndaj këtyre personazheve. Guximi dhe vendosmëria e Porusit që t'i kundërvihet Aleksandrit, duke dashur ta mbrojë vendin dhe popullin e vet do të zgjojë respekt te Aleksandri. Pasi ky merr vendimin që të pranojë Porusin dhe Axianën si mbretër në mbretëritë e tyre, në vend se t'i ndëshkojë ata dhe ta nënshtrojë popullin e tyre. Ndërkaq Porusi pranon virtytin e Aleksandrit me këto fjalë :

« Po dorëzohem. Ju pranoj fitoren e plotë,

Virtytet e juaja, po pranoj, janë të barabarta me famën që keni. »⁸⁸

Në këto rrethana shpërfaqet *dimensioni sa politik aq edhe etik i pranimit reciprok* midis një perandori dhe mbretërve të Indisë, të cilën e kishte pushtuar por vendos t'ua lë atyre që ta qeverisin vet. Ky konstelacion i raporteve e ka edhe dimensionin e pasionit të fortë të Aleksandrit për Cléophilen dhe pa këtë pasion vështirë mund të kuptohen vendimet e Aleksandrit. Në vendimet e veta Aleksandri, pas vrasjes së Taxil-it, e respekton edhe pasionin e Porusit për Axianën.

⁸⁸ Po aty, f.139.

Në Parathënien e dytë të kësaj tragjedie, Racine thekson se aty më shumë se te tragjeditë e tjera, i kishte marrë parasysh të dhënat historike, veçanërisht ato të historianëve të shquar : Quintus Curtius Rufus, Justinus, Plutarku, Diodori i Sicilisë.

Në këtë tragjedi zhvillohen refleksione të thella filozofike mbi personazhe të ndryshme, në situata shumë të ndërlikuara historiko-politike, situata edhe të skajshme me luftëra e konfrontime të pasioneve. Brenda këtyre situatave autori ndriçon shtytësit dhe motivet e veprimeve të personazheve, nxjerr në shesh anë të ndryshme të subjektivitetit të tyre ku vijëzohen aspekte të ndryshme të « natyrës » së njeriut : nëpërmjet fjalëve, refleksioneve e përplasjeve të pasioneve.

Nëse i marrim parasysh disa nga shqyrtimet në hyrje të këtij artikulli nuk hetohet ndonjë ndikim i teorive neo-augustiniane e janseniste për mallkimin e njeriut me një trashëgimi të mëkatit burimor adamik. Veprimet e personazheve Racine-i nuk i shpjegojnë këtu as me një bërthamë *a priori* « të mirë » e as « të keqe » që do ishin inherente në natyrën e njeriut. Ato shpalosin anë të ndryshme e të ndryshueshme të tipareve dhe prirjeve të personazheve, sipas situatave ushtarako-politike dhe lëvizjeve brenda subjektivitetit të tyre ; këto sfidohen nga ngjarjeve dramatike. Racine-i i njëjtte mirë konceptonet filozofike të Shën-Augustinit. Mendoj se ai e ka çmuar dhe ka përvetësuar prej tij në veçanti teorinë e thellë mbi *kohësinë* brenda së cilës zhvillohet jeta e njeriut. Është fjala për kohësinë si *dimension* brenda të së cilës shpaloset subjektiviteti i tij, pasionet dhe mendimet, synimet dhe ëndrrat e tij. Edhe Heideggeri, edhe Jaspersi e Arendt, në shekullin XX e vlerësonin lart Shën-Augustinin si mendimtarin e parë të kohës dhe të kohësisë, të karakterit historik të *përvojës* njerëzore.

Leximi i tragjedive të Racine-it na bën të mundur të diktojmë aty jo mallkimin por begatinë e thellë të subjektivitetit të njeriut, i cili shpërfaqet brenda *rrëmujs* dhe sprovës së ngjarjeve sa të përditshme aq edhe historike, por gjithherë në horizontin e kohësisë.

Résumé

Dans la première partie de cet article nous avons croisé plusieurs interprétations des critiques littéraires français (Rohou, Sellier, Starobinski) des rapports qui se nouent dans les tragédies de Racine entre la passion d'amour, la subjectivité et le pouvoir politique. Ainsi, nous avons problématisé l'interprétation de Jean Rohou qui définit le tragique racinien comme une version particulière de l'anthropologie augustinienne à l'appui de

la lecture de Philippe Sellier, notamment. Nous avons essayé de montrer que dans plusieurs tragédies les actions des personnages ne sont pas expliquées par leur nature inhérente bonne ou mauvaise, ni par le péché originel. Racine déploie et éclaire dans ces tragédies les caractères des personnages à travers leurs implications dans des situations complexes politiques et dans leurs rivalités de passion.

Nous nous sommes penché également sur les analyses de Jean Starobinski sur la subjectivité du regard et la naissance de la passion chez Racine notamment dans son ouvrage *L'œil vivant*. Le regard racinien tend à saisir l'essence des êtres ainsi que celle du monde, les couples jour-nuit, l'ombre et la lumière, tandis que la réalité cosmique s'humanise par des symboles éthiques. Les échanges des regards entre les amoureux deviennent un « événement originel » à partir duquel démarre l'action qui se joue sur la scène.

Starobinski montre que le regard qui questionne, dans les tragédies de Racine, est portée par une double finalité : il tend à saisir la vérité et en même temps à posséder l'être aimé par le biais de l'amour.

Nous avons examiné également les analyses du philosophe japonais Mariaki Watanabe, qui portent sur les similitudes entre l'écriture de Michel Foucault et celles de Racine sur les conflits des passions dans les grands événements historiques.

Dans l'analyse de la tragédie *Alexandre* nous avons mis en exergue notamment la mise en question par Cléophile de la course éperdue du grand conquérant vers des nouvelles conquêtes à partir d'un horizon de la passion de l'amour.

Mots clés: La passion de l'amour, l'augustinisme, le tragique racinien, la subjectivité, le pouvoir politique, le regard du regard, l'ambition des conquêtes.

Muhamet Hamiti, Prishtinë

SHKRIMTARI PËRKTHYES / PËRKTHYESI SHKRIMTAR

Abstrakt

Ky studim rroket me relacionet e letërsisë me përkthimin, të shkrimtarit me përkthyesin, më tej me dukurinë e shkrimtarit përkthyes e të përkthyesit shkrimtar, po ashtu me vetëpërkthyesin, duke marrë në shqyrtim shkrimtarë e përkthyes nga Evropa e Amerika, ndonëse rrezatimi kulturor është parësisht evropian, madje edhe kur përthyer me praktika letrare orientale. Në thelb të këtij shkrimi është kërkimi në fushë të përkthimit si praktikë letrare e motivuar nga qëllime estetike; përkthimi si aktivitet shkrimor; përkthimi si përthyerje e dy sistemeve kulturore. Arti dhe mjeshtëria e përkthimit. Po ashtu edhe relacioni problematik ndërmjet origjinalit dhe përkthimit; statuset e tyre të ndërrueshme. Teoritë dhe praktikat krijuese të shkrimtarëve përkthyes Charles Baudelaire, Marcel Proust, Ezra Pound, James Joyce, Jorge Luis Borges, Samuel Beckett, Octavio Paz, Milan Kundera, Seamus Heaney, dhe ndonjë tjetri, do të jenë objekt shqyrtimi në këtë studim që, mbasi trajton një fenomen me rrezatime të gjera, duke dashur të kapë esencat, merr pamjen që ka, të rrishtave të mëdha apo të vogla të një realiteti më të madh krijues.

Fjalë kyçe: letërsia, origjinali, përkthimi, shkrimtari përkthyes, shkrimtari vetëpërkthyes

Hyrje

Përkthimi është praktikë letrare esenciale për letërsinë botërore, po edhe për konstituimin e kulturave dhe të letërsive kombëtare.

Përkthyesit janë krijues në mënyrën e vet, baras dhe në partneritet me autorin e përkthyer, thotë Mark Polizzotti, poet, përkthyes e përkthimolog, me të cilin nuk pajtohen të gjithë.¹

Shumica e shkrimtarëve e shohin punën e përkthimit me besim. Ndonjëri syresh, si Milan Kundera, me mosbesim.

Pa dashur të përkufizoj përkthimin – se përkufizime ka shumë, mbi kritere të ndryshme, nganjëherë nga pikëshikime personale – le të përkujtohet se përkthimi në anglisht (nga emri në latinisht ‘translatio’, prej foljes “*transferre*” burimisht e ka kuptimin ‘carry across’, me bartë

tutje. Në gjuhët romane nga folja “*traducere*”, po ashtu me bartë, me çue tutje.

Historia e përkthimit është përdegëzuar në dy rrugë, njëra prej Shën Augustinit (Aurelius Augustinus, 354-430 të erës sonë), që kërkonte t’i përmbahej origjinalit në mënyrë strikte, tjetra prej Shën Jeronimit [Eusebius Hieronymus, 347- 420], që besonte në përshtatje dhe deri dikund invencion për ta dëftuar kuptimin në mënyrë efikase. Qasja e këtij të fundit realizohet te përkthimi i tij i Biblës (Vulgata).

Molla, të cilën Eva ia kishte dhënë Adamit mund të kishte qenë dardhë, apo pjeshkë, por Jeronimi kishte pëlqyer lojën e fjalëve *malus/malum* (mollë /i, e ligë) në latinisht, duke e kthyer Pemën e Dijes dhe të së Mirës dhe të së Ligës (*malum*) në pemën e mollëve (*malus*), shkruan Mark Polizzotti, përkthyes i njohur, autor i një libri polemik për përkthimin të botuar së voni.¹

Shën Jeronimi e përktheu Biblën nga hebraishtja dhe aramaishtja, duke e anashkaluar greqishten. “Nëse përkthej fjalë për fjalë, [teksti] tingëllon absurd; në qoftë se nga nevoja ndryshoj diçka në rendin e fjalëve apo në gjuhë, del se po heq dorë nga përgjegjësia e përkthyesit...” ka shkruar Shën Jeronimi në parathënien e Kronikave të Eusebiusit (Polizzotti, 20; po ashtu fusnota 3, 156).

Shën Jeronimi kishte ndjekur linjën e Horacit, që u kërkonte përkthyesve të mos përkthenin fjalë për fjalë.

Shën Augustini e kishte qortuar Jeronimin pse ishte larguar nga orthodoksia religjioze. Jeronimi i ishte qasur përkthimit me veshin e poetit, ndërsa Augustini me syrin e burokratit sypetrit (Polizzotti, 21).

Bibla e Mbretit Xhejms (The King James Bible), Versioni i Autorizuar (Authorized Version, shpesh shkurtimisht AV) i përkthimit në anglisht nga fillimi i shekullit XVI, është i bukur në rrafsh stilistik, në mënyrën e Jeronimit, dhe “mjaftueshëm autoritativ për ta bashkuar Kishën nën një tekst uniform”, siç kishte udhëzuar Shën Augustini, (Polizzotti, 23).

Bibla pothuaj gjithherë lexohet në përkthim, mbasi në fakt nuk ka origjinal të vërtetë të saj. Teksti burimor i saj është një “palimpsest i versioneve në hebraisht, në aramaisht dhe në greqisht” (Polizzoti, 26).

Historia e Biblës, në anglisht, ta zëmë dëshmon se si përkthimi bëhet vepra e njëmendët, e veshur me aurën e origjinalit. I tillë është Versioni i Autorizuar tash e 400 vjet që, përveç si libër kanonik fetar, ka ushqyer fuqishëm letërsinë angleze dhe shijohet si letërsi në botën anglishtfolëse.

Modeli instrumentalist dhe modeli hermeneutik: Polizzoti dhe Venuti

Në dy librat problematizues e polemikë për përkthimin, të Mark Polizzotti-it dhe Lawrence Venuti-t¹, përvijohen dy koncepte të përkthimit, njëri instrumentalist, që e përfaqon i pari, dhe tjetri hermeneutik, që e përfaqon i dyti. Venuti del kodifikues më i fortë, edhe i instrumentalizmit të Polizzotti-it.

Modeli hermeneutik e koncepton përkthimin si akt interpretimi që pashmangshëm e varion formën, kuptimin dhe efektin e tekstit burimor simbas kuptueshmërive (*intelligibilities*) dhe interesave në kulturën mbërritëse (Venuti, 1).

Modeli hermeneutik i Venuti-t mbështetet pjesërisht në teorinë semiotike të Charles Peirce-it dhe të Umberto Eco-s, simbas të cilëve përkthyesi e kthen tekstin burimor në përkthim duke aplikuar interpretantët, faktorë formalë (koncepti i barasvlerës dhe koncepti i stilit) dhe tematikë (një ideologji në kuptim të një tërësie vlerash, besimesh të një grupi social) [Venuti, 2].

Venuti është kundër instrumentalizmit që e thjeshton praktikën e përkthimit duke ushqyer iluzion të qasjes së drejtpërdrejtë në tekstin burimor.

Modeli hermeneutik është shfaqur së pari në gjirin e poetëve romantikë, e kritikëve dhe përkthyesve si Goethe dhe vëllezërit Schlegel, i nënshtrohet shqyrtimit filozofik të Friedrich Schleiermacher-it dhe është riformuluar në fund nga mendimtarë si Martin Heidegger dhe Jacques Derrida në shek XX (Venuti, 6).

Modeli instrumental, që e përkufizon përkthimin si riprodhim të një teksti burimor invariant, çon te 'efekti ekuivalent' (barasvlerës) i përkthimologut Eugene Nida.

Modeli hermeneutik e sheh përkthimin si akt interpretimi që e varion tekstin burimor; e gjeneron konceptin e ndërmjetësimit, domethanë, se dallimet gjuhësore dhe kulturore që e konstitudojnë atë tekst nuk janë të qasshme drejtpërdrejt në përkthim por ripunohen për t'u kuptuar në kulturën në të cilën përkthehet. Më tej, ky ndërmjetësim gjeneron strategji që mëton të regjistrojë ose të shënjojë huajësinë (*foreignness*) e tekstit burimor (Venuti, 8-9).

Modeli hermeneutik, siç e koncepton Venuti, e sheh përkthimin si interpretim thelbësisht të ndryshueshëm, ndonëse përfshin edhe koncepte të barasvlerës semantike dhe të përafrimit stilistik (Venuti, 39).

Lawrence Venuti, profesor dhe përkthyes, e kundërshton idenë e rrjedhshmërisë në përkthim. Ai me qasjen e vet do të theksojë huajësinë (foreignness) e tekstit të huaj.

“Përkthimi është në thelb proces dekontekstualizues” thotë Venuti duke theksuar humbjet e shumëfishta të kontekstit në çdo përkthim. Përkthimi është radikalisht transformativ, mbasi që teksti i huaj jo vetëm që dekontekstualizohet, por edhe rikontekstualizohet. (Venuti, 158-162).

Paradokset e përkthyeshmërisë dhe origjinalit: Pound, Borges, Derrida dhe Kundera

“Rien n’est intraduisible en un sens, mais *en un autre sens* tout est intraduisible, la traduction est un autre nom de l’impossible” (Në një kuptim asgjë nuk është e papërkthyeshme, mirëpo në një kuptim tjetër çdo gjë është e papërkthyeshme; përkthimi është emër tjetër për të pamundshmen), ka thënë filozofi francez, dekonstrukcionista Jacques Derrida.¹ Në një tekst tjetër, me të njëjtën lojë paradoksale, Derrida thoshte: “Ç’është e vërteta, nuk besoj se çkado mund të jetë ndonjëherë e papërkthyeshme, apo, për më shumë, e përkthyeshme.”¹

Poeti amerikan Robert Frost e ka parë poezinë efektivisht të papërkthyeshme, siç do të shohim.

Rubairat e Khajamit në përkthimin e Edward Fitzgerald-it, “një poezi angleze me aluzione persiane”, thotë Borges-i, duke ua atribuar këtë “disa kritikëve”.¹ Duke medituuar për marrëdhënien e anglezit me persianin, Borges-i thotë së kjo është dëshmi se bashkëpunimi është misterioz, sepse “vdekja dhe peripecitë dhe koha bënë që njëri ta njihje tjetrin dhe t’i bënte të dytë një poet të vetëm”.¹

Rubairat e Khajamit në përkthimin shqip të Fan S. Nolit nga përkthimi i Fitzgeraldit, që ka marrë aurën pothuaj të origjinalit, e ka bërë edhe Nolin poet njësh me Fitzgerald-in në shqip, do të mund të thoshim me këtë logjikë paradoksale të Borges-it.

“Ndërsa fjalët e poetit qëndrojnë në gjuhën e tij, edhe përkthimi më i mirë është i destinuar të bëhet pjesë e zhvillimit të gjuhës së vet dhe në

fund të përthithet nga përtëritja e saj”, thoshte Walter Benjamin te shkrimi i tij i përmendur “Roli i përkthyesit” (Polizzoti, 84).

Çeku Milan Kundera e ka parë gjithë procesin e përkthimit me mosbesim; te libri i tij *Testamente të tradhtuara* bën autopsinë e gabimeve të përkthyesve të Kafkës në frëngjisht. Kundera angazhohet thjesht për qasjen e përkthimit fjalë për fjalë.

Mbasi jetoi me vite në Francë dhe zotëroi frëngjishten, Kundera e la çekishten dhe nisi të shkruante veprat e veta në frëngjisht nga mesi i viteve tetëdhjetë të shekullit XX. Në këto vite ai rishikoi të gjitha përkthimet e romaneve të veta në frëngjisht, që i kishte shkruar në çekisht, dhe i shpalli këto versione përfundimtare, autentike të romaneve të veta. Përkthimet u bënë origjinalet e tij. Më vonë, për të bërë versionet e reja çeke, ai përdori tre origjinale: dorëshkrimin në çekisht, versionet e para çeke të botuara (në Toronto, Kanada) dhe përkthimet definitive në frëngjisht. Nuk ka “version origjinal” të veprës së Kunderës në kuptim tradicional të termit.¹

Ezra Pound ka përkthyer poezi nga letërsitë klasike dhe mesjetare. Versionet e Ezra Pound-it të poezive klasike kineze, botuar te përmbledhja e tij *Cathay* (1915), përbëjnë përpjekje të kontestueshme të krijimit të ri prej të vjetrit. Simbas nëntitullit, përmbledhja është përshtatur “në pjesën më të madhe nga kinezishtja e Riahku-t [Li Po], nga shënimet e të ndjerit Ernest Fenollosa, dhe deshifrimet e profesorëve Mori dhe Ariga”. Në një parathënie të *Poezive të zgjedhura* (1928) të Ezra Pound-it, T. S. Eliot e quajti Pound-in “shpikësin e poezisë kineze për kohën tonë”. Më tej, “secili brez duhet të përkthejë për vete”, konstatonte Eliot. Përkthimi duhet të ribëhet çdo 25 vjet, ka thënë Roland Barthes në ligjëratat e tij për haikun.¹

Janë tri risi që kishte sjellë Pound-i: kishte hedhur poshtë diksionin “pseudo-arkaik” të përkthimit nga viktorianët; secilin përkthim e shihte në njëfarë dore kritikë të poezisë në origjinal; i shihte përkthimet e mira si poezi të reja më vete.¹

Chapman-i është më shumë Chapman sesa Homer, ka thënë T. S. Eliot-i, duke iu referuar përkthyesit të *Iliadës* dhe *Odisesë* së Homerit. George Chapman ishte dramatisht, poet dhe përkthyes, po ashtu dijetar klasik, në shekujt XVI-XVII. Po kjo thuhet për punën përkthimore të Alexander Pope-it, neoklasikut anglez të fillimshekullit XVIII, i cili qe bërë i famshëm për përkthimin e Homerit: se është më shumë Pope sesa Homer.

Poeti romantik anglez John Keats përjetësoi njëfarësoj epifanie të veten në një sonet të titulluar “On first looking into Chapman’s Homer” (Kur ia lëshova sytë Homerit të Chapman-it) mbasi kishte lexuar Homerin në përkthim të Chapman-it.

Charles Baudelaire përkthyes i Edgar Allan Poe-së

Pesë nga dymbëdhjetë vëllimet e veprës së plotë të Edgar Allan Poe-së në frëngjisht i ka përkthyer Charles Baudelaire, poeti i madh francez. Baudelaire ka krijuar imazhin e Poe-së në frëngjisht. Ka njerëz që mendojnë se, falë Baudelaire-it, faqja franceze e Poe-së është më tërheqëse se faqja e tij angleze/amerikane e origjinalit.¹

Baudelaire nisi të përkthente Poe-në (përktheu 47 tekste të tij, tregime dhe ese) sepse e admironte veprën e shkrimtarit amerikan. Kishte me të njëfarë afiniteti shpirtëror. Anglishtja e shkrimtarit përkthyes nuk ishte e përkryer, ndonëse dëshmohet se ëma e tij, e lindur dhe e rritur në Angli, i kishte folur në të të dyja gjuhët, anglisht dhe frëngjisht, që prej kur ishte në djep (Faber, 253).

Shkrimtari përkthyes Baudelaire, siç dëshmojnë studiuesit e përkthimeve të tij të Poe-së, i është përmbajtur origjinalit me përpikëri, mirëpo poeti amerikano-britanik T. S. Eliot mendonte se Baudelaire ka transformuar “prozën shpeshherë shkel-e-shko në anglishte (të Poe-së, MH) në frëngjishte të admirueshme” (Faber, 253).

Fakti pse Poe lexohet më mirë në frëngjisht se në anglisht është për shkak të natyrës së tematikës së tij, të disa trilleve në stilin e tij, të sistemeve gramatikore dhe zanore të të dyja gjuhëve në fjalë, si dhe të devocionit dhe talentit të Baudelaire-it. (Faber, 254)

Poe duket më shumë si një evropian i zhvendosur në Amerikë sesa një amerikan, nëse duam të situojmë shkrimtarin Poe gjeografikisht. Nuk ka pamje të Amerikës së shekullit XIX as të ndonjë epoke tjetër në shkrimet e tij. Mungesa e referencave kulturore në shkrimet e Poe-së e lehtëson bartjen e tij në gjuhë të tjera, pa humbur informacion (Faber, 255).

Shkrimi i Poe-së duket shpeshherë i tejbërë, me poeticitet të tepruar, sidomos me përdorimin e shpeshtë të mbiemrave dhe frazave postnominale, me gjatësinë dhe ndërliqësinë e fjalive të tij. Përkthyesja Pamela Faber veneron se krijuesit letrarë të gjuhëve romane gjejnë kënaqësi në elegancën lulëzuese që s’ e honepsin shkrimtarët në anglisht (me përjashtim të Poe-së), duke zgjedhur ndërkaq realizmin, saktësinë

dhe lëvizjen. ‘Proza e purpurtë’ e Poe-së del krejt me vend në frëngjisht dhe në spanjisht, siç e dëshmojnë përkthimet e Baudelaire-it në frëngjisht dhe të Cortàzar-it në spanjisht, konstaton Faber (255).

Ka 19 raste të përdorimit të këtij lloji deviacioni stilistik (frazës postnominale) te tregimi “Rënia e shtëpisë së Asherit” (The Fall of the House of Usher) të Poe-së: “an eye large, liquid, and luminous”, “a pestilent and mystic vapour, dull, sluggish, faintly discernible, and leaden-hued”), siç veneron Faber, që në përkthim në frëngjisht (ne do të thoshim, në shqip po ashtu) del më i natyrshëm, sepse në frëngjisht nuk paraqitet si deviacion stilistik (255-6). “An eye large, liquid, and luminous” në frëngjisht “un œil large, liquide et lumineux”; në shqip “një sy i madh, i lëngshëm dhe i ndritshëm”. Në frëngjisht dhe shqip kjo nuk tingëllon si poeticitet i tepruar, siç është në anglisht.

Del konstatimi se përkthimi në frëngjisht lexohet më mirë sesa teksti në origjinalin anglisht falë gjuhës së mbërritjes që spastron teprinë stilistike të Poe-së në anglisht.

Kur sensibiliteti i përkthyesit është aq në harmoni me sensibilitetin e autorit të tekstit atëherë përkthyesi bëhet shkrimtari i tekstit në gjuhën e mbërritjes. Këtë e ka bërë Baudelaire, përfundon Pamela Faber (257).

Marcel Proust-i përkthyes i John Ruskin-it

“Proust-i ka vdekur pa e realizuar një nga dëshirat e tij të herëpashershme, të përkthente nga anglishtja dikë që ishte poaq i çuditshëm sa ç’ ishte vetë ai, John Ruskin-in”, ka shkruar Gabriel Garcia Marquez-i.¹ Nuk dihet nëse shkrimtari kolumbian e ka thënë këtë me shpoti, apo nga padija. Në të vërtetë, para se të shkruante esetë e përmbledhura te *Kundër Sainte-Beuve-it* (*Contre Sainte-Beuve*) dhe kryeveprën e vet në prozë, *Në kërkim të kohës së humbur* (*À la recherche du temps perdu*), Marcel Proust-i kishte përkthyer veprat e estetit anglez John Ruskin, *Bibla e Amiens-it* (*The Bible of Amiens*) dhe *Susami dhe zambakët* (*Sesame and Lilies*),¹ dhe këto përkthime janë bërë më të njohura falë Proust-it sesa origjinalet në anglisht. Përkthimi i tyre, jo domosdo i përkryer si përkthim, i ka shërbyer shkrimtarit francez në punën e tij letrare, mbasi prej estetit anglez mori tematikën e përvojës estetike që do ta mishëronte në roman. Bëhej fjalë për një afinitet estetik që kishte hetuar Proust-i me Ruskin-in. (Ngjashëm, siç kishte hetuar afinitetin estetik Baudelaire-i me Edgar Allan Poe-në një gjysmë shekulli

më herët.). Duke u rrokur ta përkthente Ruskin-in, ndonëse anglishtja e tij s'ishte më e mira, Proust-i ngjizte konceptin e vet për shkrimin dhe artin, teksa te shënimet që përshkojnë tekstet e Ruskin-it në frëngjisht diskursi proustian “bëhet auroreferencial”. (Ez-Zouaine, 587-8). Diskurset paratekstuale – parathënie, hyrjet dhe shënimet e Proust-it – përbëjnë një të tretën e tekstin final (590), ndërsa terminologjia proustiane, siç konstaton studiuesi, farkëtohet në kontakt me gjuhën e Ruskin-it dhe në hesap të saj, duke iu mbivendosur (592-3).

Përkthimi i eseve të Ruskin-it nuk është për Proust-in një punë e thjeshtë transferi por një vend ‘zbulimi’, një ‘ngjarje’, dhe më tej përgatitje për shkrimin e romanit *Në kërkim të kohës së humbur* (Ez-Zouaine, 588). Përkthimi është më shumë proces i rikrijimit për vete sesa për të tjerët.

Younès Ez-Zouaine e quan *estetemë* (esthétique), term të farkuar ngjashëm me ‘filozofemë’, njësinë e ndërprerë të një diskursi estetik të konsideruar sistem. “Estetema dallon nga tema për faktin se nuk është thjesht një përmbajtje por një parim i ndërtimit dhe i elaborimit të një bote të dhënë letrare apo artistike”, shpjegon autori.

Estemat e Proust-it te *Në kërkim të kohës së humbur*, përmes transferit estetik gjatë përkthimit të eseve të Ruskin-it, dalin nga estetika e anglezit, argumenton ai, për të konstatuar se situata si kjo e puna e Proust-it me tekstet e Ruskin-it të shtyjnë të shtrosh pyetjen për ‘kufijtë porozë ndërmjet aktit të shkrimit dhe aktit të përkthimit’ (Ez-Zouaine, 596).

Poetët për përkthimin e poezisë: Robert Frost-i dhe Octavio Paz-i

Dy poetë të mëdhenj, amerikani Robert Frost dhe meksikani Octavio Paz, kanë shqiptuar ide të kundërta për mundësinë e përkthimit të poezisë. “‘Poetry is what gets lost in translation’ (Poezi është ajo që humbet në përkthim’), është thënie që i atribuohet Frost-it,¹ i cili do t'i përkiste grupit të instrumentalistëve, për dallim nga Paz-i, që bie në grupin e hermeneutikëve, simbas klasifikimit të Venuti-t. Paz mendon se përkthimi është zgjidhja për konfuzionin e Babelit.¹ Ai mëton se gjuha mbi të gjitha është përkthim dhe se përkthimi dhe letërsia janë sinonime.

“Siç është letërsia një funksion i specializuar i gjuhës, përkthimi është funksion i specializuar i letërsisë” (157), konstaton ai, mbasi kishte shqiptuar filozofinë e vet të krijimit e të përkthimit letrar:

“Çdo tekst është unikal, po megjithatë është në të njëjtën kohë përkthim i një teksti tjetër. Asnjë tekst nuk mund të jetë plotësisht origjinal, sepse vetë gjuha, në esencën e vet, është tashmë përkthim – së pari nga bota joverbale, dhe pastaj, sepse çdo shenjë dhe çdo frazë është përkthim i një shenje tjetër, një fraze tjetër. Megjithëkëtë, arsyetimi i anasjelltë është po ashtu krejtësisht i vlefshëm. Të gjitha tekstet janë origjinale sepse çdo përkthim ka karakterin e vet të veçantë. Në njëfarë dore, çdo përkthim është krijim dhe përbën kështu një tekst unikal” (154).

Përkthimi fjalë-për-fjalë nuk është i pamundshëm, por në të vërtetë nuk është përkthim, thekson Paz, duke veneruar se ky lloj përkthimi në spanjisht quhet *servil*. Poezia është e përkthyeshme, pohon Paz, duke shtuar se përkthimi nënkupton “transformim të origjinalit” (154). Modeli hermeneutik nënkupton se përkthimi është transformim, madje edhe kur ruhet korrespondenca semantike dhe vendoset një përafrim stilistik, siç vë re Venuti (136).

“Përkthimi i poezisë është procedurë analoge me krijimin poetik”, mendon Paz (158), ndërsa duke u mbështetur në përkufizimin e Paul Valéry-së, meksikani thotë se përkthimi poetik konsiston në prodhimin e efekteve analoge me mjete të ndryshme (160).

Paz e sheh procesin e përkthimit si aktivitet krijues të ndryshëm por megjithatë “origjinal”. Ai sheh “ndërvarësi ndërmjet krijimit dhe imitimit, përkthimit dhe veprës origjinale” (161).

Duke folur për krijimin poetik dhe përkthimin poetik, Paz thekson se poeti është në “preokupim të përhershëm verbal (fjalësor); ai zgjedh disa fjalë, apo ato e zgjedhin poetin” (159). Të dytë, poeti dhe përkthyesi, bëjnë punë krijuesi, por procedura e përkthyesit është inverse me procedurën e poetit. Në fazën e parë aktiviteti i përkthyesit është i ngjashëm me të lexuesit apo të kritikut. Leximi është përkthim, kritika nis si përkthim. “Për kritikun, poezia është pika fillestare kah një tekst tjetër, i veti, ndërsa përkthyesi, në gjuhë tjetër dhe me karaktere të tjerë, duhet të shkruajë një poezi analoge me origjinalin” (159). Faza e dytë e aktivitetit të përkthyesit është paralele me të poetit, por me një dallim thelbësor: poeti nuk e di ku do ta çojë poezia, ndërsa përkthyesi duhet ta çojë te origjinali që ka përpara. Është proces me rend të përmbysur.

Ndonëse përkthyesi nuk e ka punë të krijojë diçka prej hiçi, përkthyesi i njohur i Marquez-it në anglisht Gregory Rabassa përkthyesin e sheh si “shkrimtarin ideal sepse gjithë çka duhet të bëjë ai është të shkruajë; syzheu, tema, karakteret, dhe të gjitha elementet e tjera thelbësore janë dhënë tashmë, kështu që ai mundet thjeshtë të ulet e t’i përvishet punës së shkrimit” (Polizzotti, xiv).

Jorge Luis Borges-i për misterin e letërsisë dhe të përkthimit

Shkrimtari argjentinas Borges, po si Paz-i, e shihte përkthimin si formë të rishkrimit krijues ndërsa inferioritetin e përkthimeve si “besëtytni”, te eseu i tij “Versionet homerike” (1932), që nis me konstatimin: “S’ka problem më thelbësor për letërsinë dhe misterin e saj modest sesa ai që shtron përkthimi”.¹

Pierre Menard-i, autori imagjinar te tregimi (fiksioni) i Borges-it, “Pierre Menard, autori i *Kishotit*”, rikrijon, praktikisht riprodhon fjalë për fjalë, copa të *Don Kishotit* të Cervantes-it, që, ndonëse identike me origjinalin, shenjojnë diçka tjetër në kohë tjetër, të re. Borges-i satirizon idenë e përkthimit simbas të cilës origjinali është i pambërrijshëm, se version i përkthyer është inferior. Versioni i Menard-it është superior, “pafundësisht më i pasur”, thotë rrëfimtari (efektivisht Borges-i) i këtij tregimi absurd.¹ (*Fiksionet* e Borges-it paraqesin një zhanër heterogjen ndërmjet rrëfenjës, eseut dhe poezisë.)¹

Përveç në disa shkrime për përkthimin, idetë e veta për përkthimin Borges-i i ka shpalosur edhe në biseda me përkthyes në anglisht. Njëri syresh, amerikani Ben Belitt, e citon argjentinasin të ketë thënë:

“Më thjeshtoni. Më modifikoni. Më mprehni. Gjuha ime shpesh më vë në siklet. Është tepër rioshe, tepër latinore... E dua fuqinë e Cynewulf-it, Beowulf-it, Bede-s [vepra dhe autorë anglo-saksonë, MH]. Më bëni maço dhe gauço dhe asht e lëkurë”.¹

Borges-i rekomandonte që fjalët shumërokëshe në spanjishte të përktheheshin me ‘fjalët e mira njërrrokëshe’ anglo-saksone, të gjuhës së vjetër angleze.

Duke përkthyer Walt Whitman-in, Edgar Allan Poe-në, Franz Kafka-n, Borges-i ka “zhvilluar strategjitë e veta si shkrimtar” (Levine,

45). Madje që në moshën nëntëvjeçare Borges-i kishte përkthyer dhe botuar “Princin e lumtur” të Oscar Wilde-it në spanjisht.

Gjyshja e Borges-it prej babe ka qenë angleze. *Kishotin* e Cervantes-it argjentinasi e kishte lexuar në anglisht fillimisht, ndërsa më vonë, kur e kishte lexuar në spanjisht, i ishte dukur “përkthim i dobët”.¹ Originali ishte jobesnik ndaj përkthimit, do të mund të thoshim me fjalët e vetë Borges-it paradoksal.

Në vitin 1970, mbasi që ishte tashmë me vite i verbët, autobiografinë e vet Borges-i ia diktoi Norman Thomas de Giovanni-t në anglisht. Së pari kjo u botua në anglisht, më vonë u përkthye në spanjisht.

Shkrimtarët përkthyes dhe vetëpërkthyes

Për sa është e mundur, është me dobi që shkrimtari vetë të marrë pjesë në përkthim, thotë Gabriel Marquez-i, duke përmendur përkthimin e jashtëzakonshëm të *Ulksit* të Joyce-it në frëngjisht, nga August Morell, që punoi për version përfundimtar me Valery Larbaud-në dhe vetë Joyce-in.

Duke folur për përkthimet e romaneve të tij, Marquez-i thoshte se nuk e njeh veten në asnjë gjuhë tjetër pos në spanjisht. Megjithatë, disa fragmente të përkthyer në anglisht nga Gregory Rabassa i pëlqenin më shumë sesa në spanjisht (Marquez, 24- 25).

Nga shkrimtarët e famshëm që kanë përkthyer vetë veprën e vet janë Samuel Beckett (frëngjisht-anglisht), Jorge Luis Borges (spanjisht-anglisht), Italo Calvino (italisht-anglisht), Vladimir Nabokov (rusisht-anglisht), Rabindranath Tagore (bengali - anglisht), Joseph Brodsky (rusisht-anglisht).

Nabokov ka lexuar dhe shkruar në rusisht, anglisht dhe frëngjisht që në moshën shtatëvjeçare. Ka qenë përkthyes gjithë jetën nga anglishtja, frëngjishtja e gjermanishtja në rusisht dhe nga rusishtja në anglisht dhe në frëngjisht.

Nabokov përktheu *Lolitën* e vet në rusisht, e vepra të tjera të vetat. U bë ithtar i përkthimit fjalë-për-fjalë, armik i përkthimit me rimë.

Nabokov-i: “Përkthimi më i ngathët fjalë për fjalë është një mijë herë më i dobishëm sesa parafrazimi më i bukur”.¹ .. “Dua përkthime me fusnota të bollshme...” thoshte ai që pas një pune prej disa dekadash

botoi përkthimin e vet në anglishte të *Eugjen Onjeginit* të Pushkinit, romanit në vargje, në katër vëllime, me 1200 faqe komente.

Nabokov-i ka shkruar shumicën e poezive të tij (rreth 1000) me rimë, por kur nisi të jepte letërsi ruse në kolegje amerikane erdhi në përfundim se përkthimi i vargjeve të rimuara në vargje të rimuara është ‘procedurë kriminale’, konstaton studiuesi Brian Boyd nga Zelanda e Re, biografi i Nabokovit, sepse kjo “i bën(te) të domosdoshme shmangiet nga origjinali, t’i vije në gojë poetit në original fraza që s’i kishte parë në ëndërr”.¹

Irlandezi Samuel Beckett ka qenë vetëpërkthyesi shembullor. Nisi me përkthimin e dramës së vet *En attendant Godot* (Duke pritur Godonë) prej frëngjishtes në anglisht. Romanin *Murphy* e shkroi në anglisht, pastaj e përktheu në frëngjisht. Vetëpërkthimi u bë pjesë e procesit krijues të Beckett-it.

Në të vërtetë, puna letrare e Beckett-i ilustron fshirjen e kufijve ndërmjet origjinalit dhe replikës, krijimit dhe kopjes, por edhe ndërmjet gjuhës burimore dhe gjuhës së përkthimit.¹ Përveç që përkthente nga dhe në të dyja gjuhët (anglisht, frëngjisht), Beckett-i i bënte këto më afër në kohë me njëra tjetrën, duke fshirë dallimin ndërmjet tyre.¹ Kjo është tjetër dëshmi e natyrës sistematike të ndërmarrjes së tij të vetëpërkthimit.

Rast i mëhershëm ilustrativ i vetëpërkthimit ishte Rabindranath Tagore, që mori çmimin Nobel për Letërsi për përmbledhjen e poezive të tij *Gitanjali*, të cilën e kishte përkthyer vetë nga gjuha bengale në anglisht. Ndër ata që e shtynë ishte edhe poeti irlandez William Butler Yeats-i, nobelist i mëvonshëm.¹

James Joyce-i shkrimtari vetëpërkthyes

Irlandezi James Joyce kishte autorizuar tri përkthime (frëngjisht, italisht, gjermanisht) të episodit “Anna Livia Plurabelle” (ALP)¹, që u botua fillimisht në origjinalin anglisht te revista “Criterion”, pastaj si libërth më vete te Faber & Faber, ku T. S. Eliot-i punonte si redaktor. Në të vërtetë ishte autori kryesor i përkthimit në italisht, pjesëtar i ekipit të përkthyesve në frëngjisht. Samuel Beckett-i kishte punuar fillimisht në versionin frëngjisht.¹

Përkthimin në italisht e kishin bërë James Joyce vetë dhe Nino Frank, ndonëse ishte botuar te revista “Prospettive” më 1940 me emrat e Joyce-it dhe të Ettore Settanni-t, mbasi emri i Frank-ut ishte censuruar

për shkak se ishte hebre.¹ Përkthimi nga origjinali i vitit 1928 përmban si shtesë një numër të konsiderueshëm emrash të lumenjve italianë, njëri prej të cilëve ('Metauro') hyn edhe në variantin përfundimtar të episodit të romani *Finnegans Wake* më 1939. Paradoksalisht, përkthimi kishte ndikuar në origjinalin e veprës së fundme, në të cilën autori punoi 17 vjet.

Te ky motërzim i episodit në italisht, kemi përkthim si proces krijues që mund ta bëjë vetëm autori.¹

Versioni fillestar në frëngjisht i përkthyer nga Alfred Péron dhe Samuel Beckett ishte punuar më tej nga katër përkthyes të tjerë, në drejtimin e vetë Joyce-it, gjatë 17 seancave triorëshe të punës, në të cilat Joyce-i kujdesej "më shumë për tingullin dhe ritmin sesa kuptimin", siç shkruan biografi i Joyce-it, Richard Ellmann.¹ Philippe Soupault, njëri nga të katër përkthyesit, ka thënë: "Ky tekst nuk është përkthim, është një 'rikonstituim' në kuptimin se është Joyce-i në frëngjisht... Më duhet ta them se Joyce-i po rindëronte, po rishkruante një pjesë të *Finnegans Wake*, dhe vetëm ai mund ta bënte këtë. Natyrisht se i kam ndihmuar, për shembull të gjente homologët për emrat e lumenjve: i kam ndihmuar, sigurisht, por në një kuptim Joyce-i ka ribërë tekstin e vet".¹ Mbasi autori ka ushtruar autoritetin e vet, nuk bëhet fjalë për përkthim, por për vazhdim të procesit krijues. Më e shumta mund të konsiderohet si 'tekst primar' (në frëngjisht) që ka një marrëdhënie intertekstuale me origjinalin (në anglisht).¹

Rosa Maria Bollettieri Bosinelli mban qëndrimin se për dallim nga versionet në frëngjisht dhe gjermanisht, versioni në italisht i ALP-së "është më shumë si tekst autonom sesa përkthim dhe, si i tillë, bën pjesë plotësisht në veprat e Joyce-it". Po të shihej si 'përkthim' do të shtronte probleme të rënda teorike në lidhje me legjitimitetin e transformimit të emrave të vendeve e njerëzve, të aluzioneve historike e letrare, të nënkuptimeve kulturore dhe politike.¹

Joyce-i rishkroi "Anna Livia Plurabelle" në frëngjisht dhe italisht duke rikrijuar plurilingualizmin e veprës së vet në anglishte. Kjo dëshmon një autonomi relative e tekstit të përkthyer, sikur edhe fluiditetin e tekstit burimor kur në krye të punës është shkrimtari përkthyes, vetëpërkthyes.

Kufijtë e lëvizshëm të krijimit e të përkthimit

Poeti irlandez Seamus Heaney, fitues i Nobelit për Letërsi në vitin 1995, ishte edhe përkthyes i njohur, ndër të tjera i epit *Beowulf*, kryeveprës së letërsisë anglo-saksone, e moçme mbi njëmijë vjet.

Drama *The Cure at Troy* (Shërimi në Trojë) e Seamus Heaney-t mban nëntitullin: “një version i Filoktetit të Sofokliut”. Çfarë versioni është ky? Çka përbën ky krijim/përkthim i Heaney-t? A është ky përkthim?

Prologu 32-vargësh i kësaj drame nuk është prolog i tragjedisë greke, që i paraprinte hyrjes së korit, por shqiptohet në të vërtetë nga kori. Te Sofokliu kori kishte 15 pjesëtarë. Këtu ka tre gjithsej, tri gra misterioze, ‘të mbështjella me shalle, që nuk kanë lidhje me veprimin, por shqiptojnë të 32 vargjet shtesë (se nuk janë të Sofokliut) si dhe 13 të tjera në fund, po ashtu shtesë e Heaney-t. Edhe në pjesë tjetër të veprës ka largim të Heaney-it nga origjinali i Sofokliut, madje nga fundi, siç vë re studiuesi Paul Turner: “besnik në lëvizjen e përgjithshme të syzheut të poetit të tij, por që nuk bën asfarë përpjekjeje të riprodhojë dialogun e tij, apo madje frymën e tij”.¹

Duke iu përgjigjur pyetjes që shtron në fillim të eseut të vet, Turner shprehet: “një dramë e mrekullueshme në vargje, Profesor Heaney, por nuk guxoni ta quani version të *Filoktetit* të Sofokliut”.

Kjo vepër i ka shërbyer Heaney-t si lëndë e parë për një Muzë moderne, konstaton Turner. Më tej studiuesi e quan *Shërimin në Trojë* pjesë të trendit aktual të “eksploatimit të letërsisë klasike”, një “nën-zhanër” i protestës irlandeze në rastin konkret (Turner, 132). Drama e Heaney-t, e botuar në vitin 1991, është për Irlandën, në të vërtetë, për Irlandën e plagëve e të trazirave të tri dekadave të fundit të shekullit XX, siç shihet nga vargjet nistore të prologut, edhe pse fillimisht përmenden emrat e Filoktetit, Herkulit dhe Odisesë:

Heroes. Victims. Gods and human beings.
All throwing shapes, every one of them
Convinced he's in the right, all of them glad
To repeat themselves and their every last mistake,
No matter what.

Heronj. Viktima. Hyjni dhe krijesa njerëzore.
 Të gjithë hedhin trajta, seicili prej tyre
 I bindur se ka të drejtë, të gjithë të kënaqur
 Ta përsërisin veten dhe seicilin gabim të tyre të mbramë,
 Pa marrë parasysh. [Përkthimi im, MH]

Rasti i Heaney-t të shtyn të mendosh se *Stinë e mërzitshme në Olymp* e Ismail Kadaresë¹ është eksploatim i letërsisë klasike dhe të shtrosh pyetjen: A është Olympi ‘blloku’ i diktaturës hoxhiste? Me gjasë po.

Në parathënie, Éric Faye e quan këtë dramë trilogji të “rindërtuar” dhe të “modernizuar” (10).

Përfundim: arti i madh i letërsisë dhe arti i vogël i përkthimit

Shkrimtari gjerman Thomas Mann, fitues i Çmimit Nobel për Letërsi, kishte fituar staturë të madhe në botën anglishtfolëse falë përpjekjeve të përkthyeses së tij të autorizuar, amerikanes Helen Lowe-Porter, ka thënë një studiues, të cilin e citon Kate Briggs, përkthyes e dy vëllimeve të ligjëratave dhe të shënimeve të seminareve të Roland Barthes-it, në librin e saj *This Little Art*,¹ që e merr titullin nga përkufizimi që i kishte bërë Lowe-Porter përkthimit si ‘ky art i vogël’. Amerikanja që jetonte në Oksford kishte vendosur të përkthente që të mos ‘vegjetonte intelektualisht’. Përkthimet e saj të romaneve të Thomas Mann-it, në radhë të parë i *Budenbrokëve* dhe i *Malit magjik*, ndonëse i kishin rritur staturën Mann-it, kanë dalë të kenë pasur mangësi jo të vogla, qoftë shkaku i mosnjohjes së gjermanishtes prej saj, madje edhe të anglishtes së saj të ngathtë, joidiomatike, qoftë të politikave të përkthimit që kishte ndjekur, siç është bërë e qartë nga vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX, kur kanë dalë studime për përkthimet e saj teksa botoheshin përkthime të reja të veprave të shkrimtarit gjerman në anglisht.¹ Një recensues i librit të Briggs-it me të drejtë e shtron pyetjen, me shpoti: “A guxoj të them se statura e Thomas Mann-it mund të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i përpjekjeve të Thomas Mann-it?”¹ Jo i përpjekjeve të Porter-it, donte të thoshte recensuesi. E vërteta është se Mann-i është shijuar me të madhe në anglishten e saj për dekada.

Shtrohet pyetja në fund: çka do të thotë sukcesi i një përkthimi jo të përkryer? Ndoshta, se nga letërsia e madhe, edhe kur humbet diçka në përkthim të saj, nuk firon arti i madh i letërsisë në punë e sipër të artit të vogël të përkthimit.

Bibliografi

- [1] Apter, Ronnie, *Digging for the Pleasure: Translation after Pound*, Paragon House Publishers, New York, 1987 (botimi i parë, 1984).
- [2] Balderston, Daniel, and Schwartz, Marcy E., *Voice-Overs: Translation and Latin American Literature*, State University of New York Press, 2002.
- [3] Bollettieri Bosinelli, Rosa Maria, "Introduction: Anna Livia Plurabelle's sisters", në *Transcultural Joyce*, edited by Karen R. Lawrence, Cambridge University Press, Cambridge, 1998, ff. 173-178.
- [4] Bollettieri Bosinelli, Rosa Maria "Anna Livia Plurabelle's sister", në *Transcultural Joyce*, edited by Karen R. Lawrence, Cambridge University Press, Cambridge, 1998, ff. 193-198.
- [5] Boyd, Brian, "Nabokov as Translator: Passion and Precision", *RUS* (São Paulo), 22/12/2012, Vol.1 (1), ff. 5-24. Në internet.
- [6] Briggs, Kate, *This Little Art*, Fitzcarraldo Editions, London, 2018.
- [7] Borges, Jorge Luis, "The Enigma of Edward FitzGerald", në Jorge Luis Borges, *Selected Non-Fictions*, edited by Eliot Weinberger, Penguin Books, New York, 1999, ff. 366-368.
- [8] Borges, Jorge Luis, "The The Homeric Versions", në Jorge Luis Borges, *Selected Non-Fictions*, edited by Eliot Weinberger, Penguin Books, New York, 1999, ff. 69-74.
- [9] Cortázar, Julio "Translate, Traduire, Tradurre: Traducir", në Daniel Balderston and Marcy E. Schwartz, *Voice-Overs: Translation and Latin American Literature*, State University of New York Press, 2002., ff. 21-22.
- [10] Crowder, Ashley Bland, and Hall, Jason David, *Seamus Heaney: Poet, Critic, Translator*, edited by, Palgrave, Macmillan, 2007.
- [11] Derrida, Jacques, "What Is a 'Relevant' Translation?", në *Critical Inquiry*, Vol. 27, No. 2 (Winter, 2001), ff. 174-200.
- [12] Ellmann, Richard, *James Joyce*, Oxford University Press, New York, 1959, botimi i plotësuar, 1982.
- [13] Ferre, Daniel and Aubert, Jacques, "Anna Livia's French bifurcations", në *Transcultural Joyce*, edited by Karen R. Lawrence, Cambridge University Press, Cambridge, 1998, ff. 179-186.
- [14] Grossman, Edith, *Why Translation Matters*, Yale University Press, New Haven and London, 2010.

- [15] Grutman, Rainier, "Beckett and Beyond: Putting Self-Translation in Perspective", në *Orbis Litterarum*, June 2013, Vol.68(3), pp.188-206.
- [16] Heaney, Seamus, *The Cure at Troy: A Version of Sophocles' Philoctetes*, Farrar, Straus, Giroux, 1991.
- [17] Johnson, David E., *Kant's Dog: On Borges, Philosophy, and the Time of Translation*, SUNY Press, New York, 2012.
- [18] Levine, Suzanne Jill, "Borges on translation", në *The Cambridge Companion to Jorge Luis Borges*, edited by Edwin Williamson, Cambridge University Press, 2013, ff. 43-55.
- [19] Kadare, Ismail, *Stinë e mërzitshme në Olymp: Tragjedia e Prometheut dhe e një grupi hyjnish në 14 dukje*, Onufri, 2002.
- [20] Kundera, Milan, *Testamentet e tradhtuara*, përktheu Balil Gjini, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2011.
- [21] Márquez, Gabriel García, "The Desire to Translate", në Daniel Balderston and Marcy E. Schwartz, *Voice-Overs: Translation and Latin American Literature*. State University of New York Press, 2002., ff. 23-25.
- [22] O' Brien, Edna "How James Joyce's *Anna Livia Plurabelle* shook the literary world", in "The Guardian", 17 January 2017, <https://www.theguardian.com/books/2017/jan/27/edna-obrien-how-james-joyces-anna-livia-plurabelle-shook-the-literary-world>.
- [23] Paz, Octavio, "Translation: Literature and Letters", translated by Irene del Corral, në *Theories of Translation: An Anthology of Essays from Dryden to Derrida*, ed. John Biguenet and Rainer Schulte, Chicago: University of Chicago Press, 1992, 152-162.
- [24] Polizzotti, Mark, *Sympathy for the Traitor: A Translation Manifesto*, The MIT Press, Cambridge, Massachusetts, London, England, 2018.
- [25] Turner, Paul, "The Cure at Troy: Sophocles or Heaney", in *Seamus Heaney: Poet, Critic, Translator*, edited by Ashby Bland Crowder and Jason David Hall, Palgrave, Macmillan, 2007, ff. 121-135.
- [26] Venuti, Lawrence, *Contra Instrumentalism: A Translation Polemic*, University of Nebraska Press, Lincoln, 2019.
- [27] Woods, Michelle, *Translating Milan Kundera*, Multilingual Matters LTD, Clevedon, Buffalo, Toronto, 2006.

Linda Mëniku, Tiranë

KONEKTORËT KUNDËRSHTORË NË VEPRËN E PJETËR BOGDANIT “CUNEUS PROPHETARUM”

Në këtë punim do të trajtohen konektorët e tekstit që shprehin marrëdhëniet kundërshtore, në veprën e Pjetër Bogdanit “Cuneus Prophetarum” (bazuar në punimin kritik të studieses Anila Omari)¹. Për të vështruar diakronikisht përdorimin e konektorëve kundërshtorë brenda një shekulli (shek. 17) dhe në ditët e sotme, do të bëjmë dhe një vështrim krahasues mes këtyre konektorëve kundërshtorë të përdorur në veprën e Bogdanit (1685) dhe në veprën e Budit “Doktrina e kërshenë” (1618), me konektorët kundërshtorë në gjuhën shqipe sot. Konektorët kundërshtorë-lidhëza do të trajtohen dhe në vështrim përmasës me lidhëzat kundërshtore në veprën e parë të shqipes “Meshari” i Gjon Buzikut, bazuar në punimin e studiuesit Emil Lafa “Lidhëzat te libri i parë shqip”¹.

Duke u nisur kryesisht nga studimi i Pasch et al.¹, konektorë do të konsiderohen “një klasë elementesh, funksioni i përbashkët i të cilave është të lidhin fjalitë nga ana semantike me njëra-tjetrën”.

Autorët kryesorë të gjuhësisë së tekstit jo gjithnjë bien dakord në lidhje me marrëdhëniet që mund të realizojnë mjete të ndryshme gjuhësore, por në një klasifikim të përgjithshëm, marrëdhëniet bazë që mund të realizojnë konektorët janë: marrëdhënia shtesore, marrëdhënia kundërshtore, marrëdhënia shkakore etj. Nën trajtimin morfosintaksor konektorët klasifikohen në: *lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse, ndajfolje dhe pjesëza*. Konektorët lidhëzorë vendosin lidhje sintaksore mes fjalive. Konektorët ndajfoljorë vendosin lidhje semantike-referenciale dhe janë të integruar në njërin nga konektet.

Konektorët kundërshtorë përdoren për të shprehur lloje të ndryshme marrëdhëniesh kundërshtore: *kontrast përmes vlerave të kundërta të konekteve, krahasimi kontrastues, kontrasti përmes ndryshimit të planit, kontrast përmes vlerave të kundërta të konekteve*. Si konektorë kundërshtorë në gjuhën e sotme shqipe konsiderohen lidhëzat bashkërenditëse: *por, ama, kurse, mirëpo, ndërsa, teksa, por,*

porse, veç, veçse, veçqë, vetëm se, si dhe lidhëzat *megjithatë, megjithëkëtë*. Konektorët kundërshtorë-lidhëza përdoren kryesisht: *në krye të fjalisë pasuese dhe në mes të fjalive*.¹ Kurse konektorët e tjerë kundërshtorë mund të gjenden dhe në pozicione të tjera.

Konektorët kundërshtorë-lidhëza

Si në shumë gjuhë, edhe në gjuhën shqipe mund të flitet për një konektor kundërshtor standard, i cili mund të përdoret për të shprehur marrëdhënie të ndryshme kundërshtore. Ky konektor në gjuhën shqipe sot është lidhëza kundërshtore *por*. Por me sa duket ky konektor ka pasur të njëjtën denduri përdorimi që në veprën e parë shqip “Meshari” i Gjon Buzukut. Sipas studiuesit Emil Lafe: “*Kjo lidhëz është më e shpeshta nga gjithë lidhëzat kundërshtore të Buzukut.*”¹ Ajo është përdorur nga Buzuku për të shprehur “*një kundërshtim, i cili mund të paraqitet me disa nuanca të ndryshme.*”¹:

1. *Porsi bie shiu e bdora n qiellshit e mā përhapëtë nukë kthen, por e pi dheu.*¹[...]

2. *U vete tek aj qi më dërgoi, e askush mos më pyesë tek vete. Por përse u juve fola këto kafshë një t idhunë mbushi zemërën taj*¹ [...]

Ndonëse është lidhëza më e përdorur në veprën e Buzukut, lidhëza *por* mungon krejtësisht si në veprën e Bogdanit¹, dhe në veprën e Budit. Studiuesi Emil Lafe ka vënë në dukje se “Gjon Buzuku përdor këto lidhëza kundërshtore: *ma (mā), po, por, pur, māse, veçëse*”. Sikurse shihet nga kjo listë, në veprën e parë të gjuhës shqipe nuk gjenden të përdorura lidhëzat kundërshtore: *ama, kurse, mirëpo, ndërsa, teksa, porse, veçqë, vetëm se*, të cilat përdoren sot gjerësisht në gjuhën shqipe.

Sipas Anila Omarit, në veprën e Bogdanit *kurse (ç)* gjendet e përdorur si parafjalë “që prej: it. *da, da che*”: *Prirënë e hjekënë shqiset’ e nierit ç’kurse së riut së vet.*¹ Pra, dhe në veprën e Bogdanit, ashtu si në veprën e Buzukut, *kurse* nuk përdoret si lidhëz. Konektori kundërshtor *kurse* mungon dhe në veprën e Budit “Doktrina e Kërshtenë”. Mund të themi se lidhëzat e përngjitura: *mirëpo, porse, teksa, veçqë, megjithatë, megjithëkëtë* nuk janë përdorur as në veprën e Buzukut, as në veprën e Pjetër Bogdanit dhe as në veprën e Pjetër Budit.

AMA

Ashtu si në veprën e Buzukut, lidhëza kundërshtore *ama* nuk gjendet e përdorur as në veprën e Bogdanit dhe as në atë të Budit. Sipas Tahir Dizdarit, i cili i referohet Ēeigand-it, “*ama* është turqizëm në shqip”¹. Edhe gjuhëtari i madh E. Çabej e sjell “prej tūrq, *ama*, *amma* (kjo e arabishtes), e cila ka shkuar dhe në të tjera gjuhë ballkanike [...]”¹. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1954, kjo lidhëz nuk është përfshirë, kurse në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 2006 është trajtuar si lidhëz bisedore: **AMA** bised. I. lidh. Por, porse; veçse. Erdhi, *ama* me vonesë. I foli, *ama* me të drejtë.”¹

Në gjuhën e sotme shqipe, pozicioni që zë konektori *ama*, i ngjan më shumë atij të një konektori ndajfoljor. Ky pozicion i tij mund të shpjegohet me faktin se konektori *ama* është një konektor i huazuar nga gjuha turke dhe ruan, me sa duket, të njëjtat karakteristika si në turqisht. Si konektor kundërshtor në gjuhën shqipe sot, *ama* përdoret në pozicione të ndryshme¹:

- në krye të fjalisë pasuese

3. *Kjo nuk do të thotë që Naimi nuk është pa reminishenca. Ama t'i kërkosh këto në vargjet e strofat e tij në mënyrë të tillë, që të arrish të thuash, bie fjala, se te “Bagëti e Bujqësi” ai “ka imituar “Bukoliket” apo “Gjeorgjiket” e Virgjilit kur ata i ndajnë dy mijëvjeçarë, tri epoka historike¹....*

- në mes të fjalive

4. *Ju ecënë kudo që të doni, ama, im dhëndër edhe ime bijë do të jesin këtu.*¹

- pas gjymtyrëve të tjera

5. *Së fundi, lufta vazhdon sepse nxit “përparimin njerëzor” duke rritur rendimentin e punës. Një përfitim për shoqërinë, ama, nuk do të thotë që është përfitim për individin.*¹

ANI

Eqrem Çabej e konsideron *ani* si pasthirmë, ndajfolje “s’ka gjë, s’ka gajle, prase; pastaj”¹, “e mbarë gjuhës, po me përdorime të ndryshme nëpër dialekte. Del së pari te Budi [...] me kuptimin “pastaj: atëherë” *ani* ndeevonë ndo të banj qi të dërgjesh.”¹

Në veprën e Budit vëmë re se *ani* është përdorur në ndonjë rast dhe si konektor kundërshtor me kuptimin ‘por, megjithatë’:

6. Bu DC 13 1: [...] *shintesë kryq banetë mbë këte arrësye, / tue vuum maa parë m ballë dorënë/ e djathë e tue thanë, se : pr emënit të/*

Atit – **ani** mbë zemërë tue thanë [...]

Në veprën e Bogdanit, *ani* është konsideruar si ndajfolje dhe lidhëz: “**ANI** ndf.; lidh. “pastaj: it. *poi*; por: lat. *autem*”:

7. *Kje argjupeshkëpi i Ohërit, ani bam argjupeshkëpi i Shkupsë/ Kur del ani e soditën/Fili kaqa i madh, ani i urtë.*¹

Gjendet e përdorur dhe si konektor teksti që shpreh marrëdhënie kundërshtore:

8. Bo I 5 175: *Të tretënë ditë ka me u ngjallunë, e ka me u pam gjaall dvekëtarësh. Ani mbasandaj ka me hipunë ndë rêt e qiullet mbë mëndyrë, qi ndjek.*

9. Bo I 10 13: *Aj qi âsht drgoj mue juve. Ani mbet e tha: ke me than bijet Izraelit: Zotyn Hyji Abramit e Hyji Isakut, e Hyji Jakobit drgoj mue juve.*

10. Bo I 20 40: [...] *me një urdhn t madh, qi ma t ligat t shrbejn ma fisnikvet, gjith ani tue u prvum krês.*

Në gjuhën e sotme shqipe, është fjalë e ligjërimit bisedor. Në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* të vitit 2006, *ani* është konsideruar si ndajfolje me kuptimin “pastaj, më vonë”. *Të mbarojë punë, ani të dalë.*: si fjalë e ndërmjetme: *Ani, do të pres.*; dhe si pasthirmë: *Ani ç’paska qafën si gastare!*¹

ASGJAMANGU(T)

Në gjuhën e sotme shqipe *asgjëmangut* konsiderohet si një lidhëz librore ‘megjithatë, prapëseprapë; veçse. *Asgjëmangut, populli e ruajti njësinë e vet kombëtare*’¹, e cila përdoret rrallë.

Sipas gjuhëtarit E. Çabej, *asgjëmangut* “megjithatë, prapëseprapë” është lidhëz kundërshtore e gegërishtes letrare, e papërgjithësuar në gjuhë. Në literaturën e vjetër *asgjëmangu*, në të renë *asgjëmangut*, kështu edhe te Junku. Shpeshherë e shkruar me dy pjesë, *asgjâ mangu*, një shenjë që nuk ish ngjizur ende në një kompozitë.¹

Studiuesi Kolec Topalli, e konsideron *asgjëmangut* si një lidhëz kundërshtore të gegërishtes letrare, “një kalk gjuhësor i formuar sipas modelit të gjuhëve latino-romane: lat. *nihilominus*, it. *nientedimeno*, *nondimeno*. E kanë autorët e vjetër që me gjasë janë krijuesit e saj.” Përsa u përket dy formave në të cilat haset: *asgjëmangu(t)*, Topalli mendon se “ndërsa autorët e vjetër fjalën *mangu* e kanë me trajtën e *pashquar të rasës rrjedhore*, në fjalorët e mëvonshëm shfaqet në trajtën

e shquar, si formim më i ri (khs. *mish lopet*). Forma *asgjëmangut*, që e kanë fjalorët e shqipes të viteve të fundit është krijim gjuhëtarësh.”¹

Lidhëza *asgjamangu* (*asgjamângu*) “megjithatë: it. *tuttavia*, *nondimeno*”¹ është një nga lidhëzat kundërshtore më të përdorura në veprën e Pjetër Bogdanit. Sikurse e theksuam më lart, në këtë veprë vihet re se nuk ka përdorime të lidhëzave *megjithatë/megjithëkëtë*, dhe rolin e tyre në atë kohë me sa duket e ka luajtur lidhëza *asgjamangu*. Si konektor teksti, në veprën e Pjetër Bogdanit, *asgjamangu* përdoret në të njëjtat pozicione si konektorët *megjithatë/megjithëkëtë*, duke dalluar kështu nga konektorët e tjerë lidhëzorë. Ai përdoret në pozicione të ndryshme: në fillim, në mes dhe në pozicionin jo në fillim të konektit të dytë. Ndryshimi në zgjedhjen e pozicionit bëhet për arsye stilistikore dhe semantike. Në këtë mënyrë, ky konektor ngjan më shumë me një konektor ndajfoljor.

- në pozicion fillestar

11. Bo I 25 44: *Jeta ndë luftë, mortja ndë dob̄. Asgjamangu Adami aso koheje kur kje krijuem nukë pat me dekunë, tue pasë kjanë i pamort, jo për forcë të përmbrenshime, përse me i pasë râm [...]*

12. Bo I 15 40: *Tue mos kallëzuem Evangjelista ndë qish duer petëkash kje veshunë. Asgjâmangu mundemi me thanë (ndëpër të madh [...]*

- në fjalinë pasuese, por jo në pozicion fillestar p.sh. pas një gjymtyre fjalie:

13. Bo I 5 70: *Duhetë asgjamangu me dijtunë se Ezau tue shitunë parëbijënië [...]*

- në mes të fjalive

14. Bo I 15 87: *Mundetë mirëfilli me u vështëruem, asgjamangu u gjetnë ende përpara Krishtit nierëz aqa t’urtë sa me të hollët të mendsë vet mbërrinë me njoftunë se është veçë një Hyj.*

15. Bo I 30 58: *Posi kje urata Matt. 26 kur tha: Atë, ndë mundetë kurraj le të shkonjë meje ky kelshëjt o mund; asgjamangu jo posi due unë, ma posi ti[...]*

Në veprën e Budit “Doktrina e kërshitenë”, *asgjamangu* gjendet e përdorur rrallë:

16. Bu DC 229 10: *veçëse m paahiir , / tue mos qenë i zoti maa mirë / me j nkthyem e me j ndërequnë . / Asgjaamangu si t a merri n dorë për / gjithë ditë tue e xgjedhunë , ndë pak dit /.*

17. Bu DC 155 1: *përse unë ndonëse të qërtonj / herë herë për ndoonjë arrësye të / dërejte , asgjaamangu ndë zemërë / teme gjithëherë dëshëronj.*

MA

Eqrem Çabej thotë se lidhëza *ma* “por” është përdorur në gegërishten e në arbërishten e Italisë dhe është e rregullt te autorët e vjetër të Veriut.¹

Lidhëza *ma* gjendet e përdorur që në veprën e parë të shqipes “Meshari”. Studiuesi Emil Lafe thotë se kjo lidhëz është përdorur 103 herë në “Mesharin” e Buzukut “me kuptimin e lidhëzave *autem* e *sed* të latinishtes.”¹

Në veprën e Budit lidhëzën *ma* e gjejmë të përdorur në një numër më të kufizuar rastesh, mbi 25, kurse në veprën e Bogdanit kemi një përdorim shumë të madh të kësaj lidhëze.

Ky konektor, si te Budi, ashtu dhe te Bogdani gjendet si në krye të konekteve (18, 19) dhe në mes të tyre (20, 21, 22),

18. *Qish áshtē zanē n teje prej Shpīrti shent áshtē. Ma pērse dēshminjēnia e sē vērtetēsē amēshueshime Krishtit Zotit tynē kurraj mangu nukē vjen, posi aj vetē thotē:*¹

19. Bu DC 162 25: *e me j u ruojtunē . Maa tashti me/kēto fjalē e besedii , qi thashē [...]*

20. Bo I 5 34: *Pērse mpkateve mortare jo veçē u pērket mundi amēshueshim, ma mbasi tē jenē xgidhunē mpkatit me rrēfim, jesēnē ende ndē pushtet tē Burgatorit [...]*

21. Bo I 5 71: *[..] një pjesē kje vērtetunē pēr letērē mbē Davidnē, qi gēzoj regjēnīnē; ma ani gjithēsej kje vērtetunē e mbushunē mbē Krishnē.*

22. Bu DC 123 10: *[...] tē mkatevet i hiek mbas vetēhej/ posikuur kaalinē pēr freni , maa ndeevonē [...]*

Në veprën e Bogdanit, konektori *ma* gjendet i shoqëruar dhe me *ende*:

23. Bo I 5 100: *Ma ende këta tue mos gjegjunē qish u kish urdhēnuem Sauli [...]*

Kurse në veprën e Budit *ma ende* nuk gjendet e përdorur.

MBĪSE

Studiuesi Lafe ka përfshirë në listën e lidhëzave kundërshtore në veprën e Buzukut dhe fjalën *māse*: “fjala *māse*, përgjithësisht me *a* të gjatë, del si lidhëz nëntëmbëdhjetë herë, me kuptimin “përveç se, veçse”.¹ Si lidhëz kundërshtore është përdorur kryesisht me nuancë kufizimi: *e të mos i epetē shenj māse tē Jonēsē profetē [...]*¹

Sipas Eqrem Çabejit “[...] kjo është një nga ato fjalët e shqipes që (si *ndiç*, *shklata* etj.) janë përftuar me përngjitje me -se përveç *māse* janë edhe *druese*, *mbase*, *ndonëse*: të gjitha formime relativisht të reja, sikundër tregon dhe ruajtja e *e-së* fundore, khs. përkundrazi *mōs*. Veçanërisht *māse* u formua pas një fjalie mohore: në *nukë kemi regj mā se ...* u bashkuan këto dy pjesëza në

Māse, me kuptimin “përveçse, veçse” e pastaj edhe ‘vetëm’, *māse* një fjalë thuo. [...] Bogdani ‘veçse, nisi’ e jep me përngjitjen *mbi+se*: *Na të ligatë suta, qish tjetër jemi mbīse një rëmbim.*”¹ Kjo shpjegon mungesën e lidhëzës *māse* në veprën e Bogdanit, dhe përdorimin e *mbīse*.

Si konektor teksti *mbīse* në veprën e Bogdanit e kemi hasur kryesisht në krye të konekteve:

24. *Mbīse ka me kjanë një i madh monarkë me forcë të kësaj jetë, ka me kjanë ende fort i bëgatë [...]*¹

Çabej thekson se “me një kuptim pak më të ndryshëm (aq pak sa, jo më shumë se”) po pas një fjalie mohore, po vetë pa folje, e përdor *māse* edhe Budi (RR 333): *gjā s kursenjënë, māse ajo gjindja e sodomstëvet...Këtë ide toskërishtja e jep me më sa: më sa e pe ti (aq) e pashë edhe unë*” aq sa e pe ti e pashë edhe unë: (d.m.th. as unë as ti).”¹

Në veprën e Budit “Doktrina e Kërshtenë” kemi hasur të njëjtat përdorime të mësipërme të *maa se*, dhe asnjë përdorim në funksionin e konektorit të tekstit.

25. Bu DC 225 25: [...] *qi s kanë të numuruom / maa se bari për dheë [...]*

26. Bu DC 12 10: [...] *e gjëniisë tyne ndeevonë / maa se për pesë mijë vjet [...]*

27. Bu DC 90 25: [...] *me ndoonjë arrësye të mos i a kiemi / maa se njaj shtase së paa ndoonjë [...]*

NDËRSA

Lidhëza e përngjitur *ndërsa* nuk gjendet e përdorur në veprën e Buzukut, që do të thotë që përngjitja ka ndodhur në një periudhë më të vonë. Në veprën e Pjetër Bogdanit, kjo lidhëz gjendet kryesisht e përdorur si konektor kohor it. *mentre*¹

28. [...] *Ndërsa po kullotënte grijnë Mojzesi të vjehërrit vet mbë Mal të Sinajt, ju duk një mrekullë fort randë*¹.

I përdorur si konektor kundërshtor *ndërsa* shpreh marrëdhënien e kontrastit krahasues, ku krahasohen topikë të cilët janë të të njëjtit tip nga ana semantike:

29. Bo I 15 17: [...] *përse kje mjesënatë përse punëtë kundërshtare vum njana përpara sjetërësë ma fort dukenë. Ndërsa nata ndë të rrjedhunit e vet gjymcën' e udhësë kishte pasunë* etc.

Në veprën e Budit, *ndërsa* nuk është përdorur. Në rastet e përdorura nga Budi, *ndër* është parafjalë:

30. Bu DC 103 25: [...] *e të përvaajshimitë e gjith ata , qi / janë ndër saa nevojë të paanjefuna .*

31. Bu DC 192 20: [...] *ndër kankë tue kënduom / e ndër saa begatii / mbë dheet tue lundruom , [...]*

PO

Në veprën e Buzukut përdorimi i lidhëzës *po* është tepër i rrallë. Kjo lidhëz është përdorur vetëm katër herë, ndërkohë që lidhëza më e shpeshtë kundërshtore në këtë veper është lidhëza *por*, e përdorur 177 herë, kryesisht në krye të një fjalie pyetëse: *E ata pyesninë: Po kush je ti, Elia?*¹.

Kurse në veprën e Budit, lidhëza kundërshtore *po* është përdorur mbi 20 herë. Si konektor teksti e gjejmë të përdorur *po* ashtu në disa raste:

a) në krye të konekteve

32. Bu DC 8 15: [...] *ndë faqet me e shukuom . Po kush kaa / pak oo shumë mend e shqise e të ndëgjuom [...]*

b) në mes të tyre

33. Bu DC 3 5: [...] *nd anët ncë mangut , qi të gjeeni , po se / ende kaqë ku kam mundunë me e mbaruom.*

Ashtu sikurse u tha më lart, sot në gjuhën shqipe si konektor standard, i cili mund të përdoret për të shprehur marrëdhënie të ndryshme kundërshtore është lidhëza kundërshtore *por*. Në veprën e Pjetër Bogdanit “Cuneus Prophetarum” konektori kundërshtor *por* mungon, dhe si konektori kundërshtor më i përdorur del lidhëza *po*.

Duke qenë konektori kundërshtor i përdorur më shumë, *po* gjendet si në pozicionin karakteristik të konektorit në mes të fjalive (34, 35, 36), ashtu dhe në krye të konektit pasues (37).

34. Bo I 10 2: [...] *ani mos thoj se këjo shtëpī nukë është lem mbë këtë jetë vetëhej, po ka diku një Zot fort të bëgatë e të lum?*

35. Bo I 15 5: *Të ma naltëtë mbī ty mos e lypë, po ato kafshë qi të ka urdhënuem Hyji, ato kujto gjithëherë: [...]*

36. Bo I 5 1: *Mb'atë krye qi mba mbi vetëhe tjetër nukë ka: po bukurë mendja jonë të gjanjë pushim e të marrë vesh [...].*

37. Bo I 10 43: *Të këqijtë asgja kanë mbë qiellt, e ju asgja mbë këtë jetë. Po me shpëresë t'atyne t'mirave kahë ini nërequnë, qish do t u goditetë mb'udhë duhetë me e gëzuem.*

Konektori **po** gjendet i përdorur shpesh i shoqëruar nga **ende**:

38. Bo II 20 59: *Jezu Krishti Shëlbuesi i shekullit, jo veçëse bante mirë jevrejet, të sijtë aso koheje ish populli i Tinëzot i xgedhunë, po ende kish të dhimptunë e bante mirë ende t'pëganëvet, shumë sish tue shëndoshunë.*

Kombimbimin e lidhëzës *po* me pjesëzën *ende* e gjejmë në dy raste dhe te Pjetër Budi:

39. Bu DC 40 10: *e dhanë gjithë aqë të mira të/ paanjefuna , po ende me të paaçmuomit/ gjak të vet na kaa çpërbleem.*

VEÇË

Në veprën e Bogdanit, **veçë** është përdorur kryesisht si pjesëz “vetëm: it. solo, solamente”¹: [...] *tue kjanë veçë Hyji i amëshueshim, andaj vjen se këjo shoqëni tjetër se Hyji nuk munë jetë.*¹

Por nuk mungojnë dhe rastet kur është përdorur si lidhëz:

40. Bo II 15 8: [...] *e silla kurraj tjetër nukë dëshëronte natë e ditë, veçë si kish për të pëlqyem Tinëzot.*

41. Bu DC 165 5: *posikundrëse thashë , se t ish i dërejti i t/ dërejtvëvet , veçë kuur tee sheh , se ashtë [...]*

Si konektor teksti do të përdoret kur shërben si lidhëz që lidh fjali të një fare, njëra prej të cilave shpreh kundërshtim a kufizim për atë që thuhet në tjetrën. Si konektor teksti përdoret në mes të konekteve si në (42, 43, 44) ose në krye të konektit të dytë si në shembullin (45, 46).

42. Bo I 15 99: *I silli tue pām Davidnë ndë petëka~të barisë, të paarmë, veçë me baet n dorë, I ndy keq për asgja nukë po e mbajmë [...]*

43. Bo I 25 90: *Mojzesi tha se gjithë kanë për të dalë, e përse pruteka kacadrëjet kje, me dam të madh qi bānë; veçë vumë regji roe, dha t līr të vejinë atēnitë e bijtë [...]*

44. Bu DC 182 15: *Se mortja tue kërkuom , / ditë e natë nukë meen / të tierë tue rrëzuom ; / veçë kuur te të gjeen , / ndo ke jee tu punuom / kund kafshë mbë këtë jetë [...]*

45. Bo I 5 133: *E nukë mundemi me u nëkuem mbë ata qi e vunë mbë kryjt, përse e banë për të paditunë, as nuk' e njoftinë. Veçë mundemi me u anëkuem mbë të mallëkueminë [...]*

46. Bu DC 225 1: *[...] s kam syy me t u afruom /posi nja i paafee / as i denjë me shukuom/ qielltë përmbii nee ./ Veçë idhunë e helmuom / përmys me faqe për dhe / dergjem errëtë e verbuom [...]*

VEÇËSE

Emil Lafe ka vërejtur se në veprën e Buzukut, lidhëza **veçëse** është përdorur vetëm një herë: “*Mā gjā nukë vijen, veçëse me u qitunë jashtë [...]*”¹. Kurse në veprën e Bogdanit ka një përdorim të dendur. Në trajtimin e **veçëse** si konektor kundërshtor, do të përjashtonim përdorimin e tij si pjesëz, që e shohim gjerësisht të përdorur si në veprën e Bogdanit dhe në atë të Budit.

47. Bo I 20 82: *Prashtu veçëse për shpīrt jemi thanë Jakob ndo Izrael.*

48. Bu DC 11 25: *E këtë kafshë s e bani /për tjetër veçëse për nee fajëtorët*

Kjo lidhëz morfologjikisht është formuar nga parafjala *veç* + lidhëzën *se*. Marrëdhënia kundërshtore që realizon lidhëza *veçse*, është kontrast krahasues. Përdoret në të njëjtat pozicione si dhe konektorët e tjerë lidhëza: në krye të konektit (49, 50), në mes të konekteve (51, 52):

49. Bo I 10 67: *[...] tē ketē me sakrifiuem e me djegunē nji tē vetēminē bīrr~e vet, qi fali Zotynē me shumē lot. Veçëse do me atē punē me na kallëzuem [...]*

50. Bu DC 195 15: *[...] gjithë dheu u faruo , / kafshë e gjallë kund s shpëtoj . / Veçëse aj profetë / nd atē barkë , qi trajtoj , me fëmiizë-të vet [...]*

51. Bo I 5 127: *Nji kafshë kje qi profetixoj Jeremia et Exekjeli; veçëse ato profetī, qi tha përpara Jeremia ndē Jeruzalemt kthjellētē e çelē xhudhijet, ato tē njimendē [...]*

52. Bu DC 11 1: *Këjo , kush kaa pak oo shumē / mend e shqise ndē vetēhe , tjetër / s do me thanē , veçëse na kallëzon nee.*

Konektorë të tjerë kundërshtorë

Si konektorë kundërshtorë, në gjuhën e sotme shqipe, klasifikohen jo vetëm lidhëzat, por dhe ndajfolje të cilat realizojnë kohezionin e tekstit. Një pjesë e këtyre ndajfoljeve ka qenë të

klasifikuara si *gjymtyrë të ndërmjetme* në sintaksë, duke e nxjerrë më në pah funksionin e tyre në njësi përtej fjalisë. Si konektorë kundërshtorë konsiderohen dhe konektorët: ***ndryshe, në të kundërt, në rast të kundërt, përndryshe, përkundrazi, nga njëra anë, nga ana tjetër, prapëseprapë, prapë, sidoqoftë, në të kundërt.***

Konektorët *përndryshe, përkundrazi, prapëseprapë, prapë, sidoqoftë, në të kundërt* nuk gjenden të përdorur në veprën e Bogdanit.¹

KUNDRË

Sipas Eqrem Çabejit¹, *kundër* është fjalë e mbarë gjuhës shqipe, dhe shumë gjuhëtarë vendës dhe të huaj e sjellin nga latinishtja: *contra*.

Gjendet që te Buzuku si fjalë që “kërkon dhanoren (gjinoren pas Kamardës I 331 e G. Meyerit), p.sh. Buzuku (L VIII/2=LXVIII/2, Gjoni 18, 29) *Qish të paditunë bani ju kondra këti njeri.* [...] Budi (DC 24) *kundra antësë tyne*; Bardhi *Contra Kundrë*; Bogdani (I 23, 17) *kundrë anëmiqet.*”¹

Konektorët kundërshtorë *në të kundërt/në rast të kundërt* nuk gjenden të përdorur në veprën e Bogdanit. Në këtë vepër vëmë re një përdorim të fjalës *kundrë*:

a) si parafjalë:

Bo I 15 23: *Ashtu ende fëjej ma fort grueja kundrë vetëhesë, kundrë Tinëzot e shoqit vet, e duketë andaj përse pat ma shumë mallëkime.*

b) si ndajfolje

Bo I 15 324: *Gjithë kundrë u del puna atyne qi vepërojnë keq.*¹

Por në ndonjë rast të rrallë e kemi hasur dhe në një funksion të ngjashëm në kundërshtim me atë që si në shembullin:

53. Bo I 15 23: *Ma aj qi i ruente u tha se po drōj të mos moriteshinë, kundrë si kish urdhënuem regji.*¹

Kurse raste të përdorimit të mirëfilltë si konektor teksti nuk kemi hasur. Në veprën e Budit *kundrë* është përdorur kryesisht si parafjalë: (Bu DC 119 5) *ashtë rrenë e mkat kundrë Shpiiritit.*

NDRYSHEJ

Në gjuhën e sotme shqipe, *ndryshe* përdoret a) si ndajfolje, me kuptimin *në mënyrë tjetër, me tjetër mënyrë a rrugë, ose me tjetër brendi, cilësi a trajtë*; dhe b) si lidhës me kuptimin *në rastin e kundërt*,

përndryshe. Do të konsiderohet si konektor teksti nëse mund të zëvendësohet nga konektorë të tjerë teksti si *në të kundërt*, *në rast të kundërt* etj., dhe lidhja semantike që ekziston mes fjalive mbetet e njëjtë.

54. *Pra, ashtu ju qëndron ura. Ndryshej, as të mos mundohi kot e të punoni, urë kurrë s'do të mbaroni.*¹

Në veprën e Bogdanit, *ndryshej* nuk e kemi hasur të përdorur si konektor teksti, por si ndajfolje “në mënyrë tjetër: it. altrimenti; përndryshe: it. altrimenti”¹:

55. [...] *françestë e tudheshqitë, të sijtë ndryshej shkruajnë se si xgedhinë.*¹

56. *Përse kallëzon punëtë si janë ndë vetëhe, e jo ndryshej.*¹

Të njëjtën gjë mund të themi dhe për veprën e Budit, ku e kemi hasur të përdorur vetëm 4 herë:

57. Bu DC 106 5: [...] *me j a bam ; përse na s jemi ndryshej / mbaajtunë këto shinte vepëra* [...]

58. Bu DC 130, 20: *Përse mkati s ashtë ndryshej ndë / shpiirti-të nieriut veçëse posikuur.*

PËRFUNDIME

Disa nga përfundimet e këtij punimi janë:

1) në veprën e Bogdanit ka një larmi mjetesh lidhëzore që realizojnë marrëdhënien kundërshtore në tekst. Kjo mund të shpjegohet me vëzhgimin që ka bërë Selman Riza se “Mënyrën e të hartuarit të tij e karakterizon përpjesëtimi i mbarë i zhvillimeve të veçanta si dhe kalimi i përgatitur nga njëra ide te tjetra.”¹

2) Konektorët kundërshtorë lidhëza që janë përdorur në veprën e Bogdanit janë: *po, ma, veçë, veçëse, mbise, asgjamangu*.

3) Në veprën e Pjetër Bogdanit janë përdorur si konektorë teksti pothuajse të gjitha lidhëzat kundërshtore që janë përdorur dhe në veprën e Gjon Buzukut: *ma (ma), po, mâse (mbise), veçëse*, me përjashtim të lidhëzave *por, pur*.

4) Si konektor kundërshtor është përdorur dhe ndajfolja *kundrë*.

5) Lidhëzat më të përdorura *po* dhe *ma*, i gjejmë shpesh të shoqëruar me *ende: po ende, ma ende*.

6) Siç është vënë re, Bogdani duhet t'i ketë njohur e përdorur veprat e paraardhësve, të paktën Budin, prej të cilëve mund të jetë ndikuar për përdorimin e lidhëzës *asgjamangu*.

7) Ashtu sikurse e thekson Prof. Selman Riza “vazhdues i vërtetë i Budit nuk qe Bardhi, autor me një vetësi pamjaftësisht të vijëzuar e me një rol gati epizodik në traditën letrare të gegërishtes së vjetër: në këtë traditë vazhdues i vërtetë i Budit qe Bogdani. [...] Budit (jo retorika pedante e të laureuarve, por) oratoria e frymës popullore iu pat shndërruar në një natyrë të dytë. Prandaj prozën e tij le ta rëndojnë e madje le ta mbytin sa të duan të famshmit çifte antonimikë e jo më pak se të famshmet fjali të stërzgjatura; prapëseprapë, në letërsinë shqipe. Budi mbetet që mbetet përfaqësuesi më tipik i prozës periodike. Anasjelltas Bogdanit përtypja dhe ripërtypja të lëndëve, punimi dhe ripunimi i trajtës i qenë bërë shprehi. E qe pikërisht në saje të kësaj shprehie që ai më në fund arriti të pajosë letërsinë tonë të vjetër me modelin më bindës të prozës shkencore të nivelit evropian. Kështu Bogdani u bë konsolidues i autoritetshëm e lavrues i mëtejshëm i traditës letrare të Buzukut, Budit e Bardhit.¹

Bibliografia

- [1] Çabej, E. *Studimi etimologjike në fushë të shqipes*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, II, Tiranë, 1976.
- [2] Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Botime Çabej, Tiranë, 2014.
- [3] Dizdari, T. *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*. Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam. Tiranë, 2005.
- [4] Lafe, E. *Lidhëzat te libri i parë shqip*. Studime filologjike, 1971. Nr. 4.
- [5] Mëniku, L. *Konektorët e gjuhës shqipe*. Monografi. Albas, Tiranë, 2014.
- [6] Mitko, Thimi. *Vepra*. Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë, 1981.
- [7] Omari, A. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- [8] Omari, Anila. *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2016.
- [9] Pasch, Renate, Ursula Brauße, Eva Breindl&Ulrich H.Waßner. *Handbuch der deutschen Konnektoren. Linguistische Grundlagen der Beschreibung und syntaktische Merkmale der deutschen Satzverknüpfen*. Berlin, de Gruyter, 2003.
- [10] Riza, S. *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*. Botime Toena, Tiranë, 2002.

- [11] Shuteriqi, Dhimitër. *Naim Frashëri-jeta dhe vepra*. Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë, 1982.
- [12] Topalli, K. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2017.
- [13] Thomai, J., Samara. M., Haxhillazi P., Shehu. H, Feka Th., Memisha V., Goga A. *Fjalor i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 2006.

Materiale nga Interneti

<http://www.peaceculture.net/krieg-al/vorwort-al.htm>.

Mimoza Hasani Pllana, Prishtinë

KOLEKSION TEMASH NË POEZINË E NJË DEKADE TË VEÇANTË

Abstrakt

Koleksion temash në poezinë e një dekade të veçantë nuk nënkupton aktin e mbledhjes së materialit për një koleksion poezish së një teme a më shumë, por një kategorizim problemesh të përsëritura që shënojnë disa ndryshime të dukshme në veprat poetike të fundshekullit XX në Kosovë. Kështu, me këtë proces kuptojmë leximin për të kërkuar kuptimin, motivet që përbëjnë lëndën themelore të veprës dhe shkaqet e ndryshimeve të dukshme tek poetët e dëshmuar; pse për ata është e nevojshme që pas tre-katër dekadash të rimendojnë për kërkesat tematike, pse është e nevojshme të ndryshojnë edhe kërkesat stilistike apo të ruajnë ato tradicionale, si dhe pse poezia gjatë kësaj kohe duhet të bëhet hermetike *dhe më e vështirë* për interpretim?

Pamja e përgjithshme

Një dekadë letrare si kjo e viteve `90 ofron mundësinë që vepra poetike të lexohet edhe si produkt historik, social e kulturor, sigurisht i realizuar me mjete letrare. Si produkt letrar me rrënjë në histori, poezia e fundshekullit XX universalizon dhe me përzgjedhjen e fjalëve ngre lart ngjarjet e veçanta historike të popullit të Kosovës. Si produkt social merr një funksion të ri, meqë me aktin e shprehjes paraqet kuptimin e ngjarjeve shoqërore përmes mendimeve të poetëve për shoqërinë, dashurinë, emigrimin, durimin, plakjen, vdekshmërinë. Një realizim i tillë jetësohet kryesisht përmes simbolit, metaforës, alegorisë, ironisë, figura këto që karakterizojnë poezinë e një kohe krejt të veçantë, një kohe që ndryshoi rrjedhën e historisë nacionale të popullit shqiptar të Kosovës. Përveç reflektimit ndaj çështjeve historike e shoqërore, poetë e poetesha vetëdijshëm reflektuan edhe ndaj ideve për ndryshime kulturore, duke marrë përjetime personale nga jeta reale e një kohe konkrete, siç është ajo pas heqjes së autonomisë së Kosovës nga pushteti serb e jugosllav, për të krijuar një realiteti të ri poetik. Poezia me tematikë nacionale e sociale është e rëndësishme për lexuesin e

cilësdo kohë, meqë e ndihmon atë të kuptojë, të vlerësojë ngjarje të veçanta nacionale dhe të japë mendim kritik për kontekstin. Po ashtu, kjo poezi është e rëndësishme për dritën që hedh mbi të vërtetën e errët të shqiptarëve të Kosovës; është si një dritare që hap komunikimin me botën përreth.

“Jeta që kushtëzon tematikën”

Zhvillimin e poezisë me tematikë nacionale e shohim, siç shkruan prof. Sabri Hamiti, tek vepra “Tematologjia”, të kushtëzuar nga jeta sociale, gjuha, moraliteti, karakteri e historia e veçantë nacionale.¹ Kjo e fundit, edhe nëse nuk e kushtëzon poezinë si krijim të lirë, mund të thuhet se i jep kahje të re magjepsjes, frymëzimit të poetëve, vepra poetike e të cilëve u botua në mes të viteve 1990-1999.

Nëse vlerësohet si krejt e natyrshme që tematika nacionale ka tendencë për të krijuar veçantinë dhe identitetin kombëtar që shënjohej më vete dhe në raport me të tjerët¹, atëherë poetët Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja (vepra e të cilëve është pjesë e punimit), lanë gjurmët e tyre në një tablo të gjerë poetike që krijon ndjesinë e një përkatësie të veçantë.

Me një qasje sinkronike, krijimet që lidhen me këtë tematikë i përkasim poetëve të një brezi që në kohën e përmendur tashmë kishin krijuar një trashëgimi poetike nisur nga vitet `60, `70 dhe poetëve të një brezi të ri, që tashmë kishin hedhur materialet e para në procesin e krijimit. Dy brezat, bashkarisht krijuan një pamje të plotë se si shtrihen tematikat nacionale në poezinë shqipe të Kosovës gjatë një dhjetë-vjeçari jo të zakonshëm. Mund të quhet periudhë jo e zakonshme për krijimtarinë letrare për faktin se, poetët bëhen pjesë e iniciativave dhe organizimeve me qëllim të përmbushjes së kërkesës popullore për krijimin e shtetit të Kosovës dhe pavarësisë së saj.

Në kuadër të një dekade intensive të refuzimit të politikave serbo-jugosllave që bënin trysni me qëllim të zhbërjes së çdo institucioni arsimor e kulturor dhe çdo institucioni tjetër në gjuhën shqipe, poetët, përmes fjalës, lanë gjurmët e tyre kryengritëse krahas intelektualëve dhe atdhetarëve tjerë. Prandaj, këto poezi lexohen pasi të jenë të njohura rrethanat e mjedisit krijues, pra, kërkohet një lexim kontekstual. Në fund të fundit edhe vetë kuptimi i poezisë sipas teoricientëve R.Wellek dhe A.Waren, është kontekstual, meqë, në poezi fjala bart jo vetëm

kuptimin nga fjalori, por edhe kuptimin e fjalëve tjera që lidhen me të nga ana kuptimore.¹

Vlerësohet se në kuadër të këtij harku kohor, autorët e etabluar ridimensionuan kërkesat tematike, madje edhe ato stilistike, duke ruajtur format letrare.¹ Poetët A. Shkreli, Rr. Dedaj dhe A. Podrimja bëjnë dallimet tematike me veprat e mëhershme, duke ndërlidhur dashurinë për vendlindjen, atdheun me zhvillimet e reja të kohës, konkretisht me krizën politike. Po ashtu, poetët fuqizuan idenë për ndryshim, duke bërë thirrje përmes poezisë me gjuhë simbolike. Gjuhën simbolike, veçanërisht e fuqizon poeti Rrahman Dedaj, gjë që e bëri poezinë e tij mjaft hermetike për interpretim.

1. Azem Shkreli

Nata e Papagajve (1990)

Lirikë me shi (1994)

Zogj dhe gurë (1997)

“*Nata e papagajve*” si vepra e parë që hap dhjetëvjeçarin më produktiv të poetit Azem Shkreli, sa i përket botimeve, strukturohet nga ciklet në vijim: “*Libri i tretë i heshtjes*”, “*Lirikë për gurë*”, “*Fara e hithës*”, “*Këtu ishte njeriu*”, “*Pergamenë*”. Si cikle, të gjitha ruajnë lidhjen me figurat me bazë lokale, përqendruar në vendlindjen e poetit, në trashëgiminë gjeografike e kulturore, si një burim temash për poezinë jo vetëm tek vepra “*Nata e Papagajve*”, por edhe te krijimet tjera të një dekade të veçantë siç është kjo në fund të shekullit XX. Si lidhje me semantikën e mëhershme vlerësohet se, poezitë nga “*Libri i tretë i heshtjes*” vijojnë semantikën e figurave nga vepra “*Bibla e Heshtjes*”, sikur edhe poezitë nga cikli “*Lirikë për gurë*”, që ruajnë semantikën tradicionale të gurit si figurë reminishente ambientale,¹ por ndërlidhur me zhvillimet e kohës kjo figurë merr kuptime të reja, duke bërë thirrje për qëndresë, durim dhe trashëgimi.

Përsëri te ky gur i mirë

Dhe ilirisht i lashtë rri unë rri fjala¹

Lëkundjet politike që prodhuan krizë sociale bëhen të pranishme edhe të ciklet “*Fara e hithës*”, “*Këtu ishte njeriu*”, figurat e të cilave i

referohen atutoktonisë së popullit shqiptar në tokën e Kosovës dhe pozicionit të tij aktual.

Vepra “*Lirikë me shi*”, vjen si një metaforë konceptuale që në titull jep të kuptuarit e idesë së vajit, emocionit gjatë aktit të krijimit. “*Lirikë me shi*” është një vepër e bukur, jashtëzakonisht e bukur, një këngë vajtimi që ndjek një ritëm në vargje, ashtu si një instrument që ndjek një vijë melodike. Poezitë e saj i përcjell një ndjeshmëri e bazuar në mënyrën se si poeti e përcepton krizën dhe si reagon ndaj padrejtësive që bien mbi Kosovë gjatë viteve 1990-1999.

Sonte qava sonte për ty Arbëri

Nuk më vjen turp

Pse qava

Më vjen turp pse s`munda

Të bëj tjetër

*Nga turpi qava*¹

“*Lirikë në shi*” josh kritikën letrare të Kosovës që të çmojë ndryshimet e prekshme dhe të shkruajë vlerësime krejt të reja, krahasuar me ato që i bëheshin veprës paraparake të Azem Shkrelit. Nëse në veprat e mëhershme Azem Shkreli veçohet për artin poetik që e mbështeste në sensibilitetin e matur, në figurën ambientale dhe në moralin e fjalës vendëse, duke shkruar si fliste dhe duke folur si shkruante, me përdorim të theksuar të figurave të fjalës dhe të heshtjes, tani, me veprën “*Lirikë në shi*”, poeti çmohet që shkroi lirikat e vajtimit, dhe vepra cilësohet si “*Libri i vajtimit të autorit*”.¹

Vajtimi, si një shprehje e pikëllimit, te vepra “*Lirikë në shi*” bëhet një nga format e manifestimit së keqardhjes për fatin e Kosovës dhe të njerëzve të saj. Vajtimi është ankthi i zjarhtë i poetit, i shprehur në vargje:

Koha në dysh po këputet, orë e trishtë po rri,

Mbi kokë me sopatë të madhe

Trupat të avullt të grave, motmote të njohma

Ofshe të nënave, na pritni

*Le të rriten bimët e fëmijët, etja le ta marrë
 Zogun e zërin e krypën
 Vetëm udhët le të plaken, lë t'i zbardhet floku
 nisjes sonë, jo kthimit
 Udhë e zezë, gjarpër i gjatë, na hëngre
 Na shpure përtej harrimit¹*

Orë e trishtë, Udhë e zezë janë metaforat kurora të fatit të hidhur që mbuloi shqiptarët e Kosovës, të cilët detyrimisht lanë atdheun, në një kohë të caktuar. Figura të ngjashme janë të pranishme edhe te poezitë me motive nga përditshmëria e që figurojnë dhunën, trishtimin, persekupimin, dëbimin, dhembjen shqiptare. “*Dhunë*”, “*Psalm për Kosovë*”, “*Lirikë me shi*”, “*Lirikë për larine*”, “*Kronikë ilire*”, “*Motiv me Kosovë*” janë poezitë e përjetësimit të krizës dhe shkeljes së të gjitha të drejtave dhe lirive të një populli të vjetër ballkanik, popullit shqiptar. Ndërkaq, përmes tematikave popullore e historike, Shkreli bën thirrje të dëshmohet vjetërsia shqiptare karshi trysnisë së pushtimeve e qeverive të vazhdueshme që lanë gjurmë barbarie mbi këtë vend:

*Në fillim ishin zogjtë, lumenjtë, ilirët
 Hanin ilirisht dhe punonin ilirishtë tokën
 Lindnin dhe vdisnin të lirë, lirshëm, ilirisht*

*Pastaj erdhën turrë turrë nga perendimi
 Kërkonin tokë ilire, ujë ilir
 U thanë: I paskeni të artë gurët, të bukët tokën*

*Pastaj erdhën turrë turrë nga lindja
 Kërkonin tokë ilire, qill, ujë ilir
 U thanë: i paskeni këngët dhe kafkat të bukura
 Dëshën t'i venë në një tumë, deshën
 T'u japin balsëmin e luleve¹*

Vepra e tretë që mbyll një dhjetëvjeçar, “*Zogj dhe gurë*”, përsëri mban një titull figurativ, por kësaj here të pamiruar përfundimisht nga dora e autorit, meqë libri është post mortum. “*Zogj dhe gurë*” u botua pas vdekjes së poetit dhe për këtë fakt, duhet kujtuar se poezitë mund

të mos ishin në variantet e fundit që do t'i kishte dëshiruar ai. Ashtu siç është, vepra pasurohet me një temë jo fort të trajtuar nga Shkreli, por të pranishme në shumicën e veprave poetike të kohës, fjala është për migracionin e jashtëm, në këtë rast migracionin e pavullnetshëm e të detyrueshëm të shqiptarëve. Si përmbyllje, nga koleksioni i poezive të mërgimit ndajmë poezinë “*Shtegtarët*”, si produkt i frikës së autorit nga zbrazja e vendit dhe shkuarja e shqiptarëve drejt një rruge pa kthim:

Fundin e udhës s`e dinë

Ata që vajtën

.....

Fundin e udhës e dinë

Ata që nuk u kthyen¹

Sa i përket prurjeve tematike, Azem Shkreli vlerësohet se gjatë dekadës së fundit të shekullit XX, pasuron krijimtarinë poetike edhe *me temën e ndërliqshme nacionle, krahas asaj të dashurisë, të vendlindjes dhe kulturore*,¹ si pasojë e krizës nacionale, sigurisht.

2. Rrahman Dedaj

Dreqi nuk plaket (1991)

Kryqëzim hijesh (1997)

Rrahman Dedaj, me veprat “*Dreqi nuk plaket*” dhe “*Kryqëzim hijesh*”, ashtu si edhe autorët tjerë të viteve `90, provon aventurën e poezisë postmoderne¹ e që sipas profesor Zejnullah Rrahmanit, teoricent letrar, *poezia postmoderne shfaqet pas Luftës së Dytë Botërore, si produkt i përzierjes së ideve poetike, religjioze, psikologjike, mitologjike dhe ideve tjera që vijnë nga fusha e teknologjisë*.¹ Kjo teori provohet nga Dedaj, kur ndikuar nga situata e viteve 1990-1999, frika për të ardhmen, vrasjet e bazuara në mite, dhuna ndaj të voglit nga i madhi dhe frika lidhur me shkatërrimin e kombit figuron brengat personale duke integruar figuracion të përvojës popullore, si në vazhdim:

I njëjti bukëpjekës dhe zjarri

I njëjti gjellbërës dhe pjata

I njëjti kasap dhe thika
I njëjti mishngrënës dhe gjengji.

E njëjta gjë provohet kur shfaqet frika e përsëritjes së historisë në funksion të zhbërjes dhe copëtimit të atdheut, te poezitë e veprës “*Kryqëzim hijesh*,” vetëm se frika tani kalon si një ankth mbinatyror që dëshmohet përmes pranisë së të njëjtit “rrobaqepës”, përcaktues të hartës së shtetit shqiptar në fillim të shekullit XX, si në vargjet në vijim:

Si e prenë me gërshërë
Hartën e atdheut tim
Rrobaqepësit e vjetër të Evropës
Babai im ishte fëmijë¹

Bazuar në këtë lloj gjuhe, kritika letrare e Kosovës, Dedajn e vlerëson si poet simbolist, si krijues që skajshmërisht përdor figurën pothuajse në secilin varg, me ç’gjë e komplikon qartësinë e kuptimit, madje edhe e bën të pamundur dekodimin e saj. Megjithatë, e pavarësisht kësaj, Dedaj në situatat pa rrugëdalje me nostalgji frymëzuese e me mallin për kohën e shkuar di të bëhet i thjeshtë në mendime e në fjalë. Në këto raste, ai kthehet te e njëjta referencë, *te Penuha*, fshati i lindjes, si një strehë e sigurt dhe e përhershme për të. Në këto gjendje, poeti lë anash lojën me figurën dhe shpërthen në emocione, pa i fshehur në asnjë varg:

Ku je ti është zemra ime
Guri i kujtesës ngulet
Deri në Penuhë
Asnjë udhë kurrë
S`mi mashtroi këmbët¹

3. Ali Podrimja

Zari (1990)
Në bisht të sorrës (1994)
Buzëqeshja në kafaz (1994)
Ishulli Albania (1998)

Temën nacionale Ali Podrimja e kishte pjesë të interesimeve, që në paraqitjet e hershme para lexuesit. Që atëherë, Ali Podrimja do të frymëzohej edhe nga kodi etik, sidomos i Esad Mekulit dhe do ta ndjejë përgjegjësinë historike, ndjenjën për të qenë përgjegjës për fatin kolektiv kosovar.¹ Përgjegjësinë e marrë në rini, Ali Podrimja do ta ruajë përgjatë pesë dekadave të krijimtarisë poetike, duke shprehur guximshëm revoltën dhe refuzimin ndaj regjimit serb e jugosllav. Ky guxim është i krahasueshëm me guximin e poetëve që vijnë nga popujt me histori të përafërt me atë të popullit shqiptar, siç është poeti me prejardhe hebreje, *Osip Mandelstram* i njohur për revoltën e shprehur ndaj regjimit të Stalinit.

Revoltën, refuzimet ndaj padrejtësive në funksion të mbrojtjes së popullit të vet, poeti Ali Podrimja nuk hezitoi ta thotë as në intervistat ndërkombëtare që i bëheshin nga gazetarë shqiptarë e të huaj në fund të shekullit XX. Në njërën nga ato, poeti kujton si në vazhdimësi ka ngritur zërin kundër padrejtësive ndaj popullit shqiptar të Kosovës dhe më pas ndalet e rrëfen për ndjesitë personale të krijuara si pasojë e tmerreve të përjetuara në familje, të cilat u bënë material temash për poezinë, si: *vrasja e shtatë vëllezërve të nënës së tij nga regjimi serb, pastaj, vrasja e fëmijëve, pleqve, grave shtatzëna, si dhe përdhunimi i vajzave të reja nga regjimi serb i viteve 1990-1999*. Poeti shton se këto dhe situata tjera personale dhe kolektive e shtynë të shkruajë poezi, citoj: *“Ndjenjat shpirtërore, ngjarjet e mëdha dhe padrejtësitë ndaj njerëzve të mi më bënë të shkruaja poezi”*.¹ Ky lloj kundërshtimi i vazhdueshëm, rebelimi e revolta që poeti manifestoi në vargje nuk kaloi pa i kushtuar me sfida të rënda përgjatë gjithë jetës. Pushteti i atëhershëm, si hakmarrje ndaj kryengritjes dhe mosnënshtrimit, poetit i krijoi pengesa që nga mosha e rinisë kur u përjashtua nga shkolla e mesme e lartë, ndërkaq kur publikoi poezinë *“Kosova është gjaku im”*, gati përfundoi në burg. Në këtë situatë të vështirë, sipas rrëfimit të Podrimajt, humanisti Esad Mekuli i bëhet krah mbështetës për ta shpëtuar nga përjetimi i rëndë i burgut, për ç’gjë poeti deklaroi se i është mirënjohës.¹

Përpjekja për ta kundërshtuar sistemin, për t’i dhënë fund padrejtësive e bënë poezinë e tij logo të revoltës së shprehur përmes fjalës poetike. Sipas kritikës së Kosovës *“Revolta është esenca e përhershme e poezisë së tij, madje e gjithë shkrimit.”*¹ Revolta bëhet poetikë e fjalës së shkruar me dhimbjen e përhershme. Lidhur me këtë, vlerësohet se Podrimja shkruan me intensitet emotiv të brendshëm e të fuqishëm në krahët e dialogut mes jetës dhe vdekjes, që kur zbulon

filozofinë e ekzistencës së vet “...se të jetosh, do të thotë të mësosh si vdiset.”¹

Një qëndrim i përafërt për jetën, poetin e përcjell edhe në dhjetëvjeçarin e fundit të shek XX, megjithëse në poezitë e kësaj dekade dhimbja kolektive triumfon mbi atë personale si pasojë e krizës socio-politike në Kosovë. Tani, dhimbja kolektive bëhet personale si rezultat i tipi të përvojës *eundo assequ*.¹

Fillim kur s`ka

S`do ketë as mbarim

Sidoqoftë kurseni kokat

*Vezullon shpata*¹

Tematika nga historia e gjerë e Kosovës pashkëputur që është pjesë e gjithë krijimtarisë dhjetëvjeçare, sigurisht përfshirë edhe veprën “Zari”. Ngjarjet, të dhënat jetësore ndërliidhen varg e vijë për të dhënë detaje të rëndësishme për historinë kombëtare në kohë të ndryshme, si: Lidhja e Prizrenit, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Pastaj vjen lidhja e toponimisë historike e toponimisë gjeografike, si: Kosova, Vlora, Prizreni, Korça, Gjakova, Dodona, Ohri, Çamëria, të cilat bashkarisht krijojnë një lidhje gjeografike të tokave shqiptare të cilat, sot, funksionojnë ndaras, dhunshëm.

Aleve të pafund të Korçës

Si aleve të harruara të Ilirisë

ç`mçu shfaq harta e humbjeve të mia

Vaji i thekshëm i një flaute të vetmuar

Aty në hijen e Orakullit të Dodonës

Thyen heshtjen e çatave mijëvjeçare

E në shuplakë e shtrirë të territ

Pikëlonin yje

Nga qiejt e padukshëm

Yje Kosove

As Çamërie nuk ishin ata

Po klithma të një flaute trishtuese

*Që më zgjonte aleve të Korçës*¹

Kështu, Podrimja nuk shkëputet së trajtuari tema të lidhura me fatin e kombit shqiptar. Kështu ai I mbetet besnik stilit të vjetër duke shprehur kundërishtimet metaforikisht¹, por jo gjithnjë. Atdheu si Kosovë, si Shqipëri e Çamëri, krijohet e rikrijohet me figura të ndryshme. Në veprën “*Ishulli Albania*”, Podrimja risjell atdheun/ Shqipërinë përmes simbolit të një ishulli të braktisur që s`mund t`i vie në ndihmë Kosovës kur hija e vdekjes e mbulon dhe poeti klith:

Hap syrin

Dhe nuk mundem pa këlithur

Hija e vdekjes

Ma paska mbuluar Kullën¹

Ndonëse, vepra “*Ishulli Albania*”, vjen si e fundit, si vepra që përmbyll gjysmëshekullin e krijimtarisë së poetit, Ali Podrimja nuk mbetet pa rënë në sy e pa u përfolur nga kritika e Kosovës, në veçanti për gjuhën e saj simbolike. Nisur nga titulli që ndahet në dy simbole: *Albania* dhe *ishulli*, nënkupton izolimin politik dhe mungesën e lirisë së popullit shqiptarë në tërësi.¹ Përveç semantikës, vepra vlerësohet për temat që vijnë si produkt i krizës nacionale në Kosovë dhe Shqipëri, specifikisht krizës së pesëvjeçarit të fundit të shekullit XX.

Resume

A literary decade like this one of '90s offers the opportunity for the poetic works of Kosovo to be read as a historical, social and cultural product, certainly made up of literary devices. As a literary product, rooted in history, poetry of the late twentieth century universalizes and with the selection of words gives great importance to the special historical events of the people of Kosovo. As a social product it takes on a new function, since with the act of expression it represents the meaning of social events through the poet's thoughts on society, love, emigration, patience, aging, mortality.

All of this is realized mainly through the chosen language, through the symbol, metaphor, allegory, irony, and these figures of speech that characterize the poetry of a very special time, a time that changes the course of the national history of Albanian people of Kosovo. In addition to reflecting on historical and social issues, poets

consciously also reflected on ideas for cultural change, taking personal experiences from real life of specific time, such as that after the abolition of Kosovo's autonomy by Serbian and Yugoslav regime, to create a new poetic reality. Poetry about national and social themes is important for the reader of any time, as it helps him to understand, evaluate special national events and give critical thinking to the context.

Also, this poem is important for shedding light on the dark truth of Kosovo Albanians; it is like a window that opens communication with the world around. Critics of Kosovo estimate that the poets who published during this decade re-dimensioned the thematic requirements, and even changed the stylistic criteria, making hermetic poetry more difficult to interpret.

Bibliografia

- [1] Azem Shkreli, *Nata e Papagajve*, Rilindja, Prishtinë, 2006
- [2] Azem Shkreli, *Lirikë në shi*, Rilindja, Prishtinë, 2006
- [3] Azem Shkreli, *Zogj dhe gur*, Rilindja, Prishtinë, 2006
- [4] Ali Podrimja, *Vepra*, Vëllimi i parë, ASHAK, Prishtinë, 2013
- [5] Ali Podrimja, *Vepra 4*, ASHAK, Prishtinë, 2013
- [6] Ali Podrimja, *Vepra 5*, ASHAK, Prishtinë, 2013
- [7] Goldwyn; R. Hoxha, *Finally*, Ali Podrimja Spoke A Conversation, publikuar në *World Literature Today*, May/June 2012, Vol.86 (3)
- [8] Kujtim Shala, *Shekulli i letërsisë shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006
- [9] Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*", 99 AIKD, Prishtinë, 2016
- [10] Nysret Krasniqi, *Thymos*, 99-AIKD, Prishtinë, 2019
- [11] Philippe Lacoue-Labarthe: Translated by Andrea Tarnowski, *Poetry as Experience*, Stanford University Press, 1999
- [12] Rene Wellek & Austin Warren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, Tiranë, 2007
- [13] Rrahman Dedaj, *Vepra letrare 3*, Faik Konica, Prishtinë, 2008
- [14] Raimon Keno, *Ushtrime Stili*, Panteon, Tiranë, 1999
- [15] Sabri Hamiti, *Letërsia Bashkëkohore*, Faik Konica, Prishtinë, 2002
- [16] Sabri Hamiti, *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë, 2005
- [17] Zejnullah Rrahmani, *Arti i Poezisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2001

Lumnije Jusufi

TRANSFER KULTUROR DHE GJUHËSOR GJERMAN NË KOSOVË

Abstract

This article addresses German-Albanian contact in cultural and language terms. The resulting findings are placed here in the context of Espagne and Werner's concept of cultural transfer and expanded to include the component of language transfer. German transfer in Kosovo is deeply rooted in culture and language and is temporally complex. Depending on the period of origin, it is Yugoslavian, all-Albanian or single-Kosovar. At its core are the various migration flows from Kosovo in German-speaking countries, which is further intensified by globalisation and digitalisation. The study is based on empirical data collected by the author as part of a larger project on cultural transfer and migration.

Keywords: Cultural transfer, language transfer, Albanian-German relations, migration, consumption

0 Hyrje

Transfere kulturore dhe gjuhësore gjermane në Kosovë janë jo vetëm të shumta, por edhe të shtresave të ndryshme, si nga koha ashtu edhe nga rrugët dhe ndërmjetësuesit e këtij transferi. Ky artikull është në kërkim të këtij transferi kulturoro-gjuhësor në bazë të materialeve empirike në Kosovë. Artikulli ka për kornizë një projekt mbi „Migracionin dhe transferin kulturor mes Gjermanisë dhe Ballkanit perëndimor shqiptar“, të drejtuar nga autorja dhe të financuar nga Ministria Federale për Arsim e Shkencë e Gjermanisë („Bundesministerium für Bildung und Forschung“, 10/2019–11/2022) në Universitetin Humboldt në Berlin.

0.1 Koncepte dhe terminologji

Artikulli bazohet në një koncept nga shkencat kulturore dhe për gjuhësinë pak e pazakontë. Dega relativisht e re e kërkimit mbi transfere kulturore lindi me zhvillimin e konceptit të transferit kulturor në shkencat kulturore dhe historike nga Michel Espagne dhe Michael

Werner në vitet e 1980-ta duke përdorur shembullin e marrëdhënieve gjermano-franceze në shekujt 18 dhe 19 (Espagne / Werner 1985). Ky koncept përqendrohet në elementet e kulturave të huaja në kulturën e pikënisjes. Sidoqoftë, Espagne përqendrohet në aktorët dhe mediat, të cilat ai i quan ndërmjetës, në atë që ai e konsideron si kërkimin në transferin kulturor të mundshëm vetëm përmes kërkimit të aktorëve (Espagne 1997a, b). Lüsebrink ka një kuptim më të gjerë të transferimit kulturor. Ai e përkufizon atë si vijon: “Qasja metodike e transferit kulturor merr kështu ,shtigjet, mediat dhe kushtet gjuhësore për përcjelljen e teksteve, objekteve dhe praktikave kulturore’ si pikënisjen e saj.” (Lüsebrink 2016: 143). Ai e definon atë afërsisht si më poshtë (Lüsebrink 2016: 145):

1. Me tre dimensione: kultura burimore, artefakte të transferuara (objekte, diskurse, tekste dhe praktika) dhe kultura e synuar.

2. Në tre procese: përzgjedhja, ndërmjetësimi dhe marrja.

a. Përzgjedhja bazuar në tre motive: interes teknik, praktik dhe ideologjik

b. Ndërmjetësimi në formën e tre figurave dhe institucioneve: ndërmjetësues individual, ndërmjetësues institucional dhe ndërmjetësues medial

c. Pesë forma të recepcionit: transmetimi, imitimi, përshtatja kulturore, format e komenteve dhe pritja produktive.

3. Me tre forca lëvizëse: interesat ekonomike, objektivat politike dhe ideologjike si dhe faktorët emocionalë ose afektivë (p.sh. imazhi francez i Gjermanisë).

Ndërsa proceset e transferit kulturor nga shekulli 16 deri në shekullin 20 në thelb prek vetëm elitën, proceset e transferit kulturor global dhe digjital prekin pothuajse të gjithë shoqërinë, për shembull në kulturën e konsumimit dhe të mediave. Karakteristikë për të gjitha proceset e transferit kulturor është, se ato ndodhin në kohëra tranzicionesh (Lüsebrink 2016: 158).

Koncepti është zbatuar në studimet e mëtejshme në shumë disiplina shkencore, në kultura të ndryshme në mbarë botën – kultura kombëtare dhe rajonale, dhe gjithashtu zhvillime më moderne – evropianizimi, globalizimi dhe amerikanizimi. Përveç kësaj, fenomeni është njohur prej kohësh në studimet e migracionit dhe globalizimit dhe gjithashtu është hulumtuar gjerësisht, pa përdorur gjithmonë termin ose konceptin e Espagne-s.

Në gjuhësi, fenomeni ka qenë prej kohësh i njohur brenda hulumtimit të kontaktit gjuhësor, por për të cilin përdoren konceptet e

zhvilluara veçanërisht për gjuhësinë si *huazime*, *ndikime gjuhësore* dhe, së fundmi, *interferenca*, bazuar në Michael Clyne (Hellinger 1980). Termi *transfer gjuhësor*, si rrjedhojë e *transferit kulturor*, është pjesë e hulumtimit të transferit kulturor dhe nënkupton aspekte të përkthimit dhe kërkimit të mësimdhënies së gjuhës së huaj, të cilat Lüsebrink në citimin e mësipërm i quan “kushte gjuhësore”. Por përdorimi i termit *transfer gjuhësor* për fenomene dhe aspekte interferencash gjuhësore si pjesë e transferit kulturor është më i përshtatshëm. Zgjerimi i konceptit të transferit kulturor për të përfshirë qasjet gjuhësore bëhet këtu për herë të parë. Në këtë mënyrë, ai shndërron kërkimin e mëparshëm të sistemit gjuhësor të kontaktit të gjuhës në kërkimin sociolinguistik të kontaktit të gjuhës dhe transferit gjuhësor në një transfer më të gjerë kulturor. Duke vepruar kështu, ndërhyrja leksikore si pjesë e transferit kulturor, veçanërisht në kulturën materiale, mund të hulumtohet shumë mirë, gjerësisht dhe me një diskurs sociolinguistik shumë më të madh. Historikisht, artefaktet që janë zhdukur prej kohësh mund të bëhen të kapshme për shkencën nëpërmjet gjuhës.

0.2 Marrëdhëniet gjermano-shqiptare

Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane janë marrëdhënie të veçanta që lindën vetëm pas Perandorisë Osmane. Ato gjithashtu janë shumë të lidhura dhe dallojnë me përkatësinë shtetërore të shqiptarëve. Në rajonin e ish-Jugosllavisë ato ishin pjesë e marrëdhënieve gjermano-jugosllave deri në vitet e 1990-ta, ndërsa në territorin e Shqipërisë këto ishin vetëm marrëdhënie austro-shqiptare për një kohë të gjatë, por përfunduan me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Deri atëherë Gjermania kishte interesa kolonialiste në zonat jugosllave dhe Austria në zonat shqiptare (Langer 2019, Csaplár-Degovics / Jusufi 2020). Për gjithë shqiptarët këto marrëdhënie deri në Luftën e Dytë Botërore ishin politike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, fashistët gjermanë dhe italianë i shpallën shqiptarët në gjithë Ballkanin perëndimor si aleatë në luftën kundër sllavëve dhe popujve të tjerë të Evropës Juglindore (Zaugg 2016).

Në vitet 1960, kjo histori e kontakteve politike u shndërrua në një histori kontakti ekonomik ose në një histori migracioni, por vetëm për pjesën ish-jugosllave të zonave shqiptare. Ky migrim ishte kryesisht një migrim i fuqisë punëtore, veçanërisht të ashtuquajturit punëtorë mysafirë (gjerm. *Gastarbeiter*) në Gjermani, por edhe në Austri dhe Zvicër. Me përkeqësimin e situatës politike të shqiptarëve në Jugosllavi

nga vitet e 1980-ta, punëtorët migrantë u morën si shembull edhe të përndjekurit politikë. Gjatë luftërave të fundit jugosllave, këtë rrugë, tashmë të njohur mirë nga migracioni, e kaloi edhe rryma e refugjatëve gjatë luftës së Kosovës. Tre vendet gjermanishtfolëse mbetën vendet më të preferuara të destinacionit (Novinščak Kölker 2016). Marrëdhëniet mes vendeve shqiptare të hapësirës ish-jugosllave me vendet gjermanishtfolëse mbetën në një rënë anë të reduktuara nëpërmjet migrantëve, në anën tjetër në Kosovë këto marrëdhënie kaluan në marrëdhënie intensive mes Kosovës dhe Gjermanisë me karakter shtetëror, institucional dhe social. Aktivitetet e ushtrisë gjermane në Prizren dhe e Entit Federal për Migracion dhe Refugjatë (‘Bundesamt für Migration und Flüchtlinge’), të organizatave joqeveritare si GiZ dhe shumë të tjera, e bëjnë gjuhën dhe kulturën gjermane mëse prezente në Kosovë.

0.3 Gjendja e hulumtimeve

Hulumtimi i kontakteve gjermano-shqiptare nuk paraqet një boshllëk, por me këtë merren vetëm tre gjuhëtarë, germanistë nga Maqedonia dhe Kosova (Maksuti 2009, 2010, 2014, 2015; Sadiku 2017; Sadiku / Ismajli 2017). Një studim më shumë kuantitativ nga Sadiku dhe Ismajli ka për bazë gjuhën në Kosovë por i qaset çështjes sociolinguistike (Sadiku / Ismajli 2017). Ndikimet e gjuhëve më të vjetra nga gjermanishtja mund të gjenden në studimet mbi sllavishten jugore (Striedter-Temps 1958, Schneeweis 1960), ato mesjetare, të tilla si ndikimi i minatorëve saksonë në Kosovë (Gashi 1995) dhe ndikimet e gjermanishtes së vjetër (Jokl 1929).

Me gjithë punën e gjerë të dy gjermanistëve të përmendur, ende nuk ka ndonjë analizë që shqyrton gjithë ndikimin gjerman, datimin dhe përhapjen gjeografike të tij mbi bazën e korpuseve gjuhësore, sidomos të gjuhës së folur dhe gjithashtu që merr parasysh sociologjinë e fjalës, apo fjalorin profesional. Termi „sociologjia e fjalës“ (Löffler 2003: 107) vjen nga socio-dialektologjia dhe i referohet sjelljes shoqërore të një fjale ose leksikut në aspektin sociolinguistik. Thelbësore për këtë qasje është shqyrtimi i leksikut me një konsideratë të veçantë të folësve, d.m.th. shtresëzimi, hierarkizimi dhe shmangia e fjalëve, pastaj marrëdhëniet midis leksikëve aktivë dhe pasivë. Pyetjet që bëhen në këtë kontekst janë, për shembull, pse, nga kush dhe si miratohet një fjalë

në mënyrë që jo vetëm të datohet transferimi i gjuhës, por edhe të zhvillohen strategji më të përgjithshme për rinovimin e një leksiku.

1 Transfer kulturor

Transferi kulturor nga vendet gjermanishtfolëse në Kosovë është shumë i vjetër dhe si pasojë e kontakteve sllavo-shqiptare. Këtu bëjnë pjesë ndikimet në mënyrë dhe lëndë ndërtimi. Austria ka luajtur në këtë fushë një rol kyç si me fqinjësinë ashtu edhe me shtrirjen territoriale të Austro-Hungarisë në vendet veriore sllave, si Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja. Gjermanët e Danubit (gjerm. *Donauschwaben*) kanë intensifikuar edhe më shumë këto marrëdhënie në viset përkatëse.¹ Me përkatësinë jugosllave këto rrugë transferi kulturor kanë depërtuar deri në Kosovë, sidomos në epokën e hekurit dhe betonit, të cilët revolucionuan mënyrat tradicionale të ndërtimit edhe në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo traditë vazhdon edhe sot e kësaj dite, kur kemi parasysh ndërmarrjen tregate *Bau Holding* me qendër në Prishtinë¹, e cila me pjesën gjermane *Bau* 'ndërtim' të emrit mund të shihet si transfer kulturor. Ky emër qëndron në linjën tradicionale për transfer kulturor gjerman, por mbështetet në aspektin e dytë të këtij fenomeni, në atë të migracionit.

Emigrantët kosovarë shkaktojnë një transfer më të ri kulturor në fushën e konsumit. Këtu hyjnë sende të jetës së përditshme, si të higjienës trupore apo shtëpiake dhe të ushqimeve të ëmbla industriale si çokollata e bonbone. Dyqani *Ardi* afër New Born-it luante si me emrin ashtu edhe me logon e ngjashme me supermarketin gjigand gjerman *Aldi*, i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë i preferuar për shkak të çmimeve të ulëta të gjithë migrantët në Gjermani. Dyqani gjerman për artikuj higjienikë *dm* në Shkup frekuentohet edhe nga qytetarë të Kosovës, duke vazhduar linjën konsumuese të artikujve të sjella nga migrantët për të afërmit e tyre në Kosovë. Por edhe popullarizimi e çokollatave *Milka* dhe e bonboneve *Haribo* ndjek traditën e dhuratëzave të emigrantëve nga Gjermania gjatë pushimeve të verës në vendlindjen e tyre. Një revolucion të mirëfilltë kulturor migrantët shkaktuan në fushën automobilistike. Dalja nga moda e makinave jugosllave, të cilat dominonin trafikun kosovar deri në vitet e 1980-ta (Ströhle 2016: 109), jo vetëm që u mundësua me forcën ekonomike të migrantëve por edhe u dominua nga shija e tyre me modele gjermane. Ndryshe nga Shqipëria, ku makina gjermane u bë simbol statusi të lartë social me modelet më të reja dhe më të shtrenjta, sidomos

të tipit Mercedes, në Kosovë makina gjermane u bë fenomen mase, me modele më të vogla, më të lira dhe pos të tjerash makina të dorës së dytë. Këtu migrantët shihen njëherë si shembull, me të cilët konkurrojnë vendasit, ose kanë funksionin e shitësit, apo transportuesit, apo ndërmjetësuesit të shitjes nga Gjermania, ku makinat e përdorura janë më të lira se në Ballkan. Me kthimin e shumë ish-refugjatëve nga Gjermania erdhi edhe kultura e zanatit të automekanikut, i cili përveç njohurive nëpër shkollat profesionale gjermane sollën me vete edhe parapëlqimin e autopjesëve gjermane që konsumohen me të madhe në Kosovë. Tregu digjital i intensifikon këto dy fusha, si atë të makinave ashtu edhe atë të autopjesëve.¹

Një tjetër transfer kulturor gjerman kanë mundësuar institucionet dhe organizatat joqeveritare gjermane, qoftë drejtpërdrejt nëpërmjet projekteve të ndryshme qoftë tërthorazi si konsumatorë në atë rajon. Vështrimi i mbrojtjes së ambientit jetësor dhe pastrimin e lumenjve në Prizren si shpikje gjermane apo si transfer kulturor në Prizren do të ishte e tepruar, por projekti dhe realizimi i tij nga Ushtria Gjermane me atë hap të vendosur dhe të shpejtë mund të shihet nga këndvështrimi i hulumtimeve të stereotipeve të gjermanëve ndaj popujve të Ballkanit, ku *pisllëku* përbën thelbin e stereotipeve të shumta për Ballkanin (Langer 2019). Rreth Ushtrisë Gjermane është krijuar edhe një infrastrukturë e tërë konsumi, ku kosovarët ofrojnë shërbime të ndryshme me tabela dhe përshkrime në gjuhën gjermane, apo tabela shenjash nga vendet gjermane, të cilat i kanë sjellë ushtarët (Drude 2008: 100). Një transfer të mirëfilltë kulturor përbën ideja e prodhimit të një tipi buke tipik gjerman, të ashtuquajtur *Vollkornbrot*, e cila prodhohet nga një bukëpjekës afër gjimnazit të Jezuitëve gjermanë Loyola në Prizren (Drude 2008: 103).¹

Ky transfer kulturor i shumanshëm ka në Kosovë edhe perceptim vizual në hapësirat e ndryshme gjuhësore.

2 Transfer *linguistic landscape*

Trafiku kosovar nuk është vetëm i fryrë me makina të prodhimit gjerman, por edhe me mbishkrime, të cilat qëndrojnë si gjurmë të ish-pronarit gjerman, qofshin persona private në rastin e veturave qofshin kompani të ndryshme në rastin e kamionave. Një *linguistic landscape* i tillë paraqitet si tepër i veçantë dhe tipik për Kosovën. Në asnjë vend tjetër shqiptar nuk e gjen këtë intensitet. Fotografitë e mëposhtme tregojnë disa shembuj.



Foto 1: Kamion në Gjilan¹
Foto 2: Kamion në Prishtinë¹

Këto dy fotografi tregojnë firma zvicrane, e para kompani teknologjie për ndërtim „Vëllezërit Egli“ nga Rosstrüti/Wil¹ dhe e dyta zdrukthëtaria „Goldinger AG“ nga St. Gallen¹. Në të dy rastet nuk pritet që kompanitë e përmendura në Zvicër të jenë aktive me bashkëpunëtorë në Kosovë, por duhet të jenë vetëm ish-pronarë të këtyre kamionëve. Mbishkrimet gjermane nuk prekin vetëm sferën e sektorit privat të ekonomisë si në rastet e mësipërme. Ato në Kosovë gjenden edhe në sferën publike-shtetërore, siç tregojnë fotografitë e mëposhtme.



Foto 3: Autobus urban në Prishtinë¹

Foto 4: Autobus urban në Prishtinë¹

Dy fotografitë e mësipërme tregojnë dy autobusë urbanë në Prishtinë. Fotografia e parë (Nr. 3) tregon kompaninë zvicerane „Stiffler AG“ nga Davos, e cila merret me shitjen e makinerive të mëdha dhe autobusëve.¹ Fotografia e dytë (Nr. 4) tregon kompaninë gjermane për udhëtim me autobusë „Kurt Geis GmbH“ nga Bad Neustadt an der Saale¹. Të dy autobusët janë të kompanive private, por nën menaxhimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike (DSHP) të Komunës së Prishtinës. Diversiteti menaxhues dhe organizativ ekonomik çon në këtë rast në diversitet vizualiteti të autobusëve, nga e cila kanë shpëtuar këto mbishkrime.¹

Transfer kulturor në *linguistic landscape* nga ana e (ish) migrantëve hasim edhe në emrat e hoteleve dhe/ose restoranteve në Kosovë, p.sh. *Hotel Magra Austria* në Bogë të Pejës¹, *Hotel Aldi* në Prishtinë¹ (nga dyqani i lartëpërmendur gjerman), *Restaurant-Hotel Bern* në Ferizaj¹, *Motel Bern* në Kaçanik¹, *Hotel Centrum* në Prizren¹ (nga fjala gjermane *Zentrum* për qendër‘).

Ky transfer kulturor i shumanshëm ka pasoja edhe në gjuhën shqipe në Kosovë.

3 Transfer gjuhësor

Transferi gjuhësor është i padukshëm, por shumë intensiv. Ai prek të gjitha fushat që u përmendën më lartë ndër to fushën profesionale teknike në ndërtimtari dhe automobilistikë. Krugët e këtij transferi janë dy llojesh, njëri nëpërmjet konsumit, i cili prek edhe shtresën e vjetër të këtij transferi, dhe tjetri nëpërmjet tregtisë dixhitale (në internet).

3.1 Transfer nëpërmjet konsumit¹

Transferi më i vjetër gjerman ka depërtuar nëpërmjet serbokroatishtes në ndërtimtarinë e konstrukcionit me metoda të hershme modernizimi.

Shembuj: *mallter* < gjerm. Malter (Mörtel), *shallovanje* < slav. šalovati < gjerm. Schalung, *llakirat* < slav. lakirati < gjerm. lackieren, *shtafëll* < slav. štafla < gjerm. Staffel, *tallpa* < slav. tabla < gjerm. Tafel, *letfa* < slav. letva < gjerm. Latte, *shperplloç* < slav. šperploča, šper- < gjerm. Sperr- + slav. ploča < gjerm. Platte, *pjek*, -u < slav. pjek < gjerm.

Blech, *cigëll* < slav. cigla < gjerm. Ziegel, *kabëll* < slav. kabel < gjerm. Kabel, *shteker* < slav. šteker < gjerm. Stecker, *sh(t)raf* < slav. štraf < gjerm. Schrauff (e vjetëruar, Sadiku / Ismajli 2017: 195), *shtrafsiger/shrafciger* < slav. šfraciger < gjerm. Schraubenzieher.

Te gjithë transeferet tjera janë të kohërave të reja dhe janë më të rralla se në ndërtimin e konstrukcionit. Këtu hynë ndërtimi i ulët (punët me tokën) dhe mjete apo makineri pune.

Shembuj: *bager* (< gjerm. Bagger) ose *kran* (< gjerm. Kran) ose makineritë më të mëdha *shleper/šleper* < (gjerm. Schlepper), *tregeer* < gjerm. Träger, *vinkëll* < gjerm. Winkel, *gëryst* < gjerm. Gerüst, *llazer* < gjerm. Laser, *shveisapar* < gjerm. Schweißapparat, *vasërvaag/vasavaag* < gjerm. Wasserwage, *bërmashiin/burmashiin* < gjerm. Bohrmaschine, *fleks* < gjerm. Flex (prej emrit të kompanisë FLEX-Elektrowerkzeuge GmbH).

Fjalori i ndërtimtarisë interiore (në brendi të ndërtasave) është shumë e prekur nga gjermanishtja. Ky transfer është më i riu, jo stabil deri në ad-hoc.

Shembuj:

- fusha e lysterjes: *moler* < gjerm. Maler, *shpak(t)ëll* < gjerm. Spachtel, *llak* < gjerm. Lack, *tapeet* < gjerm. Tapete, *faarb* < gjerm. Farbe, *llajsne* < *leistne < gjerm. Leisten, *regips/rigips* < gjerm. Rigips, *gletmaqinë* < gjerm. Glättemaschine, *glet masë* < gjerm. Glättmasse

- fusha sanitarike: *fuug* < gjerm. Fuge, *boler/bojler* < gjerm. Boiler, *dushkabiin* < Duschkabine

- fusha e dyshemeve: *estrik* < gjerm. Estrich, *llajsne* < *leistne < gjerm. Leisten, *llaminat* < gjerm. Laminat, *parket* < gjerm. Parkett, *teplik* < gjerm. Teppich, *ybercug/ibercug* < gjerm. Überzug

- mbrojtja nga dielli, pamja dhe vjedhja: *roleta* (Pl.) < *roledna < gjerm. Rollläden, *gelinder/gilinder* < gjerm. Geländer.

Vërshimi i makinave gjermane dhe transferi i njohurive teknike me kthimin e ish-refugjatëve sollli me vete edhe një transfer të madh gjuhësor në gjuhën profesionale të automobilistikës.

Shembuj:

- autopjesë: *háub* < gjerm. Haube, *allansier* < gjerm. Anlasser, *ku(m)pllug* < gjerm. Kupplung, *llager* < gjerm. (Kugel-)Lager, *shiber* < gjerm. Schieber, *shofershaajb* < shofer + gjerm. Scheibe (në gjermanisht ‚Frontscheibe‘), *tank* < gjerm. Tank, *auspuf* < gjerm. Auspuff, *fellne* < Felgen, *feder* < gjerm. Feder, *stopa/shtopa* < gjerm.

Stopp (edhe me shqiptimin gjerman $s+t>sht$), *llamella* < gjerm. Lamellen, *ventill* < gjerm. Ventil, *shpric* < gjerm. Spritze (edhe me shqiptimin gjerman $s+t>sht$), *spojler* < gjerm. Spoiler, *klema* < gjerm. Klemme, *filter* < gjerm. Filter, *puump* < gjerm. Pumpe, *lluft* < gjerm. Luft, *gaz* < gjerm. Gas, *cilindër* < gjerm. Zylinder, *motor* < gjerm. Motor

- kompozita gjermane: *ratkapne* < gjerm. Radkappen, *boschpuump* < gjerm. Boschpumpe, *alufellne* < gjerm. Alufelgen

- transfer i anës formale pa përmbajtje: *gepek* < gjerm. Gepäck për ‚valixhe‘, *bandazh* < gjerm. Bandage për ‚fashë‘

- mbiemra dhe grupe emrore: *rikve(r)c* < gjerm. rückwärts (si drejtimi ashtu edhe marshi) – *shko rikvec*, *shtii n'rikvec* –, *ler* < gjerm. Leer(-lauf) – por vetëm në kombinim e parafjalën në, *n'ler –blajfrac* < gjerm. Bleifrei, në dallim me *dizell* < gjerm. Diesel, *kurshllus,-i* < gjerm. Kurzschluss (Sadiku / Ismajli 2017: 195).

Këto transefere tregohen në një rën anë si jo stabile, por në anën tjetër edhe të integruar mirë, kur kemi parasysh fjalëformimin relativisht të gjerë në dy grupet e fundit. Stabile tregohen edhe kompozitat gjermane, edhe pse janë kundër natyrës së gjuhës shqipe për fjalëformim nëpërmjet të komozitave.

3.2 Transfer nëpërmjet internetit

Interneti shihet si rruga kryesore për përhapjen e anglishtes në gjithë botën. Por në rastin e Kosovës interneti hab dy rrugë transferi gjuhësor. Në teknologjinë e imët kompjuterike përhapet anglishtja, kurse në teknologjinë e madhe përhapet gjermnishtja. Arsyeja është te rrugët e njohura të transferit gjuhësor gjerman, i cili në Kosovë ai tashmë është bërë traditë. Karakteristika e lëndës gjuhësore dixhitale është larmia e formave të fjalëve në shkrimin e tyre, por edhe në formë. Interesant këtu është, se gjermnishtja imitohet edhe në drejtshkrim edhe në shqiptim. Në vazhdim pasojnë disa shembuj me fotografi (*screenshut*) nga ofertat e portalit *MerrJep.com* gjatë vitit 2018, sepse linqet përkatëse humbin aktivitetin e tyre me shitjen e produktit. Të dhëna më të sakta janë hequr për shkakë diskrecioni.

www.merrjep.com

MerrJep
MerrJep
FREE - In Google Play

MerrJep.com

+ Postoni shpallje FALAS! Shpalljet Ruaj shpalljen

E mëparshme Shpalljet Tjetra

Audi Felne Goma Dimri

Shitet nga: Audi Sot 18:57

Çmimi 420 EUR

Pajisje Goma dhe Bandazhe

Komuna Prishtinë

ALU Fellga me GOMA te Reja , 17c .. BMW Series

Shitet nga: BMW Sot 09:33

Çmimi 380 EUR

Pajisje Goma dhe Bandazhe

Komuna Besianë

Shembuj: Te këto dy shembuj ofrohen boshte rrotash. Në të majtë fjala *fellga* (< gjerm. Felgen) është shumë afër fjalës gjermane. Kurse në të djathtë me *fellne* i është përshtatur më shumë shqipes.



Shpaner

Shitet nga: Auto pjes prishtina Dje 11:13

Çmimi -

Pajisje Pjesë rezerve

Komuna Prishtinë



Seti rrypi dhamzor shpanerar reno megan16.16v


Shitet nga: Ledri Sot 07:48

Çmimi 30 € EUR

Pajisje Pje 3 rive

Shembuj: Te këto dy shembuj ofrohen shtërngues rrypi. *Shpaner* vjen nga gjermanishtja *Spanner*, por saktësisht (*Zahn*)*Riemenspanner*, që d.m.th. shtërngues rrypi (dhëmbor). Në Kosovë është marrë vetëm

pjesa e dytë *Spanner*, por në shkrim pasqyrohet shqipimi gjerman, ku një *s* para *t* kalon në *sh*. Por shqiptimi gjerman nuk është marrë në mbaresën *-er*, e cila në gjermanisht shqiptohet si *ea* apo *a*. Interesant është shembulli në të majtë, ku në bazë të emrit *shpaner* është krijuar mbiemri *shpanerar* me rregullat e fjalëformimit të gjuhës shqipe.



**Guma dhe ratkapne
205/55/15**

Shitet nga: goma Sot 18:01

Çmimi: -

Pajisje: Goma dhe Bandazhe

Komuna: Mitrovicë

Rotkapne 15


Shitet nga: Boss Sot 19:07

Çmimi: -

Pajisje: Goma dhe Bandazhe

Komuna: Mitrovicë

Shembuj: Te këto dy shembuj ofrohen kapakët e rrotave. Shembulli i djathtë *ratkapne* qëndron më afër orgjinalit gjerman *Radkappe*, me shurdhimin e *d* afër *k*, sipas rregullave fonetike me shurdhim progresiv të shqipes. Shembulli i djathtë largohet nga origjinali shumë, me kalimin e *a* në *o*.



**Boshpump per Reno 1.6i
thjesht**

Shitet nga: Xxx Sot 07:04

Çmimi: 60 EUR

Pajisje: Pjesë rezerve

Komuna: Prishtinë

Aku -Burmashin


Shitet nga: Fuli 07 Tet 19:40

Çmimi: 60 EUR

Pajisje: Pjesë rezerve

Komuna: Gjilan

Shembuj: Te këto dy shembuj ofrohen makineri elektrike. Te të dy rastet janë transferuar kompozitat gjermane. Shembulli i djathtë *Boshpump* vjen nga gjermanishtja *Boschpumpe*, e përbërë nga pjesa e parë *Bosch* (firma) dhe *Pumpe* për *pompë*. Përveç fjalëformimit është transferuar edhe shqiptimi i *u* te *pump*. Por shihen edhe rregullat fonetike të gjuhës shqipe të dialektit geg. *e* fundore në gjermanisht shqiptohet si *ë*, dhe ajo me rregullat e gegërishtes bie, edhe në këtë rast. Zgjatja e zanores këtu nuk shihet. *Burmashin* përbëhet në gjermanisht nga folja *bohren* për *shpoj* dhe *Maschine* për *makineri*. Këtu ka një asimilim regresiv, ku *o* para vibrantit *r* kalon në *u*, dhe si në rastin e parë *e* fundore bie, pa e parë zgjatjen e zanores në shkrim.



Stopa per Golf 6 Original

Shitet nga: Golf Sot 13:20

Çmimi -

Pajisje Pjesë rezerve

Shtopa per astra 2010

Shitet nga: shtopa Sot 18:02

Çmimi -

Pajisje Pjesë rezerve

Komuna Mitrovicë

Shembuj: Këtu ofrohen dritat e frenave. Në gjermanisht këto quhen *Bremsleuchte*, d.m.th. *drita frenash*. Ku qëndron transferi? Te *sh* te shembulli i majtë. Në gjermanisht për *stop* thuhet *stopp*, dhe siç u sqarua më parë, *s* para *t* kalon në *sh*. Fjala *Stopper* ekziston në gjermanisht, por me kuptimin *ndalues*. Me siguri *shtopa* është marrë nga *Stopper*, ku *er* fundore shqiptohet si *a*, dhe *s+t>sht*. Në anën e djathtë shembulli ruan *a* fundore, por jo specifikën e *s/sh* dhe e adapton me *stop*-in e shqipes.

Gjuha e internetit tregon një larmi të madhe në shkrim e fjalëformim, se fjalorët dhe gjuhët profesionale në gjuhën shqipe nuk janë normuar, sidomos profesionet praktike.

Përmbledhje

Kontaktet mes kulturave dhe gjuhëve të ndryshme janë janë në radhë të parë kontakte me karakter politik apo territorial. Në mungesë të kësaj ato mund të jenë kontakte njerëzish, qofshin grupe të mëdha nëpërmjet migracionave masive (ekonomike, konflikti/luftë), qofshin grupe të vogla profesionistësh të fushave të ndryshme. Kontakte kulturore paraqesin edhe rryma të ndryshme, ku rol të rëndësishëm luajnë mediat e ndryshme. Kontakti gjermano-shqiptar në Kosovë ka nga të gjitha tipat nga pak elemente. Por kontaktin më të fortë e shkaktojnë migrantët shqiptarë të kthyer pas luftës apo të tillë me karakter të migracionit cirkular. Globalizimi dhe digjitalizimi ecin këtë rrugë tradicionale, duke intensifikuar konsumin e produkteve gjermane në fushat e analizuara, por duke rritur edhe numrin dhe larminë e transferit gjuhësor nga gjermanishtja në shqipen e Kosovës.

Këto kontakte kanë shkaktuar në Kosovë një sërë transferash kulturore dhe gjuhësore, të cilat kanë karakter vizual apo jovizual. Të gjitha prekin fushën e konsumit, në fusha të cilat i kanë etabluar migrantët, por janë aktive deri sot dhe shfrytëzohen më tutje nga kompani dhe institucione gjermane. Made in Germany kuptohet në Kosovë si me produktet gjermane ashtu edhe me gjuhën gjermane, e cila në Kosovë gëzon përhapje të madhe dhe prestigj të lartë. Gjuha gjermane është bërë në Kosovë një *lingua franca* teknike, dhe e emancipoi shqipen e Kosovës nga serbokroatishtja e dikurshëm. Fushat e analizuar në këtë artikull e tregojnë këtë zhvillim shumë qartë.

Kjo e kaluar dhe kjo përvojë e kosovarëve dallon nga ajo e shqiptarëve të Shqipërisë, por deri diku edhe nga vendet dhe republikat tjera ish-jugosllave. E gjitha kjo ka çuar në një diversitet shumë të gjerë si në konsum ashtu edhe në gjuhë. Gjuhët e profesioneve teknike qëndrojnë në thelb të një pluricentrizmi shqiptar mes Kosovës dhe Shqipërisë, po të shihet si i tillë.

Literaturë e cituar

- [1] Csaplár-Degovics, Krizstián / Jusufi, Lumnije: Das ungarisch-albanische Wörterbuch von Zoltán László (1913). Imperialismus und Sprachwissenschaft. Wien 2020.
- [2] Drude, Saskia: Hundert Wochen Kosovo. Alltag in einem unfertigen Land. Aachen 2008.
- [3] Espagne, Michel / Werner, Michael: Deutsch-französischer Kulturtransfer im 18. und 19. Jahrhundert. Zu einem neuen interdisziplinären Forschungsprogramm des C.N.R.S. Nö: Francia 13 (1985). f. 502–510, online unter http://francia.digitale-sammlungen.de/Blatt_bsb00016288,00518.html.
- [4] Espagne, Michel: Die Rolle der Mittler im Kulturtransfer. Nö: Kulturtransfer im Epochenbruch. Frankreich – Deutschland 1770 bis 1815. Lüsebrink, Hans-Jürgen / Reichardt, Rolf (bot.) Leipzig 1997a. f. 309–329.
- [5] Espagne, Michel: Minderheiten und Migration im Kulturtransfer. Nö: Comparativ, Vol. 5/6 (1997b). f. 247–258.
- [6] Gashi, Skënder: Albanisch-sächsische Berührungen in Kosova und einige ihrer onomastischen und lexikalischen Relikte. Nö: Dardania. Zeitschrift für Geschichte, Kultur und Information 4 (1995). f. 87–127.
- [7] Hellinger, Marlis: Zum Begriff der sprachlichen Interferenz. Nö: Arbeiten aus Anglistik und Amerikanistik. Vol. 5, Nr. 2 (1980). f. 187–199.
- [8] Jokl, Norbert: Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen. Nö: Festschrift. Der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg vom 25. bis 29. September 1929 gewidmet. Baden 1929. f. 105–137.
- [9] Jusufi, Lumnije: Germanismen als albanische Fachwörter in Technik und Handwerk. Dorëshkrim.
- [10] Langer, Benjamin: „Fremde, ferne Welt“. Mazedonienimaginationen in der deutschsprachigen Literatur seit dem 19. Jahrhundert. Bielefeld 2019.
- [11] Löffler, Heinrich: Dialektologie. Eine Einführung. Tübingen 2003.
- [12] Lüsebrink, Hans-Jürgen: Interkulturelle Kommunikation. Interaktion, Fremdwahrnehmung und Kulturtransfer. Stuttgart 2016.
- [13] Maksuti, Izer: Internationalismen im Albanischen. Eine kontrastive Untersuchung unter besonderer Berücksichtigung des Alltagswortschatzes – Albanisch, Deutsch, Englisch, Französisch. Saarbrücken 2009.

-
- [14] Maksuti, Izer: Sprachliche Einflüsse des Deutschen auf das Albanische. Deutsche Entlehnungen im albanischen Wortschatz. Saarbrücken 2010.
- [15] Maksuti, Izer: Kontaktet gjuhësore të shqipes me gjermanishten. Në: Albanologjia. International Journal of Albanology 1–2 (2014). f. 149–154.
- [16] Maksuti, Izer: Mbi disa veçori leksikore të gjermanishtes dhe shqipes – sprovë për një krahasim të dy arealeve gjuhësore. Në: Filologjia. International Journal of Human Sciences 3 (2015). f. 30–47.
- [17] Novinšćak Kölker, K.: Migrationsnetzwerke zwischen Deutschland und den Herkunftsstaaten Republik Albanien und Republik Kosovo. Bonn 2016.
- [18] Riehl, Claudia Maria: Sprachkontaktforschung. Eine Einführung. Tübingen 2009.
- [19] Roelcke, Thorsten: Fachsprachen. Berlin 2010.
- [20] Sadiku, Milote: Deutsche Lehnwörter in der albanischen Mundart in Kosovo: Eine Analyse ihrer morphologischen Anpassung. Në: Philipp, Hannes / Ströbl, Andrea / Weber, Bernadette / Wellner, Jochan (bot.): Deutsch in Mittel-, Ost- und Südosteuropa. DiMOS Füllhorn Nr. 3. Regensburg 2018. f. 215–223.
- [21] Sadiku, Milote / Ismajli, Blertë: Germanismen in der kosovarischen Mundart der albanischen Sprache. Në: Aussiger Beiträge 11 (2017). f. 189–208.
- [22] Schneeweis, Edmund: Die deutschen Lehnwörter im Serbokroatischen in kulturgeschichtlicher Sicht. Berlin 1960.
- [23] Snežana Stanković: Worldness behind the Cemetery. Stories of Absent Germans and Jews in the Former Habsburg Borderland. Berlin 2020. Dorëshkrim.
- [24] Striedter-Temps, Hildegard: Deutsche Lehnwörter im Serbokroatischen. Wiesbaden 1958.
- [25] Ströhle, Isabel: Aus den Ruinen der alten erschaffen wir die neue Welt! Herrschaftspraxis und Loyalitäten in Kosovo (1944-1974). Berlin 2016.
- [26] Zaugg, Franziska A.: Albanische Muslime in der Waffen-SS: Von „Großalbanien“ zur Division „Skanderbeg“. Paderborn 2016.

Burime interneti

<http://www.peshkuiarte.com>.

<https://www.merrjep.com/>.

<https://www.gebr-egli.ch/>.

<https://www.goldinger-ag.ch/>.

<https://www.stiffler-ag.ch/>.

<http://www.geis-reisen.de/>.

<https://www.hotelmagra.com/>.

<https://www.balkan-hotel.com/sq/kosove/prishtina/hotele/hotel-aldi>.

<https://www.balkan-hotel.com/sq/kosove/prizren/hotele/hotel-centrum>.

<http://www.metal-inox.de.rs/>.

<https://www.facebook.com/Restaurant-Hotel-Bern-353292675224160/>.

<https://www.apex-turism.pl/Products/302/171/de/Motel-Bern>.

Albanë Mehmetaj, Prishtinë

POEZIA E DE RADËS DHE TEORIA ESTETIKE

1. “Këngë të Milosaot”

Duke interpretuar “Këngë të Milosaot”, studiuesi Sabri Hamiti thekson se De Rada e shkroi këtë vepër kur ishte 20-vjeç, një moshë kur bëhet hapja e parë e fuqishme e krijuesit ndaj veprës dhe ndaj botës, kur më shumë ka imagjinatë se përvojë; kur shkrimi mbledh më shumë ndjeshmëri, sesa ide; kur subjektiviteti shpërthen në shkrim i pavarur nga idetë e mësuara dhe nga klishetë e nga kërkesat e jashtme.¹ Karakteristikat e tilla të moshës të De Rada përshtaten edhe me pikëpamjet e tij romantike. Këto karakteristika dyfishohen në tekstin e tij: te romantikët në përgjithësi dhe, po ashtu, edhe te De Rada kufiri midis reales dhe imagjinares është i tejdukshëm dhe në shumë raste imagjinaria dominon; romantikët janë të njohur si shpirtra të ndjeshëm dhe në poezinë arbëreshe me “Këngë të Milosaot”, De Rada arrin ta ngre në majë këtë ndjeshmëri nëpërmes personazheve të imagjinuar të tij, Milosaos dhe Rinës, dhe këtu ndjeshmëria mund idenë. Mbi të gjitha për shkak të moshës, siç thotë Hamiti, dhe për shkak të bindjeve romantike, në “Këngë të Milosaot” shpërthen subjektiviteti i De Radës i dhënë përmes Milosaos. Në këtë rrafsh, studiuesi Ali Xhiku qëndrimin subjektivist e quan prirje të theksuar për këtë vepër të De Radës.

Para se të interpretojmë “Këngë të Milosaot”, veprën e parë të poetit më të njohur arbëresh, Jeronim de Rada, është e rëndësishme të theksojmë se poezia arbëreshe lindi në shekullin XVII, si përpjekje për ta thyer tematikën religjioze, përmes trajtimit të temës së atdheut. Duhet theksuar që romantizmi në letërsinë shqipe lindi më vonë se në Evropë. Konkretisht romantizmi te ne lindi pasi në Evropë kishte përfunduar. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se data e botimit të “Këngë të Milosaot”, 1836, konsiderohet si datë e lindjes së romantizmit arbëresh/shqiptar.

Romantizmi në Evropë lindi si reaksion ndaj poetikës normative, ndaj rregullave e ligjësave që kishte imponuar periudha e përparshme e klasicizmit. Romantizmi filloi me mbledhjen e folklorit dhe preokupimin për të kaluarën historike. Zejnullah Rrahmani, kur flet për

romantizmin shqiptar, thekson se edhe romantikët shqiptarë do ta pranojnë tematikën historike për shkak të pakënaqësisë ndaj gjendjes shoqërore të kohës. Por, Rrahmani thekson se romantikët shqiptarë do të dallojnë nga romantikët evropianë, sepse këtë nuk do ta bëjnë për të kërkuar ekzotikën, as mistikën, as një liri shpirtërore. Ata do ta bëjnë këtë për një shkak shumë më praktik: “t’i kthehen luftërave të periudhës së Skënderbeut, me qëllim që aty të gjejnë një identitet kombëtar, një frymë kombëtare, një dëshmi të qenies kombëtare shqiptare”.¹

Sabri Hamiti tematikën nacionale e konsideron të zbuluar nëpër histori, për të zbuluar heroin nacional, Skënderbeun. Po ashtu, Hamiti thotë se paralelisht me këtë tematikë, zhvillohet tematika individuale, personale, gati në nivel të entuziazmit për zbulimin e subjektit.¹ Kështu, diskursin letrar të letërsisë romantike e sheh të thurur në dy rrafshë, në rrafshin personal e në rrafshin kolektiv, ndërsa karakterin e këtyre dy rrafshëve himnizues.

Rrafshi personal dhe rrafshi kolektiv do të thuren edhe në poemën e De Radës. Milosao, heroi kryesor i veprës, sundimtar i Shkodrës, dashurohet me Rinën e varfër, të bijën e Kollogresë. Nga dashuria do të burojnë tërë rrëfimi, kënga e dashurisë, rrafshi personal, tema universale. Ndërsa, në anën tjetër, heroin e pret lufta për atdheun. Linja e dytë e bën rrëfimin e tekstit që të marrë kahje tjetër, dominojnë notat e larta të atdhedashurisë, rrafshi kolektiv, tema nacionale. De Rada, nëpërmes Milosaos, e ndërton dilemën sokratike. Por, tash, dilema do të dalë jo: të jem apo të mos jem?, por: të jem hero dashurie, apo hero historie? Në këtë dilemë, De Rada do ta zgjidhë të parën. Dhe, Milosao do të jetë hero lirik, hero dashurie. Protagonisti i veprës fillimisht si hero dashurie, do t’i thyejë rregullat e romantizmit. Duke qenë ndesh, parimeve romantike, dashuria do të rrënohet duke mbetur iluzion. Nën dallgët e dashurisë, në përqaftimin e vashës, Rinës, Milosao do të jetojë vetëm pak kohë. Vdekja do të marrë Rinën dhe frytin e dashurisë së tyre, duke e lënë edhe fëmijën vetëm ëndërr. Pas tragjedisë, Milosao do të bëhet hero kombëtar, duke vdekur për mbrojtjen e atdheut.

De Rada ka ribotuar disa herë veprat e tij më të mira. Rexhep Qosja këtë qëndrim të De Radës e shikon të ngjashëm me Pol Valerin, i cili e konsideronte ribotimin të domosdoshëm. Shkak tjetër të ribotimit Qosja e konsideron edhe jetën e gjatë të De Radës, që atij i ka dhënë mundësi të njihet nëpër kohë me forma dhe teknika të ndryshme të shkrimit.¹ Veprën e tij të parë “Këngë të Milosaot”, De Rada e ka ribotuar tri herë, me ndryshime të dukshme. Herën e parë në vitin 1836, herën e dytë në vitin 1847 dhe në fund në vitin 1887.

Ngjarja e dhënë te poema “Këngë të Milosaot” kap një kohë 7-vjeçare, prej datës 27 korrik 1435, deri më 20 prill 1443. Teksti ka strukturë fragmentare, këngët nuk lidhen gjithmonë me njëra-tjetrën. Mirëpo, studiuesi Sabri Hamiti konstaton se poemës nuk i mungon uniteti i ndjenjës dhe i mendimit, ndonëse në dukje poema është fragmentare. Poema ka edhe këngën e valles, në të cilën këndohet dashuria e lindur; ka këngën e vajtimit ku qahet dashuria e humbur dhe kënga e XXXI, mund të konsiderohet si kënga e kërkimit të vashës në botën tjetër.

U theksua edhe më lart se në Evropë romantizmi filloi me mbledhjen e folklorit, ndërsa te ne, ndonëse romantizmi erdhi më vonë, e dëshmon fuqishëm lidhjen krijuese me traditën e poezisë popullore shqiptare. Nismëtari i romantizmit shqiptar, De Rada, ka pasur ndikim të madh në mbledhjen e rapsodive popullore ndër shqiptarë, andaj ky ndikim do të duket shumë i pranishëm edhe në poemën e Milosaos. I formuar në këto pikëpamje, gjithçka në tekstin e tij do të marrë formën e poezisë popullore, si: struktura - fragmentare, ritmi, gjuha, figurat janë arbëreshe, ngjarja është rreth një individi, rreth një heroi/trimi, koha e rrëfimit i përket të kaluarës (këtu De Rada evokon jetën e shqiptarëve të shek. XV, ngjarjet e “Motit të Madh”). Sipas Qosjes, poetika e kompozicionit të këngëve të Milosaos është e hapur, të cilës mund t’i shtohen këngë të reja, duke mos iu cenuar kompozicioni.¹ Ndërsa, sa i përket vargut të De Radës, ai është i lirë dhe sipas Hamitit ai nuk e njeh rimën, por mbështetet tërësisht në ritëm. Hamiti konsideron se për herë të parë në letërsinë shqipe, De Rada ka krijuar një tekst poetik të fuqishëm dhe të figurshëm.¹

Element i rëndësishëm i poemës se De Radës “Këngë të Milosaot” është plani autobiografik. Këtu De Rada është unifikuar me heroin e tij, Miloson. Dhe, duke u njësuar me të, ai ka arritur ta artikulojë fuqishëm takimin midis dy të dashurve.

Ndonëse De Rada ka arritur ta shuajë dallimin social, duke e zgjedhur tërmetin si shpëtim, duke e shkatërruar Shkodrën, ai nuk ka rritur ta bëjë Milosaon hero nacional. Milosao është tipik romantik, ushqen konceptet romantike, duke u dashuruar thellësisht dhe duke i dhënë përparësi familjes. Gjersa Milosao të mos humbë dashuritë e tij personale, ai nuk do të jetë i barabartë me heronjtë e shek. XV. Pasi humb dashuritë, ai do t’i kushtohet atdheut dhe vetëm atëherë do t’i kujtohen fjalët e nënës se po i harronte detyrat e tij. Në bisedë me të motrën e tij, Hareza, Milosao, duke u ndier fajtor, arrin në atë shkallë sa duket që e akuzon Rinën, pas vdekjes së saj, dhe po ashtu, pas vdekjes së nënës.

Duke ecur midis temës së atdheut dhe temës së dashurisë, De Rada ka synuar idenë patriotike, por ka krijuar efekt dhe e ka realizuar idenë e dashurisë. Ky synim mund të konsiderohet edhe si shkak që

dashuria e Milosaos dhe Rinës të përfundojë tragjikisht. Por, mbi të gjitha, “Këngë të Milosaot” është lirikë dashurore. Për më shumë në këtë lirikë studiuesi Sabri Hamiti e përjashton ideologjinë kombëtare.¹

Rëndësi të madhe në poemën e De Radës ka përshkrimi duke e përbërë pjesën më të bukur të tekstit tij. Natyra dhe vasha janë dy kategoritë më të mëdha që dalin në poemën e De Radës dhe këtë e dallojmë më së miri në Këngën X.

2. „Skanderbeku i Pafan”

Poema tjetër epiko-lirike e rëndësishme e Jeronim De Radës është „Skanderbeku i Pafan”, shkruar një vit pas „Këngë të Milosaot”, pra në vitin 1837. Vepra ka tridhjetë e dy këngë, të ndara në pesë libra. Nga studiuesi i De Radës, Mikel Markiano, i cili edhe ka hapur horizontet që të studiohet veprimtaria letrare e De Radës në tërësi. Është kuptuar që vepra kishte dymbëdhjetë libra, por në pamundësi botimi, kanë dalë vetëm pesë. Nga ky studiues, po ashtu, është kuptuar që De Rada, në poemën “Skanderbeku i Pafan”, punoi pothuajse gjatë gjithë jetës, duke derdhur tërë imagjinatën artistike rreth idesë së patriotizmit. Struktura e kësaj poeme, për dallim nga poema e mësipërme, do të marrë shtrirje më të gjerë. Në qendër të rrëfimit nuk do të jenë vetëm dy të dashuruar, por do të ketë disa të tillë. Nuk do të jetë vetëm një hero, që duhet të zgjedhë njërin nga dy rrugët e mundshme, po do të jenë shumë heronj të tillë, që do të jetojnë sprovën të zgjedhin në mes të dy rrugëve. Përsëri te „Skanderbeku i Pafan” do të thuren dy tema të dashurisë: dashurisë për atdheun dhe dashurisë për vashën/trimin.

Në poemën „Skanderbeku i Pafan” thuret më mirë se te poema e parë sakrifikimi i dashurisë personale, që e përmend Xhiku: “te heronjtë e poezisë arbëreshe intimja, vetjakja kalon gjithmonë në plan të dytë përmes lëkundjesh e vuajtjesh dhe shpesh sakrifikohet tërësisht kur përpara heronjve qëndrojnë të mprehta detyrat që kanë ndaj atdheut”.¹

Te „Skanderbeku i Pafan” paralelisht do t’u këndohet dy shekujve: shek. XV (të kaluarës së shqiptarëve, Motit të Madh) dhe shek. XIX (kohës së autorit), për t’u forcuar ideja e heroizmit dhe e bëmave të mëdha për çlirimin e atdheut. Bazë dhe frymëzim i idesë së patriotizmit do të jetë shek. XV, i cili paralajmërohet pas titullit të veprës. De Rada, duke u përpjekur që të japë të qartë çdo pamje historike, të përshkruajë çdo detaj, ngjarjen do ta zhvillojë në dy vende, Shqipëri dhe Azi.

Heroi kombëtar, Skënderbeu, në poemën e De Radës do të jetë simbol i luftës heroike të shek. XV, prandaj mund të themi se titulli i

veprës shërben më shumë si çelës për të interpretuar ngjarjet e lavdishme të këtij shekulli. Skënderbeu këtu më shumë del si frymëzues shpirtëror i popullit shqiptar, frymëzues i heronjve të tjerë, të cilët identifikoheshin me të. Skënderbeu është më shumë iniciator, prijës i idealit të shqiptarëve rreth çlirimit nga pushtuesit turq, sesa aktiv në vepër. Ai do të duket në skenë për herë të parë në këngën e parafundit të librit të dytë, kur shkon në Ysqydar, për t'i vizituar vëllezërit, Reposhin dhe Stanishën. Dy të fundit vdesin të helmuar dhe të mashtruar, me urdhër të Sulltanit.

Këngë tjetër që lidhet pak më shumë me Skënderbeun dhe që duket si një lloj biografie e tij, është kur në skenë del babai i Skënderbeut, Gjon Kastrioti, dhe më vonë kur flitet për marrëveshjen e tij me Muratin II, për të bijtë që i kishte lënë peng. Poema “Skanderbeku i Pafan” hapet me një prolog, i cili del me gjashtë këngë lirike kënduar nga Bozdari për Serafinën. Pas prologut vjen hyrja, po ashtu e përbërë nga gjashtë pjesë, e cila jep vitin 1418 dhe disa personazhe të dyta të autorit. Prologu dhe hyrja paralajmërojnë karakterin epik e lirik të veprës. Dy personazhet e prologut, Bozdari dhe Serafina, dalin edhe në këngën e dytë të librit të parë, ndërsa në këngën e parë të këtij libri jepet gjendja e luftës (kur niset ushtria turke në Shqipëri) dhe shenjat e para të përgatitjes së ushtrisë shqiptare (me komandant Xhibraltarin). Ndeshja në mes të palëve ndodh në këngën e gjashtë. Në librin e parë del edhe heroi lirik i poemës së mësipërme, Milosao, tash hero epik, sundimtar i Shkodrës. Pastaj është Radavani, Miloshini, Gjon Kastrioti etj. Personazhet e njëjta do të dalin edhe në katër librat e tjerë, po me motivin për çlirimin e atdheut. Një personazh tjetër i lartësuar nga De Rada është Astiri, i cili tenton ta vrasë të birin e Sulltanit. Gjithë këto personazhe dhe të tjera kanë një qëllim, një komb dhe një flamur. Të gjithë kanë pikëpamje të njëjta për mbrojtjen e atdheut, kalojnë nëpër vuajtje të mëdha dhe janë mbrojtës të një ideje të një kohe të madhe. Të gjithë do të flijohen për atdheun, duke përfunduar tragjikisht.

Poema “Skanderbeku i Pafan” ka edhe linjë tjetër të rrëfimit, përveç asaj epike. Ali Xhiku e quan De Radën mjeshtër për zbulimin e dridhjeve më të holla psikologjike të personazheve.¹ De Rada këtu do të jetë mjeshtër për të kapur ato çaste dashurie në kohë lufte, të cilat mbesin gjithmonë vetëm të filluara, pak të përjetuara dhe kurrë të mbaruara. Dashuritë e heronjve, si idetë e tyre, do të përfundojnë tragjikisht. Personazhet e dashur të De Radës janë të ndjeshëm në dashuri dhe arrijnë ndjeshmërinë që e ka vetë autori ynë romantik. Kështu, poema nga këngët epike, do të marrë linjën e rrëfimit lirik. Linjën e dashurisë personale De Rada e paraqet përmes Serafinës e Bozdarit. Lidhjet dashurore do të dalin edhe përmes

Violetës dhe turkut Almanzor, pastaj këngët lirike në mes Agatës dhe Miloshinit; dashuria shfaqet edhe në burg, në mes të Astirit dhe Gonetës, në mes të Gavrilës dhe Gjakovitinit etj.

Në poemën “Skanderbeku i Pafan” vërehet një mungesë e vazhdimësisë dhe e njësisë së veprimit. Ngjarjet nuk janë kronologjike dhe vepra është fragmentare. Në tërë veprën kemi kapërcime të mëdha të kohës, të ngjarjeve, personazheve dhe të këngëve, nga ato lirike në epike dhe e kundërta. Kjo dallohet më së miri në fund, kur poema epiko-lirike përfundon në mënyrë të çuditshme dhe mbetet e paplotë. Mangësinë e tillë dhe mangësinë e karakterit epik të veprës, sipas disa studiuesve tanë, De Rada e ka arsyetuar me imitimin që i ka bërë formës së këngëve të rapsodive të atdheut, me imitimin e këngëve homerike (që lindën sipas traditës), me përmbajtjen e tekstit sipas përfytyrimit të atdheut etj.

Forma e rapsodive popullore arbëreshe është karakteristikë e tërë poetikës së De Radës dhe gjithashtu karakteristikë e poemës për Skënderbeun. Por, e veçanta për poemën e fundit të tij, “Skanderbeku i Pafan”, është synimi i autorit që të krijojë epopenë kombëtare dhe ta ngrisë frymëzimin për idenë nacionale dhe zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, duke i evokuar ngjarjet historike të shek. XV dhe të jetës shqiptare, të Motit të Madh. Duke e paraqitur epokën heroike më të madhe shqiptare (shek. XV), në krye me heroin kombëtar - Skënderbeun (disa herë futet edhe histori në tekstin e tij) dhe duke paraqitur situata reale (mes tjerash kur e quan shek. XV të pafat, pasi ishte pushtuar në realitet nga turqit) të jetës personale me natyrë lirike dhe epike, De Rada veprën e tij e ka vënë në rrafsh poetik me veprat e Homerit. “Skanderbeku i Pafan”, më vonë, edhe është krahasuar dhe është studiuar ndikimi nga veprat e Homerit, Gëtes, Virgjilit, Teokritit etj., megjithëse disa herë krijimtaria e De Radës është krahasuar me krijimtarinë e Lamartinit dhe Bajronit, sidomos për ndjenjat e theksuara të gruas, për pakënaqësinë e personazheve ndaj realitetit dhe shoqërisë, është dëshmuar se poema e tij nuk e ka brengën e romantikëve evropianë, sidomos të ashtuquajturin “pikëllimi botëror”. Brenga e De Radës dhe e tërë romantikëve arbëreshë ka qenë çështja e atdheut, ideja për çlirimin e tij, malli për atdheun etj.

3. Estetikja

Sistemin teorik-estetik Jeronim de Rada e ndërtoi me çështjet dhe idetë që kanë reflektuar në gjithë veprën poetike të tij. Në „Parime të estetikës“ këto aspekte të veprave poetike dalin si koncepte teorike e me kategori themelore estetike.

Koncepti kryesor i De Radës në teorinë estetike është uniteti *trup-mendje-shpirt*. Kjo harmoni e trefishtë e njeriut ideal të De Radës ka burim personazhet e veprave poetike të tij. Personazhet kryesore të tij do ta kenë: të theksuar mençurinë, ndjenjën dhe bukurinë. Kështu, ata do të jenë të bukur dhe të madhërishtëm.

Objekti teorik i estetikës së De Radës është *e bukura*. Shembull të manifestimit të saj në radhë të parë autori e merr tragjedinë antike greke. Personi ideal i tragjedisë greke për De Radën është Edipi i Sofokliut. Edipi është i bukur, sepse: ai ndjen dashuri të madhe për atdheun, ka përgjegjësi ndaj hyjnive, sakrifikohet për vajzat jetime - De Rada sakrifikimin e quan dashamirësi që lind nga mëshira. Pastaj, pafajësia dhe ndërgjegjja e Edipit dhe e vajzave të tij është virtyt tjetër që autori i cilëson si kategori të së bukurës së përsosur. Këto kategori burojnë nga parimi moral.

Skënderbeu është i bukur për De Radën, sepse mbron të drejtat e atdheut me shpatë në dorë dhe kështu del edhe i madhërishtëm. Madhështia te teoria e estetit tonë qëndron në themele të së bukurës. Ajo karakterizohet nga shpirtmadhësia, qetësia, qëndresa, guximi etj. Të gjitha këto kategori, mendon esteti, vijnë nga forca e shpirtit dhe nga besimi në pavdekshmërinë. Ato janë të theksuara te Skënderbeu. Ai do të luftojë guximshëm kundër armikut, pa i shkuar mendja që do të humbet jetën. Ai do të luftojë për një ideal: ta çlirojë atdheun nga pushtuesit osmanë dhe kështu nuk do të tronditet nga erërat që ngrihen, nuk tronditet nga asgjë që i del përpara, duke u mbështetur në hapësirën e pakufishme. Skënderbeu ka besim në pavdekshmërinë dhe ky besim, sipas De Radës, e bën shpirtin të aftë të fluturojë atje ku e fton bindja e pathyeshme. Shpirtmadhësia, te De Rada, e siguron qetësinë. Masat, thotë ai, kur ndodhen para një rreziku, kërkojnë dikë shpirtmadh që t'u sigurojë qetësi. Skënderbeu, jo vetëm në një masë, po tërë shqiptarëve me shpirtmadhësinë e tij, u ka siguruar qetësinë shpirtërore. Guximin në teorinë estetike, De Rada e gjen tek ata që luftojnë dhe fitojnë. Në veprën poetike, Skënderbeu lufton dhe fiton.

Virtytet që e bëjnë kulmin e bukurisë për De Radën janë: drejtësia, pafajësia, dhembshuria, mëshira, dashamirësia. I kundërt me këto forma të së bukurës është vullneti, i cili, thotë esteti, mund të na shtyjë drejt rrugës së gabueshme dhe mund të na vijë një e keqe e madhe. Për Skënderbeun ky vullnet nuk ekziston. Asgjë nuk mund t'i dalë përpara që t'i ndërrojë rrugën e drejtësisë që ka marrë. Ai priret nga format e së bukurës, të sipërpërmendurat. Skënderbeu, si personazh në veprën e De Radës, me gjithë madhësinë, forcën dhe guximin,

është njeri që përshkohet nga dhembja e mëshira. Kjo vërehet më së miri kur ai shkon t'i vizitojë vëllezërit që i janë helmuar tinëzisht.

Figurë tjetër si model për De Radën është Akili i Homerit dhe, ndoshta, pse De Rada do t'i ngjajë autorit të Akilit, Skënderbeu është më i afërt me Akilin, sesa me Edipin. Akili nga De Rada karakterizohet me harmoninë supreme: të trupit, të shpirtit dhe të mendjes. De Rada mendon që figura e Akilit nuk do të ishte vlerësuar si figurë e paarritshme dhe sovrane po t'i kishte munguar kjo harmoni e plotë në mes të ndjenjave e mirëqenies, mendjes burrërore dhe forcës së palodhshme të gjymtyrëve. Kjo harmoni ndodh kur në shpirt gjendet e bukura dhe po ashtu Skënderbeu karakterizohet nga kjo harmoni. Forcën e pamatur të Skënderbeut autori e parqet kur heroi lufton me dy tartarë turq, të nxitur nga Sulltani.

De Rada bukurinë e përsosur në estetikë e shpjegon edhe në kuadër të kompleksit emotiv, në kuadër të vuajtjeve shpirtërore. Këtu hyjnë: pikëllimi, zemërimi, dhembshuria, vuajtjet, ndjenjat e thella të dashurisë etj. Në bazë të këtij kompleksi, De Rada mendon që edhe frika në poezi e zbukuron njeriun, sikur siguria e tij e qetë. Në estetikë kompleksin emotiv e konkretizon me Akilin, dëshpërimin e tij kur kupton vdekjen e shokut, pastaj me dashurinë naive të Zhulietës etj. Në veprën poetike të tij këtë do ta konkretizonte me dëshpërimin e Skënderbeut, kur merr vesh që vëllezërit i janë helmuar. Me kompleksitetin emotiv, De Rada edhe i ndërton veprat letrare. Dallgët e pasionit dhe vuajtja shpirtërore, që janë karakteristika të rëndësishme të teorisë së tij, në veprën poetike „Skanderbuku i Pafan”, dalin shumë herë. Në vend të Zhulietës (që e merr shembull në teori), Serafina është një personazh tjetër që vuan shpirtërisht, kur ndahet nga i dashuri i vërtetë.

E bukura për De Radën është hyjnore. Kjo e bukur përbëhet nga koncepti Zot/Hyj. Sublimen estetike dhe madhështinë De Rada i gjen te besimi në Perëndinë dhe te besimtarët e krishterë, të cilët, pa frikë, shkojnë drejt vdekjes. Besimtarët nuk i frikësohen jetës tokësore sipas tij, sepse kjo jetë është e përkohshme. Këta nuk mendojnë se do të vdesin, por do të jetojnë për t'i treguar veprat e Zotit. E bukura thotë De Rada nuk ka formë të përcaktuar. Ai i njeh disa prej tyre. Mirëpo, çdo gjë të bukur e quan hyjnore. Skënderbeu, heroi i tij, pos tjerash, është i bukur, sepse është besimtar i krishterë, dhe ka besim te Hyji. Besimi te Zoti vërehet edhe te personazhet e tjerë të De Radës. Njëri ndër ta është vëllai i Skënderbeut, Reposhi.

Llojet ose format e të bukurës në teorinë estetike De Rada i kërkon në veprat artistike. Veprat e bukura duhet të kenë madhështinë, forcën dhe frymën origjinale e të sinqertë. Veprat e bukura gjithashtu duhet të

karakterizohen nga bëmat jetëgjata. „Skanderbuku i Pafan” i ka të gjitha ato karakteristika që e bëjnë një vepër jetëgjatë dhe të madhërishtme. Lufta për atdheun është pika e parë që i jep veprës jetëgjatësinë. De Rada, në veprat e tij, ka evokuar ngjarjet historike të shek. XV, luftërat e mëdha për lirinë e atdheut dhe si formë të shkrimit ka zgjedhur formën popullore, formën e rapsodive. Duke e patur parasysh teorinë e tij, veprat poetike kryejnë funksion estetik. De Rada mendon që rapsoditë shqiptare përmbledhin jetën dhe fatin e shqiptarëve, nëpër histori. Ide estetike në këto rapsodi De Rada e konsideron paraqitjen e afërt të këtyre rapsodive për realitetin historik. Të bukurën te këto këngë e gjen te forca edukative dhe këtu përmend fitoret dhe humbjet e fundit të Skënderbeut dhe të shokëve të tij, me Muratin dhe Mehmetin e dytë. Dhe, pikërisht këto kategori i ka trajtuar në veprat poetike të tij.

Në teorinë estetikë, De Rada mbi konceptin e dashurisë personale, mendon që dashuria ideale i përket mashkullit. Ai thotë që i kthehet traditës platoniane. Sikur Platoni mendonte që femrat janë më pak largpamëse, për faktin që ato nuk merrnin të njëjtën edukatë që merrnin burrat. Por, në veprat poetike, ky mendim nuk del gjithmonë kështu. Figura e femrës del me karakter të lartësuar. Bota e brendshme e tyre është shumë e ndjeshme. Ato dashurojnë fuqishëm. Në këtë aspekt, ato mund të barazohen me burrat. Madje, në shumë raste ato dashurojnë më shumë se gjinia tjetër. Femrat, sidomos te „Skanderbuku i Pafan”, nuk mund të qëndrojnë pa dashuri. P.sh., Serafina sëmuret nga dëshpërimi që duhet ta lë dashurinë e zemrës dhe të martohet me Dukagjinin, për interesa kombëtare. Goneta, kur shkon në burg dhe e gjen Astirin të vdekur nga uria dhe të ftohtit, çmendet dhe duke vrapuar pas fantazmës që i dëftohet mbytet duke u rrokullisur nga shkëmb.

Ndonëse De Rada e çmonte dashamirësinë, dashurinë ndaj atdheut mbi të gjitha, dashuria ndërmjet dy personave është po ashtu koncept i rëndësishëm në estetikën e tij. Dhe, duke iu referuar adhurimit për dashurinë tokësore dhe qiellore, ai anonte nga dashuria qiellore. Kur të dashuarit nuk ndejnë vetëm dëshirë apo epush, por janë të pushtuar nga afeksioni qiellor, De Rada mendon se rrjedh dashuria e vërtetë. Dashuria e vërtetë është dashuria qiellore. Kjo dashuri e ka bazën te nderimi dhe simpatia që e kanë dy të dashuarit. De Rada kërkon të bukurën dhe të bukurën në dashuri, si në çdo gjë tjetër ai e gjen te shpirtërorja. Pra, sipas tij dashuria është e bukur kur është shpirtërore.

Dashuria si kategoritë themelore në estetikën dhe në etikën e De Radës, është temë kryesore në poetikën e tij. Në poemën “Skanderbuku i Pafan” do të jenë të shumtë ata personazhe që përshkohen nga afeksioni qiellor, siç e quan De Rada. Dashuria shpirtërore depërton në

të bashkë me bukurinë dhe bekimin e Zotit. Ideja e pastër e dashurisë hyjnore te personazhet kryesore të De Radës nuk do të prishet nga epshi, nuk do të jetë tokësore vetëm për të realizuar kënaqësi. Ky ideal i dashurisë te këto personazhe do të prishet vetëm atëherë kur ka të bëjë me çështjen e atdheut.

Llojet e së bukurës në estetikën e De Radës: drejtësia, pafajësia, singëriteti, mëshira, ndërgjegjja, veprojnë fuqishëm te personazhet e tij: Rina dhe Milosao. Dy të dashuruarit e ndërtojnë botën e tyre përmes dashurisë së pastër me njëri-tjetrin. Ata dashurojnë pa paragjykime, dashurojnë me nder nën frymëzimin e Perëndisë. Edhe pse dashuria në këtë poemë është me shumë si një ëndërr, funksionon në bazë të parimeve estetike të autorit. Ëndrra për të dashurin/dashurën paraqitet si nevojë shpirtërore, jo si epsh (nëse do të ndodhte kjo e dyta, atëherë dashuria e Rinës dhe Milosaos do të binte ndesh me parimet estetike të De Radës.

Milosao shquhet për bukurinë shpirtërore dhe njerëzit e tillë në teori De Rada i konsideron të denjë për të udhëhequr shtetin. Duke qenë Milosao sundimtar i Shkodrës dhe shpirtlart, i plotëson parimet estetike të autorit. De Rada, si në veprën poetike, ashtu edhe në teori, sugjeron një diell të brendshëm. Ky diell i brendshëm, ndër tjerash, do të ndritte me sundimtarin shpirtlart në pushtet. Mirëpo, Milosao do të prishë këtë kriter të autorit. De Rada e njëj dashurinë e pastër në ndërmjet dy personave si kategori estetike. Por, si kategori kryesore të estetikës De Rada e njëj dashurinë për atdheun. Sipas estetikës së tij, Milosao është dashur të lerë çdo gjë për atdheun, gruan, fëmijën, familjen. Ndërsa, Milosao vepron si romantik, si hero lirik dhe në radhë të parë është i dhënë pas familjes (përkushtimi i madh ndaj atdheut te Milosao vërehet më shumë në poemën “Skandërbeku i Pafan”). Dhe, kështu duhet të vijë dënimi. Rinës dhe Milosaos u vdes fëmija e nga dëshpërimi vdes edhe Rina, dhe Milosaos i mbetet si rrugë e vetme të pendohet, të luftojë për atdheun, për të cilin vdes.

Në këtë pjesë ndoshta mund të thuhet që del më shumë koncepti platonik i De Radës, kur përkrah burrin për një dashuri ideale. Mirëpo, edhe Rina, me gjithë dëshirimin që ndjen, kryen funksion estetik, sepse De Rada të bukurën e shpjegon edhe në bazë të kompleksit emotiv, siç u tha edhe më lart. Dhembshuria, hyn në këtë kompleks, kështu që Rina realizon kategorinë e se bukurës, duke ndjerë vuajtje shpirtërore për të birin.

Në bazë të kompleksit emotiv, mund të shpjegohen edhe disa këngë të tjera të poemës për Milosaon, kur ky vuan dhe pikëllohet për vdekjen e të shoqes: “ime-zonjë, shoqja ime / ti nuk je këtu me mua / tok më kurrë s’do të rrimë!”

Në fund të poemës për Milosaon dominon ideja estetike në teori dhe tema patriotike e Jeronim de Radës. Milosao do të vetëdijesohet për detyrën, të cilit i takon, do të luftojë për Shkodrën dhe do të vdesë për të. Në radhë të parë do të duket se i biri i Milosaos dhe Rina do të përfundojnë tragjikisht, si dënim i Zotit për Milosaon, i cili jepet më shumë pas familjes. Por, të gjitha personazhet e De Radës përfundojnë tragjikisht edhe në veprat e tjera. Përfundojnë tragjikisht edhe ata të cilët i përkushtohen gjithë jetën atdheut. Atëherë mund të themi se personazhet e tij përfundojnë tragjikisht, sepse De Rada nisat nga koncepti biblik, duke thënë që njeriu është mëkatar, se ka lindur bashkë me mëkatin. Kështu, njeriu nuk është kurrë i përsosur, i përsosur është vetëm Zoti. Një ndër arsytet që personazhet e De Radës përfundojnë tragjikisht mund të konsidero-het edhe ndikimi dhe adhurimi që ka autori për tragjedinë greke.

De Rada, në veprat poetike, të bukurën në radhë të parë e kërkon brenda njeriut, p.sh. te Skënderbeu, Milosao, Astiri, Bozdari, Serafina, Rina, Imotea, Goneta etj. Njeriun si objekt të së bukurës De Rada e ka kërkuar edhe në teorinë estetike, duke e parë atë si: *trup, mendje, shpirt*. Heroizmat dhe sakrificat e personazheve të veprave poetike, në teorinë estetike De Rada i ka konsideruar si kategori estetike dhe si forma të së bukurës. Ndarja teorike-estetike: trup, mendje, shpirt, në veprat poetike duket kështu: personazhet e tij të dashur karakterizohen nga fuqia trupore dhe bukuria fizike, karakterizohen nga mendjemprehtësia dhe nga shpirtmirësia (nga shpirti në teorinë estetike dalin pothuajse të gjitha format e së bukurës: mëshira, drejtësia, sinqeriteti, dhembshuria etj). Personazhet me virtyte të tilla De Rada i konsideron të denja për të udhëhequr shtetin. Ndikim kryesor për virtyte të tilla, përpos hyjnoses, De Rada e konsideron edukatën shpirtërore. Në veprat poetike të De Radës dalin edhe personazhe veprimet e të cilëve, në teorinë estetike, ai i konsideron edhe si forma të së shëmtuarës, dhe pa virtyte të lartpërmendurve, si: Murati, Sulltani, Zonja Sultana, Maliqi dhe gjithë ushtria turke. Ata në teorinë estetike De Rada do t'i quante burim të korrupsionit. Personazhet e tjerë të cilët De Rada i përjashton nga teoria estetike janë: i shoqi i Imotesë, i cili ia dorëzon gruan pashait dhe Pashai, i cili u shtrohet epsheve. Në këtë rend të personazheve hyjnë edhe Violeta Oderizi, vajza shqiptare, e cila për para e për luks e lë veten të gënjejhet nga turk Alagazi. Luksin dhe modën De Rada i quan një lloj tjetër të kënaqësisë shpirtërore, por jo të barabarta më kënaqësitë që i vijnë shpirtit nga hyjnorja.

De Rada edhe veprat poetike, edhe teorinë estetike i ka ndërtuar në bazat morale kristiane dhe në bazë të këtij morali ka krijuar lidhjen treshe, lidhjen harmonike të personazheve të tij. Kisha, si vend i shenjtë, del më së miri në veprën „Skanderbeku i Pafan”, kur strehon

Vantizanën e humbur në natën e errët. Besimi te Zoti ose koncepti Hyj/Zot, për De Radën, është formë e së bukurës. Sublimen morale ai e gjen te besimi i krishterë.

Literatura

- [1] “Aesthetics” (edited by P. Kivy), Oxford, 2004
- [2] “Aesthetics” (edited by B. Gaut and D. M. Lopes), London and Neë York, 2005
- [3] DE RADA, Jeronim: „Parime të estetikës“, Tiranë, 2003
- [4] ECO, Umberto: “Storia della bellezza”, Milano, 2004
- [5] FERIZI, Mustafa: “Mendimi teorik-estetik i Jeronim de Radës”, Prishtinë, 2006.
- [6] FERRI, Lyk: “Homo Aestheticus”, Tiranë, 2003
- [7] GILBERT, Katarina Everet dhe KUN, Helmut: „Istorija estetike“, Beograd, 1969
- [8] HEGEL: “Estetika 3”, Beograd, 1975
- [9] HAMITI, Sabri: „Vetëdija letrare“, Prishtinë, 1989
- [10] LALO, Sharl: “Nocione të estetikës“, Prishtinë, 1978
- [11] QOSJA, Rexhep: “Historia e letërsisë shqipe -Romantizmi II”, Prishtinë, 1984
- [12] RUGOVA, Ibrahim: “Kah teoria”, Prishtinë, 1978
- [13] RUGOVA, Ibrahim: „Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983“, Prishtinë, 1986
- [14] RUGOVA, Ibrahim dhe HAMITI, Sabri, „Kritika letrare“, Prishtinë, 1979
- [15] UÇI Alfred, „Parime të estetikës e J. De Radës“, parathënie në Jeronim de Rada, „Parime të estetikës“, 2003
- [16] RRAHMANI, Zejnullah: „Nga teoria e letërsisë shqipe“, Prishtinë, 1986
- [17] TODOROV, Tzvetan: “Letërsia në rrezik“, Prishtinë, 2007
- [18] SHALA, Kujtim M.: “Pro/Classica”, Prishtinë, 2005
- [19] SHALA, Kujtim M.: “Shekulli i letërsisë shqipe”, Prishtinë , 2006
- [20] SHALA, Kujtim M.: “Elipsa”, Prishtinë, 2007
- [21] SHALA, Kujtim M.: “Analepsa”, Prishtinë, 2013
- [22] XHIKU, Ali, “Romantizmi arbëresh”, Tiranë, 2002
- [23] ZHENET, Zherar, „Figura“, Prishtinë, 1985

Manjola Lubishtani, Prishtinë

MARKERËT RENDITËS TË MBYLLJES NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij punimi është analizimi funksional e pragmatik i markerëve të mbylljes, të cilët si një nga tre tipat që konstituojnë markerët renditës, duke i prirë segmentit final, mundësojnë mbylljen në formë konkluzionesh të një procesi, të një numërimi faktesh a idesh ose të një serie të akteve të të folurit.

Pikërisht, si objekt të analizës kemi përzgjedhur markerët: *në fund, për fund, më në fund, së fundmi; tekefundit (tekembranja); për ta mbyllur, për ta përfunduar, për ta finalizuar*, të cilët do t'i kundrojmë duke analizuar relacionet që ata vendosin ndërmjet njësive përbërëse dhe funksionet që realizojnë, nëpërmjet ilustrimit me shembuj argumentues, për të nxjerrë në pah veçoritë dalluese të markerëve të tillë në shqipen.

Fjalët çelës: markerë renditës, markerë të mbylljes, funksione pragmatike, seri diskursive konkluduese.

Sfondi teorik

C. Fuentes (1987: 23), i cilëson markerët e diskursit (spanj. *enlaces extraoracionales*)¹ si njësi që mundësojnë koherencën brenda tekstit, ndërsa T. Juarez (2015: 82), duke i konsideruar MD-të si lidhës ose organizatorë të thënieve që veprojnë në planin mbifrazal dhe duke gjeneralizuar këndvështrime të shumta teorike, konkludon se funksioni i tyre nuk përqendrohet vetëm në realizimin e kohezionit¹, por, si orientues të diskursit, dhe në transmetimin e informacioneve pragmatike të rëndësishme për interpretimin e teksteve.

Në këtë punim, markerët e diskursit do të analizohen duke u kundruar nga perspektiva semantiko-pragmatike, ndaj kemi vlerësuar si referencë të qasjes sonë përkufizimin e autorëve M.A. Martin Zorraquino & Jose Portolés (1999: 4057), sipas të cilëve:

Markerët e Diskursit janë njësi linguistike të pandryshueshme, të cilat nuk ushtrojnë një funksion sintaksor në kuadër të predikativitetit të fjalisë - janë, pra, elemente marginale dhe kanë një rol të rastësishëm në diskurs: atë të orientimit sipas vetive të tyre të ndryshme morfosintaksore, semantike dhe pragmatike, të konkluzioneve që realizohen gjatë komunikimit.

Duke iu referuar diskursit, si veprim dhe si rezultat i përdorimit të njësive të ndryshme që lehtësojnë gramatikën e një gjuhe në një akt konkret të komunikimit, autorët e mësipërm e shohin të gjithë diskursin të përbërë në dy pjesë: njëra në tërësi gramatikisht e pastër dhe tjetra pragmatike.

Në këtë kontekst, argumentojnë ata, thënia *Kam shumë punë* është gramatikisht e njëjtë si në shembullin e parë (1a), ashtu dhe në të dytin (1b):

(1) a. A: *Dëshiron të vish në kinema?*

B: *Kam shumë punë.*

b. A: *Kam shumë punë.*

B: *Më vjen keq, nuk mund të të ndihmoj. Jam vonuar dhe duhet të shkoj¹.*

Por, nga perspektiva pragmatike këta janë shembuj që pasqyrojnë situata të ndryshme: në (1a) është refuzuar një ftesë e bërë, ndërsa në (1b) është kërkuar një ndihmë.

Markerët renditës (*në radhë të parë / në radhë të dytë, nga njëra anë / nga ana tjetër; së pari, së dyti; në fund, së fundmi; tekefundit; për ta mbyllur, për ta përfunduar etj.*), të cilët shënojnë dhe grupin themelor të analizës sonë, përbëjnë njërin nga nënlojet e *strukturuesve të informacionit*. Ata funksionojnë si elemente që vendosin një rend linear, hierarkik ose jo, ndërmjet pjesëve të diskursit si njësi të të njëjtit koment. Rënditësit shërbejnë për të asociuar pjesë të ndryshme të diskursit në një tërësi sekuenciale diskursive (Prada. 2001: 29).

Duke u mbështetur në klasifikimin e ofruar nga Garcés Gómez (2008: 39), markerët renditës ndahen në: a) markerë të fillimit; b) markerë të vazhdimit, dhe c) markerë të mbylljes.

Pikërisht, në këtë punim kemi përzgjedhur *markerët e mbylljes*, të cilët do t'i analizojmë duke paraqitur tiparet dhe vlerat semantiko-pragmatike të tyre, gjatë relacioneve që vendosin ndërmjet njësive përbërëse.

Markerët e mbylljes

Ky nëngrup i markerëve të diskursit karakterizohet nga prania e segmentit final që mbyll ose përfundon në formë konkluzionesh një proces, një numërim faktesh apo idesh ose të një serie të akteve të të folurit (Garcés Gómez, 2008: 60). Për vetë funksionin e tillë, markerët e mbylljes shfaqin në strukturën e tyre një element që nënkupton apo sugjeron mbylljen: *në fund, për fund, më në fund, së fundmi; tekefundit (tekembramja); për ta mbyllur, për ta përfunduar, për ta finalizuar*.

Mbyllje e diskursit pa indikim të vazhdimësisë pararendëse

Duke vënë në pah ruajtjen e kuptimit leksikor nga sintagmat *për ta përmbyllur* ose *për ta finalizuar*, Garcés Gómez pohon që këta markerë mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin ose të zëvendësohen nga sintagma të tjera semantikisht ekuivalente, si: *për ta përfunduar, për të konkluduar*, ose të zgjerohen me komplementë: *për ta përmbyllur ekspozënë (fjalën, relacionin)* etj. Markerët e mësipërm, arsyeton autorja, u referohen akteve të të folurit të realizuara nga folësi dhe bëjnë të mundur “shfaqjen e një relacioni koheziv ndërmjet segmenteve të mëparshme dhe përbërësit që futet, meqë aludohet, nëpërmjet një reference deiktike, për një seri pararendëse aktesh të të folurit” (Ibid.):

(2) ***Për ta përmbyllur***, më lejoni të shpreh sërish në emër të Bashkimit Evropian urimet për të gjithë ata që janë të përfshirë në arritjen e këtyre rezultateve: *Policia e Shtetit Shqiptar, prokuroritë shqiptare, Guardia di Finanza, Policia e Shtetit Italian, si dhe projekti SANCAS i financuar nga BE-ja*.

(Luigi Soreca, *Krenar që kohët e fundit po ndodhin ndryshime të mëdha*, javanews.al, 13 shkurt 2019)

(3) ***Për ta përmbyllur***, më lejoni të ju siguroj se ne i qëndrojmë fuqimisht propozimit të bërë publik në dhjetor, për dyfishimin e buxhetit të arsimit të lartë, pra për një shtesë 74 milionë dollarësh amerikanë në mënyrë të përvitshme, të ndarë në dy lote kryesore...

(2200 dollarë bursë për studentët, premtimi i bujshëm i Bashës për Arsimin e Lartë, lajm i fundit.al, 4 maj 2019)

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, qoftë në rastin e diskursit të z. Soreca, Ambasadorit të BE-së në Shqipëri, i cili i drejtohet trupës politike në gjuhën angleze, qoftë në fjalimin e z.Basha, në gjuhën shqipe, struktura e shfaqjes së këtij markeri është identike: pozicion prijës në segmentin final, i ndjekur nga sintagma e kortezisë “më lejoni”.

Në rastet e zgjerimit të këtij markeri me kundrinë të drejtë (komplement), duhet të kemi parasysh rastet kur sintagma “për ta përmbyllur” nuk kryen funksionin e një markeri, por thjesht të një rrethanori qëllimi:

(4) ***Për ta përmbyllur*** mësimin, i ftojme arsimtarët dhe nxënësit të marrin pjesë në krijimin e hartës Globale të të intervistuarve, që e përvijon dhe shkëmben kontributin e tyre në arsim dhe mësim për Qëllimet Globale.

(Projekti për ushqim në kuadër të Qëllimeve Globale, <http://www.mon.gov.mk/>)

Mbyllje të një serie diskursive

Në këtë nëngrup, bëjnë pjesë markerë që nuk pranojnë as zëvendësim të elementeve të tyre, as ndërrim në strukturë e as zgjerim me modifikues. Ata e ruajnë kuptimin leksikor të bërthamës (Garcés Gómez, f. 61). Kështu, autorja dallon disa lloje tipologjish: ata që funksionojnë gjithnjë si renditës diskursivë: *për fund, së fundmi*; ata që kanë një funksion të dyfishtë, si renditës dhe si shënjes të mbylljes së një procesi paraprak: *më në fund*, i cili shfaqet me një vlerë modale të të treguarit të kënaqësisë së folësit para përfundimit të pritur gjatë për një situatë të caktuar; ata që sinjalizojnë mbylljen e një procesi të përbërë nga një seri etapash paraardhëse: *në fund*; dhe ai që paraqet një mbyllje të diskursit që, në shumicën e rasteve, konvertohet në një formulim të ri të asaj që është shprehur ose që duhet të nxirret si përfundim (të deduktohet): *në fund të fundit*. Në këtë nëntip, në shqipen, ne shohim si plotësisht funksional markerin *tekefundit*, të cilin e hasim dhe në trajtën *tekembramja*.

Markerët *në fund, së fundmi* shënjojnë segmentin që renditet i fundit në një seri diskursive të strukturuar nga pjesë përbërëse me karakter numëruar (Ibid.). Nëse i referohen mbylljes së një serie diskursive, këta markerë shfaqen në fund të radhitjes së segmenteve të

parapriria nga renditësit përkatës, të cilët shënjojnë vendin që zë secili nga këto segmente në radhitjen pasuese:

(5) *Së pari*, analizon vendimet e Qeverisë të ndërmarra gjatë 100 ditëve dhe përmbajtjen e tyre...

Së dyti, analiza ofron një vlerësim të hollësishëm të programit legjislativ, më saktësisht projektligjet e hartuara, të miratuara dhe nismat e reja legjislative...

Së treti, analiza pasqyron zhvillimet dhe sfidat kryesore të diplomacisë Kosovare, duke u fokusuar në njohjet e pavarësisë së Kosovës deh anëtarësimin e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare...

Së fundmi, analiza përqendrohet në nivelin e transparencës që Qeveria ka reflektuar gjatë 100 ditëshit të qeverisjes.

(Vlerësim i 100 ditëve të para të Qeverisë Haradinaj, www.institui-gap.org, 4 janar 2018)

Nëse markeri në fund i referohet mbylljes finale të diskursit, atëherë seritë e sekuencave pararendëse janë të nënkuptueshme dhe i njëjti marker shënon praninë e sekuencës së fundit:

(6) *Në fund*, kryeministri Thaçi kërkoi nga qeveria japoneze për të hapur zyrën JICA si dhe mundësinë për të hequr vizat për studentët dhe afaristët nga Kosova.

(Kryeministri Thaçi takon kryeministrin e Japonisë Shinzo Abem- nënshkruajnë Deklaratën e Përbashkët për bashkëpunim midis Republikës së Kosovës dhe Japonisë, www.ambasada-ks.net, 14 prill 2014)

Ky marker mund të shoqërohet dhe nga prania e lidhëzës kundërshtore “ndërsa”, e cila këtu nuk kryen funksion kundërshtor, por thjesht përqasës dhe shumë mirë mund të këmbëhet me lidhëzën “dhe”:

(7) *Ndërsa në fund*, kryeministri Haradinaj theksoi se rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës, krahas fuqizimit të sundimit të ligjit, janë objektiva kryesore të kësaj Qeverie.

(Kryeministri Haradinaj priti në takim Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Fehmi Mehmeti, bqk-kos.org, 7 maj 2018)

Në rastet kur përdorimi i markerit *në fund* vjen si pasojë e një konkluzioni determinues të argumenteve korreleuese hierarkike, mund të ndodhë që, varësisht nga këndvështrimi i folësit, prania e tij të paraprihet nga lidhëza “por”, duke i dhënë kështu karakter inversiv rendit të shfaqur (loc. cit.):

(8) *Mbi këtë është shprehur se do të jetë bashkëpunues dhe do t'i dëgjojë kërkesat e tërë faktorit ndërkombëtar me vëmendje. Por sipas tij është përfaqësues i qytetarëve të Kosovës [dhe] në fund do t'i mbrojë interesat e tyre.*

(Albin Kurti, *Jam i durueshëm me ndërkombëtarët, por në fund mbroj interesat e qytetarëve të Kosovës*, mekulipress.com, 27 shkurt 2020)

Prania e këtij markeri duket e zakonshme në tituj gazetash apo reagimesh në rrjete sociale, duke u karakterizuar me pozicionin fundor argumentues, si paraprijës i një segmenti të diskursit me karakter opozicional (kundërvënës):

(9) *Shumë para të shpenzuara dhe në fund vetëm dështim për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL!*

(parstoday.com, 21 nëntor 2018)

Markeri *më në fund* bën të mundur futjen e segmentit final të një serie faktesh apo idesh, të cilat duke pasuar në mënyrë zinxhirore njëra-tjetrën arrijnë kulminacionin në segmentin në të cilin prin ky marker, për ta përmbyllur kështu perspektivën e folësit:

(10) *Letërsia shqipe, për herë të parë në historinë e vet, nëpërmjet saj është integruar në letërsinë evropiane dhe botërore, dhe përfaqësohet denjësisht në hartën e tyre.*

Përhapja e saj, mendimi kritik në gjuhë të tjera për të dhe, më në fund, vendi që zë ajo në letërsinë e zgjedhur botërore, padyshim, janë

pjesë e studimit të vlerave dhe të funksionit të saj, tanimë jo thjesht në truallin amtar, por edhe në rrafshin gjithënjëzësor.

(A. Kajtazi, *Receptimi si Kategori e Komunikimit*, Ars Poetica, nr. 23, shtator 2009, fq. 47)

Ky marker mund të indikojë një rezultat final të një procesi të pritur gjatë, i cili u referohet fakteve të mëhershme, të cilat e kanë determinuar këtë reagim në mënyrë eksplicite:

(11) *Haaland, i cili është blerë për rreth 25 milionë euro nga RB Salzburg, **më në fund** theu heshtjen dhe pranoi se nuk ishte i lumtur me festimin e tij duke u tallur, por falënderoi ata që iu bashkuan kampanjës së tij.*

(*Haaland më në fund thyen heshtjen dhe flet pas talljes që i bëri Neyman dhe lojtarët e PSG-së*, telegrafi.com, 1 maj 2020)

I njëjti marker haset shpesh në formë deklamative, karakteristike e titujve të artikujve në gazeta apo e qëndrimeve personale në rrjete sociale:

(12) ***Më në fund** kompromis mes Rusisë dhe Ukrainës!*

(*Fokus*, www.dw.com, 4 janar 2016)

(13) *Përfundon, **më në fund**, programi i shpëtimit të Eurozonës.*

(*Monitor.al*, 31 gusht 2018)

(14) ***Më në fund** po flasim për ide dhe programin, sesa për sherre e inate. Analizë e mirë e Zaloshnjës...*

(*Reagim i Erion Veliajt në rrjetin social Facebook*, 31 tetor 2011)

(15) *E mbajti sekret por **më në fund** e zbuloi, reperi i njohur shqiptar i jep fund beqarisë. Kush është vajza që i ka rrëmbyer zemrën?*

(www.panorama.com.al, 10 mars 2020)

Edhe pa pasur elemente korreluese që tregojnë se kemi të bëjmë me seri të renditur, markeri *më në fund* shënjon mbylljen e një vazhdimësie argumentesh, të cilën folësi e realizon nëpërmjet vendosjes së relacionit marker – folje: *më në fund doli / arriti më në fund*:

(16) “***Më në fund doli*** një kryeministër shqiptar që ua tregoi historinë grekëve dhe shkatërroi mitin fals të Vorioepirit”

*Një kryeministër shqiptar, pas njëqind vjetësh, **arriti më në fund** t’u flasë grekëve racistë me gjuhën e historisë dhe të vërtetës.*

(Spartak Ngjela, prizrenipost.com, 1 nëntor 2016)

Po ashtu, konkluzioni argumentues mund të arrihet edhe nëpërmjet radhitjes së fakteve të prezantuara nga folësi, duke mundësuar kështu përdorimin e markerit *më në fund* si pjesë përbërëse të segmentit final deduktiv, i cili finalizon krejt serinë e diskutimit:

(17) “*Vendi juaj e ka përmbushur detyrën e vet, duke i zbatuar të gjitha reformat, përfshirë edhe miratimin e Ligjit për Prokurori publike, kështu që radhën e kanë vendet anëtare...Unë do të përmbahem nga optimizmi i madh, sepse asnjëherë nuk dihet nëse një çështje e re nga ndonjë palë do të çrregullojë diskutimet. Po për momentin mendoj se yjet po renditen dhe shpresojmë që **më në fund** të shohim rezultat pozitiv.*”

(Shkëputur nga intervista e Ambasadorit të BE-së, S. Zhbogar, dhënë TV24, Portalb.mk, 4 mars 2020)

Markeri *në fund të fundit*, të cilin e kemi hasur në shqipen si formë që karakterizohet nga strukturë e përforcuar me përsëritje të elementit bazë -në fund-, shënjon mbylljen e një serie diskursive, duke indikuar praninë e një segmenti final që mbyll një vazhdimësi faktesh pararendëse ose përfundimin që nxirret nga faktet e ekspozuara më herët. Si marker renditës, shënjon përbërësin final që mbyll një seri në të cilën, zakonisht, ngjarjet e përmendura në segmentet e mëparshme nuk paraprihen nga markerë renditës korrespondues:

(18) *Radha është t’i hapet rrugë asaj pikës 127 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila thotë se **në fund të fundit** zgjidhjen në dorë*

e kanë deputetët, nuk e ka as Gjykata Kushtetuese e as PDK, as instituti që po kontrollon ajo.

(G. Konjufca, *Në fund të fundit, zgjidhjen në dorë e kanë deputetët shumicë,*

www.kosovarja-ks.com, prill 2020)

Ajo që është e rëndësishme të theksohet lidhet me faktin se markerët *më në fund, në fund të fundit dhe tekefundit (tekembramja)*, tipikë për shqipen, të cilët funksionojnë si markerë të mbylljes, paraqesin një vlerë funksionale të përbashkët: shënojnë momentin final ose situatën përfundimtare që mbyll një proces të mëparshëm dhe në të cilën procesi arrin pikën kulminante.

Po sipas Garcés Gómez (2008: 67), tipari dallues ndërmjet tyre shënohet nga pritshmëria e folësit: me markerin *më në fund* tregohet kapërcimi i pengesave të caktuara dhe lehtësimi dëshmohe me faktin që shënon fundin e një situatë të mëparshme të padëshiruar; *në fund të fundit, tekefundit (tekembramja)* paraqesin përbërësin e diskursit në të cilin janë futur si pjesë e fundit e një procesi argumentues kohor që zhvillohet pasi të kenë ndodhur ngjarje të tjera të mëparshme:

(19) *Kapriçiot e tij të brendshme politike nuk janë shqetësim global. Tekefundit, vetë u ka kërkuar amerikanëve “të mos përzihen në punët tona të brendshme”.*

(Blerta Deliu, *Albin Kurti ka humbur arsyen, sot na e mori fytyrën me letrën drejtuar Mike Pence*, pishpirik.de, 6 maj 2020)

(20) *Kosova vuajti gjithë këto vite nga dergja e tmerrshme e politikëbërjes dhe politikës. Tekembramja, nuk ka mundur të pritët më shumë e as gjendje tjetër nga kjo që është, kur dihet se qeveritarët tanë duhet ta kuptojnë se kështu nuk shkohet më edhe asnjë qeveri nuk mundet të jenë krenar për punën e tyre që na prunë deri këtu?!*

(Ragip Guraziu, *Politika dhe politikëbërja në Kosovë, ishte si pacienti në klinik para vdekjes*, www.kosova-sot.info, 10 mars 2020)

Pra, markerët *në fund të fundit dhe tekefundit (tekembramja)* shënojnë rezultatin final të një procesi të mëparshëm argumentues, si të vetmin fakt që folësi dëshiron të identifikojë dhe që e gjykon të vlefshëm e të vërtetë.

Përdorimi i markerit *më në fund*, konkludon Garcés Gómez (2008: 68), karakterizohet nga funksionalizimi i tiparit pritës, për të shënuar se kulminacioni i procesit, pas një serie ngjarjesh që e kanë vështirësuar përfundimin e pritur, ka arritur. Kështu, folësi shpreh kënaqësinë për situatën e re që po ndodh:

(21) *Më në fund*, është arritur marrëveshja për bashkëqeverisje ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

(*Më në fund nënshkruhet marrëveshja VV-LDK*, klankosova.tv, 2 shkurt 2020)

Përfundime

Markerët e mbylljes shfaqin veçori semantiko-pragmatike dhe realizojnë funksione të rëndësishme në ecurinë dhe zhvillimin e diskursit, duke shfaqur tipare funksionale të larmishme. Kështu, krahas markerëve për ta përmbyllur, për ta finalizuar, të cilët mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin, të zgjeruar ose jo me komplementë, markerët në fund, së fundmi, më në fund, në fund të fundit, tekefundit (*tekembramja*), duke e ruajtur kuptimin leksikor të bërthamës, paraqiten të ngurtë ndaj ndryshimeve, si: zgjerim, ndërrim apo zëvendësim të elementeve të tyre. Si tipar mjaft karakteristik kemi hasur pozicionin e tyre në krye të segmentit final të diskursit, në të cilin shfaqin vlera të larmishme, si: konkluzion, kulminacion hierarkik etj.

Një tjetër karakteristikë e tyre është marrëdhënia që disa prej tyre vendosin me lidhëzat “ndërsa”, “por” e “dhe”, të cilat i kontribuojnë shfaqjes së konkluzionit determinues të argumenteve hierarkike.

Përdorimi i markerit *më në fund* mundëson futjen e segmentit final, i cili shënon kulminacionin e një serie faktesh a idesh të radhitura nga folësi sipas këndvështrimit të tij.

Një tjetër tipar i tyre lidhet me praninë në formë deklamative në tituj artikujsh apo qëndrimesh personale në rrjete sociale, të cilat, përveç rolit deduktiv, shënojnë çastin final ose situatën përfundimtare të një procesi kulminant. Si shfaqës të këtyre vlerave, në shqipen hasen markerët *më në fund*, *në fund të fundit* dhe *tekefundit* (*tekembramja*), por sigurisht me tipare dalluese: markerët *në fund të fundit* dhe *tekefundit* (*tekembramja*) shënojnë rezultatin final të një procesi të mëparshëm argumentues, si të vetmin fakt që folësi dëshiron ta identifikojë dhe që e

gjykon të vlefshëm e të vërtetë, ndërsa me anë të markerit *më në fund* folësi shpreh kënaqësinë për situatën e re që po ndodh.

Bibliografia

- [1] Fuentes Rodríguez, C. (1987): *Enlaces extraoracionales*, Sevilla: Alfar.
- [2] Garcés Gómez, M^a. P. (2008). *La organización del discurso: marcadores de ordenación y de reformulación*. Madrid / Frankfurt: Iberoamericana / Vervuert.
- [3] Martín Zorraquino, M^a. A. & Portóles Lázaro, J. (1999). *Los marcadores del discurso*, në I. Bosque e V. Demonte (eds.), *Gramática descriptiva de la lengua española*, Madrid: Espasa-Calpe, vol.3, cap. 63, 4051-4213.
- [4] Prada, J. J. (2001). *Marcadores del discurso en español: análisis y representación*, Master Thesis, Universitat de la Republica Uruguay, Facultad de Ingeniería Instituto de Computación.
- [5] Terrones Juárez, S. (2015). *La enseñanza de los marcadores del discurso en los manuales escolares de la educación secundaria en Perú*, Tesis de doctorato, Departamento de Filología Española y Latina, Universidad de Coruña.

Burimet elektronike

- [1] 2200 dollarë bursë për studentët, premtimi i bujshëm i Bashës për Arsimin e Lartë, lajmifundit.al, 4 maj 2019.
- [2] Deliu, B., *Albin Kurti ka humbur arsyen, sot na e mori fytyrën me letrën drejtuar Mike Pence*, pishpirik.de, 6 maj 2020.
- [3] *Fokus*, www.dw.com, 4 janar 2016.
- [4] Guraziu, R., *Politika dhe politikëbërja në Kosovë, ishte si pacienti në klinik para vdekjes*, www.kosova-sot.info, 10 mars 2020.
- [5] *Haaland më në fund thyen heshtjen dhe flet pas talljes që i bëri Neyman dhe lojtarët e PSG-së*, intervista e Ambasadorit të BE-së, S. Zhbogar, dhënë TV24, Portalb.mk, 4 mars 2020.
- [6] Kajtazi, A. *Receptimi si Kategori e Komunikimit*, *Ars Poetica*, nr. 23, 2009: 47.
- [7] Konjufca, G. *Në fund të fundit, zgjidhjen në dorë e kanë deputetët shumicë*, www.kosovarja-ks.com, prill 2020.

- [8] *Kryeministri Haradinaj priti në takim Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës*, z. *Fehmi Mehmeti*, bqk-kos.org, 7 maj 2018.
- [9] *Kryeministri Thaçi takon kryeministrin e Japonisë Shinzo Aben-nëshkruajnë Deklaratën e Përbashkët për bashkëpunim midis Republikës së Kosovës dhe Japonisë*, www.ambasada-ks.net, 14 prill 2014.
- [10] Kurti, A. *Jam i durueshëm me ndërkombëtarët, por në fund mbroj interesat e qytetarëve të Kosovës*, mekulipress.com, 27 shkurt 2020.
- [11] *Më në fund nënshkruhet marrëveshja VV-LDK*, klankosova.tv, 2 shkurt 2020.
- [12] Monitor.al, 31 gusht 2018.
- [13] Ngjela, A., prizrenipost.com, 1 nëntor 2016.
- [14] parstoday.com, 21 nëntor 2018
- [15] *Projekti për ushqim në kuadër të Qëllimeve Globale*, <http://www.mon.gov.mk/>.
- [16] Reagim i Erion Veliajt në rrjetin social Facebook, 31 tetor 2011.
- [17] Soreca, L. *Krenar që kohët e fundit po ndodhin ndryshime të mëdha*, javanews.al, 13 shkurt 2019.
- [18] telegrafi.com, 1 maj 2020.
- [19] *Vlerësim i 100 ditëve të para të Qeverisë Haradinaj*, www.instituigap.org, 4 janar 2018.
- [20] www.panorama.com.al, 10 mars 2020.

Abstract

The main purpose of this paper is the functional and pragmatic analysis of closing markers, which as one of the three types that constitute ordinative markers, leading to the final segment, enable the closing in the form of conclusions of a process, a count of facts or ideas or a series of speech acts.

Exactly, as an object of analysis we have selected the markers: *në fund, për fund, më në fund, së fundmi; tekefundit (tekembramja); për ta mbyllur, për ta përfunduar, për ta finalizuar*, which we will look at by analyzing the relations they establish between the constituent units and the functions they perform, through illustrative examples, to highlight the distinctive features of such markers in Albanian.

Keywords: ordinative markers, closing markers, pragmatic functions, concluding discursive series.

Flamur Maloku, Prishtinë

POEZIA E SABRI HAMITIT

1. Vetmia dhe poezia

Meditimi dhe ndjeshmëria e thellë poetike, e bëjnë Sabri Hamitin figurë qendrore në poezinë shqipe, gjatë një rrugëtimi që do ta ketë ndjekur poeti krejtësisht ndryshe edhe nga vetë mënyra e të shkruarit, përzgjedhja e bukur e fjalës, pasqyra e saj, figuracioni, artikulimi e gjuha poetike, emocioni e mënyra e të shprehurit, të gjitha këto i dhanë mundësinë të jetë i tëri vërtet i veçantë si poet në mesin e poetëve. Konkretizimi dhe e gjithë rruga e zhvillimit shumë e zorshme për rrethanat e kohës, ngjyrat e së cilës vërehen fort e shumë nga fjala në fjalë, nga vargu në varg, nga strofa në strofë, nga poezia në poezi, nga libri në libër, dhe zaten kjo e ka bërë atë të ndihet komod dhe përgjegjës për çdo fjalë të thënë e të shkruar mjeshtërisht, ku ka prekur mendja e dora e tij e ndjeshme prej njeriu e poetit sigurisht. Dihet tashmë se poezia jeton nga kjo frymë, e nga shpirti e fjala. Pa shpirtin nuk do të rronte dot, ashtu siç nuk do të rronte as njeriu, për të cilin krijohen mu këto shkrime, sado që arti krijohet fillimisht si krejtësisht personal e intim, për t'u zhvilluar më pastaj si vend kulti e përjetësie. Prandaj, duke qenë se këto kërkesa të përhershme, poezinë e bëjnë të marrë rrugë e rrugëtim jetësor, për aq kohë sa do të ketë jetë e lexues besnikë. Poeti do ta ketë hetuar me kohë forcën e kësaj fryme universale, shpirtin, fjalën, përjetësinë, imagjinatën, dëshirën, dashurinë, urrejtjen për të keqen e shpresën për një botë tjetër. Ai sikur s'u ndal kurrë qoftë i vetëm a i vetmuar, qoftë me njerëz të shpirtit të tij apo edhe pa ta, qoftë me miq ose edhe pa ta, i zbathur a i mbathur, ai zgjodhi një udhë që i deshi qejfi i tij, të qajë aty ku duhet, të qeshë aty ku duhet, e të ëndërrojë si duhet e të mos gjuhëzohet për asnjë çast para askujt, madje as para mizorive që di t'i bëjë vetëm forca njerëzore në çdo kohë e në çdo rrethanë të saj. Kjo situatë Hamitin do ta ketë provokuar e ngacmuar pareshtur e pashmangshëm sigurisht, me net të tëra pa gjumë e me ditë të tëra me shqetësime të tjera, për se shpëtimi i qe tek fjala e vargu i shkruar mjeshtërisht mirë, me kohë e hapësirë të duhur si një kronologji

historiko-poetike, duke e bërë lexuesin rob të leximit e prehje për njerëzit që e duan akoma këtë robëri si vendin ku kërkohet paqja e përjetësia morale e sociale e këtij kërkuesi njerëzor. Delli prej poeti më ndryshe, uni i tij, parimi, dimensionet poetike, zëri kumbues, thirrja dhe lufta e këtij universi për cakun e caqet e kësaj prehjeje, poetit krejt padashur i hapën rrugën e të qenit shkruesi poetik mbase aktual në çdo kohë, me gjithë zhvillimet marramendëse teknologjike. Ai u bë i dashur përmes fjalës e përkthimit të natyrshëm të saj, një shkrim që pushtoi madje edhe shumë gjuhë të botës, me natyralitetin e epitelin e poetit që me moshën e shkrimit, poeti i lidhi shekujt si një urë krejtësisht shpirtërore e fjalës së tij që e tha edhe atëherë kur nuk qe e guximshme të thuhej. Kjo poetin e bën të gjallë e të përjetshëm në mozaikun e madh poetik jo vetëm në gjuhën shqipe.

Sabri Hamiti sikur qe përherë akti krijues, ai nuk identifikohet ndryshe, heshtja e bën më të madh, i ka shpallur vetes aktin e krijimit, qetësinë dhe rregullat e pashkruara të saj. Ai nuk është vetëm as kur është i vetmuar. Me bagazhin që ka, tashmë identifikohet përmes gjurmëve, shenjave e hapësirës gjuhësore e leksikore të saj, ai i dha kësaj bote shkrimit, tablonë më reale të mundshme me gjithë ngjyrat, jo rrallë dëshpëruese e shpresëdhënëse, ai vrau sa herë heshtjen, sado që e parapëlqente qetësinë deri në vdekjen e saj, për ta ringjallur më pastaj me shpresën e pathyeshme që nga lindja gjer në agim. Ashtu siç lind vdekja nga jeta e jeta nga vdekja, një riciklim që Zoti ua dha njerëzve e botës që merr frymë që kur zbardh drita e agut të mëngjesit e deri tek perëndimi i diellit. Hamiti këtu është unik e në harmoni me veten e shpirtin, ai di të kërkojë, e di fort mirë këtë udhë, të cilën e ka marrë pa ia dhënë askush, përgjegjës e këmbëngulës deri në vlim, i bindur thellë në qetësinë që ka, por edhe që mund të vrasë kurdo e kudo, ashtu siç ka vrarë heshtjen me fjalë sa herë i është kërkuar ajo, me gjithë betimin kushtimisht të thënë kështu, ai sikur e prishi, e shqeu terrin me sy, e lexoi mirë e mirë mesazhin e identifikimit brenda një qarku diametralisht të kundërt më atë hijen, çfarë do ta ketë kërkuar e vazhdon ta kërkojë edhe sot e gjithë ditën. E gjitha e ndodhur rrallë për poezinë shqipe, shembjet e rindërtuara nga shembjet, shembull identifikues autorial, pa prekur në esencë as përmbytjen e identifikimit, se autori është tjetër, se ai vjen i heshtur e shpërthyes, i dashur e refuzues. Kërkues në këtë shtrat lumi figurativ, përzgjedhës për të kërkuar banues qendrorë e besnikë në labirintin hapësinorë të kohës kur jeton e vepron poeti ... Prandaj, çështja e hapësirës dhe shpallja e gjuhës përballë një vetmie krijuese, shënjon një zë unik të fjalës krejtësisht tjetër. Kjo ka ndodhur rrallë në poezinë

shqipe, sepse hapësira e përjetësimit të gjuhës poetike, së pari për vetvete, pastaj si një shije e përgjithshme, i ka shembur kohët e krijimit. Vetëm poetët e mëdhenj të poezisë i shembin kohët e veta gjatë aktit sublim të shkrimit. Kjo ndoshta është edhe arsyeja pse Hamiti mbetet njëri ndër poetët me të lexuar nga të gjithë brezat.

2. Uni poetik

Gjuha poetike e realizuar me një frymëzim, tejkalon çdo hapësirë gjatë aktit të shkrimit, por çdoherë duke e pranuar atë ndjeshmërinë e thellë përballë subjektit shkruar. Pranimi i ndjeshmërisë së trupit shkruar duhet kuptuar si kërkesë potenciale e vetë gjuhës poetike, unit poetik, që në aktin e krijimit/shkrimit flet vetë dhe e tregon vetë. E kur gjithçka përmbysset në gjumë, e pushon së jetuari çdo zhurmë, qenia ekzistenciale bashkë me gjuhën, e fillon jetën brenda poezisë. “Poezia e shpreh faktin se qeniet qëndrojnë të qeta. Por, si ndodh kjo? Qeniet bien në qetësi, po pastaj është Qenia ajo që priret të flasë, se dëshiron të jetë”. (Moris Blansho). Ky esencialitet i fjalës e ka sforcuar vetëmjaftueshmërinë e gjuhës së shpallur në aktin e shkrimit nga ana e subjektit poetik, e cila ka relativizuar përherë domenin e figurës poetike karshi ndjeshmërisë. Këtij relativizimi të përhershëm i kanë ndihmuar emocionet, të cilat në kozmosin e jetësimit kanë forcuar përherë fjalën poetike të autorit. Ndihma për një forcim kushtimisht të fjalës poetike, ka ardhur nga vetë gjuha përzgjedhëse, e cila si përherë banon bashkë me figurën, konkretisht me metaforën. Sabri Hamiti me të drejtë konsiderohet nga studiuesit mjeshtër i metaforës. Metafora mbetet nga figurat më të dashura prej nga edhe pozicionohet autori. Prandaj, gjithnjë e më shumë, sa lexohet poezia e Hamitit, të krijohet ideja se gjuha përzgjedhëse dhe metafora dalin të jenë prijatare të çdo gjëje gjatë aktit të poezisë, të cilat pastaj bëhen bazë dominante e organizimit dhe e frymëzimit përgjatë krijimit.

Gjuha poetike e Hamitit, është gjuhë kuptimplotë shpërndarëse gjatë gjithë leximit, sikur krijohet një rilexim gjatë leximit, sepse lexohet thjesht e bukur çdo figurë, mu këtu ndoshta qëndron edhe madhështia e çdo vargu. Mbi këtë premisë, gjuha e poezisë së tij ngrihet si një mundësi e madhe për kërkimin e esencave kuptimore nga ana e lexuesit. Ky hetim bëhet pjesë e domosdoshme vetëm gjatë një vëzhgimi të kujdesshëm, gjatë hetimit të një sistemi gjuhësor e figurativ, që ngërthen brenda vetes poezia e Hamitit. Arsyeja është kjo,

se shenjat e brendshme të poezive mbërthehen brenda një sistemi të modeluar në frymën e strukturuar mirë, kuptimësia e së cilës është inkuadrimi brenda sferës i pranuar pa prishur asnjë rreth tjetër brenda rrethit kuptimor, gjithnjë duke pranuar *Fjalën*. Një fenomen i tillë, sa afrues aq edhe problematik për lexuesin në raport me poezinë, ngjall dëshirën e mëtejme për hetim të rrjeteve kuptimore. Ky argumentim sforcon mendimin për empirinë e leximit, pra poezia e Hamitit kërkon një gjë të tillë, që gjatë leximit të hyhet brenda sferës, rrethit, ciklit kohor, të shijohet së brendshmi çdo tingull, çdo zë, për ta prekur krejt në cak poezinë e poetit Hamiti.

Sabri Hamiti ngjall në vazhdimësi kujtime, e largon harresën me një varg, krijon tronditje përmes vargjesh, i jep kuptim figurës, e madhështon fjalën e kuptimin e saj, e thotë bukur edhe dhembjen, pa dyshim.

3. Loza / Dorëshkrimet

Melankolia e Sabri Hamitit, është titulli që i mbanë në vete, Tri Dorëshkrime Shpirti, për të dhënë figurën e Jetës. Titulli është formulim jete, shenjë e figurë personale, prekur shpirtërisht, që me Vuajtje/Melankoli shkruhen Dorëshkrimet e Fatit.

Secili Dorëshkrim, sistemohet nga plaga empirike, nga mendimi i thellë, duke dalë nga gjuha e zemrës në shkrim. Vuajtja njihet në rikthim, ndërsa figura e jetës bëhet me e përmallshme në poezi. Kjo në esencë rikthen shpirtin, zemrën/mallin në Dorëshkrim.

Në Melankoli, Sabri Hamiti Ruan Dorëshkrimin, Ruan Jetën. Gjithçka në ruajtje bëhet krijim për shkrimin, mos harrim për Gjenezën/Lozën, sidomos kur Dorëshkrimi i referohet Dumnicës, toposit gjeografik të shpirtit, botës së shenjtë personale. Aty ku strukturohet përjetimi, Hamiti nis historinë e rrëfimit dashurisht, Melankolinë/Shpirtin. Figurën e brishtë të fatit/jetës.

Në formën e diskursit personal, në kategorizimin e përgjithshëm llojor, Melankolia, shenjon figurat, që ngrihen në nivel jetësimi e shkrimi.

Në tri Dorëshkrimet: Dorëshkrimi i Prishtinës, Dorëshkrimi i Bluasë, dhe Dorëshkrimi i Dumnicës, kryqëzohen me subjektin, ndërsa në diskurs lëvizë varianti shpirtëror, sepse përpara ka Jetën në rrëfim. Shenja për jetën në fikson, bëhet shenjtërim i figurës në kryqëzim/rikthim/rrëfim. Kjo e përforcon shkrimin, njëkohësisht edhe dialogun me poezinë.

Rrëfimi/Rikthimi, konceptohet nga kujtimi e dhembja. Duke u hapur rrëfimi, hapet figura, Shpirti i Madh në Dorëshkrim.

Melankolia në përzgjedhjen e veçantë figurative e personale, bëhet ndjeshme, e zbutur deri në fund të tekstit, për të formuluar sistemin e jetës, duke prekur përherë Njeshin me Dorëshkrimin, gjithnjë me Trupin Shkrues, përgjatë tekstit/poezisë. Pra, kemi Dorëshkrimin që shenjon afrinë shpirtërore të tekstit me autorin, apo të autorit me krijesën e vet, pastaj lidhjen e trupit, nëpërmjet dorës me tekstin, si shkrirje e trupit në tekst; mëpastaj me anën psikologjike të arki- kujtesës së autorit të ruajtjes së dorëshkrimit si shenjë e fuqishme të botës personale, të vetmisë esenciale të tij¹. Dorëshkrimet krijon vetminë, mallin e bredhur personal në kohë dhe hapësirë. Dhimbshëm shkruhet vetmia esencial, thellë artikullohet filozofia në shprehjen e empirisë personale. Mbi këtë rrafsh përgjithësues, qenësia e shkrimit formulon në vete, qenësinë e figurës, arsyen e mendimit e të emocionit. Kështu, tri Dorëshkrimet: Dorëshkrimi i Prishtinës, Dorëshkrimi i Bluasë, dhe Dorëshkrimi i Dumnicës, japin mallin dhe emocionin e veçantë, për të zgjuar mallin për poezinë në lexim. Kjo ngjet, zakonisht me veprën e mirë, me vargun e mirë apo me fjalën e mirë. Pra këtu kemi të bëjmë me filozofinë e kuptimit dhe me fuqinë e ndjenjës, e me arsyen e mendjes¹.

Vepra poetike Melankolia e Sabri Hamitit, rikthen arsyeshëm Lozën e Shpirtit, Metaforën e Lozes. empirinë dhe ndjenjën e madhe në universin poetik.

4. Dhjetë ankime e një lutje

Melankolia hapet me Dorëshkrimin e Prishtinës, i sforcuar nga nëntitulli, dhjetë ankime e një lutje. Ky formulim njihet përkatësinë e dorëshkrimit: i Prishtinës. I shkruar në Prishtinë; pastaj, për Prishtinën. Në ditët e saj të mbushura ankth. Duke u shkruar në Prishtinë, më afër se elegjinë, mbanë ankimin, atë që rrjedh nga përballjet me jetën aty, në Prishtinë¹. Aty ku përshkruhet Prishtina, përshkruhet zia e shpirtit/fatit. Dëshmia personale njihet toposin, njihet dhembjen për toposin. Pikat e referimit, bëhen pika të zemrës emocionale.

Në Dorëshkrimin e Prishtinës, shënjohej përmbysja, kaosi i toposit. Përmbysja shtrin në vete figurën universale. Prishtina vendi i gjakimit, identifikon atdheun e shkapërderdhur. Prishtina është Atdheu, Atdheu është Prishtina, për t'u bërë figurë e Babilonisë. Rendi i

stërkequr babilonik, bëhet rend i përvujtërisë shpirtërore. Atdheu në nota dhembje, bëhet elegji fati. Elegjinë e formulon dramatika e jetës. Në këtë dramatikë të zemrës, janë pa dyshim dhjetë ankimet subjektive e nacionale, për të dalë në gjuhën poetike. Dhjetë ankimet përbejnë dhjetë shprehjet poetike të dhembjes për dehumanizimin e jetës, ku autori kërkon etikën e jetës në kuptimin nacional e universal të saj. Ankimet janë për jetën, jo për ligësinë nga jeta si vdekje¹. Vdekja në rendin e prishur, në vlerën e zhvlerësuar etike të jetës, bëhet Diell i errësuar, hallakamë rendi, bubullimë që pret e vret koka:

Dielli kur u errësua hallakama thirri rendin
 Bubullimë e kryqtar në lëndinë shtroi kuvendin
 Jam nga kik' e malit nemun ku kokat i korr furtuna
 Dhe cullakun leshatuk në acar e mbërthen guna
 Valët po m'i gicin këmbët kur deti është vashë e qetë
 Brusha po m'i shpërland dhëmbët të shkëlqejë qeshja vetë
 (Babilonia I)

Gjithë kjo botë semantike, është artikulum i emocionit, pse jo, edhe i një tensioni personal, përballë zhbërjes së kodit nacional. Zhbërja e kodit nacional nënkupton krizën e madhe të jetës. Babilonia e Biblës, bëhet Babiloni e Atdheut /Prishtinës. Tema zgjerohet, kurse personalja gjithnjë e më shumë ankohet. Ankimi bëhet universal, në mjerimin e përhershëm personal. Ankimi i shtresuar në strukturën tekstore, është variacion i dhembjes, i moshës së dhembjes. Tridhjetë vitet e moshës subjektive, bëhen gacë e brendshme jete. Është kohë ferri, nëpër të cilën kohë subjekti është sfiduar e sakatuar vazhdimisht.

I kam vetëm tridhjetë vite si gaca zije përbrenda
 Fjala kapërcen fytin përpara se zgjohet mendja
 Tridhjetë tjera nuk i di si rreshta lule në terr
 Kush e di çka është parajsa pa u lakuar nëpër ferr
 (Babilonia II)

Aty është dorëshkrimi, është diskursi i brishtë, për kohën hapësirën. Krejt ky rikthim në temën e figurën mitike, shenjon shkallën e dhembjes. Secila pjesë e poezisë Babilonia, është pjesë e zemrës,

pjesë e moshës së dhembjes, e identifikuar deri në skaj, në shumëzimin infinitiv. Vuajtja është Elegjia e botës sonë, që shkon në metaforën e përfshirjes kosmogonike. Pra, duke u rritur dorëshkrimi, Elegjia bëhet shumëzërëshe përballë kodit nacional. Kjo në esencë njeh pikëreferimin. Metafora e vuajtjes, tashmë është universale. Zëri i Prometheut të rebeluar, është zëri i autorit të rebeluar, pa fije frike, në fjalë/folje i Liruar, karshi kohës. Liria prometheiane, është para së gjithash guxim personal në gjuhë/veprim. Gjithçka jepet në rebelim kohe, për kohën e ferrit. Prometheu i liruar, në trajtë diskursive, shumëzon Elegjinë e kohës së atdheut.

Në mbrojtje e dëshmi figurative, është edhe poezia Mbrojtja e Antonit. Vetë titulli bëhet shenjë e formulim kategorik/tematik. Njeriu i letrave, mbrohet nga Miku i madh i letrave. Elegjia përjashtohet në mbrojtje. Duket se figura e Anton Pashkut s'mund të shihet nga një elegji, meqë ajo është e vetëmjaftueshme, andaj "e rreptë"¹. Sabri Hamiti, dëshmon për mikun e letrave. Anton Pashku, bëhet lartësim shpirti, në shkrim/poezi, të mikut, për mikun e dashur.

Sabri Hamiti Dorëshkrimin e Prishtinës, e përfundon me lutjen personale. Pra, pas ankimeve, vjen Lutja shpirtërore. Ankimet janë thënë e dëshmuar, në invariante e variante. Relacioni i autorit me lutjen, vetartikullohet nëpërmjet shenjës simbolike. Lutja i drejtohet njeriut, kohës së tmerit:

O njeri

Me zemër çelik të ndryshkur nga urrejtja

Që shkon me krye në re e ke xhepa shqyer

Kujto qeshjen e fëmijës dhe vajin e pafaj

Lisat që i pret sharra e huaj në maje

Verdhën e fushës në vjeshtën me stuhi

E lotët e drurëve të ngrirë në kristal

Butësinë e nënës me gjinj varur strajcë

Plakun që puth asfaltin në verën e prushtë

Lutja e argumentuar në shenjën tematike, është lutje sinqeriteti e shpirti. Etika e mbanë gjallë diskursin/tekstin. Fortësia karshi atdhetarizmit kërkohet nga Hamiti ngulshëm. Krejt figurat e përdorura, janë sugjeruese mbi etikën e domosdoshme të kodit nacional, pse jo edhe flijimin për të. Në poezi Etika kërkuese, buron nga Njeriu i madh

Etik. Për të dalë, njohje e diferencim i veçantë në Logos të Dorëshkrimit mbi Prishtinën.

5. Dhjetë vajtime e një gëzim

Dorëshkrimi i Bluasë, i shoqëruar nga sintagma e fortë personale, Dhjetë vajtime e një gëzim, hap pjesën e tretë të Melankolisë. Sabri Hamiti, këtu shkruan dramatiken e jetës. Kthehet dramatika e shpirtit/trupit. Figurat e shumta janë përjetim, përbrenda tragjikes së pashoq. Vdekja është kudo, në trup e shpirt të Hamitit. Njeriu i sprovuar me vdekje, tani shkruan për Tehun e vdekjes së përjetuar shpirtërisht. Dhjetë Vajtimet, i përshtaten fuqishëm Sprovës / Tehut, të jetës. Metafora e zezë në kohë përshkrimi, shndërrohet në vajë përjetimi, por nuk njihet ligështia. Njeriu me plagë në trup, përjeton e kujton gjakimin e sprovës jetësore. Koha e plagës së shkaktuar në trupin e poetit, është kohë e plagës së kodit nacional. Gjuha personale në këtë rast, bëhet gjuhë nacionale. Trishtimi është i shumëfishuar, kurse figura e tekstit, gjithnjë dëshmuese. Dëshmia e trishtuar personale rrethon potencialisht diskursin, Poetin. Teksti i shenjës autobiografike hap mundësinë për t'u lexuar si hije e jetës. Ky lexim identifikon Personin (autorin-eksplicit) e Rrethanën konkrete. Një njeri i plagosur për vdekje; që s'është po autori i poezisë¹. Vaji për Prishtinën, është vaji për plagën e madhe, personale/nacionale. Këtu, Sabri Hamiti është plot mallëngjim/pikëllim:

Duke shtrydhur shpirtin derdh lot në Luarë
 Për të dhënë shenjë që ende jam gjallë
 Po Luara e rebeluar si një lum i ndytë
 Nuk i do lotët kujtimet do të m'i mbytë
 Jam poet i vvarë i ndjekur nga egërsirat
 Me trupin një varr të shkrimtarit të huaj

Sy të bukur të trishtuar shikojnë qiellin
 Trupa fëmijësh ngrohën tokën e zezë ngrirë
 Gjaku i djemve shkruan hartën në borë malesh
 Trenat si gjarpëra të zi zhagitin kah jugu
 Mbas tyre pëllasin lopët e çmendura
 Duke kërkuar frymën e gjallë të njeriut

Mbi shtretër nëpër dhoma kalërojnë qentë
 Mbi shqiponja të plagosura korbat fluturojnë
 Duke kërkuar një copë zemre të njeriut.

“Zemrën mos ma lypni bishat ma kanë ngrënë”
 O zot nëse e humb Prishtinën bëhem asgjë
 Një kufomë e gjallë e shkrimtarit të huaj

Lemeria e rrëfyer është mundim për Sabri Haimitin. Braktisja e dhunshme nga toka e shenjtë nacionale, rrit dëshpërimin, rrit plagën e trupit. Hamiti i plagosur për vdekje, rrëfen lëngatën e mjerueshme personale e nacionale. Fija e mundimit personal/nacional, njeh lotin e shpirtit. Poeti i larguar me plagë nga atdheu i dashur, rrit emocionin e Dorëshkrimit/ Dëshmisë. Secila shenjë teksti, është shenjë pikëllimi. Nga do, që, ta marrësh, Një është Hamiti me Atdheun. Argumenti i ligë empirik, rrëfen argumentin e ligë të Prishtinës. Në vetmi e mall rrëfëhet gjithçka e parë. Esencat mbajnë ngjarjen, ndërsa ngjarja shkakton dhembjen e Vajin. Asgjë nuk i duhet poetit Jeta, pa Lirinë e Prishtinës / Atdheut. Këtu, Sabri Hamiti dëshmon, se njeriu pa Lirinë e atdheut të dashur, është njeri pa Jetën e tij.

Shtresat e Dorëshkrimit, edhe më shumë e zgjerojnë Temën e Atdheut në shkrim, duke prekur dhembje e vajë shpirti, që përherë skicojnë intencën autoriale. Shkretëtira e kuqe, ka rrethuar jetën, është kudo. Gjarpërinjtë kafshojnë jetën e pafajshme., marrin krah dhe fluturojnë. Korbi i zi, me endje pret gjahun, dhe luan lojën e tij. Kërkohet mishi i freskët. Pranvera, stina e pritur jete, bëhet stinë mërzie e vdekje. Krejt është Zi, krejt është mjegull në tokën e dashur të atdheut. Vaji është mbështjellë me jetën e poetit. Mirëpo, përherë është mundja dhe fortësia. Nga Dhjetë vaje poetik, personal, ngadalë frymon në figurë, Jeta / Liria / Gëzimi / Ëndrra. Jeta e pafajshme, personale e atdhetare, ëndërron e kërkon. Rikthimi i ëndrrës, prek shpirtin/trupin/jetën. Ëndrra e një nate verore, shënjon në vete, ëndrrën për triumf Lirie.

Në Dorëshkrimin e Bluasë, Plaga personale/autoriale, për atdheun, mbetet plagë e shenjtë, vlerë e identifikim shpirti për Sabri Hamitin.

6. Dhjetë kujtime e një ëndërr

Të Dorëshkrimi i Dumnicës, Sabri Hamiti, i kthehet kujtimit e Lozes. Dhjetë kujtime e një ëndërr, është formulim, që i vije pas titullit, Dorëshkrimi të Dumnicës. Ky përcaktim, është në nivelin e shenjës, historisë. Pra, historia personale, është rrëfimi për jetën e formimin, është bazë e tonalitetit jetësor. Toposi Gjeografik i shenjtë, Dumnica, lidh jetën për Hamitin, shenjën për jetën e Lozes. Dashuria e madhe për Dumnicën, riorganizon shenjat në strukturën e Dorëshkrimit. Sistemi i lidhjeve historike, është sistem formimi për Autorin, por që është një sistem i rrëfyer butësisht, i rregulluar dashurisht.

Sistemi figurativ, rikthehet në gjirin e ëmbël. Aty ku është gjiri, autori bëhet melankolik. Dumica, është forcë e ribërë në metaforë, në planin ekzistencial e universal. Bredhja, nëpër gjenezë, është bredhje nëpër filozofinë jetësore të Hamitit.

Melankolia personale fillon me komunikimin e njerëzve të shpirtit, me Babën, pastaj me komunikimin e toposit e shenjave të shenjta. Pra, janë Shenjat e para të kësaj filozofie, pra të nevojës për të folur me vetveten, duke “ u pasqyruar te gjenetika”¹.

Historia e gjenezës, që fillon me Babën, që me besueshmëri autoriale komunikohet në gjuhën e mallit/shpirtit, përkujtimit/përjetimit:

Bal

E kam ditur se

Do të kthehemi bashkë e heshtakë

Te ama e vorreve të vendlindjes

Unë te Mësojtorja e ti te Faltorja

E kam ditur se

Do të shkosh me furtunë e me ngricë

Kur ndalen rrotat e telat janë memecë

Vijnë vetëm ata që i mban fryma e vet

Figura e Bal, është figurë e komunikimit të dashurisë, përafrim loze, në gjuhë të përditshme, thirrje emri në jetën e përditshme. Hamiti edhe në poezi ruan emrin e motivueshëm (kratilian) për babën, pra nëse dikur në fëmijëri e rini e pse jo edhe në burrëri baba është e mbetet Bal,

atëherë, pse të mos jetësohet ky kratilizëm edhe në vjershën e nevojës imanente të komunikimit me lozën e gjakut të vet1. Motivimi hamitian është i madh nëpër shenja të emrave e të toposit. Kjo është fuqi e besueshmëri autoriale, për jetësim të figurave shpirtërore. Andaj, Shenja e Babës, gjen fuqinë e vet në gjuhën e poezisë. Duke ecur në kohën e kaluar, Hamiti përqafton të gjitha kujtimet për Babën. Duke mos qenë gjallë Baba, rrëfimi shumë emocionalizohet. Kërkimi për të, nënkupton Njëshin e vlerës në vetvete. S. Hamiti në jetë nuk heq dorë nga diçka thelbësore, nga një gjë që është bërë jetësim, kjo do të thotë përherë të dashurosh Gjenezën/Historinë. Edhe të poezitë; Katundi, Fotografia, Zjarrmia, Trashëgimia, Topika, është sistemi figurativ i rikthimit të dashurisë nëpër gjenezë. Vet titujt e poezive, japin zjarminë e shpirtit në rikthim të Historisë. Për këtë arsyeje lind rrethi i figurave i emrave, që në strukturën e tekstit bëhen universal. Procesi i përshkruar nuk ngjet njëherë të vetme, por ai organizohet në gjurmim të vetvetes e të jetës. Dumnica bëhet topikë e botës, vend i premtuar shpirti në mos harrim. Nisur nga kujtimi e përfunduar nga ëndërimi personal. Trupi shkruan dashurisht për Shpirtin, ashtu në jetësim e përmallim.

Në vend të përfundimit

Për të ardhur të një dalje e mundshme, tri Dorëshkrimet: Dorëshkrimi i Prishtinës, Dorëshkrimi i Bluasë, dhe Dorëshkrimi i Dumnices, janë ekzistencë aksiologjike në letrat shqipe. Shkruhen nga njeriu, që e njohu dhembjen, e jetojë me dhembjen, karshi kodeve të mëdha Jetësore e Nacionale. Sprova personale përballë Thikës, runa edhe sot në jetë plagën në Trup/ Shpirt. Aty ku është Plaga, Melankolia, shkruhet e figurohet në tri Pergamene, Fryme /Jete /Fati. Fryma universalizohet, Fati shkruhet mallshëm, Jeta bëhet ZA i jetësimit, Personal e Nacional. Kjo të sjellë te formulimi i Mikut të tij, Ibrahim Rugova, kur thotë për Mikun e tij të madh të letrave: Sabri Hamiti është krijues i Zanit- Zërit- Zesë shqiptare. Kjo ndihet në veprën e tij.

Egzona Hysenaj, Prishtinë
Lindita Tahiri (autore korrespondente), Prishtinë

IDEOLOGJIA POSTMODERNE E LETËRSISË SË POPULLARIZUAR

Hyrja

Studiuesit e kulturës së popullarizuar gjithnjë e më shumë flasin për mesazhet që i përshkojnë emisionet e popullarizuara e sidomos ato argëtuese, duke i nxjerrë në pah në radhë të parë vlerat hedoniste si materializmi, konsumerizmi dhe kënaqësia momentale. Vlerat të cilat ngërthehen në kulturën e popullarizuar pranohen me automatizëm nga publiku duke u bërë pjesë e bindjeve dhe sjelljeve të tij. Kur flet për programet e argëtimit në mediat masive, Potteri (2013:187-125) thekson se kulturës së popullarizuar i ekspozohemi shpesh dhe jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë por edhe në mënyrë indirekte, duke biseduar për këto përmbajtje mediatike me të tjerët, gjë që mund të ndikojë t'i ripërkufizojmë bindjet dhe vlerat tona jetësore. Disa skema të personazheve dhe temave shfaqen më shpesh në prodhimet e popullarizuara, si për shembull stereotipet racore, gjinore apo kulturore. Ashtu si thotë studiuesi Turow (2009:27), mesazhet që na vërshojnë nga mediat e popullarizuara na ndihmojnë ta kuptojmë vetveten dhe raportin tonë me botën, duke u krahasuar me imazhet e portretizuara në kulturën masive: a jam mjaftueshëm e bukur? A vishem si të tjerët? A sillem si të tjerët? A jam tip udhëheqës apo i ndrojtur?

Mesazhet e prodhimeve të kulturës së popullarizuar ndryshojnë nga njëra gjeneratë në tjetrën, gjë që i përvijon edhe ndryshimet e vlerave kulturore nëpër epoka të ndryshme (Eagleton, 2003; Storey, 2015). Në kohën e sotme të globalizimit ky zhanër tërheq publik nga mbarë bota duke thyer barrierat kulturore, gjë që ka nxitur studime përt faktorët të cilët kanë ndikuar në popullarizimin e këtyre prodhimeve (Egri, 1960; Shafer & Raney, 2012; Weijers, 2014).

Ky punim përqendrohet në romanin e popullarizuar 'Stuhi shpatash' (2000) nga George R. R. Martin, një nga librat e serisë që ka shërbyer për skenarin e filmit tejet të popullarizuar 'Luftë fronesh', i cili vitet e fundit i ka

thyer rekordet e shikueshmërisë në përmasa globale. Për të nxjerrë në pah vlerat dhe besimet kulturore të këtij prodhimi të popullarizuar, romani i Martinit është analizuar përmes skemës tradicionale të funksioneve në përrallë të studiuesit të mirënjohur Vladimir Propp (1968), duke u përqendrua në rolet funksionale të njërit prej personazheve kryesore të romanit John Snow.

Romani ‘Stuhi shpatash’ i takon zhanrit fantastik, që sipas studiuesve na mundëson t’i tejkalojmë kufijtë e botës reale, përmes përvojave të cilat nganjëherë ngatërrohen me ato të jetës reale dhe kufiri mes tyre mjegullohet deri në atë masë sa përvojat tona mediatike i përjetojmë si përvoja reale. (Potter, 2013:141-155) Por, sipas studiuesve ndodh që edhe një roman apo film fantashkencë mund të përjetohej si realitet nëse njerëzit flasin dhe sillen si në përditshmëri, kundruall një prodhimi që emërtohet ‘reality show’ e që për pikërisht po këto arsye të shkallës së probabilitetit për të ndodhur aktualisht nuk përjetohej si realitet. Pra, për ta gjykuar një prodhim mediatik si real, publiku mbështetet jo në atë se a ka ndodhur përmbajtja mediatike, por e vlerëson se sa ka gjasa të ndodhë në jetën reale ajo që e shfaq media. Personazhi mund të jetë në një film fantastiko-shkencor dhe të përjetohej si individ real dhe, nga ana tjetër, mund të ndodhë që një politikan në debat apo një personalitet i famshëm në një intervistë të mos përjetohej si real. Ngjashëm mund të mos përjetohej si reale aktivitetet në “Facebook” të miqve të afërt, në qoftë se përmbajtjet virtuale vlerësohen se nuk kanë gjasa të përkojnë me personalitetet që i njohim, apo edhe anasjelltas, përmbajtjet virtuale të largëta gjeografikisht dhe historikisht ka gjasa t’i përjetojmë si më reale sesa personalitetet aktuale të të afërmeve tanë.

Cilat përjetime e bëjnë tërheqës dhe të fuqishëm romanin e Martinit duke e përafuar atë me përjetimet e realitetit dhe duke ndikuar në popullaritetin e tij?

Analiza

Vladimir Propp-i është një nga figurat kryesore të Formalizmit rus, që në librin e tij ‘Morfologjia e përrallës’ (1968) e analizon strukturën narrative të përrallave ruse. Edhe pse Propp- in e kanë kritikuar për radhitjen skematike dhe numrin e ngurtë të roleve funksionale të përrallës, megjithatë studimi i tij ka ndikuar në përqasjet e shumë narratologjstëve (Levi-Strauss 1960, Dundes 1962a, 1964b, Bremond 1964, Greimas 1966b (1968: XII). Ky punim e shfrytëzon skemën e përrallës tradicionale në mënyrë që ta

krahasojë atë me përrallat moderne me të cilat rrethohemi përmes prodhimeve të kulturës së popullarizuar.

Propp-i e thekson rëndësinë e roleve funksionale të personazheve të përrallës, meqenëse sipas tij heronjtë e përrallës shpesh ndërmarrin veprime të ngjashme, prandaj domethënia e ngjarjeve dhe veprimeve e nënkupton funksionin e tyre (1968:19). Për shembull, funksionet e heroit rëndom janë ‘mposhtja e të keqit’, ‘shpëtimi i viktimës’, ‘zgjidhja e problemit’ e të tjera. Në këtë studim nuk përfshihen të gjitha funksionet e skemës të Propp-it, por janë përzgjedhur funksionet kryesore të heroit dhe të keqit. Vetë Propp-i flet për mungesën e funksioneve në disa raste, gjë që nuk ndikon në strukturën e përrallës, meqenëse “funksionet e tjera vazhdojnë të ngelin po aty” (1968:108). Duke pasur parasysh se romani i analizuar i Martinit është rrëfim i perspektivës së shumëfishtë, është zgjedhur për analizë rrëfimi i njërit prej personazheve kryesore, John Snow, funksionet e të cilit paraqiten në tabelën më poshtë, të krahasuara sipas radhitjes me skemën e Propp-it e cila gjendet në shtyllën A, ndërsa skema e rrëfimit të Martinit gjendet në shtyllën B:

A	B	Funksioni	Përkufizimi i funksionit
6	11	Largimi	John detyrohet të largohet nga komuniteti i vëllezërisë së tij dhe të jetojë me të egrit.
7	6	Dredhia	John dhe Mance përpiqen ta mashtrojnë njëri-tjetrin
15	7	Bashkëpunimi	Asnjëri nuk bien në kurthë të mashtrimit
16	15	Ndryshimi hapësinor	John është në kërkim të identitetit të vet
18	16	Përpjekja	Ai refuzon të bashkëpunojë me të egrit dhe përleshet me ta
19	20	Kthimi	Ai ik prej tyre dhe kthehet në Kështjellën e zezë
20	23	Mosmirënjohja	Askush nuk shpreh mirënjohje për përpjekjet e tij heroike
23	19	Mposhtja	John me komunitetin e vëllezërisë i mposhtin të egrit
24	24	Kërkesa të pabazuara	Janos Slynt (heroi i rremë) e akuzon John-in pa argumente

25	25	Detyra e vështirë	Atij i kërkohet ta dëshmojë besnikërinë duke shkuar përtej murit për ta vrarë Mance.
26	26, 18	Zgjidhja Fitorja	Papritur gjendet zgjidhja me ardhjen e ushtrisë të Stannis Baratheon që i mposht përfundimisht të egrit
28	27	Vlerësimi	Më në fund John-it i vlerësohen përpjekjet e tij heroike
29	28, 30	Ekspozimi Dënimi	Ekzpozohet personaliteti djallëzor i Janos Slynt i cili nuk lejohet të kandidojë për udhëheqës
31	31	Martesa	John shpallet lordi udhëheqës

Në korpusin e përrallave që i ka analizuar Propp-i e mira dhe e keqja janë plotësisht të ndara që në fillim e deri në fund të rrëfimit. Tek analiza e rrëfimit të Martin-it bie në sy se kjo ndarje e prerë mes të mirës dhe të keqes nuk shfaqet asnjëherë, dhe ngjashmëritë me skemën shfaqen vetëm në radhitjen e disa funksioneve të përrallës. Për dallim nga skema e Propp-it, rolet funksionale të personazhit lëvizin nga heroi tek i keqi dhe anasjelltas. Po ashtu, struktura e radhitjes të funksioneve është modifikuar në krahasim me skemën tradicionale. Heroi dështon në kryerjen e foleve kryesore sipas skemës tradicionale: largimin, dredhinë, bashkëpunimin, detyrën e vështirë, gjë që sugjeron ndërlidhjen e të mirës me të keqen në përputhje me “bindjet e sotme kulturore të cilat janë relative dhe arbitrare” (Matz, 1974: 244).

Përfundimi

Rezultatet e analizës tregojnë se rolet e heroit dhe anti-heroit në përrallën moderne të kulturës së sotme të popullarizuar janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin gjë që mund të ndikojë në tërheqjen e publikut. Studiuesit Shafer and Raney theksojnë se “antiheronjtë, përkundër veseve të tyre, funksionojnë si “forca e së mirës” në shumë rrëfime” (2012: 1030). Për më shumë, studimet dëshmojnë se personazhet kryesore të rrëfimeve kulturore kanë nevojë për kontradikta në personalitetin e tyre në mënyrë që të nxitet veprimi në rrëfim (Egri, 1960; Weijers, 2014). Paparashikueshmëria e veprimeve të heroit në rrëfimin e Martin-it mund të jetë një nga shkaqet e popullaritetit të këtij romani dhe të filmit të mbështetur në te. Publiku duket

se ka dëshirë të përballlet me dykuptimësinë dhe paparashikueshmërinë që ia nxit kureshtjen për zhvillimin e personazhit dhe rrugën që e ndjek ai/ajo.

Analiza e roleve funksionale të heroit në rrëfimin e Martin-it që është vështruar si përrallë moderne, nxjerr në pah një strukturë komplekse narrative e cila dallon nga vlerat morale tradicionale gjë që mund të jetë një nga shkaqet kryesore për popullaritetin masiv të këtij prodhimi kulturor, ku heroi e transformon imazhin e vet nga e mira tek e keqja dhe shfaqet në një konflikt të vazhdueshëm të personalitetit. Kur personazhet shfaqen me shumë ngjyra e jo thjesht bardh e zi, duke e rrënuar ndarjen rigjide mes heroit dhe të keqit, publiku post-modern duket se e pranon më lehtë dhe e ka më të kapshme dykuptimësinë.

Normalisht se nuk mund të thuhet saktë se çfarë elementesh ndikojnë në popullaritetin e prodhimeve të kulturës së popullarizuar, por në radhë të parë ato ndërlihen me zhvillimet shoqërore, politike dhe ekonomike, duke u përputhur me dëshirat, shijet dhe nevojat e njerëzve. Studimet kulturore përputhen me gjetjet e këtij punimi, duke pohuar se personazhet me moral të padefinuar del të jenë më argëtues dhe më të pranueshëm për shijen e publikut (Shafer & Raney, 2012; Krakowiak. K. M. & Oliver. M. B. 2012; Krakowia & Tsay-Vogel, 2014). Kjo mund të ndodhë për shkak gjasave që diçka e tillë të shfaqet në përditshmëri, gjë që i bën këto personazhe shumëngjyrëshe më të arritshëm dhe të kuptueshëm për publikun.

Referencat

- [1] Batts, J. & Johnston, S. (2015). *Mastering the Game of thrones: Essays on George R.R. Martin's A Song of ice and fire*. United States of America, McFarland & Company, Inc.
- [2] Berger, A. A. (1992). *Popular culture genres: Theories and texts*. Thousand Oaks, California: Sage publications, Inc.
- [3] Bottigheimer, R. B. (2009). *Fairy tales: A new history*. Albany: State University of New York Press.
- [4] Browne, B. R. (1984). Popular Culture as the New Humanities. *The Journal of Popular Culture*, 17, 1-8.
- [5] Ciccelli, V., & Octobre S., & Riegel V. (2019). *Aesthetic Cosmopolitanism and Global Culture*. Laiden, Netherlands: Brill Academic.
- [6] Eagleton, T. (2003). *After Theory*, London, United Kingdom: Penguin Books Ltd.
- [7] Egri, L. (1960). *The Art of Dramatic Writing*. New York: Simon & Schuster.
- [8] Easthope, A. (1991). *Literary Into Cultural Studies*. New York: Routledge.
- [9] Gelder, K. (2004). *Popular Fiction: The Logics and Practices of a Literary Field*, New York: Routledge.

- [10] Hall, D. (1984). Introduction, in S.L. Kaplan, ed., *Understanding Popular Culture: Europe from the Middle Ages to the Nineteenth Century*. Berlin-New York.
- [11] Hall, S. (1981). Notes on deconstructing “the popular”, in R. Samuel, ed., *People’s History and Socialist Theory*. London: Routledge and Kegan Paul, 227-240.
- [12] Krakowiak, K. M. & Oliver, M. B. (2012). When Good Characters Do Bad Things: Examining The Effect of Moral Ambiguity on Enjoyment. *Journal of communication*, 62, 117-135
- [13] Krakowiak, K. M. & Tsay-Vogel, M. (2015). The Dual Role of Morally Ambiguous Characters: Examining The Effect of Morality Salience on Narrative Responses. *Human Communication Research*, 41, 390-411
- [14] Lakoff, R. T. & Scherr, L. R. (1984). *Face Value: The Politics of Beauty*. Boston, London, Melbourne and Henley: Routledge & Kegan Paul.
- [15] Leech, G. & Short, M. (2007). *Style in Fiction: A Linguistic Introduction to English Fictional Prose*: (2nd ed.) Britain, UK: Pearson Education Limited.
- [16] Levine, W. L. (1992). The Folklore of Industrial Society: Popular Culture and Its Audiences. *The American Historical Review*, Vol. 97, 1369-1399. Oxford University Press.
- [17] Martin, R. R. George. (2013). *A Storm of Swords*. USA: Bantam Books.
- [18] Metz, Ch. (1974). *Film Language: A Semiotics of the Cinema*. Translated by Michael Taylor. New York: Oxford University Press.
- [19] Potter, James, *Media Literacy*, Sage Publications: 2013
- [20] Pugliatti, P. (2013). People and the Popular Culture and the Cultural, *Journal of Early Modern Studies*, 2, 19-42.
- [21] Propp, V. IA. (Vladimir ĪAkovlevich) (1968). *Morphology of the folktale*. Austin: University of Texas Press.
- [22] Schawbe, C. (2016). The Fairy Tale and Its Uses in Contemporary New Media and Popular Culture Introduction. *Humanities* (editorial), 1-5.
- [23] Shafer, D. M., & Raney, A. A. (2012). Exploring How We Enjoy Antihero Narratives. *Journal of Communication*, 63, 1–19.
- [24] Storey, J. (2015). *Cultural Theory and Popular Culture: An Introduction*. New York: Routledge.
- [25] Turow, Joseph. *Media Today. An Introduction to Mass Communication*. Routledge: 2009
- [26] Ylmaz, R., & Erden, N. M., & Resologlu, F. (2019). *Handbook of Research on Transmedia Storytelling and Narrative Strategies*. United States of America: IGI Global.
- [27] Weijers, A. (2014). *The craft of screenwriting*. Hague: Boom Lemma Uitgevers.

Vjollca Belegu-Caka, UEJL, Tetovë
Nebi Caka, UP, Prishtinë

VEÇORITË E LEKSIKUT TË NJË KONFERENCE TË CIGRE-S

Abstrakt

Ky punim ka për objekt studimi leksikut e 31 punimeve në gjuhën shqipe të referuara në *Konferenca e parë të KN CIGRE Kosovë*, të mbajtur në Prishtinë më 8 dhe 9 nëntor 2019. Është bërë përpunimi kompjuterik i këtij korpusi prej 91.529 fjalëve, 8.689 fjalëformave dhe 4.538 lemave dhe është nxjerrë lista e fjalëve të lematizuara e renditur sipas numrit të paraqitjeve në këtë korpus. Rezultatet e përfuara janë analizuar dhe janë dhënë përfundimet e caktuara. Kemi konstatuar se leksiku i kësaj konference, përveç leksikut të përdorimit të zakonshëm, përmban edhe një leksik që lidhet ngushtë me tematikën e këtyre punimeve profesionale, e që është leksik teknik. Në 30 leksemat e para të këtij korpusi, secila me mbi 300 paraqitje, 10, apo çdo e treta, kanë të bëjnë me rrjetet (sistemet) energjetike ose me mënyrën e paraqitjes së tyre në punime shkencore a profesionale. Edhe lista e leksemave me 50-300 paraqitje tregon se mjaft prej tyre janë fjalë nga fusha e teknikës, përkatësisht nga fusha e rrjeteve (sistemeve) elektroenergjetike. Veçori e këtij korpusi është edhe përdorimi i shkurtesave, të krijuara përbrenda shqipes, apo të marra nga anglishtja dhe të përdorura si të tilla në tekstin shqip.

Fjalët çelës: konkordancieri, korpusi gjuhësor, leksiku teknik, shkurtesat, simbolet, fjalët çelës

Hyrje

Studimet e ndryshme kanë treguar se kompjuteri është një mjet i përshtatshëm për identifikimin e leksemave të veçanta në bazë të numrit të paraqitjes së tyre në një korpus të caktuar homogjen dhe shpërndarjes së tyre në këtë korpus. Kështu, Baker (1988) e ka përdorur kompjuterin për të analizuar një numër punimesh shkencore nga mjekësia (18 punime nga 8 revista të ndryshme, me gjithsej 21.087 fjalë). Mudray (2006), në bazë të librave të detyrueshëm për studentët e inxhinierisë të të gjitha fushave të specializimit, ka përpiluar, po ashtu me kompjuter, një korpus të inxhinierisë (SEEC) me rreth 2.000.000 fjalë, të cilat pastaj

i ka reduktuar në 1.200 familje fjalësh apo në 9.000 tipa fjalësh. Ajo ka ardhur në përfundim se përdorimi i korpuseve gjuhësore në klasë mund të përmirësojë njohjen e gjuhës nga studentët dhe aftësinë e tyre që ta përdorin gjuhën në mënyrë më efikase. Nga lista e fjalëve të fituara me kompjuter, ajo ka veçuar 188 fjalë me mbi 14 paraqitje dhe i ka analizuar ato. Nga ana tjetër, Caka & Caka (2012), në bazë të Korpusit njëmilionfjalësh të gjuhës shqipe, të përpiluar po nga këta më 2006, sipas korpusit përkatës të anglishtes, të njohur si ‘Korpusi i Braunit’, kanë përdorur kompjuterin për përcaktimin e dendurisë së përdorimit të fjalëve, dhe me këtë korpus i kanë përqsuar tekstet e caktuara me qëllim të nxjerrjes së fjalëve çelës të këtyre teksteve. Belegu-Caka (2015) ka përpiluar me kompjuter, në bazë të një korpusi reprezentativ prej 25 librave universitarë, me 14.939 faqe dhe 152.382 fjalë, një listë fjalësh që do të mund të shërbenin si bazë për hartimin e silabuseve, por dhe të teksteve mësimore, për lëndën e “anglishtes teknike” në fakultetet e inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike.

Ne këtu do të përpiqemi, duke përdorur kompjuterin, të nxjerrim listën e fjalëve të një numri punimesh profesionale-shkencore nga fusha e sistemeve elektroenergjetike dhe të përcaktojmë veçoritë leksikore të këtyre punimeve.

Metoda dhe objekti i analizës

Objekt trajtimi i këtij punimi janë punimet në gjuhën shqipe të referuara në konferencën e parë të organizatës profesionale ndërkombëtare CIGRE, të mbajtur në Prishtinë më 8 dhe 9 nëntor 2019.

CIGRE (fr. *Le conseil international des grands réseaux électriques*: shq. Këshilli ndërkombëtar për rrjetet/sistemet e mëdha elektrike) – është organizatë jofitimprurëse profesionale ndërkombëtare që merret me aspektet teknike dhe ekonomike të sistemeve (rrjeteve) të mëdha elektrike (elektroenergjetike), si dhe me aspektet mjedisore dhe të rregullimit (kontrollit). Është themeluar më 1921, me seli në Paris (*The History of CIGRE*). Kosova është bërë anëtare e plotfuqishme e CIGRE-s më 2019 dhe në këtë vit CIGRE ka pasur 59 Komitete Nacionale (KN).

Veprimtaria e CIGRE-s zhvillohet në kuadër të 16 komiteteve studimore (angl. *Study committees*, SC) (<https://www.cigre.org>):

Grupi A – Pajisjet: A1 – Makinat elektrike rrotulluese; A2 – Transformatorët dhe reaktorët elektroenergetikë; A3 – Pajisjet për transmetim dhe shpërndarje (distribucion);

Grupi B – Teknologjitë: B1 – Kabllot e izoluar; B2 – Linjat ajrore; B3 – Nënstationet dhe instalimet elektrike; B4 – Sistemet e tensionit të lartë të vazhduar (HVDC) dhe elektronika energetike; B5 – Mbrojta dhe automatizimi;

Grupi C – Sistemet: C1 – Zhvillimi dhe ekonomia e sistemeve elektroenergetike; C2 – Operimi dhe kontrolli i sistemeve elektroenergetike; C3 – Ndikimi i sistemeve elektroenergetike në mjedis; C4 – Veçoritë teknike të sistemeve elektroenergetike; C5 – Tregjet e rrymës elektrike dhe rregullimi; C6 – Sistemet aktive të shpërndarjes dhe burimet e shpërndara të energjisë;

Grupi D – Materialet e reja dhe teknologjia e informacionit: D1 – Materialet dhe teknikat e reja të matjes (testimit); D2 – Sistemet e informacionit dhe telekomunikacioni

CIGRE organizon disa lloje të konferencave. Në Konferencën e parë të CIGRE-s në Kosovë, të organizuar nga KN CIGRE Kosovë, të mbajtur më 6-8 nëntor 2019 në Prishtinë, janë referuar gjithsej 44 punime, prej të cilave 31 në gjuhën shqipe dhe 13 në gjuhën angleze.

Objekt trajtimi i këtij punimi janë vetëm punimet e referuara në gjuhën shqipe, e që citohen në fund të këtij punimi, me kodin që kanë pasur në konferencë (A2-01 ... D2-02). Ato i përkasin këtyre komiteteve studimore të CIGRE-s:

A2 – 4 punime, A3 – 4 punime; B1 – 2 punime, B3 – 1 punim, B4 – 1 punim, B5 – 2 punime; C1 – 2 punime, C2 – 2 punime, C3 – 1 punim; C4 – 3 punime, C5 – 5 punime, C6 – 2 punime; D1 – 1 punim, D2 – 1 punim.

Për nxjerrjen e listës së fjalëve të këtij korpusi tekstesh është përdorur programi kompjuterik apo konkordancieri Ant Conc (Anthony, 2004). Para se të përpunohen me kompjuter, nga punimet e marra në shqyrtim janë hequr emrat e autorëve dhe institucionet ku ata janë të angazhuar, si dhe literatura/bibliografia në fund të punimit. Lista e fjalëve të përfuara me konkordancier është lematizuar, d.m.th. fjalët janë sjellë në fjalën përfaqësuese, në atë që përdoret në fjalorë të ndryshëm të gjuhës shqipe.

Ky korpus prej 31 punimesh/artikujsh ka gjithsej: 91.529 fjalë (angl. *tokens*), 8.689 fjalëforma (angl. *words, lemma word forms*), 4.538 lema (angl. *lemma, word types*).

Rezultatet e analizës

Për të veçuar fjalët e përdorimit më të shpeshtë, ato janë renditur sipas dendurisë (shpeshtisë, frekuencës) së paraqitjes së tyre në korpus. Më poshtë jepet lista e 30 lematve të para të këtij korpusi, secila me mbi 300 paraqitje dhe numri i teksteve (nga gjithsej 31) në të cilat paraqiten ato.

Tabela 1: 30 lemat e para, me mbi 300 paraqitje

1	të	31/31	7706	të 7706
2	e	31/31	5077	e 5077
3	në	31/31	3847	në 3847
4	dhe	31/31	2573	dhe 2573
5	i	31/31	2181	i 2181
6	jam	31/31	1920	është 1062 ishin 10 ishte 34 janë 635 jemi 2 jenë 51 qenë 105 qofshin 1 qoftë 20
7	për	31/31	1833	për 1833
8	me	31/31	1549	me 1549
9	nga	31/31	954	nga 954
10	së	31/31	905	së 905
11	që	31/31	830	që 830
12	sistem	30/31	797	sistem 116 sisteme 29 sistemet 71 sistemeve 52 sistemi 124 sistemin 79 sistemit 326
13	një	31/31	729	një 729
14	energji	28/31	721	energji 141 energjia 55 energjie 2 energjinë 28 energjisë 493 energjitë 1 energjive 1
15	kam	31/31	662	ka 392 kam 1 kanë 160 kemi 70 kenë 16 kesh 1 kihen 1 kishim 3 kishin 2 kishte 16
16	elektrik	29/31	625	elektrik 89 elektrike 527 elektrikë 9
17	kV	25/31	611	kV 611
18	si	31/31	559	si 559
19	më	31/31	553	më 553
20	tension	28/31	543	tension 67 tensione 13 tensionet 13 tensioneve 48 tensioni 75 tensionin 27 tensionit 300
21	kjo/ky	31/31	526	kjo 144 kësaj 68 këtë 202 ky 112

22	transformator	18/31	443	transformator 43 transformatori 62 transformatorin 14 transformatorit 133 transformatorë 38 transformatorët 56 transformatorëve 97
23	edhe	30/31	433	edhe 433
24	rrjet	27/31	423	rrjet 65 rrjete 6 rrjetet 26 rrjeteve 9 rrjeti 58 rrjetin 139 rrjetit 120
25	se	31/31	365	se 365
26	figurë	30/31	322	figura 215 figurat 3 figure 5 figurë 2 figurën 91 figurës 6
27	fuqí	28/31	320	fuqi 65 fuqia 54 fuqie 2 fuqinë 23 fuqisë 160 fuqitë 4 fuqive 12
28	gjatë	30/31	304	gjatë 304
29	mund	30/31	304	mund 304
30	linjë	21/31	303	linja 38 linjat 56 linjave 81 linje 10 linjë 22 linjën 14 linjës 82

Nga kjo listë, shihet se secila prej fjalëve të përfshira në të ka më shumë se 300 paraqitje në tekst dhe se 10 prej tyre, apo çdo e treta, kanë të bëjnë me rrjetet (sistemet) energjetike ose me mënyrën e paraqitjes së tyre në punime shkencore a profesionale (*figurë* 322; e më poshtë edhe: *tabelë* 158):

sistem (797 herë, në 30 nga gjithsej 31 punime; nuk është vetëm në punimin B1-01): *sistem DC* (33), *sistem elektrik* (15); *sistem elektrodistributiv* (2), *sistem elektroenergjetik* (113), *sistem elektrotansmetues* (1), *sistem ftohës* (2), *sistemi i izolimit* (7), *sistem njëfazor* (4), *sistem transmetues* (12), *sistem trefazor* (7);

energji (721 herë, në 28/31 punime; nuk është në 3 punime: A2-01, A3-03, C3-01): *energja aktive* (2), *energji elektrike* (383), *energji mekanike* (2), *energji e pa dërguar* (3);

elektrik (625 herë, në 29/31 punime; nuk është në 2 punime: C3-01, D2-01): *avari elektrike* (2), *energji elektrike* (383), *fuqi elektrike* (5), *hark elektrik* (23), *inxhinieri elektrike* (4), *linjë elektrike* (5), *nënstacion elektrik* (5), *qark elektrik* (9), *pajisje elektrike* (18), *prishje elektrike* (1), *rrjet elektrik* (32), *rrymë elektrike* (7), *sistem elektrik* (15); *stabilimente elektrike* (2), *shqyrtime elektrike* (2), *tension elektrik* (1), *transmetim elektrik* (2), *zbrazje elektrike* (1);

kV (611 herë, në 25/31 punime; nuk është në 6 punime: B4-01, C3-01, C5-06, C5-07, C6-04, D2-01);

tension (543 herë, në 28/31 punime, nuk është në 3 punime: C3-01, C5-07, D2-01): *tension AC* (5), *tension alternativ* (1), *tension DC* (1), *tension i durimit* (2), *tensioni durues* (2), *tension i injektuar* (2), *tension injektues* (2), *tension i lartë* (36), *tension i mbetur* (11), *tension i mesëm* (39), *tension nominal* (11), *tension operues* (2), *tension punues* (4), *tension stresues* (2), *tension i ulët* (14), *tension i vazhduar* (3);

transformator (443, në 18/31 punime; nuk është në 13 punime: A3-03, B1-01, B4-01, B5-05, C3-01, C5-01, C5-02, C5-04, C5-06, C5-07, C6-04, D2-01, D2-02): *transformator distributiv* (6), *transformator energjetik* (36), *transformator i fuqisë* (44), *transformator i tensionit* (3);

rrjet (423 herë, në 27/31 punime; nuk është në 4 punime: A2-01, A2-02, B5-07, C6-03): *rrjet ajror* (13), *rrjet hekurudhor* (2), *rrjet elektrik* (32), *rrjet energjetik* (1), *rrjet kabllor* (10), *rrjet nëntokësor* (6), *rrjet radial shpërndarës* (9), *rrjet shpërndarës* (39), *rrjet i shpërndarjes* (21), *rrjet i tensionit të lartë* (4), *rrjet i tensionit të mesëm* (6), *rrjet i tensionit të ulët* (3), *rrjet transmetues* (37);

figurë (322 herë, në 30/31 punime; nuk është vetëm në 1 punim: C5-02);

fuqi (320 herë, në 27/31 punime; nuk është në 4 punime: A3-01, B1-01, B4-01, C5-07): *fuqi aktive* (29), *fuqi elektrike* (5), *fuqi e erës* (3), *fuqi e instaluar* (5), *fuqi instaluese* (24), *fuqi maksimale* (8), *fuqi nominale* (11), *fuqi reaktive* (29), *fuqi shkyçëse* (2);

linjë (303 herë, në 21/31 punime, nuk është në 10 punime: A2-01, A2-02, A3-03, B4-01, B5-07, C3-01, C5-02, C5-04, C5-07, D2-01): *linjë ajrore* (32), *linjë elektrike* (5), *linjë interkonektive* (3), *linjë kabllore* (23), *linjë nëntokësore* (4), *linjë shpërndarëse* (2), *linjë e tensionit të lartë* (4), *linjë e tensionit të mesëm* (2), *linjë e tensionit të ulët* (4), *linjë transmetuese* (11).

Në vijim, në Tabelën 2, jepen edhe lemat e tjera (vetëm emra) të leksikut teknik me më shumë se 50 paraqitje dhe numri i teksteve (nga gjithsej 31) në të cilat paraqiten ato:

Tabela 2: Lemat emra me 51-300 paraqitje

pajisje	26/31	271	pajisja 14 pajisje 70 pajisjeje 8 pajisjen 7 pajisjes 18 pajisjesh 3 pajisjet 77 pajisjeve 74
lidhje	26/31	262	lidhja 26 lidhje 50 lidhjeje 3 lidhjen 8 lidhjes 90 lidhjesh 1 lidhjet 21 lidhjeve 63
matje	19/31	235	matja 36 matje 42 matjeje 1 matjen 24 matjes 29 matjesh 1 matjet 54 matjeve 48
ngarkesë	19/31	221	ngarkesa 49 ngarkesat 21 ngarkesave 11 ngarkese 5 ngarkesë 41 ngarkesën 21 ngarkesës 73
humbje	22/31	217	humbja 4 humbje 25 humbjen 2 humbjes 2 humbjet 79 humbjeve 105
rrymë	21/31	191	rryma 33 rrymat 20 rrymave 48 rryme 6 rrymë 12 rrymën 20 rrymës 52
tabelë	24/31	157	tabela 100 tabelat 4 tabelave 1 tabelë 4 tabelën 47 tabelës 1
mbrojtje	19/31	155	mbrojtja 22 mbrojtje 31 mbrojtjen 9 mbrojtjes 31 mbrojtjet 20 mbrojtjeve 42
prodhim	20/31	141	prodhim 11 prodhimi 68 prodhimin 20 prodhimit 38 prodhime 1 prodhimet 2 prodhimeve 1
konsumator	20/31	133	konsumator 11 konsumatori 7 konsumatorin 1 konsumatorit 4 konsumatorë 9 konsumatorët 49 konsumatorëve 52
furnizim	24/31	126	furnizim 26 furnizimi 17 furnizimin 18 furnizimit 59 furnizimet 4 furnizimeve 2
MVA	13/31	104	MVA 104
vaj	7/31	102	vaj 37 vaji 7 vajin 4 vajit 54
shpërndarje	21/31	101	shpërndarja 6 shpërndarje 9 shpërndarjen 11 shpërndarjes 74 shpërndarjeve 1
operim	19/31	100	operim 21 operimi 19 operimin 4 operimit 36 operime 1 operimesh 1 operimeve 18
rënie	18/31	97	rënia 8 rënie 28 rënien 4 rënies 5 rëniet 28 rënieve 24
kosto	19/31	93	kosto 20 kostoja 36 koston 10 kostos 16 kostot 9 kostove 2
transmetim	12/31	92	transmetim 8 transmetimi 2 transmetimin 2 transmetimit 80
parametër	17/31	91	parametër 4 parametri 1 parametra 8 parametrat 44 parametrave 34
defekt	12/31	84	defekt 15 defekti 13 defektit 12 defekte 10 defektesh 2 defektet 9 defekteve 23
shkarkues	5/31	83	shkarkues 6 shkarkuesi 13 shkarkuesin 3 shkarkuesit 43 shkarkuesve 18
element	16/31	82	element 13 elementi 4 elementin 2 elemente 7 elementesh 2 elementet 24 elementeve 30

konsum	24/31	82	konsum 13 konsumi 26 konsumin 16 konsumit 27
qark	16/31	81	qark 7 qarku 8 qarkun 3 qarkut 40 qarqe 4 qarqesh 2 qarqet 12 qarqeve 5
shqyrtim	8/31	81	shqyrtim 2 shqyrtimi 38 shqyrtimin 1 shqyrtimit 6 shqyrtime 5 shqyrtimet 20 shqyrtimeve 9
erë	9/31	80	era 8 ere 1 erë 6 erën 1 erërat 2 erës 62
izolim	12/31	79	izolim 11 izolimi 7 izolimin 7 izolimit 51 izolimet 1 izolimeve 2
relé	13/31	78	rele 63 releja 2 relejë 2 reletë 2 releu 5 releve 4
mbitension	7/31	77	mbitension 1 mbitensioni 2 mbitensionin 1 mbitensionit 37 mbitensionet 22 mbitensioneve 14
asbest	1/31	76	asbest 18 asbesti 21 asbestin 1 asbestit 36
izolator	10/31	76	izolator 3 izolatori 1 izolatorin 3 izolatorit 4 izolatorë 6 izolatorët 32 izolatorëve 27
njësi	12/31	76	njësi 4 njësia 12 njësie 1 njësinë 2 njësisë 20 njësitë 16 njësive 21
kontakt	10/31	75	kontakt 3 kontakti 8 kontaktit 2 kontakte 8 kontaktet 11 kontakteve 43
mosbalancim	5/31	75	mosbalancim 4 mosbalancimi 7 mosbalancimin 4 mosbalancimit 48 mosbalancime 1 mosbalancimet 3 mosbalancimeve 8
import	5/31	71	import 10 importi 24 importin 6 importit 30 importet 1
kyçje	10/31	71	kyçja 9 kyçje 7 kyçjen 3 kyçjes 49 kyçjet 1 kyçjeve 2
përçues	9/31	70	përçues 13 përçuesi 6 përçuesin 12 përçuesit 23 përçuesve 16
rezervë	6/31	70	rezerva 17 rezervat 2 rezervave 9 rezerve 1 rezervë 27 rezervën 2 rezervës 12
pështjellë	6/31	69	pështjella 14 pështjellat 9 pështjellave 44 pështjellën 2
kompani	14/31	69	kompani 14 kompania 8 kompaninë 3 kompanisë 12 kompanitë 19 kompanive 11
mirëmbajtje	18/31	67	mirëmbajtja 16 mirëmbajtje 9 mirëmbajtjeje 2 mirëmbajtjen 7 mirëmbajtjes 30 mirëmbajtjet 1 mirëmbajtjeve 2
modul	4/31	67	modul 1 moduli 2 modulën 3 modulit 11 module 8 modulet 19 moduleve 23
shërbim	11/31	66	shërbim 5 shërbimi 1 shërbimin 1 shërbimit 24 shërbime 5 shërbimet 10 shërbimeve 20
monitorim	14/31	63	monitorim 16 monitorimi 16 monitorimin 9 monitorimit 21 monitorime 1
njehsor	6/31	63	njehsor 4 njehsori 6 njehsorin 1 njehsorit 6 njehsorë 7 njehsorët 21 njehsorëve 18

raport	18/31	63	raport 16 raporte 1 raportet 3 raporteve 2 raporti 25 raportin 6 raportit 10
rezistencë	11/31	62	rezistenca 20 rezistencat 2 rezistencave 13 rezistence 1 rezistencë 1 rezistencën 1 rezistencës 24
frekuencë	12/31	60	frekuenca 12 frekuencave 1 frekuencë 7 frekuencën 5 frekuencës 35
problem	20/31	59	problem 10 probleme 10 problemet 15 problemeve 13 problemi 8 problemin 1 problemit 2
zgjidhje	11/31	59	zgjidhja 19 zgjidhje 24 zgjidhjeje 1 zgjidhjen 6 zgjidhjes 7 zgjidhjet 1 zgjidhjeve 1
burim	17/31	58	burim 5 burime 11 burimesh 2 burimet 21 burimeve 9 burimi 6 burimit 4
temperaturë	13/31	56	temperatura 22 temperaturat 1 temperaturave 8 temperaturën 13 temperaturës 12
baterí	2/31	55	bateri 3 bateria 2 baterie 1 baterisë 2 bateritë 15 baterive 32
projekt	14/31	55	projekt 9 projekte 7 projektet 4 projekteve 4 projekti 13 projektin 2 projektit 16
rregullator	10/31	55	rregullator 11 rregullatori 11 rregullatorin 6 rregullatorit 23 rregullatorë 4
rrezik	11/31	55	rrezik 10 rreziku 7 rrezikun 11 rrezikut 9 rreziqe 3 rreziqet 12 rreziqeve 3
zbarrë	9/31	55	zbarra 28 zbarrat 15 zbarrave 11 zbarrë 1
funksion	15/31	54	funksion 13 funksione 10 funksionet 10 funksioneve 3 funksioni 7 funksionin 7 funksionit 4
avarí	12/31	53	avari 7 avaria 9 avarie 3 avarisë 22 avaritë 4 avarive 8
operator	16/31	52	operator 6 operatori 19 operatorin 3 operatorit 13 operatorë 1 operatorët 7 operatorëve 3
prokurim	3/31	52	prokurim 5 prokurimi 18 prokurimin 10 prokurimit 19
kontratë	4/31	51	kontrata 9 kontratat 16 kontratave 14 kontrate 1 kontratë 9 kontratës 2

Nga 62 fjalët e mësipërme, 24 dalin në më shumë se gjysmën e punimeve, e 38 në më pak se gjysmën e punimeve.

Fjalët që dalin në më shumë se gjysmën e punimeve mund të merren si fjalë çelës të konferencës në tërësi. Ato bashkëlidhen me fjalë të tjera për të përcaktuar nocione të caktuara. Ja disa shembuj bashkëlidhesh të këtyre fjalëve:

pajisje (271 herë, në 26 nga 31 punime): *pajisje elektrike* (18), *pajisje elektroenergjetike* (5), *pajisje energjetike* (3), *pajisje elektromekanike* (1), *pajisje elektronike* (1), *pajisje mbrojtëse* (11), *pajisje ndihmëse* (4), *pajisja Omicron* (6), *pajisje sigurie* (1), *pajisje shkyçëse* (1), *pajisje shtëpiake* (1), *pajisje testuese* (5), *pajisja Torkel* (2), *pajisje transmetuese* (1) etj.;

lidhje (262 herë, në 26/31 punime): *lidhje e shkurtër* (94 herë, në 18 nga 31 punime);

matje (235 herë, në 19/31 punime): *matje e fortësisë dielektrike* (5), *matje e fuqisë* (1), *matje e herësit të transformimit* (7), *matje e humbjeve dielektrike* (1), *matje e rezistencës së izolimit* (10), *matjen e rezistencës së kontakteve* (2), *matje e rezistencës omike të pëshjtjellave* (5), *matje e rezistencës së pëshjtjellave* (4), *matje e rrymës* (3), *matja e tensionit* (5);

ngarkesë (221 herë, në 19/31 punime): *ngarkesë jolineare* (3), *ngarkesë josimetrike* (14), *ngarkesë maksimale* (22), *ngarkesë minimale* (3), *ngarkesë njëfazore* (4), *ngarkesë e sistemit* (10), *ngarkesë totale aktive* (3), *ngarkesë totale reaktive* (3), *ngarkesë e transformatorit* (5), *ngarkesë trefazore* (3),

humbje (217 herë, në 22/31 punime): *humbjet dielektrike* (25); *humbjet ekonomike* (1), *humbjet e energjisë* (13), *humbjet e fuqisë* (11), *humbjet në rrjet* (21), *humbjet teknike* (15), *humbjet totale* (12);

rrymë (191 herë, në 21/31 punime): *rrymë alternative* (1), *rrymë elektrike* (7), *rrymë kapacitive* (1), *rrymë e lidhjes së shkurtër* (18), *rrymë e magnetizimit* (6), *rrymë e mosbalancimit* (6), *rrymë nominale* (10), *rrymë nulare* (8), *rrymë rrjedhëse* (2), *rrymë e shkarkimit* (2), *rrymë totale* (2), *rrymë e vazhduar* (2);

tabelë (157 herë, në 24/31 punime);

mbrojtje (155 herë, në 19 nga 31 punime): *mbrojtjet diferenciale* (3), *mbrojtje mbirrymore* (14, në 2 nga 31 punime), *mbrojtja e mjedisit* (3), *mbrojtje në punë* (6, në 2 nga 31 punime), *mbrojtje rele* (60, në 9 nga 31 punime);

prodhim (141 herë, në 20/31 punime): *prodhimi i energjisë* (33), *prodhimi i energjisë elektrike* (23);

konsumator (133 herë, në 20/31 punime): *konsumatorët e energjisë elektrike* (2); *konsumatorët familjarë* (4), *konsumatorët fundorë* (7); *konsumatorët tariforë* (2);

furnizim (126 herë, në 24 nga 31 punime): *furnizim me energji* (42), *furnizim me energji elektrike* (35),

shpërndarje (101 herë, në 21/31 punime): *shpërndarje e energjisë* (17), *shpërndarje e energjisë elektrike* (9);

operim (100 herë, në 19/31 punime): *në operim* (në punë) (11), *gjatë operimit* (14);

rënie (97 herë, në 18/31 punime): *rënie e linjës* (12), *rënie e tensionit* (11), *rënie e transformatorit* (5);

kosto (93 herë, në 19/31 punime): *kostoja e energjisë* (6), *kosto financiare* (3), *kostoja e humbjeve* (6), *kostoja e mirëmbajtjes* (3), *kostoja e prokurimit* (17), *kostoja totale* (3);

parametër (91 herë, në 17/31 punime): *parametrat e gjeneratorit* (2), *parametra elektrike* (5), *parametrat e linjës* (12), *parametrat e sistemit* (5), *parametrat teknike* (7);

element (82 herë, në 16/31 punime): *element aktiv* (1), *element elektrik* (1), *element elektroenergjetik* (2), *element jolinear* (3);

konsum (82 herë, në 24/31 punime): *konsumi i energjisë* (elektrike) (11), *konsumi mesatar* (2), *konsumi i përgjithshëm* (2);

qark (81 herë, në 16/31 punime): *qark elektrik* (9), *qark ekuivalent* (2), *qark mbrojtës* (2), *qark sekondar* (4), *qark i shkurtër* (1);

mirëmbajtje (67 herë, në 18/31 punime): *ekipi i mirëmbajtjes* (5), *kostoja e mirëmbajtjes* (3) *plani i mirëmbajtjes* (2), *procesi i mirëmbajtjes* (4);

raport (63 herë, në 18 nga 31 punime): *raporti i performancës* (14), *raporti i ZRRE* (6);

problem (59 herë, në 20 nga 31 punime): *problem eventual* (3), *problem mekanik* (2);

burim (58 herë, në 17 nga 31 punime): *burime balancuese* (3), *burime energjetike* (2), *burime të ripërtritëshme* (të energjisë) (17);

operator (52 herë, në 16 nga 31 punime): *operator ekonomik* (2), *operator i sistemit* (30), *operator i tregut* (11).

Fjalët (38) që dalin në më pak se 16 punime janë karakteristike vetëm për një numër të caktuar punimesh dhe ato nuk mund të merren si fjalë që e karakterizojnë konferencën në tërësi, por vetëm punimet e caktuara:

MAV (104 herë, në 13/31 punime), vaj (102 herë, në 7/31 punime), *transmetim* (92 herë, në 12/31 punime), *defekt* (84 herë, në 12/31 punime), *shkarkues* (83 herë, në 5/31 punime), *shqyrtim* (81 herë, në 8/31 punime), *erë* (80 herë, në 9/31 punime), *izolim* (79 herë, në 12/31 punime), *relé* (78 herë, në 13/31 punime), *mbitension* (77 herë, në 7/31 punime), *asbest* (76 herë, në 1/31 punime), *izolator* (76 herë, në 10/31 punime), *njësi* (76 herë, në 12/31 punime), *kontakt* (75 herë, në 10/31 punime), *mosbalancim* (75 herë, në 5/31 punime), *import* (71 herë, në 5/31 punime), *kyçje* (71 herë, në 10/31 punime), *përçues* (70 herë, në 9/31 punime), *rezervë* (70 herë, në 6/31 punime), *pështjellë* (69 herë, në 6/31 punime), *kompani* (69 herë, në 14/31 punime), *modul* (67 herë, në 4/31 punime), *shërbim* (66 herë, në 11/31 punime), *monitorim* (63 herë, në 14/31 punime), *njehsor* (63 herë, në 6/31 punime), *rezistencë* (62 herë, në 11/31 punime), *frekuencë* (60 herë, në 12/31 punime), *zgjdhje* (59 herë, në 11/31 punime), *temperaturë* (56 herë, në 13/31 punime), *bateri* (55 herë, në 2/31 punime), *projekt* (55 herë, në 14/31 punime), *rregullator* (55 herë, në 10/31 punime), *rrezik* (55 herë, në 11/31 punime), *zbarrë* (55 herë, në 9/31 punime), *funksion* (54 herë, në 15/31 punime), *avarí* (53 herë, në 12/31 punime), *prokurim* (52 herë, në 3/31 punime), *kontratë* (51 herë, në 34/31 punime).

Fjalët çelës që jepen nga vetë autorët e punimeve e që dalin në së paku 2 punime nga gjithsej 31 janë:

energji (12), *elektrik* (9), *rrjet* (9), *fuqi* (7), *linjë* (7), *sistem* (7), *tension* (7), *transformator* (7), *treg* (5), *mbrojtje* (4), *pajisje* (4), *siguri* (4), *elektroenergjetik* (3), *humbje* (3), *izolues* (3), *kontratë* (3), *prishje* (3), *rezervë* (3), *vaj* (3), *afatgjatë* (2), *ajror* (2), *asbest* (2), *balancim* (2), *besueshmëri* (2), *çmim* (2), *diagnostikim* (2), *erë* (2), *impedancë* (2), *kapacitet* (2), *kod* (2), *l.sh.* (2), *liberalizim* (2), *lidhje* (2), *matje* (2), *MATLAB* (2), *mbitension* (2), *ndërprerës* (2), *ngarkesë* (2), *performancë* (2), *rele* (2), *rënie* (2), *shpërndarës* (2), *shqyrtim* (2), *teknik* (2), *testim* (2), *testues* (2), *TM* (2)

Në punimet e marra në shqyrtim përdoren edhe mjaft shkurtesa të krijuara përbrenda shqipes, ose të marra nga anglishtja. Kemi edhe rastin e krijimit të dy shkurtimeve nga vetë autorët.

Shkurtesa të shqipes:

BE (**B**ashkimi **E**uropian) – 8 herë në 2 punime, BE 1, BE-së 7;

BERZH (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) – 2 herë në 1 punim, C5-02;

BRE (Burime të Ripërtitëshme të Energjisë) – 16 herë në 3 punime: BRE 12, BRE-të 1, BRE-ve 3;

HEC (hidro-elektrocentral) – 53 herë në 2 punime: HEC 13, HEC-e 2, HEC-et 20, HEC-eve 17, HEC-it 1;

IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës) – 3 herë në 1 punim, B1-02;

KEK (Korporata Energjetike e Kosovës) – 39 herë në 4 punime: KEK 18, KEK-u 15, KEK-un 3, KEK-ut 3;

KESH (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare) – 3 herë në C2-03: KESH 2, KESH-i 1;

KKDFE (Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike) – 2 herë në 1 punim, C5-04;

KOSTT (Kosovë Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu) – 83 herë në 10 punime: KOSTT (48), KOSTT-i (14) KOSTT-in (1), KOSTT-it (20);

KRRE (Komisioni Rregullator për Energjetikë) – 8 herë në vetëm 1 punim, C5-02;

KKP (Koha Kritike e Prishjes) – 4 herë në 1 punim, C4-06;

KXE (Kombinati Xehetaro-Energjetik) – 3 herë në 1 punim, C5-02;

MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror) – 2 në 1 punim, C3-01;

NS (nënstacion) – 195 herë në 13 punime: NS 188, NS-i 2, NS-it 1, NS-të 2, NS-ve 2;

SHA (Shoqëri Aksionare) – 14 herë në 1 punim: C5-02; SH.A. – 5 herë në 2 punime;

OS (Operatori i Sistemit) – 1 herë në 1 punim, C5-07;

OSSh (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) – 1 herë në 1 punim, C5-02;

OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit) – 41 herë në 8 punime: OST 17, OST-ja 7, OST-në 4, OST-së 6, OST-të 4, OST-ve 3;

OT (Operatori i Tregut) – 6 herë në vetëm një punim, C5-07;

OTEE (Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike) – 2 herë në 1 punim, D2-02;

PPM (pajisjet personale mbrojtëse) – 1 herë në 1 punim, D1-02;
 QDSH (Qendra Dispečerike e Shpërndarjes) – 4 herë në 1 punim, D1-02;

QND (Qendra Nacionale Dispečerike) – 1 herë në 1 punim, D1-02;

RMV (Republika e Maqedonisë së Veriut) – 4 herë në 1 punim, C5-02;

ShPKNjP (Shoqatë me Përgjegjësi të Kufizuar e Një Personi) – 3 herë në 1 punim, C5-02;

TC (termocentral) – 12 herë në 4 punime: *TC Kosova A* (3), *TC Kosova B* (4), *TC Kosova e Re* (5);

TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimeve) – 1 herë në 1 punim, D2-01: TIK-ut 1;

TL (tension i lartë) – 10 herë në 6 punime;

TM (tension i mesëm) – 24 herë në 5 punime;

TMRR (Transformator Matës i Rrymës) – 15 herë në 2 punime: TMRR 9, TMRR-ve 6;

TMT (Transformator Matës i Tensionit) – 26 herë në 2 punime: TMT 8, TMT-ve 18;

TU (tension i ulët) – 15 herë në 5 punime;

UA (udhëzim administrativ) – 2 herë në 1 punim: C3-01;

ZRRE (Zyra e Rregullatorit për Energji) – 23 herë në 3 punime: ZRRE 22, ZRRE-ja 1;

Shkurtesa të anglishtes të përdorura në tekstin shqip:

AC (angl. *alternative current*: rrymë alternative) – 10 herë në 4 punime: *tension AC* (6);

AES (angl. *Advanced Encryption Standard*: shq. Standardi i Avancuar i Enkriptimit) – 8 herë në 1 punim, D2-01;

aFRR (angl. *automatic Frequency Restoration Reserve*: shq. Restaurimi i Frekuencës me Rregullim Automatik) – 79 herë në 2 punime, C4-06 1, C5-06 78: aFRR 62, aFRR-ja 1, aFRR-së 16;

BIL (angl. *Basic Impulse Level*: shq. Niveli bazë i impulsit) – 1 herë në 1 punim, A3-01;

CF (angl. *Capacity Factor*: shq. Faktori i kapacitetit) – 7 herë në 2 punime, C2-04 1, C6-04 6;

DC (angl. *direct current*: rrymë e vazhduar) – 49 herë në 3 punime: rrymë DC (1), sistem DC (33), tension DC (1);

DSM (angl. *Distribution System Menagement*) – 1 herë në 1 punim, C4-03

EFET (angl. *European Federation of Energy Traders*: shq. Federata Europiane e Tregtarëve të Energjisë) – 1 herë në 1 punim, C5-04;

EU (angl. *European Union*: shqip. Bashkimi Evropian) – 1 herë në 1 punim, C4-06;

FERC (angl. *Federal Energy Regulatory Commission*: shq. Komisioni Rregullator Federativ për Energjetikë) – 3 herë në 1 punim, C5-02;

FRA (angl. *Frequency Response Analysis*: shqip. Analiza e përgjigjeve frekuencore) – 2 herë në 1 punim, A2-02;

HMI (angl. *Human Machine Interface*: shq. Ndërfaqe njeri-makinë) – 2 herë në 1 punim, D2-02;

IEEE (angl. *Institute of Electrical and Electronics Engineers*: Instituti i Inxhinierëve të Elektroteknikës dhe të Elektronikës) – 32 herë në 4 punime: IEEE (30), IEEE-së (2);

IP (angl. *Internet Protocol*: shq. Protokoll i Internetit) – 3 herë në 1 punim, D2-02;

IoT (angl. *The Internet of Things*: shqip. Interneti i gjërave) – 46 herë në vetëm 1 punim, D2-01: IoT 44, IoT-së 2; pajisjet IoT (8), siguria në IoT (5);

IT (angl. *Information Technolgy*: shq. Teknologji e informacionit) – 3 herë në 3 punime;

KEDS (angl. *Kosovo Energy Distribution Services*: shq. Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë) – 51 herë në 6 punime: KEDS 36, KEDS-i 4, KEDS-it 11;

KESCO (angl. *Kosovo Electricity Supply Company*: shq. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike) – 27 herë në 3 punime: KESCO (24), KESCO-n (1), KESCO-s (2);

LAN (angl. *Local Area Network*: shq. Rrjet lokal) – 3 herë në 1 punim, D2-02;

LFC (angl. *Load Frequency Control*: shq. Rregullimi frekuencë-fuqi) – 23 herë në vetëm 1 punim, C5-06: blloku LFC (8), zona LFC (12), zona/blloku LFC (3);

NIST (angl. *National Institute of Standard Technology*: shq. Instituti Kombëtar i Teknologjisë Standarde) – 1 herë në 1 punim, C2-03;

OLTC (angl. *On-Line Tap Changing Transformer*: shq. Transformator për rregullimin e tensionit nën tension) – 1 herë në 1 punim, C4-06;

PI (angl. *Polarisation Index*: shq. Indeksi i polarizimit; 2 herë në 1 punim: A2-02;

PR (angl. *Performance Ratio*: shq. Raporti i performancës; 3 herë në 1 punim: C6-04;

PSO (angl. *Particle Swarm Optimization*: shq. Optimizimi i grumbullit të grimcave) – 5 herë në 1 punim, C4-05: *metoda PSO* (3); *metoda optimizuese PSO* (1); *PSO është algoritëm* (1).

PSS/E (angl. *Power System Simulator for Engineering*: shq. Simulator inxhinerik për sistemet elektroenergetike) – 17 herë, në 4 punime: *pakoja softuerike PSS/E* (2), *softueri PSS/E* (8);

PV (angl. *photo-voltaic*: shq. sistemet/modulet fotovoltaike) – 59 herë në vetëm 1 punim, C6-04): *sistemi PV* (37);

PVC (angl. *polyvinyl chloride*: polivinil klorur/klorid) – 5 herë në 2 punime, B1-01, C3-01: *gyp PVC*; *mbrojtës PVC*; *pllaka dyshemeje PVC*; *shirit PVC*;

PX (angl. *Power Exchange*: shq. Shkëmbimi i energjisë) – 2 herë në 2 punime: C5-02, C5-07;

SCADA (angl. *Supervisory Control and Data Acquisition*: Kontrollim i mbikëqyrur dhe përmbledhje e të dhënave) – 50 herë në 4 punime: SCADA (47), SCADA-së (1), SCADA-ve (2); *sistemi SCADA* (24);

TCP (angl. *Transmission Control Protocol*: Protokollin për kontrollin e transmetimit) – 1 herë në 1 punim, D2-02: *ndërfaqja TCP/IP*;

UCTE (angl. *Union for the Coordination of Transmission of Electricity*: Unioni për koordinimin e transmetimit të energjisë elektrike) – 3 herë në vetëm 1 punim, C5-06;

UNMIK (angl. *United Nations Mission In Kosovo*: shqip. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) – 1 herë në 1 punim, C5-02: *UNMIK-u* (në emër të Kosovës);

UTP (angl. *Unshielded Twisted Pair cable*: shq. kabloja me çiftore të përdredhur të mbrojtur) – 4 herë në 1 punim, D2-02: *kablllo UTP* (3), *kablllo Ethernet UTP* (1);

VOIP (angl. *Voice Over Internet Protocole*: shq. Zëri nëpërmjet Protokollit të Internetit) – 1 herë në 1 punim, D2-02;

YR (angl. *Referent Yild*: shq. Prodhimi referent) – 2 herë në 1 punim, C6-04.

Shkurtime:

Krahas shkurtimeve të ngurtësuara me kohë, si:

d.m.th. (domethënë) – 4 herë në 2 punime, *etj.* (e të tjera) – 79 herë në 26 punime, *p.sh.* (për shembull) – 15 herë në 9 punime; – përdoren edhe shkurtime të krijuara nga vetë autorët e punimeve të referuara në këtë konferencë të CIGRE-s, si *p.sh.*:

gj.sh. (gjenerator i shpërndarë) – 17 herë në vetëm 1 punim, C4-05; *l.sh.* (lidhje e shkurtër) – 23 herë në 6 punime.

Simbole për madhësi fizike:

Në këto punime, si në punime të tjera profesionale dhe shkencore, përdoren mjaft shpesh edhe simbole të ndryshme për madhësi të ndryshme fizike, si:

I – për rrymë, *L* – për gjatësi, *P* – për fuqi (aktive), *Q* – për fuqi reaktive, *R* – për rezistencë, *t* – për kohë, *T* – për temperaturë, *U* – për tension, *Z* – për impedancë etj.

Simbole për elemente e komponime kimike:

Al (alumin), *Fe* (hekur), *ZnO* (zink-oksidi, oksidi i zinkut) – 19 herë në vetëm 1 punim, A3-01: *shkarkuesit ZnO* (8), *shkarkuesit e mbitensionit ZnO* (7), *shkarkuesit metal-oksidi ZnO* (2), *shkarkuesit metal oksidi të mbitensioneve ZnO* (1), *varistorët ZnO* (1).

Simbole për njësi fizike:

A (amper – njësi për matjen e intensitetit të rrymës) – 36 herë në 9/31 punime); *mA* (miliamper = 1/1000 A; 16 herë në 2/31 punime); *kA* (kiloamper = 1000 A; 18 herë në 4/31 punime);

dB (decibel = 1/10 B) – njësi për matjen e nivelit të zërit; 1 herë në 1 punim, D1-02;

nF (nanofarad = 1 e njëmiliardta pjesë e F) – njësi për matjen e kapacitetit; 1 herë në A3-01;

h (orë = 60 min = 3.600 s) – 16 herë në 5 punime;

ha (hekto-ar = hektar = 100 arë – njësi për matjen e sipërfaqes së tokës) – 3 herë në 1 punim, C5-02);

Hz (herc – njësi për matjen e frekuencës) – 22 herë në 6 punime;

m (metër – njësi për matjen e gjatësisë) – 27 herë në 3 punime;

mm (milimetër = 1/1000 m) – 2 herë në 1 punim; *km* (kilometër = 1.000 m) – 27 herë në 8 punime;

s (sekondë – njësi për matjen e kohës) – 4 herë në 1 punim; *sec* (sekondë) – 19 herë në 4 punime; *sek* (sekondë) – 10 herë në vetëm në 1 punim, C2-03; *ms* (milisekundë = 1/1000 s) – 15 herë në 3 punime; *ns* (nanosekundë = 1 e njëmiliardta pjesë e sekondës) – 1 herë në 1 punim) – *μs* (mikrosekundë = 1 e njëmilionta pjesë e sekondës) – 6 herë në 2 punime);

V (volt – njësi për matjen e tensionit) – 47 herë në 9 punime), *mV* (milivolt = 1/1000 V) – 2 herë në vetëm 1 punim, A2-01; *kV* (kilovolt = 1000 V) – 611 herë në 25 punime;

VA (voltamper – njësi për matjen e fuqisë elektrike) – 1 herë në vetëm 1 punim, C2-03, *MVA* (megavoltamper = 1.000.000 VA) – 104 herë në 13 punime;

W (vat – njësi për matjen e fuqisë) – 3 herë në 2 punime; *mW* (milivat = 1/1000 W) – 13 herë në 2 punime; *MW* (megavat = 1.000.000 W) – 112 herë në 9 punime – afër nëntë herë më shumë se mW, për arsye se kemi të bëjmë me sisteme elektroenergjetike të fuqive të mëdha);

Wh (vat-orë – njësi për matjen e energjisë) – 1 herë në 1 punim), *kWh* (kilovat-orë = 1.000 Wh) – 37 herë, në 4 punime; *GWh* (gigavat-orë = 1.000.000.000 Wh) – 57 herë në 3 punime;

Ω (om – njësi për matjen e rezistencës elektrike) – 19 herë në 4 punime; $M\Omega$ (megaom = 1.000.000 Ω) – 3 herë në 1 punim, $G\Omega$ (gigaom = 1.000.000.000 Ω) – 1 herë në 1 punim;

$^{\circ}\text{C}$ (gradë Celsius – njësi për matjen e temperaturës) – 18 herë në 5 punime.

Emra të përveçëm gjeografikë:

Bashkëlidhur me shkurtesën NS (nënstacion) dalin një numër i konsideruar emrash të përveçëm gjeografikë, kryesisht të Kosovës:

NS Berivojcë, NS Bujanovc, NS Drenas, NS Ferizaj, NS Gjakovë, NS Gjilan, NS Iliridë, NS Klinë, NS Kosova A, NS Kosova B, NS Lipjan, NS Magure, NS Mitrovicë, NS Pejë, NS Piranë, NS Podujevë, NS Prishtinë, NS Prizren, NS Skenderaj, NS Shalë, NS Sharr,

NS Shtërpce, NS Shupkovc, NS Trepçë, NS Therandë, NS Vallaç, NS Viti, NS Vushtrri.

Bashkëlidhur me shkurtësën HEC (hidrocentral) dalin po ashtu një numër i konsideruar emrash të përveçëm gjeografikë të Shqipërisë:

HEC Banjë, HEC Bistricë, HEC Bishnicë, HEC Dardhë, HEC Denas, HEC Fierzë, HEC Gostime, HEC Kalivaç, HEC Koman, HEC Lengaricë, HEC Llengë, HEC Moglicë, HEC Orenje, HEC Qarishte, HEC Peshqesh, HEC Sllabinjë, HEC Stavec, HEC Shkopet, HEC Ulëzë, HEC Vau i Dejës etj.

Në punimet në anglisht, që nuk janë trajtuar në këtë punim, dalin edhe emra të përveçëm gjeografikë të shteteve të tjera të Ballkanit, si Bosnja e Hercegovina dhe Kroacia:

Brinje, Konjsko, Melina, Osijek, Rijeka, Sarajevo, Senj, Split, Tuzla, Zagreb, Vinodol.

Përfundim

Nga rezultatet e përfutuara me anë të konkordancierit, mund të konstatojmë se leksiku i konferencës së parë të CIGRE-s në Kosovë të mbajtur në Prishtinë më 8 dhe 9 nëntor 2019, përveç leksikut të përdorimit të zakonshëm, përmban edhe një leksik që lidhet ngushtë me tematikën e punimeve profesionale të referuar në gjuhën shqipe në këtë konferencë. Në 30 leksemat e para të këtij korpusi, secila me mbi 300 paraqitje, 10 prej tyre (*sistem, energji, elektrik, kV, tension, transformator, rrjet, figurë, fuqi, linjë*), apo çdo e treta, kanë të bëjnë me rrjetet (sistemet) energjetike ose me mënyrën e paraqitjes së tyre në punime shkencore a profesionale. Edhe lista e leksemave me 50-300 paraqitje tregon se mjaft prej tyre janë fjalë nga fusha e teknikës, përkatësisht nga fusha e rrjeteve (sistemeve) elektroenergjetike. Nga 62 fjalët e kësaj liste, 24 (*pajisje, lidhje, matje, ngarkesë, humbje, rrymë, tabelë, mbrojtje, prodhim, konsumator, furnizim, shpërndarje, operim, rënie, kosto, parametër, element, konsum, qark, mirëmbajtje, raport, problem, burim, operator*) dalin në më shumë se gjysmën e punimeve. Ato bashkëlidhen me fjalë të tjera të këtij korpusi për të përcaktuar nocione të caktuara dhe mund të merren si fjalë çelës të konferencës në tërësi. Veçori e këtij korpusi është edhe përdorimi i shkurtësive, të krijuara përbrenda shqipes, apo të marra nga anglishtja dhe të përdorura si të tilla në tekstin shqip. Haset në mjaft raste edhe përdorimi i simboleve fizike e kimike për të shënuar madhësitë e njësitë e ndryshme

fizike, apo elementet e komponimet e ndryshme kimike. Bashkëlidhur me disa shkurtesa si NS (nënstacion) dhe HEC (hidro-elektrocentral) na del një numër i konsideruar emrash të përveçëm gjeografikë, kryesisht të Kosovës e Shqipërisë, e që kanë të bëjnë me sistemet elektroenergjetike të këtyre vendeve.

Abstract

The purpose of this paper is to study the vocabulary of 31 papers in Albanian language referred to the first CIGRE Conference held in Prishtina on 8 and 9 November 2019. In this regard, the computer processing of this corpus of 91,529 words, 8,689 word forms and 4,538 lemmas has been done, and a list of lematized words is extracted and sorted by the number of occurrences in this corpus. The obtained results are analyzed and certain conclusions are given in this research paper. We have concluded that the vocabulary of this conference, in addition to the vocabulary of common use, also contains a vocabulary that is closely related to the topic of these papers, which is a technical vocabulary. In the first 30 lexemes of this corpus, each with over 300 occurrences, 10, or every third of them, has to do with electrical grids (systems) or the way they are presented in scientific or professional papers. Even the list of lexemes with 50-300 occurrences shows that many of them are words from the field of engineering, respectively from the field of electrical grids (systems). Out of the 62 words, 24 appear in more than half of the papers. They make collocations with other words of this corpus to define certain notions and can be taken as the keywords of the conference as a whole. The peculiarity of this corpus is also the use of abbreviations from Albanian respective words, or taken from English language and used as such in the Albanian text.

Key words: language corpus, technical vocabulary, abbreviations, symbols, keywords

Bibliografia e punimeve të referuara në Konferenca e parë të KN CIGRE Kosovë, Prishtinë 06-08.11.2019.

1. [A2-01]: Kjani Guri, Taulant Ramadani, Shaban Neziri, Revitalizimi i autotransformatorit 220/110 kV, 150 MVA në NS Kosova A.
2. [A2-02]: Kjani Guri, Besim Gerxhaliu, Arben Fejzullahu, Testimi dhe diagnostikimi i TR4 63 MVA në NS Trepça – pas avarisë së ndodhur.
3. [A2-03]: Korab Zymeri, Servisimi i rregullatorit të tensionit në transformatorët 35/10 kV në rrjetin e shpërndarjes.
4. [A2-04]: Korab Zymeri, Besueshmëria e transformatorëve energjetikë në rrjetin e shpërndarjes 35 kV, ngritja e kapaciteteve transformuese.

5. [A3-01]: Bahri Prebreza, Arben Lekaj, Përzgjedhja dhe zbatimi i shkarkuesve të mbitensionit në sistemin elektroenergetik.
6. [A3-02]: Avni Alidemaj, Arif Vitija, Nezir Neziri, Naser Xhambazi, Defektet e brendshme të ndërprerësit të fuqisë së tensionit të mesëm.
7. [A3-03]: Selman Hoti, Arif Vitija, Nezir Neziri, Naser Xhambazi, Testimet e ndërprerësit të fuqisë së tensionit të mesëm.
8. [B1-01]: Avni Alidemaj, Sadik Latifaj, Qendrim Nika, Kujtim Miftari, Përparësitë dhe të metat e rrjetit nëntokësor dhe respektimi i rregullave gjatë shtrirjes së kabllove të tensionit të mesëm.
9. [B1-02]: Avni Alidemaj, Edita Bytyqi Muçkurtaj, Enis Riza, Arsyeshmëria e kalimit nga linjat ajrore 110 kV në linjat kabllore.
10. [B3-01]: Rexhep Selimi, Kjani Guri, Shaban Neziri, Musa Kadriu, Realizimi i lidhjeve të ngurta 35 kV dhe 110 kV pas avarisë në NS Trepça me qëllim të rikthimit të furnizimit me energji elektrike.
11. [B4-01]: Albert Kajtazi, Valon Hajrizaj, Shqyrtimi i sistemeve DC në nënstacione.
12. [B5-05]: Genc Sejdiu, Vjollca Komoni, Matja e impedancës së linjës së tensionit të lartë 110 kV LP1213 mes NS Prishtina 4 dhe NS Lipjan.
13. [B5-07]: Nazif Nazifi, Nezir Neziri, Musa Kadriu, Sfidat e selektivitetit të mbrojtjeve rele në kufirin KOSTT-KEDS – përfitimet.
14. [C1-02]: Gazmend Kabashi, Kadri Kadriu, Astrite Neziri, Analiza e lidhjes së sistemit të furnizimit të hekurudhës elektrike në rrjetin e transmisionit.
15. [C1-05]: Lutfije Dervishi, Liridon Hajrizi, Durim Musiqi, Neki Sadiku, Impakti i kalimit prej nivelit të tensionit 10 kV, në operim 20 kV në daljen 'Drenica'.
16. [C2-03]: Rajmonda Bualoti, Marialis Çelo, Zean Hodaj, Engjell Zeqo, Impakti i HEC-eve të vogla dhe të mesme në dinamikën e sistemit elektroenergetik.
17. [C2-04]: Bukuriye Hoxha, Rexhep Selimaj, Sabrije Osmanaj, Integrimi i energjisë së erës në sistemin elektrik në Kosovë: gjendja aktuale dhe sfidat.
18. [C3-01]: Minivere Idrizi, Zera Ymeri Spahiu, Trajtimi i asbestit gjatë renovimit të fasadës në KOSTT SH.A. .
19. [C4-03]: Alketa Sahiti, Vjollca Komoni, Kadri Kadriu, Analiza e mosbalancimit të ngarkesës ndërmjet fazave në nivelin 0.4 kV.
20. [C4-05]: Drenusha Gashi, Vjollca Komoni, Erzen Krasniqi, Përmirësimi i profilit të tensionit dhe zvogëlimi të humbjeve të energjisë me vendosjen optimale të gjeneratorëve të shpërndarë.
21. [C4-06]: Kadri Kadriu, Gazmend Kabashi, Ilir Shala, Sabri Limari, Analizë e kyçjes së gjeneratorëve në rrjetin transmetues bazuar në kërkesat e kodit të kyçjes së njësive gjeneruese.
22. [C5-01]: Arta Isufi, Hamijete Qorolli, Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

23. [C5:02]: Imer Zenku, Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
24. [C5-04]: Albina Mekuli, Alketa Sahiti, Behije Ahmeti, Tregtimi i energjisë: analizë krahasuese e shitblerjeve afatgjata dhe afatshkurtra.
25. [C5-06]: Shyqeri Morina, Vedio Hajrullahu, Burbuqe Hasani, Diedona Breca, Analizë e kërkesës për rezervën e restaurimit të frekuencës me rregullim automatik për SEE të Kosovës.
26. [C5-07]: Herolinda Blakaj, Sylejmon Raçi, Granit Lekaj, Metodatat e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit të Kosovës.
27. [C6-03]: Arif Vitija, Drenusha Gashi, Erzen Krasniqi, Gabimet në lidhje me matjet gjysmëdirekte dhe indirekte / faktori i korigjimit.
28. [C6-04]: Vjollca Komoni, Njomza Ibrahim, Vlerësimi i performancës së monitorimit të sistemit fotovoltaiak të lidhur në rrjetin elektrik.
29. [D1-02]: Edmond Hajrizi, Arif Vitija, Burim Islami, Sabri Ternava, Siguria në punë në objektet e sistemit elektroenergjetik.
30. [D2-01]: Nerxhivane Përvetica, Eduard Haxhaj, Rrona Bunjaku, Sfidat e sigurisë kibernetike në përdorimin e IOT-së dhe platformave të bazuara në Cloud.
31. [D2-02]: Saranda Bytyqi, Albert Maloku, Bujar Krasniqi, Ndryshimi i industrisë së energjisë nëpërmjet aplikimit të teknologjive ekzistuese dhe të reja të komunikimit.

REFERENCAT/REFERENCES

- [1] Anthony, L. (2004). AntConc: A Learner and Classroom Friendly, Multi-Platform Corpus Analysis Toolkit. *IWLeL 2004: An Interactive Workshop on Language e-Learning*. pp. 7-13.
- [2] Baker, M. (1988). Sub-technical vocabulary and the ESP Teacher: An analysis of some rhetorical items in medical journal articles. *Reading in a Foreign Language*, 4(2), pp. 91-105.
- [3] Belegu-Caka, V. (2015). A linguistic corpus for electrical and computer engineering for teaching english. Master Thesis, University of Prishtina, Faculty of Philology.
- [4] Caka, N. Caka, A. (2012). Korpusi njëmilionfjalësh i gjuhës shqipe si bazë për nxjerrjen e fjalëve çelës të teksteve të ndryshme të gjuhës shqipe. *AKTET, Vëll. V, Nr. 4*, ff. 714-719.
- [5] CIGRE (2011). The History of CIGRE – A key player in the development of electric power system since 1921.
- [6] Mudraya, O. (2006). Engineering English: A lexical frequency instructional model, *English for Specific Purposes* 25, pp. 235–256.
- [7] <https://www.cigre.org>

Agostino Giordano, Drejtor i revistës „Jeta Arbëreshe”

EMANUELE GIORDANO, PRIFT E ALBANOLOG

(NË 100-VJETORIN E LINDJES)

Të shkruash mbi zotin Emanuele Giordano s'është punë e lé: as për mua, që bashkë me të rrova shumë vjet.

Emanuele Giordano lehet Frasnitë (Frascineto, Cosenza/-Calabria), katund arbëresh i Italisë, te viti **1920**, e rritet te shpia ku rroi zoti Binard Bilota (1843-1918), stërlala tij, prift e shkrimtar; ku edhe murët foljën arbrisht, ku libre e karta i gjën gjithaparë. Një shpi e madhe. Prindi Gustin/Agostino ká dhera e dhen dhe t'bilt i ndihjën t'i punojën e t'i kullotjën. Manuelli/Emanuele është i pesti ndër shtatë bil. Manuellit i pëlqen t'studhjarenj e ndien prësvògli thërritjen e t'Inzoti për t'bëhet prift. I jati e shkruan ndë skollët kur ka 5 vjet, por zilia e të tjerëvet prindë i pret udhën. Bankët e skollës, pra, i sheh kur ka 8 vjet: mënon, se pat i ndihnej fëmiles. Skollën elementare e sosën kur ká 13 vjet. Vonë, për të hynjë në Seminar. Po fati këtë herë e ndihën: një kandidat tëhilqet prap e Manuelli hyn te Seminari i Grotaferratës, ku bën shkollë të mesme e gjimnaz; pra, te viti 1938, shkon te Kollexhi Grek i Rromës, ku vijon me lliçë, filosofí e teoloxhí. Në Filosofí merr, Bakallaureàtin; ¹ e Liçenxën në Teoloxhì. Tek 12 vjet merr Meshën. Vitin 1945 është prift.

Vitin pas (1946) vjen i ëmruar famullitar i katundit Ejanina, fracjonë e Frasnitës. Janë 920 njerëz. Pak qindra metra ndajën Ejaninën ka Frasnita. E nj'urëz. Është katund arbresh me pak lëtinj: këta, o e foljën arbrishtin, o e kuptojën. Sepse lëtinjvet i folet vet arbrisht. Fuqi e asimilimit arbëresh!

Zoti Manuell bën priftin te katundi ç'i ngau. Çë peshkopi i Ungrës, Mele, zgjoth për të.

Frasnitën e ka afër. Atjë bën priftin papa Sepa Ferrari, bixantin si pak.

Sa vë këmbë Ejaninë, papas Emanuele Giordano Qishen e Shën Vasilit zë e e prier bixantine: Altar e Ikonostaz, të parët; e Ikonat daledalë zënë e marrën vendin e statuavet lëtire. Po edhe Shërbesat Qishtare ndërrojën dhe Himnet Bixantinë këndohen si i nget, po adhë në gjuhë greke.

Prifti ka t'rronjë te katundi ku bën priftin, po Ejanina s'e ka 'shpinë e priftit' (Kanònikën) e zoti Manuell – për të ngrënë e të fjetur - vete e vjen ka shpia e prindvet, Frasnitë, me biçikletë. Po, me një enerxhi të pashoqe, te dy vjet (1948-49), bën e stisjën Kanònikën.

Veprat e stërlalës, dhën Binard Bilotta, i djovasën e i studjon: i pëlqejën, e magjepsjën.

I hyn mb'zëmer Arbrishtja, rritet malli për Skanderbekun e për Zakonet Arbreshë.²

Zë e djovasën veprat arbreshe çë gjën te Biblioteka e Bilotës; De Rada është i pari.

Hyn ndër problemet e kulturës arbreshe: i pari qëndron 'Lýpsja e një Fjalori'.

Me të vërtetë, zoti Manuell s'e ká një mjeshtër ç'i mbëson gjuhë e kulturë arbëreshe e shqipe. Xë si autodidakt: në Kollexhin Grek, më parë, ku ka si shok të ngusht një shqiptar, Pjetër Isaku, Ky i dhuron një libër, ç'i hapën sytë e udhën, zotit Giordano, për përkthimet e tij qishtarë në gjuhë arbëreshe.³ E pra xë mbi veprat e Bilotës dhe mbi autorët arbëreshë çë gjën te Biblioteka Bilotiane;⁴ e ndihën të shurbërit bashkë me papa Sepën dhe miqësia me Ernest Koliqin (ndër t'parët vite '50) e me Frangjisk Solanin (prift i Frasnitës ç'ka viti 1957). E pra revista e libre shqip, jashtë e mbrënda Shqipërisë, e ndihjën të piqet sa duhet.

Ndër të parët vite '50, zoti Manuell kujdeset për katundarët e tij: i shkruan, njërit pas jetrit, ministrit të Postavet dhe Telekomunikimevet t'Italisë t'asimoti për të hapënj nj'Axhenci postale, Ejaninë; e pra ministrit të mbrëndshëm t'Italisë për hapjen e një 'Kopshti djemsh' famullitar, Ejaninë; e pëstaj edhe krietarit t'Bashkisë t'Frasnitës të motit i lypën një ndihmë ekonomike për hapjen e këtij Kopshti.

Te Salloni i Qishës mbjeth djelme e vashaz, e i mbëson Meshë, Katekizëm e Kalimere, gjuhë arbëreshe e Teatër; organixarën valle e grupe folk. Kanònika është hapët për lypsjet e katundarëvet.

Katundi do mësuar e alfabetizuar jo vet tek Arbrishtja, po do rritur edhe tek Besa e Krishterë.

Gjindja e katundit mbë qishë s'kupton faregjë të gjuhës greke: megjithatë gjithë shërbesat liturgjike, ndër qishat bixantine t'Eparkisë s'Ungrës/Cs, bëhen në gjuhë greke, o italiane.

S'vete fare mirë. Për zotin Manuell, 'Arbëreshi ka t'parkalesën arbrisht, ka t'këndonjë arbrisht'.

Te Kollexhi Grek kish xënë aq Muzikën Bixantine sa atë Perëndimore. E, i frymëzuar sa duhet, zë e muzikon ca Kalimere të shkruara ka Bilota, ja mbëson bestarëvet dhe këndohen mbë Qishë.

Po mësegjith Mesha – shërbesa liturgjike më e shtrënjtë – do pjerrë arbrisht. Sa më parë.

Zoti Manuell prier sytë ka Qisha Orthodoxkse Shqiptare, studhjon Meshen shqiptare orthodoxkse të pjerrë shqip, te djalekti tosk, ka imzot Fan Noli dhe e shkon (sa më mundën) në gjuhë arbreshe. Ajo dhuratë e shokut shqiptar P.Isaku, në vitin 1941, te Kollexhi Grek, bën mërakullin: për arsyje pastorale/baritore, zoti Manuell i mbëson arbreshvet t'Ejaninës Meshën Arbëreshe të Shën Janjit Hrisostòm. E, pas Meshës, edhe t'tjera Shërbesa Qishtare e Himne Bixantine, pak e pak, ja adhapton (sa mundën) Arbrishtes.

E bestarët e Ejaninës, të parët e Eparkisë s'Ungrës, parkalesjën e i këndojën t'Inzoti te gjuha tyre, arbërisht.

Si papa Gjergj Skiroi (1897-1992) te Hora e Arbëreshëvet/Pa, ashtu zoti Manuell Giordano është i pari, në Eparkinë e Ungrës, që prier arbrisht pjesat liturgjike të ritit bixantin.

Po papa Gjergji i prier tek e folmja e Horës s'Arbëreshvet, ndërsa zoti Manuell, - e pra Komisjona liturgjike eparkjale ungërnjote - i merr ka shqipja toske e Fan Nolit.

E kështu Arbëreshët katolikë të ritit Bixantin i qasën, pak o shumë, Qishës 'motër' Shqiptare Orthodoxkse.

Si i shtjitur ka shëmbulli i Bilotës, që kish mbjedhur gjithë Zakonet arbreshe t'Frasnitës, zoti Manuell shërben me papa Sepën Ferrari në libërthin 'Kaljimere (1946);⁵ e pra, vitin 1957, shkruan mbi zakonet e Pashkëvet, Frasnitë dhe Ejaninë (*Folklore Albanese In Italia – Usi e festeggiamenti tradizionali nell'occasione della Pasqua in Frascineto ed Ejanina (Cosenza)*).⁶

Po, mësegjithë, zë punën e 'Fjalorit': mbjeth Fjalë e fjalí arbreshe, aq ka veprat e Bilotës, - e mësemë ka *Fjalori filologjik arbresh* i Bilotës, i pabotuar -, sa ka veprat e dhjetrash autorë arbreshë; si edhe ka t'folmet e gjalla të katundevet arbëreshë. Nga Fjalë një

Skedë, milëra Skedë te një shkatull kartuni/kutí kartoni , ç'adhe shoh mbi tryesën e tij të shkrimit, ndër vitrat '50. Nd'ata vite s'ish kompjuteri, s'ish interneti, e fjalët shkruhshin me pendë, e mbi kartë.

Ndër të parët vite '50 njih e bëhet mik me prof.Ernest Koliqin e pra bashkëpunon me revistën e tij 'Shëjzat'(1958). E atjè boton, ndër të tjerat, edhe material të Fjalorit t'tij. ⁷

Dhjetë vjet (1953-1963) i duhen zotit Giordano për të dalë me '**Fjalorin e Arbëreshvet t'Italisë**' (Bari 1963), ç'i jep nderë e ëmer në tërë Botën Shqiptare. E 500 kopje ja bjen Shqipëria.

E Koliqi e Valentini – profesorët e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe në Universitetet e Romës dhe të Palermit,- janë të parët që recenzojnë kryeveprën e tij. ⁸

Jeronim De Rada e kish thënë se duhej një Fjalor Arbëresh: shumë vunë dorë, po e lanë ndër mest. B.Bilota e sosi, po s'e botoi; P.Kamodeka botoi vet t'parat dy letra (A e B). Zoti Manuell e zë, e mbaron dhe e publikaren/boton. E nderon Arbëreshët pamasë.

Ç'ka vitet '60, çdo short rivistje o libri shqiptar errën te Kanonika e zotit tonë. E libret – mësemë ata gjuhësorë, leksikorë e historikë – ai jo vet i djovasën, po i studhjaren.

Vitin **1966**, i ftuar ka Universitata e Tiranës, vete mban dy konferenca mbi B.Bilotën e këtu njih gjuhëtarë e letrarë të Shqipërisë: Çabej, A.Xhuvani, Z.Kodra, J.Kastrati, Shuteriqi, etj.. ...: me dica do të mbanjë edhe korrispondencë.

Te viti **1967**, Universiteti Shtetëror i Tiranës – vitin parë 500vjektorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit - boton veprën e B.Bilotës '**Shpata e Skanderbekut ndër Dibret poshtë**', redaktuar nga E.Giordano, stërnipi i tij. ⁹

Qasej, ndërkaq, moti t'i jipej Arbëreshëvet Bixantinë një tekst Meshje arbërisht. Komisjona Liturgjike e Ungrës, e përbërë ka zotrat Francesco Solano, Domenico Bellizzi dhe Emanuele Giordano, "*mbajti si tekst-bazë, - shkruan zoti Manuell - Librin e Shërbesavet të Shënjta të Kishës Orthodoxe Autoqefale të Shqipërisë* (Tiranë 1961); *e tekstin e pjerrë arbërisht ka zoti Emanuele Giordano, e ka ai i përdorur shumë herë mbë qishë, ç'ka vitet '50. (...)*'. E mbi gjuhën e zgjedhur, zoti Giordano shënon: '*Gjuha liturgjike e qishës ka të jetë më e lartë, më e denjë, më bulare se ajo vulgare, ç'është shumë e varfër e s'ka mundësi të pjerrë fjalë teologjike e letrare*'. ¹⁰

Një tekst çë – pas një përvoje 50 vjetsh – do arbreshizuar 'vërtet', e sa më njize. Më parë se të jetë vonë. Po 'Mesha' e vitit 1968 (*La*

Divina Liturgia di S. Giovanni Crisostomo/Liturgia hyjnore e àtit tonë ndër shëjtrat Joan Hrysostomit, Roma 1968) qe me të vërtetë një revolucionë. Ka ana gjuhësore, pra, qe vet pika e të zënurit/nisjes, jo t'errënurit/e arritjes.

U këtë 'provë teknike' e bëra dhe e botova, e rezultati pëlqen. ¹¹

Dhuj nd'atë vit (1968), peshkopi i Ungërës Janj Stamati, me Dekret të 13 shënmitrit 1968, ngrën Arbërishten në rangun e grekut: 'gjuhë liturgjike'; e ku djovasmi: '*La lingua greca, lingua matrice della Liturgia bizantina, non si intende abolita con il presente Decreto, ma sarà alternata a quella parlata* (l'arbëreshe, ndr.) / *Gjuha greke, gjuhë-mëmë e Liturgjisë bixantine, nëng është e nxjerrë jashtë Liturgjisë me këtë Dekret, po ka t'alternohet me 'gjuhën e folur'* (Arbrishtja, ndr.)'. ¹²

Arbërishtja, me këtë Dekret, hyn te Qishat Arbëreshe ka dera madhe. Me të vërtetë, zoti Giordano, pas Dekretit, Meshën e thot ngadita Arbërisht, kurse Meshën greke e këndon vet tek e prasmja e Diell të muajit. ¹³

Të këtij viti është edhe '**Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Hrysostomit**', e zotit Giordano, **në muzikë bizantine**. ¹⁴

Hapja e '*Vëllazërisë së motravet të vogla të Jisuit*', Ejaninë, vitin 1969, është edhe meritë e zotit Manuell. Pas një udhëtimit ndëpër katundet arbëreshë, vitin 1968, kryetarja e motravet të vogla, Magdeleine e Jisuit (të vëllazërisë së Charles de Foucault) përpjek zotit Manuell, Ejaninë, e zgjeth t'e hapënj aty Vëllazërinë. Ajo ka një'ëndërr: do se motrat e vogla të Kongregacionës s'saj kanë përgatiten mirë, për të shkojnë pra në Shqipëri, sapo bie rrexhimi komunist i Enver Hoxhës: kanë 'venë t'i japën shëmbullin e tyre të krishterë Botës Shqiptare.

Motra e vogël Magdeleine zgjeth Ejaninën sepse thomse gjën tek zoti Manuell një prift të përgatitur, të butë e t'urtë, me kulturë të thellë, çë di arbrishtin e shqipen: ká t'i mbësónjë Shqipen motravet të saj, historinë, zakonet shqiptare; ndërkaq i edhukon edhe te riti e këndimi bixantin.

E kështu, për 20 vjet (**1969-89**), me një'intervall të dica vitesh, motrat e vogla rrojën e punojën Ejaninë.

Venë e vijën, te kjo 'skollë e lartë kulturje, gjuhje dhe shqiptarizmi', qasur 50 motra të vogla. Dica ndër këto, më parë se t'venë nd'Shqipëri, shkojnë në Kosovë, ku punojën ndër dhera e ndë spitall, krahakraha me gjindjat më t'nëmur, ture dhënë shëmbullin e tyre si të krishtera. Po janë edhe motra të vogla çë diplomohen me teza mbi Arbëreshët, si mv.Odette Louise Marquet; ¹⁵ o si mv.Licia Conti, çë – e

shtijtur ka kryetari i Frasnitës Tommaso Ferrari, dhe e ndihur ka ca vasha t'Ejaninës - qepën në miniaturë, kukulla të veshura me kostumet e gravet arbëreshe, katund për katund; e pra, bashkë me mv.Odette Louise Marquet, mbi to shkruan edhe një libër.¹⁶

I vitit 1969 janë edhe *Lutjesorja* dhe *Oktoihu i Mbrëmësorës*, me adhaptim në muzikë bixantine.¹⁷

Ndër vitet '70 mburojën, ndër katundet arbëreshë, Rrethe e Shoqata Kulturore, Radio të Lira e Rivista Arbëreshe. U kishen edhe lerë revistat Zgijimi, Katundi Ynë, Zjarri, Rinascita Sud, etj...

Vitin 1972, Ejaninë, te Kanonika e zotit Manuell, një grup intelektualësh bën e lehet 'Associazione culturale italo-albanese /Shoqëri Kulturore Arbereshe/Acia': për të ruanj e të vlerësonjë gjuhën arbëreshe, për të zgjonjë zakonet arbëreshë, për të njihen veprat e shkrimtarëve arbëreshë e shqiptarë, e të jetë palestër për të rinjtë arbëreshë' (kështu, shkruar lëtisht, djovaset te Statuti i saj). Organ i saj është një rivistë e re, '**Zëri i Arbëreshvet**' (La voce degli italo-albanesi), që ka të dalë çdo tre muaj. Po, si ndër gjithë inixjativet, zëhet me shumë vetë e mbarohet me dy, kur vete mirë.¹⁸

Shkurt, thomi se Drejtori dhe Aministratori i vërtetë i kësaj rivistje, që del me 15 numare e për 11 vjetë (1972-1982), është zoti Emanuele Giordano. Të shkruarit arbrisht vete përpara një hap më shumë e zë e duket ndonjë shkrim shqip. Këtu shohën dritën monografi e tekste folklori nga katundet arbëreshë dhe kënka arbëreshe të muzikuara ka zoti Manuell Giordano.

E, me botimin e rivistës 'Zëri i Arbëreshëve', kontaktet me Shqipërinë shtohen. 'Zëri' i dërgohet rregullisht Akademisë së Tiranës, me k'ndërrohen rivista.¹⁹

Po Prifti s'fjë. Të mbeturit Ejaninë, katund i vogël, i pëlqen papàsit tonë: ká qetësinë e motin ç'i duhen për studimet e tij, aq ata qishtarë sa ata arbëreshë. Muzikon Himne e Rapsodi e Kalimere; prier arbërisht Vangjelin; studhjarën një Gramatikë Arbëreshe.

E shtýjën të shkonjë te katunde më të mbëdhenj, të verë përpara me karrierë, po ai s'do. Ndëse kish ndërruar katund, s'kish bënë atë ç'bëri. I sosën të bënë pjesë te Komisjona Liturgjike, të mbësonjë Katekizëm në shkollë, të jetë përfaqësues eparkial i 'Konfederatës s'Bujkëravet'/Coltivatori Diretti.

Ndë maj 1976, ture u pjerrë ka katundi i Pllatënit, zoti Manuell bën një incident me makinën e vetë, e pëson një traum te stomahji e ndë

gërllac. E shënon ai vetë, te ‘Hroniku’: *‘Ndëse u shpëtova, qe një mërakull i Tinzoti’*.²⁰

Tek ai vit (1976), merr pjesë (bashkë me F.Solano, I.Fortino, A.Giordano. F.Fusca e t’jtjerë...) tek i Trejti Seminar i Prishtinës, ku njihet Idriz Ajetin, Ibrahim Rugovën, etj...; e bën miqësi edhe me gazetarë e shkrimtarë maqedonas e kosovarë: Xh.Gega, R.Zllatku, J.Ceraja...

Meritë, sapothuaj unike, e zotit Manuell Giordano është kjo: gjatë famullitarisë s’tij në Ejaninë (1946-2009), 7 trima të katundit bëhen priftra bixantinë; 3 vasha, murgësia; e njetër trim, murg. Zoti Manuell, me shëmbullin e tij mirësjije dhe përlësjije, tëhelq djelme e vasha ndaj t’Inzoti.

Ndërkaq, bën pjesë te Komisjona liturgjike eparkjale e adhapton tekste e himne shqipe gjuhës arbëreshe. Tek Istituti i Studimeve Bestare ‘J.Stamati’ (1988-2003) mbësos, ndër të tjerat, Liturgji, Gjuhë Greke, Gjuhë Arbëreshe e Muzikë Bixantine.²¹

Dhe vete tue përgatitur një ‘Fjalorth Italisht-Arbërisht’, sepse i lypset Arbëreshvet.

Ndë gusht ’90, zoti Manuell i bën disa vizita refugjatëve shqiptarë në Pulë: në Restinco, Metaponto e pra Nova Siri. Bashkë me bestarë të Ejaninës. *‘E pëstaj – shënon te Hroniku - , s’vajta më, sepse shqiptarët u shprishin ndëpër Talljen...’*. Po shumë erhtin edhe Frasnitë dhe Ejaninë. E dera e Kanonikës s’Ejaninës është e hapët për shqiptarët, për çdo ndihmë. Çdo shqiptar që troket në derën e priftit t’Ejaninës s’ikën me duar të mbrazta. Po atje venë e vijën edhe personaxhe shqiptarë, ambasadorë, dijetarë, shkrimtarë, etj...

Vitin **1993**, zoti Giordano vete në Shqipëri, për turizëm; vitin pas, priret njetër herë për arsye qishtarë të Eparkisë s’Ungrës.

Ndër vitet **1995-1997**, zoti Manuell shkruan disa Komente të shkurtër mbi Vangjelet e të Diëlvet, në gjuhë italiane, në gazetën javore italiane *‘Il Cittadino Canadese’* - të nipit Vasil/Basilio Giordano që rron në Montréal/Canada - me titull: **‘Oggi, duemila anni fa’**. Aq të shkurtër, sa të thjeshtë e t’urtë.²²

Te viti **1997**, Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha e nderon me dekoratën ‘Naim Frashëri’;²³ dhe Presidenti i Republikës Italiane e nderon me dekoratën *‘Cavaliere al merito della Repubblica Italiana’*.²⁴

Kur pra, te viti **1999**, Parlamenti Italian aprovon Lexhen 482 mbi Minoranxat Gjuhësore Historike të Talljes, unë, vitin pas (**2000**), themelonj, bashkë me zotin lalë E.Giordano, ‘Shoqatën Kulturore Jeta Arbëreshe’. Objektivi i saj konkret është ruajtja e Gjuhës Arbëreshe,

me botimin e një rivistje të shkruar arbërisht. Për zotin Manuell zë njetër Rilindje. Zë *'Paravera e Gjuhës Arbëreshe'*.

Vitin **2000**, zoti Manuell, 80 vjet, me pëlqimin e Eparkisë s'Ungrës, boton **Vangjelin e Shën Matesë**, te një arbrishte standarde, që nganjë kupton.²⁵

Po zotit Giordano nëng i sosën: del me njetër ribotim të **'Fjalorit t'Arbreshvet t'Italisë'**, kuj i shton një **'Fjalorth (Vocabolario) Italisht-Arbrisht'**, mbi k'punonej ka gjë vjet, me ndihmën time.²⁶ Te ky vit del edhe **Alfabetizzazione Arbëreshe**, - vepër e porositur ka *'Shoqata e Mjeshtërvet Arbëreshë - Aiadi'* dhe e koordinatur ka prof.Fortino I.C.; e zoti Manuell është një ndër bashkautorët, me Carmine Stamile, Agostino Giordano, Vincenzo Bruno, Ernesto Tocci.²⁷

E, dulcis in fundo, te ky vit **2000**, vjen edhe dekorata e Presidentit të Republikës Italiane, A.Ciampi, që nderon z.Emanuele Giordano me titullin *'Komendator të Republikës Italiane'*.²⁸

Te viti **2002**, zë hera e gaxetës *'Jeta Arbëreshe'*, ç'botonj unë si drejtor përgjegjës, nga muaj: e para revistë me shkrime 100% arbëreshë. I shtijtur ka unë, gjithë studimet e zotit Manuell pak e pak, numër pas numri, dalen këtu. Zëhet me *Vangjelin e Shën Markut, Gramatikën Arbëreshe, Himnet Liturgjikë bixantinë në muzikë bixantine'*.²⁹

Vitin **2004**, Universiteti i Prishtinës,- nëpërmes Fakultetit të Filologjisë / Seminarit për të Huaj -, nderon zotin Giordano me një *'Mirenjohje'*.³⁰

Vitin **2005**, dalën si libre: **Himne Liturgjike Bixantino-Arbëreshe**³¹ e **Gramatikë Arbëreshe**.³²

Vitin **2006**, dalën si libre edhe: **Mbledhje Këndimesh Arbëreshë**³³ e **Vangjeli** i tërë - dmth. të Katër Vangjelet -, edhe ky i pjerrë te një arbrishte standarde.³⁴

E pra, vitin **2008**, dalën si dorëshkrime, po në formë definitive: **Lutjesorja, Shërbesa e Orëvet, Mbrëmësorja, Shërbesa e Varrimit**.³⁵

Emanuele Giordano në veprat e tij, në tekstet e pjerrë arbrisht, është për një *'Arbrishte standarde'*: më t'mirën t'Folme arbreshe, sa më afër shqipes, që kuptojën aq arbëreshët sa shqiptarët. Një urëz që lidhën Arbreshët me Shqiptarët, ç'i bën mirë shëndetës s'Arbrishtes. Dhe i jep Shqiptarëvet mundësinë të ngasën me dorë sa e bëgatë është Arbrishtja – edhe sot – me Fjalë, Gramatikë e Sintaksë.

Më parë se t'shkonjë në pension, zoti Manuell vë ré se Kanonika e Ejaninës – mbaruar s'stisuri, nën kujdesin e tij personal, te viti 1949, dmth. 60 vjet më parë – do restauràrtur, sepse u mbjak bashkë me të. E kështu, meqënë se nipi i tij Vasil/Basilio Giordano është senator i Republikës, Rromë, i dërgon, të nënshkruar ka peshkopi i Ungrës, proxheti për restaurimin e saj. E, mbrënda dy vjetësh, proxheti është aprovuar. Po punët e restaurimit – sipas motevet të gjetë të burokracisë italiane – zënë vet vitin 2018, pas vdekjes së zotit Giordano. Po kjo qëndron e prasmja dhuratë e zotit Manuell Giordano Qishës s'Shën Vasilit dhe Ejaninës.

Ndë gushtin e vitit **2009**, pas 63 vjetsh si prift i Ejaninës e 89 paravera ç'i mbëshojën mbi shpatullat, peshkopi i Eparkisë s'Ungrës, mbuzacjoti Ercole Lupinacci, lë zotin Manuell të verë në pension. E vjen e rron te shpia ime. Katundin, pas 63 vjet famullitarije (1946-2009), e lë më të math me shpi, po më të vogël me njerëz: ishen 920 (1946), qëndruan 500 (2009).

Në shpinë time – jashtë katundit, po ku katundi shihet i tërë në formën e tij trekëndësh – mbaron s'pjerrri arbërisht, edhe me ndihmen time, në formë definitive: *Apostullin (2010)*, *Vangjeljarin (2010)*, *Projazmenën (2011)*, *Javën e Madhe (2012)* *Paraklisin (2013)*, *Apodhipnon mikron (2014)*, *Himnin Akathist (2014)*. E më t'tjera 'thërrime bixantine'.

Ka haré se, gjithë atë ku vu duar, e sosi. E ngadita parkalesën mbi tekstet ç'ai vetë pruar arbërisht.

Në vitin **2012**, *Këshilli i Qarkut Elbasan* - për interesim të autorit elbasanas Shkëlqim Hysni Llanaj, - autor i '*Fjalorit këshillimor për pastërtinë e Gjuhës Shqipe*', Botart, Tiranë 2014 – bën zotin Manuell '*Qytetar nderi*'.³⁶

Edhe ndëse i përvuar në kurm me ndryshe dhëmbje e sëmundje, nëng këcen një të Diell pa vatur te 'Qisha tij', e Shën Vasilit të math, Ejaninë, ku këndon Meshën e, jo pak herë, edhe predhikarën.

Me trú, trim; me kurm, i mbjakur.

Viti **2015** i siell helmin e prasëm, nj'operacion tek ilja e djathtë. S'i vete mirë. E, pas një muaj durimesh, Inzot e mbjeth me të. Është dita **17 fjavarit 2015**.

E, dhaj tek viti i vdekjes së tij, *Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta* – në vizitë ndër katundet arbëreshë - e nderon, Frasnitë, *pas vdekjes*, me dekoratën '*Nënë Tereza*'.³⁷

Mbi 78 numrat e ‘Jetës Arbëreshe’, të dalë njera ahiera (2002-2014), zoti Manuell Giordano shkruan sa do, po janë edhe ata që shkruajën mbi veprën e tij. Me vdekjen e tij, të tërë nr.79/2015 i ‘Jetës Arbëreshe’ ja kushtonj figurës dhe veprës s’tij; dalën aktet e dica Kuvendesh mbi të e del Bibliografia e tij e përgjithshme. E, pas atij numri, edhe mbi të tjerët numra të J.A., dalën po shkrime mbi veprën e tij madhore, si prift e si albanolog. E gjithë libret e tij - aq prej kartje/letre, sa online; aq t’botuar, sa t’pabotuar -, gjënden te SitiWeb **jetarbreshe.it**

Pas një viti ka vdekja (2016), Sheshit përpara Qishës s’Shën Vasilit, Ejaninë, Bashkia e Frasnitës i ndërron ëmer: ish ‘Sheshi Qishës’ e nanë thërritet ‘Sheshi zoti Manuell Giordano, Prift e Albanolog’. E mbi murin e Kanonikës, me pëlqimin e Peshkopit t’Ungrës, është stisur një pllakë, ku djovaset:

**Për kujtim të zotit Manuell Giordano
(1920-2015)**

**Bir i Frasnitës e Prift i Ejaninës
(1946-2009)**

Çë këtë Qishë shërbei njera sa rroi;

Se t’jetë kujtuar ka gjithë si Arbëresh i Math

Një vit pas vdekjes s’tij ka gjithë vajtuar

Bashkia e Frasnitës këtë pllakë këtu vu.

Ejaninë, 17 fjavar 2016. ³⁸

Simbjete, pra, vitin **2020**, me rastin e Qindvjetorit të t’lerit të tij (1920-2015), Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët’, me drejtoreshen e saj në krye, prof. Diana Kastrati, i lypi Ministrisë së Diasporës të Shqipërisë dhe Bashkisë së Tiranës - në Qindvjetorin e saj si kryeqytet të Shqipërisë - t’i titullonjë një Udhë të Tiranës arbëreshit zot Emanuele Giordano. Dhe Bashkia e Tiranës e pranoi.

Shkruajta ‘jo pak’ mbi zotin lalë Emanuele Giordano, po, pesë vjet pas vdekjes së tij, edhe duan katalogatur: a) libret e Bibliotekës s’tij, arbëreshë e shqipe; b) një Bibliotekë e tërë me libre fetare; c) korrispondencë me gjuhëtarë, letrarë, dijetarë arbëreshë e shqiptarë, dhe me motrat e vogla të Jisuit; d) shënime mbi tema bestare, nëpër qindra e qindra copa karta veç, fjeturake; e) fotografi. e) një Arkiv me dhjetra

falldonesh me karta mbi argumente më të ndryshëm. Më pret një punë e gjatë.

Ndë fund të kësaj të shkurtër bio-bibliografije të ‘zotit-lalë’, pyhem:

Pse një udhë, Tiranë, e titulluar zotit Manuell/Emanuele Giordano? Ç’bëri për t’ë meritonjë?

S’bëri gjëra të mbëdha: qe Arbëresh i vërtetë, çë nderoi Etninë e Gjuhën Arbëreshe, si mundi.

Arbërisë i lypsej një ‘Fjalor Arbëresh’. E ai ja bëri.

Bestarëvet arbëreshë i lypsej Arbrishtja për t’parkalesjën Tënzonë te gjuha tyre. E ai ja dha.

Kërkoi t’ish një Prift Arbëresh i thjeshtë e i urtë. Pa dashur, qe edhe nj’Albanolog i rrallë.

Shënime:

1) “(...) *Angelicum – Pontificium Institutum Internationale Sacri Ordinis Praedicatorum – Facultas Philosophica – D.Emmanuel Giordano ex.Pont.Coll.Graecorum cum laude probatus fuit in iis quae ad Promotionem in Philosophia praescribuntur esperimentis. Quapropter, ab Apostolica Sede nobis concessa, ipsum nomine Sanctitatis Suae ad ‘Baccalaureatus’ gardum promovemus promotumque hisce litteris declaramus., Romae, die 3 Julii a.1941. f.Michael Browne P., Rector Magnificus (...)*”. (dokument origjinal, në arkivin e E.G.).

2) Jo për gjë, ‘*Zakonet e Frasnitës*’, një ndër veprat e Bilotës, zoti Giordano e çmon shumë; vepër çë unë pra nxora në dritë, në formën e saj të tërë e origjinale, mbi faqet e ‘*Jetës Arbëreshe*’(nn.3/2002-42/2005) e, sa më parë, do të dalë si ‘e-book’ mbi Sitin-Web e rivistës /jetarbreshe.it/.

3) ‘*Librë e Sherbesave të shënta të Kishës Orthodhokse, kthyer nga Greqishtja prej priftit Orthodox Fan S.Noli*, Boston, Mass.1909, shtyp. dhe Libraria Dhori Koti, Korçë 1930’, me këtë kushtim: “*Kujtim shokut t’em të dashtun Emanuelit, qi ta det Shqipnin gjithmon ma fort. At Pjetër L.Isaku, Romë 8/12/1941*”.

4) (Shih: ‘*Jeta Arbëreshe*’, nr.86/2018; po edhe SitinWeb **jetarbreshe.it** (te ‘*Bibliografie*’)

5) ‘(...) *Questi canti che pubblico, - scrive papa Sepa - con la collaborazione attiva e preziosa del mio ottimo confratello E.Giordano, non sono che una minima parte della nostra ricca collezione, pazientemente raccolta nei vari paesi albanesi della Calabria e della Lucania (...)*’; (shih ‘*Kalimere*, ditta tipografica Eduardo Patitucci, Castrovillari 1946, ff. 16).

6) “(...) *Il nostro tenace e fedele attaccamento alle tradizioni avite, e soprattutto alla Lingua patria, - shkruan E.Giordano - se da una parte è la migliore dimostrazione di riconoscenza e di pietà filiale verso di essi, dall’altra sarà il nostro più onorifico distintivo in questa nuova Patria adottiva, l’Italia (...)*”. (Shih: Emanuele Giordano: *Usi e festeggiamenti...*, op.cit., , tipi Melomo, Cassano Jonio, 1957, ff.23).

7) (Shih: *Vocabolario Arbresh-Italiano: Lettera Z*, in Shêjzat, nr.7-8/IV, korrik-gusht 1960, ff.228-236)

8) (Ernest Koliqi, ndër të tjerat, shkruan:”(...) *Il suo lavoro, di cui sentiamo tutti la vivissima necessità, colma veramente una lacuna nel campo degli studi albanologici. Esso è una chiave indispensabile per penetrare nel chiuso campo della letteratura arbëreshe, così ricco di sconosciuti o mal conosciuti tesori d’arte e di poesia (...)*; e Giuseppe Valentini shton:’ (...) *Ho letto con grande attenzione il suo ‘Dizionario degli Albanesi d’Italia’ e ne ho trovato il contenuto, oltre che ricco più di quanto non mi attendessi, anche accurato e ben ordinato, sicchè riuscirà un contributo veramente prezioso sia per lo studio dell’italo-albanese, sia per un arricchimento legittimo dell’albanese comune (...)*”.

9) “(...) *Poema e Bilotës – djovaset te ‘Parathënia’ e Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë - do t’i shërbejë popullarizimit të mëtejshëm të figurës së heroit tonë legjendar dhe pasurimit të letërsisë sonë me një vepër që paraqet interes letrar e gjuhësor e që zgjeron rrethin e temës së Skënderbeut në letërsinë arbëreshe).*

10) (Shih. Emanuele Giordano, *Mesha Arbëreshe*, në Jeta Arbëreshe, nr.12/2003).

11) (Shih: Jeta Arbëreshe, nn.86/2018, nn.87-88/2019),

12) (Shih: Jeta Arbëreshe, nr.87/2019, faqe 14).

13) E këtij viti (1968) ka datën ‘Shërbesa e Varrimit’, në dy redaçjona daktiloshkrùara me çiklostilë. E para, pa datë, tekste vet arbërisht e pa muzikë bixantine, ff.18; e dijta, tekste vet arbërisht e me muzikë bixantine, ff.19. Te faqja e prasme, është shkruar: ‘*Përkthimin e tekstit grek edhe adhaptimin e tij në muzikën bizantine e ka bërë papa Emanuil Jordani, me ndihmën e çmuar e theologut Rjenx Forestjerit; shtypur në Shën Sofi, mbë 12 të vjeshtit 1968*’.

14) ‘...e adaptuar në muzikën bizantine nga papa Emanuil Jordani, Besa, Circolo italo-albanese di cultura, Roma’. E muzikuar , në Ting.I dhe në Ting.IV, e shkruar me çiklostil, ff. 18, pa datë. Kjo ‘Liturgji e muzikuar’ gjëndet pra edhe te libri ‘E.Giordano, *Himne Liturgjike Bizantino-arbëreshe*, Biblioteka e Jetës Arbëreshe,I, Castrovillari 2005, ff. 215).

15) Odette Marquet, *Les Communautes Arbereshe, temoin de l’Ethnie Albanaise*, thèse pour le doctorat du 3ème cycle, vol.I,II, directeur de travaux:M.Christian Gut, Université de la Sorbonne Nouvelle, Paris III, 1978.

16) Licia Conti-Odette Marquet: *Shpirti mbretëror në veshjet e gruas arbëreshe/Spirito Regale nei costumi della donna arbëreshe*, Il Coscile Editore, Castrovillari 1988.

17) Papas E.Jordani, L.Forestieri, *Oktoihi i Mbrëmësores*, Ejanina 1969, botuar në çiklostil, ff. 19; përmban vet Tingëlt I e II, e s’u vate më përpara. Qe vet një provë, që s’i ka pëlqyer zotit Manuell dhe e la mbë gjimës.

18) Revista ka, si Drejtor përgjegjës/responsabile, një lëti, sepse gazetar; drejtorja është në Kastrovillari, ndërsa zoti Manuell zë si bashkëdrejtor (nr.1/1972); te nr.2/3-4/1972 është te ‘Komitati drejtues’, (me 17 vetë), po Redacjona shkon Ejaninë; me nr.5/1973, edhe Aministracjona shkon Ejaninë, te zoti Giordano. Te nr.6-7/1973, zoti Manuell Giordano e Agostino Giordano janë kryeredaktorët e revistës. Me nr.12/1979 edhe drejtorja shkon Ejaninë, po zoti Manuell e i nipi rezultojën kryeredaktorë.

19) (Bibliografia e rivistës ‘Zëri i Arbëreshëvet’, me autorë e shkrime, gjëndet mbi ‘Jeta Arbëreshe,nr.75/2013, ff.19-25; Shih edhe Sitin Web jetarbreshe.it – *Bibliografie*).

20) (Këtë ndodhje zoti Giordano e shënon mbi ‘Xpóvikov’ (shkruar dhjaj kështu, greqisht), një ditare ku singon, lëtisht, vit pas viti, shurbiset me më rëndësi ç’bën e c’i bien, ç’kur vë këmbë Ejaninë (17-7-1946) njera ditën ç’ikën (25-8-2009) e shkon në pension.

21) (Tek viti 1991 diplomon, si docent-relator: studenten Cassiano Angela Maria, me tezin ‘*La divina liturgia eucaristica – Memoriale della morte e della resurrezione di Cristo e rendimento di grazie*’; studenten Godino Elisa, me tezin ‘*Icona e Liturgia*’; studentin Costantino Bellusci, me tezin ‘*La Divina Liturgia di San Giovanni Crisostomo – origine, sviluppo e commento*’; te viti 1994, diplomon studentin Francesco Palmieri, me tezin ‘*Lo Spirito Santo in Gioacchino da Fiore e Basilio di Cesarea: Occidente ed Oriente a confronto*’).

22) Emanuele papas Giordano, ‘*Oggi, duemila anni fa*’, tek ‘Il Cittadino Canadese’, ç’ka dita 23 gusht 1995 njera ndër 24 shëndrë 1997. (Ësht gazeta italiane nr.1 në Québec e në Canada, Montréal, e themeluar te viti 1941, 15.000 kopje të shtypur, editor-drejtor on.Basilio Giordano, kryeredaktor Vittorio Giordano; journal@cittadino.ca / 6020 Jean Talon est, bureau 710, Montréal, Québec, H1S381, Tel.514.253.2332 / Fax 514.253.6574).

23) ‘Republika e Shqipërisë – Presidenti i Republikës i jep papasit Emanuele Giordano *Urdhërin e artë ‘Naim Frashëri*’, për kontribut të shquar në fushën e shkencave albanologjike si dhe në zhvillimin e

kulturës sonë kombëtare’ – Tiranë, më 14.1.1997, dekret nr.1704, Presidenti Sali Berisha’.

24) ‘Il Presidente della Repubblica Italiana, capo dell’Ordine ‘al merito della Repubblica Italiana’, in considerazione di particolari benemerenze, con decreto in data Roma 2 giugno 1997, ha conferito l’onorificenza di *Cavaliere* a don Emanuele Giordano – Firmato Scalfaro, controfirmato Prodi’.

25) (Il Vangelo di San Matteo/*Vangjeli i Shën Matesë*, Eparchia di Lungro, 2000, tip.Mit, Cosenza, ff.143. Tekst italian ka e shtrëmbura, tekst arbëresh ka e djathta; e unë i dhë një dorë).

26) *‘Questo è il Dizionario che serve agli Arbëreshë. – shkruan E.Giordano tek Paraqitja e ‘Fjalorit’ - A quegli Arbëreshë, beninteso, - studenti e adulti – che amano la propria lingua, e si avvicinano ad essa per imparare a leggerla e a scriverla, e a parlarla meglio. (...) L’approvazione della Legge di Tutela delle Minoranze Linguistiche Storiche d’Italia (482/99) ha colto tutti di sorpresa. Compreso me. Mi sono accorto di aver esaurito le copie dell’Edizione Paolina del ’63 e ho approntato in tutta fretta questa nuova Edizione. Si tratta in realtà di una ristampa del vecchio Fjalor, a cui ho aggiunto un Vocabolario Italiano-Arbëresh, da più parti richiestomi (...)’.* Te Parathënia e ‘Fjalorthit’, zoti Manuell, ndër të tjerat, shkruan: *‘Questo Vocabolario ‘Italiano-Arbëresh’ l’avrei dovuto compilare parecchi anni fa, subito dopo il ‘Fjalor i Arbëreshvet’, ma forse non ne avvertii la necessità. Oggi, invece, l’insegnamento della lingua albanese nelle scuole lo rende indispensabile.(...)Questa prima Edizione è ricca di oltre 11.000 lemmi (...). Un ‘grazie’ doveroso va a mio nipote, prof.Agostino Giordano, per la sua preziosa collaborazione: insieme a lui ho già messo mano alla prossima Edizione’.*

27) AA.VV.,*Alfabetizzazione Arbëreshe*, 2 vëllime të pandashëm/indivisibili, Edizioni Il Capitello, Torino 2000; Carmine Stamile (Alfabeti Arbëresh), Agostino Giordano (Teste të Folmevet Arbëreshe, Letërsi), Vincenzo Bruno (Folklor), Prof.I.Costante (Gramatikë), Ernesto Tocci (Histori), zoti Emanuele Giordano (Istituciona relixhooze e Muzikë Popullore). ‘Questo testo – djovaset te Parathënia – è diretto prima di tutto agli alunni albanofoni, che

frequentano o frequenteranno la scuola dell'obbligo, e naturalmente ai loro insegnanti; poi è rivolto ai soggetti alfabetizzati, e in particolare alle famiglie dei paesi albanofoni che hanno a cuore – motivatamente – la salvaguardia, la valorizzazione e la vita attiva e consapevole della socio-cultura arbëreshe attraverso il formidabile 'strumento' che è la lingua'.

28) 'Il Presidente della Repubblica Italiana, capo dell'Ordine 'al merito della Repubblica Italiana', in considerazione di particolari benemeritenze, con decreto in data Roma 2 giugno 2000, ha conferito *l'onorificenza di Commendatore* a don Emanuele Giordano, con facoltà di fregiarsi delle insegne stabilite per tale classe. – Firmato Ciampi, controfirmato Amato'.

29) Tek Editoriali i t'parit numër të 'Jetës Arbëreshe', ndër t'tjerat, shkruan: 'Kam besë se ndëse do të shpëtom i vërtet Arbërinë, s'është më mot fjalësh. Udhë është e gjatë po kueltë tanë janë të prërët. Na nget të shurbemi. Pa thërritur. Mbi gjurmat e 'Fjamurit Arbërit' të De Radës, zëm'e shkruami arbërisht. Ashtu si foljën Arbëreshët, ndër katundet e tyre'.

30) 'Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në 30-vjetorin e fillimit të punës së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nderon me '*Mirënjohje*' Emanuele Giordano, për kontribut të veçantë dhënë veprimtarisë së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 16 gusht 2004, Drejtori i Seminarit, prof.dr.Fadil Raka'.

31) (Emanuele Giordano, *Himne Liturgjike Bizantino-Arbëreshe*, Biblioteka e 'Jetës Arbëreshe'-I, Castrovillari 2005, ff.215. Në Parathënie zoti Manuell shkruan: '(...) Këtë libër ja dhuronj InterSinodit, si një provë mbi vlerjen pastorale të gjuhës arbëreshe. Kur mundet, kanë t'i jipen besimtarëvet arbëreshë tekste arbëreshë, me muzikën që edhe njohin. Te ky libër ndërrova gjuhët, po muzika origjinale pak o fare. E besimtarët kuptojnë dhe Arbërishtja rron'.

32) (Emanuele Giordano, *Gramatikë Arbëreshe*, prefazione di Salvatore Italia, nota introduttiva di Pierfranco Bruni,- sovvenzionato dal Mibac, Manduria 2005, ff.68. Tek artikulli ‘Come scrivere in arbëresh’, që autori vë përpara ‘Gramatikës’, djovaset: ‘(...) Njera sot, ndër katundet arbëreshë, kërkuam më shpejt t’ë foljem gjuhën arbëreshe; sotepara, edhe me ndihmën e shkollës, kem zë t’ë shkruami. Sa më gjindë dinë të shkruajën te një katund arbëresh, aq më vjet do të rronjë gjuha arbëreshe. Për të rronjë mirë, ka të jetë e folur, e djovasur dhe e shkruar’.

33) Emanuele Giordano, *Mbledhje Këndimesh Arbëreshë*, (që këndohen Ejaninë e Frasnitë), Supplemento a Jeta Arbereshe, nr.50/2006, Castrovillari 2006, ff.159. Në Hyrje djovasmi: ‘(...) Kjo mbledhje do të bëgatënj ndërtesën këngëtare e Arbëreshëvet të Italisë, që kanë dijtur të ruajin me kujdes të math dhe të trashëgojin me vullnet të fortë këtë pasuri kulturore. Do t’ish mirë ndëse gjithë këndimet’e katundevet arbëreshë mblidhëshin, botohëshin dhe këndohëshin: pse ata janë pasuri e të njëjtit popull, megjithëse i shprishur në botë’.

34) *Vangjeli*, i pjerrë arbërisht nga zot Emanuele Giordano, Supplemento a Jeta Arbëreshe nr.50/2006, Mit, Cosenza 2006, ff.230. Te Parathënia djovasmi: ‘Falënderonj shumë tim nip Agostino Giordano, që më shtyjtë të bëja këtë vepër, e më ndihu. Dëshiroja se Libri më i shëjtë i të Krishterëvet t’ vejt ndër duart e Arbëreshëvet. Se të jenë, çdo ditë, Arbëreshë dhe të Krishterë të vërtetë’.

35) Me të vërtetë, Pjesat liturgjike ‘*Mbrëmësorja*’ dhe ‘*Shërbesa e Varrimit*’ zoti Manuell i kish pjerrë arbërisht e muzikuar ç’ka vitrat ’60, ndërsa të tjerat dy Pjesa zu e i botoi mbi Jeta Arbëreshe; po te ky vit gjëjën formën e tyre definitive.

36) ‘Republika e Shqipërisë – Këshilli i Qarkut Elbasan – Me propozim të një grupi intelektualësh të Qarkut Elbasan, Këshilli i Qarkut Elbasan, me vendim nr.32, datë 11.6.2012, i jep titullin ‘*Qytetar nderi i Qarkut Elbasan*’ z. Emanuele Giordano, me motivacionin: Për kontribut të shquar në fushën e Albanologjisë, përhapjes së kulturës arbëreshe, për ruajtjen e traditës dhe gjuhës në trevat shqipfolëse’. Kryetari Eugen Isaj.’.

37) ‘Republika e Shqipërisë – Presidenti i Republikës i jep Emanuele Giordano (pas vdekjes) *Dekoratën ‘Nënë Tereza’*, ‘vlerësim të veprë së tij të rrallë si poet, gjuhëtar dhe gazetar, i cili me përkujdesje arbërore dhe përdëllim i një njeriu të Zotit iu përkushtua përhapjes dhe lartësimit të vlerave të gjuhës, folklorit dhe letërsisë shqipe’ – nr.dekreti 9039, Tiranë, më 3-4-2015 – Presidenti i Republikës Bujar Nishani’.

38) Shih: Jeta Arbëreshe, nr.81/2016, faqe 67. (*Fjavar/Febbraio* = *shkurt*).

RECENSIONE

Mehmet Halimi, Prishtinë
Kujtim Shala, Prishtinë

LEKSIKON I TERMAVE TË SOCIOLINGUISTIKËS

Leksikoni i termave të sociolinguistikës, i autorëve Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, vijon serinë e leksikonëve të gjuhësisë, me vështrim enciklopedik, si dhe me shpjegime bibliografike, të nisur nga Ismajli e Rugova. Nënvizojmë se për të finalizuar projektin e fjalorëve të gjuhësisë, pas këtij leksikoni, autorët kanë paralajmëruar që të vazhdojnë me fjalorin e termave të gramatikës, pastaj me atë të gjuhësisë historike, me qëllim që në fund të bëhet rikapitulim me një fjalor të vetëm të termave të gjuhësisë.

Në *Leksikonin e termave të sociolinguistikës* janë përfshirë shpjegime për mbi 850 koncepte, me përdorim në kontekste të ndryshme teorike, ndërsa në rreth 770 zërash janë dhënë edhe shpjegime për përdorimin e termave përkatës.

Edhe pse sociolinguistika konsiderohet një fushë e rëndësishme e studimeve gjuhësore, fushat e ndryshme, me të cilat ajo ka afërsi, si sociologjia, etnografia, etnologjia, studimi i tekstit, psikolinguistika etj., ndikimet e tyre dhe të traditës linguistike të periudhave të gjuhësisë krahasimtare, të gjuhësisë strukturale dhe të gjuhësisë gjenerativet, kanë bërë që autorët të trajtojnë me kujdes të madh fjalësin e përfshirë në këtë leksikon.

Duke i ndjekur me përpikmëri autorët, na duket e nevojshme që të bëjmë një paraqitje të shkurtër të fushës së trajtimit të këtij leksikoni:

Në përgjithësi, sociolinguistika konsiderohet disiplinë e vonë në raport me disiplinat e tjera linguistike. Ajo është përhapur sidomos pas viteve '60-70 të shekullit XX, kohë kur studimet linguistike në përgjithësi po arrinin zhvillime të reja, kur po lindnin hipoteza të reja mbi funksionimin e ligjërimit njerëzor, po ngriheshin metoda të analizës gjuhësore, por, në të njëjtën kohë, përmes zhvillimeve të tilla, po viheshin në dyshim vetë themelet e disiplinës, në radhë të parë, për shkak të raporteve të shumanshme me fushat e afërta të studimeve, si: psikolinguistika, sociolinguistika, pragmatika, analizat e tekstit, etnografia e komunikimit, etnometodologjia etj. Në disa tradita, sidomos në Francë, u krijua dhe shprehja *shkenca e ligjërimit*, gjë që mund të shihet edhe në Fjalorin enciklopedik të shkencave të ligjërimit të autorëve të njohur secili në fushat e tyre përkatëse, Osvald Dykro, në

filologjinë e gjuhës dhe Cvetan Todorov, në studimet letrare dhe të shkencave të afërta, të semiologjisë, të pragmatikës etj.

Që nga përdorimi i pare i termit sociolinguistikë nga Haver Currie, më 1952, e nëpër zhvillimet e mëtejme, në raport me sociologjinë e gjuhës, me psikologjinë sociale të ligjërimit, me antropologjikën, me analizën e diskursit, me etnografinë e komunikimit, e deri edhe me raportet midis gjuhës dhe gjinisë, kanë ndodhur zhvillime të specializuara të disiplinës, të trajtësimit të koherencës dhe të përzgjedhjes së nocioneve e të koncepteve, gjë që ka mundur të shihet nëpër revistat për sociolinguistikë dhe për çështje dhe për metodologji që nuk ishin shtruar më pare, sidomos për teknika të përdorura për vjeljen e të dhënave, të mjeteve të analizës statistike dhe të nënkuptimeve që kanë sjellë ato ndryshime. Kalimet nga teoritë e periudhës së studimeve historiko- krahasuese, gjenealogjike , të dialekteve rajonale e të idiolekteve, të atlaseve gjuhësor tradicionalë e deri te teoritë e variacionit të lirë të strukturalistët, sociolinguistika ka kaluar nëpër zhvillime të ndryshme teorike metodologjike.

Sociolinguistika sot po kalon nëpër faza zhvillimi të rregullt, ndërsa preokupimet që tashmë identifikohen si të saj, po marrin vëmendjen e një numri gjithnjë e më të madh e më të gjerë hulumtuesish, nga formulimet dhe synimet me peshë teorike të personaliteteve të shquara e deri te ndërlidhjet me tematikat gjithnjë e më aktuale me politikat e gjuhëve.

Kështu, disi në vazhdimësi, shfaqet nevoja për kodifikimin e disiplinës, përmes glosarëve semiologjik e shpjegues. Shpjegimet kanë një traditë të krijuar tashmë që dëshmohet me vepra, studime të veçanta, po edhe me ata pak fjalorë të sociolinguistikës apo të linguistikës në përgjithësi, siç janë ata të: Trudgill-Campoy, David Crystal, Hadmond Bussman, të grupit Swann, Deument, Lillis, Mesthrie e të tjerëve në tradita dhe gjuhë të ndryshme.

Këtë histori e problematikë të pasur të sociolinguistikës autorët e leksikonit, Ismajli, Rugova e Munishi, e kanë dhënë në trajtë paraqitjeje e shpjegimi të koncepteve të saj më të rëndësishme.

Përshtatja në gjuhën shqipe e termave është bërë sipas përdorimeve në literaturën e paktë, apo edhe sipas vlerësimit të autorëve . meqenëse shumëçka në këto fusha është ende e pastabilizuar, autorët e kanë parë të nevojshme që të ruajnë referimet terminologjike ndërkombëtare.

Redaktimin e tërë materialit e ka bërë Rexhep Ismajli.

Duke marrë parasysh mungesën e plotë të një leksikoni të tillë në gjuhësinë shqiptare, si dhe numrin tepër të vogël të tyre në gjuhësi në përgjithësi, ky fjalor hap një shteg shumë të rëndësishëm të kodifikimit e të shpjegimit gjuhësor në kulturën tone, si dhe e sprovon gjuhësinë tonë përballë traditës kodifikuese gjuhësore universal.

Leksikoni i termave të sociolinguisticës është një vepër kodifikuese fundamentale.

Leksikoni i termave të sociolinguistikës është një vepër-model në këtë rrafsh të dijes.

Rexhep Ismajli, Prishtinë

BRIAN D. JOSEPH,
VËSHTRIME ALBANO-BALKANOLOGJIKE¹

Në vitin 1996 Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve nisi projektin afatgjatë të botimeve të serisë së veprave të albanistëve të traditës, shqiptare dhe të huaj, me përqendrim kryesisht tek autorët e huaj, kryesisht ato që nuk gjendet në gjuhën shqipe, po edhe të autorëve shqiptarë që nuk janë më midis nesh. Synohej krijimi i një fondi themelor të veprave të rëndësishme në këtë fushë. Qysh atëherë u botuan 1 vëllim (nga 5) i veprave të S. Rizës, 2 (nga 4) vëllimet e veprave të G. Zajmit, nisi seria e veprave të I. Ajetit (5 vëllime) dhe të W. Cimochowskit (1 vëllim) dhe të gjitha këto u projektuan në ato vite të vështira, ndërsa dolën për një pjesë pas Çlirimit të Kosovës. Ndërkohë u botuan vëllimet e veprave të zgjedhura të E. Çabejtë, të I. Rugovës në Seksionin e Gjuhësisë-Letërsisë dhe të A. Hadrit, të A. Budës, të F. Aganit (në Seksionin e Shkencave Shoqërore), ndërsa projekti vijoi me përgatitjen e veprave të albanologëve të shquar N. Jokl, H. Pedersen, F. Miklošič, R. Nahtigal, E. P. Hamp, etj. Tani po sjellim vëllimin 33 të kësaj serie, me synimin për të krijuar një korpus veprash të rëndësishme për studimet albanologjike, pa i llogaritur vëllimet e botimeve të anëtarëve apo bashkëpunëtorëve të Akademisë. Gjatë punës u pa e nevojshme që veprat e autorëve të traditës, të cilat nuk gjenden lehtë as në botimet e tyre origjinale të botohen me përkthimin dhe origjinalin në gjuhën përkatëse. Derisa veprat e Cimochowski-t e të Pedersen-it u botuan vetëm në përkthimin shqip, veprat e Miklošič-it, të Nahtigal-it, të Jokl-it, u pa e arsyeshme të silleshin dhe në origjinalin e tyre (gjermanisht e sllovenisht), ndërsa veprat e autorëve të huaj që botohen me të gjallë të tyre sillen kryesisht në versionin shqip (Hamp, Savoia, Sawicka). Në këtë seri hyjnë dhe veprat e anëtarit të jashtëm që u shua tash vonë, W. Fiedler-it, të cilat botohen për herë të parë dhe vetëm gjermanisht (përkthimi tri i vëllimeve me mbi 2.500 faqe kërkonte kohë). Deri tash Seksioni ia ka dalë të botojë në këtë kuadër 33 vëllime dhe tani po vijmë me vëllimin e ri.

¹ Ky tekst është marrë nga botimi Brian D. Joseph, Vështrime albanobalkanologjike dhe paraqet Parathënien e tij. Red.

Tash kemi kënaqësinë që në këtë seri të vijnë para publikut shkencor dhe lexues shqiptar me përmbledhjen e studimeve dhe të shkrimeve për shqipen dhe gjuhët e Ballkanit të profesor Brian D. Joseph-it, linguist i shquar nga Universiteti Shtetëror i Ohajos.

Pas Luftës II Botërore në SHBA pati interesim më të gjallë për studimet albanistike me nxitje në dy vija: nga vetë studiuesit amerikanë, ndër të cilët kryet e vendit e zë Eric Hamp, pastaj shquhen Leonard Newmark, Janet Byron, Gary Bevington, Kosta Kazazi, Martin Huld, Philippe Hubbard, Victor Friedman, Bernd Fischer, Antonia Yung, Alexander Fox, Brian Joseph, Mat Curtis e të tjerë më vonë; vijën tjetër e përfaqësojnë studiuesit shqiptaro-amerikanë qysh me Kostë Çekrezin, Faik Konicën, Fan Nolin, e më tej me Stavro Skendin, Arshi Pipën, Safije Jukën, Sami Repishtin, Nikolla Panon, Peter Priftin, Elez Biberajn, Eda Derhemini, Ardian Vehbiun e të tjerë.

Në brezin e të lindurve pas LDB-së (1951) me interesimet e tij për gjuhën shqipe shquhet tani linguisti gjerësisht i njohur me ndihmesat e tij në fushat e gjuhësisë historike, të teorive morfologjike, të sociolinguistikës, të studimeve greke, sanskrite dhe përgjithësisht indoeuropiane, profesori i Universitetit Shtetëror të Ohios Brian D. Joseph.

Brian D. Joseph, pas studimeve të shkëlqyeshme për gjuhësi të përgjithshme dhe për gjuhët klasike në Universitetin e Jelit, u doktorua në fushën e gjuhësisë në Universitetin e Harvardit, specializoi për gjuhën greke (mikeniane, klasike, mesjetare dhe moderne), për gjuhën shqipe, për sanskritishten dhe për gjuhët e tjera indoeuropiane, si latinishtja, avestishtja, irishtja e vjetër, gotishtja, hetitishtja e hindishtja, ndërsa në fushat e gjuhësisë u specializua për gjuhësi historike, për gjuhësi ballkanike, sociolinguistikë dhe teori morfologjike. Si studiues tashmë i njohur në përmasa ndërkombëtare, përveç profesurës për linguisitkë në Universitetin Shtetëror të Ohajos, profesurës për gjuhësinë sllavo-jugorre Kenneth E. Naylor, kryesimit të Departamentit të linguistikës, Brian D. Joseph është anëtar dhe Kryetar i Shoqatës së Linguistëve të Amerikës, anëtar i Shoqatës së Filozofëve të Amerikës, anëtar i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Amerikës, anëtar i Shoqatës Amerikane për Avancimin e Shkencës dhe i shumë shoqatave e institucioneve të tjera, përfitues i granteve dhe i projekteve të shumta kombëtare e ndërkombëtare, i ftuar për konferenca e ligjërata në të katër anët e botës. Njihet tashmë si editor për mandate të caktuara i revistave *Empirical Approaches to Linguistic Theory*, *Language*, *Diachronica*, *Journal of Greek Linguistics*, i Series Syntax and Semantix, i Ligjëratave Kenneth

Naylor, por mbi të gjitha si autor apo bashkautor i veprave të rëndësishme *Language History, Language Change, and Language Relationship: An Introduction to Historical Linguistics*, co-editor bashkë me H. H. Hock; *The Handbook of Historical Linguistics*; *The Gift of Gab*; *Desert Storm: The Official Desert Storm Bible*; *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive: A study in Areal, General, and Historical Linguistics*; *Themes in Greek Linguistics*, vol. II, co-editor me G. C. Horrocks; *Modern Greek*, bashkë me I. Philippaki-Warbuton; *Balkan Syntax and (Universal) Principles of Grammar*, co-editor me I. Krapova; *Morphology and Universals in Syntactic Change: Evidence from Medieval and Modern Greek*; *When Languages Collide: Perspectives on Language Conflict, Contact, and Coexistence*; dhe vitin tjetër pritet të dale vepra tjetër e rëndësishme *Balkan Linguistics*, bashkë me Victor Friedman. Ka botuar shumë artikuj nëpër revista gjithandej në botë, ka bërë paraqitje të gjera në burimet në-linjë, etj.

Në studimet greke Brian Joseph-i ka bërë emër jo vetëm me ndihmesat e rëndësishme për greqishten moderne, po edhe për fazat e saj më të hershme, ndërsa tash vonë edhe me studimet për greqishten e folur në jug të Shqipërisë dhe me kontaktet e saj me shqipen, ashtu si me të folmet arbërore në Greqi – aravnitikan.

Në studimet ballkanike interesimet e tij janë drejtuar kryesisht në strukturat morfologjike dhe sintaksore, gjithnjë të para dhe në vështrimin semantik, por paralelisht dhe në mbështetjen e vështrimeve sociolinguistike. Gjithnjë e më shpesh bien në sy edhe vështrimet e tij etimologjike.

Libri i tij *Sinkronia dhe diakronia e infinitivit ballkanik* paraqet një vështrim të plotë të problematikës në të gjitha gjuhët e Ballkanit, problematizimet strukturore-sintaksore brenda secilës prej atyre gjuhëve, analizat sintaksore e morfologjike, por edhe vështrimet areale. Tashmë është bërë vepër reference standarde për këto studime. Vështrimet për shqipen në atë monografi paraqesin interes për albanistikën, por ato nuk mund të përktheheshin me këtë rast të veçuar nga tërësia, ku janë të integruara.

Studimet e tjera të Brian D. Joseph-it për gjuhën shqipe përqendrohen në aspekte të veçanta morfosintaksore, ndonjëherë dhe etimologjike, po edhe në fushën e kontakteve të shqipes me greqishten e të raporteve me rumanishten dhe gjuhët sllave. Gjithnjë e më shumë bien në sy interesimet e tij për arbërishten e Greqisë dhe për raportet e saj me greqishten e me shqipen tjetër, po edhe për kontaktet e shqipes me greqishten, njohës i dorës së parë i së cilës është.

Ndërkaq, në studimet ballkanistike Brian Joseph-i sheh një rol me rëndësi për gjuhën shqipe në tërësinë e këtyre raporteve, sidomos me rumanishten, me gjuhët sllave të jugut dhe me greqishten dhe këtë rol dhe pozitë përpiqet ta përtregojë në tërë spektrin e studimeve të tij ballkanologjike, gjithë duke u ndihmuar dhe me dijet e gjera në fushën e gjuhësisë krahasimtare-historike indoevropiane, ku studimi i shqipes po ashtu ka një vend dhe rol.

Në vëllimin që kemi përpara janë përmbledhur studimet e Brian Joseph-it që kanë të bëjnë me shqipen, apo me shqipen në kontekst ballkanik. Bie në sy se në të gjitha interpretimet e tij ndiqet një vështrim integruar për gjuhën, me mtesën për të bërë shpjegime sa më të plota nëpër rrafshet e ndryshme - morfologjike dhe morfosintaksore, semantike, etimologjike, sociolinguistike. Suksesin e tij në tërë këtë punë e garantojnë njohjet e thelluara teorike linguistike dhe aftësia për të përfituar në çdo rast nga arritjet teorike të disiplinave dhe të shkollave linguistike nga tradicionalet e deri te të fundit të kohës sonë. Shqyrtime të tij kanë gjithnjë një fill teorik dhe kjo i bën edhe më të rëndësishme.

Të shpresojmë se kjo përmbledhje e studimeve të Brian Joseph-it do të jetë edhe një nxitje për vështrimet komplekse të realiteteve gjuhësore të shqipes dhe të gjuhëve të Ballkanit në dimensione e tyre sinkronike e diakronike, në strukturat e veçanta, në ndërndikimet dhe në pleksjen shoqërore brenda bashkësive të veçanta dhe në kuadrin më të gjerë të 'bashkësisë ballkanike', apo edhe më gjerë historikisht në kuadrin indoevropian, etj. Urojmë që profesor Brian D. Joseph-i të na vijë dhe me vëllime të tjera studimesh në fushat e albanologjisë-ballkanologjisë.

Përkthimin me zell, dije e vullnet të studimeve të këtij vëllimi e ka bërë anëtari korrespondent i ASHAK-ut, prof. dr. Bardh Rugova.

STUDIME
Revistë për studime filologjike
27
2020

2021

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Imri Badallaj

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 20 tabakë shtypi
Tirazhi: 200 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup